
بسم الله الرحمن الرحیم

Eruditi, juristi dhe komentuesi

NASER MEKARIM SHIRAZI

KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT

(Xhuzi i njëzetenëntë)

Nga fillimi i sures "Mulk" deri në fund të sures "Murselat"

TIRANË, 2020

Titulli: ***KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT***

(Xhuzi i njëzetenëntë)

Autori: ***Eruditi, juristi dhe komentuesi***

Naser Mekarim SHIRAZI

Recensent: ***Vullnet MERJA***

E përktheu nga persishtja: ***Valbona HOROZOVA***

E redaktoi: **Jerida KULLA**

E ballafaqoi: **Rajmonda FEZA**

Korrektura teknike: ***Vjollca KARAJ***

Përkujdesja grafike: ***Sabrie FEZA***

Kapaku: ***Sabrie FEZA***

Botoi: ***Shoqata "FLLADI"***

Copyright: ***Shoqata "FLLADI"***

Shtypshkronja e shtëpisë botuese ***LILO***

Sure "El Mulk"

Zbritur në Medine

30 Ajete

Përmbajtja e sures "El Mulk"

Kjo sure është në fillim të kapitullit të 29-të të Kur'anit të Madhëruar. Bën pjesë tek suret që sipas transmetimeve të njohura, e gjitha ka zbritur në Mekë. Sikurse pjesa më e madhe e sureve të këtij kapitulli, të cilat janë Mekase. Po ashtu sipas mendimit të disa prej komentuesve dhe intrepretuesve të Kur'anit të gjitha suret e këtij xhuzi janë mekase, ndryshe nga[1] suret e xhuzit pararendës, të cilat ishin të gjtha medinase. Siç do të pohojmë dhe në komentet në vijim, surja "El Insan" është e përjashtuar nga ky rregull. Ajo ka zbritur në Medine.

[1] Tefsiri "Fi Dhilalil Kur'an", vëll. 8, f. 180.

Surja "El Mulk", ndryshe njihet dhe me emrin "Munxhieh" - "Shpëtuese", ose me emrin "Uakieh", ose "Mani'ah", sepse lexuesi i Kur'anit, duke lexuar këtë sure, e shpëton veten nga dënimi i All'llahut dhe dënimi i varrit. Kjo sure është një prej sureve me shumë mirësi, në të cilën janë trajtuar çështje të shumta kur'anore. Mirëpo përmbajtja e kësaj sureje, kryesisht bazohet në tri pjesë:

Pjesa e parë: Ajetet e kësaj pjese trajtojnë çështje që lidhen me zanafillën e krijimit, të cilësive të All'llahut, sistemin e mahnitshëm të krijimit, veçanërisht sistemin e krijimit të qiejve dhe të yjeve, sistemin e krijimit të tokës dhe dobive të saj, sistemin e krijimit të zogjve, të ujërave të rrjedhshme, trajton çështjen e krijimit të shqisave si: veshët, sytë si dhe të mjeteve të tjera të njohjes.

Pjesa e dytë: Ajetet e kësaj pjese trajtojnë çështjen e Ringjalljes dhe të dënimit në Jetën Tjetër dhe bashkëbisedimin e melekëve të dënimit me banorët e Xhehennemit si dhe çështje të tjera të ngjashme me to.

Pjesa e tretë: Ajetet e kësaj pjese trajtojnë çështjet që lidhen me paralajmërimin dhe kërcënimin e jobesimtarëve dhe të padrejtëve, për llojet e dënimit në këtë botë dhe në Botën Tjetër.

Disa komentues të Kur'anit mbrojnë idenë se thelbi i kësaj sureje lidhet me sundimin dhe fuqinë e Zotit. Kjo është përmendur dhe në ajetin e parë.[1]

[1] Tefsiri "Fi Dhilalil Kur'an", vëll. 8, f. 184.

Mirësitë e leximit të sures "El Mulk"

Janë transmetuar shumë hadithe nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe imamët, në lidhje me mirësitë e leximit të kësaj sureje.

Transmetohet nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* se ka thënë: *"Ai që e lexon suren 'El Mulk', ngjason me atë që ka qëndruar zgjuar Natën e Kadrit."*.[1]

Dhe: *"Do të dëshiroja që surja 'El Mulk' të ishte në zemrën e të gjithë besimtarëve."*.[2]

Në një hadith të transmetuar nga Imam Muhammed Bakir *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet: *"Surja 'El Mulk' është 'surja e ndalimit', pra, është surja që parandalon nga dënimet e varrit. Kjo sure është përmendur edhe në Teurat, me po këtë emër. Ai që e lexon këtë sure gjatë natës, shumë herë dhe bukur, nuk do të konsiderohet prej të pavetëdijshmëve."*.[3]

Në lidhje me këtë çështje, ekzistojnë shumë hadithe.

Sigurisht, të gjitha këto dobi të mëdha, nuk nënkuptojnë leximin e pashoqëruar me meditim, leximin pa reflektimin dhe pa praktikim. Leximi i saj nënkupton edhe shoqërimin me meditim, reflektim dhe veprim, ku konkretizohet ajo që thotë surja.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 320.

[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 320.

Ajetet 1 - 5

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

تَبَارَكَ الَّذِى بِيَدِهِ الْمُلْكُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَىْءٍ قَدِيرٌ، الَّذِى خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيَاةَ لِيَبْلُوَكُمْ أَيُّكُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا وَهُوَ الْعَزِيزُ الْغَفُورُ، الَّذِى خَلَقَ سَبْعَ سَمَاوَاتٍ طِبَاقًا مَا تَرَى فِى خَلْقِ الرَّحْمَنِ مِنْ تَفَاوُتٍ فَارْجِعِ الْبَصَرَ هَلْ تَرَى مِنْ فُطُورٍ ۳ ثُمَّ ارْجِعِ الْبَصَرَ كَرَّتَيْنِ يَنْقَلِبْ إِلَيْكَ الْبَصَرُ خَاسِئًا وَهُوَ حَسِيرٌ، وَلَقَدْ زَيَّنَّا السَّمَاءَ الدُّنْيَا بِمَصَابِيحَ وَجَعَلْنَاهَا رُجُومًا لِلشَّيَاطِينِ وَأَعْتَدْنَا لَهُمْ عَذَابَ السَّعِيرِ۔

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!

"Qoftë i lartësuar Ai, në dorën e të Cilit është pushteti suprem dhe që është i Fuqishëm të bëjë çdo gjë! "

" Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë. Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh."

"Ai ka krijuar shtatë qiej njërin mbi tjetrin. Nuk mund të gjesh në krijimin e të Gjithëmëshirshmit kurrfarë ceni. Hidhe vështrimin: a sheh ndonjë plasaritje?"

"Pastaj hidhe sërish vështrimin; sytë e tu do të kthehen të lodhur e të molisur."

"Ne jua kemi zbukuruar qiellin më të afërm me yje të shkëlqyeshme dhe i kemi bërë ato si plumba për të larguar djajtë, për të cilët kemi përgatitur dënimin me zjarr."

Komentimi

Në univers nuk vërehet asnjë e metë apo mangësi

Kjo sure fillon me trajtimin e çështjes së rëndësishme të sundimit dhe fuqisë së Zotit, si dhe të përjetësisë së Qënies së Tij të Pastër, e cila, në realitet, është çelësi i të gjitha çështjeve të kësaj sureje.[1]

Ajeti 1 thotë: **"Qoftë i lartësuar Ai, në dorën e të Cilit është pushteti suprem dhe që është i Fuqishëm të bëjë çdo gjë!"**.

Fjala *"tebareke"* rrjedh nga fjala *"berketun", e cila në zanafillë* ka kuptimin e gjoksit të devesë. Kur thuhet *"berekel beiru"*, kuptimi

[1] Kjo është surja e dytë që fillon me fjalën *"tebareke"* (Qoftë i lartësuar!). Surja e parë është surja "El Furkan" dhe fillon me fjalinë: **"I lartësuar qoftë Ai që i ka zbritur Dalluesin robit të Vet, që të jetë paralajmërues për botët.".**

i saj është se deveja ka vendosur gjoksin në tokë. Më pas kjo shprehje është përdorur edhe me kuptimin e qëndrueshmërisë, të jetëgjatësisë dhe të pathyeshmërisë. Po ashtu, kjo fjalë përdoret për çdo lloj begatie që është e qëndrueshme dhe e përhershme.

Edhe vendin ku grumbullohet uji (si edhe vendin e grumbullimit të ujit të shiut) e quajnë *"birketun"*, sepse uji qëndron për një kohë të gjatë aty.

Ajeti i lartpërmendur, në realitet sillet si argument që vërteton Qënien e Lartësuar dhe të Pastër të All'llahut, si dhe tregon pushtetin suprem dhe fuqinë e Tij, e cila përfshin çdo gjë në këtë ekzistencë. Për këtë arsye thuhet se prania e Tij është e përhershme dhe kurrë nuk zhduket.

Ajeti në vijim tregon qëllimin e krijimit të vdekjes dhe të jetës së njeriut që është prej çështjes së fuqisë absolute dhe sundimit të Tij Absolut. Ajeti thotë: **"Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë..."**.

Në qoftë se vdekjen e konsiderojmë si asgjësim dhe humbje, nënkuptohet se procesi i vdekjes nuk është krijim, sepse krijimi ka të bëjë me çështjet ekzistenciale. Por e dimë se vdekja nuk është zhdukje, nuk është asgjësim. Ajo është kalimi nga një botë në një botë tjetër, dhe kjo pa dyshim, si proces i tillë, është një çështje ekzistenciale, që lidhet më krijimin.

Vdekja këtu është përmendur para jetës, për shkak të ndikimit të thellë të vdekjes në orientimin e njeriut në punë të mira. Përveç kësaj, vdekja ka ekzistuar para jetës.

Synimi i shprehjes **"për t'ju provuar"**, pra, sprovimi i All'llahut, ashtu siç e thamë edhe më lart, lidhet me një proces të

tërë edukimi dhe formimi, i cili i fton njerëzit të trajnohen, të testohen, të sprovohen, të spastrohen, që të jenë të denjë për t'iu afruar Zotit të Madhëruar.[1]

Duhet të kemi parasysh faktin se kuptimin e togfjalëshit: **"sprovës së All'llahut"**, e kanë konsideruar si veprën e mirë dhe jo shumësinë e veprës. Ky është argument që tregon se Islami i kushton rëndësi të madhe cilësisë dhe jo sasisë. E rëndësishme është që vepra të jetë e sinqertë, për hir të All'llahut, e dobishme dhe gjithëpërfshirëse, edhe në qoftë se nga pikëpamja e sasisë mund të jetë e paktë.

Ka shumë hadithe të transmetuara nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që trajtojnë kuptimin e togfjalëshit "vepra e mirë". Në njërin prej tyre thuhet: "*Cili nga ju ka dije dhe mençuri më të plotë, ai ka më shumë frikë All'llahun, ka më shumë njohuri ndaj urdhëresave dhe ndalesave të Tij, edhe pse veprat tuaja të pëlqyeshme mund të jenë më të pakta.*".[2]

Është më e qartë, se urtësia e plotë dhe vepra e pastër, e bën qëllimin dhe nijetin më të sinqertë dhe shpërblimin më të madh.

Në një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet: *"Nuk është e rëndësishme kush punon më shumë. Më e rëndësishme është se cili nga ne vepron më drejt. Vepra e drejtë është ajo vepër që shoqërohet me adhurimin e Zotit dhe me nijet të pastër. Ruajtja e veprës nga papastërtia, është më e vështirë se sa vetë vepra. Vepër e sinqertë dhe e*

[1] Më shumë rreth sprovës së All'llahut, referojuni vëllimit të parë të këtij tefisri, ajetit 155 të sures "El Bekare".

[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 322.

drejtë, është ajo vepër që nuk dëshiron ta vlerësojë askush tjetër, përveç Zotit.".[1]

Në komentimin e sures "Edh Dhariat", në ajetin 56 të saj, lidhur me krijimin e njeriut, kemi dhënë një shpjegim të detajuar. Ky shpjegim thekson se adhurimi i Zotit dhe sprovimi i veprës së mirë nuk janë të ndara, si dhe përsosmëria e mendjes dhe e intelektit, frika ndaj Zotit dhe nijeti i sinqertë, që u përmendën në hadithet e mësipërme, formësojnë shpirtin e adhurimit.

Në këtë kontekst, kuptohet se bota është vendi i sprovimit të madh për të gjithë njerëzit. Mjetet e sprovimit janë vdekja dhe jeta. Qëllimi i kësaj sprove të madhe është arritja e veprës së mirë, që nënkupton përsosmërinë e njohjes, nijetin e sinqertë dhe kryerjen e çdo lloj vepre të dobishme.

Disa komentues të Kur'anit, sifjalinë: **"...se kush prej jush do të veprojë më mirë...",** e kanë interpretuar si rikujtim të vdekjes, ose për t'u përgatitur për vdekjen dhe ngjashëm me të. Në të vërtetë, këto komente përcjellin kuptime të përafërta dhe të përgjithshme.

Ndodh që njeriu, në skenën e gjerë të sprovës, të bëjë dhe gabime, ndonjëherë edhe të mëdha, por ai kurrsesi nuk duhet të zhgënjehet nga këto gabime. Gjithashtu, njeriun nuk duhet ta ndalojnë gabimet e tij, nga përpjekja për korrigjimin dhe edukimin e vetvetes. Prandaj, në fund të ajetit, All'llahu i Madhëruar, u premton robëve të Tij ndihmë dhe falje: **"...Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh."**.

[1] Tefsiri "Es Safij", ajeti i lartpërmendur.

Po, All'llahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë dhe Falës për çdo pendues, i cili pendohet sinqerisht për veprat e veta.

Pasi shtjellon sistemin e krijimit të vdekjes dhe të jetës, ajeti diskuton për rendin e përgjithshëm të botës dhe e fton njeriun në studimin e përbërjes së botës ekzistuese. Me anë të studimit të sistemit të vdekjes dhe të jetës, ajeti synon që njeriu ta përgatisë veten e tij për këtë sprovim të madh të All'llahut. Ajeti thotë: **"Ai ka krijuar shtatë qiej njërin mbi tjetrin..."**.

Për sqarimin e krijimit të "shtatë qiejve", diskutuam në komentimin e ajetit 12 të sures "Et Talak". Në këtë diskutim u sqarua se togfjalëshi **"njëri mbi tjetrin"**, përdoret për të treguar se shtatë qiejt, ndodhen njëri mbi tjetrin. Këtë e saktëson kuptimi i fjalës *"el mutabekatu"*, e cila në zanafillë tregon për diçka që ndodhet mbi mbi diçkaje tjetër.

Shtatë qiejt i interpretojmë si sfera shtatëllojshe të Sistemit Diellor, të cilat nuk shihen dot me sy të lirë, por ndodhen njëra përmbi tjetrën dhe kanë një largësi të përcaktuar prej Diellit.

Në qoftë se atë që shohim, yjet e qëndrueshëm dhe planetet, i konsiderojmë, që të gjitha, si pjesë të qiellit të parë, kuptohet se në hapësira më të larta, ekzistojnë botë të tjera. Edhe ato ndodhen njëra mbi tjetrën.

Në vazhdim, ajeti thotë: **"...nuk mund të gjesh në krijimin e të Gjithëmëshirshmit kurrfarë ceni..."**. Madhështia e universit është e çuditshme. Çdo gjë që ekziston në të, ekziston në bazë të një rregulli, rendi, përputhshmërie, me elemente të mirëllogaritura e ligje të sakta. Në qoftë se në një kënd të botës do të ekzistonte ndonjë parregullsi, do ta zhdukte atë.

Duke u nisur nga sistemi i mahnitshëm dhe i mrekullueshëm që mbizotëron kudo, që nga atomi, nga elektronet e protonet, deri te rendet që mbizotërojnë në gjithë Sistemin Diellor, sistemet e tjera diellore dhe galaktikat, te të gjitha mbizotërojnë rregulla të sakta, në mënyrë të atillë që ato lëvizin në një drejtim të caktuar. Thënë shkurt, kudo ekziston ligji dhe llogaria dhe kudo ekziston rregulli dhe përcaktimi.

Në fund, për një qartësi më të madhe, ajeti thotë: **"...hidhe vështrimin: a sheh ndonjë plasaritje?"**.

Fjala *"futur"* rrjedh nga fjala *"fitrun"* dhe është përdorur me kuptimin e ndarjes për së gjati. Por kjo fjalë përdoret edhe me kuptimin e thyerjes, të prishjes, si p.sh: prishja e agjërimit me anë të iftarit gjatë Ramazanit. Në kontekste të tjera, kjo fjalë përdoret edhe me kuptimin e çrregullimit dhe të cenimit. Në ajetin në fjalë ka po këtë kuptim.

Thënë me fjalë të tjera, sado që njeriu gjurmon në botën ekzistuese, ai nuk do të vërejë ndonjë plasaritje apo mospërputhje në të.

Prandaj në ajetin vijues, për ta theksuar po këtë kuptim dhe domethënie, ajeti shton: **"Pastaj hidhe sërish vështrimin; sytë e tu do të kthehen të lodhur e të molisur."**.

Fjala *"kerr'rretejn"* rrjedh nga fjala *"kerr'rrun"* dhe ka kuptimin e rikthimit ndaj një gjëje. Fjala *"kerr'rretun"* është përdorur me kuptimin e përsëritjes. Fjala *"kerr'rretejni"* ka kuptimin e dytësimit. Por disa interpretues të Kur'anit, kanë pohuar se domethënia e fjalës *"kerr'rretejn"*, në këtë ajet, nuk është

dytësimi, por të qenit i vëmendshëm, në mënyrë të vazhdueshme, të njëpasnjëshme dhe të shumëfishtë.

Si rrjedhojë, All'llahu i Madhëruar, me anë të këtyre ajeteve, i urdhëron njerëzit, që të paktën, t'i hedhin një vështrim botës ekzistuese, të studiojnë sekretet e krijimit dhe të jenë të kujdesshëm dhe të vëmendshëm vazhdimisht ndaj objektit të vrojtimit të tyre. Kur ata, pas gjithë vëzhgimeve të tyre, nuk do të gjejnë asnjë mangësi apo të metë në këtë sistem mahnitës dhe të mrekullueshëm, do të njohin më shumë edhe Dijen dhe Fuqinë e pafundme të Krijuesit së kësaj bote.

Fjala *"khási'un"* rrjedh nga rrënjët *"khesen"* dhe *"khusu'un"*. Sa herë që përdoret në lidhje me "syrin", ka kuptimin e lodhjes dhe të pafuqisë. Ndërsa kur përdoret për "qenin", ka kuptimin e largimit të tij.

Fjala *"hasijrun"* rrjedh nga rrënja *"hasrun"* dhe përdoret me kuptimin e lakuriqësisë. Duke u nisur nga fakti se njeriu, kur lodhet, humbet qëndrueshmërinë dhe fuqinë e vet, pra, thuajse zhvishet nga aftësitë dhe fuqia e vet. Në këtë kontekst, përdoret kjo fjalë dhe përcjell kuptimin e lodhjes dhe të pafuqisë. Kështu që fjalët *"khasi'un"* dhe *"hasijrun"* në ajetin e lartpërmendur, janë përdorur me të njëjtin kuptim dhe shërbejnë për të treguar mungesën e fuqisë dhe pamundësinë e syrit për të vëzhguar ndonjë të metë në sistemin e botës ekzistuese.

Disa komentues kanë bërë një ndarje mes kuptimit të këtyre dy fjalëve. Sipas tyre, fjala *"khasi'un"* është përdorur me kuptimin e privimit dhe të mospasjes sukses, kurse fjala *"hasijrun"* ka kuptimin e pafuqisë.

Sidoqoftë, nga ajetet e lartpërmendura, mund të nxjerrim dy përfundime të rëndësishme: Së pari, Kur'ani u jep urdhër të prerë të gjithë udhëtarëve të rrugës së vërtetë. Ata duhet të studiojnë sa më shumë në lidhje me sekretet e botës ekzistuese dhe mrekullitë e botës objektive. Duhet të mos mjaftohen me një vëzhgim apo me dy hulumtime, sepse ka shumë sekrete që nuk mund të zbulohen me një ose dy "shikime", por është e nevojshme të bëhen hulumtime të mprehta dhe ekzakte, në mënyrë që njeriu, pas shumë shikimesh dhe vrojtimesh, të jetë në gjendje t'i zbulojë ato.

Sa më i saktë, sa më i përpiktë dhe i kujdesshëm të tregohet njeriu ndaj këtij sistemi, aq më të lehtë dhe më mirë do ta kuptojë atë. Do të arrijë pranë një kohezioni që është larg çdo të mete, mangësie, çoroditje dhe shtrembërimi.

Disa dukuri të kësaj bote, në pamje të jashtme, duken si të dëmshme, të liga, ose të komprometuara, (si p.sh: tërmetet, përmbytjet, sëmundjet dhe ngjarjet e tmerrshme që ndonjëherë ndodhin në jetën e njeriut). Në qoftë se për këto dukuri ndërmerren studime të detajuara dhe të përpikta, do të vihet re se edhe këto kanë shpjegimet dhe filozofitë e tyre domethënëse dhe të qarta.[1]

Këto ajete janë një tregues i qartë për argumentimin e rendit dhe të rregullsisë. Këto ajete thonë se ekzistenca e rendit në çdo mekanizëm, është provë për ekzistimin e dijes së një force që qëndron pas këtij aparati, mekanizmi. Asnjëherë, ngjarjet rastësore dhe të pallogaritura, fatkeqësitë e verbra dhe të shurdhëta, nuk mund t'i konsiderojmë si burim i rendit dhe i rregullit. Kjo sqarohet

[1] Në lidhje me këtë, referojuni përshkrimit të kësaj çështjeje, që e kemi trajtuar në shkrimin *"Ithbatu uxhudil'llahi"*, si përgjigje e argumenteve materialiste, në lidhje me *"El Afatu uel Belaja"*, në librin *"Khalikul Alemi"*.

edhe në hadithin e njohur "Mufad'dal", të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, ku thuhet: *"Neglizhenca nuk sjell mirësi dhe kundërshtia nuk sjell rend e rregull."*.[1]

Ajeti 5 i hedh një vështrim qiellit dhe flet për yjet e shkëlqyeshme dhe të bukur: **"Ne jua kemi zbukuruar qiellin më të afërm me yje të shkëlqyeshme dhe i kemi bërë ato si plumba për të larguar djajtë, për të cilët kemi përgatitur dënimin me zjarr."**.

Në qoftë se në një natë të errët, njeriu do t'i hedhë një vështrim qiellit të mbushur plot me yje, në qoftë se do t'u kushtojë vëmendje atyre sferave të largëta dhe të meditojë rreth tyre dhe rreth rendit që mbizotëron mbi to, të meditojë për hijeshinë e tyre, për madhështinë e tyre, për heshtjen misterioze që i përshkon ato, ai do të futej në një botë të mbushur plot misticizëm. Shpjegimin e këtyre mistereve do ta gjente vetëm te Gjithëfuqishmëria dhe Dashuria e All'llahut, e cila nuk mund të përshkruhet me asnjë gjuhë.

Ky ajet rithekson edhe një herë se nga të gjitha yjet që ne i shohim, një pjesë prej tyre janë nga qielli i parë, i cili është më i afërt me ne nga shtatë qiejt e tjerë. Për këtë arsye, është përdorur togfjalëshi *"es semau ed dunja" - "qielli më i afërt"*.

Fjala *"er ruxhumu"* ka kuptimin e plumbave dhe është përdorur për të nënkuptuar meteorët që hidhen si plumba nga njëra anë në anën tjetër të qiellit. Dimë se meteori është pjesë e ngelur e yjeve që janë shpërbërë dhe janë copëtuar gjatë ngjarjeve dhe ndodhive, prandaj, kur thotë: **"i kemi bërë ato si plumba për**

[1] "Biharul Enuar", vëll. 3, f. 63.

të larguar djajtë...”, e ka fjalën pikërisht për këto pjesë të mbetura nga shkatërrimi i yjeve të veçantë.

Për mënyrën se si yjet e shkëlqyeshme i kemi bërë si plumba për t'i gjuajtur djajtë, kemi diskutuar gjerësisht në këtë tefsir.[1]

Hulumtim

Madhështia e krijimit të universit

Edhe pse Kur'ani i Madhërishëm ka zbritur në mjedisin e prapambetur të epokës së injorancës së popullit arab, përsëri këmbëngul që myslimanët të meditojnë dhe të mendojnë rreth enigmave dhe rreth madhështisë së universit. Kjo gjë, në epokën e injorancës, nuk kuptohej e as nuk perceptohej. Ky është një argument i qartë, i cili tregon se Kur'ani ka një burim tjetër. Sa më shumë të përparojnë dija dhe shkenca, aq më e qartë bëhet madhështia e Kur'anit.

Së pari, ne e dimë se toka në të cilën jetojmë, me gjithë madhësinë që ka, në raport me diellin, është aq e vogël, sa po t'i vendosin mbi njëri-tjetrin dhe një milion e dyqind planete të tjera të ngjashme me të, përsëri ngelet nga madhësia e diellit.

[1] Shih komentimin e ajetit 18 të sures “El Hashr” dhe komentimin e ajetit 20 të sures “Es Saffat”.

Së dyti, Sistemi ynë Diellor, është një pjesë prej galaktikave të mëdha, që quhet galaktika e "Udhës së qumështit".[1]

Sipas studimeve shkencore, vetëm në galaktika, ekzistojnë mbi një qind miliardë (100000000000) yje. Dielli ynë, me gjithë madhështinë e tij, konsiderohet si një prej yjeve të mesëm të kësaj galaktike.

Së treti, në këtë botë të madhe ekzistojnë aq shumë galaktika, sa është e pamundur llogaritja dhe numërimi i tyre.

Sa më shumë zhvillohet teknologjia, sa më të përparuar dhe më të pajisur bëhen teleskopët astronomikë, aq më shumë zbulime të reja të hapësirës qiellore bëhen.

Sa i madh është All'llahu i Madhëruar, që këtë "projektim" madhështor e ka bërë të saktë dhe të përpiktë.

[1] Galaktikat janë një koleksion prej yjesh, që njihen si "qytete të yjeve". Edhe pse ndodhen shumë afër njëra–tjetrës, ndonjëherë largësia mes tyre është miliona vite.

Ajetet 6 – 11

وَلِلَّذِينَ كَفَرُوا بِرَبِّهِمْ عَذَابُ جَهَنَّمَ وَبِئْسَ الْمَصِيرُ٦ إِذَا أُلْقُوا فِيهَا
سَمِعُوا لَهَا شَهِيقًا وَهِيَ تَفُورُ٧ تَكَادُ تَمَيَّزُ مِنَ الْغَيْظِ كُلَّمَا أُلْقِيَ فِيهَا
فَوْجٌ سَأَلَهُمْ خَزَنَتُهَا أَلَمْ يَأْتِكُمْ نَذِيرٌ٨ قَالُوا بَلَى قَدْ جَاءَنَا نَذِيرٌ
فَكَذَّبْنَا وَقُلْنَا مَا نَزَّلَ اللَّهُ مِنْ شَيْءٍ إِنْ أَنْتُمْ إِلَّا فِي ضَلَالٍ كَبِيرٍ٩
وَقَالُوا لَوْ كُنَّا نَسْمَعُ أَوْ نَعْقِلُ مَا كُنَّا فِي أَصْحَابِ السَّعِيرِ١٠ فَاعْتَرَفُوا
بِذَنْبِهِمْ فَسُحْقًا لِأَصْحَابِ السَّعِيرِ١١

"Kurse për ata, që e mohojnë All'llahun e tyre, dënimi është Xhehennemi; eh, sa i shëmtuar është ai vendbanim!

"Kur të hidhen aty, do të dëgjojnë ulërimën e tij, ndërkohë që ai vlon."

"Gati për të shpërthyer me furi. Sa herë që aty të hidhet ndonjë grup, rojtarët e tij do t'i pyesin ata: 'A nuk ju erdhi ndonjë paralajmërues?!'"

"Po - do të përgjigjen ata - na kanë ardhur vërtet paralajmërues, por ne i quajtëm ata gënjeshtarë dhe thamë: 'All'llahu nuk ka shpallur asgjë; ju jeni në një humbje të madhe!'"

"Ata do të thonë: 'Sikur të kishim dëgjuar ose menduar, nuk do të ishim midis banorëve të Zjarrit Flakërues!'"

"Kështu, ata do ta pranojnë gjynahun e tyre. Larg qofshin prej mëshirës së All'llahut banorët e Zjarrit Flakërues!"

Komentimi

Nëse do të ishim të dëgjueshëm dhe të vëmendshëm, nuk do të hynim në Xhehennem!

Në ajetet pararendëse u diskutua për shenjat e madhështisë dhe të fuqisë së Zotit dhe argumentet që lidhen me to në këtë botë. Në ajetet 6-11, do të flitet rreth atyre personave që nuk i kanë marrë parasysh dhe i kanë anashkaluar këto argumente, do të flitet për ata persona që kanë zgjedhur rrugën e politeizmit dhe të mosbesimit, që ngjashëm me djajtë, edhe për vete kanë zgjedhur dënimin.

Ajeti 6 thotë: **"Kurse për ata, që e mohojnë All'llahun e tyre, dënimi është Xhehennemi; eh, sa i shëmtuar është ai vendbanim!"**.

Më pas përshkruan një pjesë nga ky dënim i tmerrshëm dhe i frikshëm dhe thotë: **"Kur të hidhen aty, do të dëgjojnë ulërimën e tij, ndërkohë që ai vlon."**.

Kur ata hidhen me plot poshtërim dhe nënçmim, nga Xhehennemi dëgjohet një britmë e tmerrshme dhe e gjatë, nga e cila trishtohen të gjithë.

Fjala *"shahijk"* në zanafillë ka kuptimin e zërit të shëmtuar dhe të përbuzur, i cili ngjason me zërin e gomarit. Disa kanë thënë se kjo fjalë rrjedh nga rrënja *"shahuk"* dhe ka kuptimin e zgjatjes, prandaj malin e lartë e quajnë dhe "xhebelun shahik" - "mali i lartë". Por fjala *"shahijk"* është përdorur me kuptimin e rënkimit të gjatë.

Disa komentues të tjerë të ajeteve kur'anore janë të mendimit se fjala *"zefijr"* është një zë që kthehet në fyt, kurse fjala *"shahijk"* përdoret për të treguar një zë që lëviz brenda gjoksit. Sidoqoftë, këto fjalë janë tregues për zërat e tmerrshëm, trishtues dhe shqetësues.

Më pas, për të ilustruar ashpërsinë e zemërimit të Xhehennemit, ajeti thotë: **"Gati për të shpërthyer me furi..."**.[1]

Pra, ngjashëm me një enë të madhe, të cilën e kemi vendosur mbi një zjarr të fortë dhe plot flakë, ku uji valon aq shumë, sa ena është gati të shpërthejë dhe të copëtohet, ose ngjashëm me njeriun e zemëruar, që gufon, ulërin dhe pothuajse është gati të shpërthejë. Kështu është peizazhi i Xhehennemit. Ky është ligji i zemërimit të All'llahut.

[1] Fjala *"temej'jezu"*, është me kuptimin e shpërbërjes dhe të shpërndarjes. Në thelb, është *"tetemej'jezu"*.

Ajeti 8 vazhdon: **"...Sa herë që aty të hidhet ndonjë grup, rojtarët e tij do t'i pyesin ata: 'A nuk ju erdhi ndonjë paralajmërues?!'"**.

Ata nuk besojnë se një njeri i ndërgjegjshëm dhe me udhëheqje hyjnore, të ketë një fat të tillë dhe ndërmarrin veprime të tilla për veten e tyre.

Ata përgjigjen: **"Po - do të përgjigjen ata - na kanë ardhur vërtet paralajmërues, por ne i quajtëm ata gënjeshtarë dhe thamë: 'All'llahu nuk ka shpallur asgjë; ju jeni në një humbje të madhe!'"**.

Po! Kështu ata do të pohojnë ardhjen e Profetëve, të cilëve, fatkeqësisht, nuk ua dëgjuan mesazhet dhe i kundërshtuam. Profetët i konsideruan si të çmendur, që janë shmangur nga Rruga e Drejtë, prandaj do të pohojnë se ata vetë ishin në humbje dhe u larguan nga Rruga e Drejtë.

Ajeti 10 përmban argumentin thelbësor të mjerimit të tyre: **"Ata do të thonë: 'Sikur të kishim dëgjuar ose menduar, nuk do të ishim midis banorëve të Zjarrit Flakërues!'".**

Këtu, banorët e Xhehennemit, do të pranojnë mëkatin e tyre. Ata janë larg mëshirës së All'llahut: **"Kështu, ata do ta pranojnë gjynahun e tyre. Larg qofshin prej mëshirës së All'llahut banorët e Zjarrit Flakërues!"**.

Në këto ajete, krahas shpjegimit të fatit trishtues të banorëve të Xhehennemit, vëmendja përqendrohet mbi faktorin kryesor të mjerimit të tyre. Nga njëra anë, All'llahu i Madhëruar ka dhënë veshë për të dëgjuar, ka dhënë mendje dhe inteligjencë për të

menduar dhe për të analizuar gjërat. Nga ana tjetër, ka dërguar Profetë me argumente të qarta. Në qoftë se i bashkojmë këto të dyja, sigurohet lumturia e njeriut.

Por, shpeshherë, megjithëse njeriu i ka veshët, nuk dëgjon me to; ka dy sy, por nuk sheh me to; ka mendje, por nuk mendon dhe as logjikon. Madje edhe sikur të shkonin të gjithë Profetët pas tij, përsëri nuk do të kishte efekt.

Në një hadith thuhet se një grup njerëzish e lavdëruan dhe e vlerësuan një person në prani të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Profeti i pyeti: *"A është inteligjent?"* Të pranishmit thanë: *"O i Dërguar i All'llahut! Ne po flasim për veprat dhe përpjekjet e tij, në lidhje me adhurimin dhe llojet e punëve të dobishme që i kryen, kurse ju pyesni rreth inteligjencës së tij?"*

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u përgjigj: *"Fatkeqësia që rrjedh nga budallallëku i një mendjelehti, është më e keqe se sa imoraliteti i të shthururve dhe mëkati i keqbërësve. All'llahu i Madhëruar, në Ditën e Gjykimit, do të lartësojë pozitën e robëve, sipas mendjes dhe intelektit të tyre. Në bazë të këtij kriteri, njeriu do të arrijë në prani të All'llahut."*.[1]

Fjala *"suhk"* është përdorur me kuptimin e zbutjes, por ajo është përdorur edhe si emërtim për rrobat e vjetra. Këtu është përdorur me kuptimin e largimit prej mëshirës së All'llahut. Si rrjedhim, ajeti: **"Larg qofshin prej mëshirës së All'llahut banorët e Zjarrit Flakërues!"**, është përdorur për të treguar se banorët e Xhehennemit do të jenë larg mëshirës së All'llahut. Duke u nisur

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 324.

nga fakti që mallkimi i All'llahut është i shoqëruar me efekt të menjëhershëm dhe të jashtëm, kjo fjali shërben si argument, për të vërtetuar se ky grup është krejtësisht jashtë mëshirës së All'llahut.

Hulumtim

Vlera e lartë e intelektit

Nuk është hera e parë që Kur'ani Fisnik shpreh vlerën e jashtëzakonshme të mendjes dhe të inteligjencës. Mëkatin kryesor të banorëve të Xhehennemit dhe faktorin parësor të mjerimit të tyre, e konsideron mosshfrytëzimin dhe lënien pas dore të kësaj force hyjnore, të diturisë dhe të inteligjencës. Çdokush që e njeh dhe e ka studiuar Kur'anin, është në dijeni se në raste të ndryshme, All'llahu e ka shtjelluar rëndësinë e kësaj çështjeje, pavarësisht nga gënjeshtrat e atyre personave, të cilët, me anë të insinuatave të tyre, e konsiderojnë fenë si "drogë për trurin" dhe injorojnë urdhrin për shfrytëzimin e mendjes dhe të inteligjencës.

Islami e bazon njohjen e All'llahut, të lumturisë njerëzore dhe shpëtimin e tij mbi mendjen dhe inteligjencën. Në çdo rast i përmend si "*ulul e lbab*" ose "*ulul ebsar*", dijetarët dhe shkencëtarët dhe rolin e tyre në shoqëri si mjaft të rëndësishëm.

Në burimet islame janë transmetuar shumë hadithe për këtë çështje. Numri i këtyre haditheve është shumë i madh. Për shembull, interesant është fakti, se libri i njohur "El Kafij", i

konsideruar si burimi më kryesor dhe më i njohur i hadithit te shi'at, përbëhet nga kapituj. Kapitulli i parë mban titullin "*El Aklu uel Xhehlu*". Njeriu që shqyrton hadithet e transmetuara në këtë libër, do të arrijë të depërtojë në thellësinë e vizionit të Islamit rreth intelektit. Për këtë çështje, ne këtu do të mjaftohemi me përmendjen e dy haditheve.

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, ka thënë: "*Xhebraili iu shfaq Profetit Adem (Paqja qoftë mbi të!) dhe i tha: 'Unë jam urdhëruar, që në mesin e këtyre tri dhuratave, të përzgjedhësh njërën prej tyre, kurse dy të tjerat t'i lësh mënjanë.'*

Profeti Adem *(Paqja qoftë mbi të!)* e pyeti*: 'Çfarë janë ato?'*

Xhebraili iu përgjigj: *'Intelekti, turpi dhe feja.'*

Profeti Adem *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: *'Po zgjedh intelektin.'*

Xhebraili i tha "turpit" dhe "fesë": *'Lëreni të lirë atë dhe shkoni pas punëve tuaja.'*

Ata thanë: *'Ne jemi urdhëruar që gjithnjë dhe kudo, të jemi me intelektin dhe të mos ndahemi prej tij!'*

Xhebraili tha: *'Meqenëse është kështu, veproni në bazë të urdhrit që keni.' Më pas u ngrit në qiell."*.[1]

Kjo është shprehja më e përshtatshme dhe më tërheqëse që mund të jetë thënë ndonjëherë në lidhje me mendjen dhe inteligjencën dhe raportin e tyre me fenë dhe turpin. Në qoftë se mendja ndahet nga feja, edhe për gjënë më të vogël, mund të

[1] Tefsiri "El Kafij", vëll. 1, Hadithi 2, f. 10; tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5 f. 382.

humbasë, kurse turpi e pengon njeriun në kryerjen e veprave të liga, në kryerjen e mëkateve. Edhe kjo, po ashtu, është fryt i njohjes, i mendjes dhe i inteligjencës.

Kjo, tregon se Profeti Adem *(Paqja qoftë mbi të!)* e vlerësonte shumë mendjen. Ai zgjodhi më të çmueshmen, pra, intelektin dhe, si rezultat, (nën hijen e saj) mori edhe fenë, edhe turpin.

Në hadithin tjetër, nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Ai që ka intelekt, ka edhe fe. Ai që ka fe, hyn në Xhennet!"*.[1]

Sigurisht, intelekti, këtu, është në kuptimin e dijes së vërtetë dhe jo në kuptimin e dinakërisë apo ligësive djallëzore, që vërehen te politikanët tiranë dhe shtypës të botës, të cilët i përcakton saktë thënia e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"...i ngjason intelektit, por nuk është intelekt."*.[2]

[1] Tefsiri "El Kafij", vëll. 1, Hadithi 6, f. 11.

[2] Tefsiri "El Kafij", vëll. 1, Hadithi 3, f. 11.

Ajetet 12 – 14

إِنَّ الَّذِينَ يَخْشَوْنَ رَبَّهُمْ بِالْغَيْبِ لَهُمْ مَغْفِرَةٌ وَأَجْرٌ كَبِيرٌ ١٢ وَأَسِرُّوا قَوْلَكُمْ أَوِ اجْهَرُوا بِهِ إِنَّهُ عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ ١٣ أَلَا يَعْلَمُ مَنْ خَلَقَ وَهُوَ اللَّطِيفُ الْخَبِيرُ ١٤

"Vërtet, për ata që i frikësohen All'llahut të tyre pa e parë Atë, do të ketë falje dhe shpërblim të madh!"

"Sido që të flisni ju, fshehtas apo haptas, Ai e di mirë ç'ka në zemrat tuaja."

"E si të mos dijë Ai që ka krijuar gjithçka, kur Ai njeh çdo gjë me imtësi dhe është i Gjithinformuari?!"

Komentimi

Krijuesi i botës është i Gjithëditur për të fshehtat e saj

Në vazhdim të ajeteve të mëparshme, ku u diskutua rreth politeistëve dhe fatit të tyre në Kiamet, në këto ajete, Kur'ani u referohet besimtarëve dhe shpërblimit madhor të tyre.

Ajeti 12 thotë: **"Vërtet, për ata që i frikësohen All'llahut të tyre pa e parë Atë, do të ketë falje dhe shpërblim të madh!"**.

Fjala *"gajbun"*, tregon për njohjen e padukshme të All'llahut, ose besimin në Ringjalljen e padukshme, ose të dyja këto.

Për komentimin e këtij ajeti, janë dhënë dy interpretime. Në njërin interpretim bëhet fjalë për frikën prej All'llahut, edhe kur mëkatet janë të fshehura. Dihet se, nëse ndokush nuk kryen mëkate fshehurazi, është e sigurt që ai nuk do të kryejë mëkat as haptazi. Interpretimi i dytë i ajetit flet për sinqeritetin në nijet, synimin e pastër të besimtarit, qëndrimin larg prej mëkateve e zbatimin e urdhrave hyjnore, sepse vepra e fshehtë është përtej hipokrizisë.

Duhet thënë se sinteza e këtyre interpretimeve nuk shkakton ndonjë problem.

Fjala *"magfiretun"* - *"falje"* dhe togfjalëshi *"exhrun kebijrun"* - *"shpërblim i madh"*, përdoren për të treguar madhështinë dhe rëndësinë e faljes dhe të shpërblimit, të cilat do të jenë aq të mëdha, saqë asnjë njeri nuk mund t'i imagjinojë dot.

Më pas, në ajetin 13, për ta theksuar sa më shumë çështjen, thotë: **"Sido që të flisni ju, fshehtas apo haptas, Ai e di mirë ç'ka në zemrat tuaja."**.

Disa komentues të Kur'anit, kanë treguar një arsye, që u bë shkak për zbritjen e këtij ajeti. Ata tregojnë se Ibn Abasi ka thënë: "Një grup njerëzish hipokritë dhe politeistë, që ishin gojëligj, flisnin keq për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe Xhebraili e njoftoi Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e*

tij!) për këtë. Disa prej tyre iu drejtuan njëri–tjetrit, duke thënë: 'Flisni fshehurazi me njëri–tjetrin, në mënyrë që të mos ju dëgjojë Zoti i Muhammedit!'". Në këtë kohë zbriti ajeti i lartpërmendur: **"Sido që të flisni ju, fshehtas apo haptas, Ai e di mirë ç'ka në zemrat tuaja."**.[1]

Ajeti 14, është argument për atë që u tha në ajetin më lart: **"E si të mos dijë Ai që ka krijuar gjithçka, kur Ai njeh çdo gjë me imtësi dhe është i Gjithinformuari?!"**.

Duke komentuar fjalinë: **"E si të mos dijë Ai që ka krijuar gjithçka…"**, interpretuesit e Kur'anit kanë dhënë mendime të ndryshme: Disa kanë pohuar se ajeti thotë që All'llahu, i Cili i ka krijuar zemrat, a nuk është në dijeni për sekretet dhe të fshehtat e tyre? Ose, All'llahu, i Cili ka krijuar njerëzit, a nuk është në dijeni për sekretet e tyre?

Ose, All'llahu, i Cili ka krijuar gjithçka dhe është në dijeni për të gjitha sekretet e botës, a është e mundur të mos jetë në dijeni për sekretet e njeriut, që është një krijesë prej simfonisë së madhe të krijimit?!

Sidoqoftë, për ta konceptuar këtë të vërtetë, duhet të kemi parasysh faktin që procesi i krijimit, pra, i dhënies së ekzistencës nga All'llahu i Madhëruar është i vazhdueshëm. Kjo do të thotë se në çdo moment, krijesat furnizohen nga begatia e ekzistencës që buron prej All'llahut. All'llahu i Madhëruar, asnjëherë nuk i lë mënjanë krijesat e Tij.

Në thelb, qeniet janë të varura prej ekzistencës së All'llahut. Në qoftë se për një moment të vetëm, lidhja e tyre, me Vetën e

[1] Fakhru Rrazij, vëll. 3, f. 66 dhe tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 10, f. 86, ajeti në fjalë.

Pastër të All'llahut, ndërpritet, ata do të shkojnë drejt shkatërrimit dhe zhdukjes. Rëndësia e kësaj lidhjeje të përhershme dhe e këtij furnizimi të vazhdueshëm me ekzistencë, është njëherësh edhe argumentimi më kryesor për informimin e All'llahut të Madhëruar, në lidhje me sekretet e të gjitha krijesave, në çdo kohë dhe në çdo vend.

Përshkrimi i All'llahut me fjalën *"latijfun"*, e cila rrjedh nga fjala *"lutfun"*, shërben për të treguar se All'llahu i Madhëruar është në dijeni të çdo çështjeje, në mënyrën më të saktë, sado delikate që të jetë, është në dijeni të çdo lloj lëvizjeje të shpejtë dhe të çdo gjëje. Ndonjëherë kjo fjalë është përdorur edhe me kuptimin e krijimit të trupave delikatë, të vegjël, (stër)mikroskopikë.

Pra, përmbajtja kuptimore e kësaj fjale synon të tregojë se, sado që synimet e zemrës suaj janë të fshehura dhe të fshehta, sado që mendimet tuaja i shprehni në takime të ngushta, All'llahu i Madhëruar është në dijeni dhe i mirinformuar për çdo veprim, për çdo mendim dhe lëvizjeje tuajën.

Disa komentues të Kur'anit, në komentimin e fjalës *"latijfun"* kanë thënë se Zoti është Ai që e lehtëson përgjegjësinë dhe shumëfishon shpërblimin.

Në realitet, edhe ky pohim është një lloj mirëllogaritje e "imtësive", të cilat i merr parasysh All'llahu, kur do të të përfshijë në mëshirën e Tij.

Disa komentues të tjerë, po ashtu, kanë thënë se përshkrimi i All'llahut me epitetin *"latijfun"* është bërë, sepse Ai depërton në brendësi të të gjitha gjërave që ekzistojnë dhe prania e Tij nuk

mund të mungojë në asnjë vend të botës dhe për asnjë çast. Ai është i pranishëm në çdo vend dhe në çdo kohë.

Në fund, të gjitha këto rikthehen te një e vërtetë. Kjo e vërtetë thekson dhe dëshmon faktin se All'llahu është i Gjithëdijshëm dhe i Mirëinformuar ndaj sekreteve të fshehta apo të dukshme të gjithçkaje që gjendet në këtë ekzistencë.

Ajetet 15 – 18

هُوَ الَّذِى جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ ذَلُولًا فَامْشُوا فِى مَنَاكِبِهَا وَكُلُوا مِنْ رِزْقِهِ وَإِلَيْهِ النُّشُورُ١٥ أَأَمِنْتُمْ مَنْ فِى السَّمَاءِ أَنْ يَخْسِفَ بِكُمُ الْأَرْضَ فَإِذَا هِىَ تَمُورُ١٦ أَمْ أَمِنْتُمْ مَنْ فِى السَّمَاءِ أَنْ يُرْسِلَ عَلَيْكُمْ حَاصِبًا فَسَتَعْلَمُونَ كَيْفَ نَذِيرِ١٧ وَلَقَدْ كَذَّبَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ فَكَيْفَ كَانَ نَكِيرِ١٨

"Ai jua ka bërë Tokën të përdorshme, andaj ecni nëpër viset e saj dhe ushqehuni me atë, që ju ka dhënë Ai. Si të ringjalleni, do të ktheheni tek Ai."

"A jeni të sigurt se kush është në qiell, nuk do ta bëjë Tokën t'ju kapërdijë, kur të fillojë të dridhet papritmas?"

"A jeni të sigurt se kush është në qiell, nuk do t'ju çojë furtunë gurësh? Atëherë do ta dini sa i frikshëm është paralajmërimi Im!"

"Edhe ata që ishin para jush i quajtën gënjeshtarë të Dërguarit e tyre. Eh, sa i ashpër ka qenë ndëshkimi Im!"

Komentimi

Asnjë mëkatar dhe fajtor nuk është i sigurt nga dënimi i All'llahut

Në vazhdim të ajeteve të kaluara, ku u diskutua për banorët e Xhehennemit dhe të Xhennetit, në lidhje me besimtarët dhe jobesimtarët, ajetet në vazhdim flasin për nxitjen, për të qenë në radhët e banorëve të Xhennetit. Ata japin edhe paralajmërimet përkatëse, për të qëndruar larg rrugës dhe zakoneve të banorëve të Xhehennemit. Këto ajete përmendin edhe disa prej mirësive dhe begative të All'llahut. Në fund, hedhin dritë mbi një pjesë prej torturave të Xhehennemit.

Ajeti 15 thotë: **"Ai jua ka bërë Tokën të përdorshme, andaj ecni nëpër viset e saj dhe ushqehuni me atë, që ju ka dhënë Ai. Si të ringjalleni, do të ktheheni tek Ai."**.

Fjala "*dhelul*" - "*e zbutur*", "*e përdorshme*", është cilësimi më i plotë, i bërë ndonjëherë në lidhje me tokën.

Toka, ky trup lëvizës, me gjithë lëvizjet e shumta dhe shumë të shpejta që bën, duket shumë e qetë. Duket aq e qetë, saqë pothuajse çdo gjë në të është në prehje të plotë. Disa shkencëtarë pohojnë se toka ka katërmbëdhjetë lloj lëvizjesh, tri prej të cilave janë lëvizja rreth vetes, lëvizja rreth Diellit dhe lëvizja së bashku me Sistemin Diellor, në zemër të galaktikës. Kjo lëvizje, e cila ka një shpejtësi të madhe, duket e qetë dhe e butë dhe deri në momentin që nuk ishin të shpalosura argumentet vendimtare, në lidhje me lëvizjen e Tokës, askush nuk e besonte një gjë të tillë.

Nga ana tjetër, shtresa e Tokës nuk është aq e fortë dhe e ashpër, sa të mos jetë e përshtatshme për jetesë. Ajo nuk është as aq e butë dhe e njomë, që mos të jetë e qëndrueshme. Shtresa e tokës është plotësisht e përshtatshme për jetesën e njerëzve. Në qoftë se, për shembull, pjesa dërmuese e sipërfaqes së Tokës do të ishte si një moçal, në të cilin do të fundosej çdo gjë, apo të ishte si rëra e butë, në të cilën fundoset gjer në gju këmba e njeriut, apo të ishte si shkëmbinjtë e ashpër dhe të fortë, që me ecjen më të vogël në të trupi i njeriut ndien dhimbje dhe ashpërsi, atëherë do të ishte krejtësisht e qartë se toka nuk ishte e përshtatshme për jetë njerëzore.

Së treti, largësia e saj me Diellin nuk është as e vogël, sa intensiteti i lartë i nxehtësisë së tij të djegë çdo gjë. Por largësia e saj nuk është as e largët, saqë çdo gjë "të thahet" nga i ftohti.

Presioni barometrik ndaj tokës është i tillë, që siguron qetësinë e njeriut, as nuk është i lartë, që ta mbytë atë dhe nuk është as i ulët, që ta shkatërrojë.

Graviteti nuk është aq i madh, që t'i thyejë kockat dhe nuk është aq i ulët, në mënyrë që, me një lëvizje, njeriu të mundte të shkëputej nga toka dhe të fluturonte në hapësirë.

Thënë shkurt, nga çdo pikëpamje, fjala *"dhelulun"* është tepër domethënëse dhe tregon se Toka ofron kushte të përshtatshme për jetë normale njerëzore. Është interesant fakti se, pas përshkrimit të Tokës me fjalën *"dhelulun" - "e zbutur, e përdorshme"*, vjen urdhri për të ecur nëpër *"menakib" - "viset e saj"*. Dimë se fjala *"menakibun"* është shumësi i fjalës *"menkeb"* dhe është përdorur me kuptimin e supit, thuajse njeriu i vendos këmbët mbi

supet e tokës dhe toka është aq e butë, saqë mund të mbajë ekuilibrin e saj.

Njëkohësisht, këto fakte tregojnë se, po të mos bëni përpjekje për të siguruar jetesën në tokë, nuk do të keni asnjë përfitim dhe dobi nga mirësitë e shumta të saj.

Fjala *"rizkun"*, po ashtu, ka një përdorim dhe domethënie shumë të gjerë. Kuptimi i gjerë i saj përmbledh të gjithë "përbërësit" e tokës, përfshirë ato shtazore, bimore dhe minerare.

Duhet të dimë se këto nuk janë qëllimi përfundimtar i krijimit tonë. Të gjitha këto janë mjete në rrugën e Ringjalljes dhe të jetës sonë të përjetshme.

Në vijim të këtij diskutimi, ajeti 16 përqendrohet te kërcënimet dhe paralajmërimet: **"A jeni të sigurt se kush është në qiell, nuk do ta bëjë Tokën t'ju kapërdijë, kur të fillojë të dridhet papritmas?"**.

Po, në qoftë se All'llahu urdhëron, kjo tokë e butë dhe e përshtatshme do të bëhet e kapërdijshme dhe do të kthehet në formën e një kafshe që të tremb. Do të fillojnë tërmetet, do të shfaqen të çarat në tokë dhe do t'ju kapërdijë juve, shtëpitë tuaja dhe qytetet tuaja dhe përsëri do të vazhdojë me dridhjet dhe lëkundjet e veta.

Ka mendime të ndryshme për përdorimin e sifjalisë: **"...kur të fillojë të dridhet papritmas…".** Një mendim është: Kjo sifjali, është përdorur për të treguar se All'llahu mund të urdhërojë që toka t'ju kapërdijë juve dhe t'ju kalojë nga një zonë në një zonë tjetër, madje as varri juaj të mos ndihet i qetë.

Ekziston edhe mendimi se kjo sifjali të jetë përdorur për të treguar se toka do të humbasë përgjithnjë qetësinë e vet dhe në të do të mbizotërojnë tërmete të vazhdueshme. Këtë gjendje të tokës, kur ajo dridhet e lëkundet nga tërmetet, e perceptojnë shumë më mirë ata që jetojnë në zona me ndjeshmëri të lartë sizmike, ku ndodhin gjithnjë tërmete. Në ato zona, shpeshherë janë vërejtur dridhje të tokës me ditë të tëra. Kjo gjendjeje ua mohon njerëzve gjumin dhe qetësinë, ua shkatërron ushqimet dhe të mirat materiale. Veçanërisht, njerëzit që janë mësuar të jetojnë në zona të qeta sizmike, e kanë shumë të vështirë t'i përballojnë këto situata.

Sifjalia: **"kush është në qiell"** tregon për Vetën e Pastër të All'llahut, i Cili, pa dyshim, sundon mbi gjithë të qiejt, sundon edhe në tokë. Disa komentues të ajeteve kur'anore kanë pohuar se kjo fjali flet për engjëjt e Zotit, të cilët janë në qiej dhe presin të zbatojnë urdhrat e All'llahut të Madhëruar.

Në komentet, shtohet se nuk është e thënë që patjetër të ndodhin tërmete. Toka mund të trazohet edhe nga stuhi dhe uragane. Ajeti 17, për të sqaruar mirë këtë përdorim kuptimor, thotë: **"A jeni të sigurt se kush është në qiell, nuk do t'ju çojë furtunë gurësh? Atëherë do ta dini sa i frikshëm është paralajmërimi Im!"**.

Kuptimi i kësaj fjalie, gjithashtu, është shumë i qartë për ata njerëz që kanë parë furtunë gurësh dhe erëra të forta, (erëra që mbartin me vete grumbuj gurësh dhe i kalojnë nga një vend në një vend tjetër). Ata e dinë se fuqi të tilla natyrore kanë mundësinë që brenda pak çasteve, shtëpitë, vendbanimet, ose karvanët që ecin rrugës, t'i groposë nën grumbuj rëre dhe gurësh.

Në realitet, ajeti i lartpërmendur, thotë se dënimi i tyre nuk ka të bëjë vetëm me Kiametin, por dhe në këtë botë, All'llahu i Madhëruar, me një dridhje të lehtë të tokës, ose lëvizjen e erërave, ka gjasa t'i japë fund jetës së tyre. Argumenti më i fortë, në lidhje me këtë çështje, është ajo që ka ndodhur me popujt e hershëm.

Prandaj, në ajetin 18, thuhet: **"Edhe ata që ishin para jush i quajtën gënjeshtarë të Dërguarit e tyre. Eh, sa i ashpër ka qenë ndëshkimi Im!"**.

Një grup njerëzish e kemi dënuar me anë të tërmeteve shkatërruese, një popull tjetër me anë të vetëtimave, kurse një grup tjetër, me anë të stuhive dhe vërshimeve. Qytetet e rrënuara dhe të braktisura të popujve të kaluar, i kemi lënë që të shërbejnë si mësim për të tjerët në të ardhmen.

Ajetet 19 – 21

أَوَلَمْ يَرَوْا إِلَى الطَّيْرِ فَوْقَهُمْ صَافَّاتٍ وَيَقْبِضْنَ مَا يُمْسِكُهُنَّ إِلَّا الرَّحْمَنُ إِنَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ بَصِيرٌ ١٩ أَمَّنْ هَذَا الَّذِى هُوَ جُنْدٌ لَكُمْ يَنْصُرُكُمْ مِنْ دُونِ الرَّحْمَنِ إِنِ الْكَافِرُونَ إِلَّا فِى غُرُورٍ ٢٠ أَمَّنْ هَذَا الَّذِى يَرْزُقُكُمْ إِنْ أَمْسَكَ رِزْقَهُ بَلْ لَجُّوا فِى عُتُوٍّ وَنُفُورٍ ٢١

"A nuk i shohin shpendët mbi kokat e tyre, se si i hapin dhe i mbledhin krahët? Askush nuk i mban ata, përveç të Gjithëmëshirshmit; Ai, me të vërtetë, sheh çdo gjë."

"Kush është ai, që mund t'ju ndihmojë si një ushtri e tërë, përveç të Gjithëmëshirshmit? Mohuesit janë pre e mashtrimit (të shejtanit)**."**

"Kush janë ata, që do t'ju japin mjete jetese, në qoftë se Ai jua ndalon ato? Por ata janë zhytur në kryeneçësi e mendjemadhësi."

Komentimi

Hidhini një vështrim shpendëve!

Në ajetet e para të kësaj sureje, u diskutua për sundimin dhe fuqinë e pafundme të All'llahut të Madhëruar mbi shtatë qiejt, mbi yjet dhe planetet e tjera, kurse në ajetet në fjalë, trajtohet çështja e fuqisë së All'llahut. Për të treguar fuqinë e All'llahut të Madhëruar, sillet si shembull një prej krijesave të universit, që në dukje është e vogël. Ajeti 19 thotë: **"A nuk i shohin shpendët mbi kokat e tyre, se si i hapin dhe i mbledhin krahët?"**.

Këta trupa të rëndë, në kundërshtim me ligjin e gravitacionit, ngrihen nga toka, fluturojnë shumë lehtë me orë, ditë dhe muaj të tërë, pa ndërprerje, vetëm me një lëvizje të shpejtë dhe të qetë në qiell, pa u ndodhur asnjë problem.

Disa prej tyre, gjatë fluturimit, gjithnjë i hapin dhe i mbledhin krahët e tyre *"safat"* - *"i hapin krahët"* dhe, thuajse, një forcë misterioze i vë ato në lëvizje.

Ndërkohë që disa të tjerë, gjithnjë i mbajnë të hapura krahët e tyre. (Ka mundësi se fjala *"jekbidhne"* të na tregoj po për këtë kuptim.)

Disa të tjerë, ndonjëherë i hapin krahët dhe ndonjëherë i mbledhin ato.

Në grupin e katërt futen ata shpendë, që, kur duan të lëvizin me shpejtësi, i hapin krahët, kurse, kur duan të ulen, apo të zhyten

në ujërat e deteve ose të oqeaneve, i mbyllin plotësisht ato, si p.sh: harabelat.

Thënë shkurt, përveçse shpendët fluturojnë, secili prej tyre, ka një mënyrë fluturimi të veçantë.

Kush e krijoi trupin e tyre, në mënyrë të atillë që të mund të fluturojnë shumë lehtë në ajër?

Kush ua dhuroi atyre këtë fuqi, në krahët e tyre dhe ua mësoi atyre aftësinë e fluturimit?

Veçanërisht fluturimet e ndërlikuara të zogjve në grup, që ndonjëherë zgjasin me muaj të tërë dhe kalojnë mijëra kilometra rrugë duke fluturuar, duke kaluar mbi shumë qytete, mbi shumë male, mbi shumë lugina, mbi pyje dhe dete, për të arritur në vendin e tyre.

Vërtet, kush ua ka dhënë gjithë këtë forcë dhe njohuri atyre?

Prandaj, në fund të ajetit thuhet: **"Askush nuk i mban ata, përveç të Gjithëmëshirshmit; Ai, me të vërtetë, sheh çdo gjë."**.

All'llahu i Madhëruar, ka vënë në dispozicion të tyre mjete dhe fuqi të ndryshme për të fluturuar. Po, All'llahu i Mëshirshëm, mëshira e të Cilit i përfshin të gjitha gjallesat, edhe zogjve u ka dhënë atë që e ka konsideruar si të nevojshme.

Mbajtja e zogjve në qiell është njësoj si mbajtja e tokës dhe e gjallesave të tjera. Në qoftë se All'llahu nuk dëshiron, asnjë zog nuk mund të fluturojë dhe as toka nuk do ta ruajë qetësinë e saj.

Sifjalia: *"saffat ue jegbidhne"* **- "se si i hapin dhe i mbledhin krahët"**, ose është tregues për shpendë të ndryshëm, ose për gjendjet e ndryshme të të njëjtit zog.[1]

Në ajetin në vijim, theksohet fakti se jobesimtarët, kur janë përballë fuqisë së All'llahut të Madhëruar, nuk kanë asnjë mbështetje ose ndihmës. Ajeti thotë: **"Kush është ai, që mund t'ju ndihmojë si një ushtri e tërë, përveç të Gjithëmëshirshmit? Mohuesit janë pre e mashtrimit** (të shejtanit)**."**.

Jo vetëm që askush nuk do të mund t'ju vijë në ndihmë juve, por, në qoftë se All'llahu dëshiron, i urdhëron ata që t'ju dënojnë dhe t'ju shkatërrojë juve.

Vallë, uji, era, toka dhe zjarri, a nuk janë shtylla dhe shërbëtorë të jetës suaj?

All'llahu i Madhëruar, po këto, i urdhëroi në shkatërrimin e popujve arrogantë dhe mashtrues.

Historia na ka treguar shumë herë se njerëzit më të afërt të mbretërve, faraonëve dhe rebelëve janë bërë shkaktarë kryesorë të vdekjes së tyre. Kjo vihet re edhe në historinë bashkëkohore. Edhe sot, shpesh është vërejtur se njerëzit më besnikë të udhëheqësve të shquar kanë bërë kryengritje kundër tyre, apo "kanë firmosur"

[1] Fjala *"saffat"* është ndajfolje, kurse fjala *"jekbidhne"* është folje e kohës së ardhme, ka mundësi se përdorimi i tyre në këtë mënyrë, të jetë për këtë arsye: Mbajtja e krahëve hapur është një program monoton, ndërkohë që hapja dhe mbledhja e krahëve është një gjë e përsëritshme. (Kini kujdes!)
Në lidhje me mahnitjet dhe bukuritë e botës së shpendëve, si dhe mrekullitë e çështjes së fluturimit të tyre, më gjerësisht është folur në në ajetin 79 të sures "En Nahl".

dekretin e vdekjes së tyre. Po, është e vërtetë se jobesimtarët gjenden në një mashtrim të madh.

Mbi mendjet e tyre kanë rënë perdet e mashtrimit dhe të injorancës dhe nuk i lejojnë të shohin të gjitha këto mësime, të shënuara në faqet e historisë, ose në një kënd të jetës së tyre.

Fjala *"xhundun"*, në thelb, është përdorur me kuptimin e tokës së thyer dhe të ngurtë, në të cilën janë mbledhur shumë gurë. Si vazhdim i këtij konotacioni kuptimor, edhe ushtrinë, gjithashtu, e quajnë *"xhund."*

Disa komentues të Kur'anit, fjalën *"xhund"* në ajetin e lartpërmendur, e interpretojnë si idhuj, të cilët në Kiamet nuk kanë mundësi t'u vijnë në ndihmë politeistëve. Por, më e pranuar është se kjo fjalë, në ajetin që po diskutojmë, ka një kuptim të gjerë, dhe ajo që shpjeguam për idhujt, është një prej përdorimeve kuptimore të tij.

Në ajetin 21, për ta theksuar më shumë çështjen, thuhet: "**Kush janë ata, që do t'ju japin mjete jetese, në qoftë se Ai jua ndalon ato?"**.

Në qoftë se All'llahu i Madhëruar e urdhëron qiellin, që të mos lëshojë shi, tokën, që të mos mbijë bimë, ose urdhëron që të ndodhin fatkeqësi të ndryshme, që të zhdukin produktet, cili prej jush ka fuqi dhe forcë për t'i siguruar vetes ndonjë ushqim?

Në qoftë se All'llahu i Madhëruar urdhëron për ndërprerjen e begative shpirtërore dhe të Shpalljes, atëherë, cili nga ju do të ketë forcën e udhëzimit tuaj?

Këto janë të vërteta dhe të qarta, por këmbëngulja dhe topitja e tyre është si një mbulesë karshi perceptimit dhe ndjenjave të njeriut, prandaj, në fund të ajetit, thuhet: **"Por ata janë zhytur në kryeneçësi e mendjemadhësi."**.

Madje, edhe në ditët tona, me gjithë përparimin që është bërë në fusha të ndryshme të jetës së njeriut, sidomos arritjet në industrinë ushqimore, nëse vetëm për një vit nuk bie fare shi, mund të paramendoni se çfarë tragjedie do të ndodhte në të gjithë botën. Ushtria e karkalecave do të pushtonte gjithë tokën dhe mjetet e jetesës do të ndërpriteshin për të gjithë. Çfarë fatkeqësie do të ishte kjo?!

Hulumtim

Katër shkaqe për dështimin e njeriut

Në ajetet e kaluara, mësuam se faktori kryesor i përfundimit të banorëve në ferr është rebelimi dhe mungesa e mendjes së ndritur dhe të zgjuar. Po ashtu, në ajetet në diskutim, vërejtëm që ishin edhe katër shkaqe të tjera, që e çojnë njeriun në atë përfundim. Ato shkaqe janë: mendjemadhësia, kryeneçësia, kokëfortësia dhe urrejtja. Këto janë shkaqet kryesore të fatkeqësive të njeriut, që e largojnë atë nga rruga e drejtë dhe e çojnë në dështim.

Në qoftë se tregohemi të vëmendshëm, do të vëmë re se këto shkaqe kanë lidhje me faktorin e lartpërmendur, sepse këto tipare të shëmtuara hedhin një "perde" mbi veshët dhe sytë e njeriut dhe e ndalojnë atë të shikojë dhe të perceptojë të vërtetën.

Ajetet 22 - 27

أَفَمَنْ يَمْشِي مُكِبًّا عَلَى وَجْهِهِ أَهْدَى أَمَّنْ يَمْشِي سَوِيًّا عَلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ﴿٢٢﴾ قُلْ هُوَ الَّذِي أَنْشَأَكُمْ وَجَعَلَ لَكُمُ السَّمْعَ وَالْأَبْصَارَ وَالْأَفْئِدَةَ قَلِيلًا مَا تَشْكُرُونَ﴿٢٣﴾ قُلْ هُوَ الَّذِي ذَرَأَكُمْ فِي الْأَرْضِ وَإِلَيْهِ تُحْشَرُونَ﴿٢٤﴾ وَيَقُولُونَ مَتَى هَذَا الْوَعْدُ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ﴿٢٥﴾ قُلْ إِنَّمَا الْعِلْمُ عِنْدَ اللَّهِ وَإِنَّمَا أَنَا نَذِيرٌ مُبِينٌ﴿٢٦﴾ فَلَمَّا رَأَوْهُ زُلْفَةً سِيئَتْ وُجُوهُ الَّذِينَ كَفَرُوا وَقِيلَ هَذَا الَّذِي كُنْتُمْ بِهِ تَدَّعُونَ﴿٢٧﴾

“A është më mirë ai që shkon rrëshqanas e kokulur apo ai që ecën ballëlart në Rrugën e Drejtë?”

“Thuaju: ‘Është Ai që ju ka krijuar dhe ju ka dhënë dëgjimin, shikimin dhe zemrat, e megjithatë ju pak e falënderoni!’”

“Thuaju: ‘Është Ai që ju ka shpërndarë nëpër Tokë dhe para Tij do të tuboheni.’”

“Ata thonë: ‘Atëherë, kur (do të vijë) **ky premtim, nëse thoni të vërtetën?’”**

“Thuaju: ‘Dijenia (për këtë) **i përket vetëm All’llahut, kurse unë jam vetëm një paralajmërues i qartë.’”**

“Kur të shohin dënimin për së afërmi, fytyrat e atyre që mohuan do të zymtohen dhe, atëherë, do t’u thuhet: ‘Ja, kjo është ajo që e keni kërkuar të shpejtohej!’”

Komentimi

Ata që ecin ballëlart në Rrugën e Drejtë

Në vazhdim të ajeteve të kaluara, ku u diskutua rreth besimtarëve dhe jobesimtarëve, në ajetin 22, me anë të një shembulli interesant, pasqyrohet gjendja e këtyre dy grupeve.

Ajeti 22 thotë: **"A është më mirë ai që shkon rrëshqanas e kokulur apo ai që ecën ballëlart në Rrugën e Drejtë?"**.

Këtu njerëzit jobesimtarë, shtypës, kryeneçë dhe mendjemëdhenj janë krahasuar me njeriun që kalon nëpër një rrugë plot kthesa e zigzage dhe tepër të ngushtë. Ai ecën i përmbysur me fytyrë në tokë, saqë duket sikur nuk është në gjendje të shohë Rrugën e Drejtë. Ai duket sikur nuk mundet as ta kontrollojë veten, duket sikur nuk është në dijeni për pengesat gjatë rrugës dhe duket sikur as që mund të nxitojë. Bën hapa të shkurtra, por menjëherë ndihet i pafuqishëm.

Besimtarët i krahason me njerëzit që qëndrojnë në pozicion të favorshëm, që vazhdojnë të qetë rrugën e tyre, duke ecur në teren shumë të përshtatshëm; janë kokëlartë, ecin me nxitim dhe me hapa energjikë, si dhe janë plotësisht të vetëdijshëm për vendin ku duan të arrijnë.

Sa krahasim interesant dhe i saktë. Ndikimi i këtij krahasimi është plotësisht i qartë në jetën e këtyre dy grupeve dhe ne i shohim me sytë tanë dallimet mes tyre. Disa komentues të ajeteve kur'anore, simbolin konkret dhe përfaqësuesit e këtyre dy

grupeve i kanë përcaktuar me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe Ebu Xhehlin. Sigurisht që këta janë shembuj të qartë për ajetin e lartpërmendur, por as e gjithë kjo nuk e kufizon kuptimin e gjerë të tij.

Në tefsirin e fjalisë *"mukkiben ala uexhhihi"* janë parashtruar shumë mundësi:

Ajo që përputhet me kuptimin leksikor të saj, është ajo që u tha më sipër, është fjala për atë që ecën i përmbysur dhe me zvarritje në tokë.

Disa komentues të tjerë, kanë thënë se ajeti nënkupton ecjen në këmbë, por kokulur. Këtë lloj ecjeje e bën ai që nuk e ka të qartë mirë rrugën e vet.

Të tjerë komentues, janë të mendimit se ajeti ka parasysh njeriun që e ruan ekuilibrin e tij, por, pasi bën disa hapa, rrëzohet, sërish ngrihet. Kjo gjë përsëritet gjithnjë.

Në qoftë se u referohemi shpjegimeve të dhëna nga Ragib Isfahanij, në fjalorin "El Mufredat", mund të themi se ajeti flet për njeriun egocentrik, i cili tregon kujdes për veten e tij dhe është plotësisht i pandjeshëm ndaj të tjerëve. Por përdorimi i kuptimit të parë duket më i përshtatshëm, për të përshkruar gjendjen e besimtarëve, të cilët përcaktohen si *"jemshi seuija"* (ai që ecën në pozicion të drejtë).

Sidoqoftë, këtu shtrohen pyetjet: Cila është gjendja e këtyre dy grupeve, e besimtarëve dhe e jobesimtarëve, në këtë botë? Cila

është gjendja e besimtarëve dhe e jobesimtarëve në Botën Tjetër? Mos vallë bëhet fjalë për gjendjet e tyre në të dy botët?

Nuk kemi ndonjë argument në dorë që kufizon kuptimin e ajetit, kështu që si në këtë botë, si në Atë Botë, një gjendje kanë.

Njerëzit jobesimtarë, pra, egoistët kryeneçë dhe kokëfortë, nuk shohin asnjë gjë tjetër, përveç interesave të veta materiale dhe kalimtare, ecin në rrugën e tyre të devijimit dhe të epshit. Ata ngjasojnë me njeriun që ecën herë këmbadoras e herë duke u zvarritur nëpër shkëmbinj. Ata që besuan, ecin nën dritën e besimit, kanë vizion të thellë dhe janë në Rrugë të Drejtë dhe të qartë.

Ajeti 23 i drejtohet Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "**Thuaju: 'Është Ai që ju ka krijuar dhe ju ka dhënë dëgjimin, shikimin dhe zemrat, e megjithatë ju pak e falënderoni!'"**.

All'llahu i Madhëruar ju ka vënë në dispozicion edhe mjetin e vrojtimit dhe të shikimit, syrin, edhe mjetin e informimit rreth rezultatit të mendimeve të të tjerëve, veshin. Po ashtu, ju ka dhënë mjetin e të menduarit shkencor e racional, zemrën. Thënë shkurt, ka vënë në dispozicionin tuaj të gjitha mjetet e nevojshme për t'u informuar me shkencat racionale dhe fetare (shkencat e transmetuara). Por janë të paktë ata njerëz që janë falënderues për të gjitha këto begati të mëdha. Falënderimi për begatitë dhe mirësitë shprehet dhe konkretizohet, kur çdo begati dhe mirësi shfrytëzohet për qëllimin që është krijuar. Vallë, a i shfrytëzojmë ne në mënyrën e duhur sytë, veshët dhe mendjen tonë?

Më pas, edhe një herë tjetër i drejtohet Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"Thuaju: 'Është Ai që ju ka shpërndarë nëpër Tokë dhe para Tij do të tuboheni.'"**.

Në realitet, ajeti 22 e kishte përcaktuar "rrugën", ajeti 23 kishte përcaktuar "mjetet dhe instrumentet e veprimit", kurse ajeti në fjalë, 24, përcakton "qëllimin dhe objektivin", që do të thotë se duhet të ecni në Rrugën e Drejtë të besimit dhe të Islamit, duhet të përfitoni nga të gjitha mjetet e njohjes dhe duhet të ecni drejt Jetës së Përtejme.

Për të theksuar është fakti se në ajetin e mëparshëm, është përdorur shprehja *"enshe'ekum"*, kurse në këtë ajet, është përdorur shprehja *"dher'rre'kum"*. Ka mundësi që këto dy shprehje të ndryshojnë nga njëra–tjetra. Shprehja e parë të flasë për krijimin e njeriut nga asgjëja, (që do të thotë se nuk keni ekzistuar fare dhe All'llahu ju krijoi), kurse shprehja e dytë, të flasë për krijimin e njeriut nga dheu, që do të thotë "juve ju kam krijuar nga dheu".

Më pas, në lidhje me po këtë çështje, u përgjigjet mohuesve të Ditës së Gjykimit: **"Atëherë, kur** (do të vijë) **ky premtim, nëse thoni të vërtetën?"**.

Pra, përse nuk e përcaktoni saktësisht datën, kur do të ndodhë Kiameti? Përse nuk ua bëni të qartë të gjithë njerëzve këtë?

Lidhur me sqarimin se cili është kuptimi dhe synimi i togfjalëshit **"ky premtim"**, janë përmendur dy mundësi interpretimi:

Së pari, premtimi për Kiametin; së dyti, premtimi i dënimeve të ndryshme në këtë botë, si p.sh. tërmetet, vetëtimat dhe stuhitë. Duke pasur parasysh ajetin e mëparshëm, kuptimi i parë është më i përshtatshëm, edhe pse sinteza midis të dy kuptimeve është e mundshme.

Ajeti 26, u përgjigjet atyre në këtë mënyrë**: "Dijenia** (për këtë) **i përket vetëm All'llahut, kurse unë jam vetëm një paralajmërues i qartë."**.

Kjo shprehje është e ngjashme me shprehjet që janë përmendur në shumë sure të Kur'anit, si p.sh. në ajetin 178 të sures "El A'raf"**: "Të pyesin Ty** (o i Dërguar) **për çastin** (katastrofën e përgjithshme) **se kur do të ndodhë. Thuaju: Atë e di vetëm Zoti im, kohën e tij nuk mund ta zbulojë askush, përveç Tij."**.

Kështu duhet të jetë, sepse në qoftë se do të përcaktohej data e Ditës së Kiametit dhe do të kishte largësi të madhe kohore, njerëzit do të kishin ngelur të shtangur. Por, edhe nëse nuk do kishte shumë largësi kohore, njerëzit do të ishin në një gjendje mjerimi. Sidoqoftë, në të dy rastet, qëllimet edukative dhe didaktike do të kishin ngelur pezull dhe të paplota.

Në ajetin 27, thuhet: **"Kur të shohin dënimin për së afërmi, fytyrat e atyre që mohuan do të zymtohen dhe, atëherë, do t'u thuhet: 'Ja, kjo është ajo që e keni kërkuar të shpejtohej!'"**.

Fjala *"ted'une"* rrjedh nga fjala *"dua"*, që do të thotë "gjithnjë kërkonit dhe luteshit që të ndodhte Kiameti. Tani ka ndodhur dhe nuk ka rrugëdalje nga kjo situatë".

Ky kuptim është i ngjashëm me kuptimin që është përmendur në ajetin 14 të sures "Edh Dharjiat", kur u drejtohet jobesimtarëve. Këtu thuhet se në Ditën e Kiametit, do t'u thuhet atyre **"Përjetojeni dënimin tuaj, ky është ai që kërkonit t'ju shpejtohet!"**. Ashtu siç e ka pohuar shumica e komentuesve të Kur'anit, ky është një argument, që vërteton se sifjalia: **"Atëherë, kur** (do të vijë) **ky premtim…"**, tregon për premtimin në lidhje me Kiametin.

El Hakim Ebul Kasim El Haskanij thotë: "Kur jobesimtarët e kuptuan pozitën e Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* te All'llahu, fytyrat e tyre u nxinë nga zemërimi.".[1]

Ky kuptim është përcjellë, gjithashtu, në një hadith të transmetuar nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)*. Aty thuhet se ky ajet ka zbritur për Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe shokët e tij.[2]

Sigurisht, ky interpretim, i cili është transmetuar nga synitë dhe shi'at është një lloj krahasimi me ajetin që ka të bëjë me Ringjalljen dhe Kiametin, por krahasime të tilla nuk janë të pakta në literaturën e hadithit.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10 f. 330.

[2] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 385.

Ajetet 28 – 30

قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ أَهْلَكَنِيَ اللَّهُ وَمَنْ مَعِيَ أَوْ رَحِمَنَا فَمَنْ يُجِيرُ الْكَافِرِينَ مِنْ عَذَابٍ أَلِيمٍ ٢٨ قُلْ هُوَ الرَّحْمَنُ آمَنَّا بِهِ وَعَلَيْهِ تَوَكَّلْنَا فَسَتَعْلَمُونَ مَنْ هُوَ فِي ضَلَالٍ مُبِينٍ ٢٩ قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ أَصْبَحَ مَاؤُكُمْ غَوْرًا فَمَنْ يَأْتِيكُمْ بِمَاءٍ مَعِينٍ ٣٠

"Thuaj: 'Mendoni: në qoftë se All'llahu më shkatërron mua dhe ndjekësit e mi apo na mëshiron, kush është ai që do t'i mbrojë jobesimtarët nga dënimi i padurueshëm?!'"

"Thuaj: 'Ai është i Gjithëmëshirshmi; ne Atë besojmë dhe tek Ai mbështetemi e ju, sigurisht, do ta merrni vesh se kush do të jetë në humbje të plotë.'"

"Thuaj: 'Mendoni: nëse ujërat tuaja ju shteren, kush (përveç All'llahut) **do t'ju sjellë ujë rrjedhës?!'"**

Komentimi

Kush është ai që ju sjell ujë të rrjedhshëm?

Ajetet e lartpërmendura, si dhe ajetet e fundit të sures "El Mulk", fillojnë me fjalën **"thuaj"**. Pra, All'llahu i drejtohet Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e*

tij!) dhe diskutimet janë vazhdim i çështjeve të ajeteve pararendëse, në të cilat u fol rreth jobesimtarëve. Këtu jepen sqarime për aspekte të tjera, të lidhua me këtë temë.

Në fillim u drejtohet atyre që ishin në pritje të vdekjes së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe shokëve të tij, të cilët shpresonin që, me vdekjen e tyre, do të zhdukej edhe feja e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe çdo gjë do të merrte fund. Zakonisht, armiqtë e udhëheqësve të drejtë, gjithnjë mbajnë shpresa të tilla, prandaj ajeti 28 thotë: **"Thuaj: 'Mendoni: në qoftë se All'llahu më shkatërron mua dhe ndjekësit e mi apo na mëshiron, kush është ai që do t'i mbrojë jobesimtarët nga dënimi i padurueshëm?!'"**.

Në disa hadithe thuhet se jobesimtarët e Mekës e mallkonin Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe shokët e tij. Ata kërkonin vdekjen e tij, me pretekstin se, nëse Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e lë këtë botë, edhe ftesa e tij në Rrugën e Drejtë, do të ndërpritej dhe çdo gjë do të merrte fund. Në këtë kohë zbriti ajeti i lartpërmendur dhe iu përgjigj atyre.

I njëjti kuptim është përmendur edhe në ajetin 30 të sures "Et Tur": **"E ata thonë: 'Ai është poet, po presim kohën ta zhdukë.'"**.

Ata nuk e dinin se All'llahu i Madhëruar, të Dërguarit të Vet i ka dhënë premtimin e bekuar, që emri i tij do të jetë i shoqëruar me Emrin e Tij (All'llahut), që është i Përjetshmi që nuk zhduket kurrë. Edhe kur Profeti të vdesë, ai kurrë nuk do të harrohet.

Po, atij i është dhënë premtimi i fitores së kësaj feje, si dhe dominimi i saj në të gjithë botën, kështu që jeta dhe vdekja e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk do të ndryshojë asnjë gjë.

Disa komentues të tjerë, kanë dhënë një interpretim tjetër, në lidhje me këtë ajet. Ata pohojnë se Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i drejtohet duke i thënë: 'Thuaj, ne me armiqtë e besimit dhe të Zotit jemi në mes frikës dhe shpresës. Ju çfarë mendoni rreth vetes suaj?".

Interpretimi i parë duket më i drejtë dhe më i saktë.

Më pas, në vazhdim të po kësaj teme, shton: **"Thuaj: 'Ai është i Gjithëmëshirshmi; ne Atë besojmë dhe tek Ai mbështetemi e ju, sigurisht, do ta merrni vesh se kush do të jetë në humbje të plotë.'"**.

Ky ajet përcjell mesazhin: Ne besojmë në All'llahun e Madhëruar dhe e pranojmë Atë si këshilluesin dhe mbikëqyrësin tonë, sepse Ai është All'llahu i Gjithëmëshirshëm. Mëshira e Tij ka kapluar çdo gjë, të mirat e Tij u përkasin miqve dhe armiqve. Një vështrim sado i shkurtër rreth kësaj bote ekzistuese, është dëshmi e këtyre pretendimeve. Por tregoni nëse idhujt, të cilët ju i adhuroni, a kanë bërë ndonjë gjë për ju?!

Shmangia juaj nga Rruga e Drejtë, bëhet e qartë që këtu, në këtë botë, kur Islami i mbështetur dhe i përkrahur nga All'llahu, do të korrë fitore ndaj jobesimtarëve, ngadhënjimi i mrekullueshëm i të vërtetës do të bëhet më i qartë. Kurse në Ditën e Gjykimit, bëhet edhe më i qartë për të gjithë shmangia juaj nga Rruga e Drejtë.

Ky ajet është një lloj ngushëllimi për Profetin dhe besimtarët. Ky ajet u tregon atyre se nuk janë vetëm në këtë luftë të vazhdueshme ndërmjet të vërtetës dhe gënjeshtrës, përkundrazi All'llahu i Madhëruar është Ndihmës dhe Përkrahës i tyre.

Në ajetin e fundit të kësaj sureje, Kur'ani na sjell një shembull nga mëshira gjithëpërfshirëse e All'llahut, për të cilën shumica e njerëzve nuk janë në dijeni. Ajeti thotë: "**Thuaj: 'Mendoni: nëse ujërat tuaja ju shteren, kush** (përveç All'llahut) **do t'ju sjellë ujë rrjedhës?!'"**.

Dimë se toka është e përbërë nga dy shtresa të ndryshme: shtresa e depërtueshme, nëpër të cilën futet uji dhe shtresa e padepërtueshme, e cila ndodhet nën shtresën e depërtueshme. Shtresa e padepërtueshme e ruan ujin dhe e nxjerr në të gjitha burimet e ujit. Puset dhe ujësjellësit krijohen në saje të këtij kombinimi të veçantë. Në qoftë se e gjithë sipërfaqja e tokës, deri në një thellësi të madhe, do të ishte shtresë e depërtueshme, ujërat do të rridhnin e do të largoheshin. Asnjë dorë njerëzore nuk do të ishte në gjendje ta parandalonte atë. Po ashtu, edhe nëse e gjithë shtresa do të ishte shtresë e padepërtueshme, ujërat do të qëndronin mbi sipërfaqe të tokës dhe kështu do të formohej moçal dhe përmbytje e më pas do të rridhte në dete. Në këtë mënyrë, do të humbisnin të gjitha rezervat e ujërave nëntokësore.

Ky është një shembull i vogël, për sa i përket mëshirës gjithëpërfshirëse të All'llahut, me të cilin janë të ndërlidhura vdekja dhe jeta e njeriut.

Fjala "*main*" rrjedh nga rrënja "*mean*". Kjo fjalë është përdorur me kuptimin e ujit rrjedhës. Është thënë se kjo fjalë rrjedh

nga fjala *"ajn" - "syri"*, duke shpjeguar se rrokja *"mim"* është shtesë. Disa komentues të Kur'anit, fjalën *"meani"* e kanë marrë në kuptimin e ujit që shihet me anë të syrit, edhe po të mos jetë rrjedhës.

Shumica e leksikografëve e kanë komentuar me kuptimin e parë, pra, të ujit rrjedhës.

Edhe pse uji i pijshëm nuk është çdo ujë i rrjedhshëm, pa asnjë dyshim, ujërat rrjedhëse konsiderohen si ujërat më të mira, qofshin në formën e burimeve, lumenjve, apo të puseve dhe ujësjellësve.

Disa interpretues të Kur'anit, kanë transmetuar, se një jobesimtar, kur dëgjoi ajetin: **"nëse ujërat tuaja ju shteren, kush** (përveç All'llahut) **do t'ju sjellë ujë rrjedhës?!"**, tha se burrat e fortë dhe të fuqishëm, si dhe vinçat e mprehtë, do t'i nxjerrin ujërat nëntokësore.

Ndërkohë arriti nata dhe ai ra në gjumë. Ujëra të zeza ranë mbi sytë e tij. Në këtë kohë dëgjoi një zë që thoshte: "Sille atë burrin e fortë, silli vinçat apo kazmat e mprehta që të të vijnë në ndihmë për largimin e kësaj sasie uji nga fytyra!".

Në ditët tona, e dimë se po të zhduket shtresa e padepërtueshme e tokës, asnjë njeri i fuqishëm apo ndonjë vinç i mprehtë, nuk do të mund të nxjerrë asnjë pikë ujë.[1]

[1] Tefsiri "Ebul Fettuh Err Razij", vëll. 11, f. 219.

Hulumtim

Nga hadithet e transmetuara nga Imamët e Ehli Bejtit, që kanë arritur në dorën tonë, ajeti në fjalë është interpretuar se flet për ardhjen e Imam Mehdiut dhe për drejtësinë e tij që do përfshijë mbarë botën. P.sh. në hadithin e Imam Bakirit *(Paqja qoftë mbi të!)*, lidhur me interpretimin e këtij ajeti, thuhet: "Ky ajet ka zbritur për Imamin e gjallë (Mehdiu), i cili do të thotë: 'Nëse Imami juaj është i fshehur dhe nuk e dini vendndodhjen e tij, cili njeri do të dërgojë një imam për ju, që t'ju shpjegojë lajmet e qiejve dhe të tokës, haramin dhe hallallin (të ndaluarën dhe të lejuarën) e All'llahut?'". Më pas, thotë: "Betohem në Zot, se interpretimi i këtij ajeti akoma nuk është realizuar dhe në të ardhmen do të vijë koha e realizimit të tij.".[1]

Ekzistojnë shumë hadithe, lidhur me këtë ajet. Duhet të theksojmë se të gjitha hadithet janë në formën e "përngjasimit". Ajeti duket sikur ka të bëjë me ujin rrjedhës, i cili është burimi dhe shkaku i jetesës së gjallesave, por ana e brendshëm, me ekzistencën e Imamit, me diturinë dhe drejtësinë gjithëpërfshirëse të tij mbi gjithë rruzullin tokësor. Imamët e ditur i ngjajnë ujit jetëdhënës dhe, gjithashtu, janë shkaku i jetesës së shoqërisë njerëzore.

Shumë herë është thënë se ajetet e Kur'anit janë me shumë shtresime kuptimore. Këto kuptime janë herë sipërfaqësore, herë të thella e të brendshme. Kuptimi i brendshëm, nënteksti i ajeteve

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 387.

kur'anore është i vështirë për t'u kuptuar nga njerëzit e zakonshëm, përveçse me ndihmën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të Imamëve. Askush nuk ka të drejtë ta trajtojë dhe të diskutojë mbi aspektin ezoterik të ndonjë ajeti. Atë që ne e themi, ka të bëjë me anën e jashtme të ajeteve, kurse ajo që ka të bëjë me anën e brendshme, pra, ezoterike të tyre, duhet ta dëgjojmë vetëm nga Imamët e dlirë.

Surja "El Mulk" filloi me diskutimin për sundimin dhe fuqinë absolute të All'llahut dhe përfundoi me mëshirën e Tij, si një aspekt i shfaqjes së sundimit dhe fuqisë së All'llahut. Në këtë mënyrë, fillimi dhe fundi i saj është plotësisht koherent.

O Zot! Të lutemi, që të na përfshish në mëshirën Tënde të madhe dhe të veçantë dhe na bëj, që të ngopemi me ujin jetëdhënës të dashurisë së të afërmve të Tu!

O Zoti im! Të lutemi, shpejtoje ardhjen e Imam Mehdiut, atë burim të ujit të jetës, që "të eturit" e dashur të tij të "ngopen" me ardhjen e tij!

O Zoti im! Të lutemi, na dhuro sy për të parë, veshë për të dëgjuar dhe dije të drejtë, na largo mbulesën e arrogancës dhe të mendjemadhësisë, që të shohim ashtu siç është, fytyrën e të vërtetës dhe të ecim ballëlart dhe të fortë në Rrugën e Drejtë!

Sure "El Kalem"

Zbritur në Mekë

52 ajete

Përmbajtja e sures "El Kalem"

Një pjesë e komentuesve të Kur'anit mendojnë se e gjithë kjo sure nuk është mekase. Disa komentues të tjerë janë të mendimit se gjysma e sures është mekase dhe gjysma tjetër medinase. Por toni i ajeteve dhe përmbajtja e tyre përputhet plotësisht me suret që kanë zbritur në Mekë, sepse para se gjithash, e gjithë surja përqendrohet mbi çështjen e profetësisë së të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, përqendrohet në luftën me armiqtë, të cilët e konsideronin atë "të çmendur", në apelin për të treguar durim dhe qëndrueshmëri, si dhe në çështjen e paralajmërimit dhe të kërcënimit të kundërshtarëve me dënimin e All'llahut.

Çështjet e kësaj sureje, mund t'i ndajmë në shtatë pjesë:

1- Në fillim të kësaj sureje përmenden disa prej tipareve të veçanta të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, veçanërisht morali i lartë i tij, të cilin e thekson me betime të forta.

2- Më pas, disa ajete të kësaj sureje paraqesin disa nga veset e liga dhe të shëmtuara të armiqve të tij (Profetit/*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

3- Një pjesë tjetër e ajeteve të kësaj sureje, flasin për tregimin e *"es'habul xhenneti"*, i cili është një paralajmërim për ata që ndjekin rrugën e kokëforcisë prej politeistëve me karakter të shëmtuar.

4- Në pjesën e katërt të sures, janë përmendur çështje të ndryshme, në lidhje me Kiametin dhe dënimin e jobesimtarëve në atë Ditë.

5- Në disa ajete të tjera të sures përmenden paralajmërime dhe kërcënime, në lidhje me politeistët.

6- Në ajete të tjera All'llahu e urdhëron Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që të përballet me armiqtë me durim dhe qëndrueshmëri të lartë

7- Në përfundim të sures, është diskutuar rreth madhështisë së Kur'anit dhe komploteve të ndryshme që thurnin armiqtë kundër Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Emërtimi i kësaj sureje me emrin "Kalem", është në përshtatje dhe në përputhje me ajetin e parë të kësaj sureje. Disa komentues, këtë sure e kanë emëruar "Nun", por, sipas disa haditheve që janë transmetuar, në lidhje me mirësitë dhe dobitë e kësaj sureje, nënkuptohet se kjo sure është quajtur "Nun" dhe "Kalem."

Mirësitë e leximit të sures "El Kalem"

Për mirësitë që fitohen nga leximi i kësaj sureje, nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është transmetuar: *"Ai që e këndon suren 'Nun - el kalem', shpërblehet nga All'llahu i Madhëruar me shpërblimin e atyre personave që kanë moral të vyer."*.[1]

Në një hadith tjetër, të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Ai që e lexon suren 'Nun - el kalem', në namazet e detyruara, si dhe në namazet e pëlqyeshme, All'llahu e ruan gjithnjë nga varfëria dhe, kur vdes, e mbron nga shtrëngimi i varrit."*.[2]

Këto shpërblime kanë një përputhshmëri të veçantë me përmbajtjen e sures dhe theksojnë qartë se vetëm leximi, i shoqëruar me vetëdije dhe praktikim, siguron efektet e përmendura.

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 387.

[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 330.

Ajetet 1 - 7

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

ن وَالْقَلَمِ وَمَا يَسْطُرُونَ١ مَا أَنْتَ بِنِعْمَةِ رَبِّكَ بِمَجْنُونٍ٢ وَإِنَّ لَكَ لَأَجْرًا غَيْرَ مَمْنُونٍ٣ وَإِنَّكَ لَعَلَى خُلُقٍ عَظِيمٍ٤ فَسَتُبْصِرُ وَيُبْصِرُونَ٥ بِأَيِّيكُمُ الْمَفْتُونُ٦ إِنَّ رَبَّكَ هُوَ أَعْلَمُ بِمَنْ ضَلَّ عَنْ سَبِيلِهِ وَهُوَ أَعْلَمُ بِالْمُهْتَدِينَ٧

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Nûn. Betohem për penën dhe për atë që shkruajnë."

"Se ti (o Muhammed), **falë mirësisë së Zotit tënd, nuk je i marrë."**

"Pa dyshim, ti do të jesh përherë i shpërblyer."

"Se ti je me virtyte madhore."

"Së shpejti ti do ta shohësh, por edhe ata do ta shohin."

"Se cilin prej jush e ka prekur marrëzia."

"Zoti yt e di më së miri, se cili është shmangur nga Rruga e Tij dhe, i njeh mirë ata që janë në Rrugën e Drejtë."

Komentimi

Sa moral të lartë që ke!

Kjo është e vetmja sure që fillon me një shkronjë të ndarë "ن" - "*nun*".

Në lidhje me shkronjat e ndara, kemi diskutuar shumë herë, veçanërisht në fillim të sures "El Bekare", "Ali Imran" dhe "El A'raf". Këtu duhet të shtojmë se disa komentues, rrokjen "*nun*" e kanë konsideruar si shkurtesë të fjalës "*rahman*" dhe e kanë interpretuar si aludim për këtë fjalë.

Disa të tjerë, e kanë komentuar në kuptimin e "لوح" -"*pllakës së ruajtur te All'llahu*", ose në kuptimin e pusit apo lumit në Xhennet, etj. Asnjëra prej këtyre interpretimeve, nuk mbështetet te një provë e qartë.

Si rrjedhojë, kuptimi i kësaj shkronje të ndarë nuk ndryshon nga komentimi i shkronjave të tjera të ndara, për të cilat kemi dhënë sqarime herë të tjera.

Më pas betohet në dy prej çështjeve më të rëndësishme jetësore të njerëzimit: **"Betohem për penën dhe për atë që shkruajnë"**.

Sa betim i çuditshëm! Duket se betimi bëhet për një gjë të vogël, për një penë, për një pikë bojë me ngjyrë të errët, për rreshtat që shkruhen mbi një fletë të pakushtueshme, etj.

Por në realitet, kjo është ekuivalente me burimin e zanafillës së të gjitha qytetërimeve njerëzore. Te pena dhe te shkrimi e ka fillimin përparimi dhe zhvillimi i shkencave, lëvrimi i ideve dhe formësimi i mendjeve. Pena dhe shkrimi janë burimi i udhëzimit dhe i informimit të njerëzimit. Qytetërimi e ndan në dy pjesë historinë e njerëzimit: Në periudhën parahistorike dhe në periudhën historike.

Periudha e historisë së njerëzimit fillon nga momenti që u shpik "rreshti" dhe njeriu kishte mundësi të shënonte ngjarjet dhe ndodhitë e përjetuara prej tij, thënë ndryshe, është periudha kur njeriu filloi të përdorë penën. Kjo gjë shënohet me shprehjen: **"për atë që shkruajnë"**.

Madhështia e këtij betimi bëhet më e qartë, kur mendojmë për atë epokë ku zbritën këto ajete, sepse atëherë në Mekë nuk ekzistonte ndonjë mjeshtër apo shkrimtar, që dinte të shkruante, atëherë numri i njerëzve që dinin shkrim dhe lexim në të gjithë Mekën, e cila ishte qendra fetare, politike e ekonomike e Hixhazit, nuk arrinte më shumë se njëzet veta.

Prandaj betimi në penën, në një mjedis të tillë, ka një madhështi të veçantë.

Interesant është fakti se ajetet e para që i janë zbritur Profetit Muhammed në Xhebel En Nur dhe në shpellën Hira, tregojnë pozitën e lartë të penës. Në këto ajete thuhet: **"Lexo, me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi** (çdo gjë)**. Krijoi njeriun prej një gjaku të**

ngjizur. Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun)**, të shkruajë me pendë. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte."**.[1]

Më i rëndësishëm se të gjithë është fakti, se të gjitha këto shprehje rrjedhin nga goja e një njeriu, i cili vetë nuk dinte shkrim dhe lexim, nuk kishte ndjekur asnjëherë mësime në ndonjë shkollë. Ky fakt vërteton se e gjitha kjo, nuk është gjë tjetër vetëm se shpallje nga ana e All'llahut.

Disa komentues të Kur'anit, "penën" këtu e kanë komentuar si pena me të cilën engjëjt e All'llahut e shkruanin Shpalljen qiellore, ose pena që shënon në dosjen përkatëse veprimet e njeriut. Gjithsesi, nuk ka dyshim se ajeti ka një kuptim të gjerë dhe komentime të tilla janë thjesht pjesë prej këtij kuptimi të gjerë. Shprehja **"për atë që shkruajnë"**, ka një kuptim të gjerë. Ky kuptim përfshin të gjitha idetë e shkruara në formën e udhëzimit, si përsosmëri mendore, etike dhe praktike të njerëzimit dhe nuk i përket vetëm Shpalljes, ose shënimit të veprave të njerëzve.

Më pas, ajeti diskuton për betimin që është për të: **"Se ti** (o Muhammed)**, falë mirësisë së Zotit tënd, nuk je i marrë."**.

Ata që ta mveshin ty këtë ves, janë zemërligj, të cilët nuk e vërejnë gjithë këtë begati që të ka dhënë All'llahu, begatinë e intelektit dhe të urtësisë, të sinqeritetit dhe të të qenit i drejtë, i besueshëm, nuk e vërejnë begatinë e dijes dhe të shkencës së qartë, profetësinë dhe pagabueshmërinë.

[1] Sure "El Alak", ajetet 1-5.

Të marrë janë ata që, atë që është i rrethuar me dije dhe intelekt, e akuzojnë se është "i marrë". Me anë të kësaj sjelljeje, largojnë nga vetja udhëzuesin e njerëzimit.

Më pas, deklaron: **"Pa dyshim, ti do të jesh përherë i shpërblyer."**.

Pse të mos ketë një shpërblim të tillë, ndërkohë që u bën ballë këtyre kërcënimeve të padrejta dhe të liga dhe kërkon udhëzimin dhe shpëtimin e tyre prej dënimeve të All'llahut, si dhe asnjëherë nuk shfaq lodhje në këtë rrugë të vështirë?!

Fjala "*memnun*" rrjedh nga fjala "*menne*" dhe është përdorur me kuptimin e "*ndërprerjes*", që do të thotë, shpërblim që asnjëherë nuk do të ndërpritet, gjithnjë është i vazhdueshëm.

Disa komentues të tjerë, kanë thënë se rrënja e kësaj fjale vjen nga fjala "*el minnetu*", sepse "*el minnetut*" bëhet shkak i ndërprerjes së begatisë.

Komentues të tjerë, gjithashtu, kanë deklaruar se kuptimi i shprehjes "*gajre memnunin*", sqaron se All'llahu i Madhëruar, për këtë shpërblim të madh, asnjëherë nuk do të të kërkojë mirënjohje.

Interpretimi i parë është më i përshtatshëm.

Ajeti në vijim përshkruan një virtyt tjetër të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"Ti je me virtyte madhore"**, me moral të shoqëruar me një intelekt të mahnitshëm, me mëshirë dhe dashuri të pashembullt,

me cilësi dhe sinqeritet të papërshkrueshëm, si dhe me një durim, qëndresë dhe tolerancë të pashembullt.

Në qoftë se i fton njerëzit në adhurimin e All'llahut, para së gjithash, ti vetë duhet ta adhurosh më shumë All'llahun dhe, nëse i ndalon të tjerët nga kryerja e mëkateve, në fillim, ti vetë, duhet të qëndrosh larg tyre. Sa herë që të të ngacmojnë, t'i i këshillon ata; ata të abuzojnë, kurse ti kërko falje për ta; ata të gjuajnë me gurë dhe mbrapa shpine të hedhin ujë të ngrohtë mbi kokë, ti zgjati duart drejt All'llahut për udhëzimin e tyre.

Po, ti je vatra e dashurisë, e ndjenjave dhe burim i mëshirës.

Fjala *"khulukun"* rrjedh nga fjala *"khilketun"* dhe është përdorur me kuptimin e virtyteve të pandashme nga njeriu.

Disa komentues të Kur'anit, kanë përmendur disa prej virtyteve madhore të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si: durimtar në Rrugën e Drejtë, zemërgjerë dhe falës, udhëheqës i shquar, tolerant dhe dorëlëshuar, i durueshëm në vështirësitë që hasen në rrugën e thirrjes së njerëzve drejt All'llahut, falës dhe i mëshirshëm, luftëtar i përkushtuar në Rrugën e All'llahut, i larguar prej zilisë dhe lakmisë. Edhe pse Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i kishte të gjitha këto virtyte, përsëri "virtytet madhore të tij" nuk kufizohen vetëm me këto.

Në disa komente të tjera, si "virtyte madhore" janë interpretuar edhe Kur'ani dhe feja islame, të cilat mund të jenë një pjesë prej kuptimit të gjerë të lartpërmendur. Sidoqoftë, mishërimi i këtyre virtyteve madhore te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i*

All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) është argument i qartë i intelektit dhe i urtësisë së pashoqe të tij. Është argument edhe për mohimin e fjalëve të papërshtatshme të armiqve që thoshin për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Në vazhdimësi, ajetet 5-6 thonë: **"Së shpejti ti do ta shohësh, por edhe ata do ta shohin, se cilin prej jush e ka prekur marrëzia."**.

Fjala *"meftunun"* do të thotë infeksion, kurse këtu është përdorur me kuptimin e të prekurit nga marrëzira dhe çmenduria.

Ata të atribuojnë fjalë të tilla, me qëllim që të largojnë robtë e All'llahut prej teje, por njerëzit kanë mendje dhe vetëdije.

Gradualisht do të vetëdijesohen me fjalët dhe udhëzimet e tua dhe atëherë, për të gjithë, do të bëhet e qartë se këto mësime që burojnë nga All'llahu i Madhëruar, janë zbritur në zemrën tënde të pastër. Zoti i Madhëruar ty të ka dhuruar një pjesë të madhe të dijes dhe diturisë së Tij.

Qëndrimet dhe pikëpamjet e tua, në të ardhmen, përparimi dhe ndikimi i shpejtë i Islamit, nën dritën e tyre, do të dëshmojnë se ti je burim i madh i diturisë dhe i urtësisë, ndërsa të çmendur dhe të marrë janë lakuriqët e natës, politeistët, të cilët u ngritën që të përleshen me dritën e këtij dielli.

Sigurisht që në Ditën e Kiametit, këto realitete do të bëhen më të spikatura e më të dukshme.

Për ta ritheksuar dhe më shumë këtë gjë, ajeti 7 thotë: **"Zoti yt e di më së miri, se cili është shmangur nga Rruga e Tij dhe, i njeh mirë ata që janë në Rrugën e Drejtë."**.

Më mirë se çdokush, Rrugën e Drejtë e njeh Zoti i Madhëruar. Kjo i jep më shumë besim Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, se është duke ecur në këtë rrugë, kurse armiqtë e tij i janë shmangur Rrugës së Drejtë.

Në një hadith thuhet: "*Kur kurejshët panë se Profeti Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) po i kushtonte më shumë rëndësi Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) se sa të tjerëve, thanë: 'Muhammedi është i çmendur pas tij'.*".

Kur zbritën ajetet e mëposhtme, në lidhje me "Nun dhe penën", u betuan se Muhammedi nuk ishte i çmendur. Ky trajtim vazhdoi deri te ajeti: **"Zoti yt e di më së miri, se cili është shmangur nga Rruga e Tij dhe, i njeh mirë ata që janë në Rrugën e Drejtë."**.

E gjithë kjo pjesë e ajetit, i është adresuar shoqërisë së kurejshëve, të cilët i thoshin këto fjalë, kurse pjesa tjetër e ajetit: **"Zoti i njeh më së miri të udhëzuarit në Rrugën e Drejtë"**, i dedikohet Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*.[1]

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 334. Tabrisij e ka transmetuar këtë hadith me zinxhir transmetimi (sened) nga Ehli Syneti.

Hulumtime

1- Rroli i penës në jetën e njeriut

Një prej ngjarjeve më të rëndësishme në historinë njerëzore, ashtu siç e diskutuam dhe më lart, është fillimi i shkrimit dhe përdorimi i penës për të shënuar ngjarjet mbi letër, apo mbi gurë, mbi lëkurë (pergamenë). Ishte pikërisht pena, ajo që e ndau historinë në dy periudha, në atë parahistorike dhe në periudhën historike.

Me fillimin e shkrimit me penë mbi letër, përcaktohet fati i njerëzimit, prandaj fitorja apo humbja e shoqërive njerëzore ndërlidhet me penën.

Pena është kujtesa e shkencave dhe e dijeve, ruajtësja e mendimeve dhe e ideve të dijetarëve, hallka e bashkimit të mendimit të dijetarëve, urë lidhëse e të shkuarës dhe e të ardhmes së njerëzimit, bile lidhja e qiellit me tokën. Shpallja hyjnore është mundësuar me anë të fletës së shkruar me penë.

Pena bashkon njerëzit që jetojnë të ndarë dhe larg nga njëri–tjetrit. Përmes shkrimeve duket se njeriu i takon të gjithë mendimtarët dhe dijetarët e njerëzimit, të cilët kanë jetuar gjatë gjithë historisë. Përmes shkrimeve, njeriu njihet me përvojën njerëzore në breza.

Pena është misteri i njerëzimit, thesari i shkencave dhe grumbulluese e përvojave të të gjithë shekujve. Prandaj, nëse Kur'ani betohet në penën, duhet kuptuar vlerësimi për të, sepse

betimi gjithnjë bëhet mbi një çështje shumë të rëndësishme dhe të vyer.

Sigurisht, pena për ne është një mjet për të shkruar, **(për atë që shkruajnë)** dhe Kur'ani është betuar në të dy, pra, edhe mbi "mjetin", edhe mbi "produktin" e mjetit.

Në disa transmetime, thuhet: *"Gjëja e parë që ka krijuar All'llahu, ishte pena."*.

Këtë hadith, dijetarët shi'itë e kanë transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*,[1] ndërsa në librat e Ehli Synetit, është cituar si një hadith i njohur.[2]

Në një hadith tjetër, thuhet; *"Gjëja e parë që ka krijuar All'llahu, ishte boja."*.[3]

Në disa transmetime të tjera, lexojmë: *"Gjëja e parë që ka krijuar All'llahu, ishte mendja dhe intelekti."*.[4]

Në qoftë se e vërejmë kohezionin, pra, lidhjen e ngushtë që ekziston ndërmjet "penës", "bojës" dhe "intelektit", bëhet qartë se përse të gjitha këto cilësohen si krijesa të para të All'llahut.

Tek hadithi i Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, për të cilin diskutuam më lart, vërejmë se Zoti, pasi krijoi penën, e urdhëroi

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 9, f. 389.
[2] Tefsiri i "Fakhru Rrazij", vëll. 30, f. 78
[3] Tefsiri i "Fakhru Rrazij", vëll. 30, f. 78.
[4] Tefsiri i "Fakhru Rrazij", vëll. 30, f. 78.

atë të shkruajë. Ajo do të shkruajë çdo gjë që ka ekzistuar dhe do të ekzistojë, deri në Ditën e Kiametit.

Udhëheqësit e mëdhenj të Islamit, shpeshherë, i këshillonin ndihmësit e tyre, që të mos mjaftoheshin me memorizimin e dijes, por u sugjeronin që transmetimet islame dhe shkencat hyjnore t'i përmbledhin në formë të shkruar, në mënyrë që t'i linin si dëshmi për pasardhësit.[1]

Disa shkencëtarë, kanë deklaruar se shpjegimi bëhet në dy mënyra: shpjegimi me anë të gjuhës dhe shpjegimi me anë të shkrimit, pra, me anë të penës. Shpjegimi me anë të gjuhës, me kalimin e kohës, zbehet dhe kalon në harresë, kurse shpjegimi me anë të penës, asnjëherë nuk harrohet. Ai mbetet i përhershëm.[2]

Dijetarët, gjithashtu, kanë thënë se baza e çështjeve të fesë dhe botës, ndërtohet mbi dy shtylla: mbi penën dhe mbi shpatën. Shpata ndodhet nën juridiksionin e penës.[3]

Këtë domethënie, disa poetë arabë, e kanë shprehur në këtë mënyrë: "Nga dita që u mpreh pena, u përcaktua nga ana e All'llahut që shpatat e mprehta të jenë në shërbim të saj.".[4]

Një poet tjetër, duke cituar ajetet e lartpërmendura, në lidhje me këtë, thotë: "Atë ditë, kur luftëtarët e fuqishëm, betohen në shpatat e veta dhe atë e konsiderojnë si një mjet me vlerë, ndihen

[1] "Uesailu Shiah", vëll. 18, f. 56, Hadithet, 14, 16-20.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 332.
[3] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 332.
[4] Tefsiri "Mexhmaul Bejan, vëll. 10, f. 332.

krenarë për të. Penës së shkrimtarëve u mjafton vetëm kjo krenari dhe ky nder ndër epoka, e cila përftohet nga vlerësimi i madh që i ka bërë All'llahu penës, kur Ai u betua për penën e jo për shpatën.".[1]

Realiteti e miraton këtë. Fitoret ushtarake, në qoftë se nuk shoqërohen me kulturë të fuqishme dhe të pasur, nuk do të jenë të qëndrueshme. Mongolët kanë korrur fitoren më të madhe në historinë e Iranit, por, meqenëse ishin një popull i pakulturuar, shumë shpejt u detyruan ta përqafojnë kulturën e Islamit dhe të Iranit dhe kështu ndryshuan rrugëtimin e tyre.

Ngaqë kjo është një çështje tepër e gjerë dhe nuk na lejohet të largohemi nga metoda e komentimit, po e mbyllim diskutimin, duke cituar një thënie nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Janë tri zëra, të cilat i grisin perdet dhe arrijnë pranë All'llahut të Madhëruar. Zëri që lëshohet nga pena gjatë shkrimit mbi letër, zëri i hapave të luftëtarëve të së vërtetës në fushën e betejës dhe zëri i punës me dorë të grave të devotshme."*.[2]

Sigurisht, e gjithë ajo që u tha më lart, ka për qëllim penat që janë shërbëtore në Rrugën e Drejtë, në rrugën e drejtësisë. Për sa u përket penave të helmuara dhe të devijuara, ato konsiderohen prej fatkeqësive më të mëdha dhe si rreziku më i madh për shoqëritë njerëzore.

[1] Tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 10, f. 102.

[2] "Esh Shehabu fil Hukmi uel adabi", f. 22.

2- Një shembull nga morali i Profetit të Islamit

Fitoret e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishin me ndihmën dhe përkrahjen e All'llahut të Madhëruar, por ato shoqëroheshin me faktorë të tjerë mbështetës. Më të rëndësishmin prej tyre, mund të quajmë moralin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte shumë cilësi të larta njerëzore dhe fisnike. Edhe armiqtë më të mëdhenj të tij ndikoheshin nga sjellja e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe detyroheshin t'i bindeshin atij, kurse dashamirësit e vet i tërhiqte me lehtësi nga vetja.

Edhe, nëse këtë do ta quanim mrekulli etike të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nuk do e kishim tepruar. Një shembull nga mrekullitë e etikës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e kemi vërejtur dhe në çlirimin e Mekës. Në kohën kur paganët gjakatarë dhe kriminelë, të cilët me vite të tëra dhe me gjithfarë mënyrash, u ishin kundërvënë Islamit dhe Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ranë në duart e myslimanëve. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, përkundër të gjitha pritshmërive të miqve dhe armiqve, dha urdhër për faljen e tyre kolektive. Në këtë mënyrë, të gjitha krimet e tyre i la në harresë. Kjo sjellje e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u bë shembull për të gjithë. Shumë

njerëz filluan të përqafojnë Islamin duke vërtetuar thënien e All'llahut të Madhëruar: **"Dhe t'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e All'llahut grupegrupe."**.[1]

Për moralin, faljen, mëshirën, bujarinë, sakrificën dhe devotshmërinë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* janë përmendur shumë tregime në librat me komente dhe të historisë. Përmendja e të gjithë atyre është e pamundur për ne, por do të mjaftohemi vetëm me atë që thuhet në një hadith nga Imam Hysejni *(Paqja qoftë mbi të!)*: "E pyeta babain tim, (Imam Aliun) në lidhje me karakterin dhe virtytet e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si dhe për sjelljen e tij. Babai menjëherë m'u përgjigj: 'Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, me shoqëruesit e vet, ishte gjithnjë i heshtur, i buzëqeshur dhe i urtë. Ai asnjëherë nuk tregohej i ashpër, nuk ofendonte të tjerët, nuk ishte dhunues. Ai as që merrej me thashetheme, si dhe as nuk e lavdëronte veten. Askush nuk ndihej i zhgënjyer nga ai. Kushdo që vizitonte shtëpinë e tij, nuk kthehej pa shpresë. Tri gjëra ia kishte ndaluar vetes: polemikat gjatë bisedës, bisedën e tepruar dhe ndërhyrjen në punët e të tjerëve. Po ashtu, tri gjëra ia kishte lejuar vetes në lidhje me njerëzit: Nuk ofendonte asnjë njeri, nuk fajësonte asnjë njeri, si dhe nuk kërkonte të gjente gabime dhe të meta te të tjerët. Gjithnjë fliste dhe bisedonte, vetëm në lidhje me ato çështje, për të cilat shpresonte shpërblimin e All'llahut. Kur fliste ai, të gjithë binin në qetësi dhe dëgjonin me vëmendje. Kur e mbaronte bisedën, vinte radha e të pranishmëve për të folur dhe asnjëherë nuk ziheshin dhe polemizonin në prani të tij. Sa herë që një person, për shkak të mos

[1] Sure "Nasr", ajeti 2.

informimit dhe të mos dijes ndaj ndonjë çështjeje, fliste i zemëruar dhe kishte ndonjë kërkesë, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* duronte. Ai u thoshte shokëve të tij, se sa herë që të vëreni ndonjë njeri që ka një kërkesë, plotësojani atë dhe asnjëherë nuk e ndërpriste fjalën e askujt, derisa e përfundonte.'"[1]

Në qoftë se nuk do të ishte ky moral i përsosur profetik, këto veti dhe karakteristika fisnike të tij, populli i prapambetur dhe i paditur, ajo shoqëri e ashpër dhe e pandryshueshme, nuk do ta përqafonte Islamin dhe do të ishin ashtu siç thotë Kur'ani: **"Në sajë të mëshirës së All'llahut, u solle butësisht me ta** (o Muhammed)**. Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje All'llahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek All'llahu. Vërtet, All'llahu i do ata që mbështeten tek Ai."**.[2]

Sa mirë do të ishte, që kjo etikë e Islamit të ishte gjallë edhe sot në ditët tona dhe te çdo mysliman të ekzistonte një rreze nga morali dhe karakteri, nga natyra e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Ekzistojnë shumë transmetime islame, në lidhje me këtë çështje, qoftë në lidhje me personalitetin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, qoftë në lidhje me përgjegjësitë e të gjithë myslimanëve. Ne këtu do të mjaftohemi me citimin e disa prej tyre:

---

[1] "Meaniul Akhbar", f. 83. (me pak shkurtime)

[2] Sure "Ali Imran", ajeti 159.

1- Në një hadith nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: "*Unë jam dërguar për të plotësuar virtytet morale.*".[1]

Pra, njëri prej qëllimeve kryesore të dërgimit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, është plotësimi i virtyteve morale.

2- Në një hadith tjetër Profeti *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Besimtari, me anë të moralit të vet, arrin në gradën e atij, i cili natën e kalon zgjuar duke adhuruar All'llahun, kurse ditën agjëron.*".[2]

3- Në një haidth tjetër, po nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thuhet: "*Nuk ka gjë më të rëndë në peshoren e Ditës së Gjykimit, se sa morali i mirë.*".[3]

4- Po ashtu, sërish nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është transmetuar: "*Nga të gjithë ju, më i dashuri te All'llahu, është ai, morali i të cilit është më i mirë se i të tjerëve, është ai që është i përulur dhe i nënshtruar në sjellje, është ai që miqësohet me të tjerët dhe njerëzit miqësohen me të. Po ashtu, ndër ju, më të urryerit te All'llahu, janë thashethemexhinjtë, të cilët krijojnë ndarje mes vëllezërve, si dhe janë në kërkim të gabimeve te njerëzit e drejtë dhe të pafajshëm.*".[4]

[1] Sure "Ali Imran", ajeti 159.

[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 333.

[3] I njëjti burim

[4] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 333.

5- Në një hadith tjetër, transmetuar, gjithashtu, nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë: *"Devotshmëria dhe morali i mirë janë dy gjërat më të çmueshme, që e futin njeriun në Xhennet."*.[1]

6- Në një hadith nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet: *"Në mesin e besimtarëve, besimi më i përsosur i takon atij që ka moral më të lartë."*.[2]

Nga sa u tha më lart, arrijmë në përfundim, se morali i mirë është çelësi i Xhennetit, mjet i sigurimit të pëlqimit të All'llahut, shenjë e fuqisë së besimit dhe është i barasvlershëm me adhurimin gjatë natës dhe agjërimin gjatë ditës. Theksojmë sërish se ekzistojnë edhe shumë hadithe të tjera rreth kësaj teme.

[1] "Sefinetul Bihar", vëll. 1, f. 140. Po kjo përmbajtje, është përmendur edhe në "Uesailul Shiah", vëll. 8, f. 504; dhe në tefsirin e "Kurtubijjut", vëll. 10, f. 6707.

[2] "Uesailul Shiah", vëll. 8, Hadithi 21, f. 506; vëll. 12, f. 148, botim i shtëpisë botuese "Alel Bejt".

Ajetet 8 - 16

فَلَا تُطِعِ الْمُكَذِّبِينَ٨ وَدُّوا لَوْ تُدْهِنُ فَيُدْهِنُونَ٩ وَلَا تُطِعْ كُلَّ حَلَّافٍ مَهِينٍ١٠ هَمَّازٍ مَشَّاءٍ بِنَمِيمٍ١١ مَنَّاعٍ لِلْخَيْرِ مُعْتَدٍ أَثِيمٍ١٢ عُتُلٍّ بَعْدَ ذَلِكَ زَنِيمٍ١٣ أَنْ كَانَ ذَا مَالٍ وَبَنِينَ١٤ إِذَا تُتْلَى عَلَيْهِ آيَاتُنَا قَالَ أَسَاطِيرُ الْأَوَّلِينَ١٥ سَنَسِمُهُ عَلَى الْخُرْطُومِ١٦

"Andaj, ti mos i dëgjo jobesimtarët!"

"Ata dëshirojnë që ti të bësh lëshime, kështu që dhe ata të bëjnë lëshime."

"Por ti mos iu bind çdo betari të përçmuar."

"Shpifaraku, që përhap thashetheme."

"Penguesi veprash të mira, shkelësi dhe keqbërësi."

"Të ashprit që, veç kësaj, është edhe kopil."

"Vetëm se është i pasur dhe ka shumë djem."

"Kur i lexohen Shpalljet Tona, ai thotë: 'Këto janë vetëm përralla të të lashtëve!'"

"Ne do t'ia damkosim hundën!"

Komentimi

Ata që i mbartin këto cilësi, mos i merrni si shembull

Në ajetet e mësipërme u fol për moralin e lartë të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në këtë ajete do të diskutohet rreth moralit të armiqve të tij, në mënyrë që me anë të një krahasimi, të bëhet i qartë dallimi që ekzistonte mes këtyre të dyve.

Ajeti 8 thotë: **"Andaj, ti mos i dëgjo jobesimtarët!"**.

Ata janë njerëz të devijuar dhe mashtrues. Kanë shkelur të gjitha parimet e vërteta. Bindja e nënshtrimi ndaj njerëzve të tillë, madje qoftë edhe një fjalë e vetme, nuk do të japë rezultat tjetër, përveç mjerim dhe vuajtje.

Më pas tregon përpjekjen e tyre që ta bindnin Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për t'iu nënshtruar dhe t'iu bindur atyre. Ajeti 9 thotë: **"Ata dëshirojnë që ti të bësh lëshime, kështu që dhe ata të bëjnë lëshime."**. Të bësh lëshime , do të thotë të heqësh dorë prej një pjese nga urdhrat e Zotit për hir të tyre.

Komentuesit e Kur'anit, kanë deklaruar se këto ajete kanë zbritur kur paria e Mekës e ftoi Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të ndiqte fenë e të parëve të tyre, pra, politeizmin dhe adhurimin e idhujve. Zoti i Madhëruar

e ndaloi Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të afrohej me ta dhe t'u nënshtrohej atyre.[1]

Disa komentues të tjerë, kanë thënë se Velijd ibn El Mugijretu, i cili ishte një prej udhëheqësve të idhujtarëve, i ofroi një pronë të madhe Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe u betua se, nëse hiqte dorë nga feja islame, do t'ia dhuronte atij.[2]

Nga fryma e ajeteve dhe nga ajo që është shkruar në histori, arrijmë të kuptojmë se, kur politeistët panë ecurinë e shpejtë të përparimit të fesë islame, menduan ta detyronin Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të bënte lëshime, në një farë mënyre dhe kështu ta dobësonin atë dhe ta kufizonin përhapjen e Islamit. Ata provuan edhe t'i ofrojnë pasuri, siç kanë bërë me të gjithë udhëheqësit e padrejtë përgjatë gjithë historisë, të cilëve ndonjëherë u propozonin prona të mëdha, ndonjëherë femra të bukura, ndonjëherë pozita të larta, vetëm e vetëm që të hiqnin dorë nga feja e Islamit.

Kur'ani, shumë herë, e ka paralajmëruar Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që kurrë të mos tregojë as nënshtrimin më të vogël karshi këtyre propozimeve të devijuara dhe të mos bjerë pre e tyre. Të mos pajtohet asnjëherë me të devijuarit dhe mashtruesit, ashtu siç theksohet dhe në ajetin 49 të sures "El Maide": **"Edhe ti të gjykosh me atë që zbriti All'llahu, e mos ndiq dëshirat e tyre dhe ruaju**

[1] Tefsiri "Fakhru Razij", vëll. 30, f. 85, si dhe tefsiri "El Meragij", vëll. 29, f. 31
[2] Tefsiri "El Kurtubij", vëll. 10, f. 6710.

rrezikut të tyre, që të mos të shmangin nga një pjesë e asaj që ta zbriti All'llahu...”.

Fjala *“judinune”* rrjedh nga fjala *“mudahenetun”*, që në thelb është marrë nga fjala *“ed dehnu”*. Në këtë rast fjala përdoret për shfaqjen e butësisë. Në të shumtën e rasteve kjo përdoret për shfaqjen e butësisë e të prirjes qortuese siç është te dyfytërisa.

Kjo fjalë zakonisht përdoret në lidhje me lëshimet dhe lajkat e dënueshme dhe hipokrite.

Më pas, All'llahu i Madhëruar, edhe një herë tjetër e urdhëron Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që të mos u bindet dëshirave dhe kërkesave të tyre. Ndërkohë, përmend nëntë lloj cilësish të dënueshme, të cilat pengojnë bindjen dhe vartësinë ndaj dëshirave dhe kërkesave të politeistëve jobesimtarë. Ajeti 10 thotë: **“Por ti mos iu bind çdo betari të përçmuar.”**.

“Hal'laf” i thuhet atij personi që betohet shumë, betohet për çdo vepër, e vogël apo e madhe qoftë ajo. Zakonisht, persona të tillë nuk janë të drejtë në betimet e tyre.

Fjala *“mehijn”* rrjedh nga fjala *“mehanet”*. Ajo është përdorur me kuptimin e nënçmimit dhe të ultësisë. Disa komentues e kanë interpretuar edhe me kuptimin e njerëzve mendjelehtë, gënjeshtarë apo keqbërës.

Ajeti 11 thotë: **“Shpifaraku, që përhap thashetheme.”**.

Fjala *"hemmazun"* rrjedh nga fjala *"hemzun"* dhe do të thotë *"përgojim"*, *"dashakeqësi"*.

Sifjalia *"meshai binemim"* - **"shpifaraku, që përhap thashetheme"**, shënon personin që sillet rrotull njerëzve, me qëllim që t'i prishë dhe të krijojë armiqësi dhe hasmëri midis tyre. (Duhet të kemi parasysh se këto dy cilësi janë në formë sipërore, që tregon përpjekjen maksimale të tyre në lidhje me këto vepra të shëmtuara.)

Në cilësimin e pestë, të gjashtë dhe të shtatë ajeti 12 thotë: **"Penguesi veprash të mira, shkelësi dhe keqbërësi."**.

Penguesit dhe keqbërësit nuk bëjnë vepra të mira. Ata nuk sugjerojnë ndonjë rrugë të mirë, por përpiqen të jenë pengesë për ata që ecin në rrugë të mbarë. Pengojnë veprën e mirë dhe begatinë e të tjerëve. Përveç kësaj, ata janë njerëz që i nëpërkëmbin kufijtë e All'llahut dhe të drejtat që Ai i ka përcaktuar për çdo njeri. Përveç këtyre cilësive, ata janë të përlyer me çdo lloj mëkati. Mëkati është kthyer në pjesë të natyrës së tyre.

Në fund, ajeti 13 përmend cilësinë e tetë dhe të nëntë: **"Të ashpri që, veç kësaj, është edhe kopil."**.

Me fjalën *"utul'lin"* - **"shumë koprrac"**, siç thekson edhe Ragibi në librin e tij "Mufredat", quhet ai njeri që konsumon shumë ushqim dhe lakmon gjithçka, kurse të tjerët i pengon nga ajo.

Disa komentues të tjerë, fjalën *"utul'lun"* e kanë përdorur me kuptimin e njeriut arrogant, armiqësor dhe të ashpër, apo edhe për njeriun e paturpshëm dhe mendjemadh.

Shprehja *"zenijmun"* është cilësim për njeriun që nuk ka prejardhje të qartë dhe ia atribuojnë një fisi, të cilit ai nuk i përket. Kjo fjalë rrjedh nga fjala *"zenmetun"*, që do të thotë një pjesë nga veshi i deles, që është i varur, aq sa pothuajse nuk është pjesë e veshit, por është në varësi të tij.

Togfjalëshi *"ba'de dhalike"* - **"veç kësaj"**, është përdorur për të treguar se këto dy cilësi janë shumë të shëmtuara dhe të urryera. Me këtë mendim pajtohet një pjesë e komentuesve të Kur'anit. Me një fjalë, All'llahu i Madhëruar, në këtë ajet, ka bërë një përshkrim shumë të plotë për gënjeshtarët dhe cilësimet e liga, për moralin e tyre të degjeneruar, për të cilin, siç është folur këtu, ndoshta nuk përsëritet në asnjë vend tjetër të Kur'anit.

Në këtë mënyrë, tregohen cilësitë e kundërshtarëve të Islamit, të Kur'anit dhe të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ata, pra, kanë qenë njerëz gënjeshtarë, të ulët, denigrues, që merreshin me thashetheme, mëkatarë, të pacipë, të paskrupuj, të lindur jashtë kurore. Prej njerëzve të tillë mund të pritet çdo gjë, edhe kundërvënie ndaj një reformatori aq të madh.

Në ajetin tjetër tërheq vëmendjen fjalia: **"Vetëm se është i pasur dhe ka shumë djem."**.

Pa asnjë dyshim, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* asnjëherë nuk do të dorëzohej. Këto ajete miratojnë se te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* spikat metoda praktike dhe qasja ideologjike. Askush të mos ketë pritshmëri të tilla prej tij, qofshin përkrahës, qofshin kundërshtarë. Për pasojë,

fjalia e lartpërmendur është plotësuese e ajetit: **"Por ti mos iu bind çdo betari të përçmuar."**.

Disa komentues, kanë thënë se fjalia e cituar më sipër, është shpjegim për shkakun e formimit të këtyre cilësive dhe është një fjali interpretuese. Mburrja e krijuar nga pasuria dhe e përkrahësve të shumtë, i çon njerëzit drejt këtyre veseve të këqija, prandaj te shumica e pasanikëve dhe e njerëzve të pushtetshëm e pa besim vërehen të gjitha këto cilësime. Këtu duket qartë se toni i ajeteve është më i përshtatshëm me komentimin e parë. Ky përfundim është pranuar nga shumica e komentuesve të Kur'anit.

Më pas, ajeti tregon reagimin e personave, që i mbartin këto cilësi ndaj Shpalljeve hyjnore: **"Kur i lexohen Shpalljet tona, ai thotë: 'Këto janë vetëm përralla të të lashtëve!'"**.

Duke përdorur këtë justifikim të shëmtuar, mbajnë largësi nga Shpallja hyjnore, heqin dorë prej saj, si dhe i tërheqin të tjerët drejt vetes. Pikërisht, për këtë arsye nuk duhen pasuar e nuk duhen ndjekur persona të tillë. Ky plotësim dhe theksim i përsëritur, ndalon kategorikisht bindjen dhe nënshtrimin ndaj personave të tillë.

Ajeti i fundit që do të trajtojmë, diskuton për një prej dënimeve të këtyre personave: **"Ne do t'ia damkosim hundën!"**.

Kjo shprehje është tejet e qartë dhe elokuente, e cila tregon për poshtërimin që do t'u bëhet atyre, sepse, së pari, fjala *"khurtumun"* - *"hundë"*, që përdoret vetëm për derrin dhe elefantin, kur përdoret për njerëz, është tregues i një poshtërimi të madh.

Së dyti, hunda, në fjalorin arab, zakonisht shënjon dinjitetin dhe krenarinë dhe i përafrohet shprehjes në shqip: "Do t'ia thyej hundën!", që nënkupton humbjen e dinjitetit dhe të krenarisë.

Së treti, vendosja e shenjës, e cila është enkas për shtazët. Vendosja e shenjës në fytyrën e kafshëve, është e ndaluar në Islam. Kur kjo vendosje, e cila është e ndaluar edhe për kafshët, u vendoset njerëzve, tregon shkallën më të lartë të poshtërimit të tyre. Kur'ani thotë: "All'llahu i Madhëruar, persona të tillë, rebelë, mashtrues, egoistë, i poshtëron dhe i damkos në atë mënyrë që zëri i turpërimit dhe i çnderimit të tyre të dëgjohet gjithandej dhe të jetë mësim për të gjithë të tjerët.".

Historia e Islamit dëshmon se ky grup i kundërshtarëve kokëfortë, me përparimin e Islamit, u përçmuan dhe u nënçmuan në mënyrë të pashembullt, kurse turpërimi i tyre në Botën Tjetër do të jetë edhe më i madh.

Disa komentues të Kur'anit kanë pohuar se shumica e ajeteve të kësaj sureje i përkasin Velijd ibn Mugijretu, që ishte një nga udhëheqësit e njohur të idhujtarëve, por kjo nuk do të thotë se duhet kufizuar kuptimi i përgjithshëm dhe i gjerë i ajeteve.[1]

[1] Disa kanë pohuar se vendosja e shenjës në hundë, praktikisht, ndodhi në Luftën e Bedrit, kur disa udhëheqës jo myslimanë u goditën në hundë, në mënyrë të atillë që u ngeli shenjë. Nëse synohet personi në fjalë, pra, Velijd ibn Mugijretu, historia dëshmon se ai vdiq i poshtëruar, para Luftës së Bedrit. Ka mundësi që ajeti flet për një person tjetër, përpos tij.
Në fjalim e njohur të Imam Hysejnit *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet: "Unë jam fëmija i atij personi që i shtypi hundët e politeistëve, derisa ata pohuan: 'Nuk ka Zot

Dy hulumtime

1- Veset e liga

Ajetet e lartpërmendura, përveçse që përshkruajnë cilësitë e veseve të këqija të kundërshtarëve të rreptë të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, njëkohësisht janë edhe një shembull për t'i dalluar këto cilësime dhe tipare, të cilat e largojnë njeriun nga All'llahu dhe e hedhin në humnerën e fatkeqësisë dhe të mjerimit. Këta ajete kërkojnë t'i udhëzojnë myslimanët e drejtë, që të tregohen shumë të kujdesshëm ndaj politeistëve, të cilët nuk zotërojnë asnjë cilësi të besimtarëve të vërtetë, i udhëzojnë, që të mos përlyhen me to. Prandaj, në transmetimet islame, është folur dhe i është kushtuar rëndësi e veçantë kësaj çështjeje, siç tregohet më poshtë:

a- Në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"A t'ju vë në dijeni për personat më të ligj dhe mëkatarë?"*.

Ata thanë: "Po, o i Dërguar i All'llahut!".

---

tjetër përveç All'llahut!'." (ka për qëllim Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*. "Biharul Enuar", vëll. 45, f. 138.

Kjo shprehje, sidomos duke pasur parasysh ajetin në fjalë, ku Zoti thotë: **"Ne do t'ia damkosim hundën!"**, ka një domethënie interesante dhe është shenjë se vullneti i Zotit u realizua me dorën e robit të Tij të veçantë, Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Janë ata që merren me thashetheme, krijojnë ndasi mes njerëzve dhe ndaj njerëzve të drejtë dhe të pafajshëm sajojnë gënjeshtra dhe gabime."*.[1]

b- Veçanërisht Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në lidhje me këtë, ka rekomanduar qartë: *"Asnjë nga ju, (asnjë nga shokët e mi), të mos transmetojë ndonjë thënie, që ta bëjë që të dyshojë ndaj meje, sepse unë dëshiroj që të përballem me ju me zemër të pastër."*.[2]

c- Në fundin e një hadithi tjetër, po nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë: "Tri grupe njerëzish nuk do të hyjnë në Xhennet: *xhevadhi, xha'dheri dhe utlu zenijmi*." Transmetuesi thotë se e pyeta se kush është *xhevadhi*? Profeti tha: *"Ai që mbledh shumë për vete, kurse të tjerët i ndalon nga ajo."*.

U pyet se kush është *xhadheri*.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Njerëzit e ashpër dhe gjaknxehtë."*.

U pyet sërish: "Cilët janë *ulu zenijm*?".

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Njerëzit barkmëdhenj dhe të pamoralshëm, ata*

[1] "Usulul Kafij", vëll. 2, K. "El Nemimte", Hadithi 1.

[2] "Sunenu Ibn Davud" dhe "Sahih Tirmidhij", ngjashëm me transmetimin "Fi Dhilalil Kur'an", vëll. 8, f. 230.

që hanë shumë ushqim dhe e teprojnë në veshje. Ata janë të padrejtë dhe shtypës.".[1]

2- Lëshimi dhe nënshtrimi

Një prej dallimeve më të qarta mes udhëtarëve të Rrugës së Drejtë dhe aktorëve politikë, është ky: Grupi i dytë nuk është i qëndrueshëm mbi parime të veçanta, përkundrazi gjithnjë është i gatshëm t'u bëjë lajka të tjerëve dhe anasjelltas. Për shkak të interesave personale, heqin dorë prej parimeve të veta. Bindjet dhe parimet e tyre nuk janë ndonjë gjë e shtrenjtë për ta. Ata gjithnjë bëjnë marrëveshje mbi këto parime. Në realitet, ky është shembull i ajetit të lartpërmendur, se ata kanë dëshirë, që ti t'u bësh lajka, që edhe ata të të bëjnë lajka.

Grupi i parë, asnjëherë, nuk bën lëshime, asnjëherë, nuk heq dorë prej parimeve të veta të shenjta, si dhe nuk bën ndonjë marrëveshje mbi parimet. Transformimet dhe marrëveshjet e tilla politike nuk kanë asnjë vlerë për ta. Këto janë disa nga treguesit më të spikatur të grupit të parë, të cilat, njëherësh i dallojnë qartë nga grupi i mashtruesve, grupi i dytë.

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 394.

Ajetet 17 - 25

إِنَّا بَلَوْنَاهُمْ كَمَا بَلَوْنَا أَصْحَابَ الْجَنَّةِ إِذْ أَقْسَمُوا لَيَصْرِمُنَّهَا
مُصْبِحِينَ١٧ وَلَا يَسْتَثْنُونَ١٨ فَطَافَ عَلَيْهَا طَائِفٌ مِنْ رَبِّكَ وَهُمْ
نَائِمُونَ١٩ فَأَصْبَحَتْ كَالصَّرِيمِ٢٠ فَتَنَادَوْا مُصْبِحِينَ٢١ أَنِ اغْدُوا عَلَى
حَرْثِكُمْ إِنْ كُنْتُمْ صَارِمِينَ٢٢ فَانْطَلَقُوا وَهُمْ يَتَخَافَتُونَ٢٣ أَنْ لَا
يَدْخُلَنَّهَا الْيَوْمَ عَلَيْكُمْ مِسْكِينٌ٢٤ وَغَدَوْا عَلَى حَرْدٍ قَادِرِينَ٢٥

“Ne i kemi vënë në provë ata (banorët e Mekës)**, ashtu siç i sprovuam të zotët e kopshtit, të cilët ishin betuar se në mëngjes do t’i vilnin frutat.”**

“E nuk patën thënë ‘Në dashtë Zoti!’.”

“Kështu, kopshtin e goditi një fatkeqësi nga Zoti yt, ndërkohë që ata po flinin.”

“Dhe gdhiu si i kositur.”

“Në agim, ata thirrën njëri-tjetrin:”

“Nxitoni herët në kopshtin tuaj, nëse doni t’i vilni frutat!”

“Dhe u nisën duke pëshpëritur:”

"Të mos lejojmë asnjë të vobektë që të hyjë në kopshtin tonë!"

"Ata u nisën herët, të vendosur në atë që thanë."

Komentimi

Tregimi i pronarëve të kopshtit të gjelbëruar

Në përputhje me tematikën që u diskutua në ajetet më lart, në lidhje me pasanikët, egoistët dhe arrogantët, të cilët, për shkak të pasurisë së madhe dhe fëmijëve të shumtë, heqin dorë nga çdo gjë dhe i nënçmojnë begatitë hyjnore, në këto ajete përmendet një tregim, që të bën të reflektosh rreth kësaj çështjeje. Në këtë tregim flitet për disa të pasur, që zotëronin shumë kopshte të gjelbëruara, por ishin koprracë të mëdhenj. Për shkak të koprracisë dhe hutimit të tyre pas pasurisë, ata i humbën të gjitha. Ky tregim ishte shumë i njohur në ato kohë, prandaj edhe është betuar për të.

Ajeti 17 thotë: **"Ne i kemi vënë në provë ata** (banorët e Mekës)**, ashtu siç i sprovuam të zotët e kopshtit, të cilët ishin betuar se në mëngjes do t'i vilnin frutat."**.

Vallë, ku ka qenë kopshti? Në tokat e Jemenit? Në afërsi të qytetit të madh, Sena? Në tokën Habeshe? Apo në mes Beni Israilit, në tokën e quajtur Sham, ose në Taif? Kjo është çështje e diskutueshme, por i njohur është interpretimi i parë, pra, në Jemen.

Ngjarja është e tillë: Ky kopsht ishte në pronësi të një besimtari plak, i cili, kur e vilte, mbante për vete aq sa kishte nevojë. Pjesën tjetër ua jepte të varfërve dhe të vobektëve. Kur plaku u largua nga kjo botë, fëmijët e tij thanë: "Është më e pëlqyeshme që produktet e këtij kopshti t'i mbajmë për vete, sepse jemi familje e madhe dhe kemi shumë fëmijë. Nuk mund të veprojmë, siç ka vepruar babai ynë!".

Kështu, hoqën dorë nga ndihma që u jepnin të vobektëve dhe të varfërve, siç kishte bërë babai i tyre për çdo vit. Prandaj fati i tyre u përcaktua ashtu siç e lexojmë në këtë ajet: **"Ne i kemi vënë në provë ata** (banorët e Mekës)**, ashtu siç i sprovuam të zotët e kopshtit, të cilët ishin betuar se në mëngjes do t'i vilnin frutat."**.

Sifjalia: **"e nuk patën thënë 'Në dashtë Zoti!'"**, tregon se veprimi i tyre nuk ishte për shkak të nevojës së tyre, por ishte për shkak të koprracisë dhe besimit të dobët të tyre. Njeriu, sado që nevojtar të jetë, një pjesë të produktit të kopshtit të vet, mund t'ua japë të varfëve dhe të vobektëve.

Disa komentues të tjerë, kanë thënë se sifjalia: **'Në dashtë Zoti!'**, tregon se ata ishin aq mendjemëdhenj dhe arrogantë, saqë mendonin se punët e tyre do të venin mirë, pa qenë nevoja ta thonë atë fjali. Komentimi i parë është më i saktë.[1]

[1] Përpos përputhjes dhe ngjashmërisë së veçantë që ka kuptimi i parë, me thelbin e ngjarjes, nëse do të merrej parasysh kuptimi i dytë, në vend të sifjalisë: **"Nuk thanë: 'Në dashtë Zoti!'"**, duhet të ishte: "Mos dashtë Zoti!".

Në vazhdimësi të këtij tregimi, ajeti 19 shton: **"Kështu, kopshtin e goditi një fatkeqësi nga Zoti yt, ndërkohë që ata po flinin."**.

Kopshtin e përfshiu një zjarr i madh dhe i fuqishëm, i cili shkatërroi gjithçka. Kopshti thuajse "**gdhiu si i kositur"** .

Fjala *"taifun"* rrjedh nga fjala *"teuaf"*, nënkupton personin që rrotullohet rreth një gjëje, por nganjëherë tregon edhe për ndonjë fatkeqësi dhe bela që ndodh gjatë natës. Këtu është përdorur me këtë kuptim.

Fjala *"sarijmun"* rrjedh nga fjala *"sarm"* dhe është përdorur me kuptimin e *"ndërprerjes"*. Këtu nënkupton ndërprerjen e natës së errët, nënkupton pemën pa fruta, ose hirin e zi, për arsye se me lindjen e diellit, ndërpritet nata, ashtu siç ndodh dhe me ditën, e cila përfundon me perëndimin e diellit. Prandaj ndonjëherë ditën dhe natën i kanë quajtur *"sariman"*.

Fabula e tregimit qartëson fatkeqësinë e madhe qiellore, e cila goditi kopshtin dhe shkatërroi gjithçka. Çdo gjë u shndërrua në hi, siç ndodh kudo ku bie rrufeja.

Pronarët e kopshtit thërrisnin njëri-tjetrin për të shkuar të vjelin frytet e pemëve në kopsht: **"Në agim, ata thirrën njëri-tjetrin: 'Nxitoni herët në kopshtin tuaj, nëse doni t'i vilni frutat!'"**.

Fjala *"ugduu"* rrjedh nga fjala *"gadauetun"* dhe nënkupton pjesën e parë të ditës. Prandaj ushqimin që e hanë në pjesën e parë të ditës, e quajnë "mëngjes" , *(gada)*. Në ditët tona, arabët, në shprehjet e përditshme, fjalën *"gada"* e përdorin për drekën.

Bazuar në premisat e lartpërmendura: **“Dhe u nisën duke pëshpëritur: ‘Të mos lejojmë asnjë të vobekët që të hyjë në kopshtin tonë!’”**.

Flisnin me njëri–tjetrin, me zë aq të ulët, saqë askush nuk i dëgjonte bisedat e tyre. Këtë e bënin që ndonjë i varfër dhe i vobektë të mos dëgjojë dhe më pas të shkojë të vjelë një pjesë nga prodhimet në kopsht për veten ose familjen e tij.

Kështu kuptohet që, për shkak të veprave të mira të babait të tyre, një grup prej të vobektëve dhe të varfërve, për gjatë gjithë vitit prisnin, që, kur të arrinte koha e vjeljes së pemëve, të përfitonin diçka edhe ata. Prandaj këta pronarë koprracë dhe të pashpirt flisnin aq qetë me njëri–tjetrin, në mënyrë që mos i dëgjonin të varfrit, të cilët mezi e kishin pritur atë ditë.

Kështu, të vendosur në qëllimin e tyre, ata u nisën drejt kopshtit: **“Ata u nisën herët, të vendosur në atë që thanë.”**.

Fjala *“herdun”* është përdorur me kuptimin e parandalimit, të shoqëruar me zemërim dhe ashpërsi. Po, ata ishin të zemëruar nga kërkesa dhe shpresa e të vobektëve, prandaj kishin vendosur t’i ndalonin ata. Tani të shohim rezultatin e punës së tyre.

Ajetet 26 – 33

فَلَمَّا رَأَوْهَا قَالُوا إِنَّا لَضَالُّونَ٢٦ بَلْ نَحْنُ مَحْرُومُونَ٢٧ قَالَ أَوْسَطُهُمْ أَلَمْ أَقُلْ لَكُمْ لَوْلَا تُسَبِّحُونَ٢٨ قَالُوا سُبْحَانَ رَبِّنَا إِنَّا كُنَّا ظَالِمِينَ٢٩ فَأَقْبَلَ بَعْضُهُمْ عَلَى بَعْضٍ يَتَلَاوَمُونَ٣٠ قَالُوا يَا وَيْلَنَا إِنَّا كُنَّا طَاغِينَ٣١ عَسَى رَبُّنَا أَنْ يُبْدِلَنَا خَيْرًا مِنْهَا إِنَّا إِلَى رَبِّنَا رَاغِبُونَ٣٢ كَذَلِكَ الْعَذَابُ وَلَعَذَابُ الْآخِرَةِ أَكْبَرُ لَوْ كَانُوا يَعْلَمُونَ٣٣

"Por, kur e panë kopshtin, ata thanë: 'Ne qenkemi vërtet të humbur.'"

"Madje, qenkemi të privuar (nga frutat e kopshtit)**."**

"Më i arsyeshmi ndër ta tha: 'A nuk ju thashë unë se duhet ta lartësoni All'llahun?!'"

"Lavdëruar qoftë Zoti ynë! - thanë - Ne paskemi qenë vërtet të padrejtë!"

"Atëherë filluan të qortojnë njëri-tjetrin."

"Ah, të mjerët ne! - thanë ata - Paskemi qenë vërtet arrogantë!"

"Zoti ynë mund të na japë një kopsht më të mirë, po të kthehemi të penduar tek Ai!"

"I tillë ka qenë dënimi i tyre. Ndërsa dënimi në Jetën Tjetër, është më i madh, veç sikur ta dinin!"

Komentimi

Përfundimi i dhimbshëm i pronarëve të kopshtit të gjelbër

Këto ajete janë vazhdim i ndodhive të pronarëve të kopshtit, të treguara në ajetet e kaluara. Pronarët e kopshtit shpresonin të korrnin prodhim të bollshëm. Ata vendosën t'i mblidhnin frutat, pa i vënë re të varfrit, ta mbajnë të gjithë prodhimin për veten e tyre dhe të mos lejojnë që asnjë i varfër të përfitonte nga begatitë që All'llahu u kishte dhuruar. Prandaj u nisën herët në mëngjes. Ata nuk e dinin se natën, një rrufe e fortë, e kishte shkatërruar kopshtin. Kur'ani thotë: **"Por, kur e panë kopshtin, ata thanë: 'Ne qenkemi vërtet të humbur.'"**.

Ka mundësi që fjala *"dál'lune"* të nënkuptojë humbjen e rrugës për në kopsht, ashtu siç pohuam më lart. Por disa komentues, mendojnë se mund të jetë përdorur edhe me kuptimin e devijimit nga Rruga e Drejtë. Kuptimi i parë është më i përshtatshëm.

Më pas vazhduan: **"Madje, qenkemi të privuar** (nga frutat e kopshtit)**."**.

Ne deshëm që të varfrit dhe të vobektit t'i privojmë nga (këto begati), por ne qenkemi dëmtuar vetë dhe nuk arritëm as ndonjë përfitim material e as përfitim shpirtëror, që arrihen përmes dhënies në Rrugën e All'llahut.

"Më i arsyeshmi ndër ta tha: A nuk ju thashë unë se duhet ta lartësoni All'llahun?!".

A nuk ju thashë të kujtoni All'llahun, me Madhërinë e Tij, të kini frikë nga kundërshtimi i Tij, ta falënderoni Atë për begatitë që ju ka dhënë dhe të ndani pasurinë tuaj me të varfrit dhe të vobektit?! Por ju nuk dëgjuat dhe u katandisët keq!

Prej këtij ajeti arrijmë në përfundimin se midis tyre ishte një njeri besimtar, që i këshillonte të mos ishin koprracë e dorështrënguar. Por ai përfaqësonte pakicën, prandaj askush nuk i kushtonte vëmendje, deri pas kësaj ngjarjeje, kur goja e tij u lëshua, logjika e tij fitoi forcë më të madhe dhe kështu ata e panë veten nën presionin e kritikave dhe të qortimeve të tij.

Fjala *"uesatun"* - *"i mesmi"*, në këtë ajet, është përdorur me kuptimin e njeriut që, nga pikëpamja e intelektit, mendjes dhe diturisë, e ka arritur pjekurinë. Disa komentues të tjerë, këtë fjalë e përdorin me kuptimin e personit që është në një moshë të mesme. Por ky kuptim nuk qëndron, sepse nuk vërehet asnjë lidhje midis moshës dhe deklarimit të një thënieje të tillë.

Kjo thënie, thuhet nga njerëz inteligjentë dhe mendjemprehtë.

Sifjalia *"leu la tusebihun"* - **"përse nuk e lartësoni All'llahun tuaj"**, tregon se burimi i të gjitha veprave të mira, është besimi dhe njohja e Zotit si dhe madhërimi i Tij.

Disa komentues, fjalën *"madhërimin"* e kanë interpretuar si falënderimi ndaj begatisë, që duhet të shoqërohet me bamirësinë ndaj të vobektëve. Këto dy interpretime nuk e kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe kuptimi i ajetit i përfshin të dy.

Kështu ata, për një moment, u ndërgjegjësuan, pranuan gabimin e tyre dhe thanë: **"Lavdëruar qoftë Zoti ynë! - thanë - Ne paskemi qenë vërtet të padrejtë!".**

Lartësimi i tyre para pohimit të mëkatit, ka mundësi të jetë bërë sepse dëshironin që All'llahun ta konsideronin të pastër nga çdo lloj dhune dhe shtypjeje që mund të kishte lidhje me këtë fatkeqësi të madhe që u ndodhi në kopshtin e tyre, prandaj pohojnë: "O Zot! Ishim ne ata që i bëmë vetes sonë dhe të tjerëve dhunë dhe e meritojmë një dënim të tillë të dhimbshëm, kurse vepra Juaj ishte e drejtë dhe me vend.".

Edhe në disa ajete të tjera në Kur'an, para pohimit të dhunës dhe të shtypjes, vërehet një madhërim i tillë, ashtu siç e lexojmë dhe në tregimin e Profetit Junus *(Paqja qoftë mbi të!)*, ku thuhet: **"Përkujto edhe atë të peshkut** (Junusin)**, kur doli i hidhëruar** (prej popullit) **dhe mendoi se nuk do t'i vijë më puna ngushtë, po në errësira ai tha: 'Nuk ka Zot përveç Teje. Ti je i pastër, nuk ke të meta. Unë i bëra padrejtësi vetes!'"**.[1]

Por nuk përfundoi këtu çështja. **"Atëherë filluan të qortojnë njëri-tjetrin."**.

Ka mundësi që secili prej tyre, gjatë pranimit të gabimit, fajin kryesor t'ia linte tjetrit dhe ta qortonte ashpër atë, duke thënë: "Ti

[1] Sure "El Enbija", ajeti 87.

je shkaku kryesor i fatkeqësisë sonë. Në të kundërt, nuk do të ishim kaq shumë larg Zotit dhe Rrugës së Drejtë!".

Kështu është fati i të gjithë shtypësve dhe zullumqarëve, të cilët janë të përfshirë në kthetrat e dënimit hyjnor, sepse krahas pohimit të mëkatit, secili prej tyre përpiqet ta konsiderojë tjetrin si faktorin kryesor të fatkeqësisë së vet. Kjo ndoshta mund të jetë për këtë shkak se në të tilla raste, zakonisht, njëri propozon, tjetri e miraton atë, i treti e merr përgjegjësinë e zbatimit të saj, kurse i katërti, me heshtjen e tij, shfaq pëlqimin e vet. Por është më se e qartë që të gjithë janë bashkëpunëtorë të krimit dhe të përfshirë në mëkat.

Pasi u vunë në dijeni për fatkeqësinë që u kishte kapluar, ngritën zërin dhe thanë: **"Ah, të mjerët ne! - thanë ata - Paskemi qenë vërtet arrogantë!"**.

Ata, në frazën e parë, pranuan "dhunën", kurse këtu pohojnë "padrejtësinë" e vet. Në realitet, "padrejtësia" është një fazë më lart se "dhuna", sepse "i padrejti" ka gjasa të pranojë ligjin, por e shkel atë nën ndikimin e epsheve dhe dëshirave vetjake, kurse rebeli, despoti as që e pranon ligjin.

Ekziston edhe mundësia që "dhuna" të jetë tregues për padrejtësinë ndaj vetes së vet, kurse "padrejtësia" të jetë tregues për "shkeljen e të drejtave të të tjerëve".

Duhet të kemi parasysh se arabët, kur përballen me ndonjë vështirësi, ose kur dëshirojnë të shprehin urrejtjen apo zemërimin ndaj ndonjë gjëje, disa herë thonë *"uis"*, herë të tjera thonë *"uih"* dhe ndonjëherë *"uil"*. Rasti i parë ka të bëjë me fatkeqësi të lehtë, rasti i dytë me fatkeqësi të rëndë, kurse rasti i tretë me fatkeqësinë

më të rëndë. Ky komentim përcjell mesazhin që pronarët e kopshtit i meritonin qortimet më të rënda.

Në fund, pas ndërgjegjësimit dhe pohimit, pas mëkatit dhe kthimit te Zoti, ata u kthyen në drejtim të Tij, duke thënë: **"Zoti ynë mund të na japë një kopsht më të mirë, po të kthehemi të penduar tek Ai!"**.

Vallë, me të vërtetë, ky grup u pendua, vërtet rishikuan planet e tyre dhe morën vendim të prerë, që në të ardhmen të përfshihen nën mëshirën e All'llahut?! Vërtet, a do ta falënderonin Atë? Apo do të jenë si shumica e shtypësve, të cilët, kur i kaplon ndonjë stuhi e fuqishme, për një periudhë të shkurtër vetëdijesohen, por, sapo përfundon stuhia, vazhdojnë përsëri me programe e tyre.

Për këtë çështje, mes komentuesve të Kur'anit, ka diskutime. Nga toni i ajetit në vazhdim, përftohet se pendimi i tyre nuk u pranua, sepse kushti i tyre nuk ishte i përbashkët. Por në disa transmetime, lexojmë se pendimi i tyre ishte i sinqertë dhe me nijet të pastër. All'llahu u dhuroi atyre një kopsht më të mirë, plot me hardhi të frytshme rrushi.

Në ajetin e fundit të diskutimit tonë, si një përfundim i përgjithshëm dhe mësim për të gjithë, theksohet: **"I tillë ka qenë dënimi i tyre. Ndërsa dënimi në Jetën Tjetër, është më i madh, veç sikur ta dinin!"**.

Edhe ju, në qoftë se tregoheni arrogantë dhe të hutuar për hir të pronës, pasurisë dhe mundësive materiale, në qoftë se ju mposht fryma e monopolit, çdo gjë ta dëshironi vetëm për veten

tuaj dhe të privoni të varfrit, nuk do të kishit ndonjë fat më të mirë se ky! Një ditë kopshtin tuaj do ta godasë një rrufe e fortë. Në ditët tona mund t'ju ndodhin fatkeqësi të tjera, luftëra shkatërrimtare globale dhe rajonale, të cilat shkatërrojnë çdo begati.

Hulumtim

1- "Krijimi i monopolit", sprovë e madhe e pasanikëve

Njeriu, dashje pa dashje, është i dhënë pas pasurisë së kësaj bote. Kjo dëshirë, kur nuk i kalon caqet e normales, nuk është e dënueshme. E rëndësishme është që edhe të varfrit t'i bëjmë pjesëtarë të kësaj pasurie dhe prone. Të mos mjaftohemi vetëm me zbatimin e detyrave të detyrueshme hyjnore, por të tregohemi të kujdesshëm edhe ndaj gjërave të pëlqyeshme, siç është bamirësia për hir të All'llahut.

Veçanërisht, në lidhje me kopshtin dhe bujqësinë, në hadithet islame është urdhëruar që dhe të varfrit t'i bëjmë pjesë të kësaj pasurie dhe begatie. Kjo sqarohet nga ajeti në fjalë, i cili thotë: **"Është Ai që ka krijuar kopshte vreshtash të larta dhe të shtruara, hurma dhe bimë, me shije të ndryshme, ullinj e shegë, të ngjashme dhe të ndryshme. Hani frutat e tyre kurdo që të prodhojnë dhe jepni atë që është detyrë në ditën e vjeljes së tyre!**

Por mos e teproni, se All'llahu nuk i do ata që e teprojnë!".[1] Të japësh atë pjesë që është obligim, është një e drejtë, përveç të drejtës së zekatit. Pra, kur vjelim, apo korrim produktet, duhet t'u japim nevojtarëve një pjesë të saj.[2]

Ndodh që nga dashuria për pronën, kalohet në ekstrem dhe devijim, pra, e tejkalohet norma. Në këtë rast, veprimi merr formën e "krijimit të monopolit", pra, pa pasur nevojë për ndonjë gjë, dëshiron që të tjerët të jenë të privuar nga ajo gjë.

Thënë ndryshe, ai ndien kënaqësi nga përvetësimi i begative të All'llahut dhe kjo është një fatkeqësi e madhe, e cila vërehet edhe në ditët tona. Ka shumë shembuj të tillë të ngjashëm në shoqëritë njerëzore. Këtë mund ta konsiderojmë si një sëmundje të rrezikshme.

Tregimi i ngjarjes me pronarët e kopshtit, që u përmend në ajetet më lart, është një vizatim i qartë i shpirtit të monopolit të një grupi pasanikësh, të cilët i japin dorën njëri-tjetrit dhe organizojnë planin se si t'i privojnë të varfrit nga kjo begati hyjnore. Por ndodh shumë shpesh, që brenga dhe hidhërimi i këtyre të provuarve, shndërrohet në një rrufe të fuqishme dhe ua djeg të korrat e jetesës këtyre pasanikëve monopolistë. Ndodh shpesh që këto rrufe shfaqen në formën e revolucioneve dhe shohin me sytë e tyre atë që nuk e mendonin. Hidhërimi dhe brenga e tyre ngrihet në qiell. Atëherë ata i drejtohen derës së pendimit dhe të kompensimit të

[1] Sure "El En'am", ajeti 141.

[2] Për më shumë, referojuni hadithеve që trajtojnë këtë çështje, në vëll. 6, "Uesailu Shiah", kreu "Zekatul Gelat" , kreu 13 dhe veprës "Sunenu Bejhakij", vëll. 4, f. 133.

gabimeve të kaluara. Por tani është tepër vonë dhe plani i tyre ka dështuar.

2- Marrëdhënia mes mëkatit dhe ndërprerjes së begatisë

Nga ngjarja e lartpërmendur, arrijmë në përfundim, se mes mëkatit dhe ndërprerjes së begatisë, ekziston një lidhje e afërt. Për këtë, në një hadith nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Ndonjëherë njeriu, pasi ka kryer një mëkat, i ndërpritet begatia."*. Më pas Imami këndoi ajetet e lartpërmendura.

Pronarët e kopshtit u betuan se në mëngjes herët të vilnin kopshtin dhe të mos lejonin asnjë të varfër të merrte pjesë në vjeljen e kopshtit. Por atë natë, kur ata ishin në gjumë, nga ana e All'llahut, u dërgua një rrufe e fuqishme dhe i gjithë kopshti i tyre u shndërrua në hi dhe u asgjësua tërësisht.[1]

Ibn Abasi, në një transmetim, ka thënë: *"Marrëdhënia që ekziston mes 'mëkatit' dhe 'ndërprerjes së begatisë', është më e qartë se dielli, ashtu siç e ka deklaruar dhe Zoti në këtë sure."*.[2]

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, hadithi 44, f. 395.

[2] Tefsiri "El Mizan", vëll. 20, f. 38.

Ajetet 34 - 41

إِنَّ لِلْمُتَّقِينَ عِنْدَ رَبِّهِمْ جَنَّاتِ النَّعِيمِ٣٤ أَفَنَجْعَلُ الْمُسْلِمِينَ كَالْمُجْرِمِينَ٣٥ مَا لَكُمْ كَيْفَ تَحْكُمُونَ٣٦ أَمْ لَكُمْ كِتَابٌ فِيهِ تَدْرُسُونَ٣٧ إِنَّ لَكُمْ فِيهِ لَمَا تَخَيَّرُونَ٣٨ أَمْ لَكُمْ أَيْمَانٌ عَلَيْنَا بَالِغَةٌ إِلَى يَوْمِ الْقِيَامَةِ إِنَّ لَكُمْ لَمَا تَحْكُمُونَ٣٩ سَلْهُمْ أَيُّهُمْ بِذَلِكَ زَعِيمٌ٤٠ أَمْ لَهُمْ شُرَكَاءُ فَلْيَأْتُوا بِشُرَكَائِهِمْ إِنْ كَانُوا صَادِقِينَ٤١

"Për ata që ruhen (nga gjynahet)**, tek All'llahu do të ketë kopshte të kënaqësive."**

"Vallë, a t'i trajtojmë ata që Na nënshtrohen njësoj me keqbërësit?!"

"Çfarë keni ju (jobesimtarë)**? Si po gjykoni kështu?!"**

"A keni ndonjë libër, që ju premton."

"Se do të keni çfarëdo, që të zgjidhni?"

"Apo kemi bërë me ju ndonjë besëlidhje të vlefshme deri në Ditën e Kiametit dhe, e cila ju siguron, se do ta keni atë që keni urdhëruar?"

"Pyeti ata se kush i garanton për këtë."

"Ose, mos kanë ata bashkëpunëtorë? Atëherë le t'i sjellin bashkëpunëtorët e tyre, nëse ajo që thonë është e vërtetë."

Komentimi

Përgjigje e plotë

Metodika e komentimeve kur'anore është e tillë, që sjell historinë e njerëzve keqbërës dhe mirëbërës, në përqasje mes tyre, në mënyrë që të njihen sa më mirë cilësitë pozitive dhe negative që mbartin dhe përcjellin. Kjo metodikë ndikon shumë në edukim. Këtë metodë e pamë edhe te tregimi për pronarët e kopshtit. Pasi u tregua historia e dhimbshme e pronarëve të kopshtit, në ajetet e kaluara, vijohet me cilësimin e njerëzve të devotshëm. Konkretisht, ajeti thotë: **"Për ata që ruhen** (nga gjynahet)**, tek All'llahu do të ketë kopshte të kënaqësive."**.

Kopshte të parajsës, ku gjendet çdo begati. Ato begati njeriu nuk i ka përfytyruar ndonjëherë. Një pjesë e idhujtarëve dhe pasanikëve arrogantë, pretendonin se ashtu siç kishin pasur gjithçka të mirë në këtë botë, edhe në Botën Tjetër do të ishin shumë mirë. All'llahu i Madhëruar, në ajetin e radhës, i qorton ashpër ata, madje i gjykon duke thënë: **"Vallë, a t'i trajtojmë ata që Na nënshtrohen njësoj me keqbërësit?! Çfarë keni ju** (jobesimtarë)**? Si po gjykoni kështu?!"**.

A beson ndonjë njeri i mençur, që fati i të drejtit dhe i shtypësit, fati i të bindurit dhe i kriminelit, fati i bamirësit dhe i monopolistit do të jenë të njëjtë? Veçanërisht kur çështja ka lidhje me All'llahun i Cili është i Urtë dhe Llogaritësi më i mirë.

Edhe në suren "Fusilet", në ajetin 50 të saj, për të tillë njerëz, thuhet: **"Nëse pas fatkeqësisë, Ne i japim atij që të shijojë nga mirësitë Tona, ai me siguri, do të thotë: 'Këtë e meritoj! Unë nuk besoj se do të vijë Ora** (e Kiametit)**, por, edhe nëse kthehem te Zoti im, sigurisht që Ai do të më japë shpërblimin më të mirë.' Në të vërtetë, Ne do t'i njoftojmë mohuesit për atë që kanë bërë dhe do t'i bëjmë të shijojnë një dënim të ashpër."**.

Po, ky grup njerëzish arrogantë dhe të vetëkënaqur me botën, edhe Ahiretin e konsiderojnë si pronë të tyre.

Më pas, ajeti thotë se, nëse mendja dhe inteligjenca nuk i ka çuar në një gjykim të tillë, a keni argumente të transmetueshme, që bazohen në autoritetin hyjnor, për pretendimin tuaj? **"A keni ndonjë libër, që ju premton, se do të keni çfarëdo, që të zgjidhni?!"**.

Ju prisni, që kriminelë si ju, të jenë në gradën e myslimanëve?! Kjo është një gjë që as mendja nuk e miraton e as nuk është përmendur në Librin e All'llahut.

Në ajetin vijues, All'llahu thotë: **"Apo kemi bërë me ju ndonjë besëlidhje të vlefshme deri në Ditën e Kiametit dhe, e cila ju siguron, se do ta keni atë që keni urdhëruar?"**.

Kush mund të pretendojë se ka marrë premtim prej All'llahut, që t'u dorëzohet dëshirave të Tij, si dhe t'ju japë çdo

pozitë pa asnjë llogari, saqë kriminelët të barazohen me besimtarët?

Pyetjet në vijim ua mbyllin çdo rrugëdalje: **"Pyeti ata se kush i garanton për këtë."**.

Bëhet pyetja e fundit: **"Ose, mos kanë ata bashkëpunëtorë? Atëherë le t'i sjellin bashkëpunëtorët e tyre, nëse ajo që thonë është e vërtetë."**.

A kanë ata ndonjë argument, me të cilin të vërtetojnë se këta idhuj, këto objekte pa frymë dhe të pandërgjegjshme, të jenë ortakë me All'llahun dhe ndërmjetësues pranë tij?!

Disa komentues fjalën *"shureka"*, e kanë marrë në kuptimin *"shuheda"*, pra, të dëshmitarëve.

Në përmbledhje të këtyre mjeteve të lartpërmendura, si përfundim, mund të themi se ata, për të vërtetuar pretendimin e tyre, se janë të barabartë me besimtarët, madje edhe më të lart se ata, duhet të kenë, në favor të tyre, ose argumente racionale, ose libër nga librat qiellorë, ose premtim apo kontratë me All'llahun, ose ndërmjetësim të ndërmjetësuesve apo dëshmi të dëshmitarëve. Meqenëse nuk kanë asnjë nga këto, pretendimi i përmendur, është plotësisht i pa bazë dhe i pa vlerë.

Ajetet 42 – 45

يَوْمَ يُكْشَفُ عَنْ سَاقٍ وَيُدْعَوْنَ إِلَى السُّجُودِ فَلَا يَسْتَطِيعُونَ٤٢ خَاشِعَةً أَبْصَارُهُمْ تَرْهَقُهُمْ ذِلَّةٌ وَقَدْ كَانُوا يُدْعَوْنَ إِلَى السُّجُودِ وَهُمْ سَالِمُونَ٤٣ فَذَرْنِي وَمَنْ يُكَذِّبُ بِهَذَا الْحَدِيثِ سَنَسْتَدْرِجُهُمْ مِنْ حَيْثُ لَا يَعْلَمُونَ٤٤ وَأُمْلِي لَهُمْ إِنَّ كَيْدِي مَتِينٌ٤٥

"Ditën (e Kiametit)**, kur të zbulohen shumë ngjarje të frikshme, ata do të thirren që të përulen në sexhde, por nuk do të munden!"**

"Të ulura do të jenë shikimet e tyre dhe do t'i mbulojë poshtërimi, sepse kanë qenë të ftuar të përuleshin në sexhde, sa qenë shëndoshë (dhe nuk kanë pranuar)**."**

"Prandaj, më lër Mua me ata, që e mohojnë këtë Fjalë (Kur'anin)**. Ne do t'i çojmë ata hap pas hapi drejt rrënimit të tyre, me mënyra që ata nuk i kuptojnë."**

"Dhe do t'u japim atyre afat; vërtet që kurthi Im është i fortë!"

Komentimi

Ata duan të bien në sexhde, por nuk munden

Në vazhdim të ajeteve të kaluara, ku idhujtarët dhe kriminelët përballeshin me një inspektim të pamëshirshëm, këtu ilustrohet një episod nga fati i tyre në Ditën e Kiametit, që të bëhet e qartë se deri në ç'masë, ky grup egocentrik dhe i zhurmshëm, do të jetë i nënçmuar dhe i mjerë Atë Ditë.

Ajeti thotë: **"Ditën** (e Kiametit)**, kur të zbulohen shumë ngjarje të frikshme, ata do të thirren që të përulen në sexhde, por nuk do të munden!"**.

Sijalia: **"kur të zbulohen shumë ngjarje të frikshme"**, sipas disa komentuesve, tregon ashpërsinë e frikës dhe të vështirësisë së punëve, sepse arabët e kishin bërë zakon se, kur përballeshin me vështirësitë, mantelin e lidhnin për beli, në mënyrë që pjesa e poshtme e këmbës të zbulohej, prandaj lexojmë: "Kur e pyetën Ibn Abasin, komentuesin e njohur të Kur'anit rreth kuptimit të këtij ajeti, ai u përgjigj se, sa herë që diçka nga Kur'ani është e paqartë për ju, referojuni shprehjeve të përdorura nga arabët në krijimtarinë poetike të tyre. Vallë, a nuk keni dëgjuar poetin të thotë se lufta na ka mbajtur në këmbë? Ky është aludim për ashpërsinë e luftës.".

Sipas disa komentuesve, fjala *"sakun"* do të thotë *"thelbi dhe baza e çdo gjëje"*, si, p.sh. trungu i pemës. Prandaj, kjo fjalë, në këtë kontekst, tregon se Atë Ditë themelet e çdo gjëje do të zbulohen.

Sidoqoftë, kuptimi i parë është më i përshtatshëm. Atë Ditë të gjithë do të thirren për t'i bërë sexhde All'llahut. Besimtarët do të bëjnë sexhde, kurse kriminelët nuk do ta bëjnë, sepse vetat e tyre të sëmura dhe veprat e tyre të shëmtuara që kanë kryer në këtë botë, i pengojnë të përkulen përballë Qenies së Pastër të All'llahut.

Duhet të sqarohet se Dita e Kiametit nuk është ditë obligimi. Atëherë, përse bëhet thirrja për të rënë në sexhde? Përgjigjen e kësaj pyetjeje e kanë sqaruar disa hadithe. Në njërin prej tyre lexojmë: "*Në Ditën e Kiametit, zbulesa do të hiqet nga drita hyjnore dhe besimtarët, për shkak të madhështisë së saj, do të bien në sexhde, por kurrizi i dyfytyrëshve do të ngrihet i tëri, aq sa nuk do të kenë mundësinë për të bërë sexhde.*".[1]

Me fjalë të tjera, Atë Ditë do të shfaqet Madhështia e All'llahut. Kjo madhështi do t'i ftojë besimtarët në sexhde dhe ata do të bien në sexhde, por jobesimtarët do të privohen nga kjo lumturi.

Ajeti në vazhdim thotë: **"Të ulura do të jenë shikimet e tyre dhe do t'i mbulojë poshtërimi…"**.

Njerëzit kriminelë, keqbërësit, kur ndodhen para gjykatës, e ulin kokën dhe poshtërimi ua kaplon tërë qenin e tyre.

Më pas Kur'ani thotë: **"sepse kanë qenë të ftuar të përuleshin në sexhde, sa qenë shëndoshë** (dhe nuk kanë pranuar)**."**.

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, hadithi 49, f. 395.

Ata kurrë nuk bënë sexhde, por u treguan prepotentë, rebelë dhe arrogantë në skenën e Kiametit. Në këtë situatë, si do të kenë fuqi për të rënë në sexhde?

Ftesa për të bërë sexhde në këtë botë bëhej edhe përmes thirrjes së myezinëve për faljet ditore, edhe përmes tubimeve për faljen kolektive, edhe përmes ajeteve kur'anore, haditheve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe Imamëve të pagabueshëm. Kjo thirrje ka një kuptim të gjerë dhe përfshin të gjitha rastet e përmendura.

Më pas, All'llahu, duke iu drejtuar Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*, thotë: **"Prandaj, më lër Mua me ata, që e mohojnë këtë Fjalë** (Kur'anin)**."**.

Ky është një kërcënim i ashpër, nga ana e All'llahut Fuqiplotë, i Cili i thotë të Dërguarit të Vet se nuk ka nevojë të ndërhysh ti, më lër Mua me këta përgënjeshtrues, kryeneçë e rebelë, që t'jua jap atë që meritojnë!

Të mos harrojmë se këtë e thotë All'llahu i Plotfuqishëm ndaj çdo gjëje. Kjo shprehje është nxitje dhe mbështetje për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe për besimtarët, në përpjekjet e tyre ndaj kurtheve të armiqve.

Më pas shton: **"Ne do t'i çojmë ata hap pas hapi drejt rrënimit të tyre, me mënyra që ata nuk i kuptojnë. Dhe do t'u japim atyre afat; vërtet që kurthi Im është i fortë!"**.

Në një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Ndodh që, kur njerëzit kryeneçë bëjnë mëkat, Zoti u jep begati, me qëllim që ata ta harrojnë mëkatin e kryer, por atyre nuk u kujtohet, që të*

pendohen. Pikërisht kjo quhet 'istredaxh' – 'hap pas hapi', pra, tortura dhe dënimi gradual.".[1]

Nga ky hadith, si dhe nga transmetime të tjera, që kanë të bëjnë me këtë temë, vjen mesazhi se, ndonjëherë, All'llahu, për ndëshkimin e robëve kryeneçë dhe kokëfortë, për mëkatet që kryejnë, në vend të dënimeve, u jep begati dhe ata imagjinojnë se kjo është mirësia dhe favor nga All'llahu që u jepet, për shkak të meritës. Prandaj ata zhyten në harresë dhe arrogancë, por papritur All'llahu ua zëvendëson jetën plot begati me një dënim të ashpër dhe të dhimbshëm. Kjo është forma më e tmerrshme e dënimit.

Kjo mënyrë ndëshkimi është për ata persona që rebelimin dhe kryeneçësinë i kanë çuar në limitet e saj. Njerëzit që nuk e kanë arritur këtë nivel, do të gjykohen nga All'llahu, sipas mëkateve që kanë bërë. Do t'u tërhiqet vërejtje (me ndonjë dënim në këtë botë). Kjo gjë do të bëhet shkak për rizgjimin dhe pendimin e tyre. Këtë duhet ta konsiderojmë si mirësi të All'llahut ndaj tyre.

Thënë ndryshe, kur njeriu kryen mëkat, ka tri mundësi para tij: ose e shikon vetë gabimin e tij dhe e korrigjon, pra, i rikthehet Rrugës së All'llahut, ose All'llahu e "godet" me kamxhikun e ndëshkimit, që të zgjohet, ose nuk e meriton asnjërën nga këto dy mundësi. Mundësia e tretë është kur All'llahu, në vend të dënimit, u jep begati, e cila është ekuivalente me dënimin gradual. Për të sqaruar këtë çështje, flasin ajetet kur'anore, qoftë me të njëjtin emërtim apo me shprehje të tjera.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 340.

Prandaj njeriu duhet të jetë i vëmendshëm, kur i vijnë begati nga Zoti, sepse ekziston mundësia që kjo begati të kthehet në ndëshkim gradual.

Për këtë arsye, myslimanët e zgjuar, në raste të tilla, binin në mendime dhe rishikonin veprat e kryera prej tyre. Për këtë flasin dhe hadithe. Në njërin prej tyre lexojmë: "Një nga shokët e Imam Sadikut tha: 'Unë i kërkova All'llahut pasuri e Ai më dha. Pastaj i kërkova fëmijë dhe më dha, po ashtu e kam lutur për shtëpi dhe sërish ma plotësoi dëshirën dhe tani kam frikë se mos e gjithë kjo përfundon me ndëshkimin gradual!'.

Imami iu përgjigj: "*Nëse të gjitha këto shoqërohen me falënderimin dhe lavdërimin e Zotit, këto begati nuk do të jenë shenjë e ndëshkimit ose e dënimit gradual.*".[1]

Sifjalia: **"Dhe do t'u japim atyre afat"**, përcjell mesazhin se All'llahu nuk ngutet për ndëshkimin e shtypësve. Nxiton vetëm ai person që ka frikë se mundësitë do të dalin prej dorës së Tij. All'llahu i Plotfuqishëm i realizon dëshirat e Tij, sa herë që dëshiron. Për Atë humbja e mundësisë nuk ka kuptim.

Sidoqoftë, ky është një kërcënim për të gjithë shtypësit e padrejtë dhe arrogantë se shëndeti, rehatia dhe siguria, kurrë të mos bëhen shkak për humbjen e tyre, por në çdo moment të frikësohen, se mos u bie mbi kokë ndëshkimi i ashpër i All'llahut.

1 Tefsiri "Usulul Kafij", në përputhje me transmetimin e "Nuruth Thakalejn", vëll. 5, f. 397.

Ajetet 46 – 50

أَمْ تَسْأَلُهُمْ أَجْرًا فَهُمْ مِنْ مَغْرَمٍ مُثْقَلُونَ٤٦، أَمْ عِنْدَهُمُ الْغَيْبُ فَهُمْ يَكْتُبُونَ٤٧، فَاصْبِرْ لِحُكْمِ رَبِّكَ وَلَا تَكُنْ كَصَاحِبِ الْحُوتِ إِذْ نَادَى وَهُوَ مَكْظُومٌ٤٨، لَوْلَا أَنْ تَدَارَكَهُ نِعْمَةٌ مِنْ رَبِّهِ لَنُبِذَ بِالْعَرَاءِ وَهُوَ مَذْمُومٌ٤٩، فَاجْتَبَاهُ رَبُّهُ فَجَعَلَهُ مِنَ الصَّالِحِينَ٥٠

“A mos po kërkon shpërblim prej tyre, kështu që qenkan të rënduar nga borxhet?”

“Apo ata e dinë të padukshmen, kështu që e shkruajnë?”

“Prandaj, duro për gjykimin e Zotit tënd dhe mos u bëj si Njeriu i Peshkut (Junusi / *Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*)**, kur iu lut Zotit të vet i dëshpëruar** (në barkun e balenës)**!”**

“Sikur të mos i vinte mëshira prej Zotit tënd, ai do të hidhej në një shkretëtirë, i fajësuar!”

“Por Zoti i tij e zgjodhi dhe e futi me punëdrejtët.”

Komentimi

Mos nxito në kërkimin e ndëshkimit

Pas diskutimeve të bëra në ajetet e kaluara për idhujtarët dhe keqbërësit, këtu parashtrohen dy pyetje të tjera. Në ajetin 46 thuhet: **"A mos po kërkon shpërblim prej tyre, kështu që qenkan të rënduar nga borxhet?"**.

Pra, nëse ata thonë se përgjigjja e lutjes tënde kërkon shpërblim të madh material dhe se ata nuk kanë mundësi ta paguajnë atë, kjo është gënjeshtër, sepse ti nuk i ke kërkuar atyre shpërblim. Po ashtu, asnjë i Dërguar i All'llahut nuk ka kërkuar shpërblim për thirrjen e tij.

Fjala *"magramun"* rrjedh nga fjala *"geramet"*, që do të thotë *dëmtim që i shkaktohet njeriut*, megjithëse ai nuk ka bërë ndonjë krim ose tradhti. Kurse fjala *"muthkal"* rrjedh nga fjala *"thikl"* dhe nënkupton *"rëndesën"*. Në tërësi, ajeti heq një tjetër alibi të kundërshtarëve. Ajeti i lartpërmendur dhe ai që vijon, janë përsëritur tekstualisht në suren "Et Tur", ajetet 40-41.

Pas kësaj, në vazhdim të këtij dialogu, ajeti 47 shton: **"Apo ata e dinë të padukshmen, kështu që e shkruajnë?"**.

Ky është një prej varianteve të largëta, në të cilin ka gjasa që të mbështeten jobesimtarët, prandaj Kur'ani nuk e ka kursyer as atë. Kur'ani sqaron se ka nga ata që pretendojnë se, me anë të magjistarëve apo të ngjashëm me ta, kanë lidhje me Botën e Përtejme. Në këtë mënyrë kanë liri veprimi ndaj fshehtësive të asaj

Bote dhe e kanë kuptuar epërsinë e tyre ndaj myslimanëve, apo së paku pozitën e barabartë me ta.

Sigurisht, ata nuk patën argument për një pretendim të tillë dhe gjithë fjalia është një retorikë boshe. Supozimi i disa komentuesve, që me fshehtësinë, nënkuptohet "Leuhil Mahfudh", kurse me të shkruarit, nënkuptohet caktimi dhe paracaktimi, duket shumë larg nga realiteti, sepse ata kurrë nuk thoshin që çështja e caktimit dhe e paracaktimit dhe "Leuhil Mahfudhi" është në dorën e tyre. Për më tepër, ngaqë kokëfortësia dhe palogjikshmëria e idhujtarëve dhe e armiqve të Islamit, në disa momente e ngacmonte aq shumë zemrën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*, saqë ekziston mundësia që ajeti t'i mallkojë.

Në ajetin vijues, All'llahu e ngushëllon Profetin e Vet, Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe e urdhëron për durim dhe qëndresë: **"Prandaj, duro për gjykimin e Zotit tënd…"**.

Qëndro në pritje, derisa Zoti të bëjë gati mjetet e fitores tënde e të shokëve të tu, si dhe humbjen e armiqve të tu. Kurrë mos nxito për ndëshkimin e tyre dhe ki parasysh se shtyrja e kohës së ndëshkimit të tyre është një lloj "dënimi gradual".

"*Gjykimi i Zotit tënd*", do të thotë caktimi përfundimtar i Zotit për fitoren e myslimanëve. Disa komentues, e kanë interpretuar ndryshe. Ajeti përcjell mesazhin, se në rrugën e komunikimit të urdhrave të Zotit, duhet të tregohesh i durueshëm dhe i qëndrueshëm, sepse Zoti të ka urdhëruar të tregohesh i durueshëm. Interpretimi i parë është më i përshtatshëm.

Më pas, Kur'ani thotë: **"...Mos u bëj si Njeriu i Peshkut** (Junusi/*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*)**, kur iu lut Zotit të vet i dëshpëruar** (në barkun e balenës)**."**.

Me fjalën *"thirrjen"*, këtu synohet po ajo që përmendet në ajetin 87 të sures "El Enbija": **"**(Kujtoje) **Dhun Nunin** (Junusin) **kur iku i zemëruar e mendoi se Ne nuk do ta dënojmë, andaj thërriti nga errësira: 'S'ka zot tjetër, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!'".**

Në këtë mënyrë ai e pranoi moszbatimin e më primares dhe i kërkoi falje All'llahut.

Ekziston dhe mundësia se fjala *"thirrja"*, në këtë ajet, të jetë mallkimi që bëri për popullin e vet, kur e kishte mbërthyer zemërimi dhe mllefi.

Komentuesit kanë pëlqyer interpretimin e parë, sepse fjala *"nada" - "e thirri"*, në këtë ajet, është në sintoni me shprehjen që përmendet në ajetin 87 të sures "El Enbija", e cila ka të bëjë me kohën kur ishte "i burgosur" në barkun e peshkut.

Fjala *"makdhumun"* rrjedh nga fjala *"kadhmun"*, që do të thotë "grykë"; shprehja *"kadhmu seka"* është përdorur me kuptimin e mbylljes së grykës së shishes, pas mbushjes së saj. Për këtë arsye, njerëzve që zemërohen apo brengosen tepër, por tregohen të vetëpërmbajtur, u thuhet *"kadhijm"*.

Po për këtë arsye, kjo fjalë përdoret edhe në kuptimin e burgimit. Prandaj fjala *"makdhumun"*, në ajetin e lartpërmendur, mund të ketë dy kuptime: mbushja me zemërim dhe brengë dhe të qenët i burgosur në barkun e balenës. Por siç e diskutuam dhe më sipër, kuptimi i parë është më i përshtatshëm.

Në ajetin vijues, thuhet: **"Sikur të mos i vinte mëshira prej Zotit tënd, ai do të hidhej në një shkretëtirë, i fajësuar!"**.

Ne jemi në dijeni se Junusi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* doli nga barku i balenës në një shkretëtirë të thatë, për të cilën Kur'ani përdor fjalën *"el arau"*. Por kjo ndodhte, kur All'llahu e kishte pranuar pendimin e tij dhe, kur e përfshiu me mëshirën e Tij, prandaj nuk meritonte tjetër qortim.

Edhe në suren "Es Saffat", në ajetet 145-146 lexojmë: **"Ne e hodhëm në një tokë pa bimë** (shkretëtirë)**, ndërsa ai ishte i sëmurë. Dhe Ne bëmë që për të të mbijë një bimë, e cila t'i bëjë hije, të mbijë kungulli."**.

Ndoshta me fjalën *"begati"* në ajetin në fjalë, shënohet kryerja e pendimit dhe përfshirja me mëshirën e All'llahut.

Këtu parashtrohen dy pyetje: e para, është ajo që thuhet në ajetet 143–144 të sures "Es Saffat": **"...sikur ai të mos kishte qenë prej atyre që e përmendin shumë Zotin, do të mbetej në barkun e peshkut deri në Ditën e Ringjalljes."**. Kjo është në kundërshtim me atë që u tha në ajetin në fjalë.

Në përgjigje të këtij supozimi, mund të thuhet se Junusin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e prisnin dy ndëshkime të ndryshme, njëri më i ashpër dhe tjetri më i lehtë.

Çështja e parë, e cila thotë se deri në përfundim të botës, të mbetet në barkun e balenës, u mënjanua falë lëvdatës dhe Madhërimit të All'llahut. Edhe çështja e dytë, e cila thotë se, kur do të dilte nga barku i balenës, do të ishte i dëshpëruar dhe larg

mëshirës së All'llahut, u mënjanua falë mirësisë dhe mëshirës së All'llahut.

Lidhur me atë që përmendet në ajetin 142 të sures "Es Saffat": **"atë e gëlltiti një balenë, se ai kishte bërë diçka të gabuar..."**, sqarohet në ajetin që po diskutojmë, ku thuhet se ai nuk meritonte qortim dhe kritikë.

Përgjigjja e kësaj pyetjeje, sqarohet me faktin se ky qortim ka të bëjë me periudhën kur sapo ishte futur në barkun e balenës, kurse pjesa tjetër, pra, mënjanimi i qortimit, ka të bëjë me kohën kur ai u pendua dhe All'llahu e pranoi pendimin e tij, prandaj dhe e shpëtoi nga kjo situatë.

Prandaj në ajetin në vazhdim, thuhet: **"Por Zoti i tij e zgjodhi dhe e futi me punëdrejtët."**.

Pas kësaj, misionin e udhëzimit të popullit të tij, sërish ia dha atij. Ai u kthye te populli i vet dhe të gjithë u kthyen në besimtarë. Për këtë, All'llahu i Madhëruar i shpërbleu ata për një periudhë të gjatë me shumë të mira materiale. Shpjegimi i ngjarjes së Junusit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe i popullit të tij, trajtimi i çështjeve të tjera, në lidhje me heqjen dorë prej veprës së preferuar, rënia e tij në barkun e balenës, si dhe pyetje të ndryshme që shtrohen në lidhje me këtë, janë diskutuar gjerësisht në ajetet 139-148 të sures "Es Saffat", si dhe në ajetet 87-88 të sures "El Enbija."

Ajetet 51 – 52

وَإِنْ يَكَادُ الَّذِينَ كَفَرُوا لَيُزْلِقُونَكَ بِأَبْصَارِهِمْ لَمَّا سَمِعُوا الذِّكْرَ وَيَقُولُونَ إِنَّهُ لَمَجْنُونٌ۝ وَمَا هُوَ إِلَّا ذِكْرٌ لِلْعَالَمِينَ۝

"Kur dëgjojnë Kur'anin, mohuesit sa nuk të hanë me shikimet e tyre dhe thonë: 'Ai është vërtet i marrë!'"

"Por Kur'ani është vetëm këshillë për botët."

Komentimi

Duan të të shkatërrojnë, por nuk munden!

Me dy ajetet e lartpërmendura, përfundon surja "El Kalem". Këto dy ajete lidhen me atë që përmendet në fillim të kësaj sureje, e cila flet për çmendurinë e armiqve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Ajeti 51 thotë: **"Kur dëgjojnë Kur'anin, mohuesit sa nuk të hanë me shikimet e tyre dhe thonë: 'Ai është vërtet i marrë!'"**.

Fjala *"le juzlikuneke"* rrjedh nga fjala *"zelek"* dhe ka kuptimin e rrëshqitjes, rrëzimit përtokë dhe aludon për shkatërrim dhe shfarosje.

Në komentimin e këtij ajeti janë dhënë sqarime të ndryshme për këto çështje:

1- Shumë komentues kanë thënë se armiqtë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kur dëgjonin prej tij ajetet e Kur'anit, përjetonin shumë brenga dhe mllef dhe e shikonin me shumë dashakeqësi. Ata ishin gati ta rrëzonin për tokë dhe ta shkatërronin. Në plotësimin e këtij kuptimi, disa kanë shtuar se ata kishin dëshirë, që me anë të syrit të keq, të cilin e besonin shumë njerëz, të mund t'i shkaktonin sëmundjen apo vdekjen dhe ta shfarosnin.

2- Disa të tjerë kanë thënë se ajeti qartëson se shikimet ishin tepër të mllefosura, sikur donin ta hanin të gjallë.

3- Ekziston edhe një interpretim tjetër për këtë ajet. Ky interpretim mbase është më i qëlluar se interpretimet e lartpërmendura. Sipas këtij interpretimi, Kur'ani dëshiron, që me anë të kësaj shprehjeje, të vërë në pah kundërthënien e çuditshme që ekzistonte ndërmjet qëndrimeve dhe thënieve të armiqve të Islamit. Pra, ata kur i dëgjonin ajetet kur'anore impresionoheshin aq shumë dhe mbeteshin aq të habitur përballë tyre, saqë kërkonin ta merrnin mësysh. Marrja mësysh (syri i keq), zakonisht, është i lidhur me çështjet që janë tejet impresionuese, megjithatë ata deklaronin: "Ti je i çmendur dhe kjo është vërtet shumë për t'u habitur!".

Ku duket këtu çmenduria dhe të folurit përçart? Këta kokëboshë nuk dinë se ç'flasin, nuk dinë se çfarë cilësimesh thonë dhe për të përjashtuar njëri-tjetrin, të përdorin ty! Sidoqoftë, në lidhje me faktin se a ekziston realisht syri i keq, nga pikëpamja e Islamit dhe shkencat e kohës, do të diskutojmë te hulumtimet.

Në ajetin e fundit të kësaj sureje, All'llahu thotë: **"Por Kur'ani është vetëm këshillë për botët."**.

Njohuritë e Kur'anit janë dritëhedhëse, paralajmërime dhe kanë efektin e zgjimit. Shembujt e këtij Libri të begatë janë plot domethënie; përgëzimet e tij janë shpirtdhënëse. Në tërësi, janë faktorë për rizgjimin e të papërfillshmeve, si dhe rikujtim për harrestarët. Pas këtyre sqarimeve, si mund të cilësojmë si të çmendur, komunikuesin e Kur'anit?! Sipas këtij interpretimi, fjala *"dhikr"*, në këtë ajet, është përdorur me kuptimin e rikujtimit, por disa komentues kanë thënë se është përdorur me kuptimin e dinjitetit dhe ajetin e kanë interpretuar në këtë mënyrë: Ky Kur'an është fisnikëri për të gjithë njerëzimin. Ngjashëm me atë që thuhet në ajetin 44 të sures "Ez Zuhruf": **"Kur'ani është shkak i dinjitetit dhe i mburrjes sate dhe të popullit tuaj!"**.

Por siç e diskutuam edhe në interpretimin e atij ajeti, fjala *"dhikr"*, edhe atje, ishte përdorur me kuptimin e rikujtimit dhe të ndërgjegjësimit. Është për të theksuar se fjala *"dhikr"* është një nga emrat e Kur'anit Famëlartë, prandaj interpretimi i parë duket më i saktë.

Hulumtim

A është realitet syri i keq?

Shumë njerëz besojnë se tek disa sy ka një forcë të posaçme dhe, kur e drejtojnë syrin kah një gjëje, me habi dhe me kureshtje, ka mundësi ta zhdukin atë. Nëse objekti i shikimit, është njeri, e sëmurin apo e çmendin atë. Kjo gjë nuk është e pamundur, nga pikëpamja e intelektit, sidomos duke ditur se disa dijetarë bashkëkohorë janë të mendimit se te disa sy, është përqendruar një forcë magnetike e veçantë, e cila ka përdorim të gjerë. Madje, me anë të stërvitjes dhe ushtrimit, syri i keq mund të kultivohet. Gjumi magnetik është rezultat i po kësaj force magnetike të syve. Sot rrezet e lazërit, i këtij rrezatimi të padukshëm, mund të shkaktojnë efekt që asnjë armë ose armatim shkatërrues nuk ia arrin dot. Është pranuar se ekzistojnë forca te disa sy, të cilat, në mënyrë të habitshme, mund të ndikojnë te pala tjetër nëpërmjet valëve të veçanta. Shumë njerëz rrëfejnë se me sytë e vet kanë parë individë, të cilët kanë këtë forcë misterioze të syrit të keq dhe nëpërmjet syrit të keq kanë shfarosur njerëz, kafshë apo sende.

Prandaj, jo vetëm që nuk duhet të mohohen këto dukuri, por duhet të pranohet mundësia e ekzistencës së tyre. Nga pikëpamja e intelektit dhe e shkencës, edhe në transmetimet islame, po ashtu, hasim raste të ndryshme, ku, në mënyrë të përmbledhur, trajtohet ekzistenca e çështjeve të tilla. Në një hadith lexojmë: "Esma bint Umejs shkoi te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i tha se disa herë fëmijëve të Xhaferit binin mësysh a t'u lexoj atyre rukje? E pyeti Profetin, nëse

mund të përgatiste një nuskë për ta. Profeti tha, po. Bëje këtë punë. Në qoftë se diçka mund të parandalonte caktimin dhe paracaktimin, kjo do të ishte marrje mësysh (Me fjalën *"rukjetun"* nënkuptojmë lutjet që shkruhen mbi letër dhe njerëzit i mbajnë me vete për t'u ruajtur nga syri i keq, që ndryshe quhen "nuskë".).[1]

Në një hadith tjetër lexojmë: "Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* përgatiti një nuskë për Imam Hasanin dhe Imam Hysejnin *(Paqja qoftë mbi ta!)* dhe u lexonte këto lutje: "*Kërkoj mbrojtjen tuaj, me anë të të gjitha fjalëve të plota dhe Emrave të bukur të Zotit, nga ligësia e vdekjes, e kafshëve të rrezikshme dhe e çdo syri të keq, nga ligësia e njerëzve xhelozë, kur xhelozojnë.*".

Më pas Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* më shikoi dhe tha: "Në këtë mënyrë, Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* kërkonte mbrojtjen e Islamilit dhe të Is'hakut.".

Në "Nehxhul Belaga" thuhet se syri i keq është një realitet, si dhe nuska ka realitet.[2]

Është për t'u theksuar fakti se nuk ekziston asnjë pengesë që këto lutje dhe ndërmjetësime të ndikojnë me anë të urdhrit të All'llahut, për të parandaluar ndikimin e lig të forcës misterioze magnetike të syve të këqij. Ashtu siç lutjet kanë ndikimin e tyre te shumë prej faktorëve shkatërrues, edhe syrin e keq, me anë të urdhrit të All'llahut, e zhbëjmë.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 341.

[2] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 400.

Pranimi i efektit të syrit të keq, në përgjithësi, nuk do të thotë se njerëzit, në situata të paqarta, të kërkojnë ngushëllime te besëtytnitë dhe te praktikat popullore, sepse kjo është kundër rekomandimeve të fesë dhe krijon dyshime te njerëzit e painformuar në lidhje me thelbin e çështjes. Përzierja e shumë prej të emrave me besëtytnitë, ka shkaktuar efekt të padëshirueshëm te mendjet e njerëzve.

O Zot, të lutemi, që të na mbrosh prej njerëzve të ligj dhe prej armiqve, duke na vënë nën kujdestarinë Tënde!

O Krijues, të lutemi që të na dhurosh qëndresë dhe durim dhe, në saje të tyre, të na mundësohet përfitimi i kënaqësisë Tënde!

O Zot i Madh, të lutemi, që të na japësh mundësinë për të shfrytëzuar begatitë e Tua të pafundme, para se të privohemi nga ato, për shkak të mosmirënjohjes tonë ndaj Teje.

Përfundimi i sures "El Kalem"

SURE "EL HÂKKA"

Zbritur në Mekë

Ajete 52

Përmbajtja e sures "El Hâkka"

Përmbajtja e kësaj sureje trajton tri çështje.

Çështja e parë, që është edhe më e rëndësishmja, flet për Kiametin dhe për disa veçori të tij. Për këtë arsye, në këtë sure janë cituar tri emra prej emrave të Kiametit, që janë: El Hâkka, Karia dhe Vakia.

Çështja e dytë flet rreth fatit të popujve jobesimtarë. Në veçanti flet për popullin e Adit, të Themudit dhe të Faraonit. Jepen paralajmërime të forta dhe të theksuara për të gjithë jobesimtarët dhe mohuesit e Ditës së Kiametit.

Çështja e tretë flet për madhështinë e Kur'anit dhe pozitën e lartë të Profetit Muhammed *(Paqja bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si dhe për dënimin e mohuesve.

Mirësitë e leximit të sures "El Hâkka"

Në një hadith të Profetit të nderuar të Islamit, Profetit Muhammed *(Paqja bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë: *"Ai që e lexon suren 'El Hâkka', All'llahu ia lehtëson llogarinë në Ditët e Kiametit."*.

Në një tjetër hadith nga Imam Bakiri *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* thuhet: *"Lexojeni shumë suren 'El Hâkka, sepse leximi i saj në namazet e detyruara dhe ato të pëlqyera, tregon besimin në Zot dhe te të Dërguarit e Tij. Ata që e lexojnë këtë sure, e ruajnë fenë e tyre, derisa të takohen me Krijuesin."*.

Ajetet 1 – 8

بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

الْحَاقَّةُ١ مَا الْحَاقَّةُ٢ وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْحَاقَّةُ٣ كَذَّبَتْ ثَمُودُ وَعَادٌ بِالْقَارِعَةِ٤ فَأَمَّا ثَمُودُ فَأُهْلِكُوا بِالطَّاغِيَةِ٥ وَأَمَّا عَادٌ فَأُهْلِكُوا بِرِيحٍ صَرْصَرٍ عَاتِيَةٍ٦ سَخَّرَهَا عَلَيْهِمْ سَبْعَ لَيَالٍ وَثَمَانِيَةَ أَيَّامٍ حُسُومًا فَتَرَى الْقَوْمَ فِيهَا صَرْعَى كَأَنَّهُمْ أَعْجَازُ نَخْلٍ خَاوِيَةٍ٧ فَهَلْ تَرَى لَهُمْ مِنْ بَاقِيَةٍ٨

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirëshmit, Mëshiruesit!

"E Vërteta e pashmangshme!"

"Ç'është e Vërteta e pashmangshme?"

"E kush do të ta shpjegojë ty se ç'është e Vërteta e pashmangshme?"

"Fiset Themud dhe Ad e mohuan Gjëmimin e tmerrshëm",

"prandaj fisi Themud u shkatërrua nga një ulërimë e tmerrshme",

"kurse fisi Ad u shkatërrua nga një furtunë shungulluese të rreptë",

"të cilën All'llahu ua dërgoi atyre shtatë net dhe tetë ditë pareshtur. Atëherë mund t'i vëreje njerëzit të përmbysur si trungjet e hurmave të kalbura."

"A sheh ndonjë gjurmë të tyre?"

Komentimi

Dënimi i mundimshëm për popujt mohues

Kjo sure flet për çështjen e Kiametit dhe fillon me një temë të re: **"'E Vërteta e pashmangshme!' 'Ç'është e Vërteta e pashmangshme?' 'E kush do të ta shpjegojë ty se ç'është e Vërteta e pashmangshme?'"**.

Përgjithësisht, të gjithë komentuesit e Kur'anit të Shenjtë, fjalën *"el hâkka"* e kanë komentuar me kuptimin: *Dita e Kiametit*, sepse kjo ditë është e sigurt, do të ndodhë me patjetër. Kemi thënë se edhe fjala *"el uakia"* në suren "El Uâki'a", ka të njëjtin kuptim. Këtë na e shpjegon ajeti 16 i kësaj sureje, pra "El Uâki'a". Këto janë të vërteta të sigurta për Ditën e Kiametit, për atë ditë të madhe.

Interpretimi i ajetit: **"Ç'është e Vërteta e pashmangshme?"** [1], me fjalën *"ma el hake"*, bëhet për të treguar madhështinë e asaj dite, ashtu sikurse themi me fjalët tona të përditshme: "Filani është njeri! Çfarë njeriu është!" .

Pra, nuk është se ka ndonjë përshkrim, për sa i përket përshkrimit të tij.

Ajeti: **"E kush do të ta shpjegojë ty se ç'është e Vërteta e pashmangshme?"**, tregon përsëri madhështinë dhe ngjarjen e asaj dite të madhe, saqë edhe Profetit Muhammed *(Paqja bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i drejtohet, duke i thënë se ti nuk e di, se si do të jetë ajo ditë. E vërteta është se ndjeshmëria ndaj ngjarjeve të asaj dite, për ne të burgosurit e burgut të kësaj bote, është e pamundur. Ashtu sikurse një fetus në barkun e nënës e ka të pamundur të kuptojë ç'është kjo botë. Nuk mund t'ia shpjegosh me asgjë.[2]

Një tjetër mundësi për komentimin e këtyre ajeteve, edhe pse janë të paktë ata komentues që e kanë pranuar një komentim të tillë, është se fjala *"el hâkka"* – *"e vërteta e pashmangshme"*, flet për dënimin e papritur që marrin në këtë botë kriminelët, mohuesit egoistë.

---

1 Për ndërthurjen e kësaj fjalie, janë dhënë mendime të ndryshme. Më e përshtatshmja është se fjala *"el hakka"* është kryefjalë, ndërsa fjala *"ma"* është kallëzues.

2 Disa komentues janë të mendimit se fjala e ajetit: *"Ma edrake"* – **"Ç'është e Vërteta e pashmangshme"**, në të gjithë Kur'anin është çështje e kuptuar. Fjalia: *"Ue Ma Edrake"* – **"E kush do të ta shpjegojë ty se ç'është e Vërteta e pashmangshme?"**, në disa vende ka ardhur e pakuptueshme. ("Maxhmeul Bejan", vëll. 10, f. 343). Edhe komentuesi Kurtubi ka transmetuar këtë kuptim.

Disa komentues, fjalën *"el karieh"* – *"mohuan gjëmimin e tmerrshëm"*, që do të vijë në ajetin tre të kësaj sureje, e kanë komentuar me këtë kuptim. Rastësisht ky komentim është më i përshtatshëm me komentimin e ajeteve që do vijnë më poshtë, të cilat flasin për dënimin e ashpër të fisit të Adit, të Themudit, të Faraonit dhe të Lutit *(Paqja e All'llahut qoftë nbi të!)*.

Në komentimin e Ali bin Ibrahimit lexojmë se fjala *"el hâkka"* është paralajmërim për zbritjen e dënimit të njëjtë me atë të Faraonit, sikurse thuhet në ajetin 45 të sures "El Gafir"(sure "Mu'min"): **"...ndërsa ithtarët e Faraonit i kaploi dënimi i vrazhdë."**.

Më pas flet për fatin e popujve në Ditën e Kiametit, që e kanë mohuar në këtë botë Ditën e Gjykimit dhe shton se fisi i Adit, i Themudit e mohoi dënimin hyjnor.

Fisi i Themudit u zhduk nga faqja e dheut nëpërmjet një dënimi dhe britme të ashpër. Ky fis jetonte në periferi malore, midis Hixhazit dhe Shamit. Zoti dërgoi tek ata Profetin Salih *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, por ata nuk besuan kurrë, përkundrazi e kundërshtuan. Kërkuan nga ai që, nëse thotë të vërtetën, le t'u zbriste dënimin që u kishte premtuar. Në këtë moment, Zotit u lëshoi atyre një rrufe, që shkatërroi gjithçka. Në pak sekonda, gjithçka u rrëzua në tokë: të gjitha gradaçelat e tyre u rrëzuan dhe trupat e tyre të pajetë u rrëzuan në tokë.

Është për t'u theksuar se Kur'ani, citon faktin se shkaku i zhdukjes së këtij fisi është mosbindja. Kjo mosbindje e ky rebelim i tyre citohet edhe në ajetin 78 të sures "El Araf", me fjalën

"raxh'efeh" - *"tërmet"*: **"Për këtë arsye ata i goditi një tërmet i rëndë në mëngjes dhe mbetën të vdekur në shtëpitë e tyre."**.

Në ajetin 13 të sures "El Fussilet" vjen me fjalën *"saikeh"* – *"gjëmim"* dhe në ajetin 67 të sures "Hud" vjen me fjalën *"sei'he"*. Të gjitha kthehen te një kuptim i vetëm. Gjëmimi vjen më zhurmë të madhe, e bën njeriun të dridhet. Ky gjëmim është dënim për rebelët dhe mohuesit.[1]

"Fiset Themud dhe Ad e mohuan Gjëmimin e tmerrshëm."

Më tej flet për fatin e fisit të Adit, një fis që jetonte në Gadishullin Arabik, ose Jemen. Ata kishin trupa të gjatë, të fortë, qytete të lulëzuara, toka me prodhim të lartë, të gjelbëruara e të freskëta. Profeti i tyre ishte Hudi *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. Fisi i tij ishin mohues e rebel, kështu që Zoti u dërgoi atyre dënim të rëndë. Përshkrimi i dënimit ka zbritur në këto ajete.

Së pari, thuhet se fisi i Adit u shkatërrua nga një furtunë e rreptë shungulluese. Fjala *"sersere"* përdoret për erërat e ftohta që vijnë si furtunë e rreptë dhe helmuese: **"Fisi Ad u shkatërrua nga një furtunë shungulluese e rreptë."**.

Komentuesit i kanë cituar të tri kuptimet. Gjithashtu, thonë se është i mundur edhe bashkimi i kuptimeve.

Fjala *"atije"* vjen nga rrënja e fjalës *"utu"* dhe ka kuptimin: *"rebelim"*. Kuptimi nuk është rebelim i urdhrit të Zotit, por

1 Për fisin e Themudit është folur edhe në vëllimin 6 të këtij tefsiri, në faqet 234 - 241. (origjinali)

"rebelim", për sa u përket kritereve të flladeve dhe erërave të zakonshme.

Pra, përshkrimi i erërave të forta është: **"All'llahu ua dërgoi atyre shtatë net dhe tetë ditë pareshtur."**. Atëherë mund t'i vëreje njerëzit të përmbysur si trungjet e hurmave të kalbura.

Fjala *"husuma"* vjen nga rrënja e fjalës *"husem"* dhe ka kuptimin: *zhdukje e çdo efekti*. Edhe shpatës që i thuhet *"husam"*, me këtë kuptim vjen. Ndonjëherë fjala *"husem"* përdoret, kur digjemi dhe krijohet një plagë. Pra, qëllimi këtu është se këto shtatë net dhe tetë ditë bënë që këtë fis ta shkatërronin dhe të mos i mbetet rrënja.

Kur'ani thotë se, nëse do të ishe atje, do shikoje se si ai fis u rrëzua i tëri në tokë, sikurse trungjet e kalbura: **"Atëherë mund t'i vëreje njerëzit të përmbysur si trungjet e hurmave të kalbura."**.

Sa bukur e përshkruan dhe sa bukur e bën krahasimin! Në fillim tha ata janë të fortë, shtatlartë, etj. Më pas i zhduku me gjithë rrënjë. Këtu paraqet dënimin Hyjnor, se sa lehtë i shkundi ato nga vendi. Fjala *"havije"* vjen nga fjala *"khevah"*, që ka kuptimin: *"boshatisje"*. Ky lloj interpretimi përdoret për njerëzit e uritur, që u është boshatisur barku, apo për yjet e tharë nga shiu (sipas arabëve në kohën e injorancës), apo për arrën që nuk ka brenda thelpinj.

Në ajetin 8 thuhet: **"A sheh ndonjë gjurmë të tyre?"**.

Sot nuk ka asnjë shenjë nga fisi i Adit, asgjë nga ajo që kishin ata. Të gjitha u zhdukën.

Për fatin e fisit të Adit është folur edhe në komentimin e sures "Hud", ajetet 58–60, si dhe në vëllimin 20, në faqet 233 - 241. Sigurisht bëhet fjalë për vëllimet me origjinalin.

Ajetet 9 - 12

وَجَاءَ فِرْعَوْنُ وَمَنْ قَبْلَهُ وَالْمُؤْتَفِكَاتُ بِالْخَاطِئَةِ﴿٩﴾ فَعَصَوْا رَسُولَ رَبِّهِمْ فَأَخَذَهُمْ أَخْذَةً رَابِيَةً﴿١٠﴾ إِنَّا لَمَّا طَغَى الْمَاءُ حَمَلْنَاكُمْ فِي الْجَارِيَةِ﴿١١﴾ لِنَجْعَلَهَا لَكُمْ تَذْكِرَةً وَتَعِيَهَا أُذُنٌ وَاعِيَةٌ﴿١٢﴾

"Faraoni, ata para tij dhe populli i qyteteve të rrënuara kryen gjynahe të mëdha",

"dhe e kundërshtuan të Dërguarin e Zotit të tyre, andaj All'llahu i zhbiu ata me dënim të ashpër."

"Kur vërshoi uji i madh, Ne ju ngarkuam ju në anije",

"për ta bërë atë një paralajmërim, që ta dëgjojë çdo vesh i vëmendshëm."

Komentimi

Ku janë veshët që dëgjojnë?!

Pasi citohet e flitet pak për fisin e Adit dhe të Themudit, vijnë popuj e fise të tjera, sikurse është fisi i Nuhut, i Lutit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Nëpërmjet tyre njerëzit duhet të marrim

mësim, që t'u ngrihet morali. Në ajetin 9 thuhet: **"Faraoni, ata para tij dhe populli i qyteteve të rrënuara**[1] **kryen gjynahe të mëdha."**.

Fjala *"khatiat"* vjen nga fjala *"khata"* dhe, në këtë rast, ka kuptimin: politeizëm, mohues, padrejtësi, korrupsion dhe lloje të tjera mëkatesh.

Fjala *"mutefikat"* është shumësi i fjalës *"mutefeke"* dhe vjen nga rrënja e fjalës *"itifak"* dhe ka kuptimin: *revolucion apo përmbysje*. Në këtë rast, tregon për qytetet e fisit të Lutit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, të cilët u përmbytën nga tërmeti.

Fjala *"min kablihi"* flet për popuj dhe fise që ishin para Faraonit, sikurse është populli i Shuajbit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe si dhe për Nemrudin, një mburravec dhe rebel.

Në ajetin 10, për ta thuhet: **"E kundërshtuan të Dërguarin e Zotit të tyre, andaj All'llahu i zhbiu ata me dënim të ashpër."**.

Ata kundërshtuan Zotin, prandaj Ai i dënoi.

Faraoni u ngrit kundër Profetit Musa dhe Harun *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)*. Banorët e qyteteve të Sodomit u ngritën kundër Profetit Lut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*. Gjithashtu, edhe popuj të tjerë u ngritën kundër të Dërguarve të tyre. Secili grup u ndëshkua me dënim. Faraoni u mbyt në Nil, që ishte burim jete dhe lulëzim për vendin e tij. Populli i Lutit *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* u shkatërrua nga tërmeti i madh dhe nga shiu me gur.

1 Sodomës dhe Gomorrës.

Fjalët *"rabieh"* dhe *"raba"* vijnë nga një rrënjë dhe kanë kuptimin: *shtim*. Në këtë rast ka për qëllim dënimin që është shumë i vështirë dhe i padurueshëm.

Komentimi i ngjarjes së popullit të Faraonit dhe të Profetit Lut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* ka ardhur edhe në shumë sure të tjera të Kur'anit. Më e njohura është nga ajeti 10–68 të sures "Esh Shuara".

Tashmë do të flasim pak për fatin e popullit të Profetit Nuh *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe dënimet e dhimbshme të tyre.

"Kur vërshoi uji i madh, Ne ju ngarkuam ju[1] në anije."

Përmbytja e ujit ishte e tmerrshme: në qiell u ngritën re të errëta dhe nisi të bjerë aq shumë shi, saqë dukej sikur përmbytja po vërshon nga qielli. Në tokë gëlonin pellgje të mëdha. Të dyja këto i dhanë ndihmë njëra-tjetrës dhe gjithçka u zhyt në ujë. Bahçe, toka të mbjella, shtëpi e kështjella, të gjitha u përmbytën së bashku me njerëzit. Ata që shpëtuan, ishin besimtarët që u strehuan në anijen e Profetit Nuh *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*.

Fjala *"hemelnakum"* - *"ju u kemi bartur"*, tregon për të parët tanë, sepse, nëse ata nuk do kishin shpëtuar, as ne nuk do të ekzistonim sot.

Pas kësaj vjen te qëllimi kryesor i këtyre dënimeve: "për ta bërë atë një paralajmërim, që ta dëgjojë çdo vesh i vëmendshëm.".

1 D.m.th. Nuhun *(Paqja e All'llahut qoftw mbi tw!*) - babanë e dytë të njerëzimit dhe besimtarët që ishin me të.

Qëllimi i këtyre dënimeve është mjet për t'ju kujtuar ju. Veshët të dëgjojnë e të jenë të vëmendshëm në atë që themi. Kurrë nuk deshëm të hakmerremi ndaj tyre, por qëllimi ishte edukimi i njeriut, udhëzimi i tyre në përsosmëri, udhëzimi dhe shpjegimi i rrugës së pëlqyeshme.

Fjala "*taiha*" vjen nga rrënja e fjalës "*vaii*". Ragibi në veprën "Mufredat" dhe Ibn Manzuri në librin "Lisanul Arab", thonë se kjo fjalë, në origjinal, ka kuptimin: *ruajtje e një gjëje në zemër*. Më pas, çdo ene i thonë "*veai*", sepse ena mbart gjëra brenda saj.

Sipas një interpretimi tjetër, ndonjëherë njeriu dëgjon ndonjë gjë, por atë e harron e nxjerr nga vetja. Apo sipas thënieve popullore, me një vesh i hyn e me tjetrin i del. Ka nga ata që e mendojnë atë që u thuhet dhe e vënë në zemër, duke e ruajtur atë si kandilin e udhëzimit. Ky, pra, është kuptimi i fjalës *vaii*: *ruajtje në zemër*.

Hulumtime

Një tjetër virtyt nga virtytet e Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*

Në shumë prej librave të njohur të Islamit, si dhe nga tefsiret dhe transmetimet e hadithit, thuhet se Profeti ynë i nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kur zbriti ajeti: **"për ta bërë atë një paralajmërim, që ta dëgjojë çdo vesh i**

vëmendshëm”, kërkoi nga All’llahu që t’i ruajë dhe t’i bëjë veshët e Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dëgjues të së vërtetës. Bashkangjitur me këtë, Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* thoshte: “*Unë, pas asaj lutje, nuk kam lënë fjalë të Profetit Muhammed (Paqja e bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) pa dëgjuar dhe pa i kushtuar vëmendje. Çdo fjalë të tij e kam ruajtur në mendjen time.”*.[1]

Në librin “Gajetul Meram” janë transmetuar 16 hadithe, për sa u tha më lart, si nga shi’at, ashtu edhe nga synitë. Transmetuesi i madh i hadithit, Muhades Behrani, transmeton nga Muhammed bin Abasi, në komentimin “El Burhan” se për këtë gjë janë transmetuar 30 hadithe, si nga persona të veçantë, ashtu edhe të përgjithshëm.

Ky është një virtyt i çmuar, për udhëheqësin e madh, Imam Aliun *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, i cili qe sënduku i sekreteve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe trashëgimtari i gjithë dijes së Profetit.

Për këtë arsye, pas Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ishte Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* ai që u jepte zgjidhje problemeve që haste shoqëria në çështjet e dijes. Edhe ata që ishin në një mendje me të dhe ata që e kundërshtonin, shkonin tek Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* për të zgjidhur problemet e tyre. Të gjitha këto janë shkruar në librat e historisë.

---

1 Tefsiri “Kurtubij”, vëll. 10, f. 6743; shih dhe Tefsiret: “Mexhmaul Bejan”, “Ruhul Bejan”, “Ruhul Meani”, tefsirin e “Abul Fetuh Razi” dhe “El Mizan”. Ky hadith është edhe në librin “Munakeb Ibn Meghazli Shafei”, f. 265 dhe në librin “Tebe Islami”.

Përshtatje midis mëkatit dhe ndëshkimit

Interpretimet që janë sjellë në ajetet e mësipërme, janë interesante. Për popullin e Themudit thuhet "*taghije*", për popullin e Adit thuhet "*atije*", për popullin e Faraonit dhe të Profetit Lut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* është përdorur fjala "*rabieh*", ndërsa për popullin e Nuhut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* është përdorur fjala "*tegha el ma*". Të gjitha këto interpretime bartin në vetvete kuptimin: *rebelim* dhe *mosbindje*.

Kështu, këta popuj mohues, mohuan disa prej mirësive dhe begative të jetës së tyre, duke përfshirë këtu ujin dhe erërat, tokën dhe zjarrin.

Këto interpretime theksojnë faktin se ndëshkimet e kësaj bote dhe të Botës Tjetër janë mishërim i veprimeve tona, janë veprimet e qenieve njerëzore ato që kthehen tek ata.

Ajetet 13 – 17

فَإِذَا نُفِخَ فِي الصُّورِ نَفْخَةٌ وَاحِدَةٌ١٣ وَحُمِلَتِ الْأَرْضُ وَالْجِبَالُ فَدُكَّتَا دَكَّةً وَاحِدَةً١٤ فَيَوْمَئِذٍ وَقَعَتِ الْوَاقِعَةُ١٥ وَانْشَقَّتِ السَّمَاءُ فَهِيَ يَوْمَئِذٍ وَاهِيَةٌ١٦ وَالْمَلَكُ عَلَى أَرْجَائِهَا وَيَحْمِلُ عَرْشَ رَبِّكَ فَوْقَهُمْ يَوْمَئِذٍ ثَمَانِيَةٌ١٧

“Dhe kur t’i fryhet një herë Surit”,

“kur toka dhe malet të ngrihen lart e të thërrmohen me një goditje shkatërrimtare”,

“atëherë do të ndodhë Ngjarja e pashmangshme (Kiameti)**.”**

“Dhe do të çahet qielli, që atë ditë do të jetë i thyeshëm.”

“Engjëjt do të rrinë skajeve të tij, kurse tetë prej tyre do të mbajnë Fronin e Zotit tënd.”

Komentimi

Dita kur do të ndodhë ngjarja e madhe

Në vazhdim të ajeteve të kësaj sureje, që flisnin për çështjen e Ringjalljes dhe të Ditës së Kiametit, ajetet që do të komentojmë, flasin për ngjarjen e Ringjalljes. Ato e njohin njeriun me këtë të vërtetë të madhe, që do ta kenë të pranishme.

Në ajetin 13 thuhet: **"Dhe kur t'i fryhet një herë Surit."**.

Sikurse e kemi trajtuar edhe më herët, nga Kur'ani i Shenjtë kuptojmë se fundi i kësaj bote dhe fillimi i Botës Tjetër, nis papritur me një zë të madh gumëzhues, që ndryshe thuhet fryrja e Surit. Kjo vjen për shkak se në të kaluarën dhe në ditët e sotme, për të mbledhur dhe për të përgatitur ushtrinë, apo për t'i dërguar ushtarët që të pushojnë, përdornin borinë që binte me dy lloje melodish. Njëra ishte për t'i dërguar ushtarët të qetësoheshin dhe tjetra binte për t'i thirrur ata të rreshtoheshin. Duket sikur Krijuesi na thotë se çështja e mbarimit të kësaj bote dhe fillimi i Botës Tjetër, përballë fuqisë së Krijuesit është shumë e thjeshtë, sa t'i biesh borisë. Me një urdhër, në një çast, të gjithë qiellorët dhe tokësorët do të vdesin. Gjithashtu, me një urdhër tjetër, të gjithë do të veshin rrobën e jetës dhe bëhen gati të japin llogari.

Për sa i përket cilësive të Surit, bririt dhe se si do t'i fryhet, si dhe sa herë do t'i fryhet, është folur shumë në suren "Ez Zumer" dhe nuk është e nevojshme t'i përsërisim.[1]

1 Sure "Ez Zumer", në vazhdim të ajetit 68.

E vetmja gjë që do ta citojmë këtu, është se Surit, ashtu sikurse u tha më sipër, do t'i fryhet dy herë, një për vdekjen dhe e dyta për Ringjalljen.

Komentuesit kanë mendime të ndryshme për këto dy fryrje, se kush është e para, ajo e vdekjes apo e jetës, sepse ajetet që do të vijnë më vonë, disa përputhen më fryrjen e vdekjes dhe disa të jetës, pra, fryrja e Ringjalljes. Po t'i përmbledhësh ajetet, më shumë përputhen me fryrjen e parë, atë të fundit të kësaj bote.

Në ajetin 14 thuhet: **"Kur toka dhe malet të ngrihen lart e të thërmohen me një goditje shkatërrimtare."**.

Fjala *"deka"* sipas Ragibit, në librin "Mufredat", ka kuptimin: *tokë e shtrirë dhe e butë*. Për tokën që nuk është e butë apo nuk është e drejtë, duhet punuar dhe duhet plehëruar, në të shumtën e rasteve, përdoret kjo fjalë.

Në shumë fjalorë, shohim që fjala *"deka"* ka kuptimin: *godas dhe shkatërroj*. Nëse duam ta punojmë dhe ta sistemojmë si duhet tokën, në fillim e punojmë duke e goditur.[1]

Sidoqoftë, kjo fjalë në ajetin për të cilin po flasim, ka kuptimin: godas fort me njëra–tjetrën malet dhe tokën, në mënyrë të atillë, që të shkatërrohen menjëherë.

Në ajetin 15 thuhet: **"Atëherë do të ndodhë Ngjarja e pashmangshme** (Kiameti)**."**.

Ringjallja do të ndodhë. Jo vetëm toka e malet do të shkatërrohen e do të bëhen hi, por edhe qiejt, gjithashtu, do të thyhen. Ata do të jenë të dobët dhe të paqëndrueshëm.

1 "Ekrebul Mevarid", K. "Deka".

"Dhe do të çahet qielli, që atë ditë do të jetë i thyeshëm."

Sferat e mëdha qiellore nuk janë kursyer nga kjo ngjarje e tmerrshme. Ato do të thyhen, do të shkatërrohen. Edhe pse kanë fortësi dhe qëndresë të madhe, do të dobësohen e do të shkrihen si vaj. Këtë na e përshkruan Kur'ani, në ajetin 37 të sures "Er Rrahman": **"Veç kur të çahet qielli dhe të bëhet i kuq si trëndafili** (në Ditën e Kiametit)**!"**.

Me fjalë të tjera, toka dhe qielli i tanishëm do të shkatërrohen. Mbi rrënojat e tyre është ngritur një botë e re. Ajo botë do të jetë shumë herë më e mirë dhe më e përsosur se kjo botë.

"Engjëjt do të rrinë skajeve të tij."

Fjala "*urxha*" është shumësi i fjalës "*rexha*" dhe ka kuptimin: *në skaje* dhe *anash*.

Fjala "*meleke*", edhe pse është cituar në numrin njëjës, tregon numrin shumës. A thua në atë ditë, të gjithë engjëjt do të qëndrojnë si oficerë në skaje dhe do të jenë në pritje të urdhrit, për të kryer punën e tyre: **"Kurse tetë prej tyre do të mbajnë Fronin e Zotit tënd."**.

Këta do të mbajnë fronin. Edhe pse në ajet nuk ka ardhur drejtpërdrejt që do jenë engjëjt apo të tjerë që do të mbajnë fronin, në pamje të jashtme, ajeti tregon se do të jenë engjëjt, që do ta mbajnë fronin.

Gjithashtu, nuk është përcaktuar se janë tetë engjëj apo tetë grupe engjëjsh, të vegjël apo të mëdhenj. Sigurisht, në transmetimet e hadithit thuhet se në këtë periudhë, bartësit e fronit janë katër vetë (ose katër grupe). Në Ditën e Kiametit ata do të shtohen dy

herë më shumë. Ashtu sikurse thuhet edhe në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Ata sot janë katër vetë, kurse në Ditën e Kiametit do të shtohen me katër të tjerë dhe do bëhen tetë."*.[1]

Ka shumë pyetje për sa i përket fronit, se çfarë është ai dhe kush janë këta engjëj. Sigurisht që qëllimi i fronit ka të bëjë me një fron mbretëror, por nuk është fron fizik.

Më parë, kemi shpjeguar kuptimin e fjalës *"arsh"*. Kemi thënë se ka kuptimin e një "tërësie universale", që është froni i Zotit dhe engjëjt janë ekzekutuesit e urdhrit të Zotit.

Është për t'u habitur se në hadith thuhet se bartësit e fronit janë tetë, në fillim janë katër dhe në fund janë katër. Ata katër të parët janë: Nuhu, Ibrahimi, Musai, Isai *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)*, ndërsa katër të fundit janë: Muhammedi *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, Aliu, Hasani dhe Hysejni *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)*.[2]

Ky interpretim ka mundësi të bëjë fjalë për pozitën e ndërmjetësimit (shefaetit) të tyre për të parët dhe të fundit. Sigurisht, ndërmjetësimi është për personat që e meritojnë atë dhe janë të denjë për ndërmjetësim. Sidoqoftë, zgjerimi i kuptimit të fjalës *"arsh"* – *"fron"* e tregon këtë gjë. Duhet të kemi parasysh që, nëse bartësit e fronit janë tetë grupe, disa grupe mund të jenë prej engjëjve dhe disa grupe prej të Dërguarve, por të gjithë me urdhër të Zotit.

1 Tefsiri i "Ali bin Ibrahimit", vëll. 2, f. 384.
2 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 346.

Tek togfjalëshi *"feukehum"* mendohet se përemri *"hum"* – *"ata"*, kthehet te njerëzit ose tek engjëjt.

Janë dhënë mendime të ndryshme për këtë gjë, por, meqë fjalia përpara saj flet për engjëjt, ka mundësi që edhe fjala *"dhamir"* të kthehet tek engjëjt.

Kështu, në këtë mënyrë, engjëjt do t'i vijnë botës rrotull dhe sipër tyre (bëhet fjalë për pozitën e tyre) do të qëndrojnë bartësit e fronit. Mendohet se bartësit e fronit të Zotit janë personat më të përzgjedhur dhe më të mirë se engjëjt. Në këtë mënyrë përputhet ajo çka u tha më lart me hadithin e kaluar, se bartësit e fronit janë të Dërguarit dhe evlijatë.

Padyshim që ngjarjet që kanë të bëjnë me Kiametin, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me bartësit e fronit të Zotit, në atë ditë, nuk janë çështje që mund të qartësohen e të kuptohen për ne, banorët e kësaj bote të kufizuar. Ajo çka ne themi, është thjesht një pjesë e vogël që e shikojmë nëpërmjet ajeteve kur'anore. Ndryshe, të vërtetën e saj duhet të shikojmë.[1]

Është e rëndësishme të rikujtojmë se me fryrjen e Surit të parë, të gjithë personat që janë në qiell dhe në tokë, do të vdesin. Andaj çështja e bartësve të fronit ka të bëjë me fryrjen e dytë të Surit, kur të gjithë të ringjallen. Duke u bazuar në atë që kumtojnë ajetet më poshtë, bëhet e qartë se çështja lidhet me fryrjen e dytë.

1 Kuptimin e fjalës *"fron"*, duke u bazuar te fjalori dhe te Kur'ani i Shenjtë, e kemi diskutuar në ajetin 54 të sures "El Araf".

Ajetet 18 – 24

يَوْمَئِذٍ تُعْرَضُونَ لَا تَخْفَى مِنْكُمْ خَافِيَةٌ١٨ فَأَمَّا مَنْ أُوتِيَ كِتَابَهُ بِيَمِينِهِ فَيَقُولُ هَاؤُمُ اقْرَءُوا كِتَابِيَهْ١٩ إِنِّي ظَنَنْتُ أَنِّي مُلَاقٍ حِسَابِيَهْ٢٠ فَهُوَ فِي عِيشَةٍ رَاضِيَةٍ٢١ فِي جَنَّةٍ عَالِيَةٍ٢٢ قُطُوفُهَا دَانِيَةٌ٢٣ كُلُوا وَاشْرَبُوا هَنِيئًا بِمَا أَسْلَفْتُمْ فِي الْأَيَّامِ الْخَالِيَةِ٢٤

“Atë Ditë do të mbeteni zbuluar dhe asnjë fshehtësi e juaja nuk do të mbetet pa u shfaqur.”

“Ai, të cilit do t’i jepet libri i veprave të tij nga ana e djathtë, do t’u thotë (njerëzve të tij)**: ‘Ja, lexoni librin tim!’”**

“Vërtet, unë kam qenë i bindur se do të jepja llogari.”

“Kështu, ai do të ketë jetë të lumtur”,

“në një kopsht të lartë”,

“frutat e të cilit do t’i kapë lehtë.”

“(Njerëzve të tillë u thuhet)**: ‘Ju bëftë mirë, hani e pini për atë, që keni bërë në ditët e kaluara!’”**

Komentimi

Në ajetet që komentuam më lart, thamë se Suri do të fryhet dy herë. Në fryrjen e parë, të gjithë ata që janë gjallë, do të vdesin dhe i gjithë sistemi i universit do të shkatërrohet. Ndërsa në fryrjen e dytë të Surit e gjithë bota do të ringjallet. Njerëzit dhe engjëjt do të kenë një jetë të re. Ajetet e para na lajmërojnë për fryrjen e parë. Fundi i ajeteve na lajmëron për fryrjen e dytë, që është Ringjallja.

Në vazhdim të po këtij konteksti, në ajetin 18 thuhet: **"Atë Ditë do të mbeteni zbuluar dhe asnjë fshehtësi e juaja nuk do të mbetet pa u shfaqur."**.

Fjala *"taredhune"* vjen nga rrënja e fjalës *"erdh"* me kuptimin: të tregosh dhe të ofrosh dika, pavarësisht, nëse është një produkt që bëhet fjalë për tregtim, ose për ndonjë gjë tjetër. Sigurisht, njerëzit dhe të tjerët në këtë botë janë vazhdimisht në qendër të vëmendjes së All'llahut. Por kjo çështje do të shfaqet gjithnjë e më shumë në Ditën e Kiametit, për shembull, pavarësia e Zotit në univers është e përhershme, por më e dukshme është në atë Ditë.

Sifjalia: **"asnjë fshehtësi e juaja nuk do të mbetet pa u shfaqur"**, mund të tregojë që në atë ditë, secilit person do t'i dalin sheshit të fshehtat dhe sekretet e tij.

Kur'ani, për Kiametin, thotë: **"Ditën, kur do të zbulohen të fshehtat."**.[1] Në atë ditë do të do të zbulohen të gjitha, veprat e fshehura të njerëzve, që janë cilësi shpirtërore, karakteret dhe qëllimet. Kjo do të jetë një ngjarje shumë e madhe dhe, sipas disa

1 Sure "Et Târik", ajeti 9.

komentuesve, do të jetë më e madhe se sa shkërmoqja e maleve dhe shembja e maleve dhe se sa ndarja e sferave të qiellit. Do të jetë dita e skandalit të madh të punëkëqijve. Krenaria e pashembullt do të jetë e besimtarëve, është dita kur njeriu do të jetë i zhveshur nga veprat dhe sekretet e fshehura që do të shfaqen në atë skenë. Po, atë ditë, asnjë gjë nuk do mbetet e fshehtë nga qenia jonë.

Gjithashtu, mund të tregojë përfshirjen e dijes së Zotit në atë ditë mbi të gjitha gjërat. Komentimi i parë është më i përshtatshëm.

Ndaj në ndjekje të saj themi se: **"Ai, të cilit do t'i jepet libri i veprave të tij nga ana e djathtë, do t'u thotë** (njerëzve të tij)**: 'Ja, lexoni librin tim!'"**.[1]

Lumturia është futur thellë në lëkurën e tij dhe për të gjitha bekimet, suksesin dhe udhëzimet që Zoti i ka dhënë atij, të gjitha grimcat e qenies së tij, janë falënderuese. Dëgjohet thirrja e lavdërimit të Zotit.

Pastaj, duke përmbledhur nderin e tij më të madh me këtë fjalë, thotë: **"Vërtet, unë kam qenë i bindur se do të jepja llogari."**.

Fjala *"dhen"*, në fjali të tilla, vjen me kuptimin: *besim, bindje*. Ai dëshiron të thotë, se ajo çka më është dhënë, është për shkak të besimit në një ditë të tillë, është në të vërtetë. Të besuarit në dhënien e llogarisë, ia shton besimin shpirtit të devotshëm, bën që ai të jetë punëmirë dhe të largohet nga e liga, i jep siguri dhe ndjesinë e përgjegjësisë. Më i rëndësishmi është edukimi i njeriut.

1 Fjala *"haum"*, sipas gjuhëtarëve, ka kuptimin: *merreni*. Nëse do t'u drejtohemi meshkujve në shumës, do të thoshim: *"haum"*. Nëse do t'u drejtoheshim femrave në shumës, do të thoshim: *"haunu"*.

Në ajetet e tjera do të shohim një pjesë të shpërblimeve për personat që u fol më lart: **"Kështu, ai do të ketë jetë të lumtur."**.[1]

Edhe pse, me të njëjtën fjali, është thënë gjithçka. Për shpjegim të mëtejshëm, shtohet: **"në një kopsht të lartë"**.

Xhenneti është aq i lartë dhe sublim, sa askush nuk ka parë e nuk ka dëgjuar ndonjëherë për të, madje as nuk e kanë imagjinuar atë. Aty është Xhenneti, ku: **"frutat e të cilit do t'i kapë lehtë"**.

Nuk do të ketë asnjë vështirësi për t'i arritur pemët dhe frutat që ato mbartin. Në parim, të gjitha mirësitë, pa përjashtim, do të jenë të arritshme.

Ajeti 24 flet për dashurinë e Krijuesit për banorët e Xhennetit, duke u thënë: **"Ju bëftë mirë, hani e pini për atë, që keni bërë në ditët e kaluara!"**.

Po, këto bekime të mëdha nuk janë të panumërta, këto janë shpërblimet e veprave tuaja, që keni ruajtur dhe keni dërguar në botë për sot. Natyrisht, këto vepra duken të vogla, kur janë në horizontin e hirit dhe mëshirës Hyjnore.

1 Edhe pse kënaqësia dhe lumturia, në këtë rast, janë mbiemra për pronarët e kësaj jete, në ajetin më lart atë e ka vendosur mbiemër për vetë jetën, që thekson përfundimisht jetën e mbushur me plot kënaqësi.

Hulumtime

Një tjetër komentim për fjalën "arsh"

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë se qëllimi i përdorimit të fjalës *"arsh" – "fron",* te togfjalëshi **"bartësit e arshit** (fronit)**"**, ka të bëjë me dijen e Zotit. Këta bartës do të jenë tetë persona. *"Katër do jenë nga ne dhe katër nga ata që Zoti dëshiron."*.[1]

Në një hadith nga prijësi i besimtarëve Ali Ibn Ebu Talibi *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Bartësit e 'arshit' – 'fronit' do të jenë dijetarët dhe shkencëtarët, që Zoti ua ka mësuar dijen e Tij."*.[2]

Në një hadith të Imam Ali bin Musa Rizat *(Paqja e Zotit qoftë mbi të*!) lexojmë: *"Arshi, nuk është vetë Zoti, por është Emri i dijes dhe i fuqisë së Tij."*.[3]

Nga këto hadithe të transmetuara, kuptohet më së miri se *"arshi" – "froni",* përveç komentimit që kemi bërë më herët, ka edhe një tjetër kuptim, që është "cilësitë e Zotit", sikurse është Dija, Fuqia. Për këtë arsye, edhe bartësit e *"arshit" – "fronit"* të Zotit janë ata që bartin dijen e Tij. Sa më shumë i ditur të jetë njeriu apo engjëjt, aq më shumë do të ketë pjesë në bartjen e këtij *"arshit" – "fronit"* të madh.

Në këtë mënyrë, kjo e vërtetë bëhet më se e qartë që *"arshi" – "froni"* nuk ka ngjashmëri me fronin fizik dhe nuk është i

1 Tefsiri "Nuruth Thekalenj", vëll. 5, Hadithi 280, f. 406.
2 Tefsiri "Nuruth Thekalenj", vëll. 5, Hadithi 260, f. 405.
3 Po aty, Hadithi 27.

ngjashëm me fronet mbretërore. Sa herë që flitet dhe përdoret për Krijuesin, ai merr kuptime të ndryshme.

Pozita e Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe e shi'ave

Në transmetime të ndryshme thuhet se ajeti: **"Ai, të cilit do t'i jepet libri i veprave të tij nga ana e djathtë..."**, i adresohet Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, ose edhe Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, edhe shi'ave të tij.

Për nga citimi i shembujve, ky fakt, është i qartë, pa kufizuar kuptimin e vargut.

Përgjigjja e një pyetje

Në këtë rast mund të ngrihet një pyetje, e cila është: A mos vallë besimtarët, që sipas ajetit të mësipërm, thërrasin: "O njerëz të Mahsherit! Ejani dhe lexojeni librin e punëve tona!", nuk ka asnjë mëkat në librin e veprave të tyre?

Përgjigjen e kësaj pyetje mund ta nxjerrim në disa hadithe. Po përmendim një hadith nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "*Në Ditën e Kiametit, Zoti, së pari, do t'u rrëfejë robëve të Tij mëkatet e tyre, atëherë, Ai do të thotë: 'Unë i kam fshehur këto mëkate nga ju në këtë botë dhe do t'i fal ato sot!'. Atëherë u jep atyre (vetëm) librin e punëve të mira në dorën e djathtë.*".

Disa kanë thënë se në atë Ditë, Zoti do t'i shndërrojë "të këqijat" e besimtarëve në "virtyte". Në këtë rast, nuk do të këtë asnjë dobësi në tërë librin e veprave të tyre.

Ajetet 25 – 29

وَأَمَّا مَنْ أُوتِيَ كِتَابَهُ بِشِمَالِهِ فَيَقُولُ يَا لَيْتَنِي لَمْ أُوتَ كِتَابِيَهْ۲۵ وَلَمْ أَدْرِ مَا حِسَابِيَهْ۲۶ يَا لَيْتَهَا كَانَتِ الْقَاضِيَةَ۲۷ مَا أَغْنَى عَنِّي مَالِيَهْ ۲۸ هَلَكَ عَنِّي سُلْطَانِيَهْ۲۹

“Por ai, të cilit do t’i jepet libri i veprave të tij nga ana e majtë, do të thotë: ‘Ah, sikur të mos më ishte dhënë libri im’”,

“dhe të mos e kisha ditur llogarinë time!”

“Ah, të kisha qenë i vdekur (e të mos isha ringjallur)**!”**

“Pasuria ime nuk më solli dobi”,

“dhe më la fuqia ime!”

Komentimi

Ah, sikur vdekja të më merrte!

Në ajetet e mësipërme, flitej për besimtarët që do ta marrin librin në dorën e djathtë. Ata janë besimtarët, veprat e të cilëve u jepen në dorën e djathtë dhe, me krenari, ata i thërrasin njerëzit e

vendbanimit, duke i ftuar që të lexojnë veprat e tyre. Më pas ata zënë vend të përjetshëm në Xhennet.

Ajetet në fjalë, merren me të kundërtën e tyre, ata që do ta marrin librin e tyre në të majtë. Nëpërmjet krahasimit, bën situatën e të dyve mjaft të qartë.

Së pari, thuhet: **"Por ai, të cilit do t'i jepet libri i veprave të tij nga ana e majtë, do të thotë: 'Ah, sikur të mos më ishte dhënë libri im dhe të mos e kisha ditur llogarinë time! Ah, të kisha qenë i vdekur** (e të mos isha ringjallur)**!'"**.

Në atë gjyq të madh, në atë ditë të madhe, në atë ditë ku gjithçka do të shfaqet dhe të gjithë veprat do të dalin sheshit, zëri i tyre do të ngrihet lart dhe ata do të nxjerrin nga thellësia e zemrës së tyre një "Ah" përvëlues. Do të jetë kjo pasthirrmë keqardhje dhe zhgënjim për veprat e bëra. Do t'i luten Zotit t'u japë vdekjen dhe të shpëtojnë nga ai turpërim i madh.

E njëjta situatë përshkruhet edhe në ajetin 40 të sures "Nebeh": **"Me të vërtetë, Ne ju kemi paralajmëruar se është i afërt dënimi, Ditën, kur njeriu do të shohë se ç'kanë bërë duart e tij dhe, kur jobesimtari do të thotë: 'Ah, sikur të isha pluhur!'"**.

Për ajetin: **"Ah, të kisha qenë i vdekur** (e të mos isha ringjallur)**!"**, është edhe një tjetër komentim, ku thuhet se qëllimi i përdorimit të fjalës *"kadhieh"*, është vdekja e parë, që do të thotë: "Ah, sikur në atë kohë që vdiqëm, të mos ringjalleshim më!".

Kjo thuhet, kur ata, në këtë botë, nuk kishin gjë më të keqe se sa vdekjen, por në Ditën e Kiametit, ata shpresojnë e luten që ajo vdekje të vazhdojë.

Komentues të tjerë janë të mendimit se ka të bëjë me fryrjen e Surit të parë, të cilën e kanë interpretuar me fjalën *"karieh"*, që do të thotë: "Ah, sikur të mos kishte fryrje të dytë!".

Komentimi që bëmë në fillim, është më i përshtatshëm.

Pastaj shton se ky kriminel mëkatar, duke rrëfyer hapur, thotë: **"Pasuria ime nuk më solli dobi"**, në këtë ditë fatkeqe për mua.

Jo vetëm që pasuria nuk më bëri dobi mua dhe nuk më zgjidhi problemet, por as pushteti e salltaneti. Të gjitha u zhdukën: **"dhe më la fuqia ime!"**.

Përfundimisht, as pasuria nuk më bëri dobi, as pushteti e as pozita. Sot, me duar bosh dhe në kulmin e poshtërimit, qëndroj para drejtësisë hyjnore. Të gjitha mjetet e shpëtimit u prenë, pushteti e fuqia më vajtën dëm, e mbi të gjitha, shpresa m'u pre nga të gjitha anët.

Disa, fjalën *"sulltan"*, në këtë rast, e kanë marrë me kuptimin: *argument që është burim i shpëtimit të njeriut*, që do të thotë: Sot nuk kam asnjë argument apo arsyetim me të cilin mund t'i dal përpara Zotit e të mund të justifikoj çka kam vepruar.

Komentues të tjerë kanë thënë se qëllimi i përdorimit të fjalës *"sulltan"*, në këtë rast, nuk ka të bëjë me pushtetin dhe salltanetin, sepse të gjithë personat që janë në ferr, nuk janë pushtetarë të ndonjë vendi apo qyteti, por kjo fjalë ka të bëjë me pushtetin individual të njeriut ndaj egos dhe jetës së tij.

Por duke parë se shumë prej banorëve të Xhehennemit për veten e tyre kishin pushtet dhe ndikim në këtë botë , ose ishin prej të pasurve, kjo gjë nuk duket e drejtë.

Hulumtimi

Disa ngjarje mësimdhënëse

Këtu janë rrëfyer shumë histori, të gjitha theksojnë përmbajtjen e ajeteve të mësipërme. Këto ajete janë mësim për ata që mbështeten në pasuri dhe pozitë, për ata që janë përlyer me krenari, neglizhencë dhe mëkat, si për shembull: Në kohën kur Harun El Reshidi u sëmur rëndë në Khorasan, dha urdhër t'i vinte mjeku nga Tusi. Porositi që enën ku kishte vendosur urinën për t'ia analizuar, ta vinin në një rresht me të tjerë, që mjeku të mos e dinte se cila ishte e Kharun El Reshidit. Mjeku, pa e ditur se e kujt ishte shishja me urinën që do analizonte, tha: "Personi që e ka këtë shishe, t'i thoni të lërë amanetet, sepse fuqitë e tij janë dobësuar.".

Haruni, kur e dëgjoi këtë gjë, u shqetësua shumë dhe mbeti i pa shpresë për jetën e tij dhe nisi të lexojë këto rreshta poezie: "Bravo për doktorin dhe për ilaçin e tij! Nuk kam fuqi të mbrohem përballë vdekjes që është afër.

Po të kishte fuqi, atëherë pse vdes nga e njëjta sëmundje që më parë e shëronte?!".

Në atë kohë, ai u informua se njerëzit e kishin përhapur thashethemin e vdekjes së tij, Ai urdhëroi që ky thashethem të përhapet.

Kur ata sollën një kafshë me katër këmbë, tha: "Më vendos mbi të".

Papritur, gjuri i kafshës u dobësua.

Ai tha: "Largohuni nga unë, sepse thashethemi i përhapur thotë të vërtetën!"

Më pas porositi t'i sillnin disa qefinë. Ndër ta përzgjodhi një dhe tha: "Pranë këtij shtrati përgatisni për mua një varr".

Më pas vështroi varrin dhe recitoi këto ajete: **"Pasuria ime nuk më solli dobi dhe më la fuqia ime!"**.

Në atë ditë u largua nga kjo botë.[1]

Nga dijetari i madh Sheikh Behai, në po këtë libër, transmetohet se një burrë, në emër të pendesës, shpeshherë, i bënte vetvetes gjykimin. Një ditë prej ditësh, po llogariste jetën e tij. Në atë kohë ishte 60 vjeç. Ai përllogariti shumën e ditëve të viteve të tij dhe i dolën 21500 ditë. Ai tha: "Oh, i mjeri unë, nëse për secilën ditë të jetës do të kisha bërë më shumë se një gabim, shuma e gabimeve të mia do shkonte më shumë se 21500. A do mundem t'i dal përpara Zotit, me më shumë gabime!?".

1 "Sefinetul Bihar", vëll. 1, f. 523.

Në këtë çast ai tha një britmë dhe u shtri në tokë. Në këtë gjendje dha shpirt.[1]

Në librin "Jetime Thealebi" shkruhet kështu: "Kur iu afrua vdekja Edhed El Deules, gjuha e tij nuk recitonte gjë tjetër përveç këtyre ajeteve: **"Pasuria ime nuk më solli dobi dhe më la fuqia ime!".**

1 Po aty, f. 488.

Ajetet 30 – 37

خُذُوهُ فَغُلُّوهُ٣٠ ثُمَّ الْجَحِيمَ صَلُّوهُ٣١ ثُمَّ فِي سِلْسِلَةٍ ذَرْعُهَا سَبْعُونَ ذِرَاعًا فَاسْلُكُوهُ٣٢ إِنَّهُ كَانَ لَا يُؤْمِنُ بِاللَّهِ الْعَظِيمِ٣٣ وَلَا يَحُضُّ عَلَى طَعَامِ الْمِسْكِينِ٣٤ فَلَيْسَ لَهُ الْيَوْمَ هَاهُنَا حَمِيمٌ٣٥ وَلَا طَعَامٌ إِلَّا مِنْ غِسْلِينٍ٣٦ لَا يَأْكُلُهُ إِلَّا الْخَاطِئُونَ٣٧

"(Do të thuhet) **'Kapeni dhe lidheni në pranga'",**

"pastaj digjeni në zjarrin përvëlues",

"mandej lidheni në zinxhirë prej shtatëdhjetë kutësh",

"sepse ai, me të vërtetë, nuk ka besuar në All'llahun e Madhërishëm",

"dhe nuk është kujdesur për të ushqyer të varfrit e shkretë."

"Prandaj, ai sot këtu s'ka mik të afërt",

"e as ushqim tjetër, përveç qelbit",

"të cilin e hanë vetëm gjynahqarët."

Komentimi

Kapeni atë dhe lidheni me pranga!

Në ajetet e mëparshme u fol për ata që do ta marrin librin e veprave në të majtë të tyre, ku do të dëgjohen pështpërimat dhe vajtimet e tyre, që dëshirojnë vdekjen. Në ajetet në diskutim, do të flasim për një pjesë të dënimit të tyre në Ditën e Kiametit: **"**(Do të thuhet) **'Kapeni dhe lidheni në pranga.'"**.

Fjala *"guluv"*, vjen nga rrënja e fjalës *"gel"*, ashtu sikurse e kemi thënë edhe më parë, është një zinxhir që u vihej fajtorëve në duar dhe këmbë dhe u varej në qafë. Kjo gjë ishte shumë e dhimbshme dhe vuajtje e madhe për atë që e mbante.

Më pas thuhet: **"Pastaj digjeni në zjarrin përvëlues, mandej lidheni në zinxhirë prej shtatëdhjetë kutësh."**.

Fjala *"silsileh"* ka kuptimin: *zinxhir*. Kjo fjalë vjen nga rrënja e fjalës *"teslesel"* dhe ka kuptimin: *tronditje, lëkundje*. Gjatë ecjes, lëvizjes, zinxhirët tronditen dhe lëkunden.

Ndërsa kuptimi i togfjalëshit *"shtatëdhjetë kutë"* mund të jetë *"shumëzim"*, sepse numri shtatëdhjetë është një nga numrat që përdoret shpesh për të rritur apo për të zmadhuar shumësin. Mund të thuhet numri shtatëdhjetë. Sidoqoftë, në çdo rast, një zinxhir i tillë, i është mbështjell dhe i mbulon të gjithë kriminelët.

Disa komentues kanë thënë se këta zinxhirë të gjatë nuk janë për një person, por përkundrazi, secili grup është i lidhur me një zinxhir.

Përmendja e këtij dënimi, pasi përmendën prangat dhe zinxhirët në ajetet e mëparshme, është më e përshtatshme me këtë kuptim.

Fjala "*zeraeh*", ka ardhur me kuptimin e largësisë së bërrylit deri te maja e gishtit, që është përafërsisht gjysmë metri, e cila tek arabët përdoret si njësi matëse. Por disa janë të mendimit se ajo njësi matëse është ndryshe nga të tjerat, për shkak se çdo krah ka një largësi të vetën. Prandaj të gjithë të burgosurit e Xhehennemit do të lidhen me atë zinxhir.

Përsërisim edhe një herë: çështjet në lidhje me Ringjalljen, nuk mund të shprehen plotësisht në gjuhën tonë, banorët e botës dhe ajo që thuhet në ajete dhe hadithe është vetëm një përshkrim i saj.

Fjala "*thumme*", në këtë ajet, tregon se pas hyrjes në Xhehennem, do të lidhen me zinxhirë shtatëdhjetë pashë të gjatë. Ky është një dënim i ri. Për ata funksionon edhe një tjetër mundësi, se këta zinxhirë mund të jenë personalë dhe të përbashkët, për të hyrë në Xhehennem. Fjala "*thumme*", në të vërtetë, përdoret për të vonuar citimin.

Në dy ajetet e tjera tregon shkakun e vërtetësisë së këtij dënimi të vështirë: **"Sepse ai, me të vërtetë, nuk ka besuar në All'llahun e Madhërishëm."**. Pavarësisht se sa Profetë, shenjtorë dhe lajmëtarë të Zotit e ftuan atë drejt Zotit, ai nuk do ta pranonte ftesën. Në këtë mënyrë, lidhja e tij me Krijuesin do të ndërpritej në mënyrë të prerë. Gjithashtu, nuk është kujdesur për të uriturit dhe nuk ka kontribuar në pasurin e të varfërve: **"nuk është kujdesur për të ushqyer të varfrit e shkretë"**.

Në këtë mënyrë, ai e ka shkëputur lidhjen e tij më Zotin.

Kështu që shkaku kryesor i shkëputjes së marrëdhënies me Zotin mund të përmblidhet në këto dy faktorë, mosbindja dhe moskryerja e detyrave të ngarkuara nga Krijuesi.

Bashkëngjitja e togfjalëshit *"etamul miskin"* – *"ushqyerja e të varfërve"*, me fjalën *"iman"* –*"besim"*, tregon rëndësinë e jashtëzakonshme të këtij veprimi të madh njerëzor. Në të vërtetë është kështu, sepse sipas mendimit të disave, gjëja më e keqe në besim, është kufri, mosbesimi. Më e keqja nga veset morale, është koprracia.

Ajo çka e bën interesant është se nuk thotë "nuk e ushqeu", por thotë që nuk i nxiti të tjerët për të ushqyer nevojtarët, duke treguar se, së pari, nuk është problem të ushqesh një nevojtar dhe nuk e zgjidh problemin vetëm ushqyerja e një nevojtari. Por, me patjetër, duhet të ftojmë dhe të frymëzojmë edhe të tjerët që të veprojnë kështu, në mënyrë që ndihmesa të marrë përmasa publike.

Së dyti, ndoshta ka persona që vetë nuk e kanë mundësinë të ndihmojnë e të ushqejnë dikë, por të gjithë ne e kemi mundësinë për të ndryshuar të tjerët.

Së treti, personat koprracë janë të tillë që jo vetëm që nuk duan të jenë zemërgjerë, por as që e pëlqejnë zemërgjerësinë dhe mirësinë e të tjerëve.

Disa transmetojnë se ata i urdhëronin bashkëshortet e tyre që të përgatisnin më tepër ushqim, që t'ua jepnin nevojtarëve dhe thoshin se gjysmën e atij zinxhiri ta nxjerrim nga trupi nëpërmjet

besimit në Zot dhe gjysmën tjetër nëpërmjet dhënies së ushqimit për nevojtarët.[1]

Në ajetet 35–36 thuhet se, meqë besimi dhe veprat e tyre ishin të tilla, sot nuk kanë mik të dashur: **"Prandaj, ai sot këtu s'ka mik të afërt e as ushqim tjetër, përveç qelbit."**. Duhet pasur parasysh se dënimi është plotësisht në përputhje me veprat e tyre, sepse, për shkak të ndërprerjes së lidhjeve me krijesat, atje nuk ka miqësi të sinqertë. Gjithashtu, për shkak të mosdhënies ushqim nevojtarëve, atyre nuk u shkon tjetër në grykë, përveç qelbit dhe gjakut.

Ragibi, në librin "Mufredat", thotë se fjala *"gislijin"* është ujë që bie nga larja e trupit të jobesimtarit në Xhehennem. Por është e njohur se kjo fjalë ka kuptimin e qelbit dhe të gjakut që del nga trupi i banorëve të Xhehennemit.

Ndoshta edhe Ragibi ka pasur për qëllim këtë kontekst të fjalës.

Edhe interpretimi i fjalës *"team"* – *"ushqim"* ka të përshtatshëm këtë kuptim. Këtu lind pyetja: Në ajetin 6 të sures "El Gâshije" thuhet: **"Për ata nuk do të ketë tjetër ushqim, përveç ferrave helmuese."**.

Në ajetet 43-44 të sures "Duhân" lexojmë se ata do të ushqehen me një pemë me emrin Zekkum, pemë shumë e hidhur: **"Pema e Zekkumit do të jetë ushqim i gjynahqarit."**. Ushqim që hahet vetëm nga gjynahqarët. Kjo pemë e ka një të ngjashme në

1 Tefsiri "Ruhul Meani", vëll. 29, f. 51.

tokën *"tehame"*, e cila ka një qumësht të hidhur dhe djegës. Si mund të bëhet bashkimi i ajetit në fjalë me këto ajete që cituam?

Disa komentues kanë thënë se të tria fjalët: *dheri, zekumi* dhe *guslijini*, flasin për një çështje, për një pemë të tharë dhe të padëshiruar, që është ushqim për banorët e Xhehennemit.

Disa të tjerë thanë se banorët e Xhehennemit qëndrojnë në kate të ndryshme dhe secili ushqim është për secilin grup.

Disa të tjerë janë të mendimit se ushqimi i tyre është *zekkum* dhe *dherih*, ndërsa pija e tyre është *gislijin*. Interpretimi me fjalën *"team"* – *"ushqim"* nuk është term i panjohur pasi ai përmbledh edhe të pirët . Ajeti i fundit i diskutimit tonë thekson se këtë ushqim nuk e hanë të tjerë, përveç punëkëqijtë: **"të cilin e hanë vetëm gjynahqarët"**.

Disa komentuesit thanë se fjala *"khati"* – *"punëkeq"* përdoret për një person, që vazhdimisht shkon drejt punëve të ndaluara. Pra, edhe ky ushqim është për ata, që në mënyrë të qartë dhe arrogante, kanë zgjedhur rrugën e shirkut dhe të kufrit.

Hulumtim

Fillimi i vendosjes se shenjave te shkronjat e Kur'anit

Në një hadith të transmetuar thuhet se Sase'eh bin Suhan, një nga shokët e Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* tregon: "Një burrë arab erdhi pranë Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe e pyeti për ajetin: **"të cilin e hanë vetëm gjynahqarët"**.

Fjalën *"khatiun"* - *"punëkeq"* e lexoi *"khatun"* – *"hedh hapin"*. Andaj e pyeti se si do jetë puna, a do të ushqehen të gjithë kështu, se të gjithë, në një farë mënyre, e hedhin hapin për të mëkatuar.

Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* tha: *"O popull arab, leximi i drejtë është punëkëqijtë, mëkatarët."*.

Arabi i tha: "O Amirul Muminin, the të vërtetën, sepse All'llahu nuk dënon robërit që nuk bëjnë mëkat.".

Më pas, Imam Aliu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* u kthye nga Abu Asude, një njohës i mirë i gjuhës arabe dhe i thotë: *"Sot edhe joarabët janë bërë myslimanë nga gjuha arabe, kështu që përpiqu që ata ta korrigjojnë gabimin."*.

Abu Asudi, si e mori këtë urdhër, vendosi shenjat tek ajetet e Kur'anit.[1]

1 Tefsiri "Durrul Menthur", nga Xhelaludin Sujuti, vëll. 6, f. 263.

Ajetet 38 – 43

فَلَا أُقْسِمُ بِمَا تُبْصِرُونَ٣٨ وَمَا لَا تُبْصِرُونَ٣٩ إِنَّهُ لَقَوْلُ رَسُولٍ كَرِيمٍ٤٠ وَمَا هُوَ بِقَوْلِ شَاعِرٍ قَلِيلًا مَا تُؤْمِنُونَ٤١ وَلَا بِقَوْلِ كَاهِنٍ قَلِيلًا مَا تَذَكَّرُونَ٤٢ تَنْزِيلٌ مِنْ رَبِّ الْعَالَمِينَ٤٣

"Betohem për gjithçka që ju shihni",

"dhe për gjithçka që nuk e shihni",

"se ky (Kur'an) **është vërtet fjalë e** (kumtuar prej) **një të Dërguari të nderuar** (Muhammedit/*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*)**",**

"e nuk është fjalë poeti; sa pak që besoni!"

"Nuk është as fjalë e ndonjë falltari; sa pak që po reflektoni!"

"Ai është Shpallje e zbritur nga Zoti i botëve!"

"Sikur ai (Muhammedi/*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*)**, në mënyrë të rreme, të Na kishte veshur ndonjë fjalë."**

Komentimi

Ky Kur'an, është Fjala e Zotit

Pas diskutimeve në ajetet e mëparshme për Ringjalljen dhe fatin e besimtarëve dhe të jobesimtarëve, në këto ajete, diskutohet për Kur'anin e Shenjtë dhe Profetësinë, në mënyrë që diskutimi i Profetësisë dhe i Ringjalljes të plotësohet.

Në ajetet 38-39, All'llahu betohet: **"Betohem për gjithçka që ju shihni dhe për gjithçka që nuk e shihni."**.

Në gramatikën e gjuhës arabe, kur shkronja *"la"* vjen në të tilla raste, është e shtuar dhe vjen për të theksuar diçka.

Disa janë të mendimit se shkronja *"la"* ka edhe kuptimin e mohimit, që do të thotë: unë nuk betohem në këto gjëra, sepse, së pari, nuk është e nevojshme për këto betime; së dyti, betimi duhet të bëhet në Emër të Zotit.

Kjo thënie është e dobët. Kuptimi i saktë është kuptimi i parë, sepse në Kur'an shikojmë shumë betime që bëhen në Emër të Zotit.

Fjalia: "*Ma tubsirun"* dhe "*Ue ma la tubsirun"*, ka kuptim të gjerë, që përfshin gjithçka që shohin dhe nuk shohin qeniet njerëzore. Me fjalë të tjera, përfshin tërë universin e intuitës dhe të së fshehtës.

Janë dhënë mundësi të tjera për komentim e këtyre dy ajeteve, si për shembull: "*ma tubsirun"* është bota e krijimit dhe "*ue*

ma la tubsirun" është Krijuesi; mirësitë dhe begatitë e jashtme dhe të brendshme; njerëzit dhe engjëjt; trupat dhe shpirtrat; këtë botë dhe Botën e Përtejme.

Por, sikurse edhe e kemi cituar, gjerësia e kuptimit të këtyre dy interpretimeve, parandalon që kuptimi të kufizohet. Për këtë shkak, gjithçka që është dhe çfarë nuk është në horizont, përfshihet në këtë betim. Por përfshirja e tij me Zotin, duket e pamundur, sepse vendosja e Krijuesit pranë krijesës nuk është e përshtatshme, sidomos tek interpretimi me fjalën *"ma"*, e cila zakonisht përdoret për jo frymorët.

Gjithashtu, nga ky interpretim kuptohet më se miri se ajo çka njeriu nuk e sheh me sy, është e madhe. Edhe dija, edhe shkenca e sotme e vërteton këtë të vërtetë. Ndjesitë përfshijnë një rreth të kufizuar të qenieve, edhe atë që nuk është në horizontin e shqisave, qoftë ngjyrat, tingujt, shijet, vlerat, etj. Në grada është më e madhe.

Numri i përgjithshëm i yjeve që mund të shihet me sy të lirë, në të dy hemisferat e tokës, sipas përllogaritjes së shkencëtarëve, arrin përafërsisht në pesëmijë yje. Ndërkohë që yjet që nuk shihen me sy të lirë, i tejkalojnë miliardat. Valët e tingullit që veshi i njeriut është në gjendje t'i perceptojë, janë të kufizuara, ndërsa ka mijëra valë të tjera që veshi i njeriut nuk është në gjendje t'i dëgjojë.

Ngjyrat që ne mund të shohim, janë shtatë ngjyra të njohura, por sot është bërë e njohur se ekzistojnë ngjyra të panumërta ultravjollcë dhe infra të kuqe, por që sytë tanë nuk kanë aftësi t'i shohin.

Janë shumë gjallesa të vogla që nuk mund t'i shikojmë me sy të lirë. Ato janë aq shumë, saqë e kanë mbushur gjithë botën, ndonjëherë në një pikë uji ka me mijëra nga ato, kështu që sa e dhimbshme është që ne ta burgosim veten tonë në burgun e ndjenjave dhe të qëndrojmë të painformuar për ndjenjat, ose t'i mohojmë ato.

Bota e shpirtrave është një botë, që, me argumente racionale dhe me përvojë, është vërtetuar se është një botë më e gjerë se ajo e trurit tonë, kështu që si mund të qëndrojmë të bllokuar brenda shqisave?

Në ajetin tjetër, përmendet përfundimi dhe rezultati i këtij betim të madh: **"Ky** (Kur'an) **është vërtet fjalë e** (kumtuar prej) **një të Dërguari të nderuar** (Muhammedit */Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)***."**.

Pa dyshim që përmendja e fjalës *"resul"*, në ajet, i adresohet Profetit tonë *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe jo Xhebrailit, pasi ajetet që vijnë më poshtë, dëshmojnë qartë për këtë kuptim, edhe ku thuhet se kjo është fjala e Profetit të Shenjtë, ne e dimë se Kur'ani është Fjala e Zotit dhe Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është i dërguari i Tij. E gjithë kjo shprehje është bazuar në faktin e "misionit" të tij.

Gjithashtu, ne e dimë atë çka i Dërguari sjell. Fjala e Zotit përcillet nëpërmjet gjuhës së ndriçuar të të Dërguarit.

Më pas shton: **"nuk është fjalë poeti; sa pak që besoni!"**.[1]

1 Fjala *"kalilen"*, në këtë ajet dhe në ajetin në vazhdim, është mbiemër i fshehur.

Në ajetin në vazhdim thotë: **"Nuk është as fjalë e ndonjë falltari; sa pak që po reflektoni!"**.

Në të vërtetë, këto dy ajete mohojnë mendimet dhe thëniet e pahijshme që jobesimtarët dhe kundërshtarët ia vishnin të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ata ndonjëherë thoshin se ai është poet dhe se këto ajete janë poezitë e tij.

Gjithashtu, thoshin edhe se ai është fallxhor dhe këto që thotë, janë nga fallet e tij, sepse falltarët kishin lidhje me xhindet dhe shejtanët, në këtë mënyrë ata arrinin që të shfaqnin disa të fshehta.

Edhe Kur'ani tregon për të fshehtat dhe zbulon lajme të fshehta dhe ka një rregull të veçantë. Këtë shpifje ata ia vishnin të Dërguarit, ndërkohë që midis asaj që ata thoshin dhe Profetit, ka ndryshim si toka me qellin.

Disa komentues kanë transmetuar shkakun e zbritjes së këtyre dy ajeteve. Ai që ia mveshi këto gjëra Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pra, poet dhe falltar, ishte ose Ebu Xhehli, ose Akabe, ose Utbeh. Të tjerët, të frymëzuar nga këta, vazhduan t'i përsërisnin fjalët që ata thanë. Është e vërtetë që fjalët e Kur'anit janë në përputhje me njëra-tjetrën dhe kjo përputhje është e mrekullueshme, ta përkëdhel veshin dhe shpirtit i jep qetësi. Por kjo gjë nuk ka lidhje as me poezinë e as me fallin.

Zakonisht poezia është produkt i një imagjinate dhe ëndërrimi. Ajo shpreh ndjenjat e brendshme dhe emocionet e një personi. Për këtë arsye, ajo ka shumë ulje dhe ngritje. Ndërkohë që

Kur'ani është i bukur dhe tërheqës. Ai ka një përmbajtje plotësisht racionale. Edhe pse herë pas here bën parashikime për të ardhmen, këto parashikime nuk përfaqësojnë ndjenjat e Kur'anit. Po ashtu, në kundërshtim me lajmet e fallxhorëve, të gjitha ato që Kur'ani thotë, janë të vërteta, kanë ngjarë.

Fjalia: *"kalilen ma tuminun"* dhe *"kalilen ma tedhekerun"*, janë kritika dhe qortime për ata që këtë Shpallje qiellore e shikojnë me të gjitha shenjat e qarta, por ndonjëherë atë e quajnë poezi dhe ndonjëherë fall dhe ata besojnë shumë më pak.

Në fund të diskutimit të këtyre ajeteve, duke e theksuar faktin, thotë: **"Ai është Shpallje e zbritur nga Zoti i botëve!"**.

Andaj Kur'ani nuk është as poezi dhe as fall dhe as i ndërtuar nga mendja e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe as nuk është fjalë e Xhibrailit, por është Fjala e Zotit, që nëpërmjet Shpalljes i është zbritur të Dërguarit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në zemrën e tij të pastër.

Ky interpretim ka ardhur në 11 vende të ndryshme të Kur'anit të Shenjtë.

Ajetet 44 – 52

وَلَوْ تَقَوَّلَ عَلَيْنَا بَعْضَ الْأَقَاوِيلِ٤٤ لَأَخَذْنَا مِنْهُ بِالْيَمِينِ٤٥ ثُمَّ لَقَطَعْنَا مِنْهُ الْوَتِينَ٤٦ فَمَا مِنْكُمْ مِنْ أَحَدٍ عَنْهُ حَاجِزِينَ٤٧ وَإِنَّهُ لَتَذْكِرَةٌ لِلْمُتَّقِينَ٤٨ وَإِنَّا لَنَعْلَمُ أَنَّ مِنْكُمْ مُكَذِّبِينَ٤٩ وَإِنَّهُ لَحَسْرَةٌ عَلَى الْكَافِرِينَ٥٠ وَإِنَّهُ لَحَقُّ الْيَقِينِ٥١ فَسَبِّحْ بِاسْمِ رَبِّكَ الْعَظِيمِ٥٢

"Sikur ai (Muhammedi)**, në mënyrë të rreme, të Na kishte veshur ndonjë fjalë",**

"Ne do ta kapnim atë për dorën e djathtë",

"dhe me siguri që do t'ia prisnim damarin e qafës ",

"e askush prej jush nuk do të mund ta mbronte."

"Natyrisht, Kur'ani është përkujtesë për ata që i frikësohen Zotit!"

"Ne e dimë mirë se ka prej jush që e mohojnë atë."

"Ai është keqardhje për mohuesit."

"Ai është, pa dyshim, e vërtetë e pamohueshme."

"Prandaj, lartësoje Emrin e Zotit tënd të Madhërishëm!"

Komentimi

Nëse ai do të gënjente për Ne, nuk do t'i jepnim afat

Në vazhdim të diskutimeve për Kur'anin, në këto ajete, përmendet një argument i qartë për vërtetësinë e tij: **"Sikur ai** (Muhammedi)**, në mënyrë të rreme, të Na kishte veshur ndonjë fjalë, Ne do ta kapnim atë për dorën e djathtë dhe me siguri që do t'ia prisnim damarin e qafës e askush prej jush nuk do të mund ta mbronte."**.

Fjala *"ukavil"* është shumësi i fjalës *"ekval"* dhe shumësi i fjalës *"kuvl"*. Për këtë shkak, fjala *"ukavil"* është shumës. Në këtë rast, flet për fjalët e mashtruesve.

Fjala *"tekul"* vjen nga rrënja e fjalës *"tekulu"* dhe ka kuptimin*: fjalimet që njeriu i ndërton vetë dhe që nuk kanë vërtetësi*.

Interpretimi me: **"Ne do ta kapnim atë për dorën e djathtë"**, është për shkak se njeriu, kur kryen veprime me dorën e djathtë, ka më tepër fuqi, për këtë arsye është përdorur fjala *"jemin"* – *"e djathtë"*.

Disa komentues kanë dhënë mendime të ndryshme për komentimin e këtij ajeti, por për shkak se janë të panjohura dhe të papajtueshme, ne nuk i sollëm këtu.

Fjala: *"ve jetin"*, ka kuptimin *"arterie e zemrës"*. Është arteria kryesore që e transporton gjakun në të gjitha pjesët e trupit. Nëse ajo do të pritej, njeriu do të vdiste në çast. Kjo është mënyra më e shpejtë e dënimit që mund të veprohet për një person.

Disa komentues të tjerë kanë dhënë mendime të ndryshme për fjalën *"ue jetin"*. Disa thanë se është vena ku varet zemra, disa thanë se është vena që dërgon gjakun në mëlçi, ose vena kurrizore, që ndodhet në mes të shtyllës kurrizore.

Interpretimi i parë është më i sakti.

Fjala *"haxhziin"*, është shumësi i fjalës *"haxhez"* dhe ka kuptimin: *pengesë*.

Këtu na lind një pyetje: Nëse dikush gënjen dhe gënjeshtrën e bën për Zotin, Zoti atë e dënon dhe e shkatërron menjëherë. A duhet që gënjeshtarët e profetësisë të dënohen të gjithë njëherësh? Një gjë e tillë nuk ndodh, përkundrazi ka prej tyre që jetojnë gjatë, po ashtu edhe feja e tyre e rreme ka mbijetuar pas tyre.

Përgjigjja e kësaj pyetje sqarohet me një pikë: Kur'ani nuk thotë *"çdo pretendues"*, por thotë, nëse Profeti i Islamit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e bën këtë, d.m.th, një Profet që Zoti i ka dhënë mrekullinë, si dhe argumente për legjitimitetin e tij, nëse ai do të devijonte të vërtetën, atij nuk do t'i jepej as edhe një sekondë kohë, sepse ai do të bëhej burim i humbjes së Rrugës së Drejtë të njerëzve.[1]

Por ai që bën një pretendim të rremë dhe nuk ka ndonjë mrekulli, ose provë të qartë të legjitimitetit të tij, nuk ka nevojë që Zoti ta shkatërrojë menjëherë, sepse falsiteti i fjalëve të tij është i qartë për këdo që kërkon të vërtetën.

1 Kjo është e njëjta gjë që është përmendur dhe është dënuar në librat e shkencës së Kelamit, si vendosja e një mrekullie në një dorë të rreme.

Në këtë rast, bëhet e vështirë që pretenduesi i profecisë, duke qenë i shoqëruar me arsye dhe mrekulli, të devijojë përmes së vërtetës. Këtu bëhet e qartë se disa nga sektet e gabuara, për të provuar pretendimet e drejtuesve të tyre, iu ngjitën këtij ajeti. Kjo gjë është e gabuar, sepse pretendimet e rreme dhe çdo pretendues tjetër i rremë, duhet të jetë në gjendje që ta argumentojë këtë ajet me legjitimitetin e tij.

Ajeti tjetër përsëri vjen për të theksuar dhe për të kujtuar se çfarë është Kur'ani: **"Natyrisht, Kur'ani është përkujtesë për ata që i frikësohen Zotit!"**.

Për ata që janë të gatshëm të pastrohen nga mëkati dhe t'i bashkohen rrugës së vërtetë, për ata që kërkojnë të vërtetën dhe ata persona që nuk e kanë këtë nivel të devotshmërisë, sigurisht që nuk mund të përfitojnë nga mësimet e Kur'anit.

Ndikimi i thellë dhe i jashtëzakonshëm i Kur'anit, në këtë drejtim, është një tjetër shenjë e legjitimitetit dhe i vërtetësisë së tij.

Më pas thotë: **"Ne e dimë mirë se ka prej jush që e mohojnë atë."**.

Por ekzistenca e një mohuesi kokëfortë kurrë nuk do të parandalojë provën e paligjshmërisë së saj, sepse të devotshmit dhe kërkuesit e të vërtetës kujtohen, duke e përmendur atë dhe në të shikojnë shenjat e të vërtetës dhe ecin në rrugën e të vërtetës. Prandaj, ashtu sikurse për të përhapur dritën është e nevojshme një llambë, edhe njeriu, të paktën, të hapi sytë e tij, në mënyrë që të përfitojë nga drita e Kur'anit. Gjithashtu, duhet ta hapi zemrën për Kur'anin.

Në ajetin tjetër thuhet: **"Ai është keqardhje për mohuesit."**.[1] Ata sot mohojnë, por nesër në ditën e Jemul Dhuhur, shfaqjes dhe në ditën e Jeumul El Bervez dhe në të njëjtën kohë, në ditën e Jeumul Hesere, keqardhjes, do të kuptojnë se çfarë mirësie kanë humbur për shkak të kokëfortësisë dhe çfarë dënimi të madh dhe të dhimbshëm blenë për veten e tyre. Ditën që do të shikojnë vlerat e besimtarëve dhe veprat e tyre, do t'i krahasojnë ato, dhe nga keqardhja do t'i fusin gishtat e tyre në gojë dhe nga mërzia e madhe që kanë, do t'i kafshojnë me forcë ato: **"Atë Ditë keqbërësi do të hajë gishtat e duarve të veta, duke thënë: 'Ah, sikur ta kisha marrë Rrugën** (e drejtë) **me të Dërguarin!'"**. [2]

Më pas vjen ajeti që sqaron se askush nuk duhet të mendojë se dyshimi dhe frika apo mohimi i bërë nga jobesimtarët nuk është për shkak se Kur'ani ka paqartësi të koncepteve: **"Ai është, pa dyshim, e vërtetë e pamohueshme."**.

Përdorimi i sifjalisë: *"Hakkul Jekin"*, sipas mendimit të disa komentuesve, është si të shtosh diçka në shpirt, sepse vetë fjala *"hakk"* është si *"jekina"*. Dhe po ashtu, fjala *"jekina"* – *"siguria"* është si fjala *"hakku"* – *"e drejta"*. Kjo do të thotë se Kur'ani është siguri e pastër. Me fjalë të tjera: Siguria ka faza të ndryshme. Nganjëherë, ajo përftohet nga një arsye racionale, për shembull: nëse shohim tymin nga larg, kuptojmë se ka rënë zjarr.

Ndonjëherë jemi afër dhe i shikojmë flakët e zjarrit. Në këtë rast siguria bëhet më e fortë. Në këtë rast themi "vetë siguria".

1 Pra, kur të shohin se çfarë shpërblimi kanë humbur, që nuk e kanë ndjekur atë.
2 Sure "El Furkân", ajeti 27.

Ndonjëherë ne shkojmë edhe më afër dhe jemi pranë zjarrit, ose brenda në zjarr, kur e prekim atë ne digjemi. Sigurisht që kjo është një fazë më e lartë e sigurisë, e cila quhet *"Hakkul Jekin"*. Edhe pse ajeti i mësipërm thotë: **"Ai është, pa dyshim, e vërtetë e pamohueshme"**, ata e mohojnë, edhe pse e dinë se është e vërtetë.

Në përfundim, në ajetin e fundit të kësaj sureje thuhet: **"Prandaj, lartësoje Emrin e Zotit tënd të Madhërishëm!"**.

Vlen të përmendet se përmbajtja e këtij ajeti dhe i ajetit të mëparshëm, me një ndryshim të vogël, përmendet edhe në fund të sures "El Uaki'a", me ndryshimin se, këtu po flasim për Kur'anin e Shenjtë dhe përshkrimin e tij si "e vërteta e sigurisë", por në fund të sures "ngjarja" u referohet grupeve të ndryshme të të drejtëve dhe të pabesëve në Ditën e Kiametit.

Hulumtim

Vlen të përmendet se, në këto ajete, Kur'ani përshkruhet në katër përshkrime.

Së pari, thotë se këtë e ka zbritur Zoti i botëve. Më pas thotë se është kujtesë për të devotshmit. Më pas thotë se është burim keqardhje për jobesimtarët.

Në fund thotë se Kur'ani është hak i vërtetë e i sigurt, që, së pari, ka zbritur për të gjithë njerëzimin; së dyti, për të devotshmit;

së treti, ka të bëjë me jobesimtarët dhe, së katërti, ka të bëjë më njerëz të veçantë dhe të afërm.

O All'llah! Ti e di vetë se nuk ka gjë më të mirë se sa kapitali i sigurisë. Na jep ne besim dhe siguri, që të jetë shembull i drejtësisë dhe i sigurisë!

O All'llah! Dita e Kiametit është dita e keqardhjes. Na bëj të kemi të paktën keqardhje për pak bindje dhe mos na bëj prej atyre që kryejnë mëkate dhe e kanë braktisur bindjen.

O All'llah! Na e jep librin e veprave tona në dorën e djathë tonën dhe na fut në Xhennetet më të larta.

Amin Ja Rabil Alemin.

Surja “El Me’ârixh”

Zbritur në Mekë

44 ajete

Përmbajtja e sures "El Me'arixh"

Mes komentuesve të Kur'anit, është i njohur mendimi se surja "El Me'ârixh" është prej sureve që ka zbritur në Mekë. Sipas "Fehrest Ibn Nedijm", librit "Nadhmud Durrer" dhe "Tenasuku Ajati ue es Suver", në përputhje me atë që ka përcjellë Ebu Abdullah Ez Zenxhanij në "Tarikhul Kur'ani", kjo është surja e shtatëdhjetë e shtatë që ka zbritur në Mekë.

Por kjo nuk e pengon faktin që disa ajete të saj të kenë zbritur në Medine. Kjo çështje nuk i përket vetëm sures "El Me'arixh", sepse te shumë sure të Kur'anit, të zbritura në Mekë, ekziston një ajet apo disa ajete, të cilat kanë zbritur në Medine, ose e kundërta, disa sure medinase kanë ajete mekase.

Dijetari i shquar eruditi Eminij ka sjellë shembuj të shumtë në lidhje me këtë çështje, në librin e tij të njohur "El Gadijr".[1]

Ekzistojnë transmetime të shumta, që tregojnë se ajetet e para të kësaj sureje kanë zbritur në Medine. Ne, me ndihmën e All'llahut, do t'i komentojmë këto ajete.

Në këtë sure spikasin mjaft mirë karakteristikat e sureve mekase, si p.sh. tema në lidhje me parimet e fesë, veçanërisht Ringjallja dhe paralajmërimi i hipokritëve dhe i kundërshtarëve. Në përgjithësi, kjo sure ndahet në katër pjesë:

Pjesa e parë diskuton për ndëshkimin e shpejtë ndaj një personi, i cili i mohonte disa thënie të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*. Ajeti thotë: "Nëse është kjo që na thotë Muhammedi, është e vërteta ardhur prej Teje

[1] "El Gadijr", vëll. 1, f. 255-257.

(All'llahut), atëherë më dëno mua", ndërkohë zbritën tri ajetet e para të kësaj sureje.

Pjesa e dytë diskuton për veçoritë e Kiametit, premisat e tij dhe gjendjen e jobesimtarëve në atë Ditë të Madhe. (ajetet 4-18)

Pjesa e tretë e kësaj sureje shpalos vetitë e njerëzve të këqij dhe të mirë, cilësi të cilat i bëjnë ata banorë të Xhehennemit apo të Xhennetit. (ajetet 19–34)

Pjesa e katërt përfshin paralajmërimet që u bëhen hipokritëve dhe mohuesve, si dhe i kthehet edhe një herë tjetër çështjes së Ringjalljes me trajtimin e të cilës përfundon surja.

Mirësitë e leximit të sures "El Me'ârixh"

Në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Ai që e lexon suren 'El Me'ârixh', All'llahu i Madhëruar do ta shpërblejë me shpërblimin e atyre personave që janë të besueshëm, që mbajnë premtimin dhe të atyre personave që kujdesen për namazet e tyre."*.[1]

Në një hadith tjetër, të transmetuar nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet: *"Ai që e lexon gjithnjë suren 'El Me'ârixh', All'llahu i Madhëruar, në Ditën e Kiametit, nuk do ta marrë në pyetje për mëkatet që ka kryer, si dhe do ta vendosë atë në Xhennetin e Vet, së bashku me Profetin Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)."*.[2]

Është e qartë se ç'fiton njeriu nga leximi i kësaj sureje, nga leximi i shoqëruar me meditim dhe përsiatje e që më pas, plotësohet me praktikim. Pra, nuk mjafton vetëm leximi formal i saj.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 350.

[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10 f. 351.

Ajetet 1 - 3

بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

سَأَلَ سَائِلٌ بِعَذَابٍ وَاقِعٍ۝١ لِلْكَافِرِينَ لَيْسَ لَهُ دَافِعٌ۝٢ مِنَ اللَّهِ ذِى الْمَعَارِجِ۝٣

Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Dikush kërkoi një dënim të shpejtë."

"Për jobesimtarët askush nuk mund ta ndalojë atë (dënim)**"**

"(që vjen) **nga All'llahu, Zoti i Rrugëve të Ngjitjes."**

Shkaku i zbritjes

Shumë komentues të Kur'anit dhe transmetues të hadithit kanë transmetuar të njëjtën shkak të zbritjes. Ky shkak është cituar më poshtë dhe është i lidhur me kontekstet e ajeteve të sipërpërmendura.

Shkaku është ky: Në ditën e Gadijr Khumit, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, u emërua nga Profeti i Islamit si kalif dhe iu drejtua ymetit me këto fjalë: "*Prijësi i kujt jam Unë, edhe Aliu është prijës i tij.*". Nuk kaloi shumë kohë dhe kjo çështje u përhap në krahina dhe qytete. Një person, i quajtur Nu'man ibn Harith El Fehrij, erdhi te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i tha: "Ti na urdhërove ne, që të pohojmë shehadetin, njësimin e Zotit; Ti je i Dërguar i Zotit dhe ne dëshmuam për këtë. Më pas, na urdhërove për xhihad, Haxh, agjërim, namaz dhe dhënien e zekatit dhe ne i pranuam edhe këto, por nuk u mjaftove me kaq, derisa na e zgjodhe këtë djalosh të ri (duke treguar Imam Aliun) si pasardhësin tënd dhe the: 'Prijësi i kujt jam Unë, edhe Aliu është prijës i tij!'.

Vallë, a janë këto fjalë nga ana jote, apo nga ana e All'llahut?!

Profeti Muhammed *(Paqja e bekim i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu përgjigj: "*Betohem në All'llahun që nuk ka zot tjetër, përveç Tij, kjo është nga ana e All'llahut!*".

Ndërkohë, Numani iu kthye duke i thënë: "O Zot! Në qoftë se kjo që na thotë Muhammedi është e vërtetë prej Teje, atëherë lësho mbi ne gurë prej qiellit!".

Nga qielli i ra një gurë mbi kokë dhe ai vdiq. Në këtë kohë zbritën ajetet: **"Dikush kërkoi një dënim të shpejtë. Për jobesimtarët askush nuk mund ta ndalojë atë** (dënim)**."**.

Ajo që sapo u tha, është përmbajtja e një rrëfimi që është cituar në tefsirin "Mexhmaul Bejan", nga Abul Kasim Hasekanij me zinxhir transmetimi nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*.[1]

Po këtë ngjarje, e kanë transmetuar edhe shumë dijetarë të Ehli Synetit, me të njëjtën përmbajtje dhe me pak ndryshime, në komentimet e tyre të Kur'anit.

Eruditi El Eminij, e ka transmetuar atë në librin e tij "El Gadijr", prej tridhjetë dijetarëve të njohur të Ehli Synetit (duke përmendur zinxhirin e transmetimit (senedin) dhe tekstin (en nassu). Prej atyre janë:

Komentimi "Garibul Kur'an" i Hafiz Ebu Abid Herevij.

Komentimi "Shefaus Sudur" i Ebu Bekër Nakkash Musilij.

Komentimi "El Keshfu el Bejan" i Ebu Is'hak Tha'lebij.

Komentimi i Ebu Bekër Jahja (el Kurtubij).

"Tedhkiretun" i Ebu Is'hak Tha'lebij.

Libri "Feraidul Simtejn" i Hamuvij.

Libri "Durrarrul Simtejn" i shejkh Muhammed Zerendij.

Libri "Siraxhul Munijr" i Shemsudin Esh Shafiij.

Libri "Siretul Halebij".

Librin "Nurul Absar" i Sejjid Mu'min Sheblenxhij.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 352.

Librin "Sherhul Xhamiu es Sagir" i Sijutit, nga Shemsuddin Esh Shafij dhe të tjerë.[1]

Në pjesën dërmuese të librave të lartpërmendura, janë dhënë fakte konkrete që ajetet e sipërpërmendura kanë zbritur për këtë person. Ka mosmarrëveshje nëse ka qenë Harith ibn Nu'mani, apo Xhabir ibn Nedhr, apo Nu'man bin Harith El Fehrij. Por, siç e dimë, kjo gjë nuk dëmton në asnjë mënyrë thelbin e çështjes.

Sigurisht, disa komentues apo transmetues të haditheve, të cilët nuk e kanë shumë për zemër imametin e Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* kanë paraqitur kundërshtime të ndryshme për shkakun e zbritjes. Ne, me ndihmën e All'llahut, do ta trajtojmë atë në pjesën e fundit të diskutimit të komentit.

Komentimi

Dënimi i shpejtë

Surja "El Me'ârixh" fillon me thënien: **"Dikush kërkoi një dënim të shpejtë."**.

Ashtu siç e trajtuam, edhe kur diskutuam për shkakun e zbritjes, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ditën e Gadijr Khumit e emëroi Imam Aliun prijës të besimtarëve. Sapo u përhap lajmi në qytete dhe krahina,

[1] "El Gadijr", vëll. 1, f. 239–246.

ky kërkues i dënimit u zemërua. Erdhi te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i tha: "A është kjo nga ana jote, apo nga ana e All'llahut?!".

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* menjëherë iu përgjigj: *"Është nga ana e All'llahut."*.

Me të dëgjuar këtë, kërkuesi i dënimit u zemërua edhe më shumë dhe iu drejtua All'llahut me këto fjalë: "O Zot! Nëse kjo që na thotë Muhammedi është e vërtetë prej Teje, atëherë lësho mbi ne gurë prej qiellit!".

Krahas këtij komentimi, ekziston dhe një komentim tjetër, i cili është më gjithëpërfshirës se ky në kuptim. Thelbi i këtij interpretimi është ky: Një person e pyeti Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* se cilit njeri do t'i ndodhë ky dënim që ju po e thoni. Ajeti në vijim, i përgjigjet: **"Për jobesimtarët..."**.

Ka edhe një koment të tretë, i cili thotë se është vetë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ai që ia kërkoi All'llahut dënimin për jobesimtarët dhe pas kësaj kërkese zbriti ajeti.

Komentimi i parë, përveçse përputhet më shumë me ajetin, përputhet edhe me transmetime të ndryshme, të cilat janë përmendur për shkakun e zbritjes së ajetit në fjalë.

Më pas ajeti shton: **"Për jobesimtarët askush nuk mund ta ndalojë atë** (dënim)**,** (që vjen) **nga All'llahu, Zoti i Rrugëve të Ngjitjes."**

Fjala *"mearixh"* është shumësi i fjalës *"mi'rexh"* dhe nënkupton shkallët apo vendin nga ku ngjitemi lart. All'llahu i Madhëruar i ka caktuar pozita të ndryshme melekëve (engjujve) me anë të të cilave i afrohen Atij gradualisht. All'llahu e ka përshkruar me fjalën "El Mearixh".

Po, melekëjt janë urdhëruar për ndëshkimin e jobesimtarëve dhe të mëkatarëve. Melekët ishin ata që iu shfaqën Ibrahimit *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe e informuan: "Ne jemi përgjegjësit e zhdukjes së popullit të Lutit. Në mëngjes herët rrënuam qytetet e atij populli famëkeq dhe të lig po këta janë përgjegjësit për të dënuar mëkatarët e tjerë.".

Disa komentues, fjalën *"mearixh"* e kanë interpretuar si *"shkallë"* dhe *"gradë"*, kurse disa të tjerë, e kanë komentuar në kuptimin e *"engjëjve"*. Interpretimi i parë është më i përshtatshëm.

Hulumtim

Vërejtje të pabaza të justifikuesve

Në ajete kur'anore apo në hadithe që flasin rreth virtyteve të Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, disa komentues këmbëngulin që të mos i marrim në konsideratë ato, ose sjellin justifikime, për ta trajtuar çështjen me korrektësi të veçantë. Nëse këto virtyte do të ishin thënë për të tjerë, do t'i kishin pranuar me shpejtësi dhe pa asnjë shtjellim, qoftë dhe sipërfaqësor.

Një shembull i gjallë për këtë trajtim me dy standarde janë vërejtjet shtatë lloje, që i ka përmendur Ibn Tejmije në librin "Minhaxh Es Sunneh", kur flet për hadithet e transmetuara, të cilat shpjegojnë shkakun e zbritjes së këtyre ajeteve. Këto ajete, po i përmendim në mënyrë të përmbledhur:

1- Historia e Gadijr Khumit ka ndodhur pas kthimit të Profetit nga Haxhi i Lamtumirës dhe përkon me vitin e dhjetë të Hixhretit, ndërkohë që surja "El Me'ârixh" është prej sureve që ka zbritur në Mekë, pra, ka zbritur para Hixhretit.

Përgjigjja: Ashtu, siç e kemi cekur edhe më lart, shumë prej sureve quhen mekase, por disa prej ajeteve, siç shpjegojnë komentues të Kur'anit, kanë zbritur në Medine, ose ka ndodhur edhe e kundërta. Disa sure, që tradicionalisht njihen si sure medinase, kanë zbritur në Mekë.

2- Në këtë hadith thuhet: "Harith ibn Nu'mani, në vendin e quajtur *El Ebtah* erdhi te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.". Ne e dimë se El Ebtah është një luginë në Mekë. Pra, kemi një mospërputhje me ajetin, i cili thotë se ka zbritur pas historisë së Gadijrit.

Përgjigjja: Së pari, fjala *"el ebtah"* nuk është përmendur në të gjitha transmetimet, por vetëm në disa prej tyre. Së dyti, fjala *"el ebtah"* dhe *"bat'haun"* nënkupton çdo tokë prej rëre, e cila përmbytet. Në fakt, në tokat e Medines ka zona, që i quajnë *"el ebteh"* apo *"bet'haun"*, për të cilat është folur në poezitë arabe, ose në hadithe.

3- Është e njohur se ajeti: **"**(Kujtoje, gjithashtu) **kur ata thanë: Zoti ynë, nëse ky** (Kur'an) **është e Vërteta** (e zbritur prej Teje)**,**

atëherë lësho mbi ne shi gurësh nga qielli ose dërgona një ndëshkim të dhembshëm!",[1] pa dyshim që ka zbritur pas Luftës së Bedrit dhe ajo ka ndodhur shumë vite para historisë së Gadijr Khumit.

Përgjigjja: Nuk është prej nesh ai që thotë se shkaku i zbritjes së këtij ajeti është historia e Gadijr Khumit, por fjala është për ajetin: **"Dikush kërkoi një dënim të shpejtë."**.

Në ajetin 32 të sures "El Enfal" është një gjë, që Harith ibn Nu'man e përmendi në fjalimin e tij, por kjo nuk ka aspak lidhje me shkakun e zbritjes. Gjykimi i kësaj çështjeje bëhet duke u mbështetur në paragjykime, prandaj njeriu jokoherent shpeshherë mund të bëhet mohues i një çështjeje të vërtetë.

4- Kur'an i begatë thotë: **"Por All'llahu nuk do t'i ndëshkonte ata, përderisa ti ishe në mesin e tyre dhe, All'llahu nuk do t'i ndëshkojë ata, përderisa ata i kërkojnë falje Atij."**.[2]

Përgjigjja: Prej këtej vjen mesazhi se nuk ka dënim të përgjithshëm apo në grup për hir të Profetit të Islamit, por dënime të veçanta dhe individuale kanë zbritur gjithnjë për njerëzit. Ashtu siç e dëshmon edhe historia, që njerëz të shumtë, siç janë Ebu Zem'atu, Malik bin Talaletu, El Hakim ibn Ebi El Asi e të tjerë, u ndëshkuan për hir të mallkimit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ose për shkaqe tjera.

[1] Sure "El Enfal", ajeti 32.

[2] Shih, po këtë tefsir të Kur'anit, sure "El Enfal", ajeti 33, f. 154.

Por ajeti në fjalë, ka dhe komentime dhe interpretime të tjera, sipas të cilave, një argumentim i tillë nuk qëndron.

5- Nëse ky shkak i zbritjes do të ishte real, duhet të ishte njohur gjerësisht, si ngjarja e "Njerëzve të Elefantit". (Sure "El Fijl" flet rreth saj.)

Përgjigjja: Ky shkak i zbritjes është aq i njohur dhe i popullarizuar, saqë është rrëfyer së paku në tridhjetë libra të komentimeve dhe të haditheve, (siç e treguam dhe më lart). Por ne asesi nuk mund të bëjmë paralele midis një ngjarjeje individuale apo kolektive dhe pritshmërisë, që ndodhia në fjalë, të marrë përmasën e një ndodhie kolektive, si historia e "Njerëzve të Elefantit". Të habit qëndrimi me dy faqe ndaj këtyre dy ngjarjeve, sepse kjo e fundit kishte aspekte gjithëpërfshirëse. Një ushtri e madhe u përpoq të zhdukte Mekën dhe Qaben, kurse tregimi i Harith bin Nu'manit i përket vetëm një personi.

6- Nga ky hadith arrijmë në përfundim, se Harith ibn Nu'man pranonte parimet islame. Por si është e mundur, që një mysliman të dënohet me një dënim të tillë në kohën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*?

Përgjigjja: Edhe kjo vërejtje është fryt i një paragjykimi të rëndë. Hadithet e lartpërmendura, e qartësojnë më së miri se ai, jo vetëm që nuk i pranonte fjalët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por edhe ankohej nga Zoti pse e ka urdhëruar Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i ka dhënë një kumtim të tillë në lidhje me Aliun. Kjo konsiderohet si faza më e

rëndë dhe më e dënueshme e mosbesmit, e politeizmit dhe e daljes nga feja.

7- Në librat e njohur, si p.sh: "Istijab", është përmendur se nuk e hasim emrin e shokut të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, Harith ibn Nu'man.

Përgjigjja: Ajo që është përmendur në këtë libër dhe të ngjashëm me të, nën emrin "sahabë - shokë të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*" përfshin vetëm një pjesë të "sahabëve", p.sh. në librin "Usdul Gabeh", që është një prej librave më të rëndësishëm biografik rreth shokëve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* janë cituar vetëm shtatëmijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër persona, ndërkohë që ne e dimë se vetëm në Haxhin e Lamtumirës kanë qenë të pranishëm më shumë se njëqind mijë persona. Pra, shpeshherë, shumë prej shokëve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk u janë përmendur emrat në këto libra.[1]

[1] Për më shumë informacion, referohuni në librin "El Gadijr", vëll. 1, f. 247–266.

Ajetet 4 - 7

تَعْرُجُ الْمَلَائِكَةُ وَالرُّوحُ إِلَيْهِ فِي يَوْمٍ كَانَ مِقْدَارُهُ خَمْسِينَ أَلْفَ سَنَةٍ؛
فَاصْبِرْ صَبْرًا جَمِيلًا. إِنَّهُمْ يَرَوْنَهُ بَعِيدًا. وَنَرَاهُ قَرِيبًا.

"Tek Ai ngjiten engjëjt dhe Shpirti (Xhebraili)**, në një ditë që zgjat sa pesëdhjetë mijë vjet."**

"Prandaj, duro, me durim të hijshëm."

"Ata e mendojnë atë (dënim) **të largët."**

"Kurse Ne e shohim të afërt."

Komentimi

Një ditë që zgjat sa pesëdhjetë mijë vjet

Më sipër treguam për dënimin në këtë botë të personit që kishte kërkuar dënimin e All'llahut. Në këto ajete do të flitet rreth Ringjalljes dhe dënimit në Botën Tjetër të mëkatarëve. Këto dënime do të ndodhin Atë Ditë. Ajeti 4 thotë: **"Tek Ai ngjiten engjëjt dhe Shpirti** (Xhebraili)**, në një ditë që zgjat sa pesëdhjetë mijë vjet."**.

Pa dyshim që me togfjalëshin **"ngjiten engjëjt"**, nuk duhet kuptuar ngjitja fizike, trupore, por ngjitja shpirtërore. Pra, duhet kuptuar se ata nxitojnë për të arritur te Zoti dhe Atë Ditë, që është Dita e Kiametit, janë të gatshëm të pranojnë urdhrat dhe për t'i zbatuar ato. Në komentimin e ajetit 17 të sures "El Hakka" thuhet pothuaj e njëjta gjë, pra, kuptimi i fjalisë: **"engjëjt qëndrojnë në skajet e tij..."**, qartëson se Atë Ditë engjëjt e Zotit qëndrojnë përreth qiejve dhe janë të gatshëm të zbatojnë çfarëdolloj urdhri.[1]

Kuptimi i fjalës *"ruh"* është *"më i madhi i engjëjve"*. Më këtë kuptim është përmendur kjo fjalë edhe në suren "El Kadr": **"...me lejen e Zotit të tyre** (atë natë) **të zbresin engjëjt dhe shpirti** (Xhibrili) **për secilën çështje."**.[2]

Sigurisht që fjala *"ruh"* ka kuptime të ndryshme dhe secili kuptim merr konotacione të caktuara kuptimore, në përputhje me dëshmitë ekzistuese. Kuptimi i konceptit *"Shpirti i njeriut"*, shpirti në kuptimin e Kur'anit dhe shpirti në kuptimin e "shpirtit të shenjtë", ose në kuptimin e "engjëllit të Shpalljes", buron nga kuptimi i fjalës *"ruh"* - *"shpirt"*, e cila është përmendur dhe në vende të tjera në Kur'an.

Togfjalëshi **"pesëdhjetë mijë vjet"**, përdoret për të treguar sa zgjat ajo ditë, sipas matjes së kohës në këtë botë. Ky fakt nuk bie në kundërshtim me atë që është sqaruar në ajetin 5 të sure "Es

[1] Janë dhënë komentime të tjera në lidhje me togfjalëshin **"ngjiten engjëjt"**. Asnjë nuk duket i përshtatshëm, si p.sh. thuhet se kjo frazë synon "zbritjen" e engjëjve, që nga fillimi i botës deri në përfundim të saj. Jeta e të gjithë botës, në total është 50 mijë vite. Ajetet në vijim na e bëjnë të qartë, që thelbi i diskutimit është në lidhje me "Ditën e Kiametit" dhe jo kjo botë. (Kini kujdes!)

[2] Sure "El Kadr", ajeti 4.

Sexhde", ku shuma e një ditë është përcaktuar njëmijë vjet. Edhe në hadithe të tjera është thënë se në Kiamet ka "50 vendqëndrime" dhe në çdo "vendqëndrim" koha zgjat njëmijë vite.[1]

Disa komentues të tjerë, kanë pranuar dhe mundësinë që këta kufij kohorë vlejnë për kriminelët, për mëkatarët dhe jobesimtarët, prandaj në hadithin e transmetuar nga Ebu Said El Khuderij, thuhet: "Pas zbritjes së këtij ajeti, një person pyeti: 'O i Dërguar i Zotit, sa e gjatë është ajo ditë?'

Profeti iu përgjigj: *'Betohem në Atë që ka shpirtin tim në dorë! Ajo Ditë është e lehtë për besimtarin, më e shkurtër se sa një namaz i obligueshëm, që e fal në këtë botë.'"*.[2]

Ajeti në vijim i drejtohet Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i thotë: **"Prandaj, duro, me durim të hijshëm."**.

Togfjalëshi "*sabrun xhemijlun"* është përdorur me kuptimin e durimit të hijshëm dhe të mirë. Ai është durim dhe qëndrueshmëri që karakterizohet nga vazhdimësia, mosrënia në dëshpërim, stresimi dhe mos shoqërimi me rënkime, nxitje etj, përndryshe nuk do të quhet durim i hijshëm dhe i qëndrueshëm.[3]

Më pas ajetet 6-7 thonë: **"Ata e mendojnë atë** (dënim) **të largët, kurse Ne e shohim të afërt."**.

---

[1] Ky hadith është transmetuar nga Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* në "Emali Shejkh". (Ngjashëm me transmetimin e "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 413.)

[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 353 dhe tefsiri "Kurtubij", vëll. 10, f. 6761.

[3] Rreth "Sabrun Xhemijlun" është dhënë më shumë shpjegim në vëll. 9, f. 351 të po këtij tefsiri, në tregimin e Jakubit dhe Jusufit *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)*.

Ata as që nuk e besojnë që do të vijë një ditë e tillë, për të marrë në pyetje të gjitha krijesat e kësaj bote. Në këtë llogari do të llogariten madje dhe veprat dhe thëniet më të vogla të njerëzve. Kjo do të ndodhë në një ditë që do të zgjasë sa pesëdhjetë mijë vjet të kësaj bote. Por ata, në realitet, nuk e kanë njohur Zotin e vet dhe kishin dyshime në fuqinë e Tij.

Ata pohojnë: "A vërtet do të ringjallen kockat tona, pasi të jenë kalbur dhe të veshin 'rrobat e jetës' në trupin e tyre dhe toka të mblidhet dhe një herë tjetër, ndërkohë që çdo grimcë e saj është e shpërndarë në çdo cep? (ashtu siç janë cituar dhe në vende të tjera në Kur'an). A është e pranueshme që një ditë të zgjasë pesëdhjetë mijë vite?!".

Shkencërisht, tashmë është provuar se përmasa e ditës, në çdo sferë të sferave qiellore, ndryshon me sferat e tjera (planetët rrotullohen në kohëzgjatje të ndryshme rreth orbitës së tyre), sepse çdo sferë rrotullohet një herë rreth boshtit të saj, kështu që dita në Hënë është në përmasën e dy javëve në Tokë. Ata madje pohojnë se me kalimin e kohës, ka gjasa që Toka ta reduktojë shpejtësinë e lëvizjes së saj dhe një ditë në Tokë do të zgjasë sa një muaj, një vit ose me vite të tëra.

Nuk themi se Dita e Kiametit është e tillë, por po themi se një ditë mund të zgjasë sa pesë mijë vite tokësorë. Kjo nuk është një gjë e çuditshme.

Ajetet 8 - 18

يَوْمَ تَكُونُ السَّمَاءُ كَالْمُهْلِ٨ وَتَكُونُ الْجِبَالُ كَالْعِهْنِ٩ وَلَا يَسْأَلُ حَمِيمٌ حَمِيمًا١٠ يُبَصَّرُونَهُمْ يَوَدُّ الْمُجْرِمُ لَوْ يَفْتَدِي مِنْ عَذَابِ يَوْمِئِذٍ بِبَنِيهِ١١ وَصَاحِبَتِهِ وَأَخِيهِ١٢ وَفَصِيلَتِهِ الَّتِي تُؤْوِيهِ١٣ وَمَنْ فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا ثُمَّ يُنْجِيهِ١٤ كَلَّا إِنَّهَا لَظَى١٥ نَزَّاعَةً لِلشَّوَى١٦ تَدْعُو مَنْ أَدْبَرَ وَتَوَلَّى١٧ وَجَمَعَ فَأَوْعَى١٨

"Atë Ditë qielli do të bëhet si llumi i vajit."

"E malet do të bëhen si lesh i shprishur."

"Shoku s'do të pyesë për shokun."

"Edhe pse do të vihen të shohin njëri-tjetrin. Për të liruar veten nga dënimi i asaj dite, fajtori do të sakrifikonte me gjithë qejf fëmijët e vet."

"Edhe gruan, edhe vëllanë e vet."

"Edhe farefisin, që i gjendej pranë (në jetën e Tokës)**."**

"Si dhe të gjithë ata që gjenden në faqe të Tokës, nëse kjo do të mund ta shpëtonte."

"Por jo, (fajtori do të hidhet në zjarr)**! Ai është zjarr flakërues."**

"Që e shkul (dhe e djeg) **krejtësisht skalpin e kokës."**

"Ai thërret këdo që (i) **ka kthyer shpinën e** (i) **është larguar** (besimit)**."**

"Dhe që ka grumbulluar (pasuri) **dhe e ka fshehur."**

Komentimi

Dita kur asnjë mik nuk pyet për mikun

Këto ajete plotësojnë diskutimet e ajeteve të kaluara në lidhje me Ditën e Gjykimit dhe Kiametin, duke dhënë një shpjegim dhe sqarim më të plotë. Ajetet 8-9 thonë: **"Atë Ditë qielli do të bëhet si llumi i vajit e malet do të bëhen si lesh i shprishur."**.

Fjala *"el muhlu"* është përdorur me kuptimin e *metalit të shkrirë, si bakri, floriri, e të tjerë.* Ndonjëherë përdoret edhe me kuptimin e *llumit të vajit*. Këtu përshtatet më shumë me kuptimin e parë, edhe pse nuk ndryshojnë shumë nga njëra-tjetra.

Fjala *"el ihnu"* është përdorur me kuptimin e *leshit të shprishur me ngjyrë*.

Po, Atë Ditë, qiejt do të shpërbëhen dhe do të shkrihen, kurse malet do të shtypen. Më pas, me anë të erës së fuqishme, do të shpërndahen në hapësirë si lesh i shprishur, të cilin era e fortë e mbart me vete. Meqenëse malet kanë ngjyra të ndryshme, është krahasuar me leshrat e ngjyrosur. Pas këtij shkatërrimi, do të

krijohet një botë e re dhe njerëzit do ta fillojnë nga fillimi jetën e tyre të re.

Kur të ndodhë Ringjallja në atë botë të re, nga llogaridhënia e njerëzve për veprat që kanë kryer, do të krijohet një klimë e tmerrshme. Secili do të mendojë vetëm për veten e vet: **"Shoku s'do të pyesë për shokun."**.[1]

Secili mendon të shpëtojë veten e tij, ashtu siç është thënë dhe në suren "Abese", në ajetin 37: **"Atë Ditë secilit njeri i mjafton çështja e vet."**.[2]

Nuk është se aty nuk i njohin shokët e ngushtë, madje qëllimisht do t'ua tregojnë shokët e ngushtë, por secili do të jetë i zënë me çështjet e veta: **"Edhe pse do të vihen të shohin njëri-tjetrin."**.[3]

Pra, paniku dhe trishtimi Atë Ditë është aq i madh, saqë nuk ka se si të mendosh për tjetrin.

---

[1] Fjala *"hamijm"*, ashtu siç e kemi cekur edhe më lart, në thelb është në kuptimin e *"ujit të nxehtë dhe përvëlues"*. Më pas është përdorur dhe në lidhje me *"shokun e ngushtë dhe shumë të dashur"*.

[2] Për ajetin e lartpërmendur, janë dhënë dhe komentime të tjera, si p.sh, askush nuk do të pyesë për gjendjen e tjetrit, sepse gjendja e secilit është e qartë që në pamjen e jashtme të tyre. Ajo që është e qartë, a ka nevojë për shpjegim? Ose është thënë se askush nuk dëshiron nga tjetri, që ai të pranojë përgjegjësinë e veprave të veta, sepse është e papranueshme. Komentimi i parë është më i saktë.

[3] Edhe pse fjala *"hamijm"*, në të dy rastet, është dhënë në numrin njëjës, të dy përemrat te fjala *"jubs'serunehum"* janë në numrin shumës, sepse tregojnë kuptimin e gjinisë.

Në vazhdim të përshkrimit të asaj skene të tmerrshme, ajeti shton: **"Për të liruar veten nga dënimi i asaj dite, fajtori do të sakrifikonte me gjithë qejf fëmijët e vet."**.

Jo vetëm fëmijët e vet, por edhe bashkëshorten, edhe vëllanë e vet. Ajeti thotë: **"Edhe gruan, edhe vëllanë e vet."**.

Po ashtu, për të shpëtuar nga ai dënim, është gati të sakrifikojë edhe familjen, edhe farefisin dhe këdo që e pati përkrahur. Ajeti thotë: **"Edhe farefisin, që i gjendej pranë** (në jetën e Tokës)**."**.

Të gjithë njerëzit që jetojnë në tokën e kësaj bote, është gati t'i sakrifikojë vetëm që të gjejë shpëtim për veten. Ajeti shton: **"Si dhe të gjithë ata që gjenden në faqe të Tokës, nëse kjo do të mund ta shpëtonte."**.

Atë Ditë, dënimi i All'llahut do të jetë aq i tmerrshëm, saqë njeriu, për të shpëtuar veten e tij, është i gatshëm të sakrifikojë njerëzit më të dashur të kësaj bote, përfshirë: fëmijët, vëllezërit, gruan, farefisin dhe shokët e ngushtë. Nuk mjaftohet vetëm me kaq, por madje dëshiron t'i sakrifikojë të gjithë njerëzit që gjenden në faqen e kësaj toke.

Fjala *"jeued'du"* rrjedh nga fjala *"ud'dun"* dhe është përdorur me kuptimin e *"pëlqimit"* të shoqëruar me *"dëshirën"*. Sipas Ragibit, kjo fjalë përdoret në secilën prej këtyre dy kuptimeve.

Fjala *"jeftedi"* rrjedh nga fjala *"el feda"* dhe është përdorur me kuptimin e *mbrojtjes së vetes nga fatkeqësitë dhe problemet me anë të flijimit të një gjëje*.

Fjala *"el fesijletu"* është përdorur me kuptimin e *familjes dhe të farefisit*, të cilëve u përket njeriu.

Fjala *"tu'uihi"* rrjedh nga fjala *"el ijvau"* dhe është përdorur me kuptimin e *bashkimit të një gjëje me një gjë tjetër*. Më pas është përdorur edhe në kuptimin e *ofrimit të mbështetjes*.

Disa komentues të Kur'anit, pohojnë se fjala *"thum'me"* në sifjalinë *"thum'me junxhihi"* - **"nëse kjo do të mund ta shpëtonte"**, e bën të qartë se ata e dinin që këto sakrifica janë pothuajse të paefektshme, sepse fjala *"thum'me"*, zakonisht, përdoret për të treguar një veprim të ngadaltë dhe të largët.

Por duke iu përgjigjur gjithë këtyre dëshirave dhe shpresave, ajeti thotë se kurrë nuk do të jetë kështu, kështu që nuk do të pranohet asnjë shpagim dhe shfajësim: **"Por jo,** (fajtori do të hidhet në zjarr)**! Ai është zjarr flakërues, që e shkul** (dhe e djeg) **krejtësisht skalpin e kokës."**.

Fjala *"ledha"* do të thotë *"flakë e pastër e zjarrit"*. Këtë kuptim ka edhe njëri nga emrat e Xhehennemit. Edhe në këto ajete ka gjasa që kjo fjalë të përdoret me të dy kuptimet.

Kurse fjala *"nez'zaetun"* është përdorur në kuptimin e diçkaje që ndan në mënyrë të përsëritur.

Fjala *"sheua"* do të thotë ana e diçkaje si *dora, këmba dhe dy anët e trupit.* Ndonjëherë është përdorur edhe në kuptimin e pjekjes së mishit. Por këtu është përdorur me kuptimin e parë, sepse dihet që zjarri, në fillim djeg anët dhe sipërfaqen e diçkaje dhe pastaj të tërën.

Disa komentues të ajeteve kur'anore, në rastin konkret, fjalën "*sheua"* e kanë interpretuar si lëkura e trupit. Komentues të tjerë, si lëkura e kokës, kurse një grup tjetër, si mishin e nyjës së këmbës. Të gjitha këto kuptime, përmblidhen në kuptimin e gjerë, për të cilin diskutuam më sipër. Por, çuditërisht, me gjithë këto fatkeqësi dhe vuajtje, këtu nuk ka vdekje.

Më pas, ajetet 17-18 përmendin njerëz që janë të përfshirë nga ky zjarr: **"Ai thërret këdo që** (i) **ka kthyer shpinën e** (i) **është larguar** (besimit)**, dhe që ka grumbulluar** (pasuri) **dhe e ka fshehur."**.

Në këtë mënyrë, ky zjarr flakërues, me fuqinë e tërheqjes, thërret dhe fton nga vetja ata njerëz që ia kanë kthyer shpinën besimit dhe nuk kanë hequr dorë nga mashtrimi ndaj All'llahut dhe të Dërguarit. Fton ata njerëz që gjithnjë kanë qenë të zënë me grumbullimin e pasurisë, haram, apo hallall qoftë, pa i kushtuar vëmendje të drejtës së të varfërve apo pa e ditur fare filozofinë e kësaj begatie hyjnore të mallit dhe të pasurisë.

Ajetet 19 – 28

إِنَّ الْإِنْسَانَ خُلِقَ هَلُوعًا١٩ إِذَا مَسَّهُ الشَّرُّ جَزُوعًا٢٠ وَإِذَا مَسَّهُ الْخَيْرُ مَنُوعًا٢١ إِلَّا الْمُصَلِّينَ٢٢ الَّذِينَ هُمْ عَلَى صَلَاتِهِمْ دَائِمُونَ٢٣ وَالَّذِينَ فِي أَمْوَالِهِمْ حَقٌّ مَعْلُومٌ٢٤ لِلسَّائِلِ وَالْمَحْرُومِ٢٥ وَالَّذِينَ يُصَدِّقُونَ بِيَوْمِ الدِّينِ٢٦ وَالَّذِينَ هُمْ مِنْ عَذَابِ رَبِّهِمْ مُشْفِقُونَ٢٧ إِنَّ عَذَابَ رَبِّهِمْ غَيْرُ مَأْمُونٍ٢٨

“Vërtet që njeriu është krijuar i paqëndrueshëm; ”

“kur atë e godet e keqja, ai ligështohet fort;”

“por, kur i bie e mira, ai bëhet koprrac.”

“Përjashtim bëjnë ata që falen,”

“e që janë të vazhdueshëm në faljet e namazeve të tyre;”

“e që caktojnë një pjesë të pasurisë së tyre;”

“për lypësin dhe për nevojtarin;”

“e që besojnë në Ditën e Llogarisë (Gjykimit)**;”**

“e që frikësohen nga dënimi i Zotit të tyre;”

"vërtet që askush nuk është i sigurt prej dënimit të Zotit të vet;"

Komentimi

Vetitë e njerëzve të merituesheëm

Pas ilustrimit të një prej torturave të Kiametit, vjen radha për të përshkruar vetitë e njerëzve jobesimtarë dhe besimtarë, derisa të bëhet e qartë, se pse disa njerëz janë në grupin e të shpëtuarve dhe disa të tjerë në mesin e të ndëshkuarve.

Ajetet 19-21 thonë: **"Vërtet që njeriu është krijuar i paqëndrueshëm: kur atë e godet e keqja, ai ligështohet fort, por, kur i bie e mira, ai bëhet koprrac."**.

Disa komentues të ajeteve kur'anore dhe gjuhëtarë, fjalën *"el hulu'u"* e kanë interpretuar në kuptimin e lakmuesit, kurse disa të tjerë, në kuptimin e njeriut të padurueshëm. Sipas interpretimit të parë, këtu janë përmendur tri aspekte etike negative që karakterizojnë qenien njerëzore. Këta janë: lakmia, padurimi dhe koprracia. Kurse sipas interpretimit të dytë, këtu përmenden vetëm dy veti, të cilat janë: padurimi dhe koprracia, sepse ajeti i dytë i bie që të jetë shpjegim për kuptimin e fjalës *"el hulu'u"*.

Është pranuar edhe mundësia që kjo fjalë mund të përdoret me të dy kuptimet, sepse këto dy cilësi janë të ndërlidhura. Njerëzit lakmitarë, zakonisht, janë edhe koprracë. Ato nuk kanë durim, kur

vihen në sprovë me ngjarje të dhimbshme, ashtu siç është e vërtetë e kundërta e saj.

Hulumtim

A ekziston në natyrën e njeriut ligësia dhe e keqja?

Këtu parashtrohet pyetja. Në qoftë se All'llahu e ka krijuar njeriun për të arritur lumturinë dhe përsosmërinë, atëherë, pse i ka vënë në natyrën e tij ligësinë dhe të keqen? Si është e mundur që All'llahu të krijojë një gjë me një cilësi të caktuar dhe më pas ta qortojë krijesën e Vet?! Përveç këtyre, Kur'ani, në ajetin 4 të sures "Et Tin" thotë: **"Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur!"**.

Sigurisht ajeti nuk kërkon të thotë se pamja e jashtme e njeriut është e bukur, kurse brendësia e tij është e ligë dhe e keqe. Gjithë krijimi i njeriut është krijuar në formën dhe në mënyrën më të përsosur. Të tillë janë edhe ajetet e tjera që flasin rreth pozitës së lavdërueshme të njeriut. Si mund të jenë në sintoni këto ajete?

Përgjigjja e të gjitha këtyre pyetjeve bëhet e qartë, duke pasur parasysh vetëm faktin që All'llahu e ka pajisur njeriun me një sërë forcash, instinktesh dhe virtytesh, të cilat, në mënyrë potenciale, përbëjnë mjetin e përsosjes, të ngritjes dhe të lumturisë së tij. Prandaj cilësitë dhe instinktet e përmendura, vetvetiu, nuk janë të këqija. Ato, thjesht, janë mjet i përsosjes. Megjithatë, kur

këto cilësi devijojnë dhe keqpërdoren, atëherë bëhen shkak për mjerimin, dekadencën, shëmtimin dhe korrupsionin.

Për shembull, "lakmia" është një forcë që nuk e lejon njeriun që menjëherë të heqë dorë prej përpjekjes, nuk e lejon njeriun, që me fitimin e një begatie, të ndihet i ngopur. Kjo është një dëshirë përvëluese, e cila mbizotëron në qenien e njeriut. Nëse kjo cilësi do të shfrytëzohej në rrugën e nxënies së diturisë dhe të shkencës, dhe njeriu të ishte lakmues i përvetësimit të diturisë, pa dyshim që kjo lakmi do të ishte burim i përsosmërisë së tij. Por, nëse e përdor atë në rrugën e materializmit të shfrenuar, atëherë do të jetë burim i ligësisë, i fatkeqësisë dhe i koprracisë.

Thënë ndryshe, kjo veti është një aspekt i "vetërespektimit". Dashuria dhe respekti për veten e orienton njeriun drejt përsosmërisë. Në qoftë se ndjek rrugën e devijimit, atëherë do të anojë drejt vetëkënaqjes, koprracisë dhe xhelozisë.

Edhe rreth begative të tjera ndodh e njëjta gjë. All'llahu i Madhëruar ka krijuar një forcë të madhe në zemrën e atomit, e cila është e dobishme. Sa herë që kjo forcë e brendshme e atomit përdoret për qëllime shkatërruese, kjo do të jetë burim i ligësisë dhe i humbjes.

Në këtë kontekst, ne, të gjitha ajetetet kur'anore, që diskutojnë rreth njeriut, mund t'i përmbledhim, duke krijuar kohezion midis tyre.[1]

Më tej, ajeti përmend cilësitë e njerëzve të merituesheëm, të cilët i veçon nga të tjerët. Cilësitë e këtyre njerëzve i përmbledh në

[1] Për më shumë informacion, rreth temës "Njeriu në Kur'an", mund t'i referoheni po këtij tefsiri, ajeti 12 i sure "Junus".

nëntë veti. Ajetet 22-23 thonë: **"Përjashtim bëjnë ata që falen, e që janë të vazhdueshëm në faljet e tyre;"**

Fjala **"të vazhdueshëm"**, në togfjalëshin **"të vazhdueshëm në faljet e namazeve të tyre"**, është karakteristika e tyre e parë, e cila siguron lidhje të vazhdueshme me All'llahun e Madhëruar. Kjo marrëdhënie përfitohet me anë të faljes së namazit, e cila e parandalon njeriun nga shthurja morale dhe nihilizmi. Namazi e edukon dhe formon shpirtin dhe zemrën e njeriut. E bën atë që gjithnjë ta kujtojë All'llahun. Kjo përkujdesje dhe vëmendje e vazhdueshme, bëhet shkak për shpëtimin prej neglizhencës, mendjemadhësisë, dhënies pas epshit, mosrënies në kthetrat e djallit dhe të robërisë ndaj dëshirave inferiore.

Është më se e qartë që me vazhdueshmëri në namaz, nuk synohet që njeriu gjithnjë të qëndrojë duke falur namaz, por synimi është që namazin ta falë në kohën e caktuar.

Parimisht, çdo punë e dobishme, vetëm atëherë ndikon pozitivisht te njeriu, që të ketë vazhdimësi. Në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë: *"Veprat më të dashura te All'llahu, janë ato që kanë vazhdimësi, sado të pakta që të jenë ato."*.[1]

Po ashtu, në një hadith rreth këtij ajeti, të transmetuar nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Me këtë synohet që, sa herë njeriu ia obligon vetes namazet nafile, gjithnjë duhet t'i kryejë ato."*.[2]

[1] "El Mu'xhem el Mufehres li el fadhil Hadith", vëll. 2, f. 160, kreu "deuamun".
[2] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 315.

Në një hadith tjetër, të transmetuar nga ky Imam, thuhet: "*Ky ajet flet për namazet nafile.* Kurse ajeti: **'i falin namazet rregullisht...'** (që do të vijë pas disa ajetesh), *është adresim për namazet e detyrueshme."*.[1]

Ky dallim ka mundësi të jetë për arsye se fjala *"muhafizet"* përshtatet me namazet e detyrueshme, të cilat duhet të kryhen në kohë të caktuar. Fjala *"tedavum" - "vazhdimësi"* përputhet me namazet e pëlqyeshme, sepse njeriu mund t'i kryejë ato, por ndonjëherë mund edhe të mos i kryejë.

Sidoqoftë, pas përmendjes së namazit, që konsiderohet dhe si prej veprave më të mira për njeriun, përshkruan vetinë e dytë. Ajeti shton: **"e që caktojnë një pjesë të pasurisë së tyre për lypësin dhe për nevojtarin;"**.

Në këtë mënyrë i ruajnë marrëdhëniet e tyre, si me Krijuesin, ashtu edhe me krijesat e Tij.

Disa komentues të Kur'anit, janë të mendimit se me grupin emëror *"hakkun mealum" - "një pjesë të caktuar"*, në këtë ajet shënohet *"zekati"*, i cili është pjesa e caktuar që u takon "lypësve" dhe "nevojtarëve". Siç e dimë, kjo sure ka zbritur në Mekë. Pikërisht në Mekë nuk ka zbritur edhe ligji i zekatit, madje, ishte zbritur pa saktësuar se cila do të ishte pjesa që duhej ndarë për nevojtarët.

Prandaj disa komentues të tjerë, janë të mendimit se me grupin emëror *"hakkun mealum" - "një pjesë të caktuar"*, nuk synohet zekati, por një obligim moral ndaj shoqërisë. Pra, sipas tyre, njeriu

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 316.

e konsideron si të nevojshme, që një pjesë të pasurisë t'ua japë të varfërve dhe nevojtarëve. Këtë komentim e miraton edhe hadithi i transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*. Kur e pyetën në lidhje me komentimin e këtij ajeti, pra, a ka për qëllim një gjë tjetër, përveç se zekatit, ai u përgjigj: *"Po, kjo është në lidhje me atë person, të cilit All'llahu i ka dhuruar pasuri dhe mall dhe ai e ndan atë në njëmijë, dymijë, tre mijë a më shumë, a më pak pjesë dhe ua shpërndan të varfërve, duke ua lehtësuar vështirësitë popullit të tij."*.[1]

Mes lypësit dhe nevojtarit ka ndryshim. Lypës konsiderohet ai person që e kërkon ndihmën, kurse nevojtar është ai person që turpi e pengon të lypë dhe të kërkojë. Në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Nevojtarë është ai që mundohet me punën dhe përfitimin e vet të plotësojë nevojat e tij, por jeta e tij është plot me probleme."*.[2]

Ky hadith përputhet me komentimin që e cituam më lart, i cili fliste për ata persona që kanë turp të lypin.[3]

Sidoqoftë, kryerja e një vepre të tillë, nga njëra anë, ka një ndikim shoqëror, lufton varfërinë dhe skamjen, nga ana tjetër, ka ndikim etiko–moral për ata persona që bëjnë këtë vepër. Ky veprim ua pastron zemrat e tyre nga lakmia, koprracia dhe dhënia pas kësaj bote.

Ajeti në vijim, tregon karakteristikën e tretë të tyre: **"që besojnë në Ditën e Llogarisë** (Gjykimit)**;"**.

---

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 25, f. 317.

[2] Tefsiri "Nuruth Thekaljen", vëll. 5, Hadithi 27, f. 417.

[3] Në lidhje me komentimin e fjalës "lypës" dhe "nevojtar", është folur më shumë në po këtë tefsir, në vëll. 22, f. 323, ajeti 19 i sures "Edh Dharijat".

Për karakteristikën e katërt, ajeti thotë: **"që frikësohen nga dënimi i Zotit të tyre, - vërtet që askush nuk është i sigurt prej dënimit të Zotit të vet ;"**.

Ata, nga njëra anë, besojnë në Ditën e Llogarisë dhe, duke pasur parasysh shprehjen *"jusedikun"*, e cila është argument për vazhdimësinë, gjithnjë janë të vetëdijshëm për faktin që ekziston Dita e Llogarisë dhe e Dënimit.

Disa komentues të Kur'anit, e kanë interpretuar ajetin në kuptimin e "miratimit praktik", që do të thotë kryerja e obligimeve dhe heqja dorë prej gjërave të ndaluara. Por ajeti, i cili, në dukje, padyshim është shumë i qartë, përfshin edhe miratimin praktik, edhe atë teorik e konceptual.

Por, ka mundësi që një person të besojë në Ditën e Gjykimit, por veten të mos e konsiderojë si të përfshirë në dënimet e asaj Dite, ajeti thotë: **"askush nuk është i sigurt prej dënimit të Zotit të vet"**, që do të thotë se ata gjithnjë e ndiejnë ndjenjën e përgjegjësisë, prandaj të mirat e veta nuk i shohin si diçka të madhe, kurse veprat e këqija (mëkatet) i zmadhojnë.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet se ai e ka këshilluar djalin e tij me këto porosi: *"O djali im! Ta kesh aq shumë frikë Zotin, saqë mendo se ti i sjell të gjitha të mirat e njerëzve mbi tokë, por Ai nuk i pranon ato! Shpreso aq shumë në Zotin tënd, që madje, në rast se ke të gjitha mëkatet e njerëzve që banojnë në tokë, beso se Ai do të të falë ty!"*.[1]

[1] "Biharul Enuar", vëll. 64, f. 394.

Madje edhe vetë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thotë: *"Asnjë person nuk hyn në Xhennet nga vepra e tij."*.

E pyetën: "As ti, që je i Dërguar i Zotit?".

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u përgjigj: *"Po, edhe unë jam kështu, edhe pse mua më përfshin mëshira e Zotit!"*.

Ajetet 29 – 35

وَالَّذِينَ هُمْ لِفُرُوجِهِمْ حَافِظُونَ٢٩ إِلَّا عَلَى أَزْوَاجِهِمْ أَوْ مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُهُمْ فَإِنَّهُمْ غَيْرُ مَلُومِينَ٣٠ فَمَنِ ابْتَغَى وَرَاءَ ذَلِكَ فَأُولَئِكَ هُمُ الْعَادُونَ٣١ وَالَّذِينَ هُمْ لِأَمَانَاتِهِمْ وَعَهْدِهِمْ رَاعُونَ٣٢ وَالَّذِينَ هُمْ بِشَهَادَاتِهِمْ قَائِمُونَ٣٣ وَالَّذِينَ هُمْ عَلَى صَلَاتِهِمْ يُحَافِظُونَ٣٤ أُولَئِكَ فِي جَنَّاتٍ مُكْرَمُونَ٣٥

"E që e ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)**,"**

"përveçse ndaj bashkëshorteve dhe skllaveve të veta - në këtë rast nuk meritojnë qortim,"

"por kush kërkon jashtë këtyre caqeve, pikërisht ata janë shkelësit -;"

"e që i ruajnë amanetet dhe i plotësojnë besëlidhjet e tyre;"

"e që gjithnjë dëshmojnë drejt;"

"e që i falin namazet rregullisht."

"Pikërisht ata do të jenë të nderuar në kopshtet e Xhennetit."

Komentimi

Pjesa tjetër e karakteristikave të banorëve të Xhennetit

Në ajetet e kaluara u përmendën katër prej karakteristikave të besimtarëve të drejtë dhe të atyre që në Kiamet janë banorë të Xhennetit. Në këto ajete citohen dhe pesë veti të tjera. Të gjitha së bashku, bëhen 9 veçori të besimtarëve të drejtë.

Karakteristika e parë është: **"e ruajnë nderin e tyre** (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)**, përveçse ndaj bashkëshorteve dhe skllaveve të veta - në këtë rast nuk meritojnë qortim."**.

Pa asnjë dyshim, instinkti seksual është prej epsheve rebeluese dhe burim i shumë mëkateve të njeriut. Për këtë, disa komentues, janë të mendimit se në të gjitha dosjet e rëndësishme kriminale, vërehet gjurma e kësaj dëshire inferiore, kështu që kontrollimi dhe zaptimi i saj, konsiderohet një prej shenjave të rëndësishme të devotshmërisë. Pikërisht, për këtë arsye, pas përmendjes së namazit, pas ndihmës ndaj nevojtarëve, pas besimit në Ditën e Kiametit dhe pas frikës së dënimit hyjnor, është përmendur kontrollimi dhe ruajtja nga ky instinkt i fortë.

Rasti që është përjashtuar dhe është përmendur në këtë ajet, e bën të qartë se logjika e Islamit është e ndërgjegjshme se epshi seksual nuk mund të çrrënjoset plotësisht e të veprohet përkundër ligjit të All'llahut, siç bëjnë murgjit dhe të krishterët. Diçka e tillë, zakonisht, është e pamundur, ose thënë më mirë, është e palogjikshme, prandaj dhe klerikët e krishterë nuk kanë mundur që instinktin seksual ta fshijnë nga skena e jetës. Edhe pse ata nuk

martohen në mënyrë zyrtare, shumë prej tyre, në vetmi, kryejnë dhe punë të ndyra (imorale).

Nuk janë të pakta të këqijat që ka sjellë me vete kjo rrugë e gabuar. Historianë të shquar, si Will Durant dhe të tjerë, e kanë denoncuar hapur atë.

Fjala *"izuaxh"* përfshin martesën e përhershme dhe të përkohshme. Pretendimi i disave se ky ajet nuk ka për synim "martesën e përkohshme", është sepse nuk janë në dijeni që edhe ajo është një lloj martese.

Në ajetin në vijim, për ta theksuar më shumë çështjen, ajeti thotë: **"por kush kërkon jashtë këtyre caqeve, pikërisht ata janë shkelësit."**.

Fjala *"el emanetu"* ka një kuptim të gjerë. Ajo nuk synon vetëm amanetet materiale të njerëzve, të çdo lloji qofshin ato, por përfshin të gjitha amanetet hyjnore, të Profetëve dhe të Imamëve.

Çdo mirësi prej mirësive të All'llahut është nga amanetet e Tij. Pozitat shoqërore dhe veçanërisht posti i qeverisë, konsiderohet si prej amaneteve më të rëndësishme. Prandaj, në haditin e njohur nga Imam Sadiku dhe Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi ta!)*, lidhur me komentimin e ajetit: **"All'llahu ju urdhëron që amanetet t'jua ktheni atyre që u përkasin dhe, kur të gjykoni midis njerëzve, të gjykoni drejt. Vërtet, All'llahu ju këshillon mrekullueshëm dhe vërtet, All'llahu dëgjon çdo gjë dhe vështron**

të gjitha punët!”,[1] thuhet: *“Udhëheqjen dhe qeverinë lëruani të zotëve të saj.”*.[2]

Gjithashtu, në ajetin 72 të sures “El Ahzab” lexuam: **“Ne u ofruam amanetin qiejve, tokës dhe maleve...”**.

Më e rëndësishmja se të gjitha këto, feja dhe Libri i All’llahut, Kur’ani, janë amaneti i madh i Zotit dhe duhet të përpiqesh për mbrojtjen dhe ruajtjen e Tij: **“që i ruajnë amanetet dhe i plotësojnë besëlidhjet e tyre.”**.

Fjala *“el ahdu”* ka një kuptim të gjerë, që përfshin edhe premtimet e njerëzve, edhe premtimet ndaj All’llahut, sepse “premtim” konsiderohet çdo lloj detyre, si dhënia e fjalës tjetrit. Pa dyshim, më i rëndësishmi është premtimi i atij që beson All’llahun dhe të Dërguarin e Tij. Në këtë besim pranohen edhe premtimet e shumta.

Islami i ka kushtuar një rëndësi jashtëzakonisht të madhe ruajtjes dhe mbajtjes së premtimit dhe e ka konsideruar atë si një prej shenjave më të rëndësishme të besimit.[3]

Në cilësimin e katërt, ajeti shton: **“gjithnjë dëshmojnë drejt”**.

---

[1] Sure “En Nisa”, ajeti 58.

[2] Tefsiri “Burhan”, vëll. 80, f. 380.

[3] Në lidhje me këtë fushë, kemi dhënë më shumë shpjegime në vëll. 3 të po këtij tefsiri, në ajeitn 53 të sures “En Nisa”.

Sjellja e dëshmisë së drejtë, pra, rrëfimi i tij, është një nga shtyllat më të rëndësishme të realizimit të drejtësisë në shoqëritë njerëzore.

Ka nga ata njerëz që thonë pse të krijojmë armiqësi dhe t'i shkaktojmë shqetësime vetes, duke dëshmuar dhe duke sjellë fakte kundrejt këtij apo atij personi. Njerëz të tillë janë të pavëmendshëm ndaj të drejtave njerëzore, me mungesë të theksuar të frymës shoqërore, si dhe janë mospërfillës ndaj realizimit të drejtësisë.

Prandaj Kur'ani Famëlartë, në ajete të shumta, i ka ftuar myslimanët për të dhënë dëshminë e vërtetë, pra, të dëshmojnë me fakte, duke konsideruar fshehjen e të vërtetës si mëkat.[1]

Edhe në jurisprudencën islame, dhënia e dëshmisë ka një rëndësi të posaçme dhe është konsideruar si gur themeli për të theksuar shumë prej të drejtave individuale dhe sociale dhe ka depozitat e veta të posaçme.

Në cilësinë e fundit, e cila është përshkrimi i nëntë te kjo seri ajetesh, i kthehet edhe një herë tjetër çështjes së faljes. Ashtu siç kishte filluar me namazin, edhe këtu ajeti deklaron: **"i falin namazet rregullisht"**.

Siç e trajtuam më lart, duket që me fjalën "*namaz*", në rastin konkret, shënohet falja e detyrueshme, kurse në ajetin e kaluar, shënohej falja e pëlqyeshme.

Në cilësimin e parë, bëhej fjalë për vazhdimësinë e faljes, ndërsa këtu flitet për ruajtjen e normave, të kushteve, shtyllave dhe

[1] Sure "El Bekare", ajetet 140–283, sure "El Maide", ajeti 106 dhe sure "Et Talak", ajeti 2.

veçorive të tij. Norma, të cilat e ruajnë formën e namazit nga ato që e deformojnë atë, e përforcojnë shpirtin e faljes, që është prania e vëmendjes së zemrës, duke i shkatërruar pengesat etike në rrugën e pranimit të faljes.

Për pasojë, kjo, në asnjë mënyrë, nuk mund të quhet përsëritje. Ky fillim dhe fund tregojnë që vëmendja ndaj faljes, midis të gjithë këtyre cilësive, tregon se falja është më e rëndësishmja, ndërsa namazi është shkolla e lartë e edukimit dhe instrumenti më i përshtatshëm për pastrimin e shpirtit njerëzor dhe kultivimin e shoqërisë.

Në fund sqarohet se kush janë "pronarët" e këtyre cilësive. Në ajetet e kaluara u sqarua përfundimi i keqbërësve. Ndërsa këtu, me një fjali të shkurtër dhe domethënëse, Zoti deklaron se ku do të qëndrojnë zotëruesit e cilësive të përmendura më sipër: **"Pikërisht ata do të jenë të nderuar në kopshtet e Xhennetit."**.

Pse të mos jenë të nderuar, duke qenë se janë mysafirë të All'llahut? All'llahu i Plotfuqishëm dhe i Gjithëmëshirshëm ka përgatitur për ta të gjitha mjetet e mikpritjes. Me fjalët: **"kopshtet e Xhennetit"** dhe **"të nderuar"** nënkuptojmë begatitë materiale dhe shpirtërore që i takojnë këtij grupi.

Ajetet 36 – 41

فَمَالِ الَّذِينَ كَفَرُوا قِبَلَكَ مُهْطِعِينَ٣٦ عَنِ الْيَمِينِ وَعَنِ الشِّمَالِ عِزِينَ٣٧ أَيَطْمَعُ كُلُّ امْرِئٍ مِنْهُمْ أَنْ يُدْخَلَ جَنَّةَ نَعِيمٍ٣٨ كَلَّا إِنَّا خَلَقْنَاهُمْ مِمَّا يَعْلَمُونَ٣٩ فَلَا أُقْسِمُ بِرَبِّ الْمَشَارِقِ وَالْمَغَارِبِ إِنَّا لَقَادِرُونَ٤٠ عَلَى أَنْ نُبَدِّلَ خَيْرًا مِنْهُمْ وَمَا نَحْنُ بِمَسْبُوقِينَ٤١

"Ç'është kështu me jobesimtarët, që nxitojnë drejt teje"

"djathtas e majtas, grupe-grupe?!"

"A mos çdonjëri prej tyre shpreson të hyjë në Kopshtin e Lumturisë?"

"Kurrsesi! Vërtet që ata e dinë nga çfarë i kemi krijuar!"

"Betohem për Zotin e lindjeve dhe të perëndimeve, që Ne jemi të Zotë"

"t'i ndërrojmë ata me njerëz më të mirë se ata dhe askush nuk na pengon dot."

Komentimi

Me çfarë fytyre lakmon Xhennetin?

Në ajetet e kaluara të kësaj sureje, u diskutua rreth shenjave të besimtarëve, të idhujtarëve dhe fatit të secilit prej këtyre dy grupeve. Në ajetet e lartpërmendura, i rikthehet edhe një herë tjetër shpjegimit rreth gjendjes së idhujtarëve dhe talljet e tyre në lidhje me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Disa komentues kanë thënë se këto ajete kanë zbritur për idhujtarët, të cilët, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u komunikonte myslimanëve në Mekë Ajetet e Ringjalljes, ata shkonin në grupe te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, sa në të djathë sa në të majtë të tij dhe thoshin: "Nëse do të ndodhë Dita e Kiametit, gjendja jonë në atë Botë do të jetë më e mirë se sa gjendja e këtyre që të kanë besuar ty, ashtu siç ndodh edhe në këtë botë, që gjendja jonë është më e mirë se sa e atyre.".

Kur'ani, në përgjigje të tyre, thotë: **"Ç'është kështu me jobesimtarët, që nxitojnë drejt teje djathtas e majtas, grupe-grupe?! A mos çdonjëri prej tyre shpreson të hyjë në Kopshtin e Lumturisë?"**.

Me çfarë besimi dhe me cilën vepër i japin vetes një meritë të tillë?!

Fjala *"muhti'ine"* është shumësi i fjalës *"muhte'un"* dhe nënkupton personin që ngre kokën lart dhe ecën me nxitim,

personin që është në kërkim të diçkaje. Ndonjëherë përdoret edhe vetëm në kuptimin e ngritjes së kokës për të marrë lajmin.

Fjala *"iz'zijne"* është shumësi i fjalës *"iz'zetun"* dhe është përdorur në kuptimin e grupeve të shpërndara. Rrënja kryesore e saj është *"izvun"*, që është përdorur me kuptimin e lidhjes farefisnore, duke pasur parasysh faktin që çdo grup që qëndron së bashku, ka një lidhje apo marrëdhënie me njëri-tjetrin, ose kanë një synim të përbashkët; shoqëria apo grupi quhet *"iz'zetun"*.

Sidoqoftë, idhujtarët egoistë dhe vetëdashës kishin shumë pretendime të tilla të pabaza dhe, meqenëse kishin një jetë materiale të volitshme dhe të pasur (me pasuri të fituar në rrugë të pa drejtë), këtë e konsideronin si argument për lartësinë e pozitës së tyre pranë All'llahut. Me anë të një krahasimi të pakuptimtë dhe të kotë presupozonin për veten e tyre pozita të larta në Kiamet.

Është më se e vërtetë se ata nuk besonin në Ditën e Kiametit, sigurisht në atë mënyrë që e përshkruan Kur'ani. Nganjëherë, me dozë dyshimi, bisedonin dhe diskutonin rreth asaj që, nëse do të ndodhë ajo Ditë në atë Botë, si do të jetë gjendja e tyre. Apo, mbase edhe këto biseda i bënin për t'u tallur.

Kur'ani u përgjigjet atyre: **"Kurrsesi! Vërtet që ata e dinë nga çfarë i kemi krijuar!"**.

All'llahu i Madhëruar dëshiron që, me anë të kësaj fjalie, **së pari,** të thyejë mendjemadhësinë dhe arrogancën e tyre, sepse thotë: **"ata e dinë nga çfarë i kemi krijuar!"**.

Nga një farë e pavlerë, nga një ujë i prishur. Atëherë pse e gjithë kjo mendjemadhësi dhe kryelartësi?

Së dyti, u jep një përgjigje tallësve të Ditës së Gjykimit dhe u thotë se, nëse ju dyshoni për çështjen e Kiametit, atëherë shkoni dhe studiojeni çështjen e farës (spermës) suaj. Ndoshta do të kuptoni se si me anë të një pike uji, të pa vlerë dhe të pa dobishme, ne krijojmë një krijesë të re, e cila, me anë të zhvillimit të fetusit, çdo ditë merr një formë të re për vete.

Vallë, Krijuesi që e krijoi njeriun nga një pikë fare, a nuk është i aftë, që pas vdekjes, ta ringjallë atë përsëri dhe t'i veshë "rrobat" e jetës?!

Së treti, si shpresojnë këta që të hyjnë në Kopshtin e Lumturisë, ndërkohë që në dosjen e tyre vërehen të gjitha këto vepra të ndaluara dhe mëkate?! Një krijesë që është krijuar nga një farë e pavlerë, nuk ka ndonjë vleftë të veçantë për nga pikëpamja materiale. Nëse është i vlefshëm, kjo është për hir të besimit dhe të veprave të mira që ka kryer, por këta njerëz janë tepër të varfër nga ky aspekt. Atëherë, si shpresojnë të hyjnë në Kopshtin e Lumturisë?![1]

Më pas, për ta theksuar këtë çështje, shtohet: **"Betohem për Zotin e lindjeve dhe të perëndimeve, që Ne jemi të Zotë t'i**

Në komentimin e ajetit të lartpërmendur, janë dhënë mendime të tjera, si p.sh: Synimi i sifjalisë *"mim'ma jeamelun"* - **"nga çfarë i kemi krijuar"** është: Ne e kemi krijuar atë me mendje dhe inteligjencë dhe jo si shtazët, si rrjedhojë, karshi veprave të tij ka përgjegjësi.

Së dyti, kjo mund të jetë me këtë kuptim: Ne i kemi krijuar ata për qëllime që vetë janë në dijeni për ato, pra, për kryerjen e obligimeve dhe nënshtrimin ndaj Meje. Këto mendime nuk janë shumë të qëndrueshme, kështu që zakonisht, komentuesit e Kur'anit, kanë pranuar po atë kuptim që dhamë më sipër.

ndërrojmë ata me njerëz më të mirë se ata dhe askush nuk na pengon dot.".

Kjo fjali përcjell mesazhin se All'llahu jo vetëm që është i aftë t'i ringjallë përsëri ata, pasi të kenë vdekur, por mund t'i ringjallë ata dhe t'i shndërrojë në krijesa edhe më të mira dhe më të plota (përsosura). Asnjë gjë nuk do të mund të bëhet pengesë.

Në këtë mënyrë, shprehja e lartpërmendur është vazhdim i temës në lidhje me "Ringjalljen".

Kjo fjali tregon se All'llahun e Madhëruar nuk e pengon dot asgjë, nëse do të donte t'ju zhdukte së bashku, me ndëshkimin për hir të veprave tuaja dhe në vendin tuaj të krijojë si pasardhësit tuaj njerëz të denjë, të vetëdijshëm dhe besimtarë, që të jenë shokë dhe përkrahës të Profetit tonë. Asnjë gjë nuk do të mundë ta pengojë në këtë rrugë.

Si rrjedhojë, nëse këmbëngulim që ju të besoni, kjo nuk është për shkak të nevojës apo domosdoshmërisë, por e gjitha kjo bazohet në interesin e përgjithshëm, sepse edukimi dhe udhëzimi i gjinisë njerëzore është i nevojshëm.

Sifjalia: **"Betohem për Zotin e lindjeve dhe të perëndimeve"**, tregon se All'llahu i Madhëruar, i Cili është në gjendje që çdo ditë ta vërë në lëvizje diellin me gjithë atë madhështi që ka, sa në lindje, sa në perëndim, përmes përllogaritjeve aq të sakta, po ashtu, është në gjendje ta ringjallë njeriun, pasi të ketë vdekur, ose të asgjësojë një grup njerëzish dhe në vend të tyre të sjellë një grup tjetër të merituar.

Hulumtim

Zoti i "lindjeve" dhe "perëndimeve"

Në ajetet kur'anore, ndonjëherë fjala *"mashrik"* dhe *"magrib"* - *"i lindjeve"* dhe *"i perëndimeve"* është përmendur në numrin njëjës, si p.sh. në suren "El Bekare", në ajetin 115: **"...të All'llahut janë edhe lindja edhe perëndimi...."** dhe ndonjëherë është përmendur në numrin shumës, si p.sh. në suren "Err Rrahman", në ajetin 17: **"Zoti i dy lindjeve dhe Zoti i dy perëndimeve"**, po ashtu, siç është përmendur dhe në rastin e këtij ajeti.

Disa mendjelehtë dhe mendjeshkurtër i kanë konceptuar si të kundërta me njëra-tjetrën këto shprehje, ndërkohë që të gjitha janë në sintoni të plotë. Secila shprehje aludon për një çështje të caktuar.

Shpjegimi është ky: Dielli çdo ditë lind nga një pikë e re dhe, po ashtu, perëndon në një pikë të re. Çdo ditë të vitit kemi lindje dhe perëndim dhe në mes të gjithë këtyre perëndimeve dhe lindjeve veçohen dy lindje dhe dy perëndime. Njëri është në fillim të verës, pra, pika më e lartë e diellit në orbitën veriore dhe tjetri në fillim të dimrit, pra, pika e fundit e uljes së diellit në orbitën jugore. Njëri quhet Tropiku i gaforres, kurse tjetri Yjësia e bricjapit. Meqenëse këto të dyja janë plotësisht të qarta, kjo është dhe arsyeja që Kur'ani i përmend dhe bazohet në to.

Përveç kësaj, janë të qarta dhe dy lindje dhe dy perëndime të tjera, të cilat ndryshe i quajnë Ekuinoksi i lindjes dhe i perëndimit. Ato ndodhin në fillim të pranverës dhe në fillim të

vjeshtës, në kohën kur dita dhe nata në të gjithë botën, është e barabartë. Kjo është arsyeja që disa komentues e kanë interpretuar si Zoti i dy lindjeve dhe Zoti i dy perëndimeve.

Kur është përmendur në numrin njëjës, është në kuptimin e zakonshëm. Flitet vetëm lindjen dhe perëndimin, në parim. Shprehjet e ndryshme që u përmendën më lart, mbartin nga një pikë dhe njeriun e vënë në dijeni rreth çështjeve të ndryshme të lindjes dhe të perëndimit të diellit dhe ndryshimin e sistemit të orbitave diellore.

Ajetet 42 – 44

فَذَرْهُمْ يَخُوضُوا وَيَلْعَبُوا حَتَّى يُلَاقُوا يَوْمَهُمُ الَّذِى يُوعَدُونَ٤٢

يَوْمَ يَخْرُجُونَ مِنَ الْأَجْدَاثِ سِرَاعًا كَأَنَّهُمْ إِلَى نُصُبٍ يُوفِضُونَ٤٣

خَاشِعَةً أَبْصَارُهُمْ تَرْهَقُهُمْ ذِلَّةٌ ذَلِكَ الْيَوْمُ الَّذِى كَانُوا يُوعَدُونَ٤٤

“Andaj, lëri ata të zbaviten me gjëra të kota dhe të luajnë derisa të përballen me Ditën e tyre që u është premtuar,”

“Ditën, në të cilën do të dalin nga varrezat duke vrapuar, sikur të ishin duke nxituar drejt një altari,”

“me shikim të frikësuar e të kapluar nga poshtërimi. Ajo është Dita që u është premtuar atyre!”

Komentimi

Pothuajse po vrapojnë drejt idhujve të tyre

Në këto ajete, që janë dhe ajetet e fundit të sures “El Me’arixh”, për t’i tërhequr vëmendjen dhe për t’i kërcënuar idhujtarët kryeneçë dhe tallës, ajeti thotë: **“Andaj, lëri ata të**

zbaviten me gjëra të kota dhe të luajnë derisa të përballen me Ditën e tyre që u është premtuar.".

Nuk është e nevojshme për ndonjë argumentim tjetër. Ata nuk janë të zotët e mendjes, nuk logjikojnë dhe as janë të gatshëm të zgjohen nga injoranca e tyre. Lëri ata të zhyten në gënjeshtrat dhe mashtrimet e tyre, të zbaviten me gjëra të kota dhe të luajnë si fëmijët, derisa të përballen me Ditën e Kiametit, ku çdo gjë ta shohin me sytë e tyre.

Ky ajet, me këtë shprehje dhe pa asnjë ndryshim, është trajtuar edhe në suren "Ez Zuhruf", në ajetin 83.

Më pas, ajeti diskuton rreth Ditës së premtuar dhe paraqet shenjat e kësaj Dite të frikshme: **"Ditën, në të cilën do të dalin nga varrezat duke vrapuar, sikur të ishin duke nxituar drejt një altari…"**.

Sa shprehje e çuditshme! Gjendjen e tyre në Kiamet dhe momentin që i drejtohen gjykatës së drejtë të All'llahut, duke nxituar, e ngjason me vërsuljen e tyre në një ditë feste apo hidhërimi, apo me nxitimin për tek idhujt e tyre. Por ku është kjo për të cilën flasim ne e ku është ajo që supozojnë ata? Vërtet që është një krahasim i mrekullueshëm, lidhur me besimet e tyre të kota, që i kishin në këtë botë.

Fjala *"el exhdathu"* është shumësi i fjalës *"xhedethun"* dhe është përdorur me kuptimin e *varrit*.

Fjala *"sira'un"* është shumësi i fjalës *"serij'un"* dhe është përdorur me kuptimin e një diçkaje apo të një personi që ecën me nxitim.

Fjala *"nusubun"* është shumësi i fjalës *"nasijbun"*. Sipas disa komentuesve, është shumësi i fjalës *"nesbun"* dhe është në kuptimin e një gjëje që ngjitet në një vend, sepse ata adhuronin idhuj që i kishin ngjitur në vende të ndryshme, në formën e një shkëmbi dhe, në emër të tyre prisnin kurban. Gjakun e kurbanit ia hidhnin sipër. Dallimi midis këtyre fjalëve, është: *"Sanam"* ishte një idhull, që kishte një formë dhe pamje të veçantë, kurse *"nusub"* ishin shkëmbinj që nuk kishin ndonjë formë të caktuar dhe i adhuronin ata për ndonjë arsye, ashtu siç e lexojmë dhe në ajetin 3 të sures "El Maide": **"...Gjithashtu, është e ndaluar për ju edhe ngrënia e mishit të kafshëve që janë therur për nder të idhujve apo për të kërkuar fatin në fall....."**.

Fjala *"jufidhune"* rrjedh nga fjala *"ifadhetun"* dhe është në kuptimin e lëvizjes së shpejtë dhe me nxitim, ngjashëm me ujin e shpejtë të burimit.

Disa të tjerë, kanë thënë se fjala *"nusub"*, në ajetin në fjalë, nënkupton flamujt, ushtritë ose karvanët që i varin në një pikë dhe secili shkon me nxitim drejt tyre, për të arritur tek ata. Komentimi i parë është më i përshtatshëm.

Më pas, ajeti përmend shenjat e tjera: **"me shikim të frikësuar e të kapluar nga poshtërimi."**.

Në fund të ajetit, thuhet: **"Ajo është Dita që u është premtuar atyre!"**.

Po, kjo është Dita e premtuar, të cilën e merrnin si objekt talljeje dhe përqeshjeje, madje ndonjëherë për të thoshin: "Nëse supozojmë se ekziston një ditë e tillë, gjendja e jonë, Atë Ditë, do të jetë më e mirë se e besimtarëve...".

Por në atë Ditë, për shkak të frikës së madhe dhe turpit, ata nuk kanë as kurajë që të ngrenë kokën lart dhe të shohin, pasi shikimi i tyre është i frikësuar e i kapluar nga poshtërimi. Pa dyshim, që atë Ditë bëhen pishman, por çfarë dobie ka!

O Zoti im! Të lutem, më mëshiro me mëshirën Tënde në atë Ditë të vështirë!

O Zoti im! Të lutem, më mbro sepse kurthet e djallit janë të vështira dhe dhënia pas epshit është e zakonshme dhe dëshirat e afërta dhe të largëta janë mashtrim. Na mundëso ne, që të jemi në Rrugën e Drejtë!

O Zoti im, të lutem na bëj ne prej atyre besimtarëve, të cilët kanë qenë besnikë ndaj premtimit karshi Teje dhe të janë nënshtruar dhe të janë bindur plotësisht Ty!

Fundi i sures "El Me'ârixh"

Sure "Nuh"

Zbritur në Mekë

28 ajete

Përmbajtja e sures "Nuh"

Kjo sure, ashtu siç vërehet dhe nga emërtimi i saj, trajton çështjen e historisë së Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*. Në vende të ndryshme në Kur'an është folur rreth këtij Profeti të nderuar, si p.sh: në suret: "Esh Shura", "El Mu'minun", "El A'raf", "El Enbija". Më i njohuri se të gjithë është diskutimi në suren "Hud", ku për këtë Profet të madh, flitet afërsisht në 25 ajete, (nga ajeti 25–49).

Pra, ajo që është përmendur në suren "Nuh", është një pjesë e veçantë e jetës së tij, e cila nuk është trajtuar në sure të tjera. Kjo ka të bëjë me thirrjen e vazhdueshme drejt monoteizmit, mënyrën dhe kushtet e kësaj ftese. Veç kësaj, ekzistojnë edhe nënçështje tjera që lidhen me këtë temë të rëndësishme dhe, e gjithë kjo, karshi një populli kryeneç, egoist dhe mendjemadh, i cili, në asnjë mënyre, nuk ishte i gatshëm që t'i dorëzohej të Vërtetës.

Kjo sure ka zbritur në Mekë. Në atë kohë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe myslimanët e paktë, jetonin, pothuajse në kushte të ngjashme me kushtet e popullit të kohës së Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe ithtarëve të tij.

Surja u mëson atyre, pra, myslimanëve, shumë çështje. Disa prej qëllimeve të përmendjes së kësaj ngjarjeje, janë:

1- I mëson ata se si të bëjnë thirrjen tek armiqtë, me anë të argumentimit logjik, të shoqëruar me dashuri dhe dhembshuri, duke shfrytëzuar çdo mjet të dobishëm dhe të efektshëm në këtë rrugë.

2- I mëson ata, që asnjëherë të mos lodhen dhe të mos heqin dorë nga thirrja dhe ftesa drejt All'llahut, edhe nëse zgjat me vite të tëra dhe armiku bëhet pengesë.

3- I mëson ata, që në njërën dorë të mbajnë faktorin e stimulimit dhe në dorën tjetër, faktorin e paralajmërimit dhe tërheqjes së vërejtjes. Dhe të përfitojnë nga të dy këta faktorë, në rrugën e ftesës drejt All'llahut.

4- Ajetet e fundit të kësaj sureje janë paralajmërim për politeistët kokëfortë, se, nëse nuk dorëzohen karshi së Vërtetës dhe ua kthejnë shpinën urdhrave të Zotit, pa dyshim që i pret një e ardhme e trishtuar dhe e frikshme.

5- Përveç këtyre, kjo sure është ngushëllim dhe qetësi për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për besimtarët e parë dhe njerëzit në kushte të ngjashme me ata, të cilët, gjatë thirrjes së tyre, me ndihmën e All'llahut, të tregohen zemërbutë, kurse karshi problemeve dhe vështirësive, të jenë të durueshëm dhe të qëndrueshëm.

Thënë ndryshe, kjo sure është një skicim i luftës së vazhdueshme midis të drejtëve dhe të devijuarve, si dhe "taktikave" që duhet t'i përdorin përkrahësit e të drejtës gjatë ftesës dhe ecjes së tyre në Rrugën e Dejtë.

Mirësitë e leximit sures "Nuh"

Në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: "*Ai që lexon suren 'Nuh', do të jetë prej besimtarëve, që do t'i përfshijë ndriçimi i ftesës së Nuhit (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!).*".[1]

Në një hadith tjetër, nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë "*Ai që beson në All'llah dhe në Ditën e Kiametit, si dhe lexon Librin e Tij, të mos anashkalojë leximin e sures 'Nuh'. Çdokush që e lexon atë në namazet e obligueshme apo të pëlqyeshme, të shoqëruar me durim dhe vëmendje, sigurisht që All'llahu i Madhëruar do ta vendosë atë në banesat e të mirëve, si dhe, për hir të respektit, do t'i dhurojë tri kopshte prej kopshteve të Xhennetit, si bujari nga ana e Tij!*".[2]

Është e qartë se qëllimi i leximit të kësaj sureje është frymëzimi me anë të rrugës dhe metodës që ka ndjekur ky i Dërguar i All'llahut, si dhe Profeti i Islamit, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Të frymëzohemi me qëndresën e durimit të përkrahësve të tij në rrugën e thirrjes drejt All'llahut, si dhe ta përfshijmë veten në dritën e thirrjes së tij, të mos e lexojmë atë pa reflektuar dhe pa menduar, por të mendojmë dhe të veprojmë në bazë të saj.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 359.

[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 359.

Ajetet 1 - 4

بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

إِنَّا أَرْسَلْنَا نُوحًا إِلَى قَوْمِهِ أَنْ أَنْذِرْ قَوْمَكَ مِنْ قَبْلِ أَنْ يَأْتِيَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ۝١ قَالَ يَا قَوْمِ إِنِّي لَكُمْ نَذِيرٌ مُبِينٌ۝٢ أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاتَّقُوهُ وَأَطِيعُونِ۝٣ يَغْفِرْ لَكُمْ مِنْ ذُنُوبِكُمْ وَيُؤَخِّرْكُمْ إِلَى أَجَلٍ مُسَمًّى إِنَّ أَجَلَ اللَّهِ إِذَا جَاءَ لَا يُؤَخَّرُ لَوْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ۝٤

Me Emrin e All'llahu, të Gjthëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Ne e dërguam Nuhun te populli i tij dhe i thamë: 'Paralajmëroje popullin tënd para se t'i vijë një dënim i dhembshëm!'"

"Ai tha: O populli im! Në të vërtetë, unë jam për ju një paralajmërues i qartë:"

"që të adhuroni All'llahun, t'i frikësoheni Atij e të më bindeni mua,"

"me qëllim që Ai të falë disa nga gjynahet tuaja dhe t'ju lërë (të jetoni) **deri në një afat të caktuar. Dhe, kur t'ju vijë çasti i caktuar i All'llahut, askush nuk do të mund ta shtyjë atë, veç sikur ta dinit"**

Komentimi

Mesazhi i parë i Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*

Ashtu siç e diskutuam më sipër, Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* thërriste në Rrugën e Zotit dhe ua mësonte të gjithëve ecjen në atë Rrugë.

Ajeti fillon me "dërgimin" e tij dhe thotë: **"Ne e dërguam Nuhun te populli i tij dhe i thamë: 'Paralajmëroje popullin tënd para se t'i vijë një dënim i dhembshëm!'"**.

Ky dënim i dhembshëm ka gjasa të ketë lidhje me dënim e kësaj bote, ose të Botës Tjetër, Ahiretit. Të përshtatshme janë që të dyja, edhe pse në bazë të ajeteve të fundit të kësaj sureje, kuptimi i saj përputhet më shumë me dënimin e kësaj bote.

Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* ishte edhe paralajmërues, edhe përgëzues. Është kjo arsyeja që paralajmërimi pranohet se ka më shumë ndikim.

Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* ishte ligjsjellësi i parë hyjnor, pra, erdhi me Sheriat dhe me fenë hyjnore. Thirrja e tij ishte me përmasa globale. Pas marrjes së këtij urdhri, iu drejtua popullit të vet: **"O populli im! Në të vërtetë, unë jam për ju një paralajmërues i qartë."**.

Ky ajet përcjell mesazhin se duhet të adhurohet All'llahu Një dhe i Vetëm dhe të hiqet dorë nga çdo gjë tjetër, përveç Tij. Bëhuni të devotshëm dhe bindjuni urdhrave të mia, që në fakt janë

urdhrat e All'llahut: **"që të adhuroni All'llahun, t'i frikësoheni Atij e të më bindeni mua…".**

Faktikisht Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*, përmbajtjen e thirrjes së tij, në Rrugën e All'llahut, e përmblodhi në tri fjali: Adhurimin e All'llahut Një, frikësimin ndaj Tij, si dhe bindjen e urdhrave të tij, të cilat i janë zbritur nga All'llahu dhe përbëheshin nga besimi, etika dhe dispozitat hyjnore.

Më pas, ajeti diskuton për nxitjen e tyre. Rezultatin e rëndësishëm të kësaj thirrjeje në Rrugën e Zotit e shpalos shkurtimisht në dy fjali: **"me qëllim që Ai të falë disa nga gjynahet tuaja…"**.[1]

Në fakt, shprehja e njohur "Islami duhet përqafuar (dashur) më shumë se veten tënde", është një shprehje e njohur për të gjitha fetë hyjnore dhe kjo nuk i përkiste vetëm Islamit.

Ajeti, pastaj shton: **"t'ju lërë** (të jetoni) **deri në një afat të caktuar. Dhe, kur t'ju vijë çasti i caktuar i All'llahut, askush nuk do të mund ta shtyjë atë, veç sikur ta dinit!"**.

Nga ky ajet arrijmë të kuptojmë se *"exheli"* (afati përfundimtar i jetës), është dy llojesh: njëri është *"exheli musem'ma"* – *"afat i caktuar"* dhe tjetri është *"exheli nihai"* – *"afati përfundimtar"*,

[1] Pjesëza *"min"* në këtë fjali është shtesë dhe për theksimin e saj, sepse besimi në Një Zot bëhet shkak i faljes së të gjitha mëkateve. Disa komentues të Kur'anit, siç është Fakhru Rrazij, në komentimin e tij "El Kebijr" apo Al'lame Tabatabai në "El Mijzan", kanë dhënë këtë shpjegim: Pjesëza *"min"*, në këtë ajet, i referohet mëkateve të kaluara dhe jo mëkateve të ardhshme. Ky shpjegim është i papranueshëm, sepse në ajet nuk flitet rreth mëkateve të së ardhmes.

që nuk mund të shtyhet. Thënë ndryshe, vdekja e afërt dhe vdekja e largët, ose vdekja e kushtëzuar dhe vdekja e patjetërsueshme

Vdekja e parë është ajo vdekje që ka një afat të caktuar, por mund të ndryshohet. Pra, në bazë të efektit të veprave jo të hijshme dhe jo të mira të njeriut, ka gjasa të afrohet shumë më përpara. Ajo mund të vijë nga dënimet hyjnore. Mund të ndodhë dhe e kundërta e saj, pra, nën efektin e devotshmërisë dhe të kryerjes së veprave të mira e të dobishme, ka gjasa që vdekja të shtyhet në një afat më të largët.

Afati përfundimtar i vdekjes, afati i caktuar në mënyrë absolute, nuk mund të ndryshohet. Këta mund ta sqarojmë kështu: Një njeri, nuk ka jetë të përhershme. Edhe nëse organet e trupit, i ka në gjendje të mirë, kur t'i vijë koha e vdekjes, zemra e tij, e konsumuar në vite, natyrshëm do të pushojë. Megjithatë, mbajtja e higjienës dhe parandalimi me kohë i sëmundjeve, mund të ndikojë në zgjatjen e jetës së njeriut, ashtu si moskujdesi për higjienën, etj, mund ta shkurtojë shumë jetën e njeriut.[1]

[1] Në lidhje me *"exhelu nihai"* dhe *"exhelu mualak"* kemi bërë një hulumtim në ajetin 2 të sures "El En'am".

Hulumtim

Ndikimi i faktorëve shpirtërorë në shkurtimin, apo zgjatjen e jetës

Mësimi tjetër që përfitojmë nga ajeti i lartpërmendur, është ndikimi i mëkateve në shkurtimin e jetës së njeriut. Kuptimi i ajeti është: Nëse besoni dhe jeni të devotshëm, Zoti do t'ju dhurojë jetë të gjatë, si dhe do ta shtyjë vdekjen tuaj, sepse mëkatet i japin goditje të tmerrshme trupit ose shpirtit të njeriut. Konceptimi i këtij kuptimi është shumë i thjeshtë.

Në transmetimet islame, ky konceptim zë një vend të veçantë. Në një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Ata që vdesin nën efektin e mëkateve, janë më shumë se ata që vdesin për shkak të caktimit të All'llahut, pra, në afatin përfundimtar. Ata që kryejnë veprave të mira, nën efektin e tyre, jetojnë më gjatë, janë më shumë se ata që u zgjatet jeta nën ndikimin e faktorëve natyrorë."*.[1]

[1] "Sefinetul Bihar", vëll. 1, kreu "dhenbun", f. 488.

Ajetet 5 - 9

قَالَ رَبِّ إِنِّي دَعَوْتُ قَوْمِي لَيْلًا وَنَهَارًا ۝ فَلَمْ يَزِدْهُمْ دُعَائِي إِلَّا فِرَارًا ۝ وَإِنِّي كُلَّمَا دَعَوْتُهُمْ لِتَغْفِرَ لَهُمْ جَعَلُوا أَصَابِعَهُمْ فِي آذَانِهِمْ وَاسْتَغْشَوْا ثِيَابَهُمْ وَأَصَرُّوا وَاسْتَكْبَرُوا اسْتِكْبَارًا ۝ ثُمَّ إِنِّي دَعَوْتُهُمْ جِهَارًا ۝ ثُمَّ إِنِّي أَعْلَنْتُ لَهُمْ وَأَسْرَرْتُ لَهُمْ إِسْرَارًا ۝

"Ai tha: O Zoti im, unë e thirra vërtet popullin tim natë e ditë."

"Por thirrja ime edhe më tepër i largoi (nga e vërteta)**."**

"Sa herë, që i thirrja për t'i falur Ti, ata shtinin gishtërinjtë në veshë dhe mbuloheshin me petkat e tyre, duke këmbëngulur me mendjemadhësi (në mosbesim)**."**

"Pastaj i thirra me zë të lartë."

"Më pas ua shpalla edhe botërisht, edhe fshehurazi."

Komentimi

Shfrytëzimi i çdo mundësi për udhëzimin e tyre, por ...!!!

Në vazhdim të diskutimit të çështjes së dërgimit të Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe të thirrjes drejtuar popullit të tij në Rrugën e All'llahut, në këto ajete janë cituar thënie dhe fjalime të dala nga goja e tij, kur u ankua para All'llahut. Këto thënie janë shumë domethënëse dhe kuptimplota.

Fjalimet e Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*, në këtë fushë, mund të jenë të dobishme për të gjithë përhapësit e fesë islame.

Ajeti tregon se Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* thotë: **"O Zoti im, unë e thirra vërtet popullin tim natë e ditë."**.

Pra, për asnjë moment nuk kam hequr dorë e as kam reshtur në udhëzimin dhe thirrjen e tyre në Rrugën e Drejtë.

"Por thirrja ime edhe më tepër i largoi (nga e vërteta)**."**

Është i çuditshëm fakti, se thirrja drejt një gjëje, bëhet shkak për largimin më shumë prej saj. Duke pasur parasysh faktin se suksesi i thirrjeve ka nevojë për rrethana të caktuara, përshtatshmëri, apo tërheqje të ndërsjellë, nuk është për t'u habitur që në disa raste, thirrjet të kenë efekt të kundërt dhe negativ në zemrat e sëmura.

Thënë ndryshe, njerëzit kryeneçë dhe armiq të së Vërtetës, në kohën që i dëgjojnë thirrjet e njerëzve të mëdhenj, Profetëve, rezistojnë fuqishëm ndaj tyre. Kjo rezistencë dhe ky qëndrim i

largon ata më shumë nga All'llahu dhe bëhen më të vendosur në mosbesimin dhe hipokrizinë e tyre.

Kjo është e ngjashme me atë që është thënë në suren "Isra", në ajetin 82: **"Ne të shpallim Kur'anin që është shërim dhe mëshirë për besimtarët, kurse jobesimtarëve nuk u shton tjetër përveç dëshpërimit."**.

Në një vend tjetër, në Kur'an thuhet: **"Ky është Libri që nuk ka dyshim në të,** (sepse është prej All'llahut)**, është udhëzues për ata që janë të devotshëm."**.[1]

Ky ajet tregon se në qenien e njeriut duhet të ekzistojë së paku një nivel devotshmërie, edhe nëse është e dobët, në mënyrë që njeriu të ndihet i gatshëm që të pranojë të vërtetën. Ky nivel devotshmërie quhet "shpirti kërkues i të vërtetës", kurse premisat për pranimin e të vërtetës janë fjalët e drejta.

Më pas, në vazhdimësi të kësaj bisede, Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* thotë: **"Sa herë, që i thirrja për t'i falur Ti, ata shtinin gishtërinjtë në veshë dhe mbuloheshin me petkat e tyre, duke këmbëngulur me mendjemadhësi** (në mosbesim)**."**.

Vendosja e gishtërinjve në vesh, bëhej që të mos dëgjonin zërin e të vërtetës, kurse mbulimi me petkat e tyre, bëhej që mbulesa të shërbejë si një mbështetëse për gishtat e tyre të futur në vesh, në mënyrë që në veshët e tyre të mos futen fare valë zërash dhe në trurin e tyre të mos depërtojë asnjë mesazh.

Ata dëshironin të mbulonin fytyrat e tyre, që edhe shikimi i tyre të mos binte mbi fytyrën engjëllore të Profetit Nuh *(Paqja qoftë*

[1] Sure "El Bekare", ajeti 2.

mbi të!). Ata këmbëngulnin që edhe veshët të mos u dëgjonin gjë, edhe sytë të mos u shihnin gjë.

Po, si mund të arrijë njeriu deri këtu?! Si mund të ketë kaq mllef dhe armiqësi për të Vërtetën?! Si mundet t'ia ndalojë vetes dëgjimin, shikimin, reflektimin dhe meditimin?!

Në disa komentime islame thuhet se një pjesë e popullit të devijuar, i merrnin fëmijët e tyre për dore dhe i çonin te Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe u thoshin: "Kini frikë nga ky burrë, që të mos ju devijojë. Ky është një amanet që na kanë lënë baballarët dhe tani edhe ne po ju rekomandojmë të njëjtën gjë! (në mënyrë që të kemi zbatuar të drejtën e testamentit dhe të dashamirësisë).".[1]

Ky ajet e bën të qartë se Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*, gjatë gjithë jetës së gjatë të tij, vazhdoi gjithnjë thirrjen në Rrugën e Drejtë dhe asnjëherë nuk ndjeu lodhje.

Përveç kësaj, tregon se një prej faktorëve të rëndësishëm të fatkeqësisë së tyre, ishte arroganca dhe mendjemadhësia. Ata e mendonin veten e tyre më lart se Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*, prandaj nuk denjonin t'i përuleshin dhe t'i nënshtroheshin një njeriu të tillë, edhe pse ishte i Dërguar i All'llahut, edhe pse zemra e tij ishte vatra e diturisë dhe e devotshmërisë. Kjo mendjemadhësi dhe arrogancë gjithnjë ka qenë një prej pengesave kryesore për të ecur në Rrugën e Drejtë. Frytin e shëmtuar dhe të lig të këtyre veseve e vërejmë përgjatë gjithë historisë njerëzore, në jetën e njerëzve jo besimtarë.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 361.

Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* përsëri vazhdon me fjalët e veta përpara All'llahut: **"Pastaj i thirra me zë të lartë."**. Në tubimet publike, me zë të lartë, i ftoja ata në besimin në Një Zot.

Nuk u mjaftova me kaq, por: **"Më pas ua shpalla edhe botërisht, edhe fshehurazi."**.

Në bazë të disa thënieve të komentuesve të Kur'anit, Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*, në mënyrë që të ndikonte tek ky popull kryeneç dhe egoist, për të përcjellë sa më mirë thirrjen e tij, ndoqi tri rrugë të ndryshme: Ndonjëherë i ftonte njerëzit fshehurazi dhe përballej me katër lloj reagimesh: (fusnin gishtat në vesh, i mbështillnin kokat me petkun e tyre, si dhe këmbëngulnin në politeizëm dhe tregoheshin arrogantë).

Ndonjëherë i thërriste njerëzit publikisht dhe hapur, ndonjëherë përdorte metodën e përzierjes së thirrjes së hapur dhe thirrjes së fshehtë. Por asnjëra prej tyre, nuk ishte ndikuese.[1]

Njeriu është i tillë që disa herë shkon aq larg në devijimin e tij, saqë rrënjët e degradimit fitojnë një qëndrueshmëri dhe ndikojnë thellë në qenien e tij. Kësisoj, te njeriu, pak e nga pak, formohet një natyrë e dytë. Në këto raste, as ftesa dhe as thirrja e njerëzve të Zotit nuk do të ndikojë tek ai. Atij nuk do t'i sjellin dobi as Mesazhet e All'llahut.

[1] Tefsiri "Fakhru Rrazij", vëll. 11, f. 136.

Hulumtim

1- Shembulli i thirrjes

Ajo që u tha në ajetet më lart, në lidhje me thirrjen e Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*, përveç asaj që thirrjet e tij janë një faktor i ngushëllimit të Profetit dhe besimtarëve të paktë të Mekës, është dhe një program i përgjithshëm dhe universal për të gjithë misionarët në Rrugën e All'llahut.

Ai asnjëherë nuk pretendonte që njerëzit t'i përgjigjeshin thirrjes së tij, duke u tubuar në qendër të qytetit, sapo ai t'ua transmetonte Mesazhin e All'llahut në kushte tepër komode dhe pa asnjë mundim. Ai nuk pretendonte që të gjithë t'i kishin sytë nga ai dhe ta dëgjonin me vëmendje.

Nga tërësia e ajeteve, arrijmë të kuptojmë që (siç dhe është transmetuar në disa hadithe) Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*, ndonjëherë, për të kryer misionin e tij, herë shkonte në shtëpitë e njerëzve, herë bisedonte me ata në mënyrë individuale në tregje, apo nëpër rrugë dhe, me durim dhe me zë të ëmbël, i ftonte ata në fenë islame.

Ndonjëherë merrte pjesë në tubimet publike dhe të përbashkëta, të cilat organizoheshin për qëllime tjera, si p.sh: për ahengje apo hidhërime dhe me zë të lartë dhe të qartë i ftonte ata në Rrugën e All'llahut. Por në të gjitha rastet, përballej me reagime të ashpra, të papërshtatshme, fyese dhe përqeshje, ose përballej me sulme. Sido që të ndodhte, ai asnjëherë nuk hoqi dorë nga thirrja në Rrugën e Drejtë.

Ky durim stoik dhe ajo dhembshuri e spikatur, në mënyrë të papërshkrueshme, si dhe këmbëngulja dhe qëndresa e pashembullt, ishin kapitali i tij në rrugën e thirrjes në Fenë e All'llahut, në Fenë e Vërtetë.

Më i çuditshëm se e gjithë kjo, ishte fakti që përgjatë nëntëqind e pesëdhjetë viteve të thirrjes së tij, afërsisht tetëdhjetë persona i besuan dhe e pranuan thirrjen e tij. Në qoftë se këtë numër e përpjesëtojmë me vitet e thirrjes së tij, del se për udhëzimin e secilit person ai pothuajse ka bërë thirrje dymbëdhjetë vite me radhë.

Në qoftë se misionarët e fesë islame do të kishin një qëndrueshmëri dhe këmbëngulje mbresëlënëse si kjo, a mund të mos përhapej dhe mund të mos pranohej masivisht Islami?!

2- E përse largimi nga e vërteta?

Ndonjëherë njeriu çuditet, se si është e mundur, që nën këtë qiell, të ketë njerëz të tillë, të cilët nuk janë në gjendje të dëgjojnë as të vërtetën dhe i largohen asaj?! Këtu nuk bëhet fjalë për pranim, por bëhet fjalë për dëgjim.

Historia na tregon se njerëz të tillë kanë qenë të shumtë në histori.

Jo vetëm populli i Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*, në kohën që i ftonte në monoteizëm, mbështilleshin me petkun e tyre, në mënyrë që të mos shikonin dhe të mos dëgjonin të vërtetën, por dhe në kohën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, siç shprehet Kur'ani, ekzistonte një

grup njerëzisht që, kur zëri i këndshëm i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ngrihej lart gjatë këndimit të ajeteve kur'anore, krijonin shumë zhurmë dhe rrëmujë, me qëllim që askush të mos i dëgjonte fjalët e tij: **"Ata që nuk besuan thanë: 'Mos e dëgjoni këtë Kur'an dhe, kur të lexohet ai, ju bëni zhurmë** (bërtisni)**, që ta pengoni."**.[1]

Në historinë e përgjakshme të Qerbelasë, gjithashtu, është thënë: "Kur Imam Husejni *(Paqja qoftë mbi të!)*, Prijësi i dëshmorëve, dëshironte të udhëzonte dhe të zgjonte kundërshtarët, armiqtë krijuan aq shumë rrëmujë dhe zhurmë, sa zëri i tij humbi në mesin e tyre.".[2]

Edhe sot përsëritet e njëjta situatë, por në forma dhe mënyra të tjera. Sot ndjekësit e rrugës së shtrembër, me anë të llojeve të ndryshme të aktiviteteve argëtuese, por helmuese për nga përmbajtja, si muzikë e ndaluar, përdorime të drogës dhe të ngjashme me to, krijojnë dhe kanë krijuar një atmosferë të atillë, sa njerëzit, veçanërisht rinia, të mos jetë në gjendje ta dëgjojë zërin e këndshëm të Profetëve të All'llahut.

[1] Sure "Fusilet", ajeti 26.

[2] "Biharul Enuar", vëll. 45, f. 8.

Ajetet 10 – 14

فَقُلْتُ اسْتَغْفِرُوا رَبَّكُمْ إِنَّهُ كَانَ غَفَّارًا١٠ يُرْسِلِ السَّمَاءَ عَلَيْكُمْ مِدْرَارًا١١ وَيُمْدِدْكُمْ بِأَمْوَالٍ وَبَنِينَ وَيَجْعَلْ لَكُمْ جَنَّاتٍ وَيَجْعَلْ لَكُمْ أَنْهَارًا١٢ مَا لَكُمْ لَا تَرْجُونَ لِلَّهِ وَقَارًا١٣ وَقَدْ خَلَقَكُمْ أَطْوَارًا١٤

"E u thashë: Kërkoni falje nga Zoti juaj, i Cili është Falës i madh."

"Që Ai t'ju dërgojë shi të bollshëm."

"T'ju shtojë pasurinë dhe fëmijët tuaj dhe të bëjë për ju kopshte e lumenj."

"Ç'është kështu me ju, që nuk e madhëroni All'llahun siç duhet (duke e pasur frikë)**?!"**

"Ndërkohë që Ai ju ka krijuar në etapa (etapat e embrionit)**? "**

Komentimi

Shpërblimi i besimit në këtë botë

Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* vazhdon të udhëzojë popullin e tij kokëfortë dhe rebel me deklarata. Ai u premton atyre që, nëse pendohen sinqerisht dhe heqin dorë nga politeizmi dhe mëkati, All'llahu i Madhëruar do t'ua hapi dyert e mëshirës së Tij. Ai u thotë: **"Kërkoni falje nga Zoti juaj, i Cili është Falës i madh."**.

Jo vetëm që All'llahu do t'ua falë mëkatet, por, nëse veproni në këtë mënyrë, Ai, në mënyrë të vazhdueshme, do t'ju dërgojë nga qiejt shi të bollshëm: **"Që Ai t'ju dërgojë shi të bollshëm."**.

Thënë shkurt, juve do t'ju përfshijë edhe "shiu" i mëshirës shpirtërore, edhe "shiu" i begatisë materiale.

Për të sqaruar më tej këtë situatë, ajeti thotë: **"Që Ai t'ju dërgojë shi të bollshëm"**, që do të thotë se do të bjerë aq shumë shi, sa do të duket sikur qielli është duke zbritur! Por meqenëse ky shi është shi i mëshirës, as nuk do të shkatërrojë ndonjë gjë dhe as nuk do të sjelli ndonjë dëm. Ai do të jetë burim i lulëzimit, i gjelbërimit dhe i freskisë.

Më pas ajeti shton: **"T'ju shtojë pasurinë dhe fëmijët tuaj dhe të bëjë për ju kopshte e lumenj."**.

Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* u ka premtuar atyre një begati të madhe shpirtërore dhe pesë begati të mëdha materiale. Begatia e madhe shpirtërore është falja e mëkateve dhe spastrimi nga përlyerja me politeizëm dhe nga rebelimi (mosbindja). Begatitë materiale janë: lëshimi i shirave të dobishme në kohë dhe me

bollëk, shtimi i pasurisë, shtimi i fëmijëve (kapitali njerëzor), kopshte të gjelbëruara, si dhe lumenj me ujë të rrjedhshëm.

Sipas dëshmisë së Kur'anit të Shenjtë, besimi dhe devotshmëria janë shkak i begatisë së kësaj bote dhe i Botës Tjetër, Ahiretit.

Në disa transmetime është thënë se, kur ky popull kryeneç dhe rebel, e refuzoi thirrjen e Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*, ata i kaploi thatësira dhe uria. Shumë prona të tyre u asgjësuan dhe shumë fëmijë vdiqën. Gratë u bënë sterile, ose lindnin më pak fëmijë. Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* u tha atyre se, nëse besoni në Një Zot, të gjitha këto fatkeqësi dhe tragjedi do të ndërpriten. Ata nuk u kushtuan rëndësi fjalëve të tij dhe sërish vazhduan me kryeneçësinë e tyre, derisa tek ata erdhi dënimi përfundimtar i All'llahut dhe i zhduku të gjithë.

Më pas, edhe një herë tjetër, i rikthehet paralajmërimit: **"Ç'është kështu me ju, që nuk e madhëroni All'llahun siç duhet** (duke e pasur frikë)**, ndërkohë që Ai ju ka krijuar në etapa** (etapat e embrionit)**?"**.

Në fillim ju ishit një pikë sperme, pa vlerë. Nuk kaloi shumë kohë dhe ju shndërroi në formën e gjakut të ngjizur, *(alakatun)*. Më pas ju bëri në formën e një cope mishi të përtypur, *(mudgatatun)*. Ju dhuroi formë dhe gjymtyrë njerëzore, ju dhuroi rroba për të veshur, ju dhuroi shpirtin dhe aftësinë e lëvizjes. Në këtë mënyrë, njëra pas tjetrës, i kaluat fazat e ndryshme embrionale, derisa lindët nga barku i nënës në formën e një njeriu të plotë. Pastaj vazhduat jetën në format e ndryshme të saj. Ju gjithnjë jeni nën kujdesin e All'llahut dhe gjithnjë Ai ju bën në një formë të re, duke ju ndërruar pamjen e jashtme dhe trajtën e trupit tuaj. Pra, me kalimin e viteve,

merrni një pamje plotësisht tjetër dhe ngjasoni si një krijesë e re. Atëherë, si është e mundur që nuk përkuleni përpara Madhështisë së Krijuesit tuaj?!

Jo vetëm që shndërroheni fizikisht në trajta të ndryshme, por edhe shpirti juaj gjithnjë është në ndryshim. Secili nga ju ka një talent. Në çdo kokë ekziston një imagjinatë dhe në çdo zemër një dashuri. Të gjithë ju, gjithnjë, ndodheni në fazën e ndryshimit. Ndjenjat e fëmijërisë rrinë në vendin e tyre dhe ndjenjat e rinisë ua lënë vendin ndjenjave të pleqësisë.

Në këtë mënyrë, All'llahu i Madhëruar, gjithnjë, në çdo vend dhe në çdo hap të jetës suaj, është me ju. Ai ju udhëheq dhe ju udhëzon me gjithë këto bekime dhe me furnizimin e Tij. Atëherë, përse gjithë ky mosbesim dhe mos respektim?!

Hulumtim

Lidhja e devotshmërisë me mirëqenien

Nga ajetet të ndryshme kur'anore, si p.sh, nga ajetet e lartpërmendura, na bëhet e qartë se besimi dhe drejtësia janë burim i zhvillimit të shoqërive, kurse politeizmi, shtypja dhe mëkati janë shkak i shkatërrimit të tyre.

Në ajetin 96 të sures "El A'raf" lexojmë: **"Sikur banorët e këtyre vendbanimeve të kishin besuar dhe të ishin ruajtur, Ne do**

t'u hapnim begati nga qielli e toka, por ata përgënjeshtruan, andaj i dënuam me shkatërrim për atë që merituan.".

Në ajetin 41 të sures "Er Rrum" lexojmë: **"Për shkak të veprave** (të këqija) **të njerëzve, janë shfaqur në tokë e në det të zeza** (bela, skamje, katastrofa, humbje e bereqetit, etj)**, që ata të përjetojnë një pjesë të asaj të keqeje që e bënë, me qëllim që të tërhiqen** (nga të këqijat)**."**.

Në ajetin 30 të sures "Esh Shura" thuhet: **"Çfarëdo e keqe që mund t'ju godasë, ajo është pasojë e veprave tuaja** (të këqija) **e për këto e për shumë të tjera, Ai ju fal."**.

Gjithashtu, në ajetin 66 të sures "El Maide" thuhet: **"Dhe, sikur ta zbatonin Teuratin, Inxhilin dhe Kur'anin që u zbritën nga Zoti i tyre, ata do të kishin furnizim me bollëk, nga qielli dhe nga toka. Është një grup i drejtë** (i matur) **prej tyre, por është e keqe ajo që punojnë shumica prej tyre."**.

Ka dhe shumë ajete të tjera të ngjashme me to.

Kjo "ndërvarjeje", është një marrëdhënie shpirtërore, e cila sjell plot ndikime materiale.

Politeizmi dhe mosbesimi janë burim i mungesës së përgjegjësisë, i moszbatimit të ligjit dhe i lënies në harresë të vlerave morale dhe bëhen shkak i humbjes së unitetit, integritetit dhe solidaritetit në shoqëri, i lëkundjes së bazave të besimit, i shkatërrimit të forcave njerëzore dhe ekonomike, i shkatërrimit të barazisë shoqërore.

Është e qartë se, nëse në një shoqëri mbizotërojnë këto çështje, ajo shumë shpejt do të degradojë dhe do të përballet me humbjen dhe shfarosjen.

Në qoftë se një grup shoqëror ka pasur mungesë të besimit dhe të devotshmërinë dhe përsëri ka pasur përmirësim relativ të kushteve materiale, ajo ka ndodhur, sepse ai grup shoqëror i ka zbatuar relativisht disa prej parimeve morale të trashëgimisë së Profetëve të kaluar.

Përveç ajeteve të lartpërmendura, edhe në hadithet islame, gjithashtu, është folur shumë rreth kësaj çështjeje. Është treguar se pendimi dhe heqja dorë prej mëkatit bëhet shkak për shtimin e pasurisë dhe të begatisë së jetesës.

Kështu, në një hadith të transmetuar nga Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, për këtë çështje, thuhet: "*Pendohu shumë, sepse sa më shumë të pendohesh aq më shumë do të shtohet rrisku.*".[1]

Në një hadith tjetër, të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: "*Kujt i ka dhuruar Zoti një begati, le ta falënderojë Atë, kurse kujt i është vonuar risku dhe shtimi i pasurisë, le të kërkojë falje nga Zoti. Njeriun që e ka kapluar brenga, si pasojë e një tragjedie, le të thotë: 'La haule ue la kuuete il'la bil'lah.'*".[2]

Në librin "Nehxhul Belaga", gjithashtu, lexojmë: "*O Zoti im! Derdhe mbi ne shiun Tënd, bekimin Tënd, pajisjen Tënde dhe mëshirën Tënde. Na shuaj etjen me shi të frytshëm, i cili shuan etje dhe përmes të*

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn" , vëll. 5, f. 424.

[2] Tefsiri "Nuruth Thekalejn" , vëll. 5, f. 424.

cilit Ti bën që të rritet ajo që është zhdukur. Me ndihmën e shiut Tënd, ringjallet ajo që ishte shuar, shiu Yt do të japë dobi, me të do të ujiten fushat, me të Ti do të bësh që me vrull të rrjedhin lumenjtë, të lulëzojnë pemët dhe të zbresin çmimet. Me të vërtetë, Ti ke pushtet mbi çdo gjë që Ti dëshiron!".[1]

Një nga llojet e dënimeve, për shkak të mëkateve, është privimi prej begative në këtë botë. Në momentin që njeriu pendohet dhe merr udhën e dëlirësisë e të devotshmërisë, All'llahu i Madhëruar ia zhduk atij këto dënime.[2]

[1] "Nehxhul Belaga", Fjalimi 143.

[2] Një sqarim tjetër, në lidhje me këtë temë, nën titull "Mëkatet janë shkak i shkatërrimit të shoqërive", kemi dhënë në ajetin 52 të sures "Hud", të po këtij tefsiri.

Ajetet 15 – 20

أَلَمْ تَرَوْا كَيْفَ خَلَقَ اللَّهُ سَبْعَ سَمَاوَاتٍ طِبَاقًا١٥ وَجَعَلَ الْقَمَرَ فِيهِنَّ نُورًا وَجَعَلَ الشَّمْسَ سِرَاجًا١٦ وَاللَّهُ أَنْبَتَكُمْ مِنَ الْأَرْضِ نَبَاتًا١٧ ثُمَّ يُعِيدُكُمْ فِيهَا وَيُخْرِجُكُمْ إِخْرَاجًا١٨ وَاللَّهُ جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ بِسَاطًا١٩ لِتَسْلُكُوا مِنْهَا سُبُلًا فِجَاجًا٢٠

“A nuk e shihni se si All’llahu i ka krijuar shtatë qiejt njëri mbi tjetrin,”

“dhe në ta e ka bërë Hënën dritë, kurse Diellin e ka bërë fener?”

“All’llahu ju ka krijuar nga toka, ashtu si bimët.”

“Pastaj ju kthen tek ajo dhe prej saj sërish do t’ju nxjerrë.”

“All’llahu për ju e ka bërë Tokën shtrojë të gjerë,”

“që të ecni nëpër të, nëpër rrugët e gjera.”

Komentimi

All'llahu iu krijoi juve nga toka ashtu si bimët

Përmes diskutimeve të detajuara dhe të argumentuara për politeistët kryeneçë, Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*, në fillim u përpoq t'i ndërgjegjësojë ata. Ai u përpoq të depërtojë në thellësinë e shpirtit të tyre, me qëllim që ata të shohin shenjat shpirtërore brenda qenies së tyre (ashtu siç e diskutuam në ajetet e kaluara). Më pas, siç bëhet qartë dhe nga ajetet e lartpërmendura, i ftoi ata që të reflektojnë dhe të studiojnë shenjat e All'llahut, që ekzistojnë në botën e madhe objektive dhe t'i sodisin ato.

Është kjo arsyeja që ai fillon me qiellin dhe thotë: **"A nuk e shihni se si All'llahu i ka krijuar shtatë qiejt njëri mbi tjetrin."**.

Fjala *"tabakan"* është përdorur me kuptimin e fjalës *"mutabikatun"*, e cila ndonjëherë nënkupton pozicionimin e një gjëje mbi një gjë tjetër, kurse ndonjëherë vjen edhe me kuptimin e simetrisë dhe përputhshmërisë së dy gjërave me njëra-tjetrën. Në këtë kontekst, të dy kuptimet janë të sakta.

Fjala *"tabakan"* është përdorur me kuptimin e parë. Ajo tregon se shtatë qiejt janë të vendosur njëri mbi tjetrin. Siç e kemi trajtuar edhe në komentimin e shtatë qiejve, interpretim i mundshëm është që yjet dhe planetet, të cilat ne i shohim, janë pjesë e qiellit të parë, por ekzistojnë edhe gjashtë botë të tjera, të vendosura njëra mbi tjetrën, për të cilat shkenca dhe dituria e

njeriut, akoma nuk ka njohuri për to, por që në të ardhmen mund t'i zbulojë këto botë të çuditshme njëra mbi tjetrën.[1]

Sipas kuptimit të dytë, Kur'ani, me ngjashmërinë dhe përputhshmërinë e shtatë qiejve, vë në pah rregullin, madhështinë dhe bukurinë në krijim.

Më pas, ajeti shton: **"dhe në ta e ka bërë Hënën dritë, kurse Diellin e ka bërë fener?"**.

Është e vërtetë se në shatë qiejt ekzistojnë me miliona e miliona yje ndriçuese, të cilët janë më ndriçues se sa dielli dhe hëna jonë. E rëndësishme për ne dhe që ka ndikim në jetën tonë (në Tokë) është fakt se Dielli dhe Hëna të Sistemit tonë Diellor, ndriçojnë hapësirën e tonë, njëri gjatë ditës dhe tjetra gjatë natës. Përdorimi i fjalës *"siraxh"* - *"fener"* për Diellin dhe *"dritë"* për Hënën është për arsye se drita e Diellit del nga brendësia e tij, ngjashëm me fenerin (llambën), kurse drita e Hënës nuk del nga brendësia e saj, por është e ngjashme me reflektimin e një pasqyre. Kështu që fjala *"nur"* - *"dritë"* këtu është përdorur me kuptim gjithëpërfshirës.

Ky ndryshim i shprehjes është pasqyruar dhe në ajete të tjera në Kur'an. Për këtë çështje, kemi dhënë më shumë shpjegim në ajetin 5 të sures "Junus".

Më pas, Kur'ani, edhe një herë i referohet krijimit të njeriut: **"All'llahu ju ka krijuar nga toka, ashtu si bimët."**.

Fjala *"el enbatu"* është përdrur për njeriun për këto arsye:

[1] Në lidhje me komentimet e ndryshme, ndaj shtatë qiejve, kemi dhënë shpjegim më të detajuar në ajetin 29 të sures "El Bekare", vëll. 1, i po këtij tefsiri.

Së pari: Njeriu i parë është krijuar nga dheu.

Së dyti: Të gjitha lëndët ushqimore, me të cilat njeriu ushqehet, rritet dhe zhvillohet, janë nga toka, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, si p.sh. perimet, frutat, qoftë në mënyrë të tërthortë, siç është mishi i shtazëve.

Së treti: Ekziston një ngjashmëri e madhe mes njeriut dhe bimës. Shumë prej rregullave të të ushqyerit, të riprodhimit, të zhvillimit dhe të rritjes së bimëve, vlejnë edhe për njeriun.

Kjo fjalë e përdorur për njeriun është e pasur në kuptime dhe tregon se puna e All'llahut në çështjen e udhëzimit nuk është vetëm si puna e një mësuesi apo edukatori, por është e ngjashme me punën e një kopshtari, i cili i mbjell farat e bimëve në kohë të caktuar dhe të përshtatshme, pastaj përkujdeset dhe i kultivon, në mënyrë që të mundësojë lulëzimin e tyre.

Për Merjemen *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, në ajetin 37 të sures "Ali Imran", lexojmë: **"...e rriti** (lëvroi) **me një edukatë të mirë e të plotë..."**.

Më pas, ajeti i kthehet çështjes së Ringjalljes, e cila ishte një prej çështjeve të komplikuara për politeistët dhe thotë: **"pastaj ju kthen tek ajo dhe prej saj sërish do t'ju nxjerrë."**.

Në fillim ju krijoi nga toka dhe përsëri do t'ju kthejë tek ajo. Po Ai, që ka qenë i aftë t'ju krijojë nga toka, është në gjendje t'ju rikrijojë përsëri, pasi të jeni kalbur.

Transformimi i çështjes së "monoteizmit" në "ringjallje" është pasqyruar në një formë shumë interesante në ajetet e lartpërmendura. Ai tregon lidhjen e ngushtë që ekziston mes

këtyre të dyjave. Në këtë mënyrë, Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* argumenton karshi politeistëve vërtetësinë e Ringjalljes dhe të monoteizmit me anë të rendit ekzistues.

Në vazhdimësi, ajeti u rikthehet shenjave objektive (të botës së jashtme), si dëshmi të monoteizmit dhe diskuton për mirësitë që mban Toka (me mënyrën e krijimit të saj) dhe shton: **"All'llahu për ju e ka bërë Tokën shtrojë të gjerë."**.

Toka nuk është shumë e ashpër, në mënyrë që njeriu të mos mundohet kur të ecë mbi të. Ajo nuk është as është shumë e butë, që njerëzit të fundosen në të e të mos ecin dot.

As nuk është shumë e nxehtë dhe as shumë e ftohtë. Ngrohja e tepërt do të shkaktonte shqetësime dhe probleme, kurse i ftohti dhe lagështia e madhe, do ta bënin problematike jetesën. Pra, Toka ofron të gjitha kushtet për jetesë.

Jo vetëm fushat e rrafshëta janë si qilima të shtruara, por edhe malet me luginat dhe grykat nëpër të cilat kalohet mes tyre, janë shtresa të përdorshme. Pra, njeriu mund të jetojë në çdo cep të tokës, siç thotë dhe ajeti: **"që të ecni nëpër të, nëpër rrugët e gjera."**.

Fjala *"fixhaxhun"* është shumësi i fjalës *"fexh"* dhe ka kuptimin e luginës së gjerë midis dy maleve. Thuhet se ka kuptimin e rrugës së gjerë.

Si rrjedhojë, Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*, në këtë pjesë të thënieve të tij, ndonjëherë përmend shenjat e All'llahut në qiejt dhe trupat qiellorë dhe ndonjëherë përmend begatitë e shumëllojshme të All'llahut në tokë. Herë të tjera përmend konstruksionin e njeriut

dhe çështjen e jetës së tij, të cilat përbëjnë argument, si për njohjen e All'llahut, ashtu edhe për argumentimin e Ringjalljes. Por as paralajmërimet, as përgëzimet e nxitjet dhe as arsyetimet logjike, nuk ndikuan te zemrat e errësuara të këtij populli kryeneç. Ata vazhdimisht ndoqën rrugën e kundërshtimit dhe të mohimit dhe ishin betuar, që të mos e pranojnë të vërtetën. Në ajetet vijuese do të shohim se ku i çoi kryeneçësia e tyre.

Ajetet 21 – 25

قَالَ نُوحٌ رَبِّ إِنَّهُمْ عَصَوْنِي وَاتَّبَعُوا مَنْ لَمْ يَزِدْهُ مَالُهُ وَوَلَدُهُ إِلَّا خَسَارًا﴿٢١﴾ وَمَكَرُوا مَكْرًا كُبَّارًا﴿٢٢﴾ وَقَالُوا لَا تَذَرُنَّ آلِهَتَكُمْ وَلَا تَذَرُنَّ وَدًّا وَلَا سُوَاعًا وَلَا يَغُوثَ وَيَعُوقَ وَنَسْرًا﴿٢٣﴾ وَقَدْ أَضَلُّوا كَثِيرًا وَلَا تَزِدِ الظَّالِمِينَ إِلَّا ضَلَالًا﴿٢٤﴾ مِمَّا خَطِيئَاتِهِمْ أُغْرِقُوا فَأُدْخِلُوا نَارًا فَلَمْ يَجِدُوا لَهُمْ مِنْ دُونِ اللَّهِ أَنْصَارًا﴿٢٥﴾

“Nuhu tha: O Zoti im, ata më kundërshtuan mua dhe u dhanë pas atyre njerëzve, pasuria dhe fëmijët e të cilëve nuk kanë sjellë gjë tjetër, veç shkatërrimit.”

“Ata kurdisën një kurth të madh.”

“Dhe thanë: ‘Mos i lini kurrsesi zotat tuaj! Mos e lini kurrsesi as Veddin, as Suvain, as Jeguthin, as Jaukën, as Nesrin.’”

“E kështu kanë futur në rrugë të gabuar shumë (njerëz)**. Prandaj, keqbërësve mos u shto gjë tjetër, veç humbjes!”**

“Për shkak të gjynaheve të tyre, ata u përmbytën dhe u hodhën në zjarr. Ata nuk gjetën mbrojtës tjetër për veten në vend të All’llahut.”

Komentimi

Mirësia e All'llahut është me ty

Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* ishte përpjekur për qindra vite për atë popull, por me përjashtim të një grupi shumë të vogël që i besuan atij, kurse të tjerët vazhduan të këmbëngulnin në politeizëm, idhujtari, devijim nga Rruga e Drejtë. Ai i humbi shpresat që ushqente për udhëzimin e tyre dhe i drejtua All'llahut me lutje të arsyetuara dhe i kërkoi Atij dënimin e këtij populli.

Këtë e lexojmë dhe në ajetet në vijim, kur Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* thotë: **"O Zoti im, ata më kundërshtuan mua dhe u dhanë pas atyre njerëzve, pasuria dhe fëmijët e të cilëve nuk kanë sjellë gjë tjetër, veç shkatërrimit."**.

Ky ajet tregon se populli i Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* ishte dhënë shumë pas pasurisë dhe fëmijëve të shumtë që kishin. Ai popull nuk e përdorte pasurinë dhe as fëmijët për të përmirësuar veten e për të ecur në Rrugën e Drejtë, por jepej pas imoralitetit dhe korrupsionit. Ai popull nuk u shërbente njerëzve dhe as i nënshtrohej Krijuesit të tyre. Përkundrazi, kushtet e mira të jetesës dhe pasuria e madhe, u bënë shkak i mendjemadhësisë, i rebelimit dhe i rënies së tyre.

Po të shohim historinë e njerëzimit, mësojmë se shumë prej udhëheqësve të popujve të ndryshëm kanë qenë të kësaj kategorie njerëzish. Ata ishin persona që ishin të dhënë vetëm pas pasurisë, pas marrëdhënieve jashtëmartesore, të cilat çonin në lindjen e

fëmijëve jashtë kurore, ishin të dhënë pas rebelimit, pas kryeneçësisë, pas imponimit të bindjeve dhe ideve të tyre mbi masat e shtypura dhe tërheqjen e tyre si me zinxhir në udhën e devijimit.

Ajeti 22 shton: **"Ata kurdisën një kurth të madh."**.

Fjala *"kub'barun"* është përmendur në formë të pashquar dhe tregon se ata kishin kurdisur kurthe të mëdha djallëzore për çorientimin, pengimin dhe largimin e popullit prej thirrjes së Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*. Po ç'kurthe ishin këto? Kjo mbetet enigmë dhe është e paqartë për ne.

Ekziston mundësia që kjo të ishte çështja e adhurimit të idhujve, sepse sipas disa transmetimeve, adhurimi i idhujve nuk kishte ekzistuar para Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*. Ishte populli i Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* ai që shpiku adhurimin e idhujve. Thelbi i kësaj çështjeje shpjegohet me faktin që në largësinë kohore midis Profetit Adem dhe Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi ta!)* kishte njerëz të lavdishëm dhe të drejtë, për të cilët njerëzit shprehnin dashuri, por djalli (dhe njerëzit me tipare satanike) abuzuan me dashurinë e njerëzve dhe i shtynë ata të krijonin statuja të këtyre burrave të mëdhenj. Jo vetëm kaq, por i orientuan, që t'i duan dhe respektojnë këto statuja, në respekt të atyre burrave të mëdhenj.

Nuk kaloi shumë kohë dhe brezat e mëvonshëm i lanë në harresë faktet historike, me të cilat lidhej ky respekt dhe filluan të imagjinojnë se këto statuja, si të tilla, janë krijesa të dashura, të cilat duhet të adhuroheshin. Në këtë mënyrë, ata filluan me adhurimin e idhujve. Tiranët arrogantë e konsideruan këtë si një rast dhe si një

metodë shumë efikase për sundimin mbi ta. I futën në kurth dhe, me të vërtetë, ky ishte një kurth i madh.

Ka gjasa që ajeti në vijim, të jetë dëshmi e kësaj çështjeje. Ky ajet, pasi përmend këtë kurth të madh, deklaron: **"Mos i lini kurrsesi zotat tuaj!"**.

Pra, në asnjë mënyrë mos pranoni thirrjen e Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* për të adhuruar All'llahun, Një dhe të Vetëm, që asnjëherë nuk shihet me sy dhe preket me dorë.

Veçanërisht, këmbëngulja e tyre ishte mbi pesë idhuj, të cilët Kur'ani i përmend: **"Mos e lini kurrsesi as Veddin, as Suvain, as Jeguthin, as Jaukën, as Nesrin!"**.

Nga dëshmitë e ndryshme, përftohet se këta pesë idhuj kishin veçori dalluese dhe ai popull i devijuar u kushtonte vëmendje të veçantë. Për këtë arsye, udhëheqësit oportunistë të tyre, këmbëngulnin në adhurimin e këtyre idhujve.

Rreth çështjes se nga dolën këta pesë idhuj, ekzistojnë interpretime të ndryshme:

1- Disa kanë thënë se këta janë emrat e pesë njerëzve të drejtë, të cilët kanë jetuar para Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*. Pasi vdiqën, njerëzit të nxitur nga djalli, krijuan statujat e tyre, si kujtim dhe i nderuan ata. Kështu, gradualisht, arritën deri tek adhurimi i idhujve.

2- Disa të tjerë, kanë shprehur mendimin se këta janë emrat e pesë fëmijëve të Profetit Adem *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe, kur ndonjëri prej tyre vdiste, i ndërtonin një statujë për ta kujtuar. Me kalimin e kohës, këto çështje u lanë në harresë dhe në kohën e

Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* adhurimi i këtyre idhujve kishte arritur kulmin.

3- Disa të tjerë janë të mendimit se këta janë emrat e idhujve, të cilët janë ndërtuar në kohën e Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*, sepse Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* i pengonte njerëzit të bënin tavaf (të silleshin) rreth varrit të Ademit.

Disa njerëz, me nxitjen e djallit, në vend të kësaj ngritën statuja dhe filluan t'i adhuronin ato.[1]

Për çudi, këta pesë idhuj u transferuan tek arabët paganë dhe çdo fis zgjodhi për vete një prej këtyre statujave. Megjithëse mundësia e transferimit është e vogël, më e besueshme është se tek arabët paganë u transferuan vetëm emrat e tyre dhe ata ndërtuan statuja të tjera, të cilat i quajtën me të njëjtat emra.

Disa komentues të Kur'anit kanë transmetuar nga Ibn Abasi se këta pesë idhuj u varrosën gjatë përmbytjes së Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*. Në periudhën e injorancës arabe, djalli i nxori ato dhe i ftoi njerëzit në adhurimin e tyre.[2]

Gjithsesi, mënyra e ndarjes së këtyre idhujve midis fiseve injorante arabe, është çështje diskutimi.

Disa pohojnë se idhulli i Vedasë i përkiste fisit Beni Kelb dhe ndodhej në tokën e quajtur Deumetul Xhendel, qytet në afërsi të Tebukut, që sot njihet me emrin Xheuf.

---

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 364; tefsire "Ali ibn Ibrahim", tefsiri "Ebul Fettuh Rrazij" dhe komentime të tjera kanë cituar ajetin në fjalë.

[2] Tefsiri "Kurtubij", vëll. 10, f. 6787.

Idhulli Seua'an i përkiste fisit Hudejl që ndodhej në tokën e quajtur Rihat.

Idhulli Jeguth i përkiste fisit Beni Katifit, ose fisit Beni Medhxheh.

Idhulli Jeuk i përkiste fisit Hamedan.

Idhulli Nesr i përkiste fisit Dhil Kela'u, që ishte prej fiseve Hamir.[1]

Tri prej këtyre idhujve (Jeguth, Jeuk dhe Nesr) ndodheshin në tokën e Jemenit, por pas mbizotërimit të Dhunivasit mbi Jemenin, u zhdukën dhe populli u detyrua të konvertohej në fenë judaiste.[2]

Historiani i njohur, El Uakidij thotë: "Idhulli i Vud ishte në formën e një mashkulli, kurse idhulli i Seva'a në formën e një femre. Jeguth ishte në formën e një luani, kurse idhulli i Jeuk në formën e një kali. Idhulli i Nesr ishte në formën e shqiponjës.[3]

Arabët paganë, sidomos banorët e Mekës, kishin dhe idhuj të tjerë që i adhuronin, si p.sh, Hubul, që konsiderohej si idhulli më i madh i tyre dhe ndodhej në pjesën e brendshme të Qabesë. Gjatësia e tij arrinte 18 metra.

[1] Tefsiri "Maxhmeul Bejan", vëll. 10, f. 364 dhe "I'lamul Kur'an", f. 631.

[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 364 dhe "I'lamul Kur'an", f. 631.

[3] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 364.

Idhull tjetër ishte Isafi, i cili ndodhej përballë Hexherul Esved; idhulli Naile ndodhej përballë Ruknul Jemanij (qoshja në jugperëndim të Qabes). Përveç tyre, ishin dhe idhujt Lat dhe Uzza.[1]

Më pas, Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* shton: **"E kështu kanë futur në rrugë të gabuar shumë** (njerëz)**. Prandaj, keqbërësve mos u shto gjë tjetër, veç humbjes!"**.

Humbja dhe i devijimi i keqbërësve dhe shtypësve është shkaku i privimit të tyre nga mëshira e All'llahut dhe i fatkeqësive të tjera, siç janë dënimet që ata i merrnin si pasojë e dhunës dhe e ligësisë së tyre. All'llahu ua merr atyre dritën e besimit dhe ua zëvendëson me errësirën e mosbesimit.

Këto dënime ishin efekti i veprimeve të tyre, të cilat i atribuohen All'llahut, sepse çdo gjë që bie mbi çdo krijesë, është me lejen e Tij.

Këtu nuk ka asnjë kontradiktë, lidhur me urtësinë e Zotit dhe çështjes së besimit, politeizmit, udhëzimit dhe devijimit, si dhe me vullnetin e lirë të njeriut.

Në ajetin e fundit të diskutimit tonë, All'llahu i Madhëruar Fjalën e Tij të fundit, në lidhje me këtë çështje, e thotë në këtë mënyrë: **"Për shkak të gjynaheve të tyre, ata u përmbytën dhe u hodhën në zjarr. Ata nuk gjetën mbrojtës tjetër për veten në vend të All'llahut."**.

Fundi i ajetit tregon se ata përfunduan në zjarr. Të bën përshtypje fakti se si ndodhi që ata, pas ujit, menjëherë u futën në zjarr. Ky zjarr është po ai zjarr i varrit (në Botën e Ndërmjetme). Në

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 364.

bazë të dëshmive të ajeteve kur'anore, një pjesë e njerëzve, pas vdekjes, do të dënohen në varr (në Botën e Ndërmjetme). Po sipas disa transmetimeve, varri ose është "kopsht prej kopshteve të Xhennetit", ose "gropë prej gropave të Ferrit".

Ekziston dhe mundësia që me këtë të synohet zjarri i kësaj bote dhe komentimi të jetë kështu: Me urdhrin e All'llahut, ata u kapluan nga valët e përmbytjes së zjarrit, që i gëlltiti ata.[1]

[1] Tefsiri "Ebul Fettuh Rrazij", vëll. 11, f. 280.

Ajetet 26 – 28

وَقَالَ نُوحٌ رَبِّ لَا تَذَرْ عَلَى الْأَرْضِ مِنَ الْكَافِرِينَ دَيَّارًا ﴿٢٦﴾ إِنَّكَ إِنْ تَذَرْهُمْ يُضِلُّوا عِبَادَكَ وَلَا يَلِدُوا إِلَّا فَاجِرًا كَفَّارًا ﴿٢٧﴾ رَبِّ اغْفِرْ لِي وَلِوَالِدَيَّ وَلِمَنْ دَخَلَ بَيْتِيَ مُؤْمِنًا وَلِلْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ وَلَا تَزِدِ الظَّالِمِينَ إِلَّا تَبَارًا ﴿٢٨﴾

“Dhe Nuhu tha: O Zoti im, mos lër mbi tokë asnjë femohues.”

“Sepse, nëse Ti i lë, ata do t’i shpien në humbje robtë e Tu dhe do të lindin vetëm kriminelë dhe jobesimtarë!”

“O Zoti im, falmë mua dhe prindërit e mi, si dhe çdo besimtar, që kërkon strehim në shtëpinë time! Fali të gjithë besimtarët e besimtaret, ndërsa keqbërësve shtoju vetëm shkatërrim!”

Komentimi

Ky popull i shthurur dhe imoral duhet të zhduket

Këto ajete janë vazhdimësi e fjalëve të Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*, lutja e ndaj popullit të vet. Ajeti tregon se Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: **"O Zoti im, mos lër mbi tokë asnjë femohues."**.

Këtë fjalë e tha kur pa që ky popull nuk udhëzohet, pasi ai u përpoq dhe u mundua shumë për udhëzimin e tyre. Atij i besuan vetëm një grup i vogël njerëzish.

Fjala *"alel erdi"* – **"mbi Tokë"** tregon që thirrja e Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* ishte universale, prandaj edhe stuhia dhe dënimi që u erdhi atyre, më pas, ishte me përmasa botërore.

Fjala *"dej'jar"* rrjedh nga fjala *"dar"* dhe nënkupton personin që zgjedh një shtëpi për të jetuar. Kjo fjalë zakonisht përdoret në rastet e mohimit të përgjithshëm, p.sh. thuhet: *"ma fid dar'ri dej'jar"* - *"në shtëpi nuk ekziston asnjë njeri"*.

Më pas, Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* e argumenton mallkimin e tij me këto fjali: **"Sepse, nëse Ti i lë, ata do t'i shpien në humbje robtë e Tu dhe do të lindin vetëm kriminelë dhe jobesimtarë!"**.

Kjo tregon se mallkimi i Profetëve, si p.sh. mallkimi i Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* nuk buron nga zemërimi, nga inati, nga ndjenja e hakmarrjes apo e urrejtjes, por mbështetet në një bazë logjike dhe të mirëllogaritur. Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* nuk ishte prej atyre njerëzve të paduruar, që për gjënë më të vogël të ngrihet në këmbë dhe të mallkojë. Ai e ndërmori këtë hap, pas

nëntëqind e pesëdhjetë vitesh thirrjeje në Rrugën e All'llahut, me durim dhe përkushtim, me shumë këmbëngulje dhe merakosje. Vetëm pasi kishte humbur plotësisht shpresat te populli i tij, nisi t'i mallkonte.

Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* e kuptoi se këta nuk kishin ndërmend kurrë të besonin. E kuptoi se këta do t'i devijonin besimtarët, të cilët jetonin në të njëjtin mjedis, e kuptoi se edhe gjenerata e ardhshme e tyre do të jetë e prishur dhe e korruptuar. Disa komentues, kanë thënë se ai arriti ta kuptojë këtë, sepse u ndihmua nga disa njohuri të fshehta, që All'llahu ia kishte dhënë atij që ka mundësi që Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* i përftoi me anë të Shpalljes nga All'llahu, i Cili thotë: **"E, Nuhut i qe shpallur: 'Nuk do të besojë më askush nga populli yt, përveç atyre që kanë besuar, pra, mos u brengos për atë që punojnë ata.'"**.[1]

Nuk duhet të mënjanohet edhe mundësia se ai kishte arritur te kjo e vërtetë, përmes reflektimit logjik dhe përllogaritjeve të zakonshme, për arsye se një popull, i cili për nëntëqind e pesëdhjetë vite të tëra thirret në Rrugën e Drejtë me anë të shprehjeve më ndikuese dhe prapë nuk beson, nuk ngelet më asnjë shpresë për udhëzimin e tij. Ngaqë jobesimtarët politeistë përbënin shumicën e popullsisë dhe të gjithë pasuritë dhe pushteti ishin në duart e tyre, është më se normale që ata të përpiqeshin të tërhiqnin edhe të tjerët, (pakicën besimtare). Pa dyshim që edhe brezat e ardhshëm të një populli të tillë, do të ishin keqbërës dhe të shthurur moralisht.

Gjithashtu, është i mundur bashkimi i këtyre tri varianteve.

[1] Sure "Hud", ajeti 36.

Fjala *"el faxhiru"* nënkupton personin që ka kryer një mëkat të shëmtuar dhe të neveritshëm, kurse fjala *"kuf'farun"* është trajta sipërore e "jobesimtarit". Ndryshimi që ekziston mes këtyre dy fjalëve, është se njëra fjalë ka të bëjë me aspektet praktike dhe tjetra me aspektet doktrinore dhe konceptuale.

Nga tërësia e këtyre ajeteve, arrijmë të kuptojmë se dënimet hyjnore kryhen në bazë të urtësisë.

Një shoqëri e korruptuar dhe e shthurur do të lindë trashëgimtarë që do të ndjekin të njëjtën rrugë, do të ndjekin rrugën e korruptimit, të mashtrimit dhe të devijimit dhe nuk kanë të drejtën e jetesës sipas "urtësisë hyjnore". Sigurisht që edhe atyre do t'u zbresë ndonjë stuhi, rrufe, tërmet apo ndonjë fatkeqësi tjetër dhe do t'i zhdukë nga faqja e dheut, ashtu si stuhia e Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* e pastroi tokën nga fyerjet dhe sharjet e atij populli të lig dhe mëkatar.

Meqenëse ky ligj hyjnor nuk i përket një kohe apo vendi të caktuar, duhet të kemi parasysh se, nëse ekziston edhe sot ndonjë popull i korruptuar, edhe fëmijët e tyre janë *"faxhir"* (të prishur) dhe *"kuf'far"* (jobesimtarë) duhet të jenë në pritje të dënimit hyjnor, sepse në këto çështje nuk ekziston asnjë diskriminim. Kjo është një traditë hyjnore.

Shprehja *"judil'lu ibadeke"* - **"ata do t'i shpien në humbje robtë e Tu"** ka mundësi të flasë apo të tregojë për një grup të vogël besimtarësh, të cilët i besuan Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* gjatë gjithë asaj periudhe të gjatë, ose tregon për masat e gjera të popullatës të shtypur, të cilat, nën ndikimin e presionit të udhëheqësve të devijuar, pasonin fenë e tyre.

Në ajetin e fundit të kësaj sureje, Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*, për veten dhe për ata që i besuan, lutet në këtë mënyrë: **"O Zoti im, falmë mua dhe prindërit e mi, si dhe çdo besimtar, që kërkon strehim në shtëpinë time! Fali të gjithë besimtarët e besimtaret, ndërsa keqbërësve shtoju vetëm shkatërrim!"**.[1]

Ky kërkim faljeje tregon se Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* dëshiron të thotë se unë, me vite të tëra dhe në mënyrë të vazhdueshme, kam thirrur njerëzit në fenë islame Në këtë rrugë kam duruar çdo lloj ankthi dhe persekutimi, por prapë ka mundësi, që gjatë kësaj periudhe, të jem treguar neglizhent apo të kem kryer ndonjë veprim të gabuar. Prandaj unë kërkoj falje dhe asnjëherë nuk e shfajësoj veten time përpara All'llahut të Madhëruar.

Pikërisht kjo është gjendja e të dashurve të All'llahut, të cilët, edhe pas gjithë atyre përpjekjeve në Rrugën e All'llahut, përsëri e konsiderojnë veten fajtorë dhe asnjëherë nuk bien pre e mendjemadhësisë dhe e vetëkënaqjes. Ata nuk janë si personat me kapacitet të kufizuar, të cilët, me kryerjen e një vepre sado të vogël, bëhen aq mendjemëdhenj, sikur All'llahu të ishte borxhli ndaj tyre.

Në realitet, Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* kërkon falje për disa persona:

Së pari, për veten e tij, për lëshimet që mund të ketë bërë në lidhje me përparësitë.

Së dyti, për babain dhe nënën e tij, në shenjë mirënjohje dhe respekti për përpjekjet e tyre.

---

[1] Fjala *"teb'bar"* është në kuptimin e *"shkatërrimit"*, por është interpretuar dhe në kuptimin e *"dëmtimit"* dhe *"humbjes"*.

Së treti, për të gjithë ata persona që i besuan atij, edhe pse ishin të paktë në numër. Më pas, së bashku me atë hipën në anije, e cila, gjithashtu, ishte shtëpia e Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Së katërti, kërkon falje për burrat dhe gratë besimtare të të gjithë historisë dhe në gjithë botën. Këtu ai krijon lidhjen e vet me të gjithë besimtarët në të gjithë botën dhe në të gjitha periudhat kohore.

Në përfundim, përsëri thekson se shtypësit do të zhduken, sepse e meritojnë këtë dënim, për shkak të dhunës dhe shtypjes së tyre.

Hulumtim

Nuhu, Profeti i parë prej Profetëve të vendosmërisë së lartë *(ulil azmi)*

Kur'ani i Madhërishëm flet në shumë ajete për Profetin Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*. Në njëzet e nëntë sure në Kur'an është diskutuar rreth këtij Profeti të nderuar, kurse emri i tij në Kur'an është përmendur 43 herë.

Kur'ani ka përshkruar në mënyrë të detajuar pjesë të ndryshme të jetës së tij, që kanë të bëjnë më shumë me aspektet e mësimit, të edukimit dhe të këshillave.

Historianët dhe komentuesit e Kur'anit kanë shkruar: "Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*, ndryshe njihej dhe me emrat: Abdul Gaffar, Abdul Melek ose Abdul E'la, kurse epiteti "Nuh" iu

dha, për arsye se ai me vite të tëra qante për veten dhe për popullin e tij. Emri i babait të tij ishte Lemek, ose Lamik.

Në lidhje me moshën e tij, ekzistojnë mendime të ndryshme. Disa thonë se jetoi 1490 vite, kurse në disa transmetime tjera, thuhet 2500 vite.

Për njerëzit e kohës së tij thuhet se jetonin afërsisht 300 vite. Ajo që dihet mirë, është se ai ka jetuar shumë gjatë. Në bazë të ajetit të Kur'anit, thuhet se i kaloi 950 vite në mesin e popullit të tij duke e thirrur në Rrugën e drejtë.

Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* kishte tri fëmijë, me emrat Ham, Sam dhe Jafith. Historianët janë të mendimit se të gjitha racat që ekzistojnë sot në rruzullin tokësor, rrjedhin nga këta tre fëmijë.

Pasardhësit e racës së Hamit jetojnë në Afrikë.

Një grup tjetër janë prej racës së Samit, jetojnë në Lindjen e Mesme dhe Lindjen e Afërt.

Raca e Jafethit jeton në Kinë.

Edhe për vitet e stuhisë së Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*, gjithashtu, ka mosmarrëveshje. Disa thonë 50 vite dhe disa të tjerë 60 vite.

Në burimet Hebraike, (Teurati i sotshëm), gjithashtu, është dhënë një diskutim i hollësishëm për jetën e tij, e cila ndryshon në shumë aspekte me atë që tregon Kur'ani. Kjo është prej shenjave të devijimit të Teuratit.

Këto çështje janë cituar në kapitujt 6, 7, 8, 9,10 në Teurat.

Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* kishte dhe një fëmijë tjetër, me emrin Kenan, i cili nuk iu bind babait dhe e kundërshtoi. Madje

ai nuk iu bashkua atij dhe nuk hipi në anijen e shpëtimit. Sipas Kur'anit, në fund, ashtu si jobesimtarët e tjerë, u mbyt në stuhi.

Se sa njerëz i besuan atij gjatë viteve të thirrjes në Rrugën e All'llahut dhe hipën me të në anije, gjithashtu, është çështje diskutimi. Disa kanë shkruar 80 veta dhe disa të tjerë 8 persona.

Tregimi i Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* ka gjetur një pasqyrim të gjerë në literaturën arabe dhe perse, duke u përqendruar më shumë mbi stuhinë dhe anijen e shpëtimit të tij.[1]

Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* është personifikim i durimit, i falënderimit dhe i qëndresës. Kanë thënë se Profeti Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* ishte personi i parë që, për udhëzimin e njerëzve, përveç logjikës së Shpalljes, u ndihmua edhe nga logjika e argumentit dhe e intelektit. (Kjo është pasqyruar më së miri dhe në ajetet e kësaj sureje). Për këtë arsye, ka një të drejtë të madhe mbi të gjithë besimtarët dhe adhuruesit e botës.

Shpjegimin e historisë së Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)* do ta mbyllim me një hadith nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Profeti Nuh (Paqja qoftë mbi të!), në agimin dhe perëndimin e diellit, gjithnjë këndonte këtë lutje: 'Hëngra darkë dhe dëshmoj se çdo begati që kam në fe dhe në pasuri, e kam nga All'llahu i Madhëruar, që është Një dhe i pa shok. Unë jam i detyruar ta lartësoj All'llahun për këto begati dhe ta falënderoj shumë Atë. Për këtë arsye, All'llahu në Kur'an ka thënë:* **'ai ishte një njeri falënderues dhe mirënjohës'**.".[2]

[1] "A'lamul Kur'an", "Kultura e tregimeve Kur'anore", "Enciklopedia e njohurive", "Dekhuda", kreu "Nuh"; "Biharul Enuar", vëll. 11.

[2] "Biharul Enuar", vëll. 11, Hadithi 3, f. 291.

Në thënien e All'llahut: **"O Zoti im, falmë mua dhe prindërit e mi, si dhe çdo besimtar, që kërkon strehim në shtëpinë time!"**, ka diskutime për fjalën *"bejtun"*.

Për fjalën *"bejtun"* - *"shtëpi"*, ekzistojnë diskutime. Janë përmendur katër variante në lidhje me të. Disa e kanë marrë në kuptimin e shtëpisë private, disa në kuptimin e xhamisë. Disa të tjerë, në kuptimin e anijes së shpëtimit të Profetit Nuh *(Paqja qoftë mbi të!)*, kurse disa të tjerë e kanë komentuar si feja dhe Sheriati i tij.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Me fjalën 'bejtun', këtu, synohet udhëheqja hyjnore. Çdokush që hyn në këtë udhëheqje, ka hyrë në shtëpinë e të Dërguarve."*.[1]

O Zoti im! Të lutem, na beko ne që me anë të pranimit të vilajetit të Imamëve të Ehli Bejtit, të hyjmë në shtëpinë e të Dërguarve!

O Zot, të lutem, na dhuro qëndresë të ngjashme me atë të Profetit Nuh, që asnjëherë të mos lodhemi në rrugën e thirrjes në Fenë Tënde dhe asnjëherë të mos heqim dorë.

O Zot! Në kohën që arrin stuhia e zemërimit Tënd, na shpëto ne me anë të anijes Tënde të shpëtimit!

Fundi i sures "Nuh"

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 429.

Sure "El Xhinn"

Zbritur në mekë

28 ajete

Përmbajtja e sures "El Xhinn"

Kjo sure, ashtu siç bëhet e qartë dhe nga emërtimi, kryesisht diskuton për krijesat e padukshme, të cilat quhen "Xhinn", rreth besimit të tyre ndaj Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nënshtrimit karshi Kur'anit Fisnik, rreth besimit dhe bindjes së tyre ndaj Ringjalljes, ekzistimit të një

grupi besimtarësh dhe jobesimtarësh në mesin e tyre dhe çështjeve të ngjashme me këto.

Kjo temë përfshin 19 ajete nga 28 ajete gjithsej që ka kjo sure dhe korrigjon shumë prej paragjykimeve në lidhje me "xhindet", duke i hedhur tej si të pavlefshme.

Po ashtu, në një pjesë të kësaj sureje diskutohet për çështjen e Monoteizmit dhe të Ringjalljes.

Në pjesën e fundit të saj, trajtohet çështja e dijes së fshehtë, për të cilën askush nuk ka njohuri, përveç asaj që All'llahu ka dashur.

Mirësitë e leximit të sures "El Xhinn"

Në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: *"Kushdo që e lexon suren 'El Xhinn', do të ketë shpërblimin e çdo xhindi e shejtani që e vërtetuan Profetin Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi*

të dhe mbi familjen e tij!), ose e përgënjeshtruan atë dhe shpërblimin e lirimit të një skllavi.".[1]

Në një hadith tjetër, nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet: *"Çdokush që e lexon shumë suren 'El Xhinn', asnjëherë në këtë botë nuk do të jetë pre e syrit lëndues të xhindit, magjisë dhe hileve të tyre. Ai do të jetë bashkudhëtar me Profetin Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe thotë: "O Zoti im! Unë nuk dua asnjë njeri në vendin e tij dhe kurrë nuk do të anoj drejt tjetrit, përveç tij."*.[2]

Sigurisht, ky lexim është një hap drejt informimit për përmbajtjen e kësaj sureje dhe më pas për të vepruarit në bazë të saj.

Ajetet 1 – 6

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10 f. 360.

[2] Tefsiri "El Burhan", vëll. 4, f. 390.

قُلْ أُوحِيَ إِلَيَّ أَنَّهُ اسْتَمَعَ نَفَرٌ مِنَ الْجِنِّ فَقَالُوا إِنَّا سَمِعْنَا قُرْآنًا عَجَبًا١ يَهْدِي إِلَى الرُّشْدِ فَآمَنَّا بِهِ وَلَنْ نُشْرِكَ بِرَبِّنَا أَحَدًا١ وَأَنَّهُ تَعَالَى جَدُّ رَبِّنَا مَا اتَّخَذَ صَاحِبَةً وَلَا وَلَدًا١ وَأَنَّهُ كَانَ يَقُولُ سَفِيهُنَا عَلَى اللَّهِ شَطَطًا١ وَأَنَّا ظَنَنَّا أَنْ لَنْ تَقُولَ الْإِنْسُ وَالْجِنُّ عَلَى اللَّهِ كَذِبًا١ وَأَنَّهُ كَانَ رِجَالٌ مِنَ الْإِنْسِ يَعُوذُونَ بِرِجَالٍ مِنَ الْجِنِّ فَزَادُوهُمْ رَهَقًا١

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Thuaj (o Muhammed)**: Mua më është shpallur se disa prej xhindeve kanë dëgjuar** (Kur'anin) **dhe kanë thënë: 'Me të vërtetë, kemi dëgjuar një Kur'an të mrekullueshëm.'"**

"I cili udhëzon në Rrugën e Drejtë dhe kemi besuar në të, prandaj kurrsesi më nuk do t'i shoqërojmë askënd Zotit tonë (në adhurim)**!"**

"Qoftë lartësuar Madhëria e Zotit tonë! Ai nuk ka zgjedhur as bashkëshorte, as bir."

"Por disa të marrë nga ne flisnin gënjeshtra për All'llahun."

"Kurse ne mendonim se as njerëzit, as xhindet nuk flasin gënjeshtra për All'llahun."

"Në të vërtetë, ka pasur njerëz që kërkonin mbrojtje nga xhindet, por kjo vetëm sa i çoi më tej në gabime."

Shkaku i zbritjes

Shkaqet e zbritjes, që janë cituar në komentimin e ajeteve 29–34 të sures "El Ahkaf" janë plotësisht në përputhje me shkakun e zbritjes së sures "El Xhinn". Kjo tregon se të dy suret trajtojnë një ngjarje.

Këtu po tregojmë në mënyrë të përmbledhur shkakun e zbritjes:

1- Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte nisur nga Meka në drejtim të pazarit Ukadh, në Taif, me qëllim që t'i ftonte njerëzit e asaj bashkësie të madhe në Rrugën e Drejtë të fesë islame. Por askush nuk e pranoi thirrjen e tij gjatë këtij udhëtimi. U kthye në vendin e quajtur lugina e Xhindit. Natën e kaloi aty, duke kënduar ajete kur'anore. Një grup prej xhindëve, pasi dëgjuan ajetet kur'anore, u bënë besimtarë dhe u kthyen drejt popullit të tyre, për t'i thirrur në Rrugën e Drejtë.[1]

2- Ibn Abasi thotë: "Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* po falte namazin e sabahut. Gjatë faljes, po këndonte ajete kur'anore. Një grup prej xhindëve, të cilët përpiqeshin të kuptonin shkakun e ndërprerjes së

[1] Tefsiri i "Ali ibn Ibrahim", në bazë të transmetimit të tefsirit "Nuruth Thekalejn" , vëll. 5, f. 19. (i përmbledhur).

lajmeve qiellore, (parashikimeve që bëheshin me anë të vëzhgimit të qiellit), dëgjuan këndimin e Kur'anit nga ana e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe thanë: 'Kjo është arsyeja e ndërprerjes së lajmeve qiellore nga ne.'. Ata shkuan te populli i tyre dhe i ftuan ata drejt Islamit.".[1]

3- Pas vdekjes së Ebu Talibit, Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu vështirësuan dhe më shumë punët, prandaj u nis në drejtim të Taifit, që të gjejë përkrahës dhe mbështetës. Paria e Taifit u soll ashpër me të dhe populli i këtij qyteti e përndoqi dhe e gjuajti me gurë dhe sende të forta, saqë këmbët i rridhnin gjak. I lodhur dhe i rraskapitur u ul afër një kopshti. Shërbëtori i pronarit të kopshtit, i cili quhej Adas, u bë besimtar.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* po shkonte drejt Mekës. Nata e zuri afër një palme. Aty filloi të falte namazin. Një grup xhindesh nga Nasibejn ose Jemeni po kalonin andej dhe e dëgjuan Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që po këndonte Kur'an në namazin e sabahut dhe i besuan atij, u bënë besimtarë.[2]

Shkaqe zbritjesh të ngjashme ka cituar edhe një grup komentuesish në fillim të sures "El Xhinn". Ka edhe një shkak tjetër të zbritjes, i cili ndryshon nga shkaqet e përmendura. Ai është: E pyetën Abdullah bin Mesudin, se mos vallë ndonjë prej tyre ishte

[1] "Sahihu Bukharij", "Sahihu Muslim" dhe "Musned Ahmed", ngjashëm me transmetimin e tefsirit "Fi Dhilalil Kur'an" , vëll. 7, f. 429 (i përmbledhur).

[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 92 dhe "Sijretu ibn Hisham", vëll. 2, f. 62–63 (në mënyrë të përmbledhur).

shoku i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që u ndodh me të në ngjarjen e natës së xhindit. Abdullah bin Mesudi tha: "Askush nga ne nuk ka qenë. Ne, kur ishim në Mekë, nuk e pamë askund Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. E kërkuam shumë, por përsëri nuk e gjetëm. Kjo gjë na futi në dyshime se mos e kanë vrarë armiqtë. Vazhduam ta kërkojmë Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe, kur arritëm në luginat e Mekës, e pamë që po vinte nga mali Hira.

E pyetëm: 'O i Dërguar i All'llahut, ku ishit? Ne ishim tepër të shqetësuar dhe mbrëmë ka qenë nata më e keqe në jetën tonë.'.

Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u përgjigj: *'Një drejtues i xhindeve erdhi pranë meje dhe unë shkova t'i lexoj atij Kur'anin.'"*.[1]

Komentimi

Ne kemi dëgjuar një Kur'an të mrekullueshëm!

Pas diskutimeve të bëra më lart, tani do të flasim rreth komentimit të ajeteve.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 368.

Në ajetin e parë i kërkohet Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të thotë: "**Mua më është shpallur se disa prej xhindeve kanë dëgjuar** (Kur'anin) **dhe kanë thënë: 'Me të vërtetë, kemi dëgjuar një Kur'an të mrekullueshëm.'"**.[1]

Sifjalia *"uhije ilejje"* - **"mua më është shpallur"**, tregon se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka qenë vetë në këtë ngjarje. Ai nuk i ka parë xhindet, por për dëgjimin e Kur'anit, nga ana e tyre, është vënë në dijeni me anë të Shpalljes.

Ky ajet na e bën të qartë se xhindet janë inteligjentë, kanë arsye, logjikë dhe perceptim. Janë të vetëdijshëm për detyrat dhe përgjegjësitë. Kanë njohuri leksikore dhe janë në gjendje të bëjnë dallimin midis fjalëve të rëndomta dhe të përzgjedhura. E dinë ç'do të thotë fjala "mrekulli". Gjithashtu, e konsideronin si detyrë për veten e tyre, përhapjen e të Vërtetës, si dhe ishin objekt i predikimit të Kur'anit.

Kjo është vetëm një pjesë nga veçoritë e këtyre krijesave të gjalla, të qëndrueshme që përftohen vetëm nga ky ajet.

Ata shquhen dhe për karakteristika të tjera, të cilat do t'i trajtojmë në mënyrë më të detajuar në ajetet e fundit të kësaj sureje.

Ata kishin të drejtë ta quanin Kur'anin të mrekullueshëm, sepse Kur'ani është i mrekullueshëm, si nga toni, ashtu edhe nga melodia; është i mrekullueshëm, si nga ndikimi, ashtu edhe nga

[1] "Neferun" në bazë të disa mjeshtërve të gjuhësisë, fjalorit dhe komentimit, i thuhet 3 deri në 9 personave.

tërheqja; është i mrekullueshëm, si nga përmbajtja, ashtu edhe nga domethënia; është i mrekullueshëm edhe nga pikëpamja e komunikuesit të tij, i cili ishte një autodidakt dhe njeri pa shkollë.

Kur'ani është i mrekullueshëm, si në anën e jashtme, ashtu edhe në anën e brendshme. Kjo ishte dhe arsyeja që ata pranuan mrekullitë e Kur'anit.

Në vazhdim të kësaj sureje, ata i thanë dhe fjalë të tjera popullit të vet. Këto fjalë Kur'ani, i ka trajtuar në 12 fjali në ajetet vijuese. Secila nga këto fjali fillon me fjalën *"inne"*, e cila është treguese e theksimit.

Ajeti 2, në vazhdim të cilësive të Kur'anit, thotë: **"Udhëzon në Rrugën e Drejtë dhe kemi besuar në të, prandaj kurrsesi më nuk do t'i shoqërojmë askënd Zotit tonë** (në adhurim)**!"**.

Fjala *"err rrushdu"* ka kuptim tejet të gjerë dhe shumë domethënës. Ajo përfshin, në vete, çdo lloj pjekurie.

Pas shfaqjes së besimit dhe, pasi refuzuan të gjitha format e idhujtarisë, ata e vazhdojnë fjalimin e tyre, në lidhje me cilësitë e Zotit në këtë mënyrë: **"Qoftë lartësuar Madhëria e Zotit tonë! Ai nuk ka zgjedhur as bashkëshorte, as bir."**.

Fjala *"xheddu"*, në fjalor, ka kuptime të shumta, si p.sh: *madhështi intensitet, seriozitet, përfitim dhe interes* dhe kuptime të tjera të ngjashme me to. Por, nëse i referohemi librit "Mufredat" të Ragib Isfahaniut, arrijmë të kuptojmë që përdorimi kryesor kuptimor i saj, është *"ndërprerja"*.

Gjyshi është quajtur *"xhidde"*, për shkak të madhështisë së pozitës, ose moshës së tij.

Një grup komentuesish kanë thënë se fjala "*xhinde*", në këtë ajet, është përmendur me një domethënie më të kufizuar, madje e kanë komentuar se përdoret me kuptimin e "*cilësisë*". Komentues të ndryshëm, kanë dhënë mendime të ndryshme, lidhur me përdorimin kuptimor të kësaj fjale, si: në kuptimin e fuqisë, të pronësisë, qeverisë, begatisë, emrit. Të gjitha këto përmblidhen në një kuptimin, atë të madhështisë.

Por, duke pasur parasysh se fjala "*xhidde*" njihet në përgjithësi me kuptimin e gjyshit, në disa transmetime thuhet se xhindet janë quajtur me këtë emër të papërshtatshëm, për shkak të injorancës së tyre, prandaj ju asnjëherë mos përdorni shprehje të tilla në lidhje me All'llahun.[1]

Ky hadith ka mundësi t'u referohet rasteve, kur ekzistojnë lidhje të tilla.

Kur'ani, me anë të këtyre ajeteve, transmeton fjalët e tyre, me ton të përshtatshëm dhe i miraton ato. Përveç kësaj, kjo fjalë është përdorur dhe në disa prej fjalimeve të "Nehxhul Belagas".

Në fjalimin 191 thuhet: "*Falënderuar qoftë All'llahu, i Cili Veten e ka mbuluar me respekt dhe fisnikëri, të cilën e ka zgjedhur për Vete, e jo për krijesat e Tij. Ai i ka bërë të paarritshme dhe të ndaluara për të tjerët pos Tij dhe i ka zgjedhur për famën (xhidden) e Tij.*".

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 368; tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 435; në tefsrin "Ali ibn Ibrahim", është përmendur kjo shprehje.

Në disa transmetime lexojmë se Enes ibn Maliku ka thënë: "Kur ndonjë e mësonte suren 'El Bekare', e lexonte dhe e lartësonte atë (xhidde) në praninë tonë.".[1]

Sidoqoftë, kjo fjalë përdoret në kuptimin e madhështisë dhe të shkëlqimit të një çështjeje, e cila përkon edhe me kuptimet leksikore, në rastet e përdorimit të saj.

Përfaqësuesit e xhindeve mbështeteshin vetëm mbi çështjen që All'llahu nuk ka as bashkëshorte, as fëmijë. Ka mundësi që kjo fjali të jetë përdorur për të mohuar një besëtytni, e cila ekzistonte mes arabëve, të cilët dhe thoshin: "Engjëjt janë vajzat e All'llahut, nga një grua prej xhindeve, të cilën All'llahu e kishte zgjedhur për vete.".

Po me këtë kuptim, kjo fjali është cituar dhe në komentimin e ajetit 185 të sures "Es Saffat": **"Ata besonin se në mes Zotit dhe xhindeve kishte lidhje farefisnore."**.

Ajeti në vijim thotë: **"Por disa të marrë nga ne flisnin gënjeshtra për All'llahun."**.

Fjala *"es sefijhu"* ka mundësi të jetë përdorur, për të treguar gjininë dhe shumësinë e të marrëve që besonin se All'llahu kishte grua dhe fëmijë, madje kishin zgjedhur edhe një të ngjashëm dhe ortak për Të. Ata ishin larguar nga Rruga e Drejtë dhe flisnin vetëm gënjeshtra dhe trillime.

Shumë komentues kanë dhënë edhe mundësinë se fjala *"sefijh"*, në këtë ajet, është përdorur në kuptimin e njëjësit dhe tregon për Iblisin (Satanin), i cili, pas kundërshtimit të urdhrit të

[1] Tefsiri "El Kurtubij", vëll. 10, f. 6801.

All'llahut, i ngjiti Atij cilësi të padrejta. Madje, zyrtarisht kundërshtoi dhe urdhrin e All'llahut që t'i binte në sexhde Ademit *(Paqja qoftë mbi të!)*, pasi e konsideroi atë larg mëshirës dhe veten e quajti më lart se Ademi *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Duke pasur parasysh që Iblisi vetë ishte një prej xhindeve, besimtarët xhinn e urrenin atë dhe fjalët e tij i quajtën gënjeshtra dhe trillime, edhe pse në dukje ai ishte adhurues dhe dijetar. Por dijetar pa vepra, adhurues egocentrik, i devijuar dhe arrogant. Ai është një prej shembujve të qartë të "*sefihj-it*".

Fjala "*shatatun*" është përdorur në kuptimin e kalimit të cakut, e largimit nga moderimi dhe e hedhjes larg, prandaj fjalët që janë larg nga e vërteta, quhen "*shatat*" - "*të pavërteta*". Për këtë arsye, anët e përrenjve të mëdhenj, që kanë largësi të madhe nga uji dhe janë të gjata, quhen "*shatt*".

Më pas, thanë: **"Kurse ne mendonim se as njerëzit, as xhindet nuk flasin gënjeshtra për All'llahun. "**.

Kjo fjali tregon, se ky grup i kishte pasuar në mënyrë të verbër ata që besonin se All'llahu kishte grua, fëmijë dhe ortak. Ata thoshin se, nëse këto çështje i pranonin nga të tjerët, pa ndonjë argument apo arsye, kjo ishte bërë nga budallallëku dhe mendjelehtësia e tyre. Asnjëherë nuk e imagjinonim që ndonjë njeri apo xhind të kishte aq kurajë sa t'i përveshte gënjeshtra kaq të mëdha All'llahut. Tani që filluan hulumtimet dhe e zbuluan të vërtetën, kuptuan gabimin e këtij imitimi të verbër dhe të padrejtë. Prandaj e pranuan gabimin që bënë, duke ndjekur devijimin e idhujtarëve xhind.

Në përfundim, thanë: **"Në të vërtetë, ka pasur njerëz që kërkonin mbrojtje nga xhindet, por kjo vetëm sa i çoi më tej në gabime."**.

Fjala *"rahek"* tregon se diçka është dominuar nga zemërimi. Por, duke ditur se devijimi, mëkati, kryeneçësia, rebelimi dhe frika dominojnë mbi zemrën dhe shpirtin e njeriut dhe e mbulojnë atë, këtë fjalë e kanë pranuar se është përdorur me këtë kuptim.

Disa komentues të Kur'anit, fjalinë e mësipërme e kanë konsideruar si tregues për një besëtytni tjetër, e cila ekzistonte në periudhën e injorancës. Ajo lidhej me kontekste të tilla, si p.sh: kur disa karvanë arabë, hynin mbrëmjeve në ndonjë lumë, thoshin: "Kërkojmë mbrojtje nga kryetari dhe udhëheqësi i kësaj toke, nga e keqja e budallenjve të popullit të tij.". Ata besonin se me shqiptimin e kësaj fjalie, kryetari i xhindeve do t'i mbronte ata nga të këqijat e budallenjve xhind.[1]

Duke u nisur nga fakti që paragjykimet janë shkak i burimit dhe i shtimit të frikës, të devijimit dhe të rënies intelektuale, sifjalia në ajetin 6, thotë: **"...por kjo vetëm sa i çoi më tej në gabime."**.

Ky ajet tregon se në popullin e xhindeve kishte burra dhe gra, sepse në ajet është përmendur shprehja *"rixhalun minnel xhin"* - *"burra prej xhindeve"*.

Sidoqoftë, ajeti ka një kuptim të gjerë dhe gjithëpërfshirës. Kuptimi i tij përfshin çdo lloj mbrojtjeje të njerëzve nga xhindet. Besëtytnia e lartpërmendur, është vetëm një shembull i tij. Jemi në dijeni se në mesin e arabëve ka pasur shumë priftërinj, të cilët

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 369 dhe tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 28, f. 85.

mendonin se, me anë të xhindeve, jo vetëm që mund të zgjidhnin shumë probleme, por edhe të informoheshin për të ardhmen.

Ajetet 7 – 10

وَأَنَّهُمْ ظَنُّوا كَمَا ظَنَنْتُمْ أَنْ لَنْ يَبْعَثَ اللَّهُ أَحَدًا۝ وَأَنَّا لَمَسْنَا السَّمَاءَ فَوَجَدْنَاهَا مُلِئَتْ حَرَسًا شَدِيدًا وَشُهُبًا۝ وَأَنَّا كُنَّا نَقْعُدُ مِنْهَا مَقَاعِدَ

لِلسَّمْعِ فَمَنْ يَسْتَمِعِ الْآنَ يَجِدْ لَهُ شِهَابًا رَصَدًا۹ وَأَنَّا لَا نَدْرِي أَشَرٌّ أُرِيدَ بِمَنْ فِي الْأَرْضِ أَمْ أَرَادَ بِهِمْ رَبُّهُمْ رَشَدًا۱۰

"Edhe ata mendonin siç mendonit ju, se All'llahu nuk do të ringjallte askënd."

"Ne jemi ata që kemi synuar qiellin, por kemi hasur në plot roje të forta (engjëj të fuqishëm) **dhe shigjeta të zjarrta** (meteorë)**."**

"Dhe uleshim rreth tij, nëpër vende të përshtatshme për të dëgjuar diçka, por ai që përgjon tani, do të hasë në shigjeta të zjarrta (meteorë) **në pritë."**

"Ne nuk e dimë nëse (me këto roja të qiellit) **është synuar e keqja** (zbritja e dënimit) **për ata që janë në Tokë apo Zoti i tyre kërkon t'i udhëzojë në Rrugë të Drejtë?!"**

Komentimi

Më parë uleshim për të dëgjuar diçka, por...

Këto ajete janë vazhdimësi e diskutimeve të besimtarëve xhind. Besimtarët xhind, këto ajete dhe diskutimet e tyre, i kishin

shpalosur te populli i tyre, të cilin e ftonin në Islam dhe Kur'an. Ajeti 7 flet për ta: **"Edhe ata mendonin siç mendonit ju, se All'llahu nuk do të ringjallte askënd."**.

U bëmë mohues të Kur'anit dhe përgënjeshtrues të profetësisë së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por, kur studiuam me hollësi ajetet e këtij Libri Qiellor, e kuptuan më së miri vërtetësinë e Tij, prandaj ju mos veproni siç veprojnë idhujtarët, mos ndërmerrni rrugën e politeizmit, sepse do të pësoni fatin e tyre.

Ky është një paralajmërim për politeistët, të cilët duhet të mësojnë prej xhindeve dhe prej logjikës së gjykimit të tyre tejet të fortë, në mënyrë që të zgjohen dhe t'i përmbahen Kur'anit dhe të Dërguarit të All'llahut.

Disa komentues kanë shprehur mendimin se sifjalia: **"All'llahu nuk do të ringjallte askënd"**, synon të mohojë ringjalljen dhe jo Profetët. Disa interpretues të tjerë, janë të mendimit se ky ajet dhe ajeti paraprak, janë thënie prej Fjalës së All'llahut dhe jo fjalë të besimtarëve xhindë, të cilat janë të shpërndara në formën e citateve, midis thënieve të tyre. Këto fjalë u drejtohen politeistëve arabë.

Sipas këtij komentimi, kuptimi i ajetit do të ishte: "O politeistë arabë! Edhe xhindet supozuan si ju, që All'llahu nuk dërgon Profet, por, pasi e dëgjuan atë, e kuptuan gabimin e tyre. Tanimë ka ardhur koha që edhe ju të reflektoni!".

Ky interpretim duket i papërshtatshëm. Edhe renditja e ajeteve tregon se këto thënie janë vazhdimësi e fjalëve të besimtarëve xhind dhe u drejtohen jobesimtarëve prej tyre.

Pas kësaj, këta besimtarë xhind, sjellin një argumentet, për të arsyetuar pohimin e tyre. Argumenti është shprehur në fjalinë: **"Ne jemi ata që kemi synuar**[1] **qiellin, por kemi hasur në plot roje të forta**[2] (engjëj të fuqishëm) **dhe shigjeta të zjarrta** (meteorë)**."**.

Në ajetin vijues thuhet: **"Dhe uleshim rreth tij, nëpër vende të përshtatshme për të dëgjuar diçka, por ai që përgjon tani, do të hasë në shigjeta të zjarrta** (meteorë) **në pritë."**.

A nuk është kjo gjendje e re, provë që vërteton se, me shfaqjen e këtij Profeti dhe me zbritjen e Librit Qiellor, kanë ndodhur ndryshime të mëdha në botë? Pse ju, para kësaj, patët mundësinë për të depërtuar përtej qiellit, për të marrë informacione, por tani askush nuk e ka një fuqi të tillë?! A nuk tregon kjo gjendje e re, se epoka e djallit, e kultizmit dhe e mashtrimit ka mbaruar bashkë me natën e errët të injorancës, sepse shpallja e profetësisë ka mbuluar gjithë botën?!

Fjala *"shehabun"*, fillimisht, është përdorur me kuptimin e flakës që ngrihet nga zjarri. Më pas është përdorur për meteorët, që shfaqen si dritë e zgjatur në qiell. Sipas hulumtimeve të shkencëtarëve, meteorët janë copa të mëdha guri që lëvizin jashtë atmosferës, në hapësirë dhe, kur i afrohen tokës, nën ndikimin e forcës gravitacionale të saj, i drejtohen me shpejtësi asaj. Sapo kontaktojnë me atmosferën që e rrethon tokën, digjen dhe ne i shohim në formën e flakës së shndritshme, derisa bien në tokë si hi.

---

[1] Fjala *"lemesna"*, që ndodhet në këtë ajet, rrjedh nga fjala *"lems"*. Kuptimi i saj është i njohur për të gjithë, por këtu është në kuptimin e lypjes dhe kërkimit. "Mufredatu Rragib", tefsiri "El Kebijr" i Fakhru Rrazij dhe tefsiri "El Kurtubij".

[2] Fjala *"haresun"* është shumësi i fjalës *"haris"* dhe është në kuptimin e rojës. Disa atë e kanë interpretuar si emër të përgjithshëm.

Në Kur'an është përsëritur disa herë fjala *"shuhubun"*. Ato janë shkëndija që hidhen në drejtim të djajve, të cilët përgjojnë në qiej.

Cili është synimi i fjalës *"përgjim"*? Cila është mënyra e dëbimit të xhindeve dhe të djajve nga qiejt? Për këto çështje kemi dhënë diskutime të hollësishme.[1]

Sidoqoftë, fjala *"raseden"* tregon përgatitjet për pritjen e një gjëje. Kjo fjalë përdoret për të treguar edhe personin që është në pritje të një diçkaje. Në ajetin e lartpërmendur, kjo fjalë është përdorur me këtë kuptim.

Më pas shtuan: **"Ne nuk e dimë nëse** (me këto roja të qiellit) **është synuar e keqja** (zbritja e dënimit) **për ata që janë në Tokë apo Zoti i tyre kërkon t'i udhëzojë në Rrugë të Drejtë?!"**.

Thënë ndryshe, ne nuk e dimë se a është kjo çështje premisë për zbritjen e dënimit dhe fatkeqësisë nga ana e All'llahut, apo premisë për udhëzimin e tyre?

Por besimtarët xhind e kishin kuptuar që ndalimi i përgjimit, i cili përkonte me ardhjen e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është premisë për udhëzimin e njerëzve dhe dëbimin nga skena e falltarëve e besëtytnive të tjera, të ngjashme me to. Kjo nuk është gjë tjetër, përveç se lajmërim për fundin e një periudhe të errët dhe fillimin e një periudhe të ndritshme.

[1] Shih komentimin e ajetit 18 të Sure "Hixhr" e më tutje; dhe komentimin e ajetit 10 të sures "Es Safat" e më tutje.

Por, duke pasur parasysh faktin që "xhindet" kishin një lidhje të veçantë me përgjimin, akoma nuk arrinin ta besonin se ky ndalim është një lloj bekimi dhe mirësie. Megjithatë, është e qartë që falltarët, në kohën e injorancës, duke u mbështetur në përgjimin dhe depërtimin në qiell, luanin një rol të madh në devijimin e njerëzve.

Duhet të kemi parasysh që "udhëzimin", në këtë fjali ata ia atribuojnë All'llahut, kurse "të keqen" jo, duke u përpjekur të tregojnë se ajo që vjen nga All'llahu, është e dobishme dhe udhëzim, kurse e keqja dhe korrupsioni burojnë nga vetë njerëzit dhe është rezultat i keqpërdorimit të begative të All'llahut dhe i të mirave të krijimit nga njerëzit.

Ajetet 11 - 15

وَأَنَّا مِنَّا الصَّالِحُونَ وَمِنَّا دُونَ ذَٰلِكَ ۖ كُنَّا طَرَائِقَ قِدَدًا ﴿١١﴾ وَأَنَّا ظَنَنَّا أَنْ لَنْ نُعْجِزَ اللَّهَ فِي الْأَرْضِ وَلَنْ نُعْجِزَهُ هَرَبًا ﴿١٢﴾ وَأَنَّا لَمَّا سَمِعْنَا الْهُدَىٰ

آمَنَّا بِهِ فَمَنْ يُؤْمِنْ بِرَبِّهِ فَلَا يَخَافُ بَخْسًا وَلَا رَهَقًا١٣ وَأَنَّا مِنَّا الْمُسْلِمُونَ وَمِنَّا الْقَاسِطُونَ فَمَنْ أَسْلَمَ فَأُولَئِكَ تَحَرَّوْا رَشَدًا١٤ وَأَمَّا الْقَاسِطُونَ فَكَانُوا لِجَهَنَّمَ حَطَبًا١٥

"E midis nesh ka të mirë, por ka edhe që nuk janë të mirë; jemi ndarë në grupime të ndryshme."

"Ne e dimë se nuk mund t'i shpëtojmë All'llahut në Tokë dhe nuk mund t'i shmangemi Atij duke ikur (në qiell)**."**

"Posa dëgjuam udhëzimin (Kur'anin)**, Ne besuam në të; e kush beson në Zotin e vet, nuk ka përse të frikësohet se mos dëmtohet, as se mos i bëhet padrejtësi."**

"Ka prej nesh që janë myslimanë, por ka edhe të atillë që janë jobesimtarë. Kush ka përqafuar Islamin, ka zgjedhur Rrugën e Drejtë."

"Kurse jobesimtarët do të jenë lëndë djegëse të Xhehennemit."

Komentimi

Ne e dëgjuam udhëzimin dhe besuam në të

Edhe këto ajete janë vazhdim i thënieve dhe i bisedave të besimtarëve xhind, të cilët i bënin gjatë udhëzimit të popullit të tyre

të devijuar. Në ajetin 11, nga vetë goja e tyre, thuhet: **"E midis nesh ka të mirë, por ka edhe që nuk janë të mirë; jemi ndarë në grupime të ndryshme."**.

Ka mundësi që kjo shprehje të jetë përdorur për të treguar se djalli (satani) është një prej xhindeve dhe ky fakt mund të krijojë iluzionin se natyra e xhindit është e brumosur me të keqen, shkatërrimin dhe djallëzinë, prandaj në zemrën e tyre nuk ka se si të ndriçojë drita e udhëzimit.

Besimtarët xhind, me anë të kësaj shprehjeje, e bëjnë të qartë se parimi i lirisë së zgjedhjes dhe i vullnetit të lirë mbizotëron edhe tek ata. Kjo fjali tregon se në mesin e tyre ekzistojnë individë të mirë dhe individë që nuk janë të mirë, prandaj, në qenien e tyre, ekziston mundësia e udhëzimit. Parimisht, një prej faktorëve të suksesit të predikimit është "dhënia e personalitetit" palës së kundërt, si dhe vënia në dijeni për ekzistimin e mundësive të udhëzimit dhe të përsosmërisë.

Ekziston edhe mundësia që besimtarët xhind ta kenë thënë këtë shprehje për shfajësimin dhe lirimin e tyre nga tema e keqpërdorimit të çështjes së "përgjimit". Kjo do të interpretohej kështu: "Edhe pse disa prej nesh, informacionet që përftojnë me anë të "përgjimit", i vënë në dispozicion të njerëzve të këqij, me qëllim që të shkaktojnë devijimin e njerëzve, jo të gjithë xhindet janë të tillë.".

Ky ajet kur'anor e korrigjon mendimin tonë, në lidhje me xhindet, pasi në imagjinatën e shumicës së njerëzve, fjala "xhind" shoqërohet me një lloj "djallëzie", korrupsion dhe devijim. Ajeti thotë: **"E midis nesh ka të mirë, por ka edhe që nuk janë të mirë; jemi ndarë në grupime të ndryshme."**.

Fjala *"kideden"* është shumësi i fjalës *"keddun"*. Kjo fjalë nënkupton *"prerjen"*, por përdoret edhe për të shënuar pjesë ose grupe të ndara nga njëra-tjetra.

Besimtarët xhind, në vazhdimësi të bisedave të tyre, drejtuar të tjerëve, paralajmërojnë: **"Ne e dimë se nuk mund t'i shpëtojmë All'llahut në Tokë dhe nuk mund t'i shmangemi Atij duke ikur** (në qiell)**."**.

Si rrjedhojë, në qoftë se imagjinoni që mund t'i shmangeni dënimit dhe ndëshkimit të All'llahut, duke u fshehur në një qoshe të Tokës, ose duke ikur në qiell, keni gabuar rëndë.

Në këtë mënyrë, pjesa e parë e ajetit tregon përpjekjet e pafrytshme për të ikur nga kthetrat e fuqisë së All'llahut në tokë, kurse pjesa e dytë e ajetit aludon për ikjen absolute, duke përfshirë tokën dhe qiellin.

Ekziston edhe mundësia se ajeti sqaron se nuk mund të dominohet mbi All'llahun dhe së dyti, nuk mund të arratisemi nga grushti i drejtësisë së Tij. Prandaj, meqenëse nuk ekziston as mundësia e mbizotërimit dhe as arratisja, nuk ka asnjë zgjidhje tjetër, përveç dorëzimit dhe nënshtrimit ndaj urdhrit të drejtë të All'llahut.

Besimtarët xhind, në vazhdimësi të bisedave të tyre, shtojnë: **"Posa dëgjuam udhëzimin** (Kur'anin)**, Ne besuam në të."**.

Në qoftë se ne ju ftojmë në udhëzimin e Kur'anit, kjo bëhet për arsye se vetë ne, më përpara, e kemi praktikuar këtë rekomandim. Ne nuk i ftojmë të tjerët në një gjë që vetë nuk e kemi praktikuar atë, apo nuk kemi hequr dorë prej saj.

Më pas, me një fjali të shkurtër, e përshkruajnë rezultatin e besimit të tyre dhe pohojnë: **"...kush beson në Zotin e vet, nuk ka përse të frikësohet se mos dëmtohet, as se mos i bëhet padrejtësi."**.

Fjala *"bekhsun"* tregon *"dëmtimin me anë të shtypjes dhe dhunës"*, kurse fjala *"rehek"*, siç e kemi treguar edhe në diskutimet e mëparshme, tregon *"mbulimin e një gjëje me detyrim"*.

Dallimin mes këtyre dy shprehjeve, disa komentues e kanë shprehur në këtë mënyrë: "Fjala *'bekhsun'* shënon faktin që nga 'të mirat' të pakësohet ndonjë gjë, kurse fjala *'rehekan'* tregon se 'të këqijave' të tyre nuk do t'u shtohet ndonjë gjë.".

Komentues të tjerë, fjalën *"bekhs"* e kanë interpretuar në kuptimin e *"pakësimit"* të të mirave, kurse fjalën *"rehek"* e kanë quajtur si *"përgjegjësi e vështirë"*.

Sidoqoftë, qëllimi është të sqarohet mirë se besimtarët do të shpërblehen për çdo vepër që kryejnë, qoftë e vogël apo e madhe.

Drejtësia e All'llahut nuk u përket vetëm besimtarëve. Meqenëse dihet se jobesimtarët nuk kryejnë vepra të mira, nuk është diskutuar rreth shpërblimit të tyre.

Në ajetin vijues, për të dhënë më shumë sqarime rreth fatit të besimtarëve dhe politeistëve, thuhet: **"Ka prej nesh që janë myslimanë, por ka edhe të atillë që janë jobesimtarë. Kush ka përqafuar Islamin, ka zgjedhur Rrugën e Drejtë..."**.

Në këtë ajet, fjala **"mysliman"** është përmendur karshi fjalës **"jobesimtar"** dhe tregon se ajo që e parandalon njeriun nga dhuna, është besimi, ndërsa një njeri jobesimtar është i zhytur në dhunë

dhe shtypje. Ndërkohë, një besimtar i vërtetë asnjëherë nuk e përlyen veten me dhunë dhe shtypje, ashtu siç e lexojmë dhe në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Besimtar është ai që njerëzit, jetën dhe pasurinë e tyre, e ndien të sigurt në dorën e tij."*.[1]

Në një hadith tjetër, po nga Profeti i All'llahut, thuhet: *"Mysliman është ai person që myslimanët e tjerë janë të sigurt nga dora dhe gjuha e tij."*.[2]

Fjalia *"tehar'ru resheden"* - **"ka zgjedhur Rrugën e Drejtë"**, tregon se besimtarët zgjedhin Rrugën e Drejtë, kur janë të vëmendshëm dhe hulumtues dhe jo me sy të mbyllur e të verbër. Shpërblimi i tyre më i madh është arritja e të vërtetës, në saje të së cilës arrijnë të gjitha begatitë hyjnore. Ndërsa fatkeqësia më e keqe e shtypësve, është se ata do të përfundojnë si dru për zjarrin e Ferrit: **"...jobesimtarët do të jenë lëndë djegëse të Xhehennemit."**.

Ajetet 16 – 19

وَأَنْ لَوِ اسْتَقَامُوا عَلَى الطَّرِيقَةِ لَأَسْقَيْنَاهُمْ مَاءً غَدَقًا١٦ لِنَفْتِنَهُمْ فِيهِ وَمَنْ يُعْرِضْ عَنْ ذِكْرِ رَبِّهِ يَسْلُكْهُ عَذَابًا صَعَدًا١٧ وَأَنَّ الْمَسَاجِدَ لِلَّهِ

[1] Tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 10, f. 195.

[2] Tefsiri "Usulul Kafij", vëll. 2, kreu "el mumin ue alamatihi ue sifatihi", f. 233, botim "Darul Kutubil Islamije".

فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ أَحَدًا١٨ وَأَنَّهُ لَمَّا قَامَ عَبْدُ اللَّهِ يَدْعُوهُ كَادُوا يَكُونُونَ عَلَيْهِ لِبَدًا١٩

"Sikur të qëndronin (banorët e Mekës) **në Rrugën e Vërtetë, Ne do t'u jepnim ujë të bollshëm."**

"Për t'i vënë ata me këtë në sprovë. Por këdo që largohet nga këshillat e Zotit të tij, Ai do ta hedhë në një dënim të ashpër."

"Xhamitë i janë kushtuar vetëm All'llahut, prandaj mos iu lutni askujt, krahas All'llahut!"

"Kur robi i All'llahut (Muhammedi)**, u ngrit t'i lutej Atij, ata** (xhindet) **u tubuan rreth tij si shtëllungë."**

Komentimi

Me këto begati të shumta, do t'ju vëmë në sprovë

Në dukje, edhe këto ajete, janë vazhdimësi e bisedësve së xhindëve me popullin e tyre. (Edhe pse një grup komentuesish i kanë konsideruar këto ajete kundërshtuese në mesin e fjalëve të xhindeve). Por, kundërshtimi i tyre nuk pajtohet me të dukshmen e ajetit. Vazhdimsia e këtyre ajeteve ngjason me atë të ajeteve të mëparshme, e cila ishte fjala e xhindëve. Për këtë është e papranueshme që të mos jenë të xhindeve.[1]

Në ajetet e kaluara u diskutua rreth shpërblimeve të besimtarëve, në Kiamet, kurse këto ajete flasin rreth shpërblimeve të kësaj bote. Ajeti 16 thotë: **"Sikur të qëndronin** (banorët e Mekës) **në Rrugën e Vërtetë, Ne do t'u jepnim ujë të bollshëm."**.

Ne do t'u lëshonim atyre shiun e mëshirës dhe burimet e ujit për jetesë do t'ua vinim në dispozicion dhe kështu ata do të përfshiheshin në begati të shumëllojshme.

Fjala *"gadekan"* është përdorur për të treguar ujin e bollshëm.

Kur'ani Fisnik e ka diskutuar shumë herë çështjen e besimit dhe të devotshmërisë, të cilat i quan se janë jo vetëm burim i

[1] Duket që e vetmja gjë që është bërë shkak që ky grup komentuesish ta konsiderojnë atë si fjalën e All'llahut dhe fjalin ta konsiderojnë protestim janë përemrat e vetës së parë shumës, që janë përdorur në këto ajete. Në një vend thotë: Ne do t'u jepnim ujë të bollshëm. Në një vend tjetër, thotë se synimi është sprovimi. Por sa herë që këto shprehje i citohen gojarisht, nuk krijohet ndonjë problem, është ngjashëm me atë që një person të tregojë një histori nga shoku i vet dhe të thotë: "Filan njeri është i mendimit se jam një njeri i mirë.". Sigurisht që ai nuk e ka përdorur fjalën "unë", por në vend të saj ka thënë "ai", por folësi ka qenë i detyruar për këtë përdorim.

begative shpirtërore, por dhe shkak i shtimit të të mirave materiale, i shumimit të begative.[1]

Nga ky shpjegim kuptojmë se ajo që bëhet shkak për shtimin e begatisë, është qëndrueshmëria ndaj besimit dhe jo thjesht besimi, sepse besimi i përkohshëm nuk mund të dhurojë dobi të tilla. Qëndrueshmëria në besim dhe devotshmëri është shumë e rëndësishme. Por shumica e njerëzve nuk janë të qëndrueshëm dhe të përmbajtur.

Ajeti vijues i referohet një të vërtete tjetër, e cila lidhet me këtë çështje. Ajeti thotë: **"Për t'i vënë ata me këtë në sprovë..."**. A mund të jetë shkak i krenarisë dhe i injorancës së tyre shtimi i pasurisë, apo do të jetë shkak i rizgjimit, i falënderimit dhe i kushtimit më shumë vëmendje ndaj All'llahut?!

Këtu bëhet e qartë se shtimi i begatisë konsiderohet një prej sprovave hyjnore. Sprova me anë të dhënies së begatisë është më komplekse dhe më e vështirë se sa sprova me anë të dënimit, sepse rezultati i shtimit të begatisë, zakonisht sjell rritjen e përtacisë, të dembelizmit, të neglizhencës dhe të zhytjes në kënaqësi dhe epshe. Pasuria e tepërt e largon njeriun nga Rruga e All'llahut, ashtu siç, nga ana tjetër, djalli është më i lirë që të kryejë aktivitetet e veta. Vetëm ata persona që e kujtojnë dhe e përmendin përherë e në çdo situatë All'llahun e Madhëruar, mund të jenë të sigurt ndaj efekteve negative të shtimit të pasurisë dhe të djajve.[2]

---

[1] Për këtë çështje kemi dhënë shpjegim të detajuar në suren "Nuh", ajeti 12.

[2] Disa komentues të Kur'anit janë të mendimit se synimi i fjalës *"et tarikatu"*, në ajetin e lartpërmendur, është rruga e politeizmit, kurse të mirat materiale dhe shtimi i pasurisë, që përftohet gjatë kësaj rruge, me anë të qëndrueshmërisë dhe durimit, është premisë për dënimet dhe shenjë e pakësimit të bollëkut dhe të

Në vazhdim, ajeti thotë: **"...Por këdo që largohet nga këshillat e Zotit të tij, Ai do ta hedhë në një dënim të ashpër."**.

Fjala *"sa'ade"* tregon ngritjen dhe lartësimin. Ndonjëherë është përdorur dhe në kuptimin e *"vargmalit"*. Duke pasur parasysh që ngjitja nëpër male është e lodhshme, në shoqërim me këtë, edhe kjo shprehje është përdorur për të treguar kuptimin e "një lloj torture". Pikërisht për këtë fakt, shumica e komentuesve të Kur'anit, ajetin e lartpërmendur, e kanë interpretuar në këtë mënyrë: "dënimi i ashpër dhe i padurueshëm", njësoj me atë që është thënë në ajetin 17 të sures "El Muddeththir", kur flet për disa politeistë. Aty thuhet: **"Atë do ta ndrydhim me një dënim të rëndë e të padurueshëm..."**.

Por ekziston edhe mundësia që shprehja e lartpërmendur, krahas shpjegimit për ashpërsinë e këtij dënimi, të jetë aludim dhe për shtimin e dënimit.

Në këtë mënyrë, ajetet e lartpërmendura, nga një anë, vënë në pah lidhjen e besimit dhe të devotshmërisë me shtimin e begatisë, nga ana tjetër, tregojnë lidhjen e shtimit të begatisë me sprovat hyjnore.

Së treti, shpjegojnë marrëdhënien midis injorimit të kujtimit të All'llahut me dënimin e ashpër dhe të padurueshëm. Këto fakte janë pasqyruar edhe në raste të tjera në Kur'an, për shembull, në ajetin 124 të sures "Ta Ha", lexojmë: **"Kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë..."**.

---

pasurisë. Ky komentim nuk përputhet aspak me tonin e këtij ajeti, të ajetit të mëparshëm dhe atij në vijim.

Në suren "Neml", në ajetin 40, të transmetuar nga Sulejmani *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, lexojmë: **"Kjo është nga dhuntia e Zotit tim, që të më sprovojë mua, se a do ta falënderoj apo do ta përbuz..."**.

Kurse në ajetin 28 të sures "El Enfal", thuhet: **"Dhe, dije mirë, se pasuria juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm një sprovë..."**.

Në ajetin vijues, nga vetë goja e besimtarëve xhind, gjatë thirrjes së të tjerëve drejt monoteizmit, është thënë kështu: **"Xhamitë i janë kushtuar vetëm All'llahut, prandaj mos iu lutni askujt, krahas All'llahut!"**.

Për kuptimin e fjalës *"mesaxhid"* në ajetin e lartpërmendur, janë dhënë interpretime të ndryshme:

Së pari, kanë deklaruar se me fjalën *"mesaxhid"* tregohen vendet në të cilat kryhen adhurime dhe bëhet sexhde. Shembulli i qartë i këtij kuptimi është "Mesxhidul Haram". Shembujt të tjerë janë xhamitë e tjera. Objektet më gjithëpërfshirëse janë të gjitha vendet, ku njeriu kryen faljen dhe i bën sexhde All'llahut. Në një hadith të njohur të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: *"E gjithë toka është vend adhurimi dhe mjeti i pastrimit për mua"*,[1] përfshin të gjithë tokën.

Kjo është përgjigje për veprimet e politeistëve arabë dhe të të ngjashmëve me ta, të cilët "Shtëpinë e All'llahut" dhe Kishat ku kryenin veprimet e tyre të krishterët e devijuar, duke adhuruar tre zotat e tyre, i patën kthyer në faltore. Kur'ani thotë se të gjithë tempujt i përkasin All'llahut dhe në këto tempuj nuk mund t'i

[1] "Uesailul Shi'ah", vëll. 2, hadithi 3, f. 970; vëll. 3, f. 350 , botim i shtëpisë botuese "Ehlu Bejt".

bëjmë sexhde askujt, përveç Atij. Adhurimi i dikujt tjetër, përveç Tij, është i ndaluar!

Së dyti, me fjalën *"mesaxhid"* tregohen shtatë gjërat e sexhdes, të cilat duhet të bien në tokë për të bërë sexhde vetëm për All'llahun dhe jo për dikë tjetër. Kështu thuhet edhe në haditin e poshtëpërmendur, të transmetuar nga Imami i nëntë, Imam Xhevadi. Aty lexojmë: "Mu'tasem Abasi, në tubimin ku ishin mbledhur dhe juristët e Ehli Synetit, pyeti: 'Cila pjesë e dorës së vjedhësit duhet prerë?'.

Disa thanë: "Nga kyçi i dorës", - dhe këtë e argumentuan me ajetin e Tejemumit.

Disa të tjerë deklaruan: "Nga bërryli", - duke e argumentuar me Ajetin e Abdesit. Mu'tasemi kërkoi mendimin e Imamit për këtë çështje. Në fillim Imami nuk i kushtoi vëmendje asaj pyetjeje, por, kur pa këmbënguljen e tij, iu përgjigj: *"Të gjitha mendimet e dhëna janë të gabuara. Duhen prerë vetëm katër gishtat e dorës. Nuk duhet të pritet gishti i madh dhe pëllëmba e dorës."*.

Mu'tasemi i kërkoi argument për këtë. Imami e arsyetoi fjalën e vet duke iu referuar thënies së Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Sexhdja duhet të kryhet me anë të shtatë gjërave: ballit, pëllëmbës së dy duarve, dy gjunjëve dhe dy këmbëve."*.

Më pas shtoi: Nëse vjedhësit i pritet dora nga kyçi apo nga bërryli, nuk do t'i ngelë dorë që të bëjë sexhde, ndërkohë që All'llahu deklaron: **"Vendsexhdet i janë kushtuar vetëm All'llahut..."**, që do të thotë se këto shtatë gjymtyrë i janë kushtuar vetëm All'llahut.

Ajo që i përket vetëm All'llahut, nuk duhet të pritet. Ky argumentim i mrekullueshëm e habiti Mu'tasemin dhe urdhëroi që, në bazë të urdhrit të Imamit, vjedhësit t'i priten vetëm katër gishtat e dorës.[1]

Me të njëjtën përmbajtje janë transmetuar edhe hadithe të tjera.[2]

Por, zakonisht hadithet që janë transmetuar në këtë fushë, ose janë të paargumentuara, ose dëshmia është e dobët dhe e pabazë. Përveç kësaj, ka dhe përjashtime dhe nuk janë të lehta përgjigjet dhe argumentimet përkatëse. Për shembull, fakihët, (juristët myslimanë) thonë se, nëse hajduti vjedh për të dytën herë, i pritet pjesa e përparme e këmbës, kurse pjesa e thembrës nuk i preket, sepse gishti i madh i këmbës bën pjesë në gjymtyrët shtatëllojëshe, me anë të cilave kryhet sexhdja. E njëjta gjë është dhe në lidhje me "luftëtarin", për të cilin është pranuar, si një prej ndëshkimeve, prerja e një pjese të dorës dhe të këmbës së tij.

Së treti, me fjalën *"mesaxhid"* tregohen *"sexhdet"*, që gjithnjë duhet të kryhen vetëm për hir të All'llahut dhe nuk i duhet bërë sexhde askujt tjetër, përveç Tij.

Edhe ky mendim bie në kundërshtim me përmbajtjen e ajetit dhe për ta vërtetuar këtë nuk ka asnjë dëshmi.

Nga e gjithë sa u tha më lart, arrijmë në përfundimin se ajo që përputhet me përmbajtjen e ajetit, është komentimi i parë. Ai ka dhe një përputhshmëri të plotë me ajetet paraprake dhe me ajetet

[1] "Uesailul Shi'ah", vëll. 18, kreu "Haddu Serikati", f. 490; vëll. 28, kreu 4, hadithi 5, f. 252, botim i shtëpisë botuese "Ehli Bejti".

[2] Tefsiri "Nuruth Thekalejen", vëll. 5, f. 439-440.

në vijim, për monoteizmin dhe për adhurimin vetëm për hir të All'llahut.

Komentimi i dytë ka mundësi të jetë zhvillim i konceptimit të ajetit, kurse komenti i tretë nuk sjell asnjë argument apo dëshmi.

Për të pasqyruar efektin e jashtëzakonshëm të Kur'anit të Madhërishëm dhe adhurimin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ndaj xhindeve, ajeti shton: **"Kur robi i All'llahut** (Muhammedi)**, u ngrit t'i lutej Atij, ata** (xhindet) **u tubuan rreth tij si shtëllungë."**.

Fjala "*lebed*" përdoret për të treguar një gjë, gjymtyrët që janë në kontakt me njëra-tjetrën. Kjo fjalë tregon tubimin e jashtëzakonshëm të besimtarëve xhind për të dëgjuar Kur'anin, për herë të parë dhe njëherësh është shpjegues i efektit të jashtëzakonshëm që shkaktoi te ata falja e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Për këtë ajet janë dhënë dhe dy komentime të tjera:

Komentimi i parë thotë se xhindët shpjegojnë gjendjen e shokëve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në Mekë, të cilët, edhe pse ishin të paktë në numër, me të dëgjuar fjalët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, hipnin mbi supet dhe kokat e njëri-tjetrit. Ajeti tregon se xhindët i morën shokët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* si model dhe shembull për vete dhe nxituan drejt besimit.

Komenti i dytë i ajetit tregon se, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* falte

namaz apo këndonte Kur'an, politeistët arabë e rrethonin, e përqeshnin dhe e ngacmonin atë.

Por ky komentim nuk ka ndonjë përputhshmëri apo përshtatshmëri me thirrjen e besimtarëve xhind, të cilët dëshironin t'i nxisnin të tjerët në Rrugën e Drejtë, pra, në besim. Ajeti përshtatet me njërin prej dy kuptimeve të mëparshme.

Hulumtim

Shtrembërim në komentimin e ajetit "ue ennel mesaxhide lil'lah"

"Ndërmjetësimi" me anë të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe me anë të "të dashurve të All'llahut", pra, konsiderimi i tyre si ndërmjetës te All'llahu, është një çështje që nuk është në kundërshtim as me të vërtetën e njëjësimit të All'llahut dhe as me ajetet kur'anore. Kjo çështje është theksim i monoteizmit dhe i faktit se çdo gjë është nga All'llahu. Në ajetet kur'anore është diskutuar shumë herë kjo çështje.[1]

Megjithatë, disa prej të larguarve nga njohuritë islame dhe nga Kur'ani, këmbëngulin në mohimin e çdo lloj ndërmjetësimi.

[1] Në lidhje me ndërmjetësimin, për nga pikëpamja e Kur'anit dhe Hadithit, më gjerësisht kemi diskutuar në suren "El Bekare", ajeti 48. Kurse rreth të vërtetës së "ndërmjetësimit", kemi folur në suren "El Maide", ajeti 35.

Për të vërtetuar synimet e veta, kanë gjetur pesudoargumente, si ajeti i lartpërmendur, ku thuhet: **"Xhamitë i janë kushtuar vetëm All'llahut, prandaj mos iu lutni askujt, krahas All'llahut!"**.

Sipas këtij ajeti, thonë ata, Kur'ani urdhëron që krahas Emrit të All'llahut, të mos përmendni asnjë emër tjetër, të mos thirrni askënd tjetër dhe të mos kërkoni ndërmjetësim.

Por ky ajet nuk ka asnjë lidhje me çështjen në fjalë. Ky ajet është mohim i politeizmit dhe i shirkut, që do të thotë, pra, i vënies diçka në një rang me All'llahun në adhurim apo në kërkimin e plotësimit të nevojave.

Thënë ndryshe: Në qoftë se një person, veprën që i takon All'llahut, e kërkon prej dikujt tjetër dhe njëkohësisht e konsideron atë si të pavarur dhe me ndikim vetjak (jashtë vullnetit të All'llahut), është politeist. Ashtu si fjala *"mea"* (bashkë, krahas) e përdorur në fjalinë: **"... prandaj mos iu lutni askujt, krahas All'llahut!"**, është dëshmi se asnjë njeri nuk duhet të konsiderohet si "përkrah All'llahut" apo si "burim i ndikimit të pavarur".

Por në qoftë se dikush kërkon ndonjë ndërmjetësim nga Profetët e Zotit, ose ndonjë ndërlidhje me All'llahun, Kur'ani jo vetëm që nuk e mohon atë, por vetë Profetin e fton drejt kësaj dhe, ndonjëherë, i urdhëron të tjerët që të kërkojnë ndërmjetësim nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Në ajetin 103 të sures "Et Teube", lexojmë: **"Merr prej pasurisë së tyre lëmoshë, që t'i pastrosh me të dhe t'u shtosh** (të mirat) **dhe njëkohësisht lutu për ta, se lutja jote është qetësim për ta..."**.

Nga goja e vëllezërve të Profetit Jusuf *(Paqja qoftë mbi të!)*, drejtuar babait të tyre, në ajetin 97 të sures "Jusuf", lexojmë: "**Ata thanë: 'O babai ynë, lutu për ne, të na falen mëkatet tona, se me të vërtetë ne kemi qenë fajtorë.'"**.

Jakubi, gjithashtu, jo vetëm që nuk e kundërshtoi këtë kërkesë, por u premtoi atyre: **"Më vonë do t'i kërkoj Zotit tim faljen tuaj, tha ai** (Jakubi)**, se vërtet, Ai është që fal, është mëshirues."**.[1]

Prandaj, çështja e ndërmjetësimit dhe e lutjes, është një prej urdhrave të qarta të Kur'anit, në bazë të konceptit që u tha më lart.

Ajetet 20 – 24

قُلْ إِنَّمَا أَدْعُو رَبِّي وَلَا أُشْرِكُ بِهِ أَحَدًا ٢٠ قُلْ إِنِّي لَا أَمْلِكُ لَكُمْ ضَرًّا وَلَا رَشَدًا ٢١ قُلْ إِنِّي لَنْ يُجِيرَنِي مِنَ اللَّهِ أَحَدٌ وَلَنْ أَجِدَ مِنْ دُونِهِ مُلْتَحَدًا ٢٢ إِلَّا بَلَاغًا مِنَ اللَّهِ وَرِسَالَاتِهِ وَمَنْ يَعْصِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَإِنَّ لَهُ نَارَ جَهَنَّمَ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا ٢٣ حَتَّى إِذَا رَأَوْا مَا يُوعَدُونَ فَسَيَعْلَمُونَ مَنْ أَضْعَفُ نَاصِرًا وَأَقَلُّ عَدَدًا ٢٤

[1] Sure "Jusuf", ajeti 98.

"Thuaj (o Muhammed)**: Unë i lutem vetëm Zotit tim dhe nuk i shoqëroj Atij askënd** (në adhurim)**."**

"Thuaj: Unë nuk mundem t'ju largoj ndonjë dëm e as t'ju sjell ndonjë dobi."

"Thuaj: Edhe mua askush nuk mund të më mbrojë nga dënimi i All'llahut; dhe nuk mund të gjej strehim tjetërkund, përveçse tek Ai."

"Unë kam për detyrë veç t'ju përcjell atë që më vjen nga All'llahu dhe mesazhet e Tij. Këdo që s'dëgjon All'llahun dhe të Dërguarin e Tij, e pret zjarri i Xhehennemit, në të cilin do të mbetet përgjithmonë."

"Kur ata të shohin atë që u është premtuar, do ta dinë se kush është më i dobët dhe më i paktë në numër."

Komentimi

Çdo gjë është në dorën e All'llahut dhe jo në dorën time

Në këto ajete, për përforcimin e bazave të monoteizmit, si dhe mohimin e çdo lloj shirku, që u citua në ajetet e mëparshme, e urdhëron Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"Thuaj** (o Muhammed)**: Unë i lutem vetëm Zotit tim dhe nuk i shoqëroj Atij askënd** (në adhurim)**."**.

Më pas, përsëri e urdhëron: **"Thuaj: Unë nuk mundem t'ju largoj ndonjë dëm e as t'ju sjell ndonjë dobi."**.

Përsëri shton: **"Thuaj: Edhe mua askush nuk mund të më mbrojë nga dënimi i All'llahut; dhe nuk mund të gjej strehim tjetërkund, përveçse tek Ai."**.[1]

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thekson se askush nuk mund ta mbrojë atë, si dhe asnjë gjë nuk mund të jetë mbështetja e tij, përveç All'llahut të Madhëruar.

Këto fjalë, **së pari,** janë pohim për robërinë e plotë përballë All'llahut. **Së dyti,** mohojnë çdo lloj "ekzagjerimi" rreth Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Së treti, bën të qartë se adhurimi i idhujve nuk sjell asnjë dobi, sepse edhe vetë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, me gjithë atë madhështi, nuk mund të ketë ndonjë strehim apo mbrojtje të pavarur nga dënimi i All'llahut.

Së katërti, u jep fund justifikimeve dhe shpresave të kota që njerëzit kokëfortë dhe kryeneçë kishin karshi Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Po ashtu, argumenton që ndërmjetësimi realizohet vetëm me lejen e All'llahut.

---

[1] Disa, në lidhje me këtë ajet, kanë dhënë një shkak zbritje. Po e japim shkurtimisht: Politeistët kurejsh iu drejtuan Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "Hiq dorë nga feja jote dhe ne do të të ndihmojmë ty!". Ndërkohë zbriti ajeti i lartpërmendur, duke iu përgjigjur atyre. (tefsiri "Ebul Fettuh Err Rrazij", vëll. 11, f. 294).

Fjala *"multehiden"* tregon *strehën e sigurt*. Ajo rrjedh nga fjala *"lahdun"*, e cila përdoret për të treguar një *zgavër, (gropë) të veçuar*, ngjashëm me atë që hapin për të varrosur të vdekurin. Në thellësi të varrit hapin një cep dhe në të e vendosin xhenazen, me qëllim që dheu të mos bjerë mbi xhenazen, si dhe të jetë më i mbrojtur nga dëmtimi i kafshëve. Kjo fjalë është përdorur më pas për të treguar çdo vend apo strehë tjetër të sigurt.

Ashtu siç e diskutuam edhe në ajetet e lartpërmendura, këto fjalë tregojnë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk ka asnjë ndikim te All'llahu. Ai mund të kërkojë nga All'llahu zgjidhjen e problemeve të njerëzve, apo të kërkojë udhëzimin e njerëzve të denjë dhe të merituar. Kjo është plotësisht në përputhje me monoteizmin dhe kurrsesi nuk është shirk apo politeizëm.

Në këto ajete, karshi fjalës *"dararun"* - *"dëm"*, është përdorur fjala *"hidajetun"* - *"udhëzim"* dhe këto tregojnë se dobia dhe interesi i vërtetë qëndron në udhëzim. Këtë e kemi thënë edhe në ajetet e mëparshme, kur shpjeguam kuptimet e fjalës *"sherr'rrun"* - *"e keqe"*. Fjala *"darar"* dhe *"rushdun"* - *"udhëzim"* korrespondojnë me njëra-tjetrën.

Ajeti në vijim thotë: **"Unë kam për detyrë veç t'ju përcjell atë që më vjen nga All'llahu dhe Mesazhet e Tij."**.

Kjo fjali është e ngjashme me fjalinë e përmendur shumë herë në Kur'an, p.sh, në ajetin 92 të sures "El Maide": **"Bindjuni All'llahut dhe bindjuni të Dërguarit e kini kujdes. E, nëse refuzoni, atëherë, dijeni se obligimi i të Dërguarit Tonë është vetëm komunikimi i qartë."**.

Në ajetin 188 të sures "El A'raf", lexojmë**: "Thuaj: 'Unë nuk kam në dorë për veten time as ndonjë dobi, as ndonjë dëm, përveç ç'do All'llahu. Sikur ta dija të fshehtën, do të shumoja për vete të dobishmet, e nuk do të më prekte gjë e keqe. Unë nuk jam tjetër, vetëm se qortues dhe përgëzues për njerëzit që besojnë.'"**.

Për këtë ajet janë dhënë edhe interpretime të tjera. Një prej tyre thotë: **"**Unë nuk kam asnjë lloj mbrojtjeje për të shpëtuar veten time, përveç komunikimit të Mesazhit Hyjnor dhe kryerjes së misionit të Tij.".

Atëherë, cili është dallimi mes fjalës *"komunikim"* dhe *"mision"*? Disa dijetarë kanë deklaruar se fjala *"belagun"* - *"kumtim"*, tregon komunikimin e parimeve të fesë, kurse fjala *"mision"* tregon shpjegimin e degëzimeve të fesë, pra, të mësimeve praktike *(furu'ud din)*.

Disa të tjerë janë të mendimit se fjala *"belagun"* është përdorur me kuptimin e komunikimit të urdhrave hyjnorë, kurse me fjalën *"resaletun"* nënkuptohet zbatimi i tyre.

Meqenëse të dyja këto fjali i referohen të njëjtit kuptim dhe janë plotësuese të njëra-tjetrës, (gjë e zakonshme për shumë ajete kur'anore), që të dyja së bashku shënojnë të njëjtin kuptim.

Si p.sh, ajeti 62 i sures "El A'raf" thotë: **"Unë ju kumtoj juve Shpalljet e Zotit tim, ju këshilloj ..."** (dhe shumë ajete të tjera).

Pavarësisht kësaj, në fund, ajeti paralajmëron: **"Këdo që s'dëgjon All'llahun dhe të Dërguarin e Tij, e pret zjarri i Xhehennemit, në të cilin do të mbetet përgjithmonë."**.

Këtu nuk është fjala për çdo mëkatar, por për politeistët dhe jobesimtarët, sepse jo çdo mëkatar meriton të futet në zjarrin e Xhehennemit.

Më pas shton se jobesimtarët dhe politeistët, të cilët i përqeshnin myslimanët apo i konsideronin si të dobët në këtë botë, do të përballen me ato që u janë premtuar. Ata atëherë do ta kuptojnë se kush i ka shokët më të dobët dhe kush është më i paktë në numër. **"Kur ata të shohin atë që u është premtuar, do ta dinë se kush është më i dobët dhe më i paktë në numër."**.

Se çfarë nënkuptohet me sifjalinë: *"ma juadune"* - **"atë që u është premtuar"**, ka mendime të ndryshme. Disa thonë se bëhet fjalë për dënimin e kësaj bote. Të tjerë thonë se bëhet fjalë për dënimin e Botës Tjetër. Grupi i tretë thotë se bëhet fjalë për të dyja botët. Mendimi më i përshtatshëm është ai që thotë se kuptimi i saj nuk është i kushtëzuar dhe gjithëpërfshirës, sidomos duke pasur parasysh faktin që shumimi apo pakësimi në numër, dobësia apo fuqia, i përkasin kësaj bote.

Disa komentues të Kur'anit, këtë e kanë interpretuar si çështjen e Luftës së Bedrit, ku doli në pah fuqia dhe forca e myslimanëve.

Në qoftë se ajetin e komentojmë në kontekstin e gjerë kuptimor, do të përfshiheshin aty disa interpretime.

Përveç kësaj, në ajetin 75 të sures "Merjem", lexojmë: **"Thuaj Atij që është në humbje** (në mosbesim)**, se, kur ta shohin atë që po u premtohet, ose dënimin** (në këtë jetë) **ose Kiametin, atëherë do ta kuptojnë se kush do të jetë në pozitë më të keqe dhe më i dobët në përkrahje."**.

Ajeti na e bën të qartë se armiqtë e Islamit gjithnjë kanë shfaqur forcën me epërsi numerike përballë myslimanëve, të cilët i konsideronin të dobët dhe të pafuqishëm. Kur'ani, me anë të këtij ajeti, u jep kurajë dhe ngushëllim myslimanëve, si dhe u premton atyre që, në përfundim, do të vijë dita e fitores së tyre, kurse armiqtë e Islamit do të dështojnë dhe do të jenë të pafuqishëm.

Hulumtim

1- Sinqeriteti i udhëheqësve hyjnorë

Udhëheqësit hyjnorë (udhëheqësit e zgjedhur nga All'llahu) asnjëherë nuk janë treguar egoistë, mendjemëdhenj dhe arrogantë përballë "udhëheqësve satanikë" (të djallit). Kjo është një nga karakteristikat kryesore të tyre.

Faraoni gjithnjë bërtiste si injorant: **"U thuaj se Unë jam Zoti i juaj më i lartë..."**.[1] Po kështu, në një vend tjetër në Kur'an thuhet se Faraoni thotë: **"O populli im, a nuk është i imi pushteti**

[1] Sure "En Naziat", ajeti 24.

i Egjiptit dhe i këtyre lumenjve që rrjedhin në pallatin tim? A nuk po shihni?".[1]

Udhëheqësit hyjnorë ishin të përulur dhe të nënshtruar, siç u takonte të ishin robtë modestë të All'llahut.

Në ajetin 110 të sures "El Kehf", lexojmë: **"Thuaj unë jam vetëm njeri sikurse edhe ju. Mua më Shpallet se Zoti i juaj është vetëm Një!"**.

Kurse në një vend tjetër, ajeti thotë: **"...nuk e di se ç'do të bëhet me mua e as me ju. Unë nuk ndjek tjetër, vetëm atë që më Shpallet, unë nuk jam tjetër, por i Dërguar që ju tërheq vërejtjen qartas."**.[2]

Në një ajet tjetër lexojmë: **"Thuaj se unë nuk ju them juve se i kam në kompetencë depot e All'llahut, as nuk pretendoj se e di fshehtësinë, as nuk u them se unë jam engjëll. Unë ndjek vetëm atë që më shpallet mua."**.[3]

Ata, megjithëse kishin arritur në kulmin e tyre nga ana materiale apo shoqërore, kurrë nuk hiqnin dorë së thëni, siç kishte thënë edhe Sulejmani *(Paqja qoftë mbi të!)*: **"Kjo është nga dhuntia e Zotit tim, që të më sprovojë mua..."**.[4]

Në shumë ajete kur'anore përdoren shprehje të ashpra, që i referohen Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe e paralajmërojnë atë që të tregohet i kujdesshëm ndaj përgjegjësive të veta.

---

[1] Sure "Ez Zuhruf", ajeti 51.

[2] Sure "El Ahkaf", ajeti 9.

[3] Sure "El En'am", ajeti 50.

[4] Sure "En Neml", ajeti 40.

Tërësia e këtyre ajeteve dhe e ajeteve të mëparshme, të cilat nuk janë të pakta, janë dëshmi e gjallë ndaj vërtetësisë së këtij Profeti të madh, të cilin nuk e pengonte asgjë, që përballë turmës së njerëzve, të deklaronte për vete pozita të larta. Por, siç e ka treguar historia, pretendimet i shfaqin udhëheqësit satanikë.

2- Nuk është e rëndësishme sasia por cilësia

Në ajetet kur'anore është treguar se idhujtarët, gjithnjë, ishin më shumë në numër dhe përbënin pjesën më të madhe të popullsisë. Ata krenoheshin me këtë fakt përballë Profetëve.

Faraoni, me qëllim që të përbuzte admiruesit e Profetit Musa *(Paqja qoftë mbi të!)*, thoshte: **"Ata janë një grup i vogël,** (të cilët ikën me Musain)**..."**.[1]

Kurse politeistët arabë thoshin**: "Ne kemi më shumë pasuri e fëmijë, e nuk do të jemi të ndëshkuar..."**.[2]

Ndonjë njeri jo besimtar krenohej përballë një besimtari, sepse ishte më i pasur dhe familja e tij kishte shumë anëtarë: **"Unë kam pasuri më shumë se ti, e kam edhe krah më të fortë."**.[3]

Besimtarët që pasonin Profetët dhe udhëheqësit hyjnorë, asnjëherë nuk krenoheshin me numrin e madh të tyre apo me përkrahjen e fortë. Logjika e tyre ishte kjo: **"Sa e sa grupe të vogla, me dëshirën e All'llahut, kanë triumfuar ndaj grupeve të mëdha! All'llahu është me durimtarët!"**.[4]

[1] Sure "Esh Shuara", ajeti 54.
[2] Sure "Sebe'e", ajeti 35.
[3] Sure "El Kehf", ajeti 34.
[4] Sure "El Bekare", ajeti 249.

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* thotë: *"O njerëz, mos u ndjeni të vetmuar në shtegun e udhëzimit, për shkak të numrit të vogël të ithtarëve të tij..."*.[1]

Historia e Profetëve, veçanërisht historia e Profetit të Islamit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, na tregon se si turma të mëdha, të fuqishme dhe jobesimtare dhe që kishin të gjitha llojet e fuqive, pësuan humbje dhe u treguan të pafuqishëm përballë besimtarëve të All'llahut, të cilët ishin edhe të paktë në numër. Një gjë e tillë është pasqyruar në Kur'anin Famëlartë, në historinë e Beni Israilëve, Faraonit, Talutit dhe Xhalutit, si dhe në ajete që flasin për Luftën e Bedrit dhe Ahzabit.

Ajetet 25 – 28

قُلْ إِنْ أَدْرِى أَقَرِيبٌ مَا تُوعَدُونَ أَمْ يَجْعَلُ لَهُ رَبِّى أَمَدًا۝ عَالِمُ الْغَيْبِ فَلَا يُظْهِرُ عَلَى غَيْبِهِ أَحَدًا۝ إِلَّا مَنِ ارْتَضَى مِنْ رَسُولٍ فَإِنَّهُ يَسْلُكُ مِنْ بَيْنِ يَدَيْهِ وَمِنْ خَلْفِهِ رَصَدًا۝ لِيَعْلَمَ أَنْ قَدْ أَبْلَغُوا رِسَالَاتِ رَبِّهِمْ وَأَحَاطَ بِمَا لَدَيْهِمْ وَأَحْصَى كُلَّ شَىْءٍ عَدَدًا۝

[1] "Nehxhul Belaga", Fjalimi 200.

"Thuaj (o Muhammed!)**: Unë nuk e di, a është afër ajo që ju është premtuar apo Zoti im do ta vonojë."**

"Vetëm Ai e di të padukshmen dhe nuk ia zbulon atë askujt."

"Përveç të Dërguarve që ka zgjedhur. Para dhe pas tyre Ai vë mbikëqyrës (engjëj)**. "**

"Në mënyrë që ta dijë nëse i përcjellin Mesazhet e Zotit të tyre. Ai përfshin me dijen e Vet gjithçka që ata kanë dhe çdo gjë e ka llogaritur imtësisht."

Komentimi

Vetëm All'llahu e di të padukshmen

Në ajetet pararendëse u diskutua rreth përqeshjes dhe rebelimit të këtij grupi, e cila do të vazhdojë, derisa ata të shohin atë që u është premtuar. Por këtu lind pyetja: Kur do të realizohet ky premtim? Komentuesit e Kur'anit, kur sqaruan shkakun e zbritje së ajetit, kanë treguar se disa politeistë, si Nedhr ibn Harith, pas zbritjes së ajeteve të lartpërmendura, parashtruan po të njëjtën pyetje.

Kur'ani i Madhërishëm i është përgjigjur kësaj pyetjeje në këtë mënyrë: **"Thuaj** (o Muhammed!)**: 'Unë nuk e di, a është afër ajo që ju është premtuar apo Zoti im do ta vonojë.'"**.

Kjo dije i përket vetëm Qenies së Stërpastër të All'llahut. Ai ka dashur që e padukshmja e Tij të jetë e fshehur për njerëzit, me qëllim që ata të sprovohen. Në qoftë se njerëzit do të ishin në dijeni për rrjedhën e fatit të tyre, madje, nëse e dinë se është një sprovë e afërt ose largët, sprovimi do të ishte më pak i efektshëm dhe me ndikim tepër të kufizuar.

Fjala *"emeden"* është përdorur me kuptimin e *"kohës"*, e cila shënon fillimin dhe mbarimin e një ngjarjeje. Fjala *"emedun"* nënkupton vetëm mbarimin e një kohe.

Gjithashtu, është thënë se fjalët *"emedun"* dhe *"bedaun"*, nga ana kuptimore, janë afër me njëra-tjetrën, por me ndryshimin që fjala *"beda"* nënkupton kohën e pacaktuar, kurse fjala *"emed"* nënkupton një kohë të caktuar.

Këtë kuptim e hasim shpesh në Kur'anin Famëlartë. Sa herë që Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e pyesnin për Kiametin, ai përgjigjej si i painformuar rreth kësaj çështjeje dhe thoshte: *"Të fshehtën e di vetëm All'llahu."*.

Në një hadith rrëfehet se një ditë Xhebraili iu shfaq Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në formën e një beduini dhe një prej pyetjeve me të cilat iu drejtua ishte: "Më trego se kur do të ndodhi Kiameti?".

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu përgjigj: *"Personin që po pyesni, nuk është më i informuar se sa pyetësi!"*.

Herën tjetër, beduini iu drejtua me një ton të ashpër Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "O Muhammed! Kur do të ndodhi Kiameti?!".

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu përgjigj: *"Mjerë për ty! Kiameti me patjetër do të ndodhë, por ti më thuaj se çfarë ke përgatitur për Atë Ditë!"*.

Beduini tha: "Unë nuk kam falur shumë namaz e as kam agjëruar gjatë, por e dua Zotin dhe të Dërguarin e Tij!".

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Atëherë ti do të jesh me atë që ke dashur!"*.

Enesi, një nga shokët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thotë: "Myslimanët nuk ishin gëzuar me asnjë bisedë tjetër më shumë se sa nga kjo fjalë.".[1]

Në vazhdimësi të këtij diskutimi, citon një rregull më të përgjithshëm rreth të padukshmes dhe thotë: **"Vetëm Ai e di të padukshmen dhe nuk ia zbulon atë askujt."**. Më pas, si përjashtim nga ky rregull i përgjithshëm, shton: **"Përveç të dërguarve që ka zgjedhur."**. Të Dërguarve, me anë të Shpalljes, u zbulon nga e vërteta atë që dëshiron.

Më pas: **"Para dhe pas tyre Ai vë mbikëqyrës** (engjëj)**."**.

[1] Tefsiri "El Meragij", vëll. 29, f. 105.

Fjala *"resede"* tregon gatishmërinë për t'u kujdesur për një gjë, ose për disa gjëra. Por përdoret edhe për një mbikëqyrës, ose për një grup mbikëqyrësish.

Në këtë ajet, kjo fjalë tregon engjëjt. Ata i urdhëroi All'llahu, pas zbritjes së këtij ajeti, që ta rrethojnë Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nga të gjitha anët dhe ta mbrojnë atë nga çdo e ligë që mund t'i vinte nga xhindet apo njerëzit, nga joshjet apo ngacmimet e tyre. Ta mbronin nga çdo gjë që dëmton apo prish autenticitetin e Shpalljes, me qëllim që Mesazhin Hyjnor t'ua përcjellë pa asnjë të metë robëve të Vet.

Në ajetin e fundit, që po diskutojmë, që realisht është dhe ajeti i fundit i kësaj sureje, argumentohet ekzistenca e këtyre mbikëqyrësve. Ajeti e tregon: **"Në mënyrë që ta dijë nëse i përcjellin Mesazhet e Zotit të tyre. Ai përfshin me dijen e Vet gjithçka që ata kanë dhe çdo gjë e ka llogaritur imtësisht."**.

Me fjalën *"el ilmu"* – *"dituri"*, këtu nënkuptojmë *"dijen aktuale"*. Thënë ndryshe, ky ajet tregon se dituria e All'llahut është e përhershme, e amshueshme dhe e pafundme. Këtë dituri të All'llahut, Profetët duhet ta komunikojnë si Mesazhin e Tij në praktikë dhe në këtë mënyrë të plotësojnë argumentin (Dëshminë) mbi njerëzit.

Hulumtim

Hulumtim të zgjeruar rreth dijes së fshehtë

Po t'i analizojmë me kujdes ajetet e ndryshme kur'anore, do të shohim se ekzistojnë dy grupe ajetesh, të cilat flasin për dijen e fshehtë të Zotit. Grupi i parë i ajeteve, e bën të qartë, që dija e fshehtë e Zotit i përket vetëm Atij dhe mohon të gjithë të tjerët, si p.sh: në ajetin 59 të sures "El En'am": **"Çelësat e fshehtësisë janë vetëm te Ai, atë** (fshehtësinë) **nuk e di kush, përveç Tij..."**.

Në ajetin 65 të sures "En Neml", thuhet: **"Thuaj askush, veç All'llahut, as në qiej as në tokë, nuk e di të fshehtën, as nuk e dinë se kur do të ringjallen."**.

Në suren "El En'am" në ajetin 50 i thuhet Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "**Thuaj, Unë nuk ju them juve se i kam në kompetencë depot e All'llahut** (e t'ju sjell mrekulli)**, as nuk pretendoj se i di fshehtësitë..."**.

Në ajetin 188 të sures "El A'raf", lexojmë: "**Thuaj, Unë nuk kam në dorë për veten time as ndonjë dobi, as ndonjë dëm, përveç çka do All'llahu. Sikur ta dija të fshehtën, do të shumoja për vete të dobishmet e nuk do të më prekte ndonjë gjë e keqe..."**.

Në përfundim të sures "Junus", në ajetin 20, lexojmë se i kërkohet Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të thotë: **"E fshehta është** (çështje) **vetëm e All'llahut. Prandaj, ju prisni se edhe unë, së bashku me ju po pres."**. Kështu thuhet edhe në ajete të tjera të ngjashme me to.

Grupi i dytë i ajeteve, bën të qartë, se të Dërguarit e All'llahut, përgjithësisht, ishin në dijeni për dijen e fshehtë të All'llahut. Këtë e vërejmë dhe në ajetin 179 të sures "Ali Imran":

"All'llahu nuk jua zbulon juve të fshehtat. Por All'llahu është Ai, që nga të Dërguarit e Vet, zgjedh atë që do (e i zbulon ndonjë të fshehtë)**..."**.

Kurse në mrekullitë e Profetit Isa *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: **"Unë ju tregoj për atë që e hani dhe për atë që keni në shtëpitë tuaja..."**.[1]

Ajeti që po diskutojmë, gjithashtu, e bën të qartë që All'llahu i Madhëruar, një pjesë të të Dërguarve të zgjedhur nga ana e Tij, i vë në dijeni për një pjesë të dijes së fshehtë.

Nga ana tjetër, nuk është i vogël numri i ajeteve që flasin për dijen e fshehtë të Zotit. Disa prej tyre janë: ajetet 2–4 të sures "Er Rrum": **"Bizantinët** (Rumët) **u mundën, në tokën më afër** (tokës së arabëve)**, por pas disfatës së tyre, ata do të ngadhënjejnë, brenda pak viteve. Çështja është vendim i All'llahut, fillim e mbarim** (për disfatë dhe fitore)**. E atë ditë,** (kur do të fitojnë bizantinët)**, besimtarët do të gëzohen."**.

Ajeti 85 i sures "El Kasas" thotë: **"S'ka dyshim se Ai që ta bëri obligim Kur'anin, Ai do të kthejë ty nga erdhe..."**.

Ndërsa në ajetin 27 të sures "El Fet'h", thuhet*:* **"Me vullnetin e All'llahut do të hyni në xhaminë e shenjtë** (në Qabe) **të siguruar..."**.

Ka edhe shumë ajete të tjera të ngjashme me to.

Në thelb, Shpallja hyjnore që i është zbritur Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e*

[1] Sure "Ali Imran", ajeti 49.

tij!), është një lloj e fshehte, që u vihet në dispozicion atyre. Atëherë, si mund të pohojmë që ata nuk janë të informuar rreth fshehtësisë së All'llahut, ndërkohë që atyre u është zbritur Shpallja?!

Përveç këtyre, ekzistojnë shumë hadithe, të cilat tregojnë se Profetët apo Imamët, në përgjithësi, kanë qenë në dijeni dhe të informuar për të fshehtën e All'llahut. Madje, ndonjëherë i vinin edhe të tjerët në dijeni. Kështu, ata treguan fitoren e Mekës dhe ngjarjen e Hatib ibn Ebu Belteatu. Hatib ibn Belteatu, me anë të një letre, që i dërgoi një gruaje të quajtur Sara, i informoi politeistët e Mekës për sulmin që do të kryente së shpejti ushtria e Islamit. Gruaja e fshehu letrën në gërshetat e saj dhe u nis në drejtim të Mekës. Më pas, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dha urdhër që disa myslimanë të tjerë, së bashku me Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*, ta ndiqnin atë grua, duke u thënë: "Në vendin e quajtur *Khakh*, do të takoheni me një grua, e cila ka me vete një letër që Hatibi ua ka dërguar politeistëve të Mekës. Merrjani asaj letrën.". Ata u nisën dhe u takuan me gruan. Në fillim ajo këmbënguli, duke thënë se nuk kishte një letër të tillë, por si përfundim, pranoi dhe e nxori letrën nga gërshetat, ku e kishte fshehur dhe ua dorëzoi atyre.[1]

Raste të ngjashme me këtë janë: rasti i informimit rreth ngjarjeve të luftës së Mutesë, rasti i rënies dëshmor i Xhaferit dhe i disa komandantëve të tjerë të Islamit për të cilët Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i informoi myslimanët në Medine.[2]

---

[1] Kjo ngjarje është shtjelluar në po këtë tefsir, në komentimin e sures "El Mumtehine".

[2] "Kamil i ibn Ethijr", vëll. 2, f. 237.

Shembuj të tillë nuk janë të paktë në jetën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Në "Nehxhul Belaga" hasim në shumë parashikime të ngjarjeve, të cilat do të ndodhin në të ardhmen. Ato tregojnë se Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* kishte dijeni për dijen e fshehtë të All'llahut. Kjo është thënë edhe në Fjalimin 13, ku qortonte banorët e Basrës. Midis të tjerash, thuhet: "*Për All'llahun, qyteti juaj do të përmbyset në atë masë, sa më duket që e shikoj xhaminë tuaj, si pjesa e epërme e anijes, ngjashëm me gjoksin e shpezës në valët e detit.*".

Edhe në hadithe të tjera, të transmetuara në librat e dijetarëve shi'i dhe syni, ka parashikime të shumta nga Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, për ngjarje që do të ndodhin në të ardhmen, siç i ka thënë Haxher ibn Kajs: "*Pas meje, ty do të të detyrojnë që të më mallkosh.*".[1]

Ose rasti tjetër që tregon se i kishte thënë Mervanit: "*Pasi të ketë arritur moshën e pleqërisë, ai do ta mbajë mbi supe flamurin e humbjes.*".[2]

Apo rasti kur Kumejl ibn Zijadi i ishte drejtuar Haxhaxhit duke i thënë: *"se Amirul Muminin Ali Ibn Abi Talibi(Paqja qoftë mbi të!) më ka informuar se ti je vrasësi im"*.[3]

[1] "Mestredeku Es Sahihihejn", vëll. 2, f. 358.

[2] "Tabakatu ibn Sa'ad", vëll. 5, f. 30.

[3] "El Isabetu i ibn Haxher", vëll. 5, pjesa 3, f. 325.

Apo kur i kishte thënë për Havarixhët e Nahrevanit, para se t'i luftonte: *"Nga grupi ynë, do të vriten dy persona, kurse nga grupi i tyre do të shpëtojnë dhjetë veta."*. Kështu ndodhi.[1]

Apo atë që i kishte thënë Asbag ibn Nebate, në lidhje me varrin e Imam Hysejnit *(Paqja qoftë mbi të!)*, kur po kalonte në tokën e Qerbelasë.[2]

Në librin "Fadailul Khamse" janë transmetuar shumë hadithe nga librat syni, në lidhje me dijen e jashtëzakonshme të Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, por ne e kemi të pamundur përmendjen e të gjithave këtu.[3]

Në hadithet e Ehli Bejtit, tregohet se në shumë transmetime shohim dijen e fshehtë të Imamëve të pastër. P.sh. në librin e njohur "El Kafij", në vëllimin e parë, në shumë kapituj të tij, vërehen shumë citime dhe referenca në lidhje me këtë fushë.

Po ashtu, i ndjeri Muhammed Mexhlisi, në librin e njohur të tij, "Biharul Enuar", në vëllimin 26, ka përmendur më shumë se 22 hadithe për këtë çështje.

Mund të themi se janë përmendur një numër i konsiderueshëm hadithesh apo transmetimesh në lidhje me informimin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të Imamëve të pagabueshëm, të cilët kanë informacion për dijen e fshehtë.

[1] El Hejthemij, në "El Mexhma'u", vëll. 2, f. 222.

[2] "El Rijadhul Nedhireh", vëll. 2, f. 222.

[3] "Fadhailul Khamse", vëll. 2, f. 231-235.

Problemi qëndron tek mënyra e bashkimit të haditheve, në dukje kontradiktore, sepse, në disa prej tyre, deklarohet që të fshehtën nuk e di askush tjetër, përveç All'llahut, kurse në disa të tjerë, pohohet se të fshehtën, përveç All'llahut, e dinë dhe njerëz të zgjedhur nga ana e Tij.

Për këtë janë shprehur mendime të ndryshme:

1- Rruga më e njohur e zgjidhjes së kësaj kontradikte, është të themi që me dijen e fshehtë, që i përket vetëm All'llahut, shënohet dija esenciale dhe e pavarur, si rrjedhojë, përveç Tij, askush nuk ka asnjë lloj njohurie rreth asaj të fshehte. Çdo informacion e kanë nga All'llahu, falë mëshirës dhe mirësisë së Tij. Ky informacion ka karakter të varur. Këtë mendim e dëshmon ajeti në fjalë, i cili thotë: **"Vetëm Ai e di të padukshmen dhe nuk ia zbulon atë askujt, përveç të Dërguarve që ka zgjedhur. Para dhe pas tyre Ai vë mbikqyrës** (engjëj)**."**.

Në "Nehxhul Belaga", gjithashtu, thuhet: "Kur Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* informonte se në të ardhmen do të ndodhte pushtimi i vendeve islame prej mongolëve, një nga shokët, u ngrit dhe tha: 'O Ali, vallë, a është të dhënë ty njohuria për të fshehtën?'.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, duke buzëqeshur, iu përgjigj njeriut që ishte nga fisi Benu Kelb: *"Nuk është kjo njohuri nga njohuritë mbi të fshehtën. Këtë e kam fituar nga ai që e ka pasur këtë njohuri, nga Profeti."*.[1]

Këtë e kanë pranuar shumë dijetarë dhe hulumtues.

[1] "Nehxhul Belaga", Fjalimi 128.

2- Fshehtësia dhe e padukshmja janë dy llojesh: një lloj i tyre i përket vetëm All'llahut dhe përveç Tij askush tjetër nuk është në dijeni për to, si p.sh. ndodhia e Kiametit, pra, kur do të ndodhë Kiameti dhe çështje të tjera të ngjashme, kurse llojin tjetër të së fshehtës, ua mëson dhe ua zbulon vetëm të Dërguarve, ashtu siç është shprehur edhe në "Nehxhul Belaga", në fjalimin e lartpërmendur, ku thotë: "*Për sa i përket njohurisë mbi të fshehtën, ajo nënkupton njohurinë mbi Ditën e Gjykimit dhe atë të cilën All'llahu Famëlartë e përfshin në ajetin:* **'Vetëm All'llahu e di kur do të vijë Kiameti...'** (Kur'an 31:34). *Prandaj, All'llahu i Madhëruar është i Vetmi që e di ç'ka në bark, femër ose mashkull, se si do të jetë, i shëmtuar ose i bukur, dorëlirë ose dorështrënguar, i pafat ose fatlum, si dhe kush do të jetë lëndë djegëse për Xhehennem, e kush do të jetë në shoqërinë e të Dërguarve në Xhennet. Kjo është njohuri mbi sekretin, të cilin nuk e di askush, përveç All'llahut. Çdo gjë tjetër është dituri për të cilën All'llahu e mësoi Profetin e Tij, kurse ai e ka kaluar tek unë dhe është lutur që zemra ime ta ruajë atë dhe dijet e mia ta mbajnë.*".[1]

Ka gjasa që një pjesë e njerëzve, të kenë dijeni të përgjithshme për fetusin në barkun e nënës, për zbritjen së shiut apo të ngjashme me to, por dija me detaje dhe me hollësi, si dhe njohja me veçoritë e asaj, i përket vetëm Qenies së Stërpastër të Zotit. Siç dihet se për Kiametin ne kemi njohuri të përgjithshme, por për karakteristikat e tij nuk kemi dijeni. Në qoftë se në disa ajete është transmetuar se Profeti *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ose Imamët kanë informuar për disa nga lindjet e bebeve, apo për kohën e vdekjes së disa personave, kjo ka të bëjë me dijen e përgjithshme.

[1] "Nehxhul Belaga", Fjalimi 126.

3- Mënyra tjetër për bashkimin midis këtyre dy grupeve të ajeteve dhe hadithe, lidhet me sekretin e të fshehtës, i cili është i regjistruar në dy vende. Në "Leuhul Mahfudh" - "Tabela e ruajtur": "Unë nuk kam në kompetencë depot e All'llahut. Askush nuk mund të bëjë asnjë lloj ndryshimi në të dhe askush nuk është në dijeni rreth saj.".

Vendi i dytë i ruajtjes është "Leuhul Mahvi ue ithbat" - "Tabela e fshirjes dhe aprovimit", ku njohja është për kërkesat bazë dhe jo për shkakun e plotë. Për këtë arsye, këto informacione pësojnë ndryshime. Ajo që nuk e dinë të tjerët, ka të bëjë me pjesën që ndryshon.

Kështu, në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*All'llahu ka dituri që nuk e di askush tjetër, përveç Tij. Ai ka dituri, për të cilën i ka informuar engjëjt dhe të Dërguarit. Ne jemi në dijeni për atë që ua ka mësuar engjëjve dhe të Dërguarve.*".[1]

Nga Imam Hysejni *(Paqja qoftë mbi të!)* është transmetuar: "*Nëse në Kur'an nuk do të ekzistonte një ajet, unë do t'ju informoja për atë që ka ndodhur në të kaluarën dhe për atë që do të ndodhë deri në Ditën e Kiametit.*".

Një nga të pranishmit e pyeti: "Cili ajet?".

Imam Hysejni *(Paqja qoftë mbi të!)* u përgjigj, duke i treguar se All'llahu i Madhëruar thotë: **"All'llahu fshin** (nga ajo evidencë)

[1] "Biharul Enuar", vëll. 26, hadithi 5, f. 160. Për këtë çështje, janë transmetuar shumë hadithe të tjera, në po këtë burim.

çka të dojë, e edhe forcon (çka të dojë)**. Vetë, tek Ai është baza e librit** (Lehvi Mahfudhi)**."**.

Klasifikimi i njohurive sipas këtij bashkimi, bazohet në të qenët apo mos qenët i sigurt, kurse bashkimi i kaluar bazohej te një pjesë e njohurive.

4- Mënyra tjetër e bashkimit, mbështetet në dijeninë e All'llahut të Madhërishëm për të gjitha të fshehtat e të padukshmes. Por ka mundësi që të Dërguarit të mos jenë në dijeni për shumë prej sekreteve të së padukshmes. Por nëse All'llahu i Madhëruar dëshiron, ua mëson atë atyre.

Kështu që bashkimi midis ajeteve dhe hadithe që pohojnë "*ata nuk e dinë*", mund të jetë tregues për mosdijen aktuale, kurse kur thotë: "*ata e dinë*", mund të jetë tregues për mundësinë e asaj dije.

Kjo është njësoj me dikë që i është dhënë një letër për t'ia dërguar dikujt tjetër. Në këtë rast, mund të themi se personi, në fjalë, nuk ka dijeni se ç'thuhet në atë letër. Por ai mund ta hapë letrën dhe të informohet rreth saj. Në këtë rast, ne themi se ai është i informuar për përmbajtjen e letrës.

Si dëshmi të këtij bashkimi ekzistojnë hadithe që janë cituar në librin "El Kafij", në kapitullin "Imamët, sa herë që dëshirojnë të mësojnë diçka, atë ua mësojnë atyre". Në hadithin e transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*Kur Imami dëshiron të informohet ndaj ndonjë gjëje, All'llahu ia mëson atë atij.*".[1]

[1] Libri i njohur "El Kafij", vëll. 1, hadithi 3, f. 258. Në po këtë kapitull, gjithashtu, janë përmendur dhe hadithe të tjera me të njëjtën përmbajtje.

Kjo mënyrë e zgjidhjes së dilemës në fjalë, sqaron shumë probleme, lidhur me dijen e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të Imamëve, p.sh. si e konsumonin ata ujin apo ushqimin e helmuar, ndërkohë që kjo nuk është e lejuar, sepse rrezikon jetën. Duhet të pohojmë se në raste të tilla, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ose Imamët nuk ishin të lejuar, që sekretet e fshehtësisë, t'u zbuloheshin atyre.

Ndonjëherë, është me interes që Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* apo Imamët të mos vihen në dijeni ndaj ndonjë çështjeje, ose të vihen në sprovë. Kjo sprovë do të shërbejë si shkak për arritjen e përsosmërisë.

Në tregimin "Lejletul mebiti" thuhet: Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* u shtri në krevatin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* ka transmetuar se, kur politeistët kurejsh u vërsulën drejt krevatit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nuk e dinte në do të ngelte gjallë, apo do të binte dëshmor.

Kjo ngjarje tregon se, në këtë rast, ishte më e dobishme dhe më e drejtë që Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* të kishte dijeni për kryerjen e kësaj vepre, në mënyrë që të realizohej sprova e All'llahut. Në qoftë se Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* do të kishte dijeni, se do të flinte në krevatin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe në mëngjes, pasi të sulmohej, do të ngrihej shëndoshë e mirë, nuk do të kishte arsye që të krenohej me këtë veprim. Ajo që është transmetuar në

ajete apo hadithe, në lidhje me rëndësinë e kësaj sakrifice, nuk do të justifikohej.

Çështja e dijes së vullnetshme është një përgjigje për të gjitha problemet të këtij lloji.

5- Ekziston dhe një rrugë tjetër për bashkimin e hadithëve të shumta për njohjen e të padukshmes, ndonëse kjo mënyrë është vetëm për një pjesë të këtyre hadithëve.

Dërguesit e këtyre transmetimeve ishin njerëz të ndryshëm. Një pjesë prej tyre, kishin kapacitetin e duhur dhe ishin të gatshëm ta pranonin çështjen e fshehtësisë së All'llahut, në lidhje me Imamët dhe të flisnin me ta pa dorashka, kurse me kundërshtarët dhe personat e dobët, ose pa kapacitet, të diskutonin deri në ato nivele që ata ishin në gjendje të kuptonin.

P.sh. në një hadith lexojmë: "*Ebu Basiri dhe disa shokë të tjerë të Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) ishin mbledhur në një tubim. Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) hyri shumë i nxehur në tubim. Pasi u ul, u drejtua nga të pranishmit: 'Sa çudi! Disa pretendojnë se e dinë të fshehtën, ndërkohë që, përveç All'llahut, askush nuk e di atë! Unë tani doja ta edukoja shërbyesen time, por më iku nga dora dhe nuk isha në dijeni se në cilën dhomë të shtëpisë ndodhet!'*".[1]

Transmetuesi i hadithit pohon: "Kur Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* u largua nga tubimi, unë, së bashku me disa shokë të tjerë të Imamit, hymë brenda në shtëpinë e tij dhe e pyetëm: T'u bëfshim kurban, ju, në lidhje me shërbëtoren tuaj, u shprehet në këtë mënyrë, ndërkohë që ne e dimë se ju zotëroni shumë dije (keni

[1] Tefsiri "Usulul Kafij", vëll. 1, f. 257; "Darul kutub el islamije", kreu "Nadir fiihi dhikrul gajb", hadithi 3.

shumë njohuri). Ne nuk përmendim ndonjë emër nga dija e fshehtë.

Më pas Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* dha një shpjegim rreth kësaj çështjeje. Ai tha se kishte pasur synim informimin e sekretit të fshehtësisë. Është e qartë se në atë tubim, kishte persona që nuk ishin të gatshëm dhe të përgatitur, si dhe nuk kishin kapacitetin e nevojshëm për konceptimin e këtij kuptimi dhe njohjen e pozitës së Imamit.

Duhet të kemi parasysh se këto pesë mënyra apo pesë rrugë të ndryshme, për të cilat diskutuam, nuk përjashtojnë njëra-tjetrën. Të gjitha ato mund të jenë të sakta.

Rrugë apo mënyra të tjera për të vërtetuar dijen e fshehtë të Imamëve

Ekzistojnë dhe dy rrugë të tjera, që vërtetojnë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe Imamët, në përgjithësi, ishin të informuar për dijen e fshehtë të All'llahut.

Së pari, misioni i tyre nuk i përkiste një kohe apo një vendi të caktuar, por misioni dhe udhëheqja e Imamëve është universale dhe e përhershme. Si është e mundur, që dikush të ketë një mision të tillë të gjerë dhe gjithëpërfshirës dhe të mos të ketë asnjë lloj informimi apo njohurie, përveç njohurive të kufizuara të një kohe dhe ambienti të kufizuar?

Vallë, a mundet një njeri, të cilin e bëjnë përgjegjës apo guvernator të një pjesë të madhe të shtetit, të mos ketë dijeni për atë zonë, të cilën e drejton dhe menaxhon më së miri!?

Thënë ndryshe, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe Imamët, gjatë jetës së tyre, duhet t'ua shpjegonin gjërat njerëzve, në mënyrë që të jenë në gjendje të përballojnë nevojat e tyre në çdo kohë dhe në çdo vend, por kjo nuk është e mundur, pa pasur njohuri nga dija e fshehtë.

Së dyti, në Kur'an ekzistojnë tri ajete që, nëse i bashkojmë me njëri-tjetrin, e bëjnë të qartë çështjen e dijes së fshehtë të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të Imamëve.

Ajeti thotë: **"Ai që kishte dituri nga libri tha: 'Unë ta sjell atë ty, sa çel e mbyll sytë!'. E kur e pa atë të vendosur pranë tij, Sulejmani tha: 'Kjo është nga dhuntia e Zotit tim...'"**.[1]

Në një ajet tjetër thuhet: **"Ata që mohuan, thonë: 'Ti nuk je i Dërguar!'. Thuaj: 'Mjafton që All'llahu është dëshmitar midis meje dhe midis jush dhe atij që ka njohuri të Librit** (të Shpalljeve)**.'"**.[2]

Përveç kësaj, në shumë hadithe të transmetuara në librat shi'ia dhe syni, lexojmë: Ebu Seid El Khuderij ka thënë: Kur e pyeta Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për kuptimin e ajetit: **"...ai që ka njohuri të Librit** (të

[1] Sure "En Neml", ajeti 40.

[2] Sure "Er Rrad", ajeti 43.

Shpalljeve)" ai u përgjigj: *"Ai është mëkëmbësi i vëllait tim, Sulejman ibn Daud."*.

Ebu Seid Khuderij tha: Unë e pyeta: "Kush është **'midis meje dhe midis jush dhe ai që ka njohuri të Librit** (të Shpalljeve)'?". Profeti u përgjigj: *"Ai është vëllai im dhe zëvendësi im Ali ibn Ebi Talib."*.[1]

Ajo që vihet re është se dituria që ka të bëjë me "Asif", është një dituri pjesore, kurse dituria rreth Librit, në lidhje me Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*, është dituri e përgjithshme. Kjo tregon nivelin, gjerësinë dhe thellësinë e diturive të Asif dhe të Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Së treti, në ajetin 89 të sures "En Nahl", lexojmë: **"Ne ty të shpallëm Librin, sqarim për çdo send..."**.

Është e qartë se njeriu që ka njohuri rreth fshehtësisë së një libri të tillë, duhet të ketë edhe njohuri rreth fshehtësive. Ky argument, mundëson që njerëz prej të dashurve të All'llahut, me urdhrin e Tij, të njihen me fshehtësitë e botës.

Rreth dijes së Gajbit kemi folur në komentimin e ajetit 50 dhe 59 të sures "El En'am" dhe në komentimin e ajetit 188 të sures "El A'raf" në këtë komentim.

Hulumtim rreth krijimit të xhindit

[1] Shih "Ihkakul Hakki"; vëll. 3f. 280–281; Tefsiri "Nuruth Thakalejn", vëll. 2, f. 523.

Xhindi është një krijesë e padukshme. Rreth karakteristikave të tij është folur shumë në Kur'an. Këtu po sjellim disa prej tyre:

1- Është një krijesë e krijuar nga flaka e zjarrit, ndryshe nga njeriu, i cili është krijuar nga balta. Në Kur'an thuhet. **"Ai krijoi xhindet nga flaka e zjarrit."**.[1]

2- Xhindi është një krijesë që percepton, ka njohuri dhe është në gjendje të dallojë të vërtetën nga e pavërteta. Ai ka edhe fuqinë e logjikës dhe të argumentimit. (Këto sqarohen në ajete të ndryshme të sures "El Xhin".)

3- Xhindi është një krijesë që merr përsipër përgjegjësi. Kjo tregohet në ajete të ndryshme të sures "El Xhin" dhe në suren "Er Rrahman".

4- Një grup xhindesh janë besimtarë të drejtë, një grup tjetër janë jobesimtarë. Në Kur'an thuhet: **"E midis nesh ka të mirë, por ka edhe që nuk janë të mirë; jemi ndarë në grupime të ndryshme."**.[2]

5- Në mesin e tyre ka të drejtë dhe të padrejtë: **"Ata që lëshuan rrugën, ata u bënë lëndë e Xhehennemit!"**.[3]

6- Xhindi ka ndikim në qiej, ka ndikim në marrjen e lajmeve dhe në përgjim: **"Dhe uleshim rreth tij, nëpër vende të**

[1] Sure "Rrahman", ajeti 15.

[2] Sure "El Xhinn", ajeti 11.

[3] Sure "El Xhinn", ajeti 15.

përshtatshme për të dëgjuar diçka, por ai që përgjon tani, do të hasë në shigjeta të zjarrta (meteorë) **në pritë."**.[1]

7- Xhindet kanë lidhje me disa njerëz dhe nëpërmjet disa njohurive të kufizuara rreth sekreteve të tyre, i joshnin njerëzit: **"Në të vërtetë, ka pasur njerëz që kërkonin mbrojtje nga xhindet, por kjo vetëm sa i çoi më tej në gabime."**.[2]

8- Në mesin e xhindeve kishte të atillë që kishin fuqi të madhe, siç ndodh edhe me njerëzit, në mesin e të cilëve ka të atillë që janë më të fuqishëm dhe kanë më shumë dhunti: **"Njëri prej xhindeve të vrazhdë,** (Ifriti) **tha: 'Unë do të ta sjell atë ty, para se të ngrihesh nga vendi yt. Unë për të kam fuqi dhe jam i sigurt!'"**.[3]

9- Xhindet kanë fuqi të kryejnë disa prej punëve të nevojshme të njerëzve: **"Ne i dhamë atij një burim të rrjedhshëm bakri të shkrirë dhe xhind që i bëmë të punonin para syve të tij, me urdhrin e Zotit të tij. Këdo prej tyre që largohet nga urdhri Ynë, do ta bëjmë që të shijojë dënimin e Zjarrit. Ata punonin për atë çfarë të dëshironte: faltore dhe statuja, enë të gjera si puse dhe kazanë të mëdhenj të palëvizshëm."**.[4]

10- Ata janë krijuar para se të krijohet njeriu: **"Xhindet i krijuam më parë nga zjarri, nga flaka e fortë."**.[5]

Xhindet kanë edhe karakteristika të tjera.

---

[1] Sure "El Xhinn", ajeti 9.

[2] Sure "El Xhinn", ajeti 6.

[3] Sure "En Neml", ajeti 39.

[4] Sure "Sebé", ajetet 12-13.

[5] Sure "El Hixhr", ajeti 27.

Megjithëse te njerëzit qarkullon si ide se xhindet janë qenie më të larta se njeriu, nga ajetet kur'anore mësojmë se njeriu është më superior se ata, sepse të gjithë Profetët e Islamit ishin nga lloji i njeriut dhe e pasuan atë që në zanafillë.

Megjithatë, ne e dimë se njerëzit e rëndomtë dhe të painformuar, kanë sajuar besëtytni të ndryshme, prandaj është krijuar një përshtypje shumë e gabuar, alogjike dhe folklorike për këtë krijesë, aq sa me dëgjimin e fjalës *"xhind"* shoqërohen një sërë përfytyrimesh të pabaza, si p.sh: i përshkruajnë me forma të çuditshme dhe të trishtueshme, si krijesa që kanë bisht, sqep, si krijesa që ngacmojë dhe shkaktojnë dëme, që mbajnë mëri dhe hakmerren. Këto besëtytni kanë krijuar ide që po të derdhësh një ene me ujë të ngrohtë, në një pikë të zbrazët, xhindet të djegin shtëpinë dhe plot fantazira të tjera të ngjashme me këtë.

Ndërkohë që nuk kemi asnjë argument për këto. Shkencëtarët dhe dijetarët e shkencave natyrore deklarojnë se krijesat që njeriu mund t'i vërejë me anë të shqisave të tij, janë shumë të pakta, në krahasim me krijesat që nuk shihen me anë të shqisave. Deri vonë, kur krijesat e gjalla mikroskopike nuk ishin zbuluar, asnjë nuk besonte që në një pikë uji apo në një pikë gjaku të ekzistojnë me mijëra dhe mijëra krijesa të gjalla, të cilat njeriu nuk kishte aftësinë për t'i parë.

Po ashtu, shkencëtarët pohojnë se syri ynë shikon një gamë të kufizuar ngjyrash, veshi ynë percepton valë të kufizuara zërash. Ngjyrat dhe zërat që nuk kapen me anë të syrit dhe të veshit tonë, janë shumë më shumë se ata që vërehen dhe perceptohen. Meqenëse bota është kaq e larmishme, nuk ka vend për t'u çuditur se në këtë botë ekzistojnë lloj-lloj krijesash të gjalla, që ne nuk mund

t'i perceptojmë me shqisa. Por, kur një lajmëtar i sinqertë si Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* na informon për ta, nuk ka pse të mos i pranojmë.

Sidoqoftë, nga njëra anë, Kur'ani fjalëdrejtë dhe i sinqertë ka lajmëruar për ekzistencën e xhindit, me karakteristikat e përmendura më lart dhe, nga ana tjetër, nuk ekziston asnjë argument logjik për mohimin e tij, duhet pranuar ekzistenca e tyre, duke qenë të vëmendshëm për interpretimet e gabuara dhe duke hequr dorë nga besëtytnitë folklorike, në lidhje me këtë çështje.

Duhet bërë kujdes se fjala "*xhind*" ka përdorim shumë më të gjerë kuptimor. Në këtë kuptim të gjerë përfshihen edhe lloje të ndryshme të krijesave të padukshme, qofshin nga ato që kanë ndërgjegje dhe intelekt, qofshin nga ato që nuk kanë ndërgjegje. Madje, me këtë kuptim të gjerë, përfshihen edhe disa kafshë që vërehen me sy dhe fshihen nëpër fole.

Për këtë dëshmon një hadith i transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "*All'llahu ka krijuar xhindet në pesë lloje: një lloj si era në ajër (janë të padukshme), një lloj si gjarpërinjtë, lloji i tretë si akrepat, po ashtu një lloj janë si insektet në tokë, kurse lloji i pestë janë njerëzit që do të japin llogari dhe do të ndëshkohen.*".[1]

Në bazë të këtij transmetimi dhe të kuptimit të gjerë të tij, shumë prej anomalive që janë thënë në lidhje me xhindet, në transmetime të ndryshme, do të gjejnë zgjidhje. Për shembull, në shumë transmetime prej Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë:

[1] "Sefinetul Bihar", vëll. 1, kreu "El Xhinn", f. 186.

"Mos pini ujë nga ena e thyer e as nga ana e vegës së enës, sepse djalli ulet mbi pjesën e thyer dhe vegën e enës.".[1]

Duke pasur parasysh që shejtani *(djalli)* është një prej xhindeve, si dhe duke qenë në dijeni që pjesa e thyer e enës dhe vega e saj janë vendi ku mblidhen mikrobe të ndryshme, mund të pranohet që fjalët *"xhind"* dhe *"shejtani"*, në një kuptim të gjerë, të përdoren për të përfshirë dhe krijesa të tilla, megjithëse për ato ka një kuptim të posaçëm. Ky pohim tregon se ato krijesa kanë mendje dhe ndërgjegje, angazhim dhe përgjegjësi.

Transmetimet në lidhje me këtë janë të shumta.

O Zot! Në Atë Ditë ku xhindet dhe njerëzit do të paraqiten në Gjyqin e Drejtësisë Tënde dhe keqbërësit do të jenë nga ajo anë ku i çojnë veprat që kanë bërë, të lutem, na merr nën mbrojtjen e mirësisë Tënde!

O Zot! Areali i pushtetit Tënd është i gjerë dhe gjithëpërfshirës, kurse dija dhe njohja jonë është e kufizuar. Na ruaj nga gabimet, shtrembërimet dhe gjykimi i padrejtë!

O Zot! Pozita e Profetit Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) është aq e lartë, saqë thirrjes së tij, përveç njerëzve iu përgjigjën edhe xhindet. Të lutem, na bëj ne, që të jemi në mesin e besimtarëve të thirrjes së tij! Amin

Fundi i sures Xhinn

[1] Tefsiri "El Kafij", vëll. 6, hadithi 5, f. 385.

Sure "El Muzzemmil"

Zbritur në Mekë

20 ajete

Përmbajtja e sures "El Muzzemmil"

Tonaliteti i ajeteve të kësaj sureje na tregon qartë se ajo përputhet plotësisht me suret e zbritura në Mekë, kështu që, përkundër disa dijetarëve, duket e papranueshme që të ketë zbritur në Medine. Ndryshimi në metodikën midis ajeteve të para dhe të fundit, tregon se këto ajete kanë zbritur me një largësi kohore të konsiderueshme.

Disa komentues të Kur'anit kanë pranuar se kjo largësi kohore është tetë muaj, disa të tjerë një vit dhe disa të tjerë dhjetë vjet.[1] Ajete të shumta të kësaj sureje tregojnë se kjo sure ka zbritur, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte filluar t'i ftonte njerëzit hapur në Rrugën e

[1] Referohuni tefsirit "Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 276 dhe "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 377 e tutje.

Drejtë dhe, meqenëse kundërshtarët i përgënjeshtruan fjalët e tij, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u urdhërua të sillej me butësi ndaj tyre.

Kështu që ekziston shumë pak mundësia që e gjithë surja të ketë zbritur në fillim të thirrjes së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ajetet e para të saj mund të kenë zbritur në fillim të thirrjes së Tij, por sigurisht, që të gjitha ajetet nuk janë të tilla. Kuptimi i ajeteve dëshmon për përhapjen e Islamit, së paku në Mekë dhe kryengritjen e kundërshtarëve për ta penguar dhe për ta kundërshtuar atë. Ne e dimë se një gjë e tillë nuk ka ekzistuar gjatë tri viteve të para të thirrjes së tij.

Gjithashtu, ndryshon dhe shkaku i zbritjes së kësaj sureje, i cili është transmetuar në hadithe, për të gjithë suren apo për pjesë të saj.

Në disa transmetime thuhet se, kur Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i zbriti Shpallja apo Mesazhi i parë hyjnor, u trishtua dhe ndjeu dridhje, dhimbje e lodhje. Shkoi te Hatixheja dhe i tha: *"Më mbështill me një pëlhurë."*. Këtu zbriti Xhebraili dhe ia shpalli ajetin e poshtëpërmendur, duke i thënë: **"O ti i mbështjellë...!"**.[1]

Në transmetime të tjera është thënë: "Kjo ngjarje ndodhi, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nisi t'i ftonte njerëzit hapur dhe kurejshët ishin mbledhur në Daru Nedveti, që të diskutonin për punën e Profetit

[1] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 28, f. 101, dhe tefsiri "Nuruth Thekalejn" , vëll. 5, f. 446.

Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të sajonin ndonjë justifikim, për t'u përballur me të.

Disa nga të mbledhurit thanë se ai është fallxor, kurse një pjesë, nga mesi i tyre, e kundërshtuan këtë.

Disa të tjerë thanë se ai është i çmendur, por përsëri një pjesë, nga mesi i tyre, nuk u pajtuan me këtë ide dhe sugjerim.

Disa të tjerë thanë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është magjistar, por edhe këtë sugjerim e hodhën poshtë.

Në fund thanë se është fakt se ai krijon ndasi midis shokëve, si rrjedhojë është magjistar. Më pas politeistët u shpërndanë.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pasi u informua për këtë bisedë, u mbështoll me rroba, që të qetësohej. Ndërkohë zbriti engjëlli Xhebrail dhe ia këndoi ajetet: **"O ti i mbështjellë!"** dhe **"O ti i mbuluar!"**.[1]

Si përfundim, ashtu siç e diskutuam më sipër, është pranuar se kjo sure ka zbritur në Mekë. Një pjesë e saj ka zbritur pas shfaqjes publike të Islamit dhe ndikimit relativ të tij në Mekë. Ekziston mundësia që ajetet në fillim të sures të kenë zbritur në fillim të profetësisë së tij. Sidoqoftë, përmbajtjen e sures mund ta përmbledhim në pesë pjesë:

Në **pjesën e parë** përmblidhen ajetet që flasin se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e*

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 6, f. 276.

tij!) përgatitet për të kryer faljen natën, për të kënduar Kur'an, si dhe për të pranuar një projekt të rëndë.

Pjesa e dytë e sures e fton atë që, gjatë kësaj periudhe, të tregohet i durueshëm, i qëndrueshëm dhe i butë ndaj kundërshtarëve të tij.

Pjesa e tretë e sures diskuton për çështje që kanë të bëjnë me ringjalljen, me dërgimin e Musa ibn Imranit te Faraoni, me rebelimin dhe më pas, dënimin e dhimbshëm të tij.

Në **pjesën e katërt** të sures janë urdhrat e rënda, të cilat përmenden në fillim të sures dhe flasin për zgjimin natën për falje, si dhe për lehtësimin e gjendjes së vështirë të myslimanëve.

Në **pjesën e pestë**, që është dhe pjesa e fundit e sures, fton edhe një herë tjetër në leximin e Kur'anit, në faljen e namazit, në dhënin e zekatit, në dhënien në Rrugën e All'llahut dhe kërkimin e faljes.

Mirësitë e leximit të sures "El Muzzemmil"

Në një nga transmetimet nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: "*Çdokush që e lexon suren 'El Muzemmil', do t'i largohen vështirësitë në këtë botë dhe në Botën Tjetër.*".[1]

Kurse në një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*Çdokush që e lexon suren 'El Muzzemmil' në namazin e jacisë,*

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 375.

ose në pjesën e tretë të natës, dita, nata dhe vetë kjo sure do të dëshmojë për të në Ditën e Gjykimit dhe All'llahu do t'i dhurojë atij jetë dhe vdekje të këndshme.".[1]

Këto virtyte të larta realizohen vetëm nëse e praktikojmë përmbajtjen e sures, pra, në qoftë se falemi natën, këndojmë Kur'an, tregohemi të durueshëm, të qëndrueshëm, bujarë dhe japim për hir të All'llahut dhe jo thjesht të këndojmë pa e praktikuar.

Ajetet 1 - 5

بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

يَا أَيُّهَا الْمُزَّمِّلُ، قُمِ اللَّيْلَ إِلَّا قَلِيلًا، نِصْفَهُ أَوِ انْقُصْ مِنْهُ قَلِيلًا، أَوْ زِدْ عَلَيْهِ وَرَتِّلِ الْقُرْآنَ تَرْتِيلًا، إِنَّا سَنُلْقِي عَلَيْكَ قَوْلًا ثَقِيلًا،

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

"O ti i mbuluar (o Muhammed)**!"**

"Çohu (të falesh) **gjithë natën, përveç një pjese të saj."**

"Që është gjysma ose diçka më pak,"

"a diçka më shumë se ajo dhe lexoje Kur'anin ngadalë dhe qartë,"

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 375.

"sepse Ne do të të dërgojmë vërtet një Fjalë me peshë të rëndë."

Komentimi

O ti i mbuluar! Çohu!

Ashtu siç përftohet dhe në bazë të tonalitetit të ajeteve të kësaj sureje, kjo është një ftesë qiellore për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për qëndrueshmëri dhe përgatitje për pranimin e një përgjegjësie të madhe dhe të rëndë, realizimi i të cilës nuk është i mundur pa vetëformimin paraprak. Ajetet thonë: **"O ti i mbuluar** (o Muhammed)**! Çohu** (të falesh) **gjithë natën, përveç një pjese të saj, që është gjysma ose diçka më pak a diçka më shumë se ajo dhe lexoje Kur'anin ngadalë dhe qartë…"**.

Siç shihet, këto ajete i drejtohen Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Interesant është fakti se nuk i drejtohen me shprehjen "O i Dërguar" ose "O Profet", por: **"O ti i mbuluar!"**. Kjo nënkupton se nuk është kjo koha për t'u mbështjellë apo për t'u strukur në një qoshe, por është momenti

për kryengritje, vetëformim dhe përgatitje për kryerjen e një misioni të madh.

Përzgjedhja e natës për kryerjen e kësaj vepre është për këto arsye:

Së pari, sytë dhe veshët e armiqve janë në gjumë (të fjetura).

Së dyti, njeriu nuk është i angazhuar me kryerjen e punëve të përditshme dhe është më i gatshëm për të reflektuar, për të medituar dhe për të edukuar shpirtin.

Gjithashtu, përzgjedhja e Kur'anit si teksti kryesor i këtij programi është, sepse Kur'ani jo vetëm që përmban të gjitha mësimet e nevojshme në këtë fushë, por edhe është mënyra më e mirë për përforcimin e besimit, qëndrueshmërisë, devotshmërisë dhe edukimit të shpirtit.

Fjala *"tertijlun"* është përdorur në këtë ajet me kuptimin e *"sistemimit"* dhe *"radhitjes harmonike"*. Këtu është përdorur me kuptimin e këndimit të ajeteve kur'anore, me vëmendje të madhe dhe rregull të rreptë, me shqiptim të saktë të shkronjave, me shpjegim të qartë të fjalëve, me përpikëri, me reflektim në kuptimin e ajeteve, si dhe me të menduarit për rezultatin e tyre.

Një këndim i tillë i Kur'anit mund t'i dhurojë shumë shpejt njeriut rritje shpirtërore, përparim, kurajë morale, devotshmëri dhe drejtësi. Nëse disa komentues të Kur'anit, atë e kanë interpretuar në kuptimin e faljes së namazit, kjo është bërë për këtë arsye, se një prej pjesëve kryesore të namazit është pikërisht këndimi i Kur'anit.

Fjala *"kijam"*, në fjalinë *"kumil lejle"*, tregon zgjimin nga gjumi dhe nuk është vetëm në kuptimin e qëndrimit në këmbë.

Shprehjet e ndryshme që janë përmendur në këto ajete, për kohën e "qëndrimit zgjuar natën", shpjegojnë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të zgjedhë vetë, nëse do të qëndrojë zgjuar gjysmën e natës, më pak, ose më shumë se gjysma dhe të këndojë Kur'an. Në fillim thotë "gjithë natën", me përjashtim të një pjese fare të paktë të saj, më pas e ul atë, duke përcaktuar gjysmën e natës dhe më pas, më pak se gjysmën.

Komentues të tjerë kanë thënë se synimi është zgjedhja midis "dy të tretave të natës dhe gjithë natës", më pas "gjysmën e saj", apo "një të tretën e natës". Këtë e tregon ajeti i fundit i kësaj sureje, ku thuhet: **"Zoti yt e di se ti** (o Muhammed) **falesh më pak se dy të tretat e natës, ndonjëherë gjysmën ose një të tretën e saj…"**.

Ndërkaq, po nga ajeti i fundit i kësaj sureje, mësojmë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në qëndrimin natën nuk ishte vetëm. Ai kishte përkrah dhe një grup myslimanësh që e shoqëronin dhe e kishin pranuar si model e shembull në këtë rrugë.

Disa komentues të tjerë kanë thënë se fjalia **"kumil lejle il'la kalijla"**, është përdorur për të treguar se Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i thuhet të çohet çdo natë, përveç disa netëve. Pra, kuptohet se përjashtimi nuk është për pjesët e natës, por në numrin e netëve. Por ky komentim duket i papranueshëm, sepse fjala *"lejl"* - *"natë"* është në numrin njëjës, si dhe shprehjet gjysmë ose më pak se gjysmë bëhet fjalë për një natë që ndahet në gjysmë, ose në më pak se gjysmë, e rrëzojnë këtë koment.

Më pas, "qëllimin përfundimtar" të këtij urdhri të rëndë dhe të vështirë, e shpjegon në këtë mënyrë: **"Ne do të të dërgojmë vërtet një Fjalë me peshë të rëndë."**.

Edhe pse secili komentues i Kur'anit ka shpjegimin e tij, në lidhje me grupin emëror *"kaulen thekijla"* - **"Fjalë me peshë të rëndë"**, ky grup emëror, në thelb, ka të bëjë me njërin aspekt të çështjes, por që lidhet me një çështje me peshë të rëndë. Togfjalëshi **"peshë të rëndë"**, pa dyshim, që nënkupton Kur'anin Famëlartë.

Peshë e rëndë, për nga përmbajtja dhe kuptimi i ajeteve.

Peshë e rëndë, për nga pikëpamja e mbajtjes së saj në zemra dhe në shpirt, për të cilën vetë Kur'ani deklaron: **"Sikur Ne ta zbritnim këtë Kur'an mbi ndonjë kodër, do ta shihje atë të strukur e të çarë prej frikës nga All'llahu."**.[1]

Peshë e rëndë, për nga pikëpamja e premtimeve, paralajmërimeve dhe e sqarimit të përgjegjësive.

Peshë e rëndë, për nga pikëpamja e Thirrjes (në fenë islame) dhe problematikat e vështirësitë gjatë kësaj rruge.

Peshë e rëndë, në peshoren e veprave dhe daljes përpara All'llahut, në Ditën e Gjykimit.

Dhe në fund, peshë e rëndë, për nga pikëpamja e programimit dhe realizimit të plotë të tij.

Këndimi i Kur'anit, edhe pse është i lehtë, tërheqës, i bukur dhe i këndshëm, zbatimi i dispozitave të tij është një peshë e rëndë dhe e vështirë. Veçanërisht në fillim të thirrjes së Profetit

[1] Sure "El Hashr", ajeti 21.

Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe "revolucionin" e tij në Mekë, ku mbizotëronin retë e errëta të injorancës, adhurimi i idhujve e besëtytnitë, ku armiqtë tekanjozë, kryeneçë, kokëfortë dhe të pamëshirshëm, ia kishin dhënë dorën njëri–tjetrit dhe kundërshtonin Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Por Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, së bashku me një numër të vogël shokësh dhe përkrahës, arriti të triumfonte karshi gjithë këtyre problemeve dhe vështirësive, duke u mbështetur në edukimin e Kur'anit Fisnik, duke qëndruar zgjuar një pjesë të natës, si dhe duke marrë fuqi nga afërsia me Qenien e Stërpastër të All'llahut. Ata ai dolën me sukses, që ta mbartnin ngarkesën e rëndë, "fjalë me peshë të rëndë" dhe ta çojnë në "bregun e synuar".

Hulumtime

1- Ngritja natën për të lexuar Kur'an dhe për t'u lutur

Ashtu siç e thamë dhe më lart, edhe pse personazh i këtyre ajeteve është vetë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në ajetet në vijim bëhet e qartë se bashkë me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në realizimin e këtij programi, merrnin pjesë edhe besimtarët.

Tani duhet të sqarohet, nëse ngritja dhe qëndrimi zgjuar në një pjesë të natës, në fillim të thirrjes së tij, ishte e obligueshme për të gjithë, apo jo.

Disa komentues të Kur'anit janë të mendimit se ky urdhër ka qenë i obligueshëm. Më pas ajeti i fundit i kësaj sureje e anuloi këtë. Largësia kohore midis këtyre ndryshimeve, ka qenë pothuajse një vit.

Disa të tjerë janë të mendimit se ky urdhër është dhënë para urdhrit të faljes së pesë vakteve ditore dhe më pas, pas urdhrit për pesë vaktet e faljes, urdhri i lartpërmendur u anulua.

I ndjeri Tabarsij në veprën "Mexhmaul Bejan", është shprehur se në tekstin e ajeteve të kësaj sureje, nuk vërehet ndonjë dëshmi për "anulim". Më e saktë, do të ishte të themi se kjo ngritje dhe ky adhurim ishin të pëlqyeshme (mustehab) dhe traditë e preferuar, por asnjëherë nuk ka pasur karakter detyrimi, përveç për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kjo tregohet në disa ajete të tjera kur'anore, ku thuhet se falja e namazit të natës ishte e detyrueshme për të. Nuk ka ndonjë pengesë që kjo çështje është e detyrueshme për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kurse për myslimanët e pëlqyeshme.

Përveç kësaj, ajo që është thënë në ajetet e lartpërmendura, nuk i përket vetëm "namazit të natës", sepse namazi i natës nuk e zë gjysmën e natës, as dy të tretën e natës, apo një të tretën e saj. Në ajet është theksuar ngritja natën për këndim të Kur'anit.

Prandaj, pikësëpari, ky urdhër ka qenë një urdhër *mustehab* (i pëlqyeshëm) dhe më pas janë bërë lëshime në të. Duke pasur

parasysh që në fillim të çdo vepre, veçanërisht në fillimet e një revolucioni të madh, ka nevojë për forcë dhe energji të shumta, nuk është për t'u habitur që një urdhër i tillë, i jashtëzakonshëm, t'i jetë dhënë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe myslimanëve. Pra, të jenë urdhëruar që një pjesë të natës, ta kalojnë zgjuar, me qëllim që të njihen me përmbajtjen e këtij Projekti të ri dhe me mësimet revolucionare të tij. Përveç njohjes dhe konceptimit, ta përgatisin veten edhe shpirtërisht për zbatimin e tij.

2- Kuptimi i fjalës "et tertijlu"

Asaj që i është kushtuar rëndësi në ajetet e lartpërmendura, nuk është vetëm çështja e këndimit të Kur'anit, por është çështja e këndimit me vëmendje, ngadalë dhe në mënyrë të qartë.

Për komentimin e fjalës *"et tertijlu"* janë dhënë mendime të shumta nga Imamët. Secili koment përmend një prej dimensioneve të gjera të saj.

Në hadithin e transmetuar nga Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Atë, Kur'anin shpjegoje qartë dhe jo si vjershat që lexohen me nxitim. As mos e shpërnda atë, siç shpërndahen guralecët e rërës, por lexoje në mënyrë të atillë që t'i zgjosh zemrat e ngrysura dhe të eklipsuara me anë të atij leximi. Asnjëherë qëllimi yt i vetëm të mos jetë që të arrish*

në fund të sures. E rëndësishme është që të perceptoni kuptimin e ajeteve.".[1]

Në një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, për komentimin e fjalës *"tertil"*, lexojmë: *"Kur gjatë këndimit të Kur'anit, arrin në ndonjë ajet, që përmendet Xhenneti, ndalo dhe kërko nga All'llahu Xhennetin. Në kohën që arrin në ndonjë ajet që përmendet Xhehennemi, kërko nga All'llahu mbrojtje prej tij."*.[2]

Në një hadith tjetër, po nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet: *"Me fjalën "et tertijlu" kuptojmë leximin me zë të bukur të Kur'anit Famëlartë. Jo vetëm kaq, por lexim i përqendruar dhe duke respektuar pushimet."*.[3]

Nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është transmetuar: *"Kur'anin nuk duhet ta lexoni me nxitim, shpejt, por ta lexoni me vëmendje. Sa herë që hasim në ndonjë ajet që flet për Xhehennemin, duhet të ndalohet dhe duhet të kërkohet mbrojtje nga zjarri i tij."*.[4]

Në jetëshkrimin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është transmetuar: *"Profeti i ndante ajetet nga njëri-tjetri dhe e zgjaste zërin e tij."*.[5]

Këto transmetime, si dhe transmetime të tjera, janë përmendur me po këtë kuptim, në librat "Usulul Kafij", "Nuruth

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 378. Ky hadith, gjithashtu, është cituar dhe në librin "Usulul Kafij", vëll. 2, kreu "Tertilul Kur'an bil Seutil Hasani" dhe libra të tjerë, me pak ndryshim.

[2] Po aty.

[3] Po aty.

[4] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 447.

[5] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 378, ajeti në diskutim.

Thekalejn", si dhe libra të tjerë të hadhit dhe komentimit të Kur'anit. Të gjitha janë dëshmi se ajetet kur'anore nuk duhet të lexohen si fjalë të privuara nga përmbajtja dhe kuptimi, por duhet të tregohet vëmendje ndaj të gjitha çështjeve që thellojnë ndikimin e tij për kënduesin dhe për dëgjuesin, si dhe nuk duhet të harrohet që janë mesazhe hyjnore. Synimi është realizimi i përmbajtjes së tyre.

Por fatkeqësisht, në ditët tona, shumë myslimanë i qëndrojnë larg këtij realiteti. Mjaftohen vetëm me leximin e Kur'anit dhe kanë synim përfundimin e sures apo përfundimin e hatmes së Kur'anit (leximi i të gjithë Kur'anit), pa qenë në dijeni se përse kanë zbritur këto ajete. Çfarë mesazhi transmetojnë ato? Është e drejtë që duhet të respektohet teksti i Kur'anit, por duhet të theksohet se dhe këndimi i tij, sipas teknikave që thamë më lart, ka mirësi dhe dobi. Nuk duhet të harrohet se ky tekst dhe ky këndim është premisë për shpjegimin e përmbajtjes.

3- Mirësitë e namazit të natës

Këto ajete, edhe një herë tjetër, na tregojnë rëndësinë e qëndrimit zgjuar gjatë natës, rëndësinë e faljes së namazit të natës dhe të këndimit të Kur'anit, kur mospërfillësit janë në gjumë të thellë. Adhurimi gjatë natës, veçanërisht në pjesën e tretë të saj, në afërsi të agimit, ka një ndikim të jashtëzakonshëm në dëlirësinë e shpirtit dhe në rafinimin e tij, në pastrimin e zemrës dhe në edukimin shpirtëror të njeriut, në çiltërsinë e zemrës dhe zgjimin e saj, në përforcimin e besimit dhe të vullnetit, si dhe në forcimin e themeleve të devotshmërisë në zemrën dhe shpirtin e njeriut. Të

gjithë këto bëjnë që njeriu t'i ndiejë më së miri brenda vetes ndikimet e tyre.

Prandaj, përveç ajeteve kur'anore, në hadithet islame është theksuar përsëri kjo çështje. P.sh, në hadithin e transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Tri gjëra janë prej të mirave të veçanta të Zotit: adhurimi (namazi) i natës, shtrimi i iftarit për të tjerët, si dhe vizita te vëllezërit myslimanë."*.[1]

Në një hadith tjetër, nga po ky Imam, lexojmë: "*Veprat e mira zhdukin veprat e këqija. Namazi i natës shlyen mëkatet e kryera gjatë ditës."*.[2]

Në ajetin 79 të sures "El Isra" kemi dhënë një shpjegim të detajuar për këtë çështje, si dhe kemi transmetuar dhjetë hadithe interesante rreth rëndësisë së namazit të natës.

[1] "Biharul Enuar", vëll. 87, f. 143.

[2] Po aty.

Ajetet 6 – 10

إِنَّ نَاشِئَةَ اللَّيْلِ هِيَ أَشَدُّ وَطْئًا وَأَقْوَمُ قِيلًا ٦ إِنَّ لَكَ فِي النَّهَارِ سَبْحًا طَوِيلًا ٧ وَاذْكُرِ اسْمَ رَبِّكَ وَتَبَتَّلْ إِلَيْهِ تَبْتِيلًا ٨ رَبُّ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ فَاتَّخِذْهُ وَكِيلًا ٩ وَاصْبِرْ عَلَى مَا يَقُولُونَ وَاهْجُرْهُمْ هَجْرًا جَمِيلًا ١٠

"Natyrisht, adhurimi natën vepron më fuqishëm dhe fjala është më shprehëse."

"Ngaqë ti ditën je vërtet shumë i zënë."

"Prandaj, përmende Emrin e Zotit tënd dhe përkushtoju krejtësisht Atij!"

"Ai është Zot i lindjes dhe i perëndimit, s'ka zot tjetër të vërtetë përveç Tij, drejtoju Atij si rregullues i punëve të tua!"

"Duroji llomotitjet e atyre dhe largohu nga ata në mënyrë të hijshme!"

Komentimi

Ndikimi i adhurimit gjatë natës

Ajetet 6-10 janë vazhdimësi e diskutimit për adhurimin e natës, si dhe për mësimet shpirtërore, nën ndriçimin e leximit të Kur'anit, janë argumente për atë që u diskutua në ajetet e mëparshme. Në lidhje me këtë, Kur'ani deklaron: **"Natyrisht, adhurimi natën vepron më fuqishëm dhe fjala është më shprehëse…"**.

Fjala *"en nashi'etu"* rrjedh nga fjala *"neshj"* dhe tregon *"ngjarjen", (ndodhinë)*. Për kuptimin e saj janë dhënë tri interpretime të ndryshme në këtë ajet.

I pari tregon për orët e natës, të cilat ndjekin njëra-tjetrën, ose orët e fundit të natës, pra, para agimit.

I dyti tregon programin e veçantë, sipas të cilit duhet ngritur natën për adhurim, për falje dhe lexim Kur'ani. Për këtë është

transmetuar edhe në një hadith nga Imam Sadiku dhe Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi ta!)*: *"Synimi është ngritja në orët e vona të natës, për të falur namazin e natës."*.[1]

Kurse në një hadith tjetër nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, lidhur me komentimin e këtij ajeti, thuhet: *"Me fjalën 'ajet' shënohet ngritja nga krevati vetëm për hir të Zotit."*.[2]

Interpretimi i tretë tregon se kuptimi i ajetit është: "Gjendjet dhe aktivitetet shpirtërore, të cilat përjetohen në këto orë të veçanta të natës, në zemrën dhe shpirtin e njeriut, kanë ndikim shumë më të thellë dhe më të qëndrueshëm se çdo veprimtari tjetër e tij.

Sigurisht, ky interpretim, si dhe interpretimi paraardhës janë të ndërvarur me njëri-tjetrin. Është e përshtatshme që të dyja të përfshihen në kuptimin e ajetit.

Fjala *"ue'ta"*, tregon hedhjen e hapit, por përdoret edhe me kuptimin e pajtimit.

Shprehja *"esheddu uet'an"* përdoret për të treguar vështirësitë dhe rëndësinë që mbart me vete ngritja dhe adhurimi natën, ose tregon ndikimet e qëndrueshme dhe të thella, të cilat, nën ndriçimin e këtij adhurimi, depërtojnë në zemrën dhe shpirtin e njeriut. (Sigurisht kuptimi i dytë është më i përshtatshëm.)

Ekziston mundësia që kuptimi të jetë në kontekstin e pajtimit, të koordinimit më të gjerë, që vërehet në këto çaste mes

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 378.

[2] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 16, f. 448.

zemrës, syrit dhe veshit të njeriut dhe të gjitha këto mobilizohen në rrugën e adhurimit.

Fjala *"ekuemu"* rrjedh nga fjala *"kijam"* dhe tregon më të qëndrueshmit dhe më të çiltrit, kurse fjala *"kijla"* është në kuptimin e *"bisedës"*, (të të folurit) dhe këtu nënkuptohet përmendja e All'llahut dhe leximi i Kur'anit.

Shkurtimisht, ky ajet, me anë të shprehjeve të ndryshme, shumë domethënëse, ka shpjeguar rëndësinë e adhurimit gjatë natës, rëndësinë e lutjeve në kohën e agimit dhe intimitetit me Zotin, kur kushtet e përqendrimit mendor janë më të volitshme se asnjëherë tjetër. Po ashtu, ka shpjeguar ndikimin e lutjeve të natës dhe të leximit të Kur'anit, në pastrimin dhe në edukimin shpirtëror të njeriut. Gjithashtu, ajeti bën të qartë se njeriu, shpirtërisht, në këto çaste, ka një angazhim të veçantë për lutje, adhurim, për kujtim të All'llahut dhe për meditim.

Në ajetin vijues deklarohet: **"ngaqë ti ditën je vërtet shumë i zënë"**.

Meqenëse gjithnjë je i zënë me udhëzimin e njerëzve, komunikimin e Mesazhit të All'llahut, zgjidhjen e problemeve individuale dhe kolektive dhe nuk ke mundësi dhe kohë të mjaftueshme për adhurim dhe lutje, atëherë ngrihu natën për t'i kompensuar këto, (për t'ju lutur All'llahut dhe për të kërkuar ndihmë nga Ai).

Ekziston edhe një mënyrë tjetër e komentimit të këtij ajeti. Kjo mënyrë komentimi, në disa aspekte, është më tërheqëse dhe përshtatet më shumë me ajetet pararendëse dhe me ato që vijnë më pas. Ky komentim i ajetit thotë: Duke pasur parasysh faktin se gjatë

ditës je i angazhuar me përgjegjësi të mëdha, natën duhet ta përdorësh për adhurim. Me adhurimin e natës ke mundësi të sigurosh paraqitjen e nevojshme për këto aktivitete dhe veprimtari të mëdha.

Fjala *"sebhun"* tregon lëvizje, vajtje-ardhje. Ndonjëherë përdoret edhe në kuptimin e notit, për shkak të lëvizjeve të vazhdueshme, që bëhen kur notohet.

Shoqërinë njerëzore e imagjinon si një oqean të pafund, në të cilin janë duke u mbytur grupe të shumta njerëzish. Dallgët e forta të tij lëvizin në çdo drejtim dhe anijet e trishtuara kërkojnë vendstrehim. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është i vetmi që të shpëton nga ky oqean i trazuar, kurse Kur'ani është anija e vetme e shpëtimit.

Ky notar i shkathët duhet ta stërvitë veten për këtë mision dhe përgjegjshmëri të madhe ditore, me anë të adhurimeve dhe lutjeve të natës.

Pas urdhrit për këtë adhurim nate dhe sqarimit të shkurtër rreth ndikimeve të thella të tij, Kur'ani përmend pesë urdhra të tjera, si plotësim dhe deklaron: **"Prandaj, përmende emrin e Zotit tënd."**.

Pa dyshim, këtu nuk synohet vetëm përmendja me emër, por kushtimi i vëmendjes, adhurimi i Tij, meditimi për Të. Përmendja me gojë është premisë për përmendjen me zemër dhe përmendja me zemër i jep pastërti dhe dëlirësi shpirtit dhe zemrës dhe e ujit fidanin e njohjes dhe të devotshmërisë, i cili rritet në zemër.

Fjala *"rabbun"* tregon se sa herë të përmendet Emri i All'llahut, duhet të tregohet vëmendje jo vetëm ndaj begative të pafundme të All'llahut, por edhe ndaj edukimit të vazhdueshëm të Tij ndaj teje.

Një prej komentuesve të Kur'anit, ka propozuar disa etapa për përmendjen e All'llahut:

Etapa e parë, ashtu siç u përmend dhe në ajetin në diskutim, është përmendja e Emrit të All'llahut.

Faza tjetër ka të bëjë me kujtimin me zemër, të Qenies së Pastër të Zotit. Kjo është përmendur dhe në ajetin 205 të sures "El A'raf": **"Ti përmende Zotin tënd me vete** (heshtur)**, me respekt e me droje, jo me shprehje të larta..."**.

Në fund vjen radha e etapës së tretë. Në këtë etapë, ai shkon përtej pozitës së të qenit rob i All'llahut, te pozita e tërësisë së cilësive të hijeshisë dhe madhështisë së All'llahut. Kjo është treguar në ajetin 41 të sures "El Ahzab": **"O ju që besuat, përkujtoni All'llahun sa më shpesh."**.

Në këtë mënyrë, ky përkujtim i All'llahut vazhdon gjithnjë. Ai evoluon hap pas hapi dhe pronarin e tij (përmendësin e All'llahut) e merr me vete dhe e çon në kulmin e përsosmërisë.[1]

Në urdhrin e dytë thotë: **"përkushtoju krejtësisht Atij"**.

Fjala *"tebettel"* rrjedh nga fjala *"el betl"* dhe është përdorur me kuptimin e "shkëputjes, ndarjes". Edhe Merjemen *(Paqja qoftë mbi të!)* e kanë quajtur "Betul", sepse nuk kishte zgjedhur për vete

[1] Tefsiri "Fakhru Rrazij", vëll. 30, f. 177.

asnjë bashkëshort. Kurse Fatimen *(Paqja qoftë mbi të!)*, ndryshe e kanë quajtur "Betul", sepse, në mesin e grave të asaj periudhe, për nga pikëpamja e veprave, sjelljes, njohurive të veçanta dhe sipërore, ajo kishte arritur në pozitën që i përkushtohej vetëm All'llahut.

Sidoqoftë, fjala *"tebettul"* nënkupton njeriun që i është përkushtuar vetëm All'llahut me gjithë zemër, njeriun që nuk i shkëput marrëdhëniet me All'llahun, që të gjitha veprat i kryen për hir të Tij, si dhe është i sinqertë.

Në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: *"Në Islam, nuk ka as murgëri dhe as ndarje."*.[1]

Ky hadith nënkupton se heqja dorë nga kjo botë, e pranuar nga murgjërit e krishterë, nuk ekziston në Islam. Madje, ata, për të hequr dorë nga kjo botë, kanë hequr dorë edhe nga martesa, si dhe nga çdo lloj aktiviteti shoqëror. Kurse një mysliman i vërtetë, krahas jetesës në zemër të shoqërisë, gjithë vëmendjen e tij ia ka përkushtuar All'llahut.

Në disa transmetime nga Imamët e pamëkatshëm, është transmetuar se fjala *"tebettel"* është përdorur me kuptimin e ngritjes së dorës gjatë faljes së namazit.[2] Por është e qartë, se kjo lëvizje, në realitet, shpreh një prej manifestimeve të sinqeritetit dhe përkushtimit ndaj All'llahut.

[1] "Mufredat" dhe "Mexhmaul Bahrejn", lënda *"el betl"*.

[2] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 27, f. 450.

Sidoqoftë, ky përkujtim i All'llahut dhe ky sinqeritet është një veprim i rëndësishëm i besimtarëve, të cilët, në këtë mënyrë, tregojnë se janë plotësisht të udhëzuar, si dhe udhëzojnë edhe të tjerë.

Më pas, përmend urdhrin e tretë: **"Ai është Zot i lindjes dhe i perëndimit, s'ka zot tjetër të vërtetë përveç Tij, drejtoju Atij si rregullues i punëve të tua!".**

Pas etapës ku flitej për "kujtimin e All'llahut" dhe "etapës së sinqeritetit", vjen etapa e besimit dhe dorëzimit plotësisht Atij. Pra, çdo gjë dhe të gjitha punët t'ia besojmë All'llahut dhe t'i lemë në dorë të Tij. All'llahu, i Cili është Zot i lindjes dhe i perëndimit, d.m.th. e tërë ekzistenca ndodhet nën sundimin dhe zotërimin e Tij dhe Ai është i Vetmi i denjë për adhurim. Kjo shprehje, në realitet, është argument në lidhje me çështjen e mbështetjes te All'llahu. Si mundet që njeriu, të mos i mbështetet All'llahut dhe të mos ia besojë Atij punët e veta, kur në të gjithë universin nuk ekziston asnjë sundues, sovran, mëshirues, edukator, apo i adhuruar tjetër, përveç Tij?!

Në përfundim, në urdhrin e tretë dhe të katërt, deklaron: **"Duroji llomotitjet e atyre dhe largohu nga ata në mënyrë të hijshme!"**

Në këtë mënyrë shpaloset "durimi" dhe "largimi", si dy cilësi të rëndësishme, që duhet t'i karakterizojnë Profetët dhe Imamët, sepse në rrugën e thirrjes për në Udhën e Drejtë, llomotitjet e armiqve, ngacmimet dhe lëndimet e tyre janë të shumta. Në qoftë se një kopshtar dëshiron të këpusë një trëndafil, duhet të durojë edhe lëndimin e gjembit.

Neglizhimi dhe distancimi, disa herë, janë të nevojshëm për të shpëtuar nga ligësia e tyre, por edhe për t'u dhënë një mësim, me anë të kësaj shmangieje. Por ky distancim nuk duhet të ndërpresë programet edukative, ftesën dhe thirrjen drejt All'llahut.

Në këtë mënyrë, ajetet e lartpërmendura i japin një rekomandim të plotë dhe gjithëpërfshirës Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të gjithë atyre që hedhin hapa në Rrugën e Tij, që të marrin ndihmë nga adhurimi i natës dhe lutjeve drejtuar All'llahut në agim dhe, më pas, këtë "fidan" ta ujisin me përkujtimin e All'llahut, me sinqeritet, me mbështetje te All'llahu, me durim dhe largim në mënyrë të hijshme. A nuk është ky një rekomandim i kompletuar dhe mbreslënës?!

Sifjalia: **"Ai është Zot i lindjes dhe i perëndimit"**, nënkupton sundimin e Tij në të gjithë universin.

Largimi i hijshëm, siç dhe u trajtua, tregon distancimin e shoqëruar me dhembshuri, me thirrje dhe ftesë në Rrugën e All'llahut. Ky largim konsiderohet si një prej metodave të edukimit në periudha të caktuara dhe raste të veçanta dhe në asnjë mënyrë nuk është në kundërshti me çështjen e "xhihadit" në periudhat e tjera. Secila nga ato ka vendin e vet. Thënë ndryshe, ky largim (largimi i hijshëm) nuk është shpërfillje, përkundrazi, është një lloj vëmendjeje e veçantë. Zhvendosja e urdhrit të lartpërmendur, me anë të ajeteve të xhihadit, nuk është i saktë.

I ndjeri Tabersiu në veprën "Mexhmaul Bejan", kur komenton ajetin në fjalë, shkruan: "Ky ajet u tërheq vëmendjen thirrësve në Rrugën e Drejtë, në Rrugën e Islamit dhe thirrësve drejt Kur'anit, që të tregohen të durueshëm ndaj vështirësive dhe fatkeqësive, të tregohen të sjellshëm, të butë, të qetë dhe tolerantë

në sjelljen e tyre me njerëzit, në mënyrë që fjala e tyre të pranohet më shpejt.".[1]

Ajetet 11 – 19

وَذَرْنِي وَالْمُكَذِّبِينَ أُولِي النَّعْمَةِ وَمَهِّلْهُمْ قَلِيلًا ١١ إِنَّ لَدَيْنَا أَنْكَالًا وَجَحِيمًا ١٢ وَطَعَامًا ذَا غُصَّةٍ وَعَذَابًا أَلِيمًا ١٣ يَوْمَ تَرْجُفُ الْأَرْضُ وَالْجِبَالُ وَكَانَتِ الْجِبَالُ كَثِيبًا مَهِيلًا ١٤ إِنَّا أَرْسَلْنَا إِلَيْكُمْ رَسُولًا شَاهِدًا عَلَيْكُمْ كَمَا أَرْسَلْنَا إِلَى فِرْعَوْنَ رَسُولًا ١٥ فَعَصَى فِرْعَوْنُ الرَّسُولَ فَأَخَذْنَاهُ أَخْذًا وَبِيلًا ١٦ فَكَيْفَ تَتَّقُونَ إِنْ كَفَرْتُمْ يَوْمًا يَجْعَلُ الْوِلْدَانَ شِيبًا ١٧ السَّمَاءُ مُنْفَطِرٌ بِهِ كَانَ وَعْدُهُ مَفْعُولًا ١٨ إِنَّ هَذِهِ تَذْكِرَةٌ فَمَنْ شَاءَ اتَّخَذَ إِلَى رَبِّهِ سَبِيلًا ١٩

"Lërmi Mua ata që të quajnë gënjeshtar e që jetojnë në luks dhe jepu pak afat atyre."

"Se, pa dyshim, Ne kemi përgatitur për ata pranga, zjarr flakërues."

"Ushqime që ngecin në fyt dhe dënime të dhembshme."

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 379.

"Në Ditën, kur Toka dhe malet dridhen e bëhen si pirgje rëre të lëvizshme."

"Ne, me të vërtetë, ju kemi sjellë një të Dërguar dëshmitar mbi ju, ashtu siç ia çuam një të Dërguar Faraonit."

"Por Faraoni nuk e dëgjoi të Dërguarin, andaj i çuam dënim të rëndë."

"Qysh do të mbroheni ju, nëse mbeteni jobesimtarë, Ditën në të cilën fëmijët do të thinjen?"

"Atë ditë qielli do të çahet e premtimi i Zotit do të përmbushet."

"Në të vërtetë, kjo është këshillë, prandaj, kush dëshiron, le të zgjedhë Rrugën e Drejtë që e çon te Zoti i tij."

Komentim

Lërma mua llogarinë e këtyre mëkatarëve arrogantë!

Në ajetin 10, u diskutua për pengesat, fjalët fyese dhe të padrejta, për ngacmimet dhe lëndimet e armiqve të Islamit. Në këto ajete, tregohet se ata janë vënë nën breshërinë e kërcënimeve të frikshme për dënimet e All'llahut në këtë dhe në Atë Botë. Këto ajete i ftojnë të rishqyrtojnë planet e tyre ogurzeza. Këto ajete i ngushëllojnë myslimanët besimtarë të Islamit dhe i ftojnë që përballë sulmeve të ashpra të armiqve, të jenë fortë.

Ajeti 11, thotë: **"Lërmi Mua ata që të quajnë gënjeshtar e që jetojnë në luks dhe jepu pak afat atyre."**.

Kuptimi i ajetit është: Jo ti, por Unë jam përballë tyre. Lërma Mua ndëshkimin dhe dënimin e tyre, si dhe jepu pak afat atyre, me qëllim që të zbulojnë me duart e veta identitetin e tyre të vërtetë. Gjithashtu, lëri që ta mbushin barrën e vet me mëkate dhe atëherë, zemërimi Im do të ndrydhë fytin e tyre.

Ne e dimë se pa kaluar shumë kohë, myslimanët u fuqizuan dhe goditën me ashpërsi të madhe dhe shkatërruese armikun në Luftën e Bedrit, të Hunejnit, të Ahzabit, etj. Nuk kaloi shumë kohë dhe këta kryelartët, mëkatarë arrogantë u larguan nga kjo botë. Në botën e varrit i pret Dënimi Hyjnor, dënimi i Kiametit.

Fjala *"uli ni'ma" - "pasanikët"* përdoret për të treguar arrogancën dhe neglizhencën që buron nga malli e pasuria e tepërt dhe nga mundësitë materiale, që zakonisht pasanikët kanë. Ata do të dështojnë, për shkak të pasurisë së tyre, prandaj, në gjithë historinë e Profetëve, siç na dëshmon Kur'ani, ky grup njerëzish (pasanikët), gjithnjë ishin në rreshtin e parë të kundërshtarëve.

Ky ajet është i ngjashëm me ajetin 34 të sures "Es Sebé": **"Ne nuk dërguam në asnjë vendbanim ndonjë nga Profetët, për të cilin pasanikët e atij vendi të mos i thoshin: 'Ne nuk i besojmë asaj me çka jeni dërguar.'"**.

Ndërkohë që persona të tillë duhet të pranojnë më përpara se të tjerët ftesën e thirrësve të së drejtës dhe të falënderojnë Zotin për të gjithë këto begati hyjnore.

Në vazhdim të këtij kërcënimi, por në mënyrë më të qartë, ajeti deklaron: **"....Pa dyshim, Ne kemi përgatitur për ata pranga, zjarr flakërues."**.

Fjala *"el enkal"* është shumësi i fjalës *"nakl"* dhe nënkupton zinxhirët e rëndë. Në fakt, kjo fjalë rrjedh nga rrënja *"nekul"* dhe është përdorur me kuptimin e dobësimit dhe pafuqisë, në kontekstin e mëposhtëm: prangat që i vendosin në duar, këmbë apo fyt, pengojnë lëvizjet e njeriut, si dhe e bëjnë të pafuqishëm atë. Si rrjedhojë, kjo fjalë është përdorur në kuptimin e "zinxhirit". Po, përballë lirisë së pakushtëzuar që kishin në këtë botë, përfitimi i tyre, nuk është gjë tjetër, përveç robërim dhe zjarr flakërues.

Përsëri shtohet: **"...ushqime që ngecin në fyt dhe dënime të dhembshme."**.

Ky do të jetë një ushqim i ndryshëm nga ushqimi i tyre i shijshëm dhe i ëmbël i kësaj bote, i cili nuk të ngecte në fyt, madje ishte i shijshëm. Por, për këta egoistë, në Botën Tjetër do të ketë një jetesë të dhimbshme, një jetesë të ndryshme nga jetesa e rehatshme e kësaj bote.

Edhe pse ushqimi i tyre i hidhur, që të ngec në fyt, në vetvete, është një dënim i dhimbshëm, përsëri ajeti e përmend "dënimin e dhimbshëm". Kjo tregon se dimensionet e dënimit të dhimbshëm në Jetën e Përtejme, pra, në Ahiret, janë shumë të ashpra. Ato nuk janë të njohura për askënd, përveç All'llahut. Rreth kësaj situate, në një hadith thuhet: "Një ditë, një prej myslimanëve e këndoi ajetin në fjalë. Profeti po e dëgjonte atë.

Papritur, personi që po këndonte Kur'an, lëshoi një britmë të madhe dhe ra pa ndjenja.".[1]

Në një hadith tjetër thuhet: "*Vetë Profeti Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) e këndonte këtë ajet dhe pësonte një gjendje të tillë.*".[2]

Si të mos ngecë në fyt një ushqim i tillë? Ndërkohë që në ajetin e gjashtë të sures "El Gashije" lexojmë: **"Ata nuk kanë ushqim tjetër, përveç një barishteje me ferra helmuese."**.

Edhe në ajetet 43-44 të sures "Ed Duhan" lexojmë: **"Është e vërtetë se pema e Zukumit do të jetë ushqim i mëkatarëve."**.

Më pas, përshkruan Ditën e Gjykimit, kur do të ndodhin këto dënime dhe deklaron: **"...në Ditën, kur Toka dhe malet dridhen e bëhen si pirgje rëre të lëvizshme."**.

Fjala *"kethijbun"* është përdorur me kuptimin e rërës së dendur, kurse fjala *"mehijl"* rrjedh nga fjala *"hejl"* dhe është përdorur me kuptimin e hedhjes së një gjëje të butë, (siç është të hedhësh miell mbi një gjë tjetër). Këtu përdoret për të treguar rërën e butë, e cila asnjëherë nuk ka qëndrueshmëri.

Si kjo rërë do të bëhen malet Atë Ditë.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 380.

[2] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 29, f. 107.

Për fatin e maleve në prag të Kiametit, Kur'ani ka përdorur shprehje të ndryshme. Që të gjitha na tregojnë asgjësimin dhe shndërrimin tyre në dhè të butë.[1]

Më pas, krahason misionin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me kundërshtimet e të fuqishmëve arabë dhe me kryengritjen e Musa ibn Imranit kundër Faraonëve dhe thotë: **"Ne, me të vërtetë, ju kemi sjellë një të Dërguar dëshmitar mbi ju, ashtu siç ia çuam një të Dërguar Faraonit."**.

Ky ajet ka për qëllim udhëzimin tuaj dhe monitorimin e veprave tuaja, ashtu siç ishte synimi i Musa ibn Imranit, të udhëzonte Faraonin dhe të monitoronte e të mbikëqyrte veprimtarinë e tij dhe të përkrahësve të tij.

Por Faraoni u ngrit dhe e kundërshtoi atë të Dërguar dhe Ne e dënuam ashpër: **"Faraoni nuk e dëgjoi të Dërguarin, andaj i çuam dënim të rëndë."**.

As ushtria e madhe e tij, as shteti i fuqishëm, as pasuria e tij nuk e parandaluan dot një gjë të tillë. Si përfundim, të gjithë së bashku u mbytët në valët e dhunshme të Nilit, me të cilin krenoheshin. Ju që jeni në një nivel shumë më të ulët se ata, si dhe nga pikëpamja e numrit jeni më të pakët përballë Faraonit dhe përkrahësve të tij, ç'mendoni për veten tuaj?!

[1] Në lidhje me etapat e ndryshme të zhdukjes së maleve, si dhe shprehjeve të ndryshme të Kur'anit, është folur në ajetin 105 të sures "Ta Ha". (Po ky tefsir, vëll. 13, f. 302.)

Si mund të krenoheni me këtë pasuri dhe përkrahje të kufizuar?!

Fjala *"uebijl"* rrjedh nga fjala *"uebl"* dhe tregon shiun e dendur dhe të vrullshëm. Më pas kjo fjalë është përdorur për çdo gjë të ashpër dhe të rëndë, veçanërisht për dënimet e ashpra dhe të rënda. Edhe në ajetin në fjalë, është përdorur me kuptimin e dënimit të ashpër.

Më pas, ajeti është përqendruar mbi jobesimtarët e kohës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i paralajmëron ata në këtë mënyrë: **"Qysh do të mbroheni ju, nëse mbeteni jobesimtarë, Ditën në të cilën fëmijët do të thinjen?"**.

Po, dënimi i asaj Dite është aq i madh, aq i rëndë, aq i ashpër, aq i tmerrshëm dhe katastrofik, saqë edhe fëmijët do të thinjen!

Nga ajeti i lartpërmendur nënkuptohet se dënimi i Faraonit dhe i pasuesve të tij në këtë botë është i pakrahasueshëm me dënimin në Ditën e Kiametit.

Në ajetin në vijim bëhet një përshkrim i detajuar i Ditës së Kiametit. Për Këtë Ditë trishtuese ajeti thotë: **"Atë ditë qielli do të çahet e premtimi i Zotit do të përmbushet."**.

Shumë ajete kur'anore flasin rreth Kiametit dhe çastit kur do të ndodhë, flasin për ngjarjet e asaj dite, për çastin e përfundimit të botës dhe fillimin e Ringjalljes. Të gjitha këto ajete, na tregojnë për shpërthime të mëdha, për tërmete të ashpra dhe transformime të shpejta. Ky ajet ka përmendur vetëm një pjesë prej tyre.

Qielli dhe objektet qiellore, me gjithë madhështinë e tyre, nuk mund t'i përballojnë ngjarjet madhështore të Asaj Dite. Ç'mund të presim prej njeriut të dobët dhe të pafuqishëm?!

Në fund të këtij diskutimi, sërish përmenden të gjitha paralajmërimet e mëparshme: **"Në të vërtetë, kjo është kështillë…"**.

Njeriu është i lirë të zgjedhë rrugën që do. Ai që dëshiron të udhëzohet dhe është në kërkim të lumturisë së përhershme, pa dyshim që zgjedh rrugën që e çon drejt All'llahut. Për këtë moment, ajeti thotë: **"...prandaj, kush dëshiron, le të zgjedhë Rrugën e Drejtë që e çon te Zoti i tij."**.

Nëse tejkalohet kjo rrugë me anë të detyrimit dhe përkundrejt vullnetit, kjo nuk është as krenari dhe as virtyt. Virtyt është kur njeriu zgjedh këtë rrugë dhe i bashkohet asaj me vullnetin e vet të plotë dhe lirinë e zgjedhjes.

Thënë shkurt, All'llahu na e ka bërë të qartë rrugën nga humnera. All'llahu i Madhëruar ka dhënë sy që të shikojmë, na ka dhënë ndërgjegje, na orienton dhe më pas i le njerëzit të lirë të zgjedhin, nëse u binden urdhrave të Tij me vullnet të lirë dhe të veprojnë sipas tyre, ose zgjedhin rrugën e humbjes.

Për kuptimin e sifjalisë: **"Në të vërtetë, kjo është kështillë..."**, janë dhënë interpretime të ndryshme nga ana e komentuesve të Kur'anit. Disa komentues kanë thënë se aludon për kështillën që është përmendur në ajetet e mëparshme. Disa të tjerë kanë thënë se me të nënkuptohet e gjithë surja, të tjerë mendojnë se aludon për të gjithë Kur'anin e Madhërishëm.

Të tjerë komentues kanë pohuar se ka mundësi që të jetë tregues për urdhrin për faljen e namazit dhe faljen gjatë natës, i cili është përmendur në ajetet e para të kësaj sureje dhe subjekti i saj ishte vetë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Me këtë fjali, dëshiron ta përgjithësojë këtë urdhër dhe të përfshijë në të dhe myslimanët e tjerë.

Prandaj, fjala *"sebijlun" - "rrugë"*, në fjalinë pasardhëse përdoret për të treguar namazin e natës, i cili konsiderohet si një prej rrugëve të rëndësishme që të çojnë drejt All'llahut. Edhe në suren "El Insan", pas urdhrit të namazit të natës, ajeti 26 thotë: **"...falu për hir të Tij në një kohë të natës, mandej adhuroje Atë edhe natën më gjatë."**. Vetëm pas një intervali të shkurtër, sërish shprehet: **"Vërtet, këto janë një këshillë, e kush do, e merr rrugën që e çon te Zoti i tij."**.[1]

Sigurisht, ky është një interpretim i përshtatshëm, por më i saktë dhe më i përshtatshëm është kuptimi gjithëpërfshirës i ajetit, ku futen edhe të gjitha praktikat e vetëformimit të njeriut, për të cilat u diskutua në këtë sure.

Hulumtim

Katër llojet e etapave të dënimit të All'llahut

[1] Tefsiri "El Mijzan", vëll. 20, f. 147.

Në ajetet e lartpërmendura, përgënjeshtruesit arrogantë dhe të zhytur në begati, All'llahu i Madhëruar i kërcënon me katër tortura dhe dënime të frikshme: me pranga dhe zinxhirë, me zjarrin përvëlues të Xhehennemit, me ushqim të ashpër e të hidhur që ngec në fyt dhe është vdekjeprurës, si dhe me lloj-lloj dënimesh të tjera të dhimbshme dhe të frikshme, që mendja e njeriut as nuk i përfytyron dot.

Këto dënime jepen sipas veprimtarisë që kanë kryer në këtë botë.

Në këtë botë ata kishin liri të plotë, kishin jetë të rehatshme, kishin ushqime të shijshme dhe të ëmbla, kishin lloj-lloj komoditetesh dhe privilegjesh.

Por, meqenëse të gjitha këto i përfituan përmes shtypjes, dhunës, shkeljes së të drejtave të të tjerëve, si dhe mendjemadhësisë, arrogancës dhe neglizhencës karshi All'llahut, në Ditën e Kiametit, asgjë nga këto nuk u hyn në punë. Në Kiamet do t'i presë një dënim i dhimbshëm.

Ajeti 20

إِنَّ رَبَّكَ يَعْلَمُ أَنَّكَ تَقُومُ أَدْنَى مِنْ ثُلُثَيِ اللَّيْلِ وَنِصْفَهُ وَثُلُثَهُ وَطَائِفَةٌ مِنَ الَّذِينَ مَعَكَ وَاللَّهُ يُقَدِّرُ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ عَلِمَ أَنْ لَنْ تُحْصُوهُ فَتَابَ عَلَيْكُمْ فَاقْرَءُوا مَا تَيَسَّرَ مِنَ الْقُرْآنِ عَلِمَ أَنْ سَيَكُونُ مِنْكُمْ مَرْضَى وَآخَرُونَ يَضْرِبُونَ فِي الْأَرْضِ يَبْتَغُونَ مِنْ فَضْلِ اللَّهِ وَآخَرُونَ يُقَاتِلُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ فَاقْرَءُوا مَا تَيَسَّرَ مِنْهُ وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ وَأَقْرِضُوا اللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا وَمَا تُقَدِّمُوا لِأَنْفُسِكُمْ مِنْ خَيْرٍ تَجِدُوهُ عِنْدَ اللَّهِ هُوَ خَيْرًا وَأَعْظَمَ أَجْرًا وَاسْتَغْفِرُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ﴿٢٠﴾

"Natyrisht, Zoti yt e di se ti (o Muhammed) **falesh më pak se dy të tretat e natës, ndonjëherë gjysmën ose një të tretën e saj, si edhe disa prej atyre që janë me ty. All'llahu e përcakton gjatësinë e ditës dhe të natës dhe e di se ju nuk mund ta llogarisni atë saktësisht, prandaj kthehet tek ju me mëshirë. Kështu që lexoni Kur'an aq sa mundeni! Ai e di se disa prej jush do të jenë të sëmurë, disa do të udhëtojnë nëpër botë, duke kërkuar mirësitë e Tij** (për jetesë) **dhe disa të tjerë do të jenë duke luftuar në Rrugën e Tij, prandaj lexoni sa keni mundësi nga Kur'ani! Faleni namazin, jepeni zekatin dhe jepini All'llahut një hua të mirë** (që Ai t'jua kthejë shumëfish)**. Çfarëdo mirësie që bëni për shpirtin tuaj, me siguri që do ta gjeni tek All'llahu. Ajo do të jetë më e mirë dhe më e shpërblyer. Kërkoni faljen e All'llahut, sepse All'llahu është vërtet Falës i madh dhe Mëshirëplotë."**

Komentimi

Lexoni Kur'an sa të keni mundësi!

Ky është ajeti më i gjatë i kësaj sureje dhe përfshin shumë çështje, të cilat janë plotësuese të përmbajtjes së ajeteve të kaluara.

Mbeten çështje diskutimi mes komentuesve të Kur'anit çështje të tilla, si: A e zbeh urdhrin e ajeteve të para të kësaj sureje,

ky ajet, apo është një sqarim dhe komentim shtesë? A ka zbritur në Mekë apo në Medine?

Përgjigjja e këtyre pyetjeve do të bëhet e qartë pas interpretimit të ajetit.

Në fillim, ajeti thotë: **"Natyrisht, Zoti yt e di se ti** (o Muhammed) **falesh më pak se dy të tretat e natës, ndonjëherë gjysmën ose një të tretën e saj, si edhe disa prej atyre që janë me ty..."**.[1]

Është tregues për të njëjtin urdhër që i është zbritur Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, me të vetmin ndryshim, se këtu është shtuar fjalia: "Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e shoqëronin në adhurimin e natës dhe një grup besimtarësh" (si një urdhër i pëlqyeshëm, ose si një urdhër detyrues, ose kushtet në fillim të përhapjes së Islamit i detyronin që me anë të këndimit të Kur'anit dhe me anë të adhurimit të natës, të formonin veten e tyre, për të qenë në gjendje që ta përhapnin fenë islame dhe ta mbronin atë).

Në qoftë se u referohemi disa transmetimeve dhe haditheve, arrijmë në përfundimin se një grup myslimanësh patën vështirësi në përllogaritjen e një të tretës, të gjysmës dhe dy të tretave të natës, sepse në atë kohë nuk ekzistonte ndonjë mjet për matjen e kohës, pra, caktimin e orëve. Për këtë arsye ishin të detyruar të tregonin

[1] Duhet të kemi parasysh se fjala *"nisfehu"* dhe *"thuluthehu"* lidhet me fjalën *"edna"* dhe jo me *"thulutheilejl"* prandaj kuptimi i fjalisë do të ishte në këtë mënyrë: "Rreth dy të tretat e natës, ose vetëm gjysma, ose një e treta e natës.". Ndërkohë duhet të kemi parasysh se fjala *"udna"* zakonisht përdoret për vend të afërt dhe këtu është aluzion për kohën e afërt.

kujdes të madh. Kjo bëhej shkak që ndonjëherë të qëndronin zgjuar gjithë natën, duke falur namaz, aq sa këmbët e tyre ënjteshin dhe fryheshin.

All'llahu u tregua i mëshirshëm ndaj tyre dhe bëri lëshime me këtë urdhër, përmes të cilit deklaroi: **"...All'llahu e përcakton gjatësinë e ditës dhe të natës dhe e di se ju nuk mund ta llogarisni atë saktësisht, prandaj kthehet tek ju me mëshirë. Kështu që lexoni Kur'an aq sa mundeni!..."**.

Fjala *"len tuhsuhu"* rrjedh nga fjala *"el ihsa"* dhe është përdorur me kuptimin e numërimit, meqë besimtarët e kishin të vështirë të përcaktonin saktë kohën që u duhej për namazin e natës.

Disa komentues të tjerë kanë deklaruar se kjo fjalë përdoret për të treguar se ju nuk jeni në gjendje të përballoni këtë punë gjatë gjithë vitit.

Edhe sot, kur janë mjetet e nevojshme për t'u zgjuar në kohë të caktuar, përllogaritja e saktë e kohës për namaz gjatë vitit nuk është aq e lehtë, sepse dita dhe nata ndryshojnë vazhdimisht.

Fjalën *"tabe alejkum"*, shumica e komentuesve të Kur'anit, e kanë interpretuar në kuptimin "e të bërit lëshime" nga kjo përgjegjësi dhe jo në kuptimin e "pendimit nga mëkati".

Ekziston edhe mundësia që me zëvendësimin e një urdhri, nuk mbetet më mëkat, pra, kemi të bëjmë me njëfarë amnistie hyjnore.

Për fjalinë *"fekrau ma tej'jesere minel Kuran"* - **"Kështu që lexoni Kur'an, aq sa mundeni"**, ekzistojnë shumë diskutime dhe polemika.

Një grup e ka komentuar atë si namazi i natës, gjatë të cilit duhet të këndohet patjetër Kur'an.

Disa të tjerë janë shprehur se me këtë fjali kërkohet pikërisht këndimi i Kur'anit edhe jashtë namazit.

Disa të tjerë e kanë interpretuar atë si lexim të pesëdhjetë ajeteve, disa të tjerë të njëqind ajeteve, disa të dyqind ajeteve. Asnjë prej këtyre shifrave nuk ka ndonjë argument të veçantë. Përkundrazi, kuptimi i ajetit është që njeriu të këndojë Kur'an brenda mundësive të tij, aq sa mundet.

Është e qartë se "këndimi i Kur'anit" duhet të shërbejë për të mësuar, për vetëformim, vetërealizim, për kultivimin e besimit dhe të devotshmërisë.

Më pas, ajeti sjell një argument tjetër, në lidhje me lëshimin që bën ky urdhër: **"...Ai e di se disa prej jush do të jenë të sëmurë, disa do të udhëtojnë nëpër botë, duke kërkuar mirësitë e Tij** (për jetesë) **dhe disa të tjerë do të jenë duke luftuar në Rrugën e Tij..."**. Këto çështje, do t'ju pengojnë nga kryerja e adhurimit të natës në masën e caktuar, për një kohë të gjatë.

Ky është shkaku tjetër për lëshimin që bën ky urdhër, prandaj sërish e përsërit: **"...prandaj lexoni sa keni mundësi nga Kur'ani!"**.

Është e qartë se përmendja e sëmundjes, e udhëtimeve të domosdoshme dhe e luftës për hir të All'llahut, janë tre shembuj për justifikim të arsyetuar, por vetëm këta tre shembuj nuk shërbejnë si justifikim i plotë. Justifikimi i plotë lidhet me faktin se All'llahu i Madhëruar është në dijeni për problemet e ndryshme që

hasni në jetën përditshme, të cilat ju pengojnë ta plotësoni këtë program të vështirë.

Tani lind pyetja: Vallë, a e anulon ky urdhër atë që është përmendur në fillim të sures apo është një përjashtim?

Kuptimi i ajeteve na e bën të qartë anulimin e urdhrit të parë. Në realitet, ishte e nevojshme që ky urdhër të zbatohej për një periudhë kohe dhe urdhri që kishte aspekt të përkohshëm dhe të jashtëzakonshëm, ia arriti qëllimit. Pas përfundimit të kësaj periudhe, detyrimi mbeti në formë më të lehtë, sepse ajeti sqaron se shumë njerëz nuk kishin mundësi ta zbatonin këtë urdhër. Është kjo arsyeja që ky urdhër u lehtësua për të gjithë, jo vetëm për grupin e përmendur, prandaj nuk mund të konsiderohet përjashtim nga urdhri i parë.

Këtu shtrohet edhe një pyetje tjetër: Vallë, këndimi i Kur'anit, aq sa mundemi, a është i mjaftueshëm, sepse ajeti e përsërit dy herë: një herë e quan të obligueshëm, një herë të pëlqyeshëm?

Disa komentues pohojnë se është e pëlqyeshme, kurse disa të tjerë shfaqin dyshime se mund të jetë e obligueshme, sepse këndimi i Kur'anit mundëson informimin dhe njohjen e argumenteve të monoteizmit, të dërgimit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të mrekullive të këtij Libri Qiellor, si dhe jep mësime për detyrat e tjera të fesë. Prandaj, leximi i Kur'anit është premisë për kryerjen e obligimit, si rrjedhojë dhe vetë është obligim, thonë komentuesit e dytë.

Por duhet të kemi parasysh faktin se leximi i Kur'anit të bëhet ose gjatë namazit të natës, ose gjatë ditës. Leximi i Kur'anit është detyrim për çdo njeri madhor. Çdo njeri duhet të lexojë Kur'an, aq sa është e nevojshme për arsimimin dhe edukimin e vet, për t'u njohur me konceptet bazë, për të njohur praktikën e Islamit dhe për t'ua mësuar atë brezave të ardhshëm, pa pasur të përcaktuar një kohë apo periudhë të veçantë për leximin e tij.

Kuptimi i fjalës *"fe'ekreu"* është detyrimi. Kjo është shpjeguar dhe në metodologjinë e Fik'hut, ku bëhet përjashtim rasti kur thuhet që ky 'urdhër', sipas mendimit të përbashkët të juristëve për 'mos detyrimin' është një urdhër i pëlqyeshëm, sepse në fillimet e Islamit, ekzistonin disa kushte të caktuara: këndimi i Kur'anit, adhurimi i obligueshëm gjatë natës, për të cilët më pas u bënë lëshime, si nga pikëpamja sasiore, ashtu dhe nga pikëpamja e cilësisë së urdhrit. Ky urdhër, i cili deri atëherë kishte qenë i obligueshëm, u shndërrua në formën e një urdhri të pëlqyeshëm, i cili do të realizohej në bazë të mundësive. Detyrimi i namazit të natës mbeti i pandryshueshëm për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* gjer në fund të jetës së tij (sipas dëshmive të ajeteve të tjera kur'anore dhe transmetimeve).

Në një hadith të transmetuar nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Urdhri në lidhje me dy të tretat e natës, të gjysmës apo të një të tretës së saj, është anuluar dhe në vend të saj është caktuar: 'feekreu ma tejes'sere minel Kuran'* – **'prandaj lexoni nga Kur'ani, aq sa keni mundësi'**".[1]

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 451.

Duhet të kemi parasysh faktin se, në ajetin në diskutim, janë përmendur tre lloj justifikimesh: njëri ka karakter trupor, (sëmundja), tjetri ka karakter ekonomik, (udhëtimi për të fituar dhe punuar) dhe i treti ka karakter fetar (xhihadi për hir të All'llahut), prandaj, disa kanë thënë: Nga ky ajet përftojmë se përpjekja për sigurimin e jetesës, është në të njëjtin nivel me luftën në Rrugën e All'llahut.

Këtë fjali e kanë konsideruar si një argument që vërteton se ky ajet ka zbritur në Medine, sepse detyrimi i xhihadit nuk ishte në Mekë, por, duke pasur parasysh se përdoret fjalia: *"sej'jekun"* - **"do të ndodhë së shpejti"**, ka mundësi që kjo fjali të jetë lajmërim për ligjvënien e xhihadit në të ardhmen. Pra, meqenëse momentalisht keni arsye që ju pengojnë dhe në të ardhmen, gjithashtu, do të keni arsye të tjera, prandaj ky urdhër nuk u shndërrua në dispozitë konstante, kështu që nuk bie në kundërshtim me të qenët ajet mekas.

Në fund të këtij ajeti, përmenden edhe katër urdhra të tjera, me të cilët plotësohet programi i vetëformimit të paraqitur në këtë ajet. Ajeti thotë: **"...faleni namazin, jepeni zekatin dhe jepini All'llahut një hua të mirë** (që Ai t'jua kthejë shumëfish)**. Çfarëdo mirësie që bëni për shpirtin tuaj, me siguri që do ta gjeni tek All'llahu. Ajo do të jetë më e mirë dhe më e shpërblyer. Kërkoni faljen e All'llahut, sepse All'llahu është vërtet Falës i madh dhe Mëshirëplotë."**.

Këta katër urdhra (namazi, zekati, mirësitë e pëlqyeshme dhe kërkimi i faljes me pendim), duke u bashkangjitur dhe urdhrin për këndimin e Kur'anit dhe të reflektimit ndaj tij, në tërësi, përbëjnë një program të plotë të vetëformimit, i cili, në çdo

periudhë kohore, sidomos në fillimet e Islamit, ka pasur dhe vazhdon të ketë ndikim të pamohueshëm.

Me fjalën **"namaz"** kuptohen pesë namazet e obligueshme dhe me **"zekat"** kuptohet zekati i obligueshëm. Me **"dhënien e All'llahut një hua të mirë",** kuptohen bamirësitë dhe dhëniet jo të detyrueshme të njeriut, që i kryhen për hir të All'llahut. Kjo është shprehja më bujare dhe më fisnike që mund të imagjinohet, sepse Ai që zotëron gjithçka, kërkon hua nga një njeri, i cili absolutisht nuk ka asnjë gjë nga vetja. Këtë e bën, me qëllim që me anë të kësaj, ta nxitë atë të japë për hir të All'llahut dhe të përfitojë nga ky veprim i dobishëm dhe kështu, të edukohet, të formohet dhe të arrijë përsosmërinë.

Përmendja e kërkimit të faljes, në fund të këtyre urdhrave, bëhet që njeriu të mos kujtojë se me kryerjen e këtyre adhurimeve dhe lutjeve ta konsiderojë veten një njeri të plotësuar dhe të përsosur. Thënë ndryshe, gjithnjë duhet ta imagjinoni veten si borxhlinj ndaj All'llahut dhe gjithnjë t'i kërkoni falje Atij.

Disa komentues të Kur'anit, janë të mendimit se mbështetja në këto urdhra bëhet që të mos të imagjinohet se lëshimi i bërë ndaj urdhrit të namazit të natës dhe këndimit të Kur'anit natën, të ketë prekur urdhrat dhe programet e tjera fetare, të cilat kanë peshën e tyre.[1]

Ndërkohë, përmendjen e zekatit si obligim, në këtë ajet, e kanë konsideruar si një argument tjetër që vërteton se ajeti është medinas, sepse urdhri për dhënien e zekatit kishte zbritur në Medine dhe jo në Mekë. Por disa janë përgjigjur se parimi i zekatit

[1] Tefsiri "El Mijzan", vëll. 20. f. 156.

ka zbritur në Mekë. Sidoqoftë, akoma nuk është shprehur shuma dhe sasia e tij. Në Medine u caktua si ligj përmasa dhe norma e tij.

Hulumtime

1- Domosdoshmëria e përgatitjes ideologjike dhe kulturore

Për realizimin e veprave të rëndësishme shoqërore, sidomos për të bërë një revolucion të madh dhe të gjerë, në të gjitha aspektet e jetës, para se gjithash, nevojitet një forcë e vendosur njerëzore, që të jetë e formuar dhe e përgatitur, të jetë me bindje të forta dhe njohuri të plota, me rekomandime të nevojshme mendore e kulturore dhe edukim etiko-moral të shëndoshë.

Këtë realizoi Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në Mekë, jo vetëm gjatë viteve të para të dërgimit të tij si Profet, por gjatë gjithë jetës së tij. Puna e tij e pandërprerë dhe e mbështetur edhe në themelet e forta të besimit, të Islamit, u rrit me shpejtësi, mbiu, nxori gjethe dhe u degëzua.

Kjo sure është një shembull i gjallë dhe shumë i spikatur i lidhjes me këtë planifikim të mirëmenduar.

Urdhri për faljen gjatë dy të tretave të natës, ose së paku një të tretës së saj dhe kjo e shoqëruar me këndim Kur'ani dhe reflektim për atë që thuhet në vargjet e tij, krijoi një ndikim të çuditshëm në shpirtin dhe zemrat e myslimanëve. I përgatiti ata që të përballeshin me përpjekje të mëdha dhe të pandërprera. Në fund e arriti qëllimin e vet. Një grup i vogël njerëzish prej shtresave të shtypura u bë i denjë për të qeverisur dhe për të drejtuar një pjesë të madhe të botës.

Edhe sot, në qoftë se ne, myslimanët, dëshirojmë të rigjejmë madhështinë dhe fuqinë e vjetër, rruga është po kjo dhe plani është po ky. Pra, duhet ndjekur dhe duhet adoptuar e njëjta rrugë dhe i njëjti plan. Asnjëherë nuk duhet të pretendojmë që me njerëz të paformuar nga pikëpamja ideore dhe e besimit, me njerëz, që akoma nuk kanë marrë edukimin e nevojshëm kulturor dhe etik, të zhdukim "regjimin cionist" nga vendet islame. Kjo është një temë e gjerë dhe e gjatë, por aty ku ka njerëz që e dinë vlerën e besimit, mjafton dhe një fjalë e vetme.

2- Këndimi i Kur'anit, i shoqëruar me reflektim dhe meditim

Nga transmetimet islame, përcillet mesazhi se mirësia (ndikimi) e këndimit të Kur'anit nuk qëndron në këndimin e sa më shumë të Kur'anit, por në këndimin e tij në mënyrë të bukur, të shoqëruar me reflektim dhe meditim.

Ajeti i lartpërmendur urdhëron: **"...prandaj lexoni sa keni mundësi nga Kur'ani!"**. Rreth këtij ajeti është transmetuar një hadith nga Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)*. Aty thuhet se Profeti ka

thënë: *"Këndoni nga Kur'ani, aq sa prej atij leximi të keni zemër të përulur, çiltërsi të brendshme, ndërgjegje të pastër, ekzaltim shpirtëror dhe vitalitet shpirtëror."*.[1]

Pse të mos jetë kështu, kur e dimë se synimi kryesor i këndimit të Kur'anit është mësimi dhe edukimi?!

Për këtë çështje ka shumë hadithe dhe transmetime.

3- Përpjekja për të siguruar jetesën, e barasvlershme me xhihadin në Rrugën e All'llahut

Në ajetin e lartpërmendur, siç u diskutua edhe më parë, përpjekja për të jetuar është vlerësuar si e njëjtë me xhihadin, luftën në Rrugë e All'llahut. Kjo tregon se Islami i kushton një rëndësi të madhe kësaj çështjeje. Aq më shumë, kur lufton për jetesë një popull i varfër dhe i uritur. Në qoftë se nuk vlerësohet njësoj "xhihadi ekonomik" me "xhihadin kundër armikut", ai popull asnjëherë nuk do ta gëzojë pavarësinë, madhështinë dhe krenarinë e tij.

Në lidhje me këtë është transmetuar një fjali nga sahabi i njohur, Abdullah ibn Mes'udi: "Çdokush që çon ndonjë mall në njërin prej qyteteve të myslimanëve dhe përpjekjet e tij në këtë rrugë i konsideron në llogarinë e All'llahut dhe më pas e shet atë me çmim të ditës, ai njeri, përpara All'llahut është në pozitën e dëshmorëve.". Më pas e lexoi ajetin e fundit të sures "El

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 382.

Muzzemmil" si dëshmi të kësaj: "Të tjerë që gjallërojnë nëpër tokë, duke kërkuar nga begatitë e All'llahut.".[1]

O Zot! Të lutem, na mundëso ne xhihadin, në të gjitha dimensionet e tij!

O Zot! Të lutem, na mundëso ne ngritjen natën për namaz, për këndim të Kur'anit dhe vetëformim, nën ndriçimin e kësaj drite qiellore!

O Zot! Të lutem, me frymëzim nga kjo sure plot domethënie, ngrije shoqërinë tonë në pozitën e duhur dhe madhështinë e lashtë të saj.

Fundi i sures "Muzemmil"

[1] Tefsiri "Mexhmeul Bejan" vëll. 10, f. 382, tefsiri "Ebul Fettuh Err Rrazij", tefsiri i "Kurtubiut", në ajetin në fjalë, ndërkohë nga hadithi tjetër, që është i ngjashëm me këtë hadith dhe në tefsirin e "Kurtubiut", të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* përftohet se Abdullah ibn Mes'udi këtë fjalë nuk e ka thënë nga vetja, por e ka transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Sure "El Muddeththir"

Zbritur në Mekë

56 ajete

Përmbajtja e sures "El Muddeththir"

Kjo është një nga suret që ka zbritur në Mekë, por diskutohet, nëse kjo ishte surja e parë që i zbriti Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, apo ka zbritur pas sures "Ikra".

Nëse e analizojmë me kujdes përmbajtjen e këtyre dy sureve, pra, të sures "Ikra" dhe të sures "El Muddeththir", vërejmë se surja "Ikra" është shpallur në fillim të thirrjes së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kurse surja "El Muddeththir" i përket periudhës kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u urdhërua që t'i ftonte hapur njerëzit në Rrugën e Drejtë, pasi kohës së ftesës fshehurazi i kishte ardhur fundi.

Kështu që disa komentues janë të mendimit se surja "Ikra" është surja e parë, e cila i është shpallur Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në fillim të dërgimit të tij, kurse surja "El Muddeththir" është surja e parë e

thirrjes hapur. Ky mendim është më i pranuar midis këtyre dy alternativave.

Sidoqoftë, në këtë sure është reflektuar plotësisht natyra e sureve mekase, siç janë: ftesa për besim, trajtimi i çështjeve që lidhen me Ringjalljen, me luftën kundër idhujtarisë, si dhe paralajmërimi apo kërcënimi i kundërshtarëve me anë të dënimit hyjnor.

Tematika e saj përmblidhet në shtatë pika kryesore:

1- I bëhet thirrje Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që t'i përvishet me zell detyrës, t'u tërheqë vërejtjen idhujtarëve, të ftojë hapur, të tregojë durim dhe qëndrueshmëri në këtë rrugë, si dhe të sigurojë përgatitjen e nevojshme për realizimin e kësaj përgjegjësie.

2- Në këtë sure flitet për Ringjalljen, për cilësitë e banorëve të Xhehennemit, të cilët jo vetëm e kundërshtonin Kur'anin, por edhe përqeshnin Fjalët e All'llahut.

3- Përmendet një pjesë e karakteristikave të banorëve të Xhehennemit, të shoqëruar me tërheqje vërejtje dhe paralajmërim për idhujtarët.

4- Me anë të betimeve të njëpasnjëshme, theksohet çështja e Ringjalljes.

5- Ndërlidhja e fatit të çdo njeriu me veprat e tij, si dhe mohimi i çdo lloj ideje dhe mendimi të palogjikshëm lidhur me këtë.

6- Shpaloset një pjesë e karakteristikave të banorëve të Xhennetit dhe Xhehennemit, si dhe fati i secilit prej tyre.

7- Në fund përmendet shkaku i largimit të njerëzve injorantë, të paditur, mendjemëdhenj dhe egoistë nga Rruga e Drejtë.

Mirësitë e leximit të sures "El Muddeththir"

Në një hadith të transmetuar nga Profeti i nderuar i Islamit, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë: "*Çdokush që ia lexon dikujt suren 'El Muddeththir' dhe për çdo njeri që e ka pranuar apo e ka përgënjeshtruar Profetin Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) në Mekë për shkak të këtij leximi, lexuesit do t'i jepen dhjetë të mira.*".[1]

Në një hadith tjetër, të transmetuar nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*Ai që e lexon suren 'El Muddeththir' në namazet e detyruara, All'llahu ka të drejtë që ta ringjallë përkrah Profetit Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), në vendin dhe pozitën e tij, si dhe në këtë botë asnjëherë të mos e kaplojë fatkeqësia dhe mjerimi.*".[2]

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 383.

[2] Po aty.

Është e qartë që rezultate të tilla madhështore nuk arrihen vetëm me anë të shqiptimit me gojë të sures, por duhet të merret parasysh përmbajtja dhe zbatimi i saj me përpikëri.

Ajetet 1 – 10

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

يَا أَيُّهَا الْمُدَّثِّرُ١ قُمْ فَأَنْذِرْ٢ وَرَبَّكَ فَكَبِّرْ٣ وَثِيَابَكَ فَطَهِّرْ٤ وَالرُّجْزَ فَاهْجُرْ٥ وَلَا تَمْنُنْ تَسْتَكْثِرُ٦ وَلِرَبِّكَ فَاصْبِرْ٧ فَإِذَا نُقِرَ فِي النَّاقُورِ٨ فَذَلِكَ يَوْمَئِذٍ يَوْمٌ عَسِيرٌ٩ عَلَى الْكَافِرِينَ غَيْرُ يَسِيرٍ١٠

Me Emrin e All'llahut, të Gjthëmëshirshmit, Mëshirëplotit

"O ti, i mbështjellë (o Muhammed)**!"**

"Çohu dhe paralajmëro!"

"Zotin tënd madhëroje."

"Petkat e tua pastroji."

"Dhe largohu nga ndyrësia (adhurimi i idhujve)**!"**

"Mos jep gjë, me synimin që të marrësh më shumë."

"Dhe për hir të Zotit tënd, duro."

"Se, kur të fryhet në Sur."

"Ajo do të jetë një ditë e rëndë."

"Për jobesimtarët nuk do të jetë aspak e lehtë."

Komentimi

Ngrihu dhe tërhiqja vërejtjen botës!

Është krejtësisht e qartë se këto ajete i drejtohen Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, edhe pse nuk është përmendur rishtazi emri i tij.

Surja nis me këto ajete: **"O ti, i mbështjellë** (o Muhammed)**! Çohu dhe paralajmëro!"**.

Kjo do të thotë se ka kaluar koha e gjumit dhe e pushimit dhe ka ardhur koha e ngritjes dhe e thirrjes në fenë islame.

Vënia në pah e "paralajmërimit", në këtë ajet, në fillim të detyrës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi*

të dhe mbi familjen e tij!), bëhet, sepse paralajmërimi ka një ndikim më të thellë në zgjimin e shpirtrave të fjetur.

Lidhur me faktin se pse pikërisht Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kur ishte shtrirë dhe po pushonte, u urdhërua të ngrihej dhe t'i ftonte njerëzit në Rrugën e Drejtë, ka mendime të ndryshme nga komentuesit e Kur'anit:

1- Idhujtarët arabë, në prag të ritualit të Haxhit, ishin mbledhur bashkë dhe paria e tyre, siç ishin: Ebu Xhehli, Ebu Sufjani, Uelijd ibn Mugejretu, Nedher bin Harith dhe të tjerë, po këshilloheshin dhe po diskutonin me njëri–tjetrin se si t'u përgjigjeshin pyetjeve të njerëzve, që vinin nga jashtë qytetit të Mekës, sepse kishin dëgjuar për shfaqjen e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Secili prej tyre do të përgjigjej në veçanti. U vendos që njëri ta quante mashtrues, tjetri magjistar, i treti të çmendur, një tjetër hallakatës idesh, etj. Kjo do të ndikonte negativisht, ndaj dhe gjykuan, që përballë thirrjes së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duhet të ishin të gjithë në një zë dhe në një qëndrim.

Pas diskutimit me njëri-tjetrin, arritën në përfundimin se më e pëlqyer do të ishte që Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ta quanin magjistar, sepse një prej efekteve të magjisë është ndarja e bashkëshortëve nga njëri-tjetri, ndarja e fëmijës nga prindi, etj, gjë që Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e kishte shkaktuar gjatë përpjekjeve të tij për përhapjen e fesë islame.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, sapo u vu në dijeni për këtë vendim të tyre, u zemërua ashpër, aq sa dukej si i sëmurë. U kthye i dëshpëruar dhe i pikëlluar në shtëpi dhe u shtri në krevat për të pushuar. Në këtë kohë i zbritën ajetet e lartpërmendura dhe e ftuan me ngulm që të ngrihej dhe të thërriste popullin në Rrugën e Drejtë.

2- Këto ajete janë ajetet e para që i kishin zbritur Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Nga Xhabir ibn Abdullahi është transmetuar se i Dërguari i All'llahut të ketë thënë: "*Unë isha në shpellën Hira dhe dëgjova: ;O Pejgamber! Ti je i Dërguari i Zotit!'*". Hodha vështrimin sa djathtas, sa majtas, por nuk shikova asnjë gjë. Pashë mbi kokën time një engjëll mbi fron, në mes qiellit dhe tokës. U frikësova shumë. U ktheva te Hatixheja dhe i thashë: 'Më mbulo! Më hidh ujë të ftohtë!' Në këtë kohë zbriti Xhebraili *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe shpalli: **'O ti, i mbuluar!'**".

Por ftesa e hapur e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është një argument që vërteton se këto ajete kanë zbritur tri vite pas thirrjes së tij fshehurazi. Ky mendim nuk përputhet me transmetimin e përmendur më lart. Mund të kishte përputhje vetëm nëse themi se disa nga ajetet e para të kësaj sureje kanë zbritur në fillim të thirrjes së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe ajetet në vijim i përkasin një periudhe të mëvonshme, me largësi prej disa vitesh.

2- Profeti ishte shtrirë për gjumë dhe ishte i mbuluar. Ndërkohë zbriti Xhebraili dhe e zgjoi atë, ia këndoi këto ajete dhe i

tha: "Ngrihu dhe lëre mënjanë krevatin dhe gjumin, përvishu detyrës me zell dhe thirri njerëzit në Rrugën e Drejtë.".

3- Me fjalën *"mbulim"*, këtu nuk kuptohet mbulimi me rroba, por mbulesa e Profetësisë dhe e misionit, siç thamë, kur diskutuam rreth devotshmërisë (rrobat e devotshmërisë).

4- Me fjalën *"muddeththir"* tregohet personi që rri i strukur në një qoshe dhe qëndron i izoluar dhe i vetmuar. Prandaj ajeti pohon: "Dil nga izolimi dhe vetmia, ftoi njerëzit në Rrugën e Drejtë dhe i udhëzo robtë e All'llahut.".[1]

Komentimi i parë, konsiderohet si më i përshtatshmi.

Duhet të kemi parasysh se fjala *"fe endhir"* - **"tërhiqja vërejtjen, paralajmëro"**, nuk e përcakton se për çfarë duhet paralajmëruar. Pra, përse duhet paralajmëruar? Kjo do të thotë se ky paralajmërim është për adhuruesit e idhujve, për idhujtarinë, për politeizmin, për dhunën, për korrupsionin dhe ryshfetin, për dënimin hyjnor dhe llogarinë në Botën Tjetër. Thënë ndryshe, përfshin edhe dënimet e kësaj bote edhe dënimin në Botën Tjetër. Njëherësh, është paralajmërim se pasojat negative të veprave që kryen njeriu, do ta kaplojnë atë.

Pasi Xhebraili i tha Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ta bëjë hapur thirrjen dhe paralajmërimin, i dha pesë urdhra të rëndësishme, të cila janë edhe shembuj për të tjerët.

[1] Fakhru Razij, këto pesë komentime së bashku me disa mundësi të tjera, i ka përmendur në tefsrin e tij, të quajtur "Kebijr".

Urdhri i parë ka të bëjë me monoteizmin. Ajeti thotë: **"Zotin tënd madhëroje."**. All'llahu është Zotëruesi, (Pronari) dhe Edukatori yt dhe çdo gjë që ti ke, të është dhënë nga Ai.

Hidh në tymnajën e harresës gjithçka, përveç All'llahut, fshiji të gjithë idhujt e tjerë të rremë dhe pastroje çdo gjurmë të politeizmit dhe të idhujtarisë.

Fjala *"fe keb'bir"* nuk do të thotë vetëm shqiptim i shprehjes "All'llahu Ekber". Megjithëse deklarimi "All'llahu Ekber" është një prej kuptimeve të fjalës *"fe keb'bir"*, në shumë hadithe është folur për këtë.

Fjala "All'llahu Ekber" do të thotë: Madhëroje All'llahun Tënd, si nga pikëpamja ideologjike, ashtu edhe nga ana praktike dhe me fjalë. Konsideroje Atë të pastër nga çdo lloj mangësie, nga çdo lloj të mete, si dhe përshkruaje Atë me cilësitë e bukurisë dhe të hijeshisë, madhëroje dhe konsiderojë Atë më të lartë nga çdo përshkrim. Edhe në hadithet e Ehli Bejtit, thuhet se fjala "All'llahu Ekber" përdoret për të treguar se All'llahu është më i lartë se si përshkruhet dhe perceptohet nga mendja e njeriut. Prandaj fjala *"tekbir"* ka një kuptim më të gjerë se sa nocioni i "lartësimit", i cili përfshin, në vetvete, spastrimin nga çdo lloj mangësie apo të mete.

Pas çështjes së monoteizmit, i jep urdhrin e dytë, rreth pastërtisë nga pisllëqet dhe shton: **"Petkat e tua pastroji."**.

Përdorimi i fjalës **"petkat"** ka mundësi të jetë përdorur për veprën, sepse veprat e çdo njeriu do ta mbështjellin atë, si të ishte veshja e tij dhe kjo veshje, kjo paraqitje e jashtme, tregon edhe anën e brendshme të tij.

Disa komentues të tjerë, gjithashtu, kanë thënë se fjala **"petka"**, në këtë ajet, përdoret për të treguar zemrën, shpirtin dhe frymën. Thënë ndryshe, pastroje zemrën nga çdo papastërti.

Disa të tjerë, gjithashtu, përdorimin e kësaj fjale e kanë interpretuar me veshjen e jashtme, sepse pastërtia e rrobave dhe paraqitja e jashtme është shenjë e personalitetit, e edukimit dhe e kulturës së njeriut. Kjo merrte më shumë vlerë, sidomos në kohën e injorancës, kur i kushtonin më pak rëndësi kësaj çështjeje dhe gjithnjë mbanin rroba të papastra në trupin e tyre. P.sh. e kishin traditë që të mbanin rroba shumë të gjata, në mënyrë që, gjatë ecjes ato t'u binin përtokë dhe t'u njolloheshin. Kjo gjendje kështillohet të mos vijojë. Për këtë, në disa hadithe të transmetuara nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet: *"Shkurtojini rrobat tuaja!"*.[1]

Disa komentues të tjerë, përdorimin e kësaj fjale, e kanë komentuar në kuptimin e bashkëshorteve, sepse Kur'ani deklaron: **"Ato janë rroba për ju dhe ju jeni rroba për to..."**.[2]

Është e mundur dhe bashkimi midis këtyre dy kuptimeve.

Në realitet, ajeti, gjithashtu, flet edhe se fjala e udhëheqësve hyjnorë mund të ndikojë te njerëzit, që t'i mbajnë të pastra petkat e tyre dhe të jenë të devotshëm dhe të drejtë, prandaj pas urdhrit për paralajmërim, urdhëron për pastërti.

Në urdhrin e tretë deklaron: **"Largohu nga ndyrësia** (adhurimi i idhujve)**!"**.

---

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 385.

[2] Sure "El Bekare", ajeti 187.

Për shkak të kuptimit të gjerë që ka fjala *"rixhzun"*- *"ndyrësi"*, janë bërë komentime të llojllojshme në lidhje me të: P.sh, ndonjëherë e kanë marrë në kuptimin e idhujve, ndonjëherë në kuptimin e çdo lloj mëkati, ndonjëherë si moral i keq dhe i lig, ndonjëherë në kuptimin e dashurisë së kësaj bote, që është burimi i të gjitha të këqijave, ndonjëherë në kuptimin e dënimit të All'llahut, i cili vjen si pasojë e politeizmit dhe e mëkateve, si dhe në kuptimin e çdo gjëje që bëhet shkak që njeriu të heqë dorë nga All'llahu.

Fjala *"rixhzun"*, në përdorimin kuptimor kryesor të saj, tregon ankthin dhe pasigurinë.[1] Më pas është përdorur me kuptimin e çdo lloj mëkati: të politeizmit, të adhurimit të idhujve, të cytjeve të djallit, të imoralitetit të shfrenuar, si dhe të dënimit hyjnor, i cili është shkak i ankthit të njeriut dhe i devijimit të tij nga Rruga e Drejtë.

Disa komentues të tjerë këtë fjalë e përdorin me kuptimin e "dënimit".[2] Duke pasur parasysh që politeizmi, mëkati, morali i keq, si dhe dashuria ndaj kësaj bote të shpien drejt dënimit të All'llahut, fjalët e lartpërmendura, gjithashtu, i kanë konsideruar të përfshira në kuptimin e fjalës *"rixhzun"*.

Po ashtu, nuk duhet të kalojmë pa përmendur faktin që në Kur'anin Famëlartë, fjala *"rixhzun"* zakonisht është përdorur në kuptimin e *"dënimit"*.[3]

---

[1] "Mufredatu" Rragib.

[2] Tefsiri "El Mijzan" dhe tefsiri "Fi Dhilalil Kur'an", në ajetin në diskutim.

[3] Shih; ajetet 134-135 të sures "El A'raf"' ajetin 5 të sures "Es Sebe", ajetin 11 të sures "El Xhathije", ajetin 59 të sures "El Bekare", ajetin 162 të sures "El A'raf", si dhe ajetin 34 të sures "El Ankebut".

Komentues të tjerë pohojnë se fjalët "*rixhzun*" dhe "*rixhsun*", e cila është në kuptimin e "*ndyrësisë*", janë sinonime.[1]

Këto tri kuptime, edhe pse ndryshojnë nga njëra-tjetra, kanë lidhje të ngushtë mes tyre. Megjithatë, ajeti ka kuptim të gjerë dhe gjithëpërfshirës, i cili shënon çdo lloj devijimi, çdo lloj shmangieje nga Rruga e Drejtë, çdo vepër të ndyrë dhe të shëmtuar, si dhe çdo veprim që bëhet shkak për zemërimin dhe dënimin e All'llahut në këtë botë dhe Botën Tjetër.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, para profetësisë, u shmangej dhe qëndronte larg këtyre çështjeve. Historia e jetës së tij, të cilën e pranojnë dashamirësit dhe armiqtë e Islamit, është dëshmi për këtë. Por këtu është theksuar si një parim themelor në udhën e ftesës drejt Zotit dhe si një model e shembull për të gjithë.

Në urdhrin e katërt deklarohet: **"Mos jep gjë, me synimin që të marrësh më shumë…"**.

Përsëri kemi të bëjmë me një kuptim të përgjithshëm dhe të gjerë të ajetit, lidhur me ndalimin e mburrjes dhe të lakmisë. Ky kuptim i përgjithshëm përfshin çdo lloj mburrje. Ai thekson se nuk duhet t'i mburresh askujt dhe as All'llahut, as kur bën xhihad dhe përpjekje në Rrugën e Tij, sepse është Ai që është treguar bujar ndaj teje dhe të ka dhuruar këtë pozitë të lartë.

Gjithashtu, lutjet, adhurimet dhe veprat e tua të mira mos i konsidero si të shumta, por veten gjithnjë shikoje në kufirin midis

[1] Në tefsirin e Fakhru Rrazij ky kuptim është përmendur si një mundësi, vëll. 30 f. 193.

"neglizhencës" dhe "gabimit" dhe adhurimin konsideroje për vete si një lloj mirësie të madhe nga ana e All'llahut.

Thënë ndryshe, nuk duhet t'i kërkosh mirënjohje All'llahut, për shkak të përpjekjes dhe paralajmërimit të njerëzve, për shkak të përhapjes së monoteizmit dhe të sqarimit të madhështisë së All'llahut, për shkak të mbajtjes së rrobave pastër dhe largimit nga çdo lloj mëkati. Përkundrazi, duhet t'i konsiderosh si dhurata të çmuara nga ana e All'llahut dhe për këtë ta falënderosh Atë, pra, t'i jesh mirënjohës All'llahut për këtë fakt. Prandaj, zhytu dhe thellohu shumë në dashurinë e All'llahut Tënd dhe këto begati dhe mirësi, këto vepra të rëndësishme t'i llogarisësh si të papërfillshme.

Gjithashtu, nëse i bën një shërbim një njeriu, qoftë dhe në aspektin shpirtëror, si përhapja e fesë islame dhe udhëzimi në Rrugën e Drejtë, qoftë në aspektin material, si dhënia për hir të All'llahut dhe ofrimi i ndihmës për të tjerët, asnjëherë nuk duhet të mburresh për këto veprime, ose të presësh kompensim, sepse mburrja i prish veprat e mira dhe i asgjëson ato: **"O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja me të krenuar e me ofendim, siç bën ai që e jep pasurinë e vet sa për sy e faqe të njerëzve..."**.[1]

Fjala *"la temnunu"* rrjedh nga fjala *"min'net"*. Në raste të tilla është përdorur me kuptimin e *"fjalës së thënë"* dhe tregon rëndësinë e begatisë (të të mirës materiale) që njeriu ia ka dhënë një njeriu tjetër. Këtu bëhet e qartë dhe lidhja e saj me çështjen e *"istiktharit"* (të kërkimit më shumë), sepse, nëse njeriu shërbimin e vet e konsideron si të papërfillshëm, nuk pret të shpërblehet për të e as të kërkojë shpërblim dyfish. Në këtë mënyrë, kërkimi i mirënjohjes

[1] Sure "El Bekare", ajeti 264.

dhe i mburrjes është burim i *"istiktharit"* (i kërkimit më shumë). Ky veprim zhduk që në rrënjë vlerën e veprës së dobishme.

Në disa hadithe është transmetuar se kuptimi i ajetit është ky: *"Mos i jep një gjë tjetrit, me synimin që të pretendosh të marrësh dyfishin e saj!"*.[1] Ky është shpjegim i njërit prej kuptimeve të shumta të ajetit.

Në një hadith tjetër nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, për komentimin e këtij ajeti, lexojmë: *"Veprën e mirë, të cilën e kryen për hir të All'llahut, asnjëherë mos e konsidero si shumë."*.[2] Edhe ky është shpjegim për njërin prej degëve nga ky kuptim i gjerë i këtij ajeti.

Në ajetin në vijim, përmendet urdhri i pestë që është dhe urdhri i fundit: **"Dhe për hir të Zotit tënd, duro."**.

Siç shihet, ajeti ka kuptim të gjerë, që përmbledh durimin, këmbënguljen dhe qëndresën.

Konteksti i gjerë i këtij kuptimi, tregon se në rrugën e kryerjes së këtij misioni të madh, duhet të tregohesh i durueshëm, të durosh karshi ngacmimeve të politeistëve, të armiqve injorantë dhe të paditur. Në rrugën e përuljes me bindje ndaj urdhrit të All'llahut, duhet të tregohesh i qëndrueshëm, ashtu siç duhet të jesh i durueshëm edhe në përballjen me egon (armikun e brendshëm) dhe në sheshin e luftës me armikun e jashtëm.

Durimi dhe qëndresa janë themeli i të gjitha programeve të kaluara. Parimisht, durimi dhe rezistenca janë kapitali më i

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 454; tefsiri "Burhan", vëll. 4, f. 400.

[2] Po aty.

rëndësishëm i rrugës së përhapjes së Islamit dhe udhëzimit në Rrugën e Drejtë, prandaj dhe Kur'ani, shumë herë, është bazuar dhe është mbështetur në këtë, pikërisht për këtë arsye.

Në thëniet e Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Bëhuni të durueshëm, ngaqë durimi për besimin është si koka për trupin dhe siç nuk ka gjë të mirë në trupin pa kokë, nuk ka të mirë as në besimin pa durim."*.[1]

Prandaj dhe një prej koncepteve më të rëndësishme të Profetëve dhe njerëzve të All'llahut, ishte durimi dhe qëndresa. Me sa më shumë ngjarje të mundimshme dhe probleme të përballeshin, aq më shumë rritej dhe durimi i tyre.

Në një hadith nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për shpërblimin e durimtarëve, lexojmë: *"All'llahu deklaron se në kohën që njërin prej robëve të Mi e degdis me ndonjë fatkeqësi në trup, mall, pasuri, apo në fëmijë dhe ai i përballon ato, pra, tregohet i durueshëm, turpërohem që në Ditën e Gjykimit ta vë atë në peshoren e veprave, ose ta hap librin e veprave të tij."*.[2]

Në vazhdimësi të urdhrit për ngritjen dhe paralajmërimin, që u diskutuan në ajetet e mëparshme, në këto ajete paralajmërimin e shpreh në mënyrë shumë të theksuar dhe shumë të qartë: **"Kur të fryhet në Sur, ajo do të jetë një ditë e rëndë. Për jobesimtarët nuk do të jetë aspak e lehtë."**.

Duhet të bëjmë kujdes se fjala *"nakur"*, e cila rrjedh nga fjala *"nakrun"* është përdorur me kuptimin e trokitjes që çon gjer në

[1] "Nehxhul Belaga", "Fjalë të zgjedhura", Fjala 82.

[2] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 29, f. 120.

hapjen e vrimës; fjala *"minkarun" - "sqepi i zogjve"*, që është mjet i gjuajtjes për të hapur vrimën në sende, është marrë nga ky kuptim. Mbi këtë ngjashmëri, tromba, zëri i të cilës thuajse e shpon veshin e njeriut dhe hyn thellë në tru, është quajtur *"nakur"*.

Nga ajetet kur'anore kuptohet më së miri se në fund të botës dhe në fillim të Ringjalljes do t'i fryhet dy herë Surit, pra, do të dëgjohen dy zëra, që janë jashtëzakonisht të tmerrshëm dhe tronditës. Zëri i parë është i vdekjes, kurse zëri i dytë i Ringjalljes dhe i jetës, që kaplon anembanë botën. Këta zëra ndryshe janë quajtur "fryerja e surit të parë" dhe "fryerja e surit të dytë". Ajeti në fjalë, aludon në "fryerjen e dytë", pra, që ringjallja do të fillojë me të dhe do të jetë një ditë e rëndë dhe e vështirë për jobesimtarët.[1]

Ajetet e lartpërmendura, dëshmojnë se, me fryerjen e Ringjalljes, problemet e jobesimtarëve do të zbulohen njëri pas tjetrit. Ajo është një ditë tejet e ashpër, e frikshme, e cila do të gjunjëzojë dhe njerëzit më të fuqishëm.

[1] Në lidhje me fryerjen e Surit dhe mënyrën e fryerjes së tij, më gjerësisht kemi diskutuar në ajetin 68 të sures "Ez Zumer".

Ajetet 11 - 17

ذَرْنِي وَمَنْ خَلَقْتُ وَحِيدًا١١ وَجَعَلْتُ لَهُ مَالًا مَمْدُودًا١٢ وَبَنِينَ شُهُودًا١٣
وَمَهَّدْتُ لَهُ تَمْهِيدًا١٤ ثُمَّ يَطْمَعُ أَنْ أَزِيدَ١٥ كَلَّا إِنَّهُ كَانَ لِآيَاتِنَا عَنِيدًا١٦
سَأُرْهِقُهُ صَعُودًا١٧

"Më ler Vetëm (të merrem) **me atë që e krijova."**

"Dhe i dhashë pasuri të pamatë."

"E djem pranë vetes!"

"Unë ia bëra kamjen të lehtë e të shtruar."

"E, megjithatë, ai lakmon që t'i jap më tepër. "

"Jo, kurrsesi! Vërtet, ai i mohoi me kryeneçësi Shpalljet Tona."

"Prandaj Unë do ta ngarkoj atë me dënime të rënda."

Shkaku i zbritjes

Për këto ajete janë përmendur dy shkaqe zbritjesh:

1- Kurejshët ishin mbledhur në Daru En Nedvetu (një qendër në afërsi të Mesxhidul Haramit). Aty mblidheshin për t'u këshilluar për çështje të rëndësishme. Ata i pa Veijd ibn Mugijretu, i cili ishte një prej burrave të shquar të Mekës dhe politeistët besonin në urtësinë e tij. Ata këshilloheshin me të për çështje të rëndësishme. Një herë ai u kthye nga të pranishmit dhe u tha: "Bashkojini thëniet tuaja! Ju jeni një populli i zgjuar dhe inteligjent, me prejardhje fisnike. Arabët, nga të gjitha anët, vijnë drejt jush (për të vizituar Qaben dhe gjëra të tjera), dëgjojnë përgjigje të ndryshme nga ju, prandaj bashkohuni të gjithë në një mendim të përbashkët.".

Më pas, duke qenë i kthyer në drejtim të tyre, vazhdoi: "Çfarë mendimi keni në lidhje me këtë burrë?" (duke treguar Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.).

Ata pohuan: "Do themi që është poet!".

Velijdi, me fytyrë të vrenjtur dhe i pakënaqur, tha: "Ne kemi dëgjuar shumë poezi dhe poema, por fjalët e tij nuk kanë ngjashmëri me poezinë.".

Ata thanë: "Do të themi që është orakull!".

Ai tha: "Kur jeni në prani të tij, në fjalët e tij nuk vëreni fjalë që i thonë orakujt, që gjoja parashikojnë të ardhmen.".

Ata thanë: "Do të deklarojmë që është i çmendur!".

Velijdi tha: "Po të jeni afër tij, nuk vëreni asnjë shenjë çmendurie tek ai.".

Ata thanë: "Themi që është magjistar.".

Ai u përgjigj: "Magjistar, në ç'kuptim?".

Ata thanë: "Njeri që në mes të armiqve dhe në mes të shokëve krijon armiqësi.".

Ai tha: "Po, ai është 'magjistar' dhe vepron në këtë mënyrë!", sepse disa prej tyre, pasi bëhen myslimanë, e ndajnë rrugën e tyre me të tjerët.

Pasi dolën nga Darun Nedve çdokush që e takonte Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i thërriste: "O magjistar! O magjistar!".

Kjo çështje e shqetësoi tej mase Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Në këtë kohë, All'llahu i Madhëruar ia Shpalli ajetet e para të kësaj sureje dhe ajetet e lartpërmendura, deri tek ajeti 25 dhe e ngushëlloi Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

2- Disa komentues të tjerë kanë thënë se, kur zbritën ajetet e sures "El Gafir", Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* po qëndronte në këmbë në Mesxhidul Haram dhe Velid ibn Mugijre (personi i lartpërmendur), ishte aty afër dhe dëgjonte këndimin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e vuri re praninë e tij, e përsëriti këndimin e këtyre ajeteve.

Velijdi, pasi erdhi në tubimin e popullit të tij, të fisit të Beni Makhzumit, tha: "Betohem në All'llah, që pak më parë nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dëgjova një fjalë që nuk ngjason as me fjalën e njerëzve dhe as me fjalën e xhindeve. Fjalët e tij kanë një shije të veçantë, bukuri dhe freski të posaçme, degët e të cilës janë plot fruta, kurse rrënjët e saj janë të forta dhe të qëndrueshme. Fjalët e tij janë thënie që e kapërcejnë çdo thënie tjetër dhe asnjë tjetër nuk e kapërcen atë!".

E tha këtë dhe u kthye në shtëpi. Kurejshët iu drejtuan njëri-tjetrit: "Betohemi në All'llah, ai është magjepsur me fenë e Muhammedit dhe ka hequr dorë nga feja jonë dhe do t'i devijojë të gjithë kurejshët." .Velijdin e quanin "trëndafili i kurejshëve".

Ebu Xhehli tha: "Unë do ta zgjidh këtë punë.". Ndërkohë me fytyrë të mërzitur erdhi te Velidi.

Velijdi e pyeti: "Djali i vëllait tim, pse je i trishtuar!?".

Ai i tha: "Kurejshët po të përgojojnë dhe mendojnë se ti i ke stolisur fjalët e Muhammedit.

Ai u ngrit dhe së bashku me Ebu Xhehlin erdhën dhe iu bashkuan kuvendit të popullit.

Ai iu drejtua atyre: "A mendoni ju se Muhammedi është një njeri i çmendur?".

Ata thanë: "Jo.".

Ai i pyeti: "A mendoni se ai është një faltar, orakull?".

Thanë: "Jo.".

"Mendoni se është poet? A e keni parë ndonjëherë të thurë vjersha?"

Përgjigjja e parë ishte negative.

"A mendoni se është një gënjeshtar? Vallë a keni dëgjuar në të kaluarën ndonjë gënjeshtër nga ai?"

Thanë: "Jo. Ai në praninë tonë, para pretendimit ndaj profetësisë, njihej si "njeriu më besnik" (më i sinqertë).

Këtu kurejshët iu drejtuan Velijdit: "Atëherë, sipas teje, si ta quajmë atë?".

Velijdi, pasi ndaloi për një çast dhe reflektoi, me fytyrë të vrenjtur tha: "Ai është vetëm një magjistar. A nuk e keni vërejtur

që krijon ndarje mes burrit dhe familjes, mes fëmijëve dhe shokëve? (ka ndodhur që një grup i ka besuar atij dhe janë ndarë nga familjet e tyre). Kështu që ai është një magjistar dhe çfarë e nxjerr nga goja nuk është gjë përveç magji interesante!".[1]

Komentimi

Velijdi, një pasanik mendjemadh dhe mosmirënjohës

Në vazhdimësi të ajeteve të kaluara, që ishin paralajmërim për të gjithë jobesimtarët në përgjithësi, në serinë e re të ajeteve, fokusi është veçanërisht mbi disa njerëz, të cilët patën më tepër ndikim. Kur'ani, nëpërmjet shprehjeve të qarta, elokuente dhe të ashpra, i paralajmëron për dënime të rënda.

Ajeti 11 thotë: **"Më ler Vetëm** (të merrem) **me atë që e krijova."**.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 386. Këtë shkak të zbritjes e kanë përmendur dhe shumë komentues të tjerë të Kur'anit, si p.sh: Kurtubij, Maragij, Fakhru Rrazij dhe Tabatabai në El Mizan etj...

Ashtu siç e diskutuam edhe kur folëm për shkakun e zbritjes, ky ajet dhe ajeti në vijim, kanë zbritur për Velijd ibn Mugijretu, i cili ishte prej njerëzve të shquar të fisit kurejsh.

Fjala *"uahiden"* - **"vetëm"**, ka mundësi të jetë përshkrim për Krijuesin, ose për krijesën. Në rastin e parë, ekzistojnë dy mendime:

I pari: "Më lër Vetëm Mua me atë, që ta ndëshkoj ashpër.".

I dyti: "Unë Vetë e krijova atë dhe ia dhashë gjithë këto begati dhe mirësi, por ai u tregua mosmirënjohës.".

Për rastin e dytë ekzistojnë dy mundësi: e para, ka gjasa të tregojë se njeriu, që në barkun e nënës dhe gjatë lindjes, është i vetëm, nuk ka as pasuri dhe as fëmijë dhe të gjitha këto ia dhurova më vonë.

Pra, mundësia nënkupton se ai veten e vet e konsideronte *"vahidun"* (person që ishte unik në mesin e arabëve) dhe ishte i njohur me epitetin e gjatë: "Unë jam një njeri unik, fëmija i unikut. Në mesin e arabëve nuk ekziston ndonjë i ngjashëm me mua, as me babain tim.".[1] Kjo çështje mund të jetë përmendur si një përqeshje në ajetin në fjalë.

[1] Tefsiri i "Fakhru Rrazij"; "Keshshaf"; "Meragij", dhe "Kurtubij". Sipas disa transmetimeve, për ajetin në fjalë, përftohet se fjala *"vehid"* është në kuptimin e fëmijës pa prind dhe fëmijës të lindur jashtë martese, por në këto hadithe nuk ekziston asnjë dëshmi që të jetë komentimi i ajetit të lartpërmendur. Përveç kësaj, nëse e analizojmë me kujdes, bëhet e qartë se ky kuptim nuk përputhet me ajetin e lartpërmendur.

Por mes këtyre katër interpretimeve, i pari është më i përshtatshëm.

Ajeti 12, shton: **"Dhe i dhashë pasuri të pamatë."**.

Fjala *"el memdudu"* është përdorur me kuptimin e "zgjatjes". Këtu është në kuptimin e zgjerimit të pasurisë së tij, apo zgjerimit, për nga pikëpamja e kohës dhe e hapësirës.

Disa komentues kanë thënë se pasuria e tij ishte e madhe dhe e gjerë. Ai kishte shume toka të mbjella, kishte shumë deve e kuaj, saqë mbushnin hapësirën mes Mekës dhe Ta'ifit.

Disa të tjerë kanë treguar se ai kishte pemëtore dhe fusha, ku, pa mbaruar drithërat e njërit, piqeshin drithërat e tokës tjetër. Përveç kësaj, kishte njëqind mijë dinarë flori. E gjithë kjo pasuri është përmbledhur në fjalën *"memdudun"*.

Pas kësaj, përmendet shtimi i forcës së tij njerëzore: **"E djem pranë vetes."**.

Djemtë e tij gjithnjë ishin të gatshëm t'i ofronin ndihmë dhe t'i shërbenin atij. Ata u bënë shkak i rehatisë së tij. Ata asnjëherë nuk e ndienin veten të detyruar, që të ndërmerrnin udhëtime të gjata, për plotësimin e nevojave jetësore, sepse babai i tyre do të ndiente dhimbjen e ndarjes, të vetmisë dhe të largësisë. Sipas disa transmetimeve, thuhet se ai kishte dhjetë djem.

Më pas, në mënyrë të përgjithshme, ka përmendur të mirat e tjera që ia ka dhuruar atij: **"Unë ia bëra kamjen të lehtë e të shtruar."**.

Jo vetëm mirësi dhe fëmijë të fortë dhe të fuqishëm, por edhe plot begati dhe mirësi.

Fjala *"et temhijdu"* rrjedh nga fjala *"mehdun"* dhe është përdorur me kuptimin e vendit, të cilin e përgatisin enkas për fëmijë të vegjël (djepin dhe ngjashëm me të). Më pas është përdorur për çdo lloj mjeti të rehatisë, të përparimit, pozicionit dhe pozitës së lartë shoqërore. Pra, në përgjithësi, ka një kuptim të gjerë, i cili përfshin lloje të ndryshme të të mirave të jetesës dhe mjete të përparimit dhe arritjes së suksesit.

Por ai, në vend që për të gjithë këto begati dhe mirësi, të tregohej i përulur dhe mirënjohës, u tregua mosmirënjohës dhe lakmitar. Ai kërkonte më shumë se ç'kishte: **"Megjithatë, ai lakmon që t'i jap më tepër."**.

Kjo nuk i përkiste vetëm Velid Ibn Mugijres, por të gjithë adhuruesit e kësaj bote janë të tillë. Atyre asnjëherë nuk u shuhet lakmia. Ata janë të pangopshëm.

Ajeti në vijim, me gjithë ashpërsinë e vet, përpiqet ta bindë këtë lloj njeriu dhe thotë: **"Jo, kurrsesi! Vërtet, ai i mohoi me kryeneçësi Shpalljet Tona."**.

Edhe pse ishte në dijeni të plotë që Kur'ani nuk është fjalë e xhindit dhe as fjalë e njeriut, përsëri atë e quante "magji" dhe komunikuesin e tij "magjistar".

Fjala *"el anijdu"* që rrjedh nga fjala *"i'nad"*, sipas disa komentuesve, përdoret me kuptimin e një lloj kundërshtimi dhe armiqësie, që bëhet me vetëdije. Pra, njeriu e percepton të vërtetën e një gjëje shumë qartë, por e kundërshton me vetëdije atë. Velidi është një shembull i qartë i këtij kuptimi.

Fjala *"kane"* tregon që urrejtja e tij ndaj të vërtetës ishte një çështje e vazhdueshme dhe konstante, jo e përkohshme dhe e kalueshme.

Në përfundim, në ajetin 17, me anë të një shprehjeje të shkurtër, por tepër domethënëse, tregon fatin e tmerrshëm të tij dhe deklaron: **"Unë do ta ngarkoj atë me dënime të rënda."**.

Fjala *"se urhikuhu"* rrjedh nga fjala *"el irhaku"* dhe është përdorur me kuptimin: *"mbulim i një gjëje me dhunë"*, por është përdorur edhe me kuptimin: *ngarkim i veprave të vështira dhe me llojlloj dënimesh.*

Fjala *"es saudu"* tregon një vend, prej të cilit ngjiten lart, kurse fjala *"su'ud"* tregon *"ngjitjen lart"*.

Duke pasur parasysh që të ngjiturit nëpër majat e larta, është një gjë shumë e vështirë dhe e rëndë, kjo fjalë përdoret për çdo vepër të vështirë dhe të mundimshme. Kështu që disa komentues, këtë e kanë komentuar në kuptimin e dënimit hyjnor.

Komentues të tjerë kanë pretenduar që *"saudu"* është një mal prej zjarri në Xhehennem. Velijdin e detyrojnë t'i ngjitet atij mali. Kanë thënë se ky mal është i pakalueshëm, sepse sa herë që dikush përpiqet të ngjitet lart, rrëshqet dhe bie poshtë dhe ky veprim përsëritet gjithnjë.

Ekziston edhe mundësia që ajeti të jetë tregues për dënimin e Velijdit në këtë botë, sepse ashtu siç e dëshmon edhe historia, ai, pasi arriti në kulmin e pushtetit në jetën individuale dhe shoqërore,

pësoi aq shumë rënie, saqë gjer në fund të jetës vazhdimisht e humbte pasurinë dhe fëmijët. Në fund ngeli i mjeruar.[1]

Ajetet 18 – 25

إِنَّهُۥ فَكَّرَ وَقَدَّرَ١٨ فَقُتِلَ كَيْفَ قَدَّرَ١٩ ثُمَّ قُتِلَ كَيْفَ قَدَّرَ٢٠ ثُمَّ نَظَرَ٢١ ثُمَّ عَبَسَ وَبَسَرَ٢٢ ثُمَّ أَدْبَرَ وَاسْتَكْبَرَ٢٣ فَقَالَ إِنْ هَٰذَا إِلَّا سِحْرٌ يُؤْثَرُ٢٤ إِنْ هَٰذَا إِلَّا قَوْلُ الْبَشَرِ٢٥

[1] Tefsiri "El Meragij", vëll. 29, f. 131.

"Ai mendoi dhe kurdisi (kundër Kur'anit)**."**

"Dhe qoftë mallkuar, si kurdisi!"

"Dhe sërish qoftë mallkuar, si kurdisi!"

"Pastaj vështroi rreth vetes."

"Mblodhi vetullat e u vrenjt.",

"Pastaj u kthye i kapardisur."

"Dhe tha: 'Ky (Kur'an) **nuk është gjë tjetër, veçse magji e trashëguar!'"**

"Këto janë vetëm fjalë të një vdekatari!"

Komentimi

Vdekja qoftë mbi të, çfarë kurthi të mallkuar kurdisi!

Në këto ajete janë dhënë më shumë shpjegime për Velijdin. All'llahu i kishte dhënë atij shumë pasuri dhe fëmijë, por ai u ngrit kundër Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pra, për Velijd ibn Mugijretu Mekhzumij thuhet se ai mendoi se me çfarë gjëje të akuzonte Profetin dhe

Kur'anin. Në mendjen e vet planifikoi gjithçka në lidhje me këtë: **"Ai mendoi dhe kurdisi** (kundër Kur'anit)**."**.

Është e qartë se mendimi dhe reflektimi mbi një çështje, është një vepër e pëlqyeshme, por me kusht që të jetë në Rrugën e Drejtë. Ndonjëherë, një orë mendim apo reflektim ka vlerën e një viti adhurim, madje sa një jetë e tërë, sepse një orë meditim dhe mendim ka mundësi të ndryshojë në tërësi fatin e njeriut. Por në qoftë se mendimi dhe reflektimi është në rrugën e politeizmit, të shkatërrimit, të korrupsionit, të djallëzisë, është i qortueshëm dhe i kritikueshëm. Mendimi i Velijdit i përkiste këtij lloji.

Fjala *"kad'dere"* rrjedh nga fjala *"takdirun"* dhe tregon përgatitjen e një çështje dhe marrjen e vendimit për realizimin e asaj thurjeje të ligë.

Më pas, për qortimin e tij, thotë: **"Qoftë mallkuar, si kurdisi!"**.

Më pas, për ta ritheksuar atë, shton: **"Dhe sërish qoftë mallkuar, si kurdisi!"**.

Ky ajet nënkupton edhe shkakun e zbritjes së ajetit, para zbritjes së të cilit, Velijdi dëshironte që politeistët të ishin të gjithë një mendje dhe të ngriheshin të gjithë njëzëri kundër Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kur ia propozuan që Profetin ta quanin "poet", nuk e pranoi, më pas propozuan nofkën "falltar" dhe përsëri nuk ra dakord. Pas kësaj iu propozua epiteti "i çmendur", por edhe këtë nuk e pëlqeu.

Më në fund vendosën ta quanin "magjistar". Këtë propozim e pranoi, sepse, sipas imagjinatës së tij, efekti i magjisë ndante dy

miq dhe krijonte miqësi mes dy kundërshtarëve, gjë që u shfaq me ardhjen e Islamit dhe të Kur'anit.

Meqenëse ky kurth u sajua, pasi e studiuan situatën, Kur'ani e përmend me shprehjen domethënëse *"fek'kere ue ked'dere"*. Në këtë mënyrë, edhe pse ishte propozim nga të tjerët, u pranua nga Velijdi.

Kjo fjali, e cila përsëritet, tregon se ai kishte shumë mendime djallëzore.

Më pas shton: **"Pastaj vështroi rreth vetes"**, pra, vendosi të rishqyrtonte edhe një herë atë që kishte kurdisur në mendjen e vet, që të ishte plotësisht i sigurt dhe i bindur për çdo gjë, deri në detaje.

Pas kësaj thotë: **"Mblodhi vetullat e u vrenjt, pastaj u kthye i kapardisur dhe tha: 'Ky** (Kur'an) **nuk është gjë tjetër, veçse magji e trashëguar! Këto janë vetëm fjalë të një vdekatari!'"**.

Ky Kur'an është vetëm fjalë e popullit dhe nuk ka asnjë lidhje me Shpalljen hyjnore.

Në këtë mënyrë, pas një studimi të vazhdueshëm të këtij mendimi djallëzor, ai dha variantin e vet përfundimtar, në lidhje me kundërshtimin e Kur'anit dhe të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Por, me gjithë djallëzitë e tij, ky mendimtar i shquar i periudhës së injorancës dhe politeizmit, pa qenë i vetëdijshëm, i bëri një lavdërim dhe admirim të jashtëzakonshëm Kur'anit me përfundimin e tij. Ai pohoi qartë se Kur'ani ka një tërheqje të jashtëzakonshme, një mënyrë që pushton zemrën e çdo qenieje njerëzore dhe, siç shprehet vetë ai, në të ekziston një ndikim magjik, që i magjeps zemrat e njerëzve.

Dihet botërisht se Kur'ani nuk ka asnjë lloj ngjashmërie me magjitë e magjistarëve, por është fjalë logjike, ritmike dhe e mirëkonstruktuar. Kjo tregon se Kur'ani nuk është fjalë e njeriut, por buron nga një Shpallje qiellore, përtej botës njerëzore, buron nga dija e pafundme e All'llahut, i Cili ka mbledhur të gjitha bukuritë dhe i sinkronizon mrekullisht, duke krijuar një kohezion të brendshëm të përkryer.

Fjala *"abese"* rrjedh nga fjala *"ubus"* dhe është përdorur me kuptimin e fytyrës së vrenjtur, kurse fjala *"abus"* nënkupton personin që është i vrenjtur.

Fjala *"besere"* rrjedh nga fjala *"besur"* dhe *"besr"*. Ndonjëherë është përdorur me kuptimin e nxitimit në kryerjen e një pune, pa i arritur koha e duhur, ndonjëherë tjetër është përdorur me kuptimin e fytyrës së vrenjtur dhe të prishur.

Në ajetin që po diskutojmë, kuptimi i dytë përputhet me fjalën *"abese"*, kurse kuptimi i parë, tregon një konfuzion dhe vendimmarrje të nxituar për të përzgjedhur një "nofkë" të padrejtë ndaj dikujt, e në këtë rast, ndaj Kur'anit.

Fjala *"ju'ther"* rrjedh nga fjala *"el etheru"* dhe është përdorur me kuptimin e një thënieje, që është transmetuar nga të parët, si dhe vepra të mbetura prej tyre. Ka disa komentues, që mendojnë se kjo fjalë rrjedh nga fjala *"el ijtharu"* dhe përdoret me kuptimin e pëlqimit dhe të përzgjedhjes.

Sipas kuptimit të parë, Velijdi thotë se ky Kur'an është një magji e ngjashme me magjitë që janë transmetuar nga të parët. Sipas kuptimit të dytë, ai shprehet se është një magji, e cila, përmes

ëmbëlsisë së saj, tërheq dhe ndikon në zemrat e njerëzve. Njerëzit e pëlqejnë atë dhe i japin përparësi mbi çdo gjë tjetër.

Sidoqoftë, ky është një pranim i nënkuptuar për mrekullinë e Kur'anit, sepse Kur'ani nuk ka asnjë lloj ngjashmërie me punët e jashtëzakonshme të magjistarëve. Kur'ani është një fjalë e këndshme dhe me strukturë të qëndrueshme. Kur'ani është një fjalë e mbushur plot me ndjeshmëri shpirtërore dhe ka një forcë të madhe tërheqëse dhe ndikim të pashembullt. Në qoftë se, sipas thënies së Velijdit, do të ishte fjalë e njeriut, edhe njerëz të tjerë do të kishin mundësi të sillnin një Kur'an të ngjashëm me këtë. Ndërkohë, ne jemi në dijeni se Kur'ani, shumë herë, ka sfiduar për t'u përballuar me të, por asnjë prej armiqve të betuar të Islamit, të cilët kishin talent të jashtëzakonshëm në gjuhën arabe, nuk mundi të sillte një të ngjashëm me të, madje as fjalë në një nivel më të ulët se Kur'ani nuk sollën dot. Ky është kuptimi i mrekullisë!

Ajetet 26 – 30

سَأُصْلِيهِ سَقَرَ ﴿٢٦﴾ وَمَا أَدْرَاكَ مَا سَقَرُ ﴿٢٧﴾ لَا تُبْقِي وَلَا تَذَرُ ﴿٢٨﴾ لَوَّاحَةٌ لِلْبَشَرِ ﴿٢٩﴾
عَلَيْهَا تِسْعَةَ عَشَرَ ﴿٣٠﴾

"Do ta hedh në Sekar (Xhehennem)**!"**

"E si mund ta dish ti tamam se çfarë është Sekari?"

"Ai nuk lë gjë dhe nuk kursen asgjë."

"Lëkurat i shkrumbon."

"Atij i rrinë roje nëntëmbëdhjetë (engjëj)**."**

Komentimi

Ky është fati i tij ogurzi

Në vazhdim të ajeteve të lartpërmendura, të cilët treguan gjendjen e një prej udhëheqësve politeistë dhe fjalët e tij në lidhje me mohimin dhe refuzimin e Kur'anit të Madhërishëm dhe të misionit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, këtu do të flitet për dënimet e tmerrshme që do t'i përjetojë në Kiamet.

Ajeti thotë se së shpejti do ta hedh atë në Xhehennem dhe do ta djeg me zjarrin e Xhehennemit: **"Do ta hedh në Sekar** (Xhehennem)**!"**.

Fjala *"sakar"* rrjedh nga fjala *"sakr"* dhe është përdorur me kuptimin e transformimit dhe të shkrirjes së diçkaje nën efektet e rrezatimit diellor. Më pas, me këtë fjalë është emëruar një prej emrave të Xhehennemit dhe kjo fjalë është përsëritur shumë herë

në Kur'an. Përzgjedhja e këtij emri është aludim për dënimet e tmerrshme të Xhehennemit, që përfshijnë banorët e tij. Disa komentues të tjerë, këtë fjalë e kanë konsideruar si emri i një prej kateve dhe venduljeve trishtuese të Xhehennemit.

Më pas, për të vënë në pah madhështinë dhe ashpërsinë e dënimit të ferrit, ajeti shton: **"E si mund ta dish ti tamam se çfarë është Sekari?"**.

Ky ajet tregon se dënimi është aq i rëndë, sa as imagjinata e njeriut nuk është në gjendje ta perceptojë, ashtu siç nuk perceptohet as vlera e begative të Xhennetit dhe madhështia e tyre.

"Ai nuk lë gjë dhe nuk kursen asgjë..."

Kjo fjali ka mundësi të tregojë fuqinë e zjarrit të Xhehennemit, krahasuar me zjarrin e kësaj bote, i cili nuk e ka atë forcë tmerruese e shkatërrimtare si zjarri i Xhehennemit.

Disa komentues të tjerë, kanë thënë se me këtë tregohet se banorët e Xhehennemit as nuk vdesin dhe as nuk mbesin të gjallë. Ata gjithnjë ndodhen mes vdekjes dhe jetës, ashtu siç deklarohet në ajetin 13 të sures "El A'la": **"Dhe aty as nuk do të vdesë, as nuk do të jetojë!"**.

Komentues të tjerë mendojnë se shënon faktin se zjarri i Xhehennemit nuk lë as lëkurë në trup, as mish apo kocka të shëndosha. Prandaj kuptimi i ajetit nuk tregon se zjarri i Xhehennemit i djeg ata krejtësisht dhe i zhduk, sepse ky kuptim nuk përputhet me atë që është deklaruar në suren "En Nisa", në ajetin 56: **"... sa herë që u digjen lëkurat e tyre, ne ndërrojmë lëkura të tjera që të shijojnë dënimin..."**.

Më pas, duke e përshkruar me një cilësi tjetër këtë zjarr përvëlues dhe zemërimin Hyjnor, ajeti shton se lëkura e trupit të njeriut, e cila është e dukshme për njerëzit nga një largësi shumë e madhe, ndryshon komplet: **"Lëkurat i shkrumbon."**.

Ai zjarr i nxin fytyrat e tyre dhe bëhen më të errëta se sa nata e errët.

Fjala *"besher"* është shumësi i fjalës *"beshretu"* dhe nënkupton lëkurën e dukshme mbi trup. Ka mundësi të tregojë edhe njerëzit.

Fjala *"leuahetun"* rrjedh nga fjala *"leuhun"*, e cila ndonjëherë është përdorur me kuptimin e ekspozimit dhe të shfaqjes. Edhe kjo, ndonjëherë, përdoret me kuptimin e ndryshimit dhe të transformimit.

Sipas kuptimit të parë, komentimi i ajetit do të ishte i tillë: Xhehennemi bëhet i dukshëm për njerëzit nga një largësi e madhe. Kjo thuhet dhe në ajetin 36 të sures "En Naziat": **"Xhehennemi shfaqet sheshazi për atë që e sheh."**.

Sipas kuptimit të dytë, interpretimi i ajetit do të ishte i tillë: Ferri e ndryshon në tërësi lëkurën e trupit të njeriut.

Në ajetin 30, deklarohet: **"Atij i rrinë roje nëntëmbëdhjetë** (engjëj)**."**.

Këta engjëj nuk janë urdhëruar për të treguar mëshirë, keqardhje apo dashuri. Këta engjëj janë përgjegjës për ndëshkim, dënim dhe dhunë.

Edhe pse në këtë ajet është përmendur vetëm numri nëntëmbëdhjetë dhe nuk është specifikuar se janë engjëjt e dënimit, nga ajeti në vijim mësojmë se ky numër tregon numrin e përgjegjësve për engjëjt e dënimit.

Komentues të tjerë pohojnë se përmendja e numrit 19 nënkupton 19 grupe engjëjsh dhe jo nëntëmbëdhjeta veta dhe fjalinë: **"...ushtrinë e Zotit tënd nuk e di kush, përveç Atij."**, që është përmendur në ajetin në vijim, e konsiderojnë si një dëshmi për këtë kuptim.

Përse numri nëntëmbëdhjetë është përzgjedhur për të treguar përgjegjësit e Xhehennemit? Këtë saktësisht askush nuk e di. Disa komentues kanë propozuar se në numrin nëntëmbëdhjetë gjendet numri më i madh i numrave tek, numri nëntë dhe numri më i vogël i dhjetësheve, numri dhjetë.

Disa të tjerë kanë thënë se ky numër është përdorur për shkak se rrënjët e vesit dhe të moralit të keq u referohen nëntëmbëdhjetë huqeve të dukshme dhe të padukshme. Duke u nisur dhe nga fakti që secili nga huqet është një prej faktorëve të dënimit të All'llahut, katet e Xhehennemit gjithsej janë nëntëmbëdhjetë, plotësisht sipas numrit të veseve dhe në çdo kat ka një engjëll, apo një grup prej engjëjve, të cilët janë përgjegjës për dënimin.

Në thelb, çështjet, që kanë të bëjnë me Kiametin, siç janë Xhenneti, Xhehennemi, hollësirat dhe karakteristikat e tyre, nuk janë të qarta saktësisht për ne njerëzit, të cilët jetojmë në një mjedis të kufizuar tokësor, prandaj në hadithe është transmetuar, se secili

nga këto nëntëmbëdhjetë engjëj ka një fuqi madhështore, saqë fare lehtë mund ta hedhin në ferr një fis të madh.

Nga këtu bëhet e qartë dhe mendjelehtësia dhe pafuqia mendore e njerëzve të tillë, që mendojnë si Ebu Xhehli, i cili, kur e dëgjoi këtë ajet, duke u tallur, u kthye në drejtim të fisit kurejsh dhe u tha: "Nënat tuaja të ulen dhe t'u vajtojnë ju. A nuk e dëgjoni këtë njeri (duke treguar Profetin Muhammed), çfarë është duke thënë?! Thotë se rojtarët e Xhehennemit janë nëntëmbëdhjetë veta. Por ju jeni një grup i madh, i përbërë nga njerëz trima. Vallë, a nuk është mundur, që dhjetë veta nga ju ta mposhtin njërin prej tyre?".

Ebul Esed El Xhemhij, një prej njerëzve të fuqishëm të kurejshëve, u ngrit dhe tha: "Unë jam në gjendje të dal përballë shtatëmbëdhjetëve prej tyre dhe ju përballuni me dy të tjerë!".[1]

Këta mendjelehtë dëshironin që me këto tallje, të parandalonin dritën e të vërtetës dhe ta shpëtojnë veten nga eliminimi i patjetërsueshëm i tyre.

Hulumtim

Nëntëmbëdhjetë engjujt e dënimit

Në ajetet e lartpërmendura, u bë e qartë se numri i përgjegjësve të Xhehennemit është nëntëmbëdhjetë, përkatësisht nëntëmbëdhjetë ushtri, ose nëntëmbëdhjetë grupe. Në ajetet në

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 388, si dhe tefsire të tjera.

vijim, gjithashtu, do të flitet rreth të njëjtës çështjeje. Por i çuditshëm është fakti që disa prej sekteve të devijuara këmbëngulin në shenjtërimin e këtij numri, madje përpiqen që numri i muajve të vitit dhe numrin e ditëve të muajve, krejt përkundër rregullave natyrore dhe kozmike, t'i marrin dhe t'i sistemojnë në bazë të numrit nëntëmbëdhjetë. Gjithashtu, edhe praktikat e tyre i kanë përcaktuar në përputhje me të.

Më i çuditshëm është fakti se një shkrimtar, i cili mbase është i lidhur me organizatën e tyre, këmbëngul në mënyrë të çuditshme dhe qesharake, që çdo gjë rreth Kur'anit ta shpjegojë në bazë të numrit nëntëmbëdhjetë, por ky numër i preferuar i tij, në shumë raste, nuk përputhet me faktet (realitetet) e ajeteve ekzistuese në Kur'an. Ai shton apo pakëson diçka, sipas dëshirës së vet, derisa llogaritë e tij të përputhen me numrin nëntëmbëdhjetë, ose me shumëzimet e numrit nëntëmbëdhjetë.

Për shkak se trajtimi i rasteve të tilla, do të konsiderohej humbje kohe, ne nuk kemi ndërmend të merremi me ta.

Ajeti 31

وَمَا جَعَلْنَا أَصْحَابَ النَّارِ إِلَّا مَلَائِكَةً وَمَا جَعَلْنَا عِدَّتَهُمْ إِلَّا فِتْنَةً لِلَّذِينَ كَفَرُوا لِيَسْتَيْقِنَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ وَيَزْدَادَ الَّذِينَ آمَنُوا

إِيمَانًا وَلَا يَرْتَابَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ وَالْمُؤْمِنُونَ وَلِيَقُولَ الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ مَرَضٌ وَالْكَافِرُونَ مَاذَا أَرَادَ اللَّهُ بِهَذَا مَثَلًا كَذَلِكَ يُضِلُّ اللَّهُ مَنْ يَشَاءُ وَيَهْدِي مَنْ يَشَاءُ وَمَا يَعْلَمُ جُنُودَ رَبِّكَ إِلَّا هُوَ وَمَا هِيَ إِلَّا ذِكْرَى لِلْبَشَرِ[٣١]

"Ne kemi bërë rojtarë të zjarrit vetëm engjëjt dhe numrin e tyre e kemi bërë sprovë (objekt polemikash) **për jobesimtarët, me qëllim që të binden ata që u është dhënë Libri e t'u shtohet besimi atyre që besojnë; që të mos dyshojnë ata që u është dhënë Libri dhe besimtarët e vërtetë dhe që të thonë ata që kanë sëmundjen e dyshimit në zemër dhe mosbesimtarët: 'Ç'ka dashur të thotë All'llahu me këtë shembull?'. Kështu, All'llahu lë në humbje atë që do dhe çon në Rrugë të Drejtë atë që do. Askush tjetër, përveç Tij, nuk e di numrin e ushtrisë së Zotit tënd. Ky është vetëm një përkujtesë për njerëzit."**

Komentimi

Për çfarë është numri i përgjegjësve të zjarrit?

Ashtu siç e diskutuam edhe në ajetet e kaluara, All'llahu i Madhëruar përmend numrin nëntëmbëdhjetë si numrin e

përgjegjësve të Xhehennemit (ose si numrin e nëntëmbëdhjetë grupeve të tyre). Po ashtu lexuam se përmendja e këtij numri, u bë shkak i bisedës mes politeistëve dhe jobesimtarëve. Disa prej tyre e konsideruan si objekt talljeje dhe numrin e vogël të tyre e menduan si argument që mposhtja e tyre nuk është një punë shumë e vështirë.

Ajeti në fjalë është dhe ajeti më i gjatë i kësaj sureje. Ai u përgjigjet atyre, si dhe sjell më shumë fakte në lidhje me këtë çështje.

Në fillim thotë: **"Ne kemi bërë rojtarë të zjarrit vetëm engjëjt..."**.[1]

Engjëj të fortë dhe të fuqishëm. Në bazë të Kur'anit, përdorimi i fjalëve *"giladh"* dhe *"shidad"*, pra, *"të ashpër"* dhe *"të rreptë"*, është bërë për të treguar se të gjithë mëkatarët janë të dobët dhe të pafuqishëm përballë tyre.

Më pas, ajeti shton: **"...dhe numrin e tyre e kemi bërë sprovë** (objekt polemikash) **për jobesimtarët..."**.

Kjo sprovë ishte në dy aspekte: Së pari, ata talleshin, duke ironizuar zgjedhjen e numrit nëntëmbëdhjetë, ndërkohë që çfarëdo numri tjetër që do të përcaktohej, përsëri do të ishin tallur edhe me atë.

[1] Shprehja *"as'habu en nari"*, është përmendur shpesh në Kur'an. Në të gjitha rastet është në kuptimin e banorëve të Xhehennemit, me përjashtim të ajetit në fjalë, që është në kuptimin e "rojtarëve të zjarrit".

Nga ana tjetër, këtë numër e konsideronin të vogël dhe, duke u tallur, thoshin se përballë çdo njërit prej tyre, do të vendosnin dhjetë veta prej tyre, në mënyrë që t'i mposhtnin.

Ndërkohë që engjëjt e All'llahut janë të atillë që, sipas Kur'anit, një numër i vogël prej tyre ishte ngarkuar me shkatërrimin e popullit të Lutit dhe shkatërruan qytetet e banuara prej tyre. Përveç kësaj, përzgjedhja e numrit nëntëmbëdhjetë për rojtarët e zjarrit ka sekrete, të cilat u përmendën te shënimet e ajeteve të lartpërmendura.

Kur'ani përsëri shton: **"...me qëllim që të binden ata që u është dhënë Libri..."**. Në një hadith thuhet se një grup nga jehudët (çifutët), pyetën disa nga shokët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për numrin e përgjegjësve të zjarrit, sepse Zoti dhe lajmëtari i tij janë më të informuar. Në atë moment zbriti Xhebraili dhe e informoi Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "*Mbi të janë (përgjegjës) nëntëmbëdhjetë.*".[1]

Ata nuk e kundërshtuan këtë çështje. Kjo do të thotë se atë e konsideruan në përputhje me librin e tyre dhe iu shtua besimi ndaj Profetësisë së të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Po kjo çështje u bë shkak që besimtarët të bëhen më të fortë në besimin dhe bindjen e tyre.

Kështu që në fjalinë në vijim, shton: **"...t'u shtohet besimi atyre që besojnë..."**.

[1] Këtë hadith e kanë transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: Bejhakij, Ibn ebi Hatim dhe Ibn Merdeuije. (Tefsiri "Meragij", vëll. 29, f. 234.)

Menjëherë pas përmendjes së kësaj fjalie, i rikthehet atyre tri qëllimeve, për t'i theksuar ato dhe sërish i kthehet çështjes së besimit të njerëzve të Librit, besimtarëve. Në fund, sprovës së politeistëve dhe jobesimtarëve dhe thotë: **"...Të mos dyshojnë ata që u është dhënë Libri dhe besimtarët e vërtetë dhe që të thonë ata që kanë sëmundjen e dyshimit në zemër dhe mosbesimtarët: 'Ç'ka dashur të thotë All'llahu me këtë shembull?'..."**.

Për cilët persona flet ajeti në fjalinë e parë, kur thotë: **"ata që kanë sëmundjen e dyshimit në zemër dhe mosbesimtarët"**? Disa komentues kanë deklaruar se në këtë fjali flitet për "hipokritët", sepse në ajetet kur'anore, kjo shprehje është përmendur për ata. Këtë e lexojmë dhe në ajetin e dhjetë të sures "El Bekare", ku flitet rreth hipokritëve. Në atë ajet thuhet: **"Në zemrat e tyre kanë sëmundje, e All'llahu u shton sëmundje edhe më shumë.".**

Ky është një argument që vërteton se ajeti i lartpërmendur është medinas, sepse grupi i hipokritëve u shfaq në kohën e forcimit të Islamit në Medine e jo në Mekë.

Shqyrtimi i rasteve të përmendjes së kësaj fjalie në ajetet kur'anore, tregon se kjo fjali nuk i përket vetëm hipokritëve, por të tillë janë konsideruar të gjithë politeistët, të cilët kishin urrejtje, armiqësi dhe kryeneçësi ndaj ajeteve kur'anore. Madje, ndonjëherë përmendet se pas hipokritëve, ka gjasa që kjo të jetë argument edhe për diferencimin midis tyre. P.sh, në ajetin 49 të sures "El Enfal", lexojmë: **"Kur hipokritët dhe ata që në zemrat e tyre kishte sëmundje,** (dyshime)**, thanë: 'Këta myslimanët i ka mashtruar feja e tyre...'"** dhe po kështu thuhet edhe në ajete të tjera të ngjashme.

Si përfundim, mund të themi se nuk ekziston ndonjë argument që mohon përkatësinë mekase të këtij ajeti. Veç të tjerash, ky ajet ka një përputhshmëri dhe harmoni të plotë me ajetet pararendëse, të cilat duken se janë mekase. Në favor të këtij argumenti, ka edhe disa dëshmi të tjera.

Në vazhdim të bisedimeve rreth mënyrës se si ndikojnë Fjalët e All'llahut te besimtarët dhe politeistët me zemër të sëmurë, ajeti shton: **"...Kështu, All'llahu lë në humbje atë që do dhe çon në Rrugë të Drejtë atë që do."**.

Fjalia e lartpërmendur na e tregon se ky vullnet hyjnor, që udhëzon disa dhe devijon disa të tjerë, nuk është e privuar nga llogaria. Ata, me zemër të sëmurë dhe kryeneçë, nuk meritojnë gjë tjetër përveç llogarisë, kurse ata që i janë përulur urdhrit të All'llahut dhe janë besimtarë, meritojnë një udhëzim të tillë.

Në fund të ajetit thuhet: **"Askush tjetër, përveç Tij, nuk e di numrin e ushtrisë së Zotit tënd. Ky është vetëm një përkujtesë për njerëzit."**.

Fakti që u përmend numri nëntëmbëdhjetë për rojtarët e zjarrit, nuk do të thotë se ushtria e All'llahut kufizohet me këtë numër. Ushtria e Tij është shumë e madhe. Disa transmetime tregojnë se rojtarët e zjarrit kanë mbushur gjithë tokën dhe qiellin. Madje thuhet se nuk ekziston asnjë vend në botë, që të mos ketë një engjëll që i lutet dhe e madhëron All'llahun.

Komentuesit e Kur'anit kanë dhënë mendime të ndryshme, se kujt i referohet përemri "*hije*" në fjalinë "*ue ma hije il'la dhikra lil besher*".

Disa kanë thënë se i referohet "ushtrisë së All'llahut" dhe një grup prej tyre janë rojtarë të zjarrit. Ka të tjerë që mendojnë se i referohet Sakarit, pra, vet Xhehennemit. Të tjerë komentues kanë pohuar se është tregues për ajetet e Kur'anit të Madhërishëm.

Këto mendime janë rrjedhojë e ndërgjegjësimit, e zgjimit dhe e njohjes, por mendimi i parë duket më i përshtatshëm, sepse tregon se All'llahu ka zgjedhur për Vete një ushtri. Ky fakt nuk do të thotë se All'llahu Vetë nuk ka mundësi t'i ndëshkojë të gjithë mëkatarët dhe gjynahqarët. Kjo ushtri e engjëjve është për këshillë e për ndërgjegjësim, për zgjim dhe kushtim të vëmendjes ndaj seriozitetit të çështjes së dënimit hyjnor.

Hulumtim

Numri i ushtrisë së All'llahut

Prania e All'llahut në çdo vend, përhapja e fuqisë së Tij në të gjithë universin, Esenca e Pastër e Tij, e bën të panevojshëm të ketë ndonjë ndihmës, mbështetës apo ushtri. Megjithëkëtë, për t'ua treguar krijesave madhështinë e Vet, për ndërgjegjësimin e tyre, ka zgjedhur ushtri të madhe për Vete, e cila është zbatuese e urdhrit të Tij anembanë botës.

Në hadithet islame janë përdorur shprehje të ndryshme dhe madhështore për numrin e madh, për madhështinë dhe fuqinë e

ushtrisë së All'llahut, por dëgjimi i tyre për ne është i pamundur, sepse nuk përputhet me perceptimet tona të zakonshme.

Këtu do të mjaftohemi me fjalën madhështore dhe shumë domethënëse që Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* e ka përmendur për këtë çështje, në Fjalimin e parë, në veprën "Nehxhul Belaga", ku thotë: "*Pastaj All'llahu krijoi hapësirat mes qiejve të lartë dhe i mbushi me lloje të ndryshëm engjëjsh. Disa prej tyre janë lëshuar përmbys dhe nuk kthehen në pozitën e gjunjëzimit. Të tjerët janë në gjunjë dhe nuk ngrihen në këmbë. Disa prej tyre qëndrojnë në radhë dhe nuk e ndërrojnë pozitën e tyre. Të tjerët vazhdimisht madhërojnë All'llahun dhe nuk lodhen. Ata nuk i këput as gjumi i syrit, as gabimi i mendjes, as molisja e trupit, as efekti i harresës.*

Në mesin e tyre ndodhen rojtarët besnikë të Shpalljeve të All'llahut dhe transmetuesit e porosive të Profetëve të Tij. Ndodhen edhe ata që i mbartin andej e këndej urdhrat dhe vendimet e Tij. Në mesin e tyre ndodhen edhe mbrojtësit e krijesave të Tij, edhe rojtarët e dyerve të kopshteve të Xhennetit. Në mesin e tyre ndodhen edhe ata, këmbët e të cilëve janë të ngulura në tokë, kurse qafat u zgjaten në qiej. Gjymtyrët e tyre dalin në të gjitha anët, shpinat e tyre puthiten me shtyllat e Fronit Hyjnor, para të cilit shikimi është i lëshuar dhe nën të cilin, krahët e tyre janë të ulur dhe mes vetes dhe gjithë të tjerëve kanë shtrirë velin e famës dhe perden e fuqisë. Ata nuk mendojnë mbi Krijuesin e vet përmes shëmbëlltyrës, nuk i përshkruajnë cilësi të krijuara, nuk e kufizojnë Atë në ndonjë vendbanim dhe nuk rrëfejnë për Të përmes interpretimeve.".[1]

Ashtu siç e kemi diskutuar edhe më përpara, fjala "*melek*" ka një kuptim dhe domethënie të gjerë, i cili përfshin edhe engjëjt

[1] "Nehxhul Belaga", fjalimi i parë.

mendjeqartë, inteligjentë, të bindur dhe të nënshtruar dhe prej forcave dhe fuqive të botës.

Për këtë çështje kemi dhënë një shpjegim më të detajuar në komentimin e ajeteve të para të sures "El Fatir".

Ajetet 32 – 37

كَلَّا وَالْقَمَرِ ٣٢ وَاللَّيْلِ إِذْ أَدْبَرَ ٣٣ وَالصُّبْحِ إِذَا أَسْفَرَ ٣٤ إِنَّهَا لَإِحْدَى الْكُبَرِ ٣٥
نَذِيرًا لِلْبَشَرِ ٣٦ لِمَنْ شَاءَ مِنْكُمْ أَنْ يَتَقَدَّمَ أَوْ يَتَأَخَّرَ ٣٧

"Kurrsesi! Betohem për Hënën."

"Për natën që largohet."

"E për agimin që zbardhëllon."

"Se ai (Xhehennemi) **është vërtet një nga fatkeqësitë më të mëdha."**

"Paralajmërim për njerëzit."

"Për ata nga ju që dëshirojnë të ecin përpara (me vepra të mira) **ose të kthehen mbrapsht** (me vepra të këqija)**."**

Komentimi

Në vazhdim të bisedës me mohuesit e profetësisë së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të Ringjalljes, në këto ajete do të flasim për betime të shumta, për theksimin e çështjeve të Kiametit, të Ringjalljes, të Xhehennemit dhe ndëshkimit në Atë Botë.

Ajeti 32 thotë se nuk është kështu siç pretendojnë ata. All'llahu betohet për Hënën: **"Kurrsesi! Betohem për Hënën"**.

Fjala *"kel'la"* është lidhëz mohuese dhe përdoret për mohimin e një thënie që biseduesi e ka përmendur më përpara. Ndonjëherë përdoret edhe për mohim të thënies vijuese. Në këtë rast, sipas dëshmisë së ajeteve të kaluara, mohon mendimin e idhujtarëve, të cilët ishin mohues të Xhehennemit dhe të dënimit në të dhe talleshin me numrin e engjëjve përgjegjës të zjarrit të Xhehennemit.

Betimi për Hënën, bëhet sepse hëna është një prej shenjave të mëdha hyjnore, si për nga pikëpamja e krijimit, e rrotullimit të rregullt dhe e dritës së bukurisë, ashtu edhe për ndryshimet graduale që pëson. Ajo është një kalendar i gjallë për përcaktimin e ditëve.

Më pas, ajeti vazhdon betimin: **"Për natën që largohet e për agimin që zbardhëllon."**.

Në realitet, këto tri betime janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën dhe plotësuese të njëra-tjetrës, sepse e dimë se Hëna shfaqet gjatë natës dhe drita e saj zbehet gjatë ditës, sepse mbulohet nga drita e Diellit. Por kjo nuk përbën asnjë rëndësi.

Nata sjell qetësi dhe është koha e lutjes dhe e ngashërimit të të dashurve të All'llahut. Nata tërhiqet në pritje të mëngjesit, të agimit dhe të lindjes së diellit. Lindja e diellit është momenti më i bukur dhe më tërheqës. Ai sjell gëzim dhe lumturi në zemrën e çdo njeriu.

Këto betime janë të tri lloje dhe kanë një përshtatshmëri me dritën e udhëzimit të Kur'anit, flakin tutje errësirat e politeizmit, të idhujtarisë dhe zbardhin monoteizmin, agimin e ditës së re.

Pasi tregon se këto betime janë të tri lloje, përmend shkakun, pse kryhet betimi: **"Se ai** (Xhehennemi) **është vërtet një nga fatkeqësitë më të mëdha."**.

Pa dyshim që ngjarjet e frikshme dhe trishtuese të Kiametit, të Xhehennemit dhe të engjëjve të dënimit, janë prej çështjeve të rëndësishme.

Përemri te *"in'neha"*, ose ka të bëjë me *"sakar"* - *"Xhehennemin"*, ose me *"xhunudun"*, pra, me ushtrinë e All'llahut, ose me tërësinë e ngjarjeve të Kiametit. Gjithsesi, madhështia e saj është e qartë.

Më pas, shton: **"Paralajmërim për njerëzit."**.

Paralajmëron dhe i informon të gjithë për dënimin e frikshëm që i pret mëkatarët, politeistët dhe armiqtë e të Vërtetës.

Në fund, për ta theksuar më shumë çështjen, ajeti 37 thotë: **"Për ata nga ju që dëshirojnë të ecin përpara** (me vepra të mira) **ose të kthehen mbrapsht** (me vepra të këqija)**."**.

Çdokush që "ecën përpara", me vepra të mira, ka zgjedhur për vete lumturinë dhe çdokush që kthehet mbrapsht, me vepra të këqija, ka zgjedhur për vete fatkeqësinë dhe mjerimin.

Disa komentues kanë pohuar se me këtë ajet, ose synohet përparësia e shpirtit njerëzor dhe përsosmëria e tij, ose synohet devijimi dhe kthimi mbrapsht i tij.

Kuptimi i parë dhe i tretë duken më të përshtatshëm, kurse komentimi i dytë nuk përputhet dhe aq shumë.

Ajetet 38 – 48

كُلُّ نَفْسٍۭ بِمَا كَسَبَتْ رَهِينَةٌ٣٨ إِلَّآ أَصْحَٰبَ ٱلْيَمِينِ٣٩ فِى جَنَّٰتٍ يَتَسَآءَلُونَ٤٠ عَنِ ٱلْمُجْرِمِينَ٤١ مَا سَلَكَكُمْ فِى سَقَرَ٤٢ قَالُوا۟ لَمْ نَكُ مِنَ ٱلْمُصَلِّينَ٤٣ وَلَمْ نَكُ نُطْعِمُ ٱلْمِسْكِينَ٤٤ وَكُنَّا نَخُوضُ مَعَ ٱلْخَآئِضِينَ٤٥ وَكُنَّا نُكَذِّبُ بِيَوْمِ ٱلدِّينِ٤٦ حَتَّىٰٓ أَتَىٰنَا ٱلْيَقِينُ٤٧ فَمَا تَنفَعُهُمْ شَفَٰعَةُ ٱلشَّٰفِعِينَ٤٨

"Çdo njeri është peng i veprave të veta."

"Përveç njerëzve të krahut të djathtë."

"Të cilët në kopshtet e Xhennetit pyesin njëri-tjetrin."

"Për keqbërësit."

"Çfarë ju ka sjellë në Sekar?"

"Ata do të përgjigjen: 'Nuk ishim nga ata që falnin namaz.'"

"Dhe as prej atyre që i ushqenin të varfrit."

"Ne lëshoheshim në biseda të kota me llafazanët."

"Dhe mohonim Ditën e Llogarisë."

"Derisa na erdhi vdekja."

"Prandaj, kurrfarë ndërmjetësimi i cilitdo ndërmjetësuesi nuk do t'i ndihmojë ata."

Komentimi

Ju, pse jeni prej banorëve të Xhehennemit?

Në vazhdim të ajeteve të lartpërmendura, ku u diskutua për Xhehennemin dhe banorët e tij, ajeti 38 shton: **"Çdo njeri është peng i veprave të veta."**.

Fjala *"rahijnetun"* rrjedh nga fjala *"rehnun"* dhe është përdorur me kuptimin *"peng"*. Zakonisht është si një garanci që e japin kundrejt "huasë". Për analogji, thuajse e gjithë ekzistenca e njeriut është peng i realizmit të kësaj përgjegjësie dhe detyrimi. Në kohën që e kryen atë, ndihet i lirë, në të kundërt, do të ngelet peng i robërimit.

Nga disa thënie të leksikografëve, nënkuptohet, që njëri kuptim i fjalës *"rehnun"* është shoqërimi dhe ndërvarja.[1] Sipas këtij sqarimi, kuptimi i ajetit do të ishte: Të gjithë janë bashkë me veprat e tyre, qofshin të mira, qofshin të këqija.

Por, sipas ajeteve që vijojnë, interpretimi i parë është më i përshtatshëm.

Prandaj ajeti 39 menjëherë thotë: **"Përveç njerëzve të krahut të djathtë."**.

[1] "Lisanul Arab", lënda *"rehnun"*.

Njerëzit e krahut të djathtë janë besimtarë dhe kryejnë vepra të mira, prandaj do të futen në Xhennet, pa dhënë llogari.

Po fjalia: *"es'habul jemijni"*, ç'kuptim ka në këtë ajet? Komentuesit e Kur'anit thonë se kjo është çështje diskutimi.

Komentues të tjerë thonë se kjo fjali tregon se njerëzve të krahut të djathtë do t'u jepet libri i veprave të kryera nga dora e djathtë.

Disa të tjerë e kanë pranuar se ajo fjali tregon edhe njerëzit besimtarë, të cilët, në mënyrë absolute, nuk kanë kryer mëkat, edhe disa të tjerë, si engjëjt e All'llahut. Por ka edhe komentime të tjera.

Nga ajetet e ndryshme kur'anore dëshmohet se kuptimi i parë është më i pranueshëm. Pra, ata janë persona që besojnë (në All'llahun) dhe kanë kryer vepra të mira. Mund të kenë kryer edhe pak mëkate. Ata janë nën ndikimin e veprave të tyre të mira dhe në bazë të rregullit "Veprat e mira i zhdukin veprat e liga", veprat e tyre të këqija mbulohen nga veprat e mira dhe, ose hyjnë në Xhennet pa dhënë llogari, ose, nëse u kërkohet llogari, do të jetë shumë e lehtë dhe e thjeshtë. Kjo deklarohet edhe në ajetet 7-8 të sures "El Inshikak": **"E për sa i përket atij që Libri i vet i jepet nga e djathta, ai do të llogaritet me një llogari të lehtë."**.

Kurtubij, komentues i njohur i Ehli Synetit, në komentimin e këtij ajeti, nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)*, transmeton: *"Ne dhe shiat (ndjekësit) tanë jemi 'es'habul jemin' dhe çdokush që e kundërshton Ehli Bejtin, është peng i veprave të veta."*.[1]

[1] Tefsiri "Kurtubij", vëll. 10, f. 6878.

Këtë hadith e kanë transmetuar dhe komentues të tjerë në ajetin në fjalë, si komentuesi Bejan në "Mexhmaul Bejan" dhe autori i tefsirit "Nuruth Thekalejn".

Më pas, ajeti sqaron kuptimin e fjalisë: *"es'habul jemijni"* dhe grupin përballë tyre dhe shton: **"Të cilët në kopshtet e Xhennetit pyesin njëri-tjetrin për keqbërësit: 'Çfarë ju ka sjellë në Sekar?'"**.

Nga këto ajete mësojmë se marrëdhënia mes banorëve të Xhennetit dhe të Xhehennemit nuk shkëputet plotësisht. Banorët e Xhennetit, nga hapësira e tyre, arrijnë ta shohin se në ç'gjendje janë banorët Xhehennemit dhe të bashkëbisedojnë me ata.

Tani, le të shohim se si i përgjigjen kriminelët *"es'habul jemijn"*. Në përgjigjen e tyre ata pohojnë katër mëkatet e veta të mëdha.

Në fillim thonë: **"Ata do të përgjigjen: 'Nuk ishim nga ata që falnin namaz.'"**. Nëse do të falnin namaz, namazi do të ishte shkak për rikujtim të Zotit dhe do t'i parandalonte nga punët e liga dhe të shëmtuara, si dhe do t'i udhëzonte në Rrugën e Drejtë.

Së dyti, **"As prej atyre që i ushqenin të varfrit."**.

Ushqimi i të varfërve, edhe pse në dukje nënkupton dhënien e ushqimit, ka një kuptim më të gjerë, që përfshin çdo lloj ndihme për plotësimin e nevojave të domosdoshme të nevojtarëve dhe të vobektëve, përfshirë këtu ushqimin, veshmbathjen, strehimin e të tjera.

Ashtu siç e kanë përshkruar dhe komentuesit e Kur'anit, synimi i ajetit është "zekati i obligueshëm", sepse heqja dorë prej dhënies në Rrugën e All'llahut, e cila është një vepër e pëlqyeshme

te All'llahu, nuk mund të jetë shkak për shkuarjen në Xhehennem. Ky ajet rithekson edhe një herë tjetër, këtë çështje, se detyrimi për të dhënë zekatin ishte përcaktuar edhe në Mekë, edhe pse caktimi i detajeve dhe i sasisë së domosdoshme dhe mbledhja (depozitimi) e tij në thesarin shtetëror, u bë në Medine.

Më pas ajeti shton: **"Ne lëshoheshim në biseda të kota me llafazanët."**.

Në çdo qoshe dhe në çdo vend, ngrinim zërin kundër të Vërtetës. Në çdo tubim bëhej thirrje kundër Rrugës së Drejtë dhe ne ishim në dijeni për këtë, por prapë i shoqëronim ata dhe bëheshim pjesë e asaj shoqërie dhe atyre tubimeve, vërtetonim fjalët e tyre dhe quanim të drejtë përgënjeshtrimin dhe mohimin e tyre, ndjenim kënaqësi dhe gëzim nga përqeshjet dhe talljet e tyre ndaj të vërtetës.

Fjala *"nekhudhu"* rrjedh nga fjala *"khaudhun"* dhe është përdorur me kuptimin e futjes në ujë dhe lëvizjes në të. Më pas është përdorur dhe në kuptimin e futjes në dhè. Në Kur'anin Famëlartë, zakonisht përdoret në kuptimin e hyrjes në çështje të gabuara dhe pa themel.

Togfjalëshi *"zhytje në gabim"* ka një kuptim dhe domethënie të gjerë. Ai nënkupton edhe hyrjen në tubimet e individëve, të cilët i përqeshin ajetet e All'llahut, edhe ata që bëjnë thirrje kundër Tij, ose bëjnë përhapjen e risive në fe, ose tallen në mënyrë të neveritshme, ose mburren me mëkatet që kanë kryer dhe ndihen krenarë apo ndiejnë kënaqësi gjatë tregimeve të tyre. Po ashtu, përfshin pjesëmarrjen në tubime ku bëhet përgojimi, akuzimi, tallja dhe të ngjashme me to. Por, ajeti në diskutim, më shumë ka për synim tubimet që organizohen për të përhapur politeizmin,

idhujtarinë, dobësimin e fesë së All'llahut, përqeshjen dhe talljen e personave të shenjtë.

Më pas, ajetet 46-47 shtojnë: **"Dhe mohonim Ditën e Llogarisë, derisa na erdhi vdekja."**.

Mohimi i Ringjalljes dhe i Ditës së Llogarisë dëmton dhe zhvlerëson të gjitha vlerat hyjnore dhe morale, e shtyn njeriun drejt kryerjes së mëkateve.

Nga këto ajete përftohet se jobesimtarët dhe politeistët, ashtu siç janë përgjegjës për parimet themelore të fesë, po ashtu janë dhe përgjegjës për çështjet dytësore (praktike) të saj.

Gjithashtu, bëhet e qartë se këto katër çështje, d.m.th. namazi, zekati, heqja dorë nga pjesëmarrja në tubime të njerëzve të falsitetit dhe besimi në Ditën e Kiametit, kanë një rol të rëndësishëm dhe të jashtëzakonshëm në udhëzimin dhe edukimin e njeriut. Në këtë mënyrë, Xhehennemi nuk është vend i falësve të sinqertë dhe të vërtetë, i atyre që japin zekatin, i atyre që nuk marrin pjesë në tubimet e devijuara dhe besimtarëve në Ditën e Gjykimit.

Sigurisht, namazi është adhurim për All'llahun. Ky adhurim është i parealizueshëm pa besuar në All'llahun, prandaj përmendja e tij është simbol për besimin dhe bindjen ndaj All'llahut, për nënshtrimin ndaj urdhrave të Tij. Mund të themi se këto katër çështje fillojnë nga monoteizmi dhe përfundojnë në Ringjalljen dhe përfshijnë edhe marrëdhënien e njeriut me Krijuesin me krijesat dhe me vetveten.

Mes komentuesve të Kur'anit, është e njohur se me fjalën *"jekin"* synohet *"vdekja"*, sepse konsiderohet një çështje e sigurt për besimtarin dhe jobesimtarin. Njeriu mund të dyshojë në çdo gjë, përveç vdekjes. Për vdekjen nuk ka vend për dyshim. Kjo thuhet në ajetin 99 të sures "Hixhr": **"Adhuroje Zotin tënd ,derisa të vijë ty e vërteta** (vdekja)**."**.

Disa komentues, fjalën *"jekinun"*, në këtë ajet, e kanë përdorur me kuptimin e njohjes që përfiton njeriu pas vdekjes, me njohjen e botës së varrit (ndërmjetme) dhe të Kiametit. Ky shpjegim përputhet disi dhe me komentimin e parë.

Në ajetin 48, përmendet fundi i hidhur i këtij grupi: **"Prandaj, kurrfarë ndërmjetësimi i cilitdo ndërmjetësuesi nuk do t'i ndihmojë ata."**.

Ata nuk do t'i ndihmojë as ndërmjetësimi i Profetëve dhe as i të Dërguarve të All'llahut, as ndërmjetësimi i engjëjve, as i të sinqertëve dhe dëshmorëve dhe as ndërmjetësimi i të drejtëve, sepse ndërmjetësimi ka nevojë për disa kushte. Këto kushte nuk ekzistonin, i kishin zhdukur tërësisht. Ndërmjetësimi është si uji i kulluar, i cili hidhet në rrënjët e një fidani të dobët dhe e ngjall atë. Thënë ndryshe, ashtu siç e diskutuam më sipër, kur folëm për ndërmjetësimin, fjala *"shefaat"* rrjedh nga fjala *"shef'e"* dhe është përdorur me kuptimin e "bashkëngjitjes së një gjëje me një gjë tjetër", prandaj kjo fjalë tregon personin ndërmjetësues, i cili duhet të ketë kaluar vetë një pjesë të rrugës dhe është përshtatur me terrenin e vështirë, prandaj edhe mund ta ndihmojë për të kaluar rrugën e mbetur.[1]

[1] Shih po në këtë tefsir, ajeti 48, sure "El Bekare".

Ajeti në fjalë thekson edhe një herë tjetër çështjen e ndërmjetësimit, zgjerimin dhe shumëllojshmërinë e ndërmjetësuesve përpara All'llahut, si dhe është një përgjigje e fortë për ata që mohojnë ndërmjetësimin.

Ajeti thekson se ndërmjetësimi nuk është i pakushtëzuar, si dhe nuk konsiderohet si dritë jeshile për mëkatin, por është një faktor për edukimin e njeriut, që të arrijë të japë shpresë për ndërmjetësim dhe të mos i ndërpresë marrëdhëniet me All'llahun dhe të Dërguarit e Tij.

Ajeti i lartpërmendur tregon se ndërmjetësimi nuk i sjell ndonjë dobi gjendjes së tyre. Ata nuk do të ndërmjetësojnë, sepse të dashurit e All'llahut nuk kryejnë punë të kota dhe të padobishme.

Hulumtim

Ndërmjetësuesit e Ditës së Gjykimit

Nga ajetet që po diskutojmë, si dhe nga disa ajete të tjera të Kur'anit, përftohet se ndërmjetësuesit në Ditën e Gjykimit janë disa llojesh. Këto transmetime janë të shumta dhe bëjnë të qartë se ndërmjetësuesit në Kiamet do të ndërmjetësojnë vetëm për ata mëkatarë, tek të cilët ekzistojnë kushtet e mëposhtme të ndërmjetësimit:

1- Ndërmjetësuesi i parë është Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Për këtë, në një hadith thuhet se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka deklaruar: "*Unë jam ndërmjetësuesi i parë në Kiamet.*".[1]

2- Të gjithë Profetët janë ndërmjetësues të Ditës së Gjykimit. Në një hadith tjetër, të transmetuar po nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thuhet: "*Profetët do të ndërmjetësojnë për të gjithë ata që, me sinqeritet, dëshmojnë se nuk ka hyjni tjetër, përveç Zotit dhe do t'i nxjerrin nga Xhehennemi.*".[2]

3- Edhe engjëjt janë ndërmjetësues të Ditës së Gjykimit. Këtë e ka transmetuar vetë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ai thotë: "*Atë Ditë, engjëjve, të Dërguarve dhe dëshmorëve, do t'u jepet leja për të ndërmjetësuar.*".[3]

4 , 5 - Imamët e pamëkatshëm, edhe shi'at e tyre do të ndërmjetësojnë. Këtë e ka transmetuar vetë Imam Aliu *(Paqja qoftë*

[1] "Sahih Muslim", vëll. 2, f. 130.

[2] "Musned Ahmed", vëll. 3, f. 12.

[3] "Musned Ahmed", vëll. 5, f. 43.

mbi të!). Ai ka thënë: *"Ne do të ndërmjetësojmë dhe, gjithashtu, miqtë tanë do të jenë në pozitën e ndërmjetësimit."*.[1]

6, 7- Dijetarët, shkencëtarët dhe dëshmorët e rënë në Rrugën e All'llahut, do të ndërmjetësojnë në atë Ditë. Këtë e ka thënë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Në Ditën e Gjykimit, në fillim do të ndërmjetësojnë Profetët, më pas dijetarët dhe pas tyre, dëshmorët."*.

Në një hadith tjetër, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Ndërmjetësimi i dëshmorit pranohet për rreth shtatëdhjetë persona të fisit dhe familjes së vet."*.[2]

Në hadithin tjetër, që e ka transmetuar i ndjeri Al'lame Mexhlisij në "Biharul Enuar", thuhet: "Ndërmjetësimi i tyre pranohet për shtatëdhjetë mijë persona.".[3]

Qoftë numri shtatëdhjetë, qoftë numri shtatëdhjetë mijë, tregon shumësinë dhe për këtë nuk ka ndonjë kontradiktë në transmetime.

8- Edhe Kur'ani do të ndërmjetësojë në Ditën e Gjykimit. Këtë e ka thënë dhe Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* në "Nehxhul Belaga": *"Për atë që Kur'ani ndërmjetëson në Ditën e Gjykimit, ndërmjetësimi i tij për atë person, do të pranohet."*.[4]

---

[1] "El Khisalu i Saduk", vëll. 2, f. 624.

[2] "Sunen ibn Davud", vëll. 2, f. 15.

[3] "Biharul Enuar", vëll. 100, f. 14.

[4] "Nehxhul Belaga", Fjalimi 175.

9- Për ata që e kanë kaluar gjithë jetën në Rrugën e Islamit, lexojmë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Në kohën që njeriu arrin në moshën nëntëdhjetë vjeçare dhe ka ecur në Rrugën e Besimit, Zoti do t'ia falë mëkatet e kaluara dhe të ardhme dhe ndërmjetësimi i tij ndaj familjes së vet do të pranohet."*.[1]

10- Edhe adhurimi do të ndërmjetësojë. Këtë e ka thënë në një hadith Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Agjërimi dhe Kur'ani do të ndërmjetësojnë për njeriun në Ditën e Kiametit."*.[2]

11- Nga disa transmetime thuhet se edhe veprat e mira do të ndërmjetësojë për njeriun në Ditën e Gjykimit.".[3]

12- Interesant është fakti se nga disa transmetime nënkuptojmë se vetë All'llahu i Madhëruar, gjithashtu, do të ndërmjetësojë për mëkatarët. Kjo është transmetuar nga një hadith tjetër i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Në Ditën e Kiametit, do të ndërmjetësojnë Profetët, engjëjt dhe besimtarët. All'llahu do të thotë, se tani ka mbetur ndërmjetësimi Im."*.[4]

Për këtë ekzistojnë shumë transmetime. Ne përmendëm vetëm një pjesë prej tyre.[5]

---

[1] "Musned Ahmed", vëll. 2, f. 89.

[2] "Musned Ahmed", vëll. 2, f. 174.

[3] "Menakib ibn Shehr Ashub", vëll. 2, f. 14.

[4] "Sahih Bukhari", vëll. 9, f. 149.

[5] Për më shumë informacion, referojuni librit "Mefahimul Kur'an", vëll. 4, f. 288-311.

Përsëri po e ritheksojmë se ndërmjetësimi ka nevojë për kushte dhe dispozita dhe pa ato nuk është i mundur. Edhe për një grup prej kriminelëve, ndërmjetësimi i të gjithë ndërmjetësuesve është i padobishëm. Është e rëndësishme që pranuesi (i ndërmjetësimit), po ashtu duhet të ketë aftësinë e pranimit, sepse vetëm prania e ndërmjetësuesit nuk është e mjaftueshme.

(Për këtë çështje kemi diskutuar më shumë në xhuzin e parë të këtij tefsiri, kur diskutuam për temën e ndërmjetësimit.)

Ajetet 49 – 56

فَمَا لَهُمْ عَنِ ٱلتَّذْكِرَةِ مُعْرِضِينَ۝٤٩ كَأَنَّهُمْ حُمُرٌ مُّسْتَنفِرَةٌ۝٥٠ فَرَّتْ مِن
قَسْوَرَةٍۭ۝٥١ بَلْ يُرِيدُ كُلُّ ٱمْرِئٍ مِّنْهُمْ أَن يُؤْتَىٰ صُحُفًا مُّنَشَّرَةً۝٥٢ كَلَّاۖ بَل لَّا

يَخَافُونَ ٱلۡأٓخِرَةَۚ كَلَّآ إِنَّهُۥ تَذۡكِرَةٞۖ فَمَن شَآءَ ذَكَرَهُۥ وَمَا يَذۡكُرُونَ إِلَّآ أَن يَشَآءَ ٱللَّهُۚ هُوَ أَهۡلُ ٱلتَّقۡوَىٰ وَأَهۡلُ ٱلۡمَغۡفِرَةِ

"Atëherë, përse shmangen ata nga këshillimi."

"Sikur të ishin gomerë të egër."

"E të frikësuar që ikin prej luanit?!"

"Vërtet, çdonjëri prej tyre kërkon që t'i jepen shkrime të hapura (nga Zoti)**."**

"Kurrsesi, pasi ata nuk i frikësohen Jetës Tjetër!"

"Në të vërtetë, ky (Kur'an) **është këshillë."**

"Prandaj, kush të dojë, le t'ia vërë veshin!"

"Por atij ia vënë veshin vetëm ata që do All'llahu. Vetëm Ai është i Denjë për t'u pasur frikë dhe vetëm Ai është i Denjë për të falur."

Komentimi

Ikin nga e vërteta si ikën zebra nga luani

Ajetet e lartpërmendura diskutuan për fatin e kriminelëve dhe të banorëve të Xhehennemit. Në këto ajete tregohet qartë paniku dhe frika e këtij grupi kokëfortësh dhe kryeneçësh, të cilët i shmangeshin dëgjimit të së vërtetës dhe çdo lloj këshille.

Ajetet 49-51 thonë: **"Atëherë, përse shmangen ata nga këshillimi sikur të ishin gomerë të egër e të frikësuar që ikin prej luanit?!"**.

Përse largohen nga ilaçi shërues i Kur'anit? Përse vënë dorën e refuzimit mbi kraharorin e mjekut të dhembshur? Me të vërtetë është për t'u habitur!

Fjala *"humurun"* është shumësi i fjalës *"himarun"* dhe tregon gomarin, por këtu nënkuptohet zebra, e cila përpiqet t'u ikë kthetrave të luanit. Kjo fjalë ka një kuptim të gjerë dhe gjithëpërfshirës, që përfshin edhe gomarin e egër dhe kafshën e butë.

Fjala *"kas'ueretun"* rrjedh nga fjala *"kasrun"* (në kuptimin e detyrimit dhe të triumfimit) dhe është një nga emrat e luanit. Disa komentues e kanë pranuar si gjuajtësi apo gjahtari. Por kuptimi i parë është më i përshtatshëm.

Dihet se zebra i frikësohet shumë luanit, madje edhe kur dëgjon zërin e tij, frikësohet shumë, sillet si e çmendur. Kur luani i afrohet një tufe të tyre, ato shpërndahen në mënyrë të çoroditur dhe vrapojnë në çdo drejtim, që çudisin çdo shikues.

Sidoqoftë, ky ajet është një shprehje shumë e qartë dhe elokuente për trishtimin dhe shmangien e politeistëve nga ajetet jetëdhënëse kur'anore. Ata i ka krahasuar me zebrën, e cila është

privuar intelekti. Kjo egërsirë i shmanget çdo gjëje. Ajo nuk pranon as këshilla.

Megjithëse ishin injorantë dhe të painformuar, ishin aq pretendues dhe mendjemëdhenj, sa thoshin: **"Vërtet, çdonjëri prej tyre kërkon që t'i jepen shkrime të hapura** (nga Zoti)**."**.[1]

Kjo ngjan me atë që është thënë në suren "El Isra", në ajetin 93: **"... ose të kesh një shtëpi prej ari, apo të ngjitesh lart në qiell, po ne nuk të besojmë për ngjitjen tënde, derisa të na sjellësh një libër, që ta lexojmë..."**.

Edhe në ajetin 124 të sures "El En'am" deklarohet se ata thonë: **"...kurrsesi nuk e besojmë atë, derisa të mos na jepet edhe neve ngjashëm me atë që u është dhënë të Dërguarve të All'llahut..."**.

Në këtë mënyrë, secili nga ata dëshironte që të ishte prej Profetëve të zgjedhur të All'llahut dhe nga ana e Tij t'u zbriste ndonjë letër enkas për ta, me emrin e secilit. Por edhe sikur All'llahu t'u zbriste ndonjë letër, ata përsëri nuk do të besonin.

Në disa transmetime, thuhet se Ebu Xhehli, së bashku me një grup nga kurejshët, thanë: "O Profet, ne nuk do të të besojmë ty, derisa të na sjellësh një letër nga qielli me titull: 'Në emër të All'llahut, kjo letër i dërgohet filan njeriu, të birit të filanit dhe në të të urdhërohet zyrtarisht që ne të të besojmë ty.'".[2]

---

[1] Fjala *"suhufun"* është shumësi i fjalës *"sahifetun"* dhe nënkupton një letër që e dërgojnë sa në një anë në një tjetër (thelbi i fjalës *"suhufun"* dhe *"sahifetun"* është në kuptimin e një gjëje të gjerë, p.sh. si fytyra). Më pas është përdorur në kuptimin e letrës dhe të librit.

[2] Tefsiri "El Kurtubij", tefsiri "El Meragij" dhe tefsire të tjera.

Kërkesa që t'u zbriste një libër qiellor dhe çështje të tjera të ngjashme me këto, nuk janë gjë tjetër, përveçse justifikime të tyre: **"Kurrsesi, pasi ata nuk i frikësohen Jetës Tjetër!"**.

Në qoftë se ata do t'i frikësoheshin ndëshkimit të Botës Tjetër, nuk do të kishin sjellë kaq shumë justifikime dhe alibi, nuk do të përgënjeshtronin Profetin e All'llahut, nuk do të talleshin me ajetet kur'anore, si dhe numrin e engjëjve rojtarë të dënimit nuk do t'i merrnin si objekt talljeje.

Në këto ajete tregohet se besimi në Ringjallje ndikon në devotshmërinë e njeriut, në qëndrimin larg mëkatit, si dhe në pastrimin nga lloje të ndryshme të mëkateve të mëdha.

Besimi në Ringjallje, besimi në shpërblimin dhe ndëshkimin në Kiamet i dhuron njeriut një personalitet të ri. Edhe njeriun egoist e të devijuar nga Rruga e Drejtë, arrogant dhe shtypës, e shndërron në një njeri të besueshëm, të devotshëm, të nënshtruar, të përulur dhe të drejtë.

Më pas, në Kur'an thekson edhe një herë tjetër: **"Në të vërtetë, ky** (Kur'an) **është këshillë, prandaj, kush të dojë, le t'ia vërë veshin! Por atij ia vënë veshin vetëm ata që do All'llahu."**.

Për këtë fjali janë bërë disa interpretime. Interpretimi **i parë** sqaron se njeriu nuk mund të ndjekë Rrugën e Udhëzimit, pa qenë i nënshtruar dhe i mbështetur te All'llahu, pa kërkuar ndihmën e Tij.

Sigurisht, kjo ndihmesë hyjnore zbret në mjedise të favorshme.

Së dyti, fjalia: **"Prandaj, kush të dojë, le t'ia vërë veshin!"**, ka mundësi të jetë përdorur për të treguar se çdo gjë varet nga vullneti i njeriut. Njeriu është i lirë të bëjë çdo zgjedhje. Ky ajet e zhduk këtë gabim dhe thotë se njeriu, duke qenë i lirë, njëkohësisht është i varur nga urdhrat hyjnorë, të cilëve u nënshtrohet i gjithë rruzulli tokësor.

Thënë ndryshe, po kjo liri dhe ky vullnet i njeriut, është i mundur të realizohet vetëm me urdhrin dhe dëshirën e All'llahut të Madhëruar. Ai ia jep dhe ia heq sa herë që dëshiron kujt të dojë.

Së treti, thotë se ata nuk besojnë me asnjë lloj çmimi, vetëm nëse All'llahu dëshiron dhe i detyron ata. Por, ne e dimë që All'llahu nuk detyron askënd, as për besim as, për mosbesim.

Sigurisht, interpretimi i parë dhe i dytë duken më të mirë dhe të përshtatshëm.

Në fund të ajetit 56 thuhet: **"Vetëm Ai është i Denjë për t'u pasur frikë dhe vetëm Ai është i Denjë për të falur."**.

Është e denjë që ata të kenë frikë ndëshkimin e All'llahut, të heqin dorë nga bërja ortak Atij, si dhe është e denjë që të shpresojë në faljen e Tij.

Kjo fjali flet për pozitën e frikës, shpresës, dënimit dhe faljes së All'llahut, si dhe është arsyetim për ajetin e mëparshëm.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, në lidhje me interpretimin e këtij ajeti, lexojmë: *"Unë jam i denjë që të frikësohet prej Meje robi Im dhe të mos më bëjë ndonjë ortak*

Mua! Po ashtu, Unë jam i denjë, që, nëse robi nuk më bën diçka ortak, do ta çoj atë në Xhennet.”.[1]

Edhe pse të gjithë komentuesit, me sa kemi parë ne, “devotshmërinë” këtu e kanë interpretuar në kuptimin pasiv, pra, kanë pohuar se All’llahu është i denjë që politeizmi dhe mëkatimi të qëndrojnë larg Tij. Megjithatë ekziston edhe mundësia që të komentohet në kuptimin aktiv, pra, All’llahu është larg çdo lloj padrejtësie apo vepre të ligë, si dhe prej çdo lloj vepre që bie në kundërshtim me urtësinë e Tij.

Sidoqoftë, kjo sure filloi me urdhër për këshillim dhe përgjegjësi dhe përfundoi me ftesë për devotshmëri dhe premtim faljeje. Pra, këtu theksohet se vetëm me përulësi dhe përgjërim duhet t’i drejtohemi All’llahut.

O Zoti im! Të lutem na bëj ne prej të devotshmëve dhe të falurve prej Teje!

O Zoti im! Të lutem, nuk do të arrijmë asgjëkund pa ndihmën dhe vullnetin Tënd, kështu që na përfshi ne në mirësinë Tënde të pafundme!

O Zoti im! Kurthi është i vështirë, rruga është plot kthesa dhe djalli është i gatshëm të na joshë. Kalimi i kësaj rruge është i pamundur pa ndihmën Tënde, prandaj, të lutem na ndihmo ne!

[1] Tefsiri “El Burhan”, vëll. 4, f. 405.

Fundi i sures "Mudeththir"

Sure "El Kijame"

Zbritur në Mekë

40 ajete

Përmbajtja e sures "El Kijame"

Nga vetë emërtimi, kuptohet se kjo sure, kryesisht, diskuton çështje që kanë të bëjnë me Ringjalljen dhe Kiametin. Vetëm disa ajete diskutojnë për Kur'anin Fisnik dhe përgënjeshtruesit e tij. Çështjet e trajtuara rreth Kiametit, në përgjithësi, ndahen në katër pjesë:

1- Çështje që kanë të bëjnë me shenjat e ardhjes së çastit të ndodhjes së Kiametit. (Ngjarjet e befasishme dhe tepër frikësuese,

të cilat do të ndodhin në fund të kësaj bote dhe në fillim të Kiametit).

2- Çështje që ndërlidhen me gjendjen e punëmirëve (mirëbërësve) dhe keqbërësve në atë Ditë.

3- Çështje që lidhen me çastet plot ankthe në momentin e vdekjes dhe kalimin nga kjo botë në Botën Tjetër.

4- Çështje që kanë të bëjnë me qëllimin e krijimit të njeriut dhe raportin e tij me çështjen e Ringjalljes.

Mirësitë e leximit të sures "El Kijame"

Në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë: *"Çdokush që e lexon suren 'El Kijame', unë dhe Xhebraili do të dëshmojmë për të në Ditën e Gjykimit, se ai ka pasur besim në këtë Ditë dhe fytyra e tij do të ndriçojë më shumë se sa fytyrat e njerëzve të tjerë."*.[1]

[1] "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 393.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të)*, lexojmë: "*Kush e lexon dhe e praktikon gjithnjë suren 'El Kijame', All'llahu i Madhëruar, në Ditën e Gjykimit, do ta nxjerrë nga varri, së bashku me këtë sure, me fytyrën më të mirë, do ta përgëzojë vazhdimisht atë dhe do t'i qeshë në fytyrë, derisa ta kalojë Urën e Siratit dhe venddhënien e llogarisë.*".[1]

Duhet të kemi parasysh faktin se ajo që transmetohet nga dëshmitë, si mirësi e leximit të sureve të Kur'anit është pohuar qartë në këtë hadith të Imam Sadikut. Pra, rrjedhimisht të gjitha këto janë si premisa për praktikimin dhe zbatimin e përmbajtjes së sureve dhe ajeteve kur'anore.

Ajetet 1 - 6

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

[1] "Maxhmeul Bejan", vëll. 10, f. 393.

لَآ أُقۡسِمُ بِيَوۡمِ ٱلۡقِيَٰمَةِ ١ وَلَآ أُقۡسِمُ بِٱلنَّفۡسِ ٱللَّوَّامَةِ ٢ أَيَحۡسَبُ ٱلۡإِنسَٰنُ
أَلَّن نَّجۡمَعَ عِظَامَهُۥ ٣ بَلَىٰ قَٰدِرِينَ عَلَىٰٓ أَن نُّسَوِّيَ بَنَانَهُۥ ٤ بَلۡ يُرِيدُ
ٱلۡإِنسَٰنُ لِيَفۡجُرَ أَمَامَهُۥ ٥ يَسۡـَٔلُ أَيَّانَ يَوۡمُ ٱلۡقِيَٰمَةِ ٦

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Betohem në Ditën e Kiametit!"

"Betohem në shpirtin qortues!"

"A mendon njeriu se nuk do të mund t'i mbledhim eshtrat e tij?!"

"Po, si jo! Ne jemi të Zotë t'ia ribëjmë bashkë me përsosmëri edhe majat e gishtave të tij."

"Por njeriu dëshiron të gabojë sa të jetë gjallë."

"Dhe pyet: 'Kur do të jetë Dita e Kiametit?'"

Komentimi

Betohet në Ditën e Kiametit dhe në shpirtin qortues

Kjo sure fillon me dy betime të mëdha: **"Betohem në Ditën e Kiametit!"** dhe **"Betohem në shpirtin qortues!"**.

Për fjalën *"la"*, në këto dy ajete, ka thënie të ndryshme në mesin e komentuesve. Kanë thënë se ajo është shtesë për siguri dhe nuk e mohon betimin, madje e përforcon atë. Kanë thënë se mund të jetë mohuese jo për të mohuar betimin, por për ta theksuar më shumë atë. Në rastin konkret, kjo pjesëz mohuese, në fakt, pohon se kjo çështje është aq e rëndësishme, saqë betohet në të, megjithëse mes komentuesve të Kur'anit kjo mbetet akoma çështje e diskutueshme.

Shumica e komentuesve kanë zgjedhur variantin e parë, ndërsa disa të tjerë përkrahin të dytin. Ata janë të mendimit se *"la"*, si shtesë, nuk përdoret në fillim të fjalisë, por duhet të jetë në mesin e saj.

Komentimi i parë duket më i përshtatshëm, sepse All'llahu i Madhëruar është betuar në çështje më të rëndësishme se Kiameti, p.sh. është betuar në Esencën e Vet të Pastër, kështu që nuk ekziston ndonjë argument, që të vërtetojë se këtu të mos jetë betuar në Ditën e Kiametit. Gjithashtu, vendosja e *"la"*-së si shtesë, në fillim të fjalisë është përdorur në poemat e "Imreul Kejsit".[1]

Sipas mendimit tonë, përdorimi ose heqja e *"la"*-së nuk është dhe aq e rëndësishme, sepse rezultati i të dyjave është i njëjtë, rëndësia e betimit që është përmendur.

---

[1] "La ue ebijke ibnete amirin la jed'di'i el kaumu in'ni efir'ru"
Betohem në babain tuaj, o vajza e Amirit, populli asnjëherë nuk mund të pretendojë, që unë do të largohem.

Me rëndësi është fakti, që të shohim se çfarë lidhjesh ekzistojnë mes këtyre dy betimeve (betimi në Ditën e Kiametit dhe betimi në shpirtin qortues).

Një prej argumenteve të ekzistimit të Ringjalljes, është ekzistimi i "gjykatës së ndërgjegjes", e cila ndodhet në brendësi të shpirtit të njeriut. Në qoftë se njeriu kryen një vepër të mirë, e mbush shpirtin e tij me gëzim dhe lumturi dhe, me anë të kësaj, e shpërblen atë. Në qoftë se kryen një vepër të shëmtuar, ose ndonjë krim, shpirti i tij ndihet nën presion të madh dhe e ndëshkon dhe e torturon atë deri në atë masë, saqë ndonjëherë, për të shpëtuar nga tortura dhe dënimi i ndërgjegjes, është i gatshëm të kryejë dhe vetëvrasje.

Pra, në realitet, ndërgjegjja lëshon urdhrin e vdekjes së tij dhe ai e zbaton atë me duart e veta!

Reflektimi i "*nefsul leuame*" - "*shpirtit qortues*", në ekzistencën e njerëzve, është shumë i shtrirë dhe i gjerë. Duhet të tregohet kujdes nga çdo pikëpamje dhe duhet të studiohet me saktësi rreth tij. Më pas, në shënimet rreth ajeteve, do të flasim më shumë për këtë çështje.

Meqenëse brenda "mikrokozmosit", brenda njeriut, gjendet një gjykatë e vogël, si është e mundur që universi, (makrokozmosi), me gjithë madhështinë e vet, të mos ketë një gjykatë madhështore të drejtësisë për vete?!

Këtu është që, ne, nga ekzistenca e "ndërgjegjes morale", deduktojmë në ekzistencën e Ringjalljes dhe të Kiametit. Po ashtu, këtu bëhet më e qartë dhe lidhja interesante mes këtyre dy

betimeve. Thënë ndryshe, betimi i dytë është argument për betimin e parë.

Por cili është synimi i fjalës *"nefsul leuame"*?[1] Për këtë, komentuesit kanë dhënë interpretime të ndryshme.

Një komentim i njohur është ai që diskutuam më lart, pra, që "ndërgjegjja morale" e qorton njeriun, kur kryen vepra të papëlqyeshme në këtë botë dhe e detyron t'i kompensojë dhe t'i rishikojë ato.

Interpretimi tjetër tregon se me këtë fjali synohet autoqortimi i të gjithë njerëzve në Kiamet. Besimtarët e qortojnë veten e tyre, pse kanë kryer kaq pak vepra të mira në këtë botë, kurse jobesimtarët e qortojnë veten e tyre, pse kanë marrë rrugën e politeizmit, të shirkut dhe të mëkatit.

Interpretimi i tretë supozon se vetëm shpirti i jobesimtarëve në Ditën e Kiametit i qorton dhe i kritikon tej mase ata, për shkak të veprave të tyre të këqija.

Por, përsëri mendimi i parë është më i përshtatshëm me ajetin pararendës dhe pasrendës.

Po! Kjo gjykatë e ndërgjegjes është kaq madhështore dhe e respektueshme, saqë All'llahu është betuar në të dhe e ka madhëruar. Me të vërtetë, është për t'u madhëruar, sepse konsiderohet si një prej faktorëve të rëndësishëm të shpëtimit të njeriut, me kusht, që kjo ndërgjegjeje të jetë zgjuar dhe të mos

[1] Fjala *"leuametu"* është në kuptimin: "qortues i rreptë".

dobësohet e të mos bëhet e pafuqishme, nën ndikimin e mëkateve të shumta.

Duhet përmendur se përgjigjja e betimit këtu nuk përmendet. Aludimi i përgjigjes së betimit është: "Betohem në All'llahun dhe shpirtin qortues, se të gjithë ju, në Ditën e Gjykimit, do të ringjalleni dhe do të shpërbleheni për veprat tuaja.".

Interesant është fakti se është betuar në Kiamet, sepse ekziston Kiameti dhe Ringjallja është konsideruar aq e sigurt, sa edhe karshi jobesimtarëve, mund të betohemi në të.

Në ajetin në vijim, si një lloj pyetjeje retorike, thuhet: **"A mendon njeriu se nuk do të mund t'i mbledhim eshtrat e tij?! Po, si jo! Ne jemi të Zotë t'ia ribëjmë bashkë me përsosmëri edhe majat e gishtave të tij."**.

Në një hadith është transmetuar: "Një politeist, i quajtur Udej ibn Ebu Rebiatu, jetonte afër shtëpisë së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Një ditë erdhi dhe e pyeti për Ditën e Kiametit se si është ajo ditë, se kur do të ndodhë. Më pas shtoi: "Edhe nëse unë e shoh Atë Ditë me sytë e mi, përsëri nuk do të ta miratoj fjalën tënde, si dhe nuk do t'u besoj fjalëve të tua! Si është e mundur që All'llahu t'i ribashkojë kockat, pasi të jenë kalbur? Kjo është e pa besueshme!".

Në këtë kohë zbritën ajetet e lartpërmendura dhe ia dhanë përgjigjen atij. Më pas, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në lidhje me këtë burrë

kryeneç dhe kokëfortë, shtoi: *"O All'llah, largoji nga unë të këqijat e këtij burri!"*.[1]

Të njëjtin kuptim hasim dhe në vende të tjera në Kur'an. P.sh, në ajetin 78 të sures "Ja Sin" lexojmë se një prej mohuesve të Ringjalljes kishte marrë në dorë disa copa kockash të kalbura dhe iu drejtua Profetit: **"Kush i ngjall eshtrat, duke qenë ato të kalbura?"**.[2]

Fjala *"jehsebu"* rrjedh nga fjala *"hisban"* dhe është përdorur me kuptimin e hamendjes. Ajo aludon se këta mohues nuk i besonin vetë fjalët e tyre, por mbështeteshin vetëm në hamendësime dhe përfytyrime të rrejshme e të pa baza.

Tani le të shohim se përse përqendrohet kaq shumë te kockat. Ky përqendrim mbi kockat është bërë, sepse: Së pari, kockat qëndrojnë më shumë se gjymtyrët e tjera. Kur ato kalben dhe shndërrohen në dhè, grimcat e pluhurit shpërndahen në tokë dhe shpresa e ribashkimit, e rikompozimit, e rikthimit të tyre është më e paktë në optikën e njerëzve sipërfaqësorë.

Së dyti, kockat përbëjnë bazën më të rëndësishme të trupit të njeriut, sepse kockat formojnë "shtyllat" e trupit të njeriut. Me anë të kockave kryhen të gjitha lëvizjet, zhvendosjet dhe aktivitetet e rëndësishme të trupit. Shumësia, format dhe përmasat e ndryshme të kockave në trupin e njeriut konsiderohen si prej mrekullive të krijimit të All'llahut. Vlera e një kocke të vogël, në pjesën e prapme të trupit njerëzor, vërehet atëherë kur pushon së

[1] Këtë hadith e ka transmetuar El Meragij, përmendet në "Ruhul Meanij" dhe te tefsiri "Es Safij", me shumë pak ndryshime.

[2] Sure "Ja Sin", ajeti 78.

funksionuari, sepse nga mosfunksionimi i saj shohim se paralizohet i gjithë trupi i njeriut.

Fjala *"benan"* është përdorur në kuptimin e *"gishtërinjve"* edhe në kuptimin e *"majave të gishtave"*. Në të dy rastet tregohet se All'llahu është Ai që i mbledh kockat dhe i kthen ato në gjendjen e mëparshme, por madje i mbledh dhe kockat e vogla, me përmasa delikate e të sakta, siç janë kockat e gishtave dhe i rendit ato në mënyrë të saktë, siç kanë qenë më parë, madje më shumë se kaq. All'llahu i Madhëruar është në gjendje që dhe majat e gishtave t'i kthejë në gjendjen e mëparshme, ashtu siç kanë qenë, në mënyrë harmonike dhe të përpiktë.

Ka gjasa, që kjo shprehje të jetë një aludim i qëlluar për vijat e majave të gishtave të njerëzve, për të cilat thuhet: "Në këtë botë, janë fare të paktë ata njerëz, që u përputhen majat e gishtave të tyre.". Ose thënë ndryshe, veçori e çdo individi, që e dallon nga individët e tjerë janë vijat në majë të gishtërinjve. Prandaj, në kohën që jetojmë, çështja e "gjurmës së gishtit" ka marrë formë zyrtare, sepse nëpërmjet saj janë zbuluar shumë autorë të krimeve. Kur një hajdut hyn në një dhomë apo në shtëpinë e dikujt, gjurmët e gishtave të tij do të ngelin mbi dorezën e derës, apo xhamin e dhomës, në çelës, në arkë, etj, dhe duke e filmuar zonën që ka vepruar hajduti, organet përkatëse bëjnë krahasimin e gjurmëve të gjetura me të dhënat e kriminelëve dhe hajdutëve të tjerë. Në këtë mënyrë zbulohet krimineli.

Më pas, All'llahu përmend një prej arsyeve reale të mohimit të Ringjalljes dhe shton se nuk është kështu, se njeriu dyshon në fuqinë e All'llahut, në lidhje me bashkimin e kockave dhe

Ringjalljen e vdekurve, por motivi i mohimit të tij është: **"Por njeriu dëshiron të gabojë sa të jetë gjallë."**.

Njeriu dëshiron që me anë të mohimit të Ringjalljes, të fitojë lirinë për kryerjen e çdo lloj mëkati, dhune dhe kapriçoje. Me anë të mohimit të Ringjalljes, njeriu përpiqet ta ngushëllojë ndërgjegjen e vet me gënjeshtra, se përballë krijesave të All'llahut, mund të mos mbartë ndonjë përgjegjësi.

Besimi në Ringjallje dhe daljen përpara Gjykatës së drejtë të All'llahut është një barrierë e fuqishme, përballë çdo lloj mëkati dhe krimi.

Ai dëshiron t'i kapërcejë këto pengesa, që të jetë i lirë dhe të kryejë çdo vepër që dëshiron.

Kjo nuk u përket vetëm periudhave të kaluara. Edhe në ditët tona, një prej faktorëve të rëndësishëm të prirjes drejt materializmit dhe mohimit të Zanafillës (burimit hyjnor të jetës) dhe të Ringjalljes, është përftimi i "lirisë" për imoralitetin, shmangia ndaj përgjegjësive, si dhe nëpërkëmbja e çdo lloj ligji hyjnor. Por, argumentet e Zanafillës dhe të Ringjalljes janë tepër të qarta.

Në tefsirin e "Ali bin Ibrahimit" lexojmë se, kur ka shpjeguar këtë ajet, ka thënë: "Ajeti ka parasysh personin që i jep përparësi mëkatit, kurse pendimin e vonon duke thënë: 'Më vonë do të pendohem.'".[1]

Disa të tjerë, gjithashtu, kanë thënë se kuptimi i fjalës *"fexhr"*, në ajet, është *"përgënjeshtrimi"*, kështu që kuptimi i ajetit do

[1] Tefsiri "Ali ibn Ibrahim", vëll. 2, f. 392.

të ishte kështu: Njeriu dëshiron të përgënjeshtrojë Kiametin dhe Ringjalljen. Por komentimi i parë është më i përshtatshëm.

Në vazhdimësi, përsëri thotë: **"Kur do të jetë Dita e Kiametit?"**.

Po! Ai, për t'iu shmangur përgjegjësive, parashtron pyetjen mohuese në lidhje me kohën e ndodhjes së Kiametit. Ai ka për qëllim t'i hapë rrugë vetes për të kryer sa më shumë gabime.

Duhet të theksojmë se pyetja e tyre, në lidhje me kohën e ndodhjes së Kiametit, nuk ishte për faktin se ata besonin në Kiametin dhe interesoheshin për kohën e ndodhjes së tij. Jo! Kjo pyetje ishte një hap drejt mohimit të Kiametit që në thelb. Kjo është e ngjashme me situatën, kur një person deklaron se filan njeri do të kthehet nga udhëtimi, por kur koha e udhëtimit zgjatet tepër dhe nuk kemi lajme nga pasagjeri, personi tjetër që është mosbesues i ardhjes së këtij pasagjeri, pyet: "Pra, kur do të arrijë ky pasagjer?"

Dy hulumtime

1- Gjykata e ndërgjegjes apo Ringjallje e vogël?

Nga Kur'ani Famëlartë përftohet që fryma dhe shpirti njerëzor ka tri faza:

a) *"En Nefsul emmaretu"* do të thotë "shpirti rebelues", i cili gjithnjë e shtyn njeriun të kryejë vepra të liga dhe të shëmtuara dhe përpiqet t'i zbukurojë dëshirat inferiore dhe gabimet. Kjo është e njëjtë me atë që ndodhi me bashkëshorten e sunduesit të Egjiptit. Kjo grua kapriçioze, kur pa fundin e vet ogurzi, iu drejtua atij duke i thënë: **"Unë asnjëherë nuk e shfajësoj veten time, pse epshi është shumë nxitës për të keqen..."**.[1]

b) *"En Nefsul levvametu"*, e përmendur në ajetet në diskutim, tregon një shpirt të ndërgjegjësuar dhe pothuajse të informuar. Edhe pse karshi mëkatit, akoma nuk ka gjetur mbrojtje dhe strehë të sigurt, ndonjëherë përballet me ndonjë mëkat dhe bie në kurthin e tij, por pas pak kohe vetëdijesohet, pendohet dhe i rikthehet plotësisht rrugës së lumturisë. Tek ai ekziston mundësia e devijimit, por kjo është diçka e përkohshme dhe jo e përhershme. Ai patjetër që është i përlyer me mëkate, por pa vonuar, e kompenson atë me vetëqortim, fajësim dhe pendim.

Këtë e quajnë "ndërgjegjje etike" dhe te disa njerëz është shumë e fortë dhe e fuqishme, kurse te një numër tjetër njerëzish është tepër e dobësuar dhe e pafuqishme. Megjithatë, ajo ekziston

[1] Sure "Jusuf", ajeti 53.

te çdo njeri, por disa e flakin atë tërësisht me anë të kryerjeve të mëkateve të shumta.

c) *"En Nefsul mutmeinnetu"*, do të thotë shpirti i përsosur, i cili ka arritur në fazën e bindjes së plotë. Tregon një shpirt që e ka mposhtur shpirtin rebel dhe ka arritur në pozitën e devotshmërisë, të përsosmërisë dhe ndjenjës së përgjegjësisë. Për këtë ka shumë pak gjasa që mëkati të depërtojë tek ai.

Kjo është e njëjtë me atë që është thënë në suren "El Fexhr", në ajetet njëzet e shtatë dhe njëzet e tetë: **"O ti, shpirti i bindur plotësisht! Kthehu te Zoti yt i vetëkënaqur e i pranuar!"**.

Ashtu siç e diskutuam edhe më lart, *"en nefsul levvametu"*, është një "Ringjallje e vogël" brenda shpirtit të çdo njeriu. Në momentin që ai kryen ndonjë vepër të mirë apo të ligë, menjëherë brenda shpirtit të tij krijohet "gjyqi" që i kërkon llogari apo e lavdëron atë.

Prandaj, njeriu, karshi një vepre të mirë dhe të rëndësishme, ndihet i qetë brenda vetes dhe shpirti i tij fluturon nga gëzimi dhe lumturia. Kënaqësia, entuziazmi dhe gëzimi që përjeton, nuk mund të përshkruhet me asnjë shprehje dhe me asnjë penë.

Mund të ndodhë e kundërta e kësaj. Njeriu, karshi një gabimi ose mëkati të madh, ndihet aq në makth dhe në gjendje të trishtuar, saqë i vërsulet një stuhi pikëllimi dhe hidhërimi, shpirti i vlon nga brenda dhe ndihet plotësisht i "ngopur" nga kjo jetë. Madje, ndonjëherë, për të shpëtuar nga kthetrat e kësaj brenge, duke qenë i vetëdijshëm për fundin e hidhur, u dorëzohet autoriteteve gjyqësore.

Kjo gjykatë e brendshme, e çuditshme, ka një ngjashmëri të përafërt me Gjyqin e Ringjalljes:

1- Gjykatësi, dëshmitari dhe ekzekutuesi në këtë botë (të ndërgjegjes) është i njëjtë, ndërkohë që edhe në Kiamet ndodh e njëjta gjë: **"Ti do të gjykosh mes robve të Tu për kundërshtitë që kanë pasur!"**.[1]

2- Ky gjykatës i ndërgjegjes nuk i pranon rekomandimet, ryshfetet, ndërhyrjet e politikanëve etj., ashtu siç e lexojmë dhe në lidhje me gjykatën e Kiametit, ku thuhet: **"Dhe ruajuni Një Dite kur askush askujt nuk do të mund t'i kryejë asgjë, kur nuk pranohet për të** (jobesimtarin) **ndonjë ndërmjetësim dhe nuk pranohet për të kompensim, e as që do të ndihmohen ata** (fajtorët)**."**.[2]

3- Gjykata e ndërgjegjes i analizon dhe i gjykon dosjet më të rëndësishme dhe më të domosdoshme të njeriut. Për një periudhë të shkurtër, e miraton vendimin e vet përfundimtar. Për të as nuk ka apelim, as thirrje dhe as rishikim. Ai vendim nuk zvarritet me muaj apo vite të tëra. Këtë e lexojmë dhe në lidhje me Gjykatën e Ringjalljes, ku thuhet: **"All'llahu gjykon, e s'ka kush që mund t'i kundërvihet gjykimit të Tij. Ai ndërmerr masë të shpejtë."**.[3]

4- Dënimet dhe ndëshkimet e All'llahut, përkundër dënimeve të gjykatave zyrtare të kësaj bote, shkëndijat e para të Tij, ndizen në thellësi të zemrës dhe shpirtit dhe nga aty dalin dhe përhapen më gjerë. Në fillim e ngacmon dhe e prek zemrën e

[1] Sure "Ez Zumer", ajeti 46.

[2] Sure "El Bekare", ajeti 48.

[3] Sure "Er Rra'd", ajeti 41.

njeriut, më pas ndikimet e tij shfaqen në trup, në fytyrë dhe në ndryshimin e regjimit të gjumit dhe ushqimit të tij, ashtu siç e lexojmë: **"...është zjarri i ndezur fort që depërton deri në thellësi të zemrës."**.[1]

5- Kjo gjykatë e ndërgjegjes nuk ka aq shumë nevojë për dëshmitarë dhe vëzhgues. Ajo do të pranojë si "dëshmitarë" pro, apo kundër njohuritë dhe perceptimet e njeriut të akuzuar. Ashtu si dhe në Gjykatën e Ringjalljes, grimcat e qenies së njeriut, madje dora, këmba dhe lëkura e trupit të tij do të dëshmojnë për veprat e kryera: **"...e derisa i afrohen atij, kundër tyre dëshmojnë: të dëgjuarit e tyre, të parit e tyre dhe lëkurat e tyre për çdo gjë që ata kanë punuar."**.[2]

Kjo ngjashmëri e përafërt mes këtyre "dy gjykatave" është një shenjë tjetër se çështja e Ringjalljes është natyrore. Po të ishte ndryshe, si do mund ta besojmë që në ekzistencën e një njeriu të ekzistojë një llogaridhënie dhe gjykatë misterioze dhe enigmatike dhe në brendësi të kësaj bote dhe universi të madh të mos ekzistojë fare ndonjë llogaridhënie apo ndonjë gjykatë?! Kjo është e pabesueshme!

2- Emrat e Kiametit në Kur'anin e Madhërishëm

Një pjesë e madhe e njohurive kur'anore dhe çështjeve ideologjike kanë të bëjnë me çështje që lidhen me Kiametin dhe

[1] Sure "El Humeze", ajetet 6-7.

[2] Sure "Fussilet", ajeti 20.

Ringjalljen, sepse këto kanë ndikimin më të madh në edukimin dhe zhvillimin e njeriut.

Kur'ani ka përmendur shumë emra për këtë Ditë të Madhe. Secili emër shpjegon një prej dimensioneve të asaj Dite dhe mundëson parashtrimin e çështjeve të shumta për atë Ditë.

Sipas të ndjerit Fejdul Kashanij, në "Mehexhxhetul Bejdha", thuhet se në secilin prej këtyre emrave qëndron një sekret dhe në çdo përshkrim është shprehur një aspekt i rëndësishëm. Kështu që ne duhet të përpiqemi t'i perceptojmë këto aspekte dhe t'i zbulojmë këto fshehtësi.

Për Kiametin janë përmendur më shumë se njëqind emra. Që të gjithë, ose pjesën më të madhe të tyre, i hasim në Kur'an, si p.sh: Jeumul Hasre, Jeumul Nedame, Jeumul Muhasibe, Jeumul Musaele, Jeumul Vakiatu, Jeumul Kariatu, Jeumul Raxhietu, Jeumul Radifetu, Jeumut Talak, Jeumul Furkan, Jeumul Hisab, Jeumul Tenad, Jeumul Adhab, Jeumul Ferar, Jeumul Hakk, Jeumul Hukm, Jeumul Fasl, Jeumul Xhem'i, Jeumuddin, Jeumul tubla Serair, Jeumul la jugni meula an meula shej'en, Jeumu jefirul mere'u min ekhihi, Jeumul la jenfa'u malun uela benun dhe Jeumu Tegabun, etj."[1]

Emri më i njohur i Asaj Dite është "Jeumul Kijame", i cili është përsëritur shtatëdhjetë herë në Kur'anin e Madhërishëm. Ai nënkupton ngritjen e përgjithshme të njerëzve dhe Ringjalljen madhështore të tyre. Gjithashtu, kujtimi i asaj Dite e shtyn njeriun, që të kryejë detyrat në këtë botë.

[1] "El Mehxhxhetul Bejdha", vëll. 8, f. 331 (me shkurtime).

Sipas mendimit tonë, për t'u zgjuar nga gjumi i neglizhencës, i shpërfilljes dhe i arrogancës, për të zbutur shpirtin rebel dhe për edukimin dhe fisnikërimin e njeriut, mjafton të reflektojmë rreth këtyre emrave dhe të marrim në konsideratë se si do të gjendemi ne në atë Ditë të Madhe, në atë Ditë, kur të gjithë do të dalim përpara All'llahut dhe do të japim llogari; në atë Ditë, kur do të hiqen perdet mënjanë dhe çdo gjë do të dalë në shesh, do të zbulohet; në atë Ditë, kur Xhenneti do të zbukurohet, kurse Xhehennemi do të jetë i rrethuar nga zjarri; në atë Ditë, kur të gjithë do të qëndrojmë para peshores së drejtë të All'llahut.

O Zot, të përgjërohemi për mbrojtjen Tënde në atë Ditë!

Ajetet 7 - 15

فَإِذَا بَرِقَ ٱلۡبَصَرُ ۝٧ وَخَسَفَ ٱلۡقَمَرُ ۝٨ وَجُمِعَ ٱلشَّمۡسُ وَٱلۡقَمَرُ ۝٩ يَقُولُ ٱلۡإِنسَٰنُ يَوۡمَئِذٍ أَيۡنَ ٱلۡمَفَرُّ ۝١٠ كَلَّا لَا وَزَرَ ۝١١ إِلَىٰ رَبِّكَ يَوۡمَئِذٍ ٱلۡمُسۡتَقَرُّ ۝١٢ يُنَبَّؤُاْ ٱلۡإِنسَٰنُ يَوۡمَئِذِۭ بِمَا قَدَّمَ وَأَخَّرَ ۝١٣ بَلِ ٱلۡإِنسَٰنُ عَلَىٰ نَفۡسِهِۦ بَصِيرَةٞ ۝١٤ وَلَوۡ أَلۡقَىٰ مَعَاذِيرَهُۥ ۝١٥

“Por, kur sytë t’i verbohen”

“Dhe të zihet Hëna.”

“Dhe Dielli e Hëna të bashkohen.”

“Atë Ditë njeriu do të thotë: ‘Ku të iki?’”

“Askund! S’ka strehë!”

“Atë Ditë, streha është te Zoti yt.”

“Atë Ditë, njeriu do të vihet në dijeni për veprat që ka bërë dhe për ato që ka lënë pa bërë.”

“Po, vërtet që njeriu do të dëshmojë kundër vetvetes.”

“Edhe sikur të paraqesë shfajësimet e veta.”

Komentimi

Njeriu është gjykatësi më i mirë i vetes

Në ajetet e kaluara, diskutimi përfundoi me pyetjen që e kishin parashtruar mohuesit e Ringjalljes në lidhje me Kiametin. Ata thoshin se, nëse Kiameti është i vërtetë, kur do të ndodhë?

Ajetet në vijim i japin përgjigje kësaj pyetjeje.

Ajetet 7-9 përmendin ngjarjet e çuditshme që do të ndodhin para Ringjalljes, siç janë: transformimet e mëdha që do të shfaqen në këtë botë, prishja e rendit të saj. Ajetet deklarojnë: **"Por, kur sytë t'i verbohen dhe të zihet Hëna dhe Dielli e Hëna të bashkohen."**.

Po, cili është synimi i bashkimit të Diellit me Hënën? Komentuesit e Kur'anit kanë paraqitur ide të ndryshme:

Disa kanë thënë edhe Dielli, edhe Hëna do të afrohen pranë, ose të dy do të lindin në lindje dhe do të perëndojnë në perëndim së bashku.

Të tjerë kanë thënë se të dy që do ta humbasin dritën e tyre.[1]

[1] I ndjeri Tabrasij, në "Mexhmaul Bejan" (vëll. 10, f. 395), pohon se bashkimi është në tri lloje: bashkimi kohor, bashkimi hapësinor dhe bashkimi i tipareve në një objekt të vetëm (siç është p.sh. bashkimi i dijes dhe drejtësisë te njeriu), kurse bashkimi në kuptimin e "bashkimit të dy gjërave në tipar", p.sh. humbja e dritës së Hënës dhe e Diellit në një kohë, është një lloj shprehje figurative (që duhet ta kuptojmë me anë të shoqërimit).

Ekziston edhe mundësia që Hëna, gradualisht, nën ndikimin e gravitetit të Diellit, do të afrohet drejt tij dhe do të bashkohet me të dhe më pas të dy do të humbasin dritën.

Këtu tregohet për dy dukuritë më të rëndësishme revolucionare në fund të kësaj bote, pra, eklipsisi i Hënës dhe i Diellit dhe bashkimi i Hënës dhe i Diellit me njëri-tjetrin. Kjo çështje deri diku është diskutuar edhe në ajete të tjera të Kur'anit. P.sh, në ajetin 10 të sures "Et Tekuir" thuhet: **"Kur dielli të mbështillet** (dhe errësohet)**."**. Ne e dimë se Hëna ndriçohet nga Dielli. Në kohën që Dielli do të errësohet, edhe Hëna do të errësohet, si pasojë rruzulli tokësor do të bjerë në terr, në një errësirë të tmerrshme.

Pra, fundi i botës do të vijë nga një transformim i madh. Më pas, me anë të një transformimi tjetër madhor, me fyerjen e surit për herë të dytë, që është edhe fryrja e vitalizmit, fillon ringjallja e njerëzve: **"Atë Ditë njeriu do të thotë: 'Ku të iki?'"**.

Njerëzit politeistë dhe mëkatarë, që përgënjeshtronin Ditën e Kiametit, atë Ditë, nga sikleti dhe turpi i madh, nga barra e rëndë e mëkateve dhe e frikës prej dënimit, do të kërkojnë rrugë për të shpëtuar, siç ndodh edhe në këtë botë, kur njerëzit ndodhen përballë ndonjë ngjarjeje të rrezikshme, kërkojnë rrugë shpëtimi.

Menjëherë atyre do t'u thuhet: **"Askund! S'ka strehë!**[1] **Atë ditë, streha është te Zoti yt."**.

[1] Fjala *"uezere"*, është në kuptimin e vendstrehimeve malore dhe të ngjashme me to, kurse fjala *"uezijrun"* - *"ministër"*, që punët mbështeten tek ai. Në ajetin në fjalë, nënkupton çdo lloj vendstrehimi.

Në këtë ajet, përveç komentimit të lartpërmendur, janë paraqitur edhe komentime të tjera, si p.sh: Në atë Ditë, gjykimi përfundimtar është në duart e All'llahut; vendpërcaktimi i fundit, në Xhennet apo në Xhehennem, është me urdhrin e All'llahut; ose vendndodhja për gjykim dhe kërkim llogarie është përpara All'llahut.

Duke pasur parasysh ajetin në vijim, komentimi që kemi përzgjedhur, është më i përshtatshmi nga të gjithë.

Disa të tjerë mendojnë se ajeti i lartpërmendur tregon udhën e përsosmërisë së përhershme të njeriut dhe është në të njëjtën linjë me ajetet e tjera që flasin për të njëjtën çështje, si: **"Vetëm te Ai është e ardhmja."**[1], ose **"O ti njeri, vërtet ti përpiqesh me një përpjekje të madhe që çon te Zoti yt, e atë do ta gjesh."**[2], apo **"Kthimi i fundit do të jetë te Zoti yt."**.[3]

Thënë më qartë: Njerëzit janë shtegtarë. Ata e kanë nisur lëvizjen e tyre nga mosqenia për të arritur në qenie. Ata kanë ecur shumë rrugë, edhe në këtë areal, sërish janë në lëvizje, por kësaj here drejt Qenies Absolute dhe ekzistencës së pafundme të All'llahut. Sa herë që nuk largohen nga udha kryesore dhe Rruga e Drejtë, kjo lëvizje evolutive do të vazhdojë deri në pafundësi dhe njerëzit çdo ditë do të hyjnë në një fazë të re të afërsisë me All'llahun. Por në rast se largohen nga rruga e tyre, do të dështojnë dhe do të asgjësohen.

[1] Sure "Et Tegabun", ajeti 3.

[2] Sure "El Inshikak", ajeti 6.

[3] Sure "En Nexhm", ajeti 42.

Më pas, në vazhdimësi të kësaj bisede, ajeti shton: **"Atë Ditë, njeriu do të vihet në dijeni për veprat që ka bërë dhe për ato që ka lënë pa bërë."**. Për kuptimin e këtyre dy fjalive janë përmendur komentime të ndryshme:

Së pari, synohen veprat që njeriu i ka kryer, kur ka qenë i gjallë në këtë botë, apo veprat që kanë mbetur pas vdekjes së tij, përfshirë traditat e mira dhe të këqija, të cilat i ka lënë mes njerëzve dhe ata frymëzohen prej tyre, veprojnë në bazë të tyre. Tregohen mirësitë apo të këqijat që i përkasin atij, (shkruhen në dosjen e veprave të tij). Apo janë librat dhe shkrimet, ndërtimet e dobishme apo të dëmshme, fëmijë të dobishëm apo keqbërës, që veprat e tyre do t'i arrijnë atij.

Së dyti, me këtë synohen veprat e para dhe veprat e fundit që ka kryer në këtë botë. Thënë ndryshe, do të vihen në dijeni për të gjitha veprat që ka kryer.

Së treti, janë pronat që ka marrë para vetes dhe pronat që ka lënë për trashëgimtarët.

Disa komentues të tjerë, gjithashtu, kanë pohuar se me këtë synohen mëkatet, të cilave u kishte dhënë përparësi dhe adhurimet, të cilat i kishte vonuar, ose e kundërta e tyre.

Nga të gjitha këto, më i përshtatshmi është komentimi i parë. Në lidhje me këtë çështje, po japim një hadith të transmetuar nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)*: "*Atë Ditë, njeriu do të vihet në dijeni për të mirat dhe të këqijat, të cilave u ka paraprirë, si dhe për ato që ka lënë pa kryer, për traditat, zakonet, të cilat i ka lënë pas vetes dhe ata që vijnë pas tij, të veprojnë në bazë të tyre. Kështu që, nëse ka qenë traditë e keqe, do t'i shtohet atij si mëkat, pavarësisht nga numri i vepruesve sipas*

asaj tradite të keqe, pa u hequr, (pakësuar), atyre ndonjë gjë nga mëkati i tyre. Nëse ka qenë një traditë e dobishme, do të shpërblehet sa shpërblimi i tyre, por pa u zvogëluar nga shpërblimi i tyre.".[1]

Në ajetin vijues thuhet se, edhe pse All'llahu dhe engjëjt atë Ditë do ta vënë në dijeni atë për veprat e veta, një gjë e tillë nuk është nevojshme, sepse vetë njeriu është në dijeni për gjendjen e vet. Edhe gjymtyrët e trupit do të dëshmojnë për atë në atë Ditë të Madhe. Ajeti thotë: **"Po, vërtet që njeriu do të dëshmojë kundër vetvetes, edhe sikur të paraqesë shfajësimet e veta."**.

Këto ajete pohojnë po atë që kanë dëshmuar edhe ajetet e tjera të Kur'anit, për dëshminë e gjymtyrëve të trupit të njeriut për veprat e tij. P.sh, në ajetin 20 të sures "Fussilet", thuhet: **"E derisa t'i afrohen atij, kundër tyre dëshmojnë: të dëgjuarit e tyre, të parit e tyre dhe lëkurat e tyre për çdo gjë që ata kanë punuar."**.

Kurse në ajetin 65 të sures "Ja Sin" Kur'ani thotë: **"Sot Ne ua mbyllim gojët atyre, Neve na flasin duart e tyre, kurse këmbët e tyre dëshmojnë për atë që punuan."**.

Si rrjedhojë, në atë gjykatë të madhe të Kiametit, vetë njeriu është dëshmia më e madhe e veprave të tij, sepse vetë ai është në dijeni dhe i informuar për gjendjen e vet më mirë se çdokush tjetër. Përveç kësaj Zoti, i ka dhënë atij (njeriut) argumenta dhe dëshmi të shumta.

Fjala *"besijra"* është përdorur dhe me kuptimin *"vizioni"* dhe *"njohuri"*, edhe me kuptimin e *"personit të i informuar"*, prandaj disa

[1] Tefsiri "El Burhan", vëll. 4, f. 306. Një transmetim i ngjashëm është përmendur, gjithashtu dhe në tefsirin "El Kurtubij", vëll. 10, f. 6891.

komentues atë e kanë interpretuar në kuptimin e "arsyes, të provës dhe argumentit" për informacionin.

Fjala "*meadhir*" është shumësi i fjalës "*meadhiret*" dhe tregon "*gjetjen e një gjëje, që zhduk efektet e mëkatit*". Edhe ky, ndonjëherë është arsyetim i vërtetë dhe real, dhe ndonjëherë formal dhe sipërfaqësor.

Disa të tjerë, gjithashtu, kanë deklaruar se fjala "*meadhir*" është shumësi i fjalës "*mi'dhar*" dhe është përdorur me kuptimin e "*perdes dhe mbulimit*". Në bazë të këtij komentimi, kuptimi i ajetit do të ishte kështu: Njeriu i di veprat e tij, (është i vetëdijshëm), sado që të vejë perde ndaj veprave të tij e t'i mbajë të fshehta punët e veta. Interpretimi i parë është më i përshtatshëm.

Sidoqoftë, Gjykatës i asaj Dite të Madhe do të jetë Zoti, i Cili është në dijeni për sekretet e jashtme dhe të brendshme dhe e përcakton vetë njeriun, që të jetë llogaritës i veprave të veta. Këtë mendim e gjejmë të shprehur edhe në ajetin 14 të sures "El Isra": **"Lexo librin tënd, mjafton të jesh sot llogaritës i vetvetes."**.

Edhe pse ajetet në diskutim flasin rreth Ringjalljes dhe Kiametit, koncepti i tyre është i gjerë dhe e përfshin edhe këtë botë. Në këtë botë, gjithashtu, njerëzit janë në dijeni për gjendjen e tyre, edhe pse disa e fshehin fytyrën e vërtetë, me anë të hipokrizisë, gënjeshtrës dhe mashtrimit.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet: "*Sa herë që njëri prej jush e zbukuron veten në pamje të jashtme, (tregohet mirëbërës), por në fshehtësi, (kur është vetëm), kryen vepra të këqija, sa vlen vepra e tij? A nuk është, vallë, në dijeni në kohën që i drejtohet vetes që nuk është i tillë?* All'llahu i Madhëruar thotë në

Kur'an: **"Por njeriu është në dijeni ndaj vetvetes."**. *Kur bota e brendshme e njeriut bëhet fisnike, përforcohet dhe ana e jashtme e tij."*.[1]

Në hadithet që flasin për agjëruesin e sëmurë, është transmetuar se një prej shokëve të Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* e pyeti atë: "Sa është masa e asaj sëmundjeje që të lejon të prishësh agjërimin?".

Imami iu përgjigj: "*Njeriu është në dijeni ndaj vetvetes dhe e di se deri në ç'masë ka mundësi (fuqi)?"*.[2]

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 396.

[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 396. (Këtë hadith e ka transmetuar dhe i ndjeri Saduk, në veprën "Men la jehdherul Fakijh", në librin "Agjërimi", vëll. 2, kreu "Haddul meredhi el ledhi juftiru sahibehu", hadithi 1941, f. 132.

Ajetet 16 – 19

لَا تُحَرِّكْ بِهِۦ لِسَانَكَ لِتَعْجَلَ بِهِۦٓ ١٦ إِنَّ عَلَيْنَا جَمْعَهُۥ وَقُرْءَانَهُۥ ١٧ فَإِذَا قَرَأْنَٰهُ فَٱتَّبِعْ قُرْءَانَهُۥ ١٨ ثُمَّ إِنَّ عَلَيْنَا بَيَانَهُۥ ١٩

"Mos nxito (o Muhammed) **në leximin e Kur'anit me gjuhën tënde!"**

"Ne e kemi për detyrë t'i mbledhim pjesët e tij e ta lexojmë atë."

"Dhe, kur ta lexojmë atë, ti përcille leximin e tij!"

"Pastaj, e kemi Ne për detyrë ta shpjegojmë."

Komentimi

Mbledhja dhe ruajtja e Kur'anit është përgjegjësi e jona!

Këto ajete janë si fjalia jashtë kontekstit, të cilën, folësi detyrohet ta thotë në mes të fjalimit të vet. P.sh, një orator, gjatë fjalimit, sheh se në fund të sallës janë grumbulluar shumë njerëz, ndërkohë që përpara tij ka vende bosh. Ai e ndërpret fjalimin dhe

i fton të pranishmit të afrohen më shumë dhe të zënë vend në pjesën e boshatisur të sallës, që të hapet vend për të tjerët. Më pas e vijon fjalimin e vet. Një shembull tjetër është kur profesori, sheh se studenti i tij është i pavëmendshëm, e ndërpret mësimin për një çast, ia tërheq vërejtjen dhe vazhdon mësimin.

Në qoftë se një person, këtë fjalim apo mësim e dëgjon nga kaseta, apo nëpërmjet CD, ka gjasa të mos orientohet, përse u bë kjo shkëputje, por duke ndjekur vijimin e leksionit, kupton arsyen e ndërprerjes. Konteksti e qartëson edhe më mirë leksionin.

Pas këtij sqarimi, fillojmë komentimin e ajeteve të lartpërmendura.

All'llahu i Madhëruar, përkohësisht e ndërpret rrëfimin e Vet në lidhje me Kiametin dhe gjendjen e besimtarëve e të jobesimtarëve në atë Ditë dhe i bën një vërejtje të shkurtër Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në lidhje me Kur'anin: **"Mos nxito** (o Muhammed) **në leximin e Kur'anit me gjuhën tënde!"**.

Për interpretimin e këtij ajeti, midis komentuesve të Kur'anit ka shumë diskutime. Tri interpretime janë përmendur si më kryesoret:

I pari është interpretimi i njohur, që është transmetuar nga Ibn Abasi në librat e hadithit dhe të tefsirit. Aty thuhet se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për shkak të dashurisë së madhe, që kishte ndaj memorizimit të Kur'anit, kur engjëlli i shpalljes ia lexonte atij ajetet kur'anore, ai lëvizte buzët e veta së bashku me atë. All'llahu e urdhëroi atë që mos të sillej në këtë mënyrë, sepse Ai vetë do ta mblidhte atë.

Interpretimi i dytë tregon se Kur'ani ka dy zbritje. "Zbritja e njëhershme", që do të thotë se i gjithë Kur'ani i ka zbritur njëkohësisht zemrës së pastër të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* brenda një nate, brenda Natës së Kadrit dhe "zbritja graduale", që do të thotë se zbritja e Kur'anit është bërë përgjatë 23 viteve, radhazi. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për shkak të nxitimit që kishte për komunikimin e Thirrjes, ndonjëherë, para zbritjes graduale, të Kur'anit, ose përgjatë zbritjes, i këndonte ajetet. Për këtë arsye, u urdhërua që të heqë dorë nga kjo mënyrë leximi dhe çdo ajet ta lexojë dhe ta komunikojë në kohën e caktuar të tij.

Prandaj, përmbajtja e këtij ajeti është e ngjashme me ajetin 114 të sures "Ta Ha": **"Ti mos nxito me Kur'anin, para se të përfundojë Shpallja e tij..."**.

Këto dy interpretime nuk ndryshojnë dhe aq shumë nga njëri-tjetri. Në thelb, këto përcjellin kuptimin se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, edhe gjatë leximit të ajeteve kur'anore, edhe gjatë pranimit të Shpalljes, nuk duhet të nxitohet.

Komentimi i tretë ka shumë pak përkrahës. Ai thotë se këto ajete u drejtohen mëkatarëve në Ditën e Kiametit, të cilët urdhërohen të lexojnë librin e veprave të tyre dhe të jenë vetë llogaritës së veprave të veta. Atyre do t'u thuhet: "Mos nxitoni në leximin e tij, sepse ata, kur arrijnë te veprat e këqija, ndihen të mërzitur dhe të zemëruar dhe duan ta lexojnë e ta kalojnë sa më shpejt atë pjesë. Prandaj atyre u jepet urdhri, që të mos nxitojnë

dhe, kur engjëjt të lexojnë librin e veprave të tyre, t'i dëgjojnë me vëmendje.

Sipas këtij komenti, këto ajete nuk janë fjali jashtë kontekstit, përkundrazi ekziston lidhja mes ajeteve të kaluara dhe ajeteve në vijim. Ato kanë kohezion me njëra-tjetrën, sepse të gjithë flasin për Kiametin dhe Ringjalljen. Por në bazë të komentimit të parë dhe të dytë, ashtu siç e diskutuam dhe më lart, këto ajete janë jashtë kontekstit.

Sidoqoftë, interpretimi i tretë, sidomos duke pasur parasysh, që në ajetet në vijim është përmendur rishtazi emri i Kur'anit, duket i papranueshëm. Këtë mospërputhje na e bën të qartë edhe tonaliteti i ajeteve. Edhe bashkimi midis tyre, gjithashtu, nuk është i pamundur, sado që tonaliteti i ajeve në vijim përputhet me atë të parin, pra, komentimin e njohur.

Më pas ajeti shton: **"Ne e kemi për detyrë t'i mbledhim pjesët e tij e ta lexojmë atë."**.

Thënë shkurt, mos u mërzit për mbledhjen e Kur'anit. Ne do t'i grumbullojmë ajetet kur'anore dhe përsëri do të t'i lexojmë ty me anë të engjëllit të Shpalljes: **"Dhe, kur ta lexojmë atë, ti përcille leximin e tij! Pastaj, e kemi Ne për detyrë ta shpjegojmë."**.

Si rrjedhojë, mbledhja e Kur'anit, leximi dhe shpjegimi i tij, na takon Neve. Ti mos u brengos. Ai që e ka zbritur këtë Shpallje, në të gjitha etapat e zbritjes, është dhe mbrojtës i tij. Detyra jote është vetëm ta pasosh leximin e engjëllit të Shpalljes dhe t'ia komunikosh njerëzimit këtë mesazh.

Disa komentues të tjerë kanë thënë se synimi i mbledhjes, nuk është grumbullimi për të dëgjuar gjuhën e Shpalljes, por që

Shpallja të depërtojë në gjoksin (kraharorin) e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe leximi, nga ana e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të mos jetë i shpejtë. Ne, të gjitha këto ajete, do t'i mbledhim në gjoksin tuaj. Më pas do ta bëjmë të mundshme artikulimin e tyre përmes gjuhës tënde.

Sidoqoftë, të gjitha këto komentime miratojnë komentimin e parë, pra, që Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, gjatë Shpalljes së Kur'anit prej Xhebrailit, gjithnjë nxitonte t'i përsëriste ajetet kur'anore, nga frika se mos i harronte. Prandaj iu shpall nga All'llahu, që të ruajë qetësinë, si dhe e siguroi që jo vetëm grumbullimi i Kur'anit dhe leximi i tij, por edhe shpjegimi i Kur'anit, do të ishte i sigurt nga All'llahu i Madhëruar.

Ndërkaq, këto ajete vërtetojnë origjinalitetin e Kur'anit, si garancinë e ruajtjes së tij nga çdo lloj shtrembërimi dhe ndryshimi. All'llahu ka premtuar grumbullimin, leximin dhe shpjegimin e tij.

Në një hadith thuhet: "Kur Xhebraili i shfaqej Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i zbriste ajetet kur'anore, ai binte në qetësi absolute. Vetëm kur Xhebraili largohej, fillonte leximin e ajeteve të Kur'anit.".[1]

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 397.

Ajetet 20 – 25

كَلَّا بَلْ تُحِبُّونَ ٱلْعَاجِلَةَ ٢٠ وَتَذَرُونَ ٱلْآخِرَةَ ٢١ وُجُوهٌ يَوْمَئِذٍ نَّاضِرَةٌ ٢٢ إِلَىٰ رَبِّهَا نَاظِرَةٌ ٢٣ وَوُجُوهٌ يَوْمَئِذٍ بَاسِرَةٌ ٢٤ تَظُنُّ أَن يُفْعَلَ بِهَا فَاقِرَةٌ ٢٥

"Por ju doni këtë jetë (kalimtare)**."**

"E për Jetën Tjetër nuk kujtoheni!"

"Atë Ditë, disa fytyra do të shkëlqejnë."

"Dhe Zotin e tyre do të shohin."

"Kurse disa fytyra, atë Ditë, do të jenë të zymta."

"Duke e ditur se do të pësojnë një fatkeqësi, që të thyen në mes."

Komentimi

Fytyra të qeshura dhe të zymta në skenën e Kiametit

Këto ajete i kthehen përsëri diskutimit për Ringjalljen. Shpjegojnë karakteristika të tjera të Kiametit dhe shkaqet e mohimit të Ringjalljes. Dy nga këto ajete thonë: **"Por ju doni këtë jetë** (kalimtare) **e për Jetën Tjetër nuk kujtoheni!"**.

Argumenti kryesor i mohimit të Ringjalljes nuk është dyshimi në fuqinë e All'llahut për grumbullimin e eshtrave të kalbura dhe dherat e shpërndara, por dashuria juaj e tepërt për këtë botë. Dëshirat inferiore dhe dhënia pas epsheve bëhen shkak që të hiqni pengesat nga rruga juaj e epshit.

Duke pasur parasysh faktin, që pranimi i Ringjalljes, si dhe urdhëresat dhe ndalesat hyjnore, krijojnë pengesa dhe kufizime të shumta në këtë rrugë, ju shënjestroni çështjen kryesore, duke e mohuar atë. Në këtë mënyrë, e lini tërësisht në harresë jetën pas vdekjes, Ahiretin.

Ashtu siç e kemi diskutuar edhe më parë, një prej shkaqeve kryesore të prirjes ndaj materializmit dhe mohimit të zanafillës (Monoteizmit) dhe Ringjalljes (Eskatlogjisë), është përftimi i lirisë absolute kundrejt epsheve dhe dëshirave inferiore dhe çdo lloj mëkati. Kjo është e vërtetuar jo vetëm në të kaluarën, por edhe sot, ky koncept dëshmohet në formë të qartë dhe të spikatur.

Këto dy ajete janë theksim i ajeteve paraprake, ku u citua: **"Por njeriu dëshiron të vazhdojë edhe më tej me mëkate. Andaj edhe pyet: 'Kur është Dita e Kiametit?'"**.

Më pas, shtjellon gjendjen e besimtarëve dhe të jobesimtarëve në atë Ditë dhe thotë: **"Atë Ditë, disa fytyra do të shkëlqejnë."**.

Fjala *"nadhiretun"* rrjedh nga fjala *"nadhretun"* dhe tregon një ngadhënjim të veçantë, që njeriu e ndien nën ndikimin e bollëkut, të begatisë dhe mirëqenies. Ai ngadhënjim shoqërohet me gëzim, bukuri dhe lartësim shpirtëror. U ndriçon ngjyra e fytyrës. Kjo tregon për gjendjen e atyre që janë zhytur në begatitë hyjnore.

Në fakt, kjo është e ngjashme me atë që thuhet në suren "Mutaffifijn", në ajetin 24: **"Në fytyrat e tyre mund të kuptosh kënaqësinë e përjetimeve."**.

Kjo është për nga pikëpamja e shpërblimeve materiale, kurse në lidhje me shpërblimin shpirtëror të tyre, ajeti thotë: **"Zotin e tyre do të shohin."**. Një shikim me syrin e zemrës dhe me anë të intuitës, i bën ata të magjepsen pas asaj esence të pa shembull, pas asaj bukurie dhe përsosmërie absolute. Ata i kaplon një kënaqësi shpirtërore e papërshkrueshme. Një çast i saj është më i lartë dhe më i mirë se e gjithë bota!

Duhet të kemi parasysh se përdorimi i fjalës *"ila rabiha"* përpara fjalës *"nadhire"* nënkupton ekskluzivitetin, që do të thotë: "Atë e shikojnë, askënd tjetër".

Në qoftë se thuhet se banorët e Xhennetit, sigurisht, që do shohin dhe gjëra të tjera, përveç All'llahut, në përgjigje, do të themi se të shikosh pasojën, do të thotë të shikosh shkakun (e pasojës).

Thënë ndryshe, kudo e shohin All'llahun. Në çdo gjë që shohin, shohin Fuqinë, Lavdinë dhe Bukurinë e All'llahut, prandaj vëmendja ndaj begative të Xhennetit nuk i pengon ata nga shikimi i Vetës së All'llahut.

Në disa hadithe të transmetuara, për komentimin e këtij ajeti, lexojmë: "Ata shikojnë Mëshirën, Begatinë dhe Shpërblimin e All'llahut"[1], sepse shikimi i gjithë këtyre, është shikimi i Vetës së Pastër të All'llahut.

[1] Tesriri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 464-465.

Një grup njerëzish të painformuar, ajetin e lartpërmendur e kanë komentuar si shikimi ndijor i All'llahut në Kiamet dhe deklarojnë se në atë Ditë, All'llahun do ta shohim me syrin e zakonshëm.

Një shikim i tillë nënkupton që All'llahu të ketë fizikisht trup, të jetë i pranishëm në vend dhe të ketë cilësi dhe gjendje të posaçme trupore, ndërkohë që ne e dimë se Veta e Pastër e All'llahut është larg këtyre "papastërtive". Kjo gjë është sqaruar shpesh në Kur'an. P.sh, në suren "El En'am", në ajetin 103, thuhet: **"Të parët e njerëzve nuk mund ta përfshinë Atë, e Ai i përfshin të parët."**. (Njerëzit nuk mund ta shohin Atë, Ai i shikon njerëzit!)

Ky ajet është i pakushtëzuar në kuptimin e tij.

Njerëzit nuk mund ta shohin All'llahun! Kjo është e qartë dhe e prerë. Për këtë nuk ka nevojë të flasim dhe diskutojmë më shumë se kaq. Njeriu, që ka sado pak njohuri mbi Kur'anin dhe dijet islame, e pohon këtë të vërtetë.

Disa komentues të tjerë kanë dhënë një shpjegim tjetër në lidhje me fjalën *"nadhiretun"*. Sipas tyre, kjo fjalë rrjedh nga fjala *"intidhar"* - "pritje", që do të thotë se besimtarët atë Ditë shpresën e kanë vetëm te Qenia e Pastër e All'llahut. Ata nuk mbështeten, madje, as te veprat e tyre të mira, por gjithnjë janë në pritje të mëshirës dhe begatisë së Tij.

Në qoftë se thuhet se kjo pritje do të jetë e përzier me stres dhe shqetësim, për besimtarët nuk ekziston asnjë brengë.

Kjo pritje është e përzier me shqetësim dhe brengë, sepse nuk kanë siguri për fundin e lumtur të saj. Kur sigurohen se nuk do të kenë brenga e shqetësime, pritja është e qetë.

Gjithashtu, është i mundur edhe bashkimi i kuptimit të "të shikuarit" dhe "të pritjes", sepse mund të përdoret në fjali një fjalë me dy kuptime të ndryshme. Por, nëse këmbëngulet për njërin prej këtyre dy kuptimeve, më i preferuar do të ishte kuptimi i parë.

Këtë diskutim do ta mbyllim me një hadith shumë domethënës, nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Atëherë, kur banorët e Xhennetit hyjnë në Xhennet, All'llahu do të thotë: 'A dëshironi t'ju shtoj gjë tjetër?'. Ata do të thonë: 'O All'llahu ynë, çdo gjë na e ke dhuruar. A nuk na e ke ndriçuar fytyrën tonë? A nuk na fute në Xhennet? A nuk na shpëtove nga zjarri i Xhehennemit?'. Në këtë kohë do të hiqen perdet dhe do ta shohin All'llahun me syrin e zemrës. Atëherë për ata nuk ka asgjë më të dashur se sa shikimi i All'llahut të tyre."*.[1]

Interesant është hadithi i transmetuar nga Enes ibn Malik: *"Ata e shohin Zotin e tyre pa kufi të caktuar, shumë të qartë."*.[2]

Ky hadith thekson njohjen intuitive, të brendshme (syrin e zemrës) dhe jo shikimin me sy të zakonshëm.

Përballë këtij grupi besimtarësh, ndodhet grupi i jobesimtarëve. Për ata ajeti thotë: **"Kurse disa fytyra, atë Ditë, do të jenë të zymta."**.

[1] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 29, f. 145.

[2] Tefsiri "El Mijzan", vëll. 20, f. 204.

Fjala *"basire"* rrjedh nga fjala *"busrun"* dhe tregon një gjë të papjekur, apo një punë të pambaruar. Prandaj, në këtë kuptim, edhe frytin e papjekur të palmës e quajnë *"busr"*. Më pas kjo fjalë është përdorur edhe për fytyrat e zymta dhe të ashpra, për shkak se është reagimi që njeriu shfaq, kur gjendet para dënimit.

Sidoqoftë, kur u shfaqen shenjat e dënimit dhe librin e veprave të tyre e shohin pa asnjë vepër të mirë, e shohin të mbushur me vepra të liga, tregohen të shqetësuar, të trishtuar dhe të hidhëruar dhe fytyrat e tyre bëhen të zymta.

Më pas, shtohet: **"Duke e ditur se do të pësojnë një fatkeqësi, që të thyen në mes."**.

Shumica e komentuesve të Kur'anit janë të mendimit se fjala *"dhannun"* këtu është në kuptimin e diturisë, që do të thotë ata e dinë, janë të bindur që i pret një fatkeqësi e tillë. Disa komentues të tjerë janë të mendimit se fjala *"dhannun"* nënkupton hamendësimin dhe supozimin. Ata, përgjithësisht, janë të bindur që i pret një fatkeqësi, por dyshojnë dhe hamendësojnë edhe për dënimin që u thyen mesin.

Fjala *"fakiretun"* rrjedh nga fjala *"fakratun"*. Shumësi i saj është *"fek'karun"* dhe është në kuptimin e shpinës *"shtyllës kurrizore"*. Prandaj fjalën *"fakrun"* e përdorin edhe në lidhje me ngjarjet e rënda dhe të mëdha, të cilat e thyejnë mesin e njeriut. Fjalën *"fakir"* e kanë përdorur për të treguar njeriun e varfër, i cili "thuajse mesin e ka të thyer".

Sidoqoftë, kjo fjalë nënkupton dënime të mëdha dhe të rënda, të cilat priten në Xhehennem. Pra, ky grup është në pritje të dënimeve që të thyejnë mesin, ndërkohë që grupi i lartpërmendur

është në pritje të mëshirës së All'llahut, si dhe janë në gatishmëri të takimit me të dashurin e tyre. Ky grup, grupi i jobesimtarëve, do të përjetojë dënimet më të rënda, kurse grupi tjetër, grupi i besimtarëve, do të ketë begatitë materiale më të mira, bekimet dhe kënaqësitë shpirtërore.

Ajetet 26 – 30

كَلَّآ إِذَا بَلَغَتِ ٱلتَّرَاقِيَ٢٦ وَقِيلَ مَنۡۜ رَاقٖ٢٧ وَظَنَّ أَنَّهُ ٱلۡفِرَاقُ٢٨ وَٱلۡتَفَّتِ ٱلسَّاقُ بِٱلسَّاقِ٢٩ إِلَىٰ رَبِّكَ يَوۡمَئِذٍ ٱلۡمَسَاقُ٣٠

"Por, kur shpirti të vijë në grykë."

"E të thërrasin 'A ka shërues?'"

"Atëherë, ai (që po vdes) **do të bindet se ky është çasti i ndarjes."**

"Dhe këmbët do të ngrijnë."

"Atë Ditë, ai do të sillet te Zoti yt."

Komentimi

Në vazhdim të diskutimeve për Botën Tjetër dhe fatin e besimtarëve dhe të jobesimtarëve, këtu flitet për çastin e dhimbshëm të vdekjes, e cila është dritare drejt Botës Tjetër.

Ajeti 26 thotë se, **"kur shpirti të vijë në grykë"**, atij do t'i hapen sytë.

Është dita kur syri i tij ezoterik, syri i botës së ndërmjetme, do të hapet, perdet do të hiqen dhe ai jo vetëm do të shikojë shenjat e ndëshkimit dhe të dënimit, por edhe do të njihet me veprat e tij. Në ato çaste do të besojë, por ky besim tashmë nuk do të sjellë asnjë dobi për të në atë gjendje.

Fjala *"et terakij"* është shumësi i fjalës *"terkuvetun"* dhe tregon kockat që kanë rrethuar fytin, kurse *"arritja e shpirtit në grykë"* nënkupton momentet e fundit të jetës së njeriut, sepse në kohën që shpirti ndahet nga trupi, gjymtyrët e trupit, të cilat janë më larg zemrës, si duart dhe këmbët, pushojnë të parat së funksionuari. Shpirti gradualisht largohet nga trupi, derisa arrin në grykë.

Në këto momente tregohet se njerëzit e pranishëm te i sëmuri kërkojnë me ngulm rrugë për shpëtim. Në ajet thuhet se a ka ndonjë njeri, që mund ta shpëtojë jetën e këtij të sëmuri e **"të thërrasin 'A ka shërues?'"**.

Këtë fjalë e thonë nga dëshpërimi, pafuqia dhe mjerimi, sepse e dinë që të sëmurit i ka ardhur fundi dhe as mjeku nuk mund të bëjë ndonjë gjë.

Fjala *"rakun"* rrjedh nga fjala *"rekjun"*, kurse fjala *"rukjetun"* tregon ngjitjen lart. Kjo fjalë përdoret për hajmalitë dhe dhikret, të cilat ndikojnë për shërimin e të sëmurëve. Për këtë arsye, edhe mjekun që shëron pacientin, e kanë quajtur *"raaki"*. Në këtë kontekst, kuptimi i ajetit është ky: Shoqëruesit e të sëmurit, ndonjëherë dhe vetë i sëmuri, nga dhimbjet e padurueshme, thërret: "A ka ndonjë mjek? A ka njeri, që të lutet dhe ta shpëtojë të sëmurin?!".

Disa komentues të tjerë kanë thënë se kuptimi i ajetit është ky: Cili nga engjëjt do t'ia marrë shpirtin dhe do ta çojë lart? A do të jetë engjëlli i dënimit apo i mëshirës?

Ka të tjerë që kanë shtuar se, duke u nisur nga fakti që engjëjt ndiejnë bezdi nga marrja e shpirtit të personit jobesimtar, si dhe nga ngjitja e tij lart, engjëlli i vdekjes do të thotë: "Kush është ai që do t'ia marrë shpirtin dhe do t'ia çojë lart?".

Komentimi i parë është më i saktë dhe më i përshtatshëm se të gjitha komentimet tjera.

Në ajetin vijues tregohet dëshpërimi i plotë i të sëmurit. Për këtë, ajeti thotë: **"Atëherë, ai** (që po vdes) **do të bindet se ky është çasti i ndarjes dhe këmbët do të ngrijnë."**.

Kjo ngrirje e këmbëve ndodh, sepse shpirti u largua nga ato. Për këtë moment, në këtë ajet, janë përmendur dhe komentime të tjera. P.sh, në një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*Puqet bota me Ahiretin.*".[1]

Në tefsirin e "Ali ibn Ibrahimit", gjithashtu, është përmendur po ky kuptim.[2]

Nga Ibn Abasi, gjithashtu, është transmetuar se me këtë nënkuptohet puqja e vështirësive të vdekjes me vështirësitë e Kiametit.

Duket se të gjitha këto interpretime i rikthehen kuptimit që u transmetua nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)*.

---

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 465.

[2] Po aty.

Ky interpretim rrjedh nga kuptimi që përcjell fjala *"sakun"*, e cila, në fjalorin arab, me njërin prej kuptimeve, tregon se është ngjarja e rëndë, fatkeqësia dhe katastrofa e madhe.

Disa të tjerë, gjithashtu, kanë thënë se me këtë nënkuptohet puqja e nyjave të këmbës në qefinin.

Sigurisht, këto komentime nuk bien në kundërshti me njëra–tjetrën, pra, është e mundur përfshirja e të gjithë atyre në domethënien e ajetit.

Në ajetin e fundit të diskutimit tonë, thuhet: **"Atë Ditë, ai do të sillet te Zoti yt."**.

Po, të gjithë do të rikthehen te All'llahu dhe do të jenë të pranishëm në Gjykatën e drejtë të Tij dhe të gjitha rrugët (linjat) do të përfundojnë tek Ai.

Ky ajet thekson edhe çështjen e Ringjalljes së përgjithshme të njerëzve. Ai mund të jetë edhe një aludim për kahun e lëvizjes së krijesave drejt Qenies së Pastër të All'llahut të Madhëruar.

Hulumtim

Çasti i dhimbshëm i vdekjes

Ashtu siç e dimë, Kur'ani i ka kushtuar një rëndësi të madhe çështjes së vdekjes, veçanërisht çastit të dhënies së shpirtit dhe i paralajmëron njerëzit se të gjithë do të ballafaqohen me këtë çast,

të cilin e ka përshkruar edhe si *"sekratul meut"* - **"agonia e vdekjes"**.[1]

Ndonjëherë e ka përmendur si *"gameratul meut"*, që do të thotë **"trishtimet e vdekjes"**.[2]

Herë tjetër e ka përmendur me shprehjen: **"kur arrin shpirti në fyt"**.[3]

E ka përmendur edhe me shprehjen **"arritja e shpirtit në grykë"**, (ajetet që po diskutojmë).

Nga të gjitha këto që përmendëm më lart, kuptojmë se ai çast, ndryshe nga ç'pretendojnë disa materialistë, është një moment tejet i vështirë dhe i dhimbshëm. Si mund të mos jetë kështu, kur janë çastet e kalimit nga kjo botë në Botën Tjetër, që do të thotë se është kalim i dhimbshëm, siç është i dhimbshëm kalimi i njeriut nga bota embrionale në këtë botë.

Në transmetimet islame tregohet se këto çaste, për besimtarët e drejtë, do të jenë të lehta, ndërkohë që për njerëzit jobesimtarë do të jenë tepër të vështira dhe të frikshme. Kjo ndodh për shkak se euforia e takimit me All'llahun, gëzimi i ballafaqimit me mëshirën dhe begatitë e pafundme të Tij, e largojnë aq shumë vëmendjen e besimtarëve, sa nuk i ndiejnë as dhimbjet e çastit të kalimit nga kjo botë në Botën Tjetër.

---

[1] **"Agonia e vdekjes i vjen me të vërtetën."**. Sure "Kaf", ajeti 19

[2] Sure "El En'am", ajeti 93.

[3] Sure "El Uakia", ajeti 83.

Ndërkohë që jobesimtarët ndiejnë shumë frikën e dënimeve, edhe fatkeqësinë e ndarjes nga kjo botë, pas së cilës ishin tepër të lidhur. Pra, ata përjetojnë dhimbje të dyfishta në çastin e vdekjes.

Në një hadith nga Imam Ali bin Hysejn Zejnul Abidin *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*Kur e pyetën atë rreth vdekjes, tha: 'Për besimtarin, vdekja është si heqja e një rrobe të papastër dhe të mbushur plot me insekte, si lirimi prej prangave dhe zinxhirëve të rëndë, si zëvendësimi i tyre me rrobat më të mira, parfumet më aromatike, si shëtitja me kuajt (mjetet e udhëtimit) më të shpejtë, si transferimi në shtëpitë më të bukura; kurse për jobesimtarët (çasti i vdekjes) është si heqja e një rrobe të stolisur dhe transferimi nga shtëpitë e pashme, në veshjet me rrobat më të pista dhe dërgimi në shtëpinë më të frikshme, më trishtuese e në dënimet më të mëdha.*".[1]

Në një hadith tjetër, transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*Një person kërkoi nga Imami që ta përshkruante vdekjen. Imami i tha: 'Vdekja për besimtarin është si parfumi me aromë të këndshme, të cilin, kur e nuhat, të kaplon një gjendje e ngjashme me gjumin dhe dhimbja e vuajtja hiqen plotësisht! Për jobesimtarin, vdekja është si thumbimi i gjarpërinjve, apo i akrepave, ose më të ashpër se kjo.'*".[2]

Thënë shkurt, vdekja është dritarja e Botës së Përjetshme. Pothuaj, i njëjti vlerësim thuhet edhe në një hadith nga Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*: "*Çdo shtëpi ka një derë, dera e shtëpisë së Ahiretit është vdekja.*".[3]

Kushtimi i vëmendjes ndaj vdekjes ka një ndikim të thellë në shuarjen e pasioneve, në dhënien fund të dëshirave të kota dhe

[1] "Biharul Enuar", vëll. 6, f. 155.

[2] "Biharul Enuar", vëll. 6, f. 156.

[3] Shpjegimi i "Nehxhul Belaga", Ibn Ebil Hadijd, vëll. 20, f. 345.

të neglizhencës. Prandaj në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*Kujtimi i vdekjes i shuan, i mbyt epshet në shpirtin e njeriut, i çrrënjos rrënjët e neglizhencës nga zemra, e përforcon zemrën me premtimet hyjnore. Natyrës së njeriut i dhuron qetësi, dinjitet dhe butësi, i shkatërron gjurmët e egoizmit, e shuan zjarrin e lakmisë. Në syrin e njeriut botën e bën të vogël dhe të pa vlerë dhe kjo është domethënia e thënies së Profetit Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), i cili ka deklaruar: 'Një orë meditim, është më e dobishme se një vit adhurim.'*".[1]

Sigurisht, ky është shpjegim për njërën nga çështjet e meditimit dhe nuk është kështu, që objekti i reflektimit është vetëm ky.

Në lidhje me këtë, kemi dhënë një shpjegim më të detajuar në vëllimin 22, faqe 253, ajeti 19, i sures "Kaf".

[1] "Biharul Enuar", vëll. 6, f. 133.

Ajetet 31 - 40

فَلَا صَدَّقَ وَلَا صَلَّىٰ ٣١ وَلَٰكِن كَذَّبَ وَتَوَلَّىٰ ٣٢ ثُمَّ ذَهَبَ إِلَىٰٓ أَهۡلِهِۦ
يَتَمَطَّىٰٓ ٣٣ أَوۡلَىٰ لَكَ فَأَوۡلَىٰ ٣٤ ثُمَّ أَوۡلَىٰ لَكَ فَأَوۡلَىٰٓ ٣٥ أَيَحۡسَبُ ٱلۡإِنسَٰنُ أَن
يُتۡرَكَ سُدًى ٣٦ أَلَمۡ يَكُ نُطۡفَةٗ مِّن مَّنِيّٖ يُمۡنَىٰ ٣٧ ثُمَّ كَانَ عَلَقَةٗ فَخَلَقَ
فَسَوَّىٰ ٣٨ فَجَعَلَ مِنۡهُ ٱلزَّوۡجَيۡنِ ٱلذَّكَرَ وَٱلۡأُنثَىٰٓ ٣٩ أَلَيۡسَ ذَٰلِكَ بِقَٰدِرٍ عَلَىٰٓ
أَن يُحۡۦِيَ ٱلۡمَوۡتَىٰ ٤٠

"Ai as nuk besoi dhe as nuk u fal."

"Por e mohoi të vërtetën dhe ia ktheu kurrizin."

"E pastaj shkoi te njerëzit e vet, duke u krenuar. "

"Mjerë për ty! Mjerë për ty!"

"Sërish: Mjerë për ty! Mjerë për ty!"

"Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri? "

"A s'ka qenë një pikë fare që derdhej",

"Pastaj u bë droçkë gjaku e më pas All'llahu e krijoi dhe i dha formë e përmasa të caktuara?!"

“E prej tij bëri çiftin: mashkullin e femrën?!”

“Vallë, Ai Krijues, a nuk ka fuqi që t’i ngjallë të vdekurit?!”

Komentimi

Njeriu është krijuar prej një pikë fare të pavlerë

Në vazhdim të diskutimeve të ajeteve të kaluara rreth vdekjes, që është dhe hapi i parë në udhëtimin drejt Ahiretit, në këto ajete tregohet se jobesimtarët janë nisur në këtë udhëtim duarbosh.

Në fillim, thuhet se ky njeri, mohues i Ringjalljes, asnjëherë nuk besoi, nuk u besoi ajeteve kur’anore dhe nuk fali namaz për All’llahun. **“Ai as nuk besoi dhe as nuk u fal.”**,[1] por ndërmori rrugën e përgënjeshtrimit dhe ua ktheu shpinën udhëzimeve dhe urdhrave të All’llahut: **“Por e mohoi të vërtetën dhe ia ktheu kurrizin.”**.

Kuptimi i fjalisë *“fela sad’deka”* është mospranimi i Kiametit, i Llogaridhënies dhe i dënimit, mohimi i ajeteve hyjnore, i monoteizmit dhe i profetësisë së Profetit Muhammed *(Paqja e*

[1] Përemri në fjalinë *“sad’deka ue sel'la”* i rikthehet “njeriut mohues të ringjalljes”. Kjo kuptohet nga tonaliteti i fjalës. Gjithashtu, edhe në fillim të sures është përmendur në lidhje me të.

bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Disa komentues të tjerë e kanë interpretuar si heqja dorë nga bamirësia, nga dhënia në Rrugë të Zotit dhe si dhënien e lëmoshës nga ana e jobesimtarëve, duke e arsyetuar me përmendjen e namazit (faljes), krahas asaj.

Por ajeti i dytë dëshmon më së miri, që pika e kundërt e këtij pranimi, është përgënjeshtrimi. Prandaj komentimi i parë konsiderohet si më i saktë.

Në vijim, ajeti shton: **"Pastaj shkoi te njerëzit e vet, duke u krenuar."**.

Ai hamendësonte se, duke përbuzur dhe duke përgënjeshtruar Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe ajetet hyjnore, do të korrte fitore të rëndësishme dhe ishte i dehur nga "kjo krenari". Ai kthehej në shtëpi dhe, siç e kishte zakon, u rrëfente me krenari ndodhitë që i kishin ndodhur jashtë shtëpisë. Madje krenaria dhe arroganca e tij vërehej edhe në mënyrën e ecjes dhe të lëvizjes së gjymtyrëve të trupit të tij.

Fjala *"jetemet'ta"* rrjedh nga fjala *"meta"* dhe tregon kthimin prapa, kurse fjala *"temet'ta"* nënkupton tërheqjen e trupit për shkak të krenarisë dhe mospërfilljes, ose përdoret edhe në kuptimin e sëmundjes dhe të dremitjes. Kuptimi i parë është më i pranueshëm.

Disa komentues të tjerë kanë thënë se kjo fjalë rrjedh nga fjala *"met't"*, që është përdorur me kuptimin e zgjatjes së këmbës, ose të gjymtyrëve të tjera të trupit, kur tregohesh mospërfillës. Kjo

fjalë është përdorur edhe me kuptimin e sëmundjes, por rrjedhja e saj nga fjala *"meta"* është më e përshtatshme.[1]

Sidoqoftë, ky kuptim është i ngjashëm me atë që është thënë në suren "El Mutaffifjin", ajeti 31: **"E kur ktheheshin te familjet e veta, ktheheshin të kënaqur."**.

Më pas u drejtohet njerëzve jobesimtarë, duke i kërcënuar: **"Mjerë për ty! Mjerë për ty! Sërish: Mjerë për ty! Mjerë për ty!"**.

Në lidhje me këtë ajet janë përmendur dhe interpretime të tjera, si p.sh: Ky ajet është një kërcënim për ata: "Dënimi qoftë mbi ty, dënimi qoftë mbi ty...".

Një interpretim tjetër, tregon se ky ajet flet për gjendjen në të cilën je: "...është më e merituesshme për ty, më e merituesshme për ty...".

Një tjetër interpretim thotë se ky ajet është qortimi dhe fajësimi është më i mirë për ty: "Mjerë për ty! Mjerë për ty!".

Ose: "Të mirat e kësaj bote qofshin larg teje dhe të mirat e Ahiretit qofshin larg teje!".

Ose: "E keqja dhe vuajtja të të kaplojë ty, sërish e keqja dhe vuajtja të të kaplojë ty!".

[1] Nëse rrjedh nga fjala *"meta"*, nuk i jep ndonjë ndryshim termit, ndërkohë që, nëse rrjedh nga fjala *"mett"*, fjala *"jetemet'ta"*, ka qenë *"jetemet'tat* يتمطط", që pjesëza *"ta"* në fund të saj është zëvendësuar me pjesëzën "ja"

Ose: "Dënimin që e sheh në sheshin e Bedrit është më i merituesHëm për ty në këtë botë dhe dënimi i varrit dhe i Kiametit, gjithashtu, është më i merituesHëm për ty.".

Por është e qartë që shumica e këtyre kuptimeve i referohen një kuptimi të përgjithshëm dhe universal, i cili përfshin kërcënimin për dënim, për qortim, për vuajtje dhe për ndëshkim, qoftë në Këtë botë, qoftë në Jetën pas vdekjes, qoftë në Kiamet.

Në disa transmetime është thënë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* mori dorën e Ebu Xhehlit (në bazë të disa transmetimeve të tjera, kapi jakën e tij) dhe tha: "*Eula leke fe eula thum'me eula leke fe'eula*".

Ebu Xhehli ia ktheu: "Me çfarë po më akuzoni? As ti e as All'llahu yt nuk jeni në gjendje, që të më shkaktoni ndonjë dëm mua. Unë jam njeriu më i fuqishëm i kësaj toke!".

Ky ishte rasti që i zbritën po këto fjalë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në formën e ajeteve kur'anore.[1]

Pas kësaj sjell dy argumente interesante në lidhje me Ringjalljen. Njëri tregon qëllimin e krijimit dhe Urtësinë e Zotit, kurse tjetri, shpjegon fuqinë e Tij, i Cili transformon dhe zhvillon farën e njeriut në faza të ndryshme në botën embrionale.

Në fazën e parë thotë: **"Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri?"**.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 401.

Fjala *"suda"* tregon kotësinë, nihilizmin dhe mungesën e qëllimit. Në gjuhën arabe thuhet *"ibilun suda"* për devenë që është braktisur, është e lirë që të shkojë ku të dojë. Kurse me fjalën *"njeri"* tregohet ai njeri që është mohues i Ringjalljes. Ajeti thotë se si është e mundur që ai të besojë se All'llahu e ka krijuar për njeriun këtë botë të gjerë, me gjithë këtë madhështi dhe mrekulli të tjera, por me krijimin e njeriut të mos ketë ndonjë qëllim? Si mund ta besojë se çdo gjymtyrë e trupit të njeriut është krijuar për një qëllim të caktuar: sytë për të parë, veshët për të dëgjuar dhe zemra për t'u ofruar të gjitha qelizave të trupit ushqim, oksigjen dhe ujë. Madje, edhe në linjat e majave të gishtave ekziston një urtësi. Po për tërësinë e ekzistencës së tij nuk ka asnjë qëllim dhe është krijuar kot, pa qëllim dhe pa asnjë plan, pa urdhër, pa ndalim, pa përgjegjësi dhe pa obligim?!

Nëse një njeri i ditur krijon një objekt të vogël, pa ndonjë qëllim, e kritikojnë dhe emrin e tij e fshijnë nga lista e njerëzve të mençur. Atëherë, si është mundur që All'llahu i Urtë ta ketë krijuar njeriun pa asnjë qëllim?!

Në qoftë se thuhet se synimi i krijimit është jeta disaditëshe e kësaj bote, ky konsumim ushqimi dhe gjumë i përsëritshëm, i shoqëruar me njëmijë lloj dhimbjesh dhe vuajtjesh, pa dyshim që kjo nuk mund të justifikojë këtë krijim të madh.

Prandaj, arrijmë në përfundimin se njeriu është krijuar për një qëllim më të madh. Ai është krijuar për Jetën e Përhershme, në afërsi të mëshirës së All'llahut dhe përsosmërisë së vazhdueshme dhe të pafundme.[1]

[1] Në lidhje me këtë, kemi diskutuar dhe në ajetin 115 të sures "El Mu'minun".

Më pas, ajeti shpalos argumentin e dytë: **"A s'ka qenë një pikë fare që derdhej, pastaj u bë droçkë gjaku e më pas All'llahu e krijoi dhe i dha formë e përmasa të caktuara, e prej tij bëri çiftin: mashkullin e femrën?!"**.

A nuk është All'llahu, që në mitrën e errët të nënës lëshon një pikë të vogël dhe të pa vlerë, i jep çdo ditë asaj pike një pamje (krijim) të re, vë në trupin e tij rroba të reja prej jete dhe vitaliteti dhe i jep atij pamje të re, që në fund formësohet si një krijesë e plotë mashkulli ose femre dhe më pas lind nga barku i nënës, i aftë për të ngjallë të vdekurit: **"Vallë, Ai Krijues, a nuk ka fuqi që t'i ngjallë të vdekurit?!"**.

Ky shpjegim, në fakt, është për ata mohues që Ringjalljen fizike të njeriut e pretendonin të pamundur, pra, e mohonin mundësinë e Ringjalljes pas vdekjes dhe pas bërjes pluhur. Ndërkohë, Kur'ani, për ta vërtetuar mundësinë e këtij kuptimi, e kap dorën e njeriut dhe e kthen në fillesat e krijimit të tij dhe i tregon atij etapat e çuditshme të fetusit, si dhe transformimet mahnitëse të njeriut gjatë këtyre etapave, në mënyrë që t'i bëhet e qartë se All'llahu është i Plotfuqishëm dhe i Aftë për çdo gjë. Shprehur ndryshe, argumenti më i mirë për mundësinë e një gjëje është realizimi i saj.

Dy hulumtime

1- Transformimet e fetusit, apo ringjalljet e përsëritura

Fjala *"en nutfetu"* përdoret me kuptimin e ujit të paktë apo ujit të pastër. Këtu është përdorur si emër për spermën, e cila, me anë të fekondimit, mundëson lindjen e njeriut apo të kafshës.

Realisht, transformimi i spermës, kur shndërrohet në fetus, është një nga dukuritë më mbresëlënëse në botën e ekzistencës dhe shqyrtohet në embriologji.

Në shekujt e fundit është hedhur dritë mbi enigmat dhe fshehtësitë rreth saj janë zbuluar. Kur'ani që atëherë, kur këto çështje akoma nuk ishin zbuluar, në mënyrë të përsëritur, është mbështetur apo i ka referuar ato si një nga shenjat e fuqisë së All'llahut.

Në këto ajete përmenden vetëm disa nga fazat e fetusit. Në ajetet e tjera kur'anore, si në ato të fillimit të sures "Haxhxh" dhe të sures "El Mu'minun" janë shqyrtuar më shumë etapa të transformimeve të fetusit dhe ne kemi dhënë sqarime të bollshme në interpretimin e sureve, pra, të ajeteve të përmendura.

Fjala *"dhalike"* tregon largësinë me All'llahun, nënkupton madhështinë e pozitës së Tij dhe shënon faktin se Veta e Pastër e All'llahut është aq e lartësuar, saqë është jashtë perceptimit të mendjes njerëzore. Në një hadith thuhet: "Kur zbriti ajeti: **'Vallë, Ai Krijues, a nuk ka fuqi që t'i ngjallë të vdekurit?!'**, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* deklaroi: *'O Zoti im! Ti je i Pastër! Po, Ti ke një fuqi të tillë.'"*.

E njëjta fjalë është transmetuar dhe nga Imam Bakiri dhe Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi ta!)*.[1]

2- Sistemi i gjinisë në botën njerëzore

Me gjithë diskutimet që janë zhvilluar rreth faktorëve përcaktues të gjinisë së fetusit, rreth kushteve dhe ndikimeve që fetusi të përcaktohet mashkull apo femër, deri tani askush nuk e di saktësisht se cilët janë faktorët kryesorë.

Është e vërtetë se disa ushqime apo ilaçe mund të kenë ndikim në këtë çështje, por pa asnjë dyshim, asnjëri prej tyre nuk konsiderohet si faktor përcaktues. Kjo është një çështje që e di vetëm All'llahu i Madhëruar.

Nga ana tjetër, në të gjitha shoqëritë njerëzore, gjithnjë vërehet një ekuilibër relativ midis dy gjinive. Në shumicën e shoqërive, numri i femrave është më i vogël se i meshkujve, megjithatë, në përgjithësi, ekziston një baraspeshim relativ midis këtyre dy gjinive.

Në qoftë se hipotetikisht vjen një ditë që ky ekuilibër prishet dhe, p.sh, numri i grave bëhet dhjetë herë më i madh se i burrave, apo anasjelltas, mund të mendoni se rendi shoqëror i njerëzve do të shpartallohet. Do të ketë dëme e shthurje marramendëse. Përballë një gruaje do të kishim dhjetë burra, ose përballë një burri do të ishin dhjetë gra. Do të krijohej një amulli e plotë.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 402.

Ajetet e lartpërmendura thonë se All'llahu, prej tyre, bëri dy lloje: mashkullin dhe femrën. Ky ajet tregon se krijimi në raporte përafërsisht të barabarta mes femrave dhe meshkujve, i takon vetëm All'llahut të Gjithëdijshëm. Ai di të vejë ekuilibrat në shoqëri dhe të shmangë amulli të tilla.

O Zoti im! Ne dëshmojmë që Ti je i Plotfuqishëm dhe i aftë, që në një çast të vetëm t'i veshësh me rrobën e ekzistencës dhe të jetës të gjithë të vdekurit. Asgjë nuk është e vështirë përballë fuqisë Tënde!

O Zot! Atë Ditë kur shpirtrat mbërrijnë te gryka e fytit dhe ndërpresin shpresën tonë prej çdo gjëje, e vetmja shpresë që kemi, lidhet me Qenien Tënde të Stërpastër.

O Zot! Na mundëso njohjen e qëllimit të krijimit!

Fundi i sures "El Kijame"

Sure "El Insan"

Zbritur në Medine

31 ajete

Përmbajtja e sures "El Insan"

Kjo sure, edhe pse është e shkurtër, ka një përmbajte të thellë, të larmishme dhe gjithëpërfshirëse. Sipas këtij kuptimi, mund ta klasifikojmë në pesë pjesë:

Pjesa e parë, diskuton rreth zanafillës së njeriut, krijimin e tij nga një pikë fare *(emshaxh)* dhe më pas, udhëzimin dhe lirinë e vullnetit të tij.

Pjesa e dytë, përmend të mirat, që do t'i gëzojnë njerëzit e devotshëm dhe mirëbërës. Për këtë ka një shkak zbritjeje të veçantë, për Ehli Bejtin. Ne do të diskutojmë në vijim atë.

Pjesa e tretë, me fjali të shkurtra dhe shumë domethënëse, përmend argumentet, që bëjnë të mundur t'i meritosh këto shpërblime.

Pjesa e katërt, përmend rëndësinë e Kur'anit, metodën e zbatimit të dispozitave të tij, si dhe rrugën e mbushur plot ngritje dhe ulje të vetëformimit.

Pjesa e pestë, diskuton mbi sundimin e Shpalljes hyjnore (duke mos e dëmtuar lirinë e njeriut, por me vullnet të lirë).

Për këtë sure janë përmendur shumë emra, por emrat më të njohur të saj janë: *"Insan", "Dehr"* dhe sure "*Hel Eta"*. Secili emër është marrë nga një prej fjalëve në fillimin e kësaj sureje, edhe pse në hadithet që do të transmetojmë në pjesën "Mirësitë së leximit të sures 'El Insan'" është përmendur vetëm emri "*Hel Eta*".

Mirësitë e leximit të sures "El Insan"

Në një hadith nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Ai që e lexon suren 'Hel Eta', do të shpërblehet me Xhennetin dhe me rroba të Xhennetit."*.[1]

Në një hadith të transmetuar nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet: *"Një prej shpërblimeve të atij që e lexon suren 'Hal Eta' çdo mëngjes të ditës së enjte është se në Ditën e Kiametit do të jetë me Profetin Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij)."*.[2]

A ka zbritur kjo sure në Medine?

Ka diskutime mes komentuesve të Kur'anit, se ku ka zbritur kjo sure, në Medine apo në Mekë. Sipas mendimit të dijetarëve dhe komentuesve shi'itë është pranuar se të gjitha ajetet, apo së paku një pjesë prej ajeteve të para të kësaj sureje, ku shpjegohet pozita e mirëbërësve dhe veprave të tyre të mira, kanë zbritur në Medine. Shkaku i zbritjes së saj, pra, tregimi i dhënies së sadakasë nga ana e Aliut, Fatimes, Imam Hasanit, Imam Hysejnit *(Paqja qoftë mbi ta!)* dhe shërbyeses Fedhdhatu do të shqyrtohet më gjerësisht në vijim.

Për dijetarët syni kjo sure ka zbritur në Medine. Komentuesi i njohur syni, Kurtubiu, ka deklaruar në tefsirin e tij: "Dijetarët e njohur janë të mendimit se kjo sure ka zbritur në Medine.".[3]

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 410.

[2] Po aty.

[3] Tefsiri "El Kurtubij", vëll. 10, f. 6909.

Dijetarët që e konsiderojnë të gjithë suren, ose një pjesë të saj, si medinase janë:

1- El Hakim Ebul Kasim El Hasekanij, nga Ibn Abasi, i ka përmendur me detaje dhe përpikëri numrin e ajeteve, të cilat kanë zbritur në Medine dhe në Mekë dhe këtë sure e ka konsideruar si sure medinase, e cila ka zbritur pas sures "Err Rrahman" dhe para sures "Et Talak".[1] Autori i librit "El Ijdhah", profesori Ahmed Zahir, gjithashtu, e ka cituar po këtë hadith nga Ibn Abasi.[2]

2- "Tarijkhul Kur'an" i Ebu Abdullah Zenxhanij ka përcjellë nga libri "Nedhmul Durrer ue Tanasukul ajati ues suer" nga një grup prej dijetarësh të Ehli Synetit, ka transmetuar që suren "Insan" e ka renditur në mesin e sureve që kanë zbritur në Medine.[3]

3- Gjithashtu, në të njëjtin libër, nga libri "Fehrest" (Bibliografi) të Ibn Nedijm nga Ibn Abasi është transmetuar se surja "Hel Eta" është surja e njëmbëdhjetë medinase.[4]

4- Në librin "El Itkanu" i Sujutit përcillet nga El Bejhakij në veprën "Delalilul Nubuvve" nga Akrimetu i cili ka thënë se surja "Hel Eta" ka zbritur në Medine.[5]

5- Në "Ed Durr'rrul Menthur", po ashtu nga Ibn Abasi, është transmetuar po ky kuptim, përmes burimeve të ndryshme.[6]

---

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 405.

[2] Po aty.

[3] "Tarijkhul Kur'an", f. 55.

[4] Po aty.

[5] Tefsiri "El Mijzan", vëll. 20, f. 221.

[6] Po aty.

6- Zamakhsherij në tefsirin "El Kesh'shaf" ka përmendur shkakun e zbritjes së ajeteve të para të kësaj sureje, në lidhje me nedhrin, (sadakanë) e Imam Aliut, bashkëshortes dhe fëmijëve të tyre.[1]

7- Përveç rasteve të lartpërmendura, një grup tjetër i madh i dijetarëve të Ehli Synetit, si p.sh. El Uahidij në veprën "Esbabul Nuzul", Begauij në veprën "Mealimu Tenzil", Sibt ibn Xheuzij në veprën "Et Tedhkiretu", Genxhij Esh Shafi'ij në veprën "Kefajetut Talib" dhe një grup tjetër, zbritjen e ajeteve të para të kësaj sureje ua kanë atribuar Imam Aliut, Fatimes, Imam Hasanit dhe Imam Hysejnit. Ky fakt është një dëshmi se kjo sure është medinase, (sepse, siç e dimë, Imam Hasani dhe Imam Hysejni kanë lindur në Medine).[2]

Kjo çështje është aq e njohur dhe e përhapur, sa Muhammed ibn Idris Esh Shafi'ij, një prej katër Imamëve të Ehli Synetit, (themelues i një prej shkollave juridike), në poemën e njohur të tij shprehet: "Deri kur, deri kur dhe deri në ç'kohë? Më qortoni mua në dashurinë e këtij të riu! A iu martua Fatimja ndonjë tjetri përpos tij? A zbriti 'Hel Eta' për ndonjë tjetër?!".[3]

Ekzistojnë dhe shumë dëshmi të tjera rreth shkakut të zbritjes së ajeteve 5-9 të kësaj sureje.

Megjithatë, disa fanatikë këmbëngulin se kjo sure ka zbritur në Mekë. Ata mohojnë të gjitha transmetimet që e konsiderojnë suren si medinase, përfshirë edhe faktin se kjo sure ka zbritur për

[1] Tefsiri "El Keshshaf", vëll. 4, f. 670.

[2] "Ihkakul Hakki", vëll. 3, f. 157-170.

[3] "Ihkakul Hakki", vëll. 3, f. 158.

Imam Aliun, Fatimen, Imam Hasanin dhe Imam Husenjin *(Paqja qoftë mbi ta!)*.

Është për t'u çuditur se sa herë që ndonjë ajet apo hadith vë në pah cilësitë e Imam Aliut dhe Ehli Bejtit, një grup njerëzish e ngrenë zërin dhe shfaqin ndjeshmëri ekstreme, thuajse Islami është në rrezik, edhe pse pretendojnë se Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* është njëri prej kalifëve të drejtë dhe një prej prijësve të mëdhenj të Islamit, si dhe shfaqin dashuri ndaj Ehli Bejtit.

Ne besojmë se ky fanatizëm është rezultat i sundimit të shpirtit emevit mbi mendimet e këtij grupi, si dhe është pjellë e propagandës të asaj periudhe ogurzeze.

I lutemi All'llahut që të na mbrojë të gjithë ne prej gabimeve të tilla!

Ajetet 1 - 4

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

هَلۡ أَتَىٰ عَلَى ٱلۡإِنسَٰنِ حِينٞ مِّنَ ٱلدَّهۡرِ لَمۡ يَكُن شَيۡـٔٗا مَّذۡكُورًا١ إِنَّا خَلَقۡنَا ٱلۡإِنسَٰنَ مِن نُّطۡفَةٍ أَمۡشَاجٖ نَّبۡتَلِيهِ فَجَعَلۡنَٰهُ سَمِيعَۢا بَصِيرًا٢ إِنَّا هَدَيۡنَٰهُ ٱلسَّبِيلَ إِمَّا شَاكِرًا وَإِمَّا كَفُورًا٣ إِنَّآ أَعۡتَدۡنَا لِلۡكَٰفِرِينَ سَلَٰسِلَا۠ وَأَغۡلَٰلٗا وَسَعِيرًا٤

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Vallë, a nuk ka kaluar një periudhë kohore, kur njeriu nuk ka qenë qenie e denjë për t'u përmendur?!"

"Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun nga një pikë farë e përzier, për ta sprovuar dhe e bëmë që të dëgjojë dhe të shohë."

"Natyrisht që Ne i treguam atij Rrugën e Drejtë, që ai të jetë ose mirënjohës, ose mosmirënjohës."

"Pa dyshim, Ne kemi përgatitur për jobesimtarët zinxhirë, pranga dhe zjarr flakërues."

Komentimi

Njeriun e krijuam nga një farë e pavlerë

Edhe pse pjesa më e madhe e kësaj sureje diskuton për Kiametin dhe begatitë e Xhennetit, në fillim të saj, flitet rreth krijimit të njeriut, sepse kushtimi i vëmendjes ndaj këtij krijimi është premisë për vëmendjen ndaj Kiametit dhe Ringjalljes, ashtu siç e diskutuam më lart, në komentimin e sures "El Kijame".

Ajeti 1 thotë: **"Vallë, a nuk ka kaluar një periudhë kohore, kur njeriu nuk ka qenë qenie e denjë për t'u përmendur?!"**.

Çdo grimcë e qenies së tij ka qenë e shpërndarë nëpër qoshe, nëpër dhera, në mesin e pikave të ujërave të deteve, në ajrin që ndodhet në atmosferën e tokës. Përbërësit kryesorë të qenies së tij ishin të shpërndara në hapësira të këtyre tri mjediseve të gjera dhe ai ishte i humbur në mesin e tyre dhe as përmendej gjëkund emri i tij.

Vallë, a shënon fjala "njeri" këtu llojin e njeriut? A e përfshin të gjithë njerëzimin, apo i përket vetëm Ademit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*?

Ajeti në vijim, thotë se Ne njeriun e krijuam prej një pike fare. Ky pohim është një aluzion i qartë për kuptimin e parë. Disa komentues janë të mendimit se fjala "njeri", në ajetin e parë, shënon Ademin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, kurse fjala "njeri", në ajetin e dytë, flet për fëmijët e Ademit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Kjo ndarje duket e papranueshme.

Për komentimin e sifjalisë *"lem jekun shejen medhkura"* - **"kur njeriu nuk ka qenë qenie e denjë për t'u përmendur"**, janë dhënë mendime të tjera dhe pohojnë se, kur njeriu ishte në botën e spermës dhe të embrionit, nuk ishte krijesë për t'u përmendur. Por më pas, kur kaloi etapat e përsosmërisë, u shndërrua në një krijesë të denjë për t'u përmendur...

Në një hadith të transmetuar nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)*, është transmetuar: *"Njeriu, në 'diturinë e Zotit' ishte i përmendur, megjithëse në botën e krijimit nuk ishte i përmendur."*.[1]

Në disa libra të komentimeve thuhet se fjala "njeri" këtu shënohen dijetarët dhe njerëzit e shkencës, të cilët, para se të përvetësonin diturinë, nuk përmendeshin, por, pasi mbërritën në pozitën e dijetarit të pranuar nga të gjithë njerëzit, nga këto çaste e tutje, në jetën tokësore dhe në jetën pas vdekjes së tyre, përmenden kudo.

Në disa tefsire të tjera, gjithashtu, është thënë se Omer Ibn Khatabi dëgjoi dikënd që po lexonte këtë sure dhe tha: "Ah sikur Ademi të kishte mbetur ashtu siç ishte e të mos kishte lindur dhe fëmijët e tij të mos ishte vënë në sprovë.".[2]

Kjo shprehje është e çuditshme, sepse në realitet është një kritikë ndaj çështjes së krijimit.

Sidoqoftë, pas kësaj etape, vjen radha e krijimit të njeriut dhe krijesës, i cili tashmë, është në gjendje për t'u përmendur. Ajeti 2

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 406.

[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10 f. 406.

thotë: **"Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun nga një pikë farë e përzier, për ta sprovuar dhe e bëmë që të dëgjojë dhe të shohë."**.

Fjala *"emshaxhun"* është shumësi i fjalës *"meshexh"* ose shumësi i *"meshijxhun"* dhe është në kuptimin e një gjëje të përzier.

Krijimi i njeriut nga **"një pikë fare e përzier"** ka gjasa të jetë tregues për përzierjen e spermës së burrit me të gruas, pra, bashkimi i "spermës" me "evolun", të cilën e hasim edhe në hadithet e Ehli Bejtit; ose është aludim për kapacitetet e ndryshme që ekzistojnë në brendësi të farës, të (spermës), si mbartja e trashëgimisë me anë të geneve dhe të ngjashme me to. Ashtu siç mund të shënojë edhe përzierjen e përbërësve të ndryshëm, të kombinuara të farës, (spermës), sepse ajo përbëhet nga dhjetëra lëndë të ndryshme; ose përzierjen e të gjitha këtyre me njëra-tjetrën. Interpretimi i fundit është më gjithëpërfshirës dhe më i përshtatshëm se të gjithë të tjerët.

Ekziston edhe mundësia që fjala *"emshaxhun"* të tregojë për transformimet e pikës së farës në periudhën embrionale.[1;2]

[1;2] Duhet të kemi parasysh faktin se fjala *"nutfetun"* është në numrin njëjës dhe mbiemri i saj *"emshaxhun"* është në numrin shumës. Është kështu, sepse fjala *"nutfetun"* është e përbërë prej pjesëve të ndryshme dhe është në pozitën e shumësit. Disa të tjerë, si Zamakheshri, në veprën e tij "El Kesh'shaf", ka pohuar se fjala *"emshaxhun"* është në numrin njëjës, edhe pse përdoret në numrin shumës. Edhe shkenca e sotshme e ka argumentuar që sperma e burrit është e përbërë nga disa ujëra të ndryshme, ku secila nga këto ujëra, në një masë të caktuar, është krijuar për një qëllim të veçantë. Më pas drejtohet drejt mitrës, në barkun e nënës. Kjo përputhet më shumë me fjalën *"imshaxhun"*.

Fjalia *"nebtelijhi"* tregon ngritjen e njeriut në pozitë, në "përgjegjësinë e angazhimit, të detyrës dhe të sprovës". Kjo është një prej bekimeve më të mëdha të Zotit, që i dhuroi njeriut dinjitet, e fisnikëroi dhe e bëri të denjë për të qenë "përgjegjës dhe i zbatues".

Meqenëse "sprova" dhe "përgjegjësia" janë të pamundura pa "njohurinë", në fund të ajetit, All'llahu përmend instrumentet e njohjes, siç janë sytë dhe veshët, të cilat i ka vënë në dispozicion të njeriut.

Disa komentues të tjerë, gjithashtu, kanë deklaruar se me fjalën *"sprovë"*, në këtë ajet, kuptohen transformimet dhe ndryshimet që e shoqërojnë fetusin nga momenti i ngjizjes derisa të bëhet një njeri i përkryer.

Por, duke pasur parasysh fjalën *"nebtelijhi"* dhe fjalën *"insan"*, komentimi i parë është më i përshtatshëm.

Kjo shprehje tregon se rrënja e të gjitha perceptimeve të njeriut janë perceptimet e tij ndijore. Thënë ndryshe, perceptimet ndijore janë "nëna" e të gjitha "koncepteve të arsyes. Ky është mendimi i shumë filozofëve myslimanë. Edhe filozofi grek, Aristoteli, së bashku me disa filozofëve të tjerë, njihet si përkrahës i këtij mendimi.

Sprovimi dhe përgjegjësia e njeriut, përveç informimit dhe mjetit të njohjes, kanë nevojë edhe për dy faktorë të tjerë, për "udhëzimin" dhe "vullnetin e lirë". Ajeti vijues thotë për këtë: **"Natyrisht që Ne i treguam atij Rrugën e Drejtë, që ai të jetë ose mirënjohës, ose mosmirënjohës."**.

Fjala *"hidajetun"* ka një kuptim gjithëpërfshirës. Ky kuptim përfshin udhëzimin "ontologjik" (në krijim), atë të "natyrës", si dhe udhëzimin "legjislativ" (teshrii), megjithëse ajeti anon më shumë nga udhëzimi legjislativ.

Shpjegimi është ky: Meqenëse All'llahu e ka krijuar njeriun me synim "sprovimin, testimin e përsosmërisë së tij", në qenien e tij ka përgatitur kushtet e nevojshme për t'ia arritur këtij qëllimi, i ka dhuruar atij aftësitë e nevojshme. Pikërisht ky është udhëzimi "ontologjik" (në krijim).

Më pas, në thellësi të natyrës së tij, ka mbjellë dashurinë për të ndjekur këtë rrugë dhe, me anë të frymëzimeve natyrore (shpirtërore), i ka treguar udhën, kështu që edhe nga kjo pikëpamje ka kryer udhëzimin "natyror".

Nga ana tjetër, ka dërguar Profetë të mëdhenj, këta udhëheqës qiellorë me dispozita dhe rekomandime të qarta, për të "treguar rrugën" dhe nëpërmjet tyre ka përmbushur dhe udhëzimin "legjislativ". Natyrisht, këto tri degë të udhëzimit, kanë aspekt gjithëpërfshirës (përfshijnë të gjithë njerëzit).

Në tërësi, ky ajet përmend tri çështje të rëndësishme dhe vendimtare në jetën e njeriut:

Çështja e "përgjegjësisë", e "udhëzimit" dhe çështja e "vullnetit të lirë", të cilat janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën dhe plotësuese të njëra-tjetrës.

Ndërkaq fjalia: **"Natyrisht që Ne i treguam atij Rrugën e Drejtë, që ai të jetë ose mirënjohës, ose mosmirënjohës."**, e flak tutje drejtimin determinist.

Fjalët *"shakiran"* dhe *"kefuran"* janë më se të përshtatshme dhe mund të përdoren këtu, sepse karshi begatisë së madhe të udhëzimit të All'llahut, ata që dorëzohen, që e pranojnë atë, si dhe marrin Rrugën e Udhëzimit, rrjedhimisht e kanë falënderuar për këtë begati, kurse ata që kundërshtojnë, janë treguar mosmirënjohës.

Duke u nisur nga fakti që dora dhe gjuha e askujt nuk del që të përmbushë të drejtën e falënderimit ndaj All'llahut, së bashku me fjalën *"shukr"* ka përdorur emrin aktiv (shakir - falënderues), ndërkohë për "mosmirënjohjen" ka përdorur mbiemër me paradigmë hiperbolike (kefur – shumë mosmirënjohës), sepse ata që e shpërfillin këtë begati të madhe, tregojnë mosmirënjohjen më të madhe, sepse All'llahu i Madhëruar ka vënë në dispozicion të tyre lloj-lloj mjetesh për t'u udhëzuar dhe do të ishte kulmi i mosmirënjohjes, që të gjitha këto t'i nëpërkëmbin, t'i shpërfillin dhe, si rrjedhojë të ndërmarrin udhën e gabuar.

Ndërkohë, duhet të kemi parasysh se fjala *"kefurun"* është një fjalë që përdoret edhe për mohimin e begatisë, (mosmirënjohësit), edhe për mosbesimin ideologjik (ashtu siç e ka përmend edhe Ragibi në veprën "Mufredat".

Në ajetin e fundit të diskutimit tonë, flitet shkurt, por kuptimplotë, në lidhje me fatin e atyre që kanë ndërmarrë rrugën e mosbesimit dhe të mosmirënjohjes: **"Pa dyshim, Ne kemi përgatitur për jobesimtarët zinxhirë, pranga dhe zjarr flakërues."**.

Fjala *"e'atedna"* - **"kemi përgatitur"** thekson se dënimi i këtij grupi është i pashmangshëm. Është e drejtë që përgatitjet paraprake janë vepër e individëve, të cilët kanë fuqi të kufizuara

dhe mendojnë se në momentin e nevojës mund të mos i kenë këto fuqi. Kjo është diçka që nuk përputhet me All'llahun, sepse çdo gjë që Ai dëshiron, realizohet menjëherë me anë të urdhrit "Bëhu!" Por, për të shprehur sigurinë e dënimit të jobesimtarëve, ajeti deklaron se mjetet e dënimit të tyre janë të përgatitura që tani.

Fjala "*selasile*", është shumësi i fjalës "*silsiletun*", është përdorur me kuptimin e zinxhirit, kurse fjala "*eglalun*" është shumësi i fjalës "*gil'lun*" dhe tregon rrethin e prangave që i vënë në duar apo në qafë e më pas e lidhin me zinxhir.[1]

Sidoqoftë, përmendja e zinxhirit dhe e prangave dhe më pas e zjarrit flakërues, vënë në pah dënimet e mëdha dhe të rënda që i përkasin këtij grupi. Një gjë e tillë është paraqitur edhe në ajetet e tjera kur'anore, të cilat përmbledhin në vetvete "dënimin" dhe "robërimin".

Liria e epsheve të tyre këtu bëhet shkak për robërimin e tyre atje, zjarret që i kanë ndezur vetë në këtë botë, atje, në Botën Tjetër do të personifikohen dhe do t'i kaplojnë.

[1] Një shpjegim më të detajuar, në lidhje me fjalën "*eglalun*" është dhënë në ajetin 8 të sures "Ja Sin".

Hulumtim

Bota e çuditshme e fetusit

Ne e dimë se embrioni i njeriut formohet nga bashkimi i spermës së burrit me ovullën, vezën e gruas. Kjo spermë e bashkuar, si dhe fazat e ndryshme të fetusit janë nga mrekullitë dhe çudirat e mëdha të botës së krijimit. Me përparimin e shkencës së embriologjisë janë zbuluar sekretet e ndryshme të saj, edhe pse sekretet më të shumta akoma mbeten për t'u zbuluar. Këtu do të përmendim disa nga mrekullitë e përmendura, të cilat përbëjnë vetëm një aspekt të vogël:

1- *El hamijnu*, që del nga burri, bashkë me ujin e farës, është një qenie e gjallë, e lëvizshme, shumë e vogël, mikroskopike. Ajo përbëhet nga koka, qafa dhe bishti. Mbresëlënës është fakti që në çdo ejakulim të burrit derdhen nga 2-5000.000.000 spermatozoidë, në numër, sa popullsia e disa shteteve. Nga ky numër i pafund, në vezore depërton vetëm një apo ca prej tyre. Aty ndodh fekondimi.

2- Mitra, para shtatzënisë, është sa një arrë, si përmasë, por pas frekuentimit të embrionit dhe rritjes së fetusit, ajo rritet aq shumë, sa zë një hapësirë të madhe. Interesant është fakti që muri i saj është aq shumë i ndjeshëm, saqë e përballon këtë vëllim të madh në mënyrë të plotë.

3- Gjaku në membranën e mitrës nuk ndodhet brenda damarëve dhe venave të gjakut, por rrjedh lirshëm midis muskujve, sepse ndryshe nuk mund të rezistonte përballë elasticitetit tepër të lartë të murit (membranës) të mitrës.

4- Disa dijetarë janë të mendimit se fara e gruas ka elektricitet pozitiv, kurse sperma ka elektricitet negativ, prandaj dhe tërhiqen nga njëra-tjetra. Në momentin që sperma futet në vezore, e kthen në negative masën elektrike të saj dhe për këtë shkak spermatozoidet e shumtë që ndodhen rreth saj, largohen. Disa mendimtarë kanë propozuar se me depërtimin e spermës lëshohet një sekrecion kimik i posaçëm, i cili i përzë spermatozoidet e tjerë.

5- Fetusi është duke lundruar brenda një qeseje të madhe, në një lëng të dendur, të quajtur amenibus, i cili ka aftësi kundër goditjeve që mund të bëjë nëna, apo goditjeve të diçkaje në bark. Përveç kësaj, ajo e mban temperaturën në një nivel të caktuar, në mënyrë që ndërrimi i temperaturës së jashtme nuk ndikon për një kohë të gjatë. Më i çuditshëm është fakti se e vendos atë në gjendje të mospeshimit dhe kështu parandalon presionin e gjesteve të ndryshme të fetusit, të cilat mund të sillnin shumë dëme te nëna.

6- Të ushqyerit e fetusit bëhet me anë të placentës dhe kërthizës, d.m.th. nga gjaku i nënës. Oksigjeni futet në placentë së bashku me lëndët ushqimore dhe pas një rifiltrimi përmes kërthizës, futet në zemrën e fetusit dhe më pas shpërndahet në të gjitha organet e trupit. Është për t'u përmendur se ana e djathtë dhe e majtë e zemrës së fetusit është e lidhur për frymëmarrjen me anë të mushkërive, sepse embrioni nuk merr frymë, por sa vjen në këtë botë, gropat ndahen nga njëra-tjetra dhe aparati i frymëmarrjes fillon së punuari.

Ajetet 5 - 11

إِنَّ ٱلۡأَبۡرَارَ يَشۡرَبُونَ مِن كَأۡسٖ كَانَ مِزَاجُهَا كَافُورًا٥ عَيۡنٗا يَشۡرَبُ بِهَا
عِبَادُ ٱللَّهِ يُفَجِّرُونَهَا تَفۡجِيرٗا٦ يُوفُونَ بِٱلنَّذۡرِ وَيَخَافُونَ يَوۡمٗا كَانَ شَرُّهُۥ
مُسۡتَطِيرٗا٧ وَيُطۡعِمُونَ ٱلطَّعَامَ عَلَىٰ حُبِّهِۦ مِسۡكِينٗا وَيَتِيمٗا وَأَسِيرًا٨ إِنَّمَا
نُطۡعِمُكُمۡ لِوَجۡهِ ٱللَّهِ لَا نُرِيدُ مِنكُمۡ جَزَآءٗ وَلَا شُكُورًا٩ إِنَّا نَخَافُ
مِن رَّبِّنَا يَوۡمًا عَبُوسٗا قَمۡطَرِيرٗا١٠ فَوَقَىٰهُمُ ٱللَّهُ شَرَّ ذَٰلِكَ ٱلۡيَوۡمِ وَلَقَّىٰهُمۡ
نَضۡرَةٗ وَسُرُورٗا١١

"Sigurisht, të ndershmit besimtarë do të pinë (në Xhennet) **kupa me pije të përzier me Kafur."**

"Nga burimi që vetëm robtë e All'llahut pinë dhe të cilin mund ta çojnë nga të duan."

"Ata e zbatojnë premtimin dhe i frikësohen Ditës (së Kiametit)**, tmerri i së cilës përhapet gjithkund."**

"Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënët rob edhe pse vetë janë nevojtarë,"

"duke thënë: 'Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim!'"

"Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t'i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura."

"Por All'llahu do t'i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t'u japë shkëlqim dhe gëzim."

Shkaku i zbritjes

Argument madhështor mbi virtytin e Ehli Bekjtit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

Ibn Abasi ka thënë: "Imam Hasani dhe Imam Hysejni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)* ishin të sëmurë. Profeti, së bashku me disa shokë, shkoi për t'i vizituar. Ndërkohë iu drejtua Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*: '*O Ebu Hasan! Do të ishte mirë, që të kishe bërë një nedhër për shërimin e fëmijëve të tu.'*. Imam Aliu, Hz. Fatimeja dhe Fedhdhetu, shërbëtorja e tyre, vendosën se, nëse fëmijët shërohen, do të agjërojnë tri ditë. (Sipas disa transmetimeve edhe Imam Hasani dhe Imam Hysejni vendosën të agjëronin.)

Nuk kaloi shumë kohë dhe që të dy u shëruan. Ndërkohë u mungonin lëndët ushqimore në shtëpi. Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* mori borxh ca kile grurë. Fatimja e bloi një të tretën e tij dhe me miellin gatoi bukë. Në kohën e iftarit, në shtëpinë e tyre erdhi një varfanjak dhe iu drejtua me fjalët: 'Paqja qoftë mbi ju o Familja e Muhammedit! Unë jam një nevojtar prej fukarenjve myslimanë. Ju

lutem, më jepni pak ushqim që All'llahu t'ju dhurojë ushqimin e Xhennetit.'.

Të gjithë ushqimin ia dhuruan këtij njeriu. Atë natë nuk futën gjë në gojë, përveç ujit që pinë.

Ditën e dytë, gjithashtu, agjëruan dhe në kohën e iftarit e shtruan sofrën me ushqimin, bukën prej gruri. Përsëri u dëgjua trokitja e derës. Ishte një jetim që kërkonte ushqim dhe çfarë kishin për vete, ia dhanë atij. (Edhe këtë herë bënë iftar vetëm me ujë dhe vazhduan të agjëronin ditën e tretë.)

Në ditën e tretë, një person i zënë rob, në kohën e perëndimit të diellit, erdhi në shtëpinë e tyre. Sërish secili prej tyre i dhanë atij pjesën e ushqimit të vet. Pra, të gjithë sakrifikuan ushqimin për të. Të nesërmen në agim, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* kapi për dore Imam Hasanin dhe Imam Hysejnin *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)* dhe shkuan te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e pa se atyre u dridheshin këmbët nga uria, ndër të tjera tha: *'Për Mua është shumë e vështirë t'ju shoh në këtë gjendje.'"*.

Më pas u ngrit në këmbë dhe u nis me ata. Kur hynë në shtëpinë e Fatimes, e pa që ishte e zënë me adhurim. Ndërkohë, nga uria e tepërt, barku i ishte ngjitur me kurrizin, sytë i ishin futur brenda. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u shqetësua.

Në këtë kohë zbriti Xhebraili dhe tha: *"O Muhammed! Merre këtë sure. Zoti i Madhëruar të përgëzon me një familje të tillë!"*. Më pas

ia lexoi suren "Hel Eta". (Disa kanë thënë se i lexoi tetëmbëdhjetë ajete, nga ajeti i pestë deri tek ajeti 22.)

Më lart u tha teksti i hadithit, i cili, me pak shkurtime, është shënuar në librin "El Gadijr" si teksti i përbashkët i transmetimeve të shumta rreth kësaj ngjarjeje. Në këtë libër janë shënuar edhe emrat e 34 dijetarëve të famshëm syni, që e kanë cituar në librat e tyre këtë hadith (në titullin e librit dhe brenda tij).

Pra, hadithi i lartpërmendur është gjerësisht i njohur prej dijetarëve syni.[1]

Dijetarët shiia mendojnë se këto tetëmbëdhjetë ajete, apo pjesa më e madhe e kësaj sureje, ka zbritur rreth ngjarjes së lartpërmendur. Të gjithë, pa përjashtim, në librat e komentimit të Kur'anit apo të hadithit, këtë hadith e kanë përmendur si një prej shkaqeve të krenarisë dhe virtyteve të rëndësishme të Imam Aliut e Fatime Zahrasë dhe fëmijëve të tyre.

Përveç kësaj, ashtu siç e diskutuam edhe në fillim të sures, kjo ngjarje është aq e njohur dhe e përhapur, saqë është pasqyruar edhe në poezitë e poetëve, përfshirë odën e njohur të Imam Shafi'iut.

Kritikuesit fanatikë, ashtu siç kanë zakon, sa herë që hasin në virtytet e Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, shfaqin një ndjeshmëri të jashtëzakonshme. Ata kanë treguar shumë zell për të sjellë kundër argumente dhe kanë bërë vërejtje të ndryshme rreth shkakut të zbritjes. Midis këtyre vërejtjeve, përmendim:

[1] "El Gadijr", vëll. 3, f. 107–111 dhe në librin "Ihkakul Hakki", vëll. 3, f. 157-171. Hadithi i lartpërmendur është transmetuar nga 36 dijetarë dhe shkencëtarë syni.

1- Kjo sure është mekase, ndërkohë që ngjarja për shkakun e zbritjes i përket periudhës pas lindjes së Imam Hasanit dhe Imam Hysejnit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)*, ndërkohë që këta dy imamë kanë lindur në Medine.

Por ashtu, siç e shpjeguam gjerësisht në fillim të kësaj sureje, kemi argumente të qarta, të cilat vërtetojnë se e gjithë surja, apo së paku tetëmbëdhjetë ajete të saj, kanë zbritur në Medine.

2- Rrëfimi i ajetit është i përgjithshëm. Atëherë, si është e mundur që t'u atribuohet personave të caktuar?

Kuptimi përgjithësues i ajetit nuk bie në kundërshtim me zbritjen e tij për një rast të posaçëm. Shumë prej ajeteve kur'anore kanë kuptim gjithëpërfshirës, por shkak për zbritjen e tyre është bërë një gjë apo person i veçantë. Por nuk është e drejtë që kuptimin përgjithësues të një ajeti, pavarësisht shkakut të zbritjes, ta personalizojë dikush dhe ta marrë si argument për mohimin e shkakut të zbritjes së tij.

3- Disa komentues të tjerë kanë transmetuar shkaqe të tjera zbritjeje rreth këtij ajeti, të cilat, nuk përputhen me shkakun e lartpërmendur. P.sh, Sujutij në "Ed Durrul Menthur" ka transmetuar se një zezak erdhi te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe e pyeti për tesbihun dhe tehlilin.

Omeri tha: "Mjaft! I ke bërë shumë pyetje Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.".

Profeti iu kthye: "Ej Omer! Pusho!" .

Ky rast u bë shkak për zbritjen e sures "Hel Eta".[1]

Në një hadith tjetër, po në këtë libër, thuhet se një burrë nga Hebeshja erdhi pranë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe donte ta pyeste atë. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha: "Pyet dhe mëso.".

Burri e pyeti: "O i Dërguari i All'llahut, grupi juaj, për nga ngjyra, fytyra dhe profetësia qëndron më lart se ne. A do të jem me ty në Xhennet, nëse unë besoj në atë që keni besuar ju dhe veproj ashtu siç keni vepruar ju?".

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "Po, betohem në All'llahun që jeta ime është në dorën e Tij, se bardhësia e zezakëve në Xhennet do të vërehet nga njëmijë vite rrugë.".

Më pas, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tregoi për shpërblimet e rëndësishme për shqiptimin e shprehjes: "La ilahe ilAll'llah, ue subhanell'llah ue bihamdih".

Këtu zbriti surja "Hel Eta".[2]

Por duke parë se këto hadithe pothuajse nuk kanë asnjë përshtatshmëri me përmbajtjen e ajeteve të sures "Hel Eta", arrijmë të kuptojmë se kemi të bëjmë me falsifikim nga ana e përfaqësuesve të Beni Umejes dhe e të ngjashmëve me ta, për të nëpërkëmbur shkakun e zbritjes së vërtetë, në lidhje me Familjen e Profetit

[1] Tefsiri "Ed Durrul Menthur", vëll. 6, f. 298.

[2] Tefsiri "Ed Durrul Menthur", vëll. 6, f. 297.

Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

4- Pretendimi tjetër i tyre lidhet me pyetjen: "Si është e mundur që njeriu të qëndrojë i uritur tri ditë me radhë dhe të bëjë iftar vetëm me ujë?!". Këtë pretendim po e diskutojmë.

Në fakt, kjo është një kritikë e çuditshme, sepse ne dimë jo pak raste, që për arsye shëndetësore, njerëzit kanë praktikuar jo tri ditë agjërim, por madje agjërimin e njohur 40 ditor, pra, 40 ditë të plota kanë konsumuar vetëm ujë. Ata absolutisht nuk kanë konsumuar ndonjë ushqim. Po kjo vepër është bërë shkak për shërimin e shumë prej sëmundjeve të tyre, madje një prej mjekëve të njohur jo myslimanë, me emër Aleksi Soforin, ka shkruar një libër[1] për efektet mjekësore të një agjërimi të tillë, duke paraqitur një program të saktë dhe të përpiktë.

Madje, nëse nuk do të ishte e çuditshme për ju, disa nga bashkëpunëtorët tanë, në këtë komentim, e kanë praktikuar këtë agjërim gjer në 22 ditë të plota.

5- Disa të tjerë kanë zgjedhur një rrugë tjetër. P.sh, Alusij thotë: "Edhe nëse pohojmë, që kjo sure nuk ka zbritur për Aliun dhe Fatimen, nuk do t'u humbiste ndonjë vlerë, sepse prania e tyre në radhën e të devotshmëve është një çështje që e dinë të gjithë. Më pas, përmend disa nga virtytet e tyre dhe shton: "Çfarë mund të thotë njeriu për këta dy persona të nderuar dhe të respektuar, veçse: 'Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* është prijësi i besimtarëve dhe mëkëmbësi i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, Fatimja është pjesë e trupit të Profetit

[1] "Es Seum Tarijkatun hadijthetun li shifail emradhi"

Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe pjesë e ekzistencës Muhammedane, kurse Hasani dhe Hysejni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)* janë shpirt, trëndafila dhe dy zotërinjtë e të rinjve të Xhennetit.'".

Kjo nuk do të thotë që të heqim dorë nga të tjerët, madje çdokush që ndjek rrugë tjetër, përveç kësaj rruge, është i humbur (ka devijuar).[1]

Por ne themi: "Në qoftë se pajtohemi që një virtyt, me një popullaritet të tillë, të mos e marrim parasysh, atëherë edhe virtytet tjera, në mënyrë graduale, do të pësojnë të njëjtin fat dhe do të arrijë një ditë, kur do të mohojnë virtytshmërinë e Imam Aliut, Fatimes, Imam Hasanit dhe Imam Hysejnit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)*!".

Duhet të kemi parasysh dhe këtë, që në disa hadithe, nga vetë Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* është transmetuar, që në shumë raste, karshi kundërshtarëve të vet, ka sjellë argumente, që këto ajete kanë zbritur për të dhe familjen e tij.[2]

Është për tu theksuar fakti se në Medine zakonisht kishte "rob", ndërsa në Mekë për shkak se nuk kishte nisur akoma fushata islame kishte më pak "robër", kjo gjë është një tjetër dëshmi e të qenurit medinase kjo sure.

Pika e fundit, që është e nevojshme ta përmendim këtu, është fakti se disa dijetarë myslimanë, si Alusiu, komentuesi i njohur i Ehli Synetit, ka përmendur se në këtë sure hasim shumë

[1] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 29, f. 158.

[2] "El Ihtexhaxh" i Et Tabrasij dhe "Khisalu" i Sadukut, sipas transmetimit të tefsirit "El Mijzanit", vëll. 20, f. 224.

prej begative të Xhennetit, por për "hurul ejn"(vajzat sybukura të Parajsës), që zakonisht përmenden në Kur'anin Famëlartë midis begative të Xhennetit, nuk flitet fare. Ka gjasa që kjo mospërmendje të jetë ngaqë kjo sure zbriti për Fatimen, bashkëshortin e djemtë e saj dhe për hir të respektit ndaj Zonjës së Islamit *(Paqja qoftë mbi të!)*. Në këtë sure nuk thuhet asnjë fjalë për hyritë sybukura.[1]

Edhe pse diskutimi ynë për këtë temë u zgjat shumë, ishim të detyruar ta bënim, për shkak të kritikave dhe vërejtjeve të kundërshtarëve.

Komentimi

Shpërblimi madhështor i mirëbërësve të devotshëm

Në ajetet e kaluara, pasi njerëzit u ndanë në dy grupe "falënderues" dhe "mohues" apo në "mirënjohës" dhe "mosmirënjohës", diskutuam shkurtimisht për ndëshkimet e ashpra për mosmirënjohësit dhe për shpërblimet e mirënjohësve dhe të devotshmëve. Këtu po sjellim shënime tepër interesante rreth kësaj çështjeje.

Në ajetin 5 Kur'ani thotë: **"Sigurisht, të ndershmit besimtarë do të pinë** (në Xhennet) **kupa me pije të përzier me Kafur."**.

[1] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 29, f. 158.

Fjala *"el ebraru"* është shumësi i fjalës *"berr'rrun"*. Kuptimi kryesor i saj është gjerësia dhe shtrirja, prandaj fushat e gjera janë quajtur *"berr'rrun"*. Meqenëse veprat e mirëbërësve kanë ndikim të gjerë në nivelin shoqëror, kjo fjalë përdoret me këtë konotacion, kurse fjala *"birr'rrun"* tregon mirëbërjen, bamirësisë. Sipas disa dijetarëve, dallimi midis saj dhe fjalës *"khajrun" (hajr)*, konsiston në faktin se fjala *"birr'rrun"* është në kuptimin e mirësisë, të cilës i kushtohet vëmendje, kurse fjala *"khajrun"* ka një kuptim më të gjerë.

Fjala *"kafur"* ka kuptime të ndryshme leksikore. Një nga kuptimet e njohura të saj, është era apo aroma e këndshme. Kafuri njihet si bimë aromatike, me erë të fortë, që përdoret në mjekësi.

Pavarësisht kësaj, ajeti i lartpërmendur tregon se kjo pije e Parajsës mban erë të këndshme. Ajo e kënaq njeriun, edhe me shijen e vet, edhe me aromën e vet. Ka komentues që kanë thënë: "'*Kafurun*' është emri i një prej burimeve të Xhennetit." Ky interpretim nuk përputhet me sifjalinë: **"kupa me pije të përzier me Kafur"**.

Nga ana tjetër, duke pasur parasysh faktin se fjala *"kafurun"* rrjedh nga fjala *"kefer"* që përdoret me kuptimin e *"mbulesës"*, disa gjuhëtarë, midis tyre edhe Ragibi, në librin "Mufredat", janë të mendimit se është zgjedhur ky emër për kafurin, sepse ajo fshihet mes lëvores së frytit të pemës. Disa të tjerë kanë thënë se e kanë quajtur *"kafurun"*, për shkak të bardhësisë së jashtëzakonshme dhe freskisë së saj, sepse kafuri i zakonshëm njihet gjerësisht për freskinë dhe bardhësinë e tij.

Interpretimi i parë duket si më i përshtatshëm, sidomos duke e ditur që shpesh fjala *"kafur"* është përmendur krahas miskut dhe ambrit, të cilët janë nga aromat më të preferuara.

Më pas ajeti përmend burimin e kësaj pijeje të pastër dhe thotë për këtë: **"...nga burimi që vetëm robtë e All'llahut pinë dhe të cilin mund ta çojnë nga të duan."**. Ky burim i kësaj pije të pastër është plotësisht në funksion të mirëbërsve të devotshëm dhe robëve të All'llahut.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)*, jepen shpjegime rreth saj. Ai thotë: *"Ky është një burim në shtëpinë qiellore të Profetit të Islamit dhe prej atje rrjedh drejt shtëpisë të Profetëve dhe besimtarëve të tjerë. Ashtu si në këtë botë burimet e dijes dhe të mëshirës gufojnë nga shtëpia e Profetit të nderuar dhe rrjedhin drejt robve të All'llahut dhe mirëbërësve, edhe në Ahiret, burimi i pijes së pastër hyjnore buron nga kjo shtëpi e Shpalljes dhe degët e tij rrjedhin nëpër shtëpitë e besimtarëve!"*.

Fjala *"jufexh'xhirune"* tregon çarjen e gjerë, qoftë çarja e tokës apo diçka tjetër. Çarjen e natës nga drita e mëngjesit e quajnë *"fexhr"*, kurse personin imoral e quajnë *"faxhir"*, në kuptimin e çarjes së perdes së turpit.

Ajeti që po diskutojmë, këtë fjalë e ka përdorur me kuptimin e çarjes së tokës.

Këtu do të tregojmë se në mesin e begative të shumëllojshme të Xhennetit, të cilat përmenden në këtë sure, begatia e parë është pija e spastruar aromatike, për të cilën diskutuam, sepse pas përfundimit të llogaridhënies në atë Ditë të tmerrshme, sapo besimtarët hyjnë në Xhennet, u jepet kjo pije, e cila u largon çdo lloj

brenge, shqetësimi dhe papastërtie. Besimtarët, të dehur nga dashuria e Zotit, shijojnë begatitë e tjera të Xhennetit.

Në vijim, ajetet flasin për veprat dhe cilësitë me të cilat karakterizohen mirëbërësit e devotshëm dhe robtë e All'llahut. Përmenden pesë cilësi dhe shpjegojnë arsyen e meritimit të tyre, mes aq shumë begatish.

Ajeti 7 thotë: **"Ata e zbatojnë premtimin dhe i frikësohen Ditës** (së Kiametit)**, tmerri i së cilës përhapet gjithkund."**.

Foljet *"jufune"* dhe *"jekhafune"* në fjalitë në vijim, janë në kohën e tashme dhe bëjnë të qartë se ky është programi dhe praktika e tyre e vazhdueshme dhe e qëndrueshme.

Sigurisht, ashtu siç e diskutuam, shkaku i zbritjes, shembulli më i përsosur dhe më i plotë i këtyre ajeteve janë: Imam Aliu, Fatimja dhe dy djemtë e tyre, Hasani dhe Hysejni *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)*, të cilët premtimin e tyre në lidhje me tri ditët e agjërimit e përmbushen duke bërë iftar vetëm me ujë. Zemra e tyre ishte e mbushur me frikën ndaj All'llahut dhe druajtjen e Kiametit.

Fjala *"mustetijra"* është përdorur me kuptimin e shtrirjes dhe të përhapjes së dënimeve të shumëllojshme në Atë Ditë të madhe.

Frika e tyre nga sherri i Asaj Dite të madhe tregon besimin e tyre në Ringjallje, si dhe përgjegjësinë e madhe që ndiejnë karshi urdhrit hyjnor. Ata kanë besuar në të përjetshmen dhe kanë besim për vërtetësinë e të gjitha dënimeve të keqbërësve në Atë Ditë. Gjurmët e këtij besimi janë plotësisht të dukshme në veprat e tyre. Pas kësaj, ajeti 8 përmend veprën e tretë të merituar të tyre: **"Ata i**

ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënët rob edhe pse vetë janë nevojtarë…".

Të ushqyerit e tyre nuk është kaq e thjeshtë. Ajo, së bashku me vetëflijimin në kohën e nevojës së madhe, është një bamirësi e gjerë, që shtrihet në lloje të ndryshme të varfërisë, siç është jetimi, varfanjaku dhe i zëni rob, kështu që mëshira e tyre është e përgjithshme dhe shërbimi i tyre është i gjerë.

Përemri *"ala hub'bihi"* i referohet ushqimit për të cilin kanë nevojë, por përsëri preferojnë ta dhurojnë atë. Kjo është e ngjashme me konceptin që është diskutuar në ajetin 92 të sures "Ali Imran" ku thuhet: **"Kurrë nuk do ta arrini sinqeritetin e plotë në besim** (as kënaqësinë e lumtur në Xhennet)**, derisa nuk e jepni më të dhembshmen e pasurisë suaj..."**.

Disa kanë thënë se përemri në fjalë i referohet All'llahut. Kjo fjalë përmendet në ajetet e kaluara dhe do të thotë se ata ushqejnë për hir të dashurisë ndaj All'llahut. Por duke pas parasysh faktin se kjo çështje trajtohet në ajetin në vijim, duket që interpretimi i parë është më i saktë.

Domethënia e fjalëve *"i varfër"*, *"jetim"* dhe *"i zënë rob"* është e qartë, por ajo që është objekt diskutimi midis komentuesve të Kur'anit ka të bëjë me pyetjen se për cilin "të zënë rob" bëhet fjalë në këtë ajet?

Shumë komentues kanë thënë se këtu bëhet fjalë për zënien rob të politeistëve dhe të jobesimtarëve, të cilët i sillnin në shtetin islam të asaj kohe, pra, në Medine.

Disa kanë dhënë mendimin se bëhet fjalë për skllevërit që janë zënë nga pronarët e tyre.

Një pjesë e tyre kanë konsideruar si "të zënë rob" të burgosurit. Komentimi i parë është më i përshtatshëm dhe më i njohur.

Këtu lind pyetja: "I zëni rob që trokiti në derën e Imam Aliut, ishte i burgosur, apo jo? Kësaj pyetjeje i është dhënë përgjigje nga transmetimet e librave të historisë në kohën e Profetit, ku thuhet se në mënyrë absolute nuk ekzistonte asnjë i burgosur. I Dërguari i respektuar i shpërndante robërit e zënë dhe ua kishte besuar myslimanëve duke u thënë: *'Kujdesuni për ta, respektoni dhe ndihmojini ata.'*. Nëse dikush nuk kishte mundësi të siguronte ushqim për ta, kërkonte ndihmën e myslimanëve të tjerë për t'i ushqyer, i dërgonin të shoqëruar apo të pashoqëruar në shtëpitë e myslimanëve, me qëllim që t'i ndihmonin, sepse në atë kohë myslimanët ishin në kushte tepër të vështira.

Është e vërtetë që më vonë, kur shteti islam u përhap dhe numri i robërve u shtua dhe për shkak të zmadhimit të arealit të shtetit, kriminelët u shtuan, u krijua institucioni i burgut dhe ushqimi i robërve dhe i kriminelëve bëhej nga buxheti i shtetit.

Sidoqoftë, nga ky ajet kuptojmë se një nga veprat më të mira, është ushqyerja e të vobektëve dhe e nevojtarëve, e cila nuk vlen vetëm për nevojtarët myslimanë, por edhe robtë e shteteve të jobesimtarëve përfshihen në këtë dispozitë të Islamit. Madje, ushqyerja e tyre është konsideruar si një nga veprat e spikatura të mirëbërësve të devotshëm. Në një hadith prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: "*Silluni mirë me robërit.*". Kur myslimanët e dëgjuan këtë, ndonjëherë, edhe ushqimin e vet ua jepnin robërve.

Vepra e katërt e spikatur e mirëbërësve të devotshëm, konsiderohet sinqeriteti dhe çiltërsia. Për këtë ajeti thotë: **"Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim!"**.

Ky realitet nuk është kufizuar vetëm me çështjen e të ushqyerit, por të gjitha veprat e tyre janë motivim i pastër dhe për hir të All'llahut, ata nuk kanë asnjë pritshmëri për shpërblimin e njerëzve, madje për vlerësimin dhe falënderimin e tyre.

Në thelb, në Islam, vlera e veprës varet nga çiltërsia dhe sinqeriteti i saj, prandaj veprat me motive hyjnore, nëse janë produkt i hipokrizisë, egoizmit dhe egocentrizmit, pritshmërisë për falënderim dhe mirënjohje, shpërblimit material, nuk kanë asnjë vlerë shpirtërore dhe hyjnore.

Hadithi i njohur i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Nuk ka vepër pa synim, veprat janë vetëm me anë të synimeve."*, dëshmon po këtë kuptim.

Me fjalën *"vexhull'llah"* - **"fytyrën e All'llahut"**, nënkuptohet Qenia e All'llahut, sepse All'llahui nuk ka "formë fizike". Këtë e hasim edhe në ajete të tjera kur'anore, si në ajetin 272 të sures "El Bekare": **"... por vetëm për hir të All'llahut..."**.

Ajeti 28 i sures "El Kehf" për shoqërinë rreth Profetit, thotë: **"Përkufizoje veten tënde me ata që lusin Zotin e tyre në mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë e Tij..."**.

Për cilësimin e fundit të këtyre njerëzve të rafinuar ajeti 10 thotë: **"Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t'i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura."**.

Kjo fjalë mund të jetë treguese e gjendjes së tyre.

Fjala *"abusen"* tregon një njeri që bën fytyrën e zymtë, për shkak të theksimit të gjendjes së trishtueshme të asaj Dite, që do të thotë se ngjarjet e asaj Dite, janë kaq të frikshme dhe shqetësuese, saqë atë Ditë jo vetëm njerëzit janë me fytyra të zymta, por edhe vetë ajo Ditë është e zymtë.

Për etimologjinë e fjalës *"kamtarijra"* ka mosmarrëveshje midis komentuesve të Kur'anit dhe gjuhëtarëve.

Sipas disa prej tyre, ajo rrjedh nga rrënja *"el kamtaru"*. Mendimi tjetër është se ajo rrjedh nga fjala *"katr"* dhe shkronja *"mim"* është shtesë.

Më i pranueshëm dhe që njihet gjerësisht, është kuptimi "i ashpër dhe i zymtë".[1]

Këtu lind pyetja: Në qoftë se "mirëbërësit e devotshëm" punojnë vetëm për hir të All'llahut, pse atëherë deklarojnë 'ne jemi të frikësuar' nga Dënimi i Ditës së Kiametit? A mund të pajtohet motivimi hyjnor me motivimin që buron nga frika e përmendur? Duke pasur parasysh se ata, çdo hap e hedhin për hir të All'llahut, kjo është edhe përgjigjja. Nëse frikësohen nga dënimi i Kiametit dhe i Dënimit hyjnor dhe, nëse kanë pasion për begatitë e Xhennetit, kjo është po ajo çështje që në jurisprudencën islame trajtohet në kapitullin "Nijeti i adhurimit". Sipas jurisprudencës islame, synimi i afrimit me All'llahun në adhurimet dhe ritet fetare nuk është në kundërshti me dëshirën për shpërblim dhe frikën nga

[1] "Mufredatu Rragib", "Lisanul arab", "El Munxhid", tefsiri "El Kurtubij" dhe tefsiri "Mexhmaul Bejan".

ndëshkimi. Edhe përfitimi i të mirave materiale në këtë botë prej All'llahut, nuk është në kundërshtim me jurisprudencës islame, sepse të gjitha këto kthehen te All'llahu, apo siç shprehen dijetarët, janë nga motivi mbi motivin, edhe pse etapa më e lartë e adhurimit është pasioni për begatitë e Xhennetit e as frika nga dënimi i Ferrit, por bëhet për shkak të dashurisë ndaj All'llahut.

Të shprehurit si: **"do t'i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura"**, gjithashtu, është dëshmi për se kjo frikë është nga lloji i druajtjes prej All'llahut.

Çështja tjetër që kërkon vëmendje, është fakti se cilësimi i dytë, nga pesë cilësitë e përmendura, si dhe e pesta, janë çështje e frikës, vetëm me këtë ndryshim: në rastin e parë, flitet vetëm për frikën nga Dita e Kiametit, kurse në rastin tjetër, druajtja është nga All'llahu në Ditën e Kiametit.

Një njërin rast, Kiameti është përshkruar i tillë që e keqja e tij është e gjerë, kurse në rastin tjetër, e keqja e tij është e ashpër dhe e zymtë. Njëri tregon gjerësinë sasiore, kurse tjetri gjerësinë cilësore.

Në ajetin e fundit të diskutimit tonë, flitet në përgjithësi për veprat e mira dhe synimet e çiltra të mirëbërësve të devotshëm. Ajeti deklaron: **"Por All'llahu do t'i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t'u japë shkëlqim dhe gëzim."**.

Fjala *"nedhratun"* tregon egoizmin, euforinë dhe lumturinë që ndien njeriu, për shkak të bollëkut të begative dhe komfortit.

Po, ngjyra e fytyrave të tyre në atë Ditë reflekton qetësinë dhe disponushmërinë e tyre të brendshme. Për pasojë, nëse në këtë botë, për shkak të ndjenjës së përgjegjësisë, i druheshin asaj Dite,

All'llahu i Madhëruar, në këmbim, atë Ditë i zhyt në gëzim dhe ngadhënjim.

Të shprehurit me *"lek'kakum"* është shumë e qëlluar dhe tregon se All'llahu i Madhëruar do t'i gostisë me mirësinë e posaçme të Tij këta mysafirë të nderuar, si dhe ata janë të zhytur në ngadhënjim dhe lumturi dhe do t'i vejë nën hijen e mëshirës së Vet.

Hulumtim

Ushqyerja e të uriturve është nga mirësitë më të larta

Kur'ani, jo vetëm në këto ajete e ka konsideruar të ushqyerit e të tjerëve si një nga veprat e spikatura të mirëbërësve të devotshëm dhe robëve të All'llahut, por edhe në shumë ajete tjera e ka theksuar dhe ka vënë në pah këtë koncept. Kjo gjë gëzon një admirim të posaçëm pranë All'llahut. Në qoftë se e shohim botën e sotme, çdo vit vdesin nga uria, ndërkohë që në rajone të tjera të botës, në koshin e plehrave hidhet shumë ushqim i tepruar, saqë nuk llogaritet dot. Për ne do të bëhet e qartë, nga një anë, rëndësia e këtij rekomandimi të Islamit dhe, nga ana tjetër, shkalla e largimit të botës së sotme nga vlerat dhe kriteret kritike.

Edhe në transmetimet islame vërehen këshillime të shumta për këtë çështje. Këtu po përmendim disa shembuj: Në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut*

qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) thuhet: *"Ai që i ushqen tre myslimanë, All'llahu do ta ushqejë me tri kopshte të Parajsës."*.[1]

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* thotë. *"Ai që e ushqen besimtarin, derisa të ngopet, asnjë nga krijesat e All'llahut nuk e dinë se sa shumë sevap ka në Ahiret, as engjëjt më të aftë nga All'llahu, as Profetët e dërguar, përveç All'llahut që është kujdestar i botëve."*.[2]

Në një hadith tjetër, po ky Imam thotë: *"Ushqyerja e një besimtari nevojtar është më e pëlqyeshme për mua, se sa ta vizitoj atë, ashtu siç vizita e tij është më e pëlqyeshme për mua, se lirimi i dhjetë skllevërve."*.[3]

Në transmetime nuk flitet vetëm për nevojtarët dhe të uriturit, por në disa prej tyre thuhet qartë: "Të ushqyerit e besimtarit, edhe nëse nuk është nevojtar, është e barabartë me lirimin e robit. Kjo tregon se ky veprim, përveç plotësimit të nevojave, krijon miqësi dhe përforcon lidhjet me njëri–tjetrin. Tërësisht e kundërta e kësaj praktikohet në botën e sotme, ku indiferentizmi ndaj këtyre plagëve është i pranishëm kudo.

Në disa transmetime është diskutuar se të shqyerit e të uriturve, edhe pse nuk janë besimtarë dhe myslimanë, është nga veprat më të mira. Për këtë, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Një nga veprat më të mira te All'llahu është freskimi i mushkërive të nxehta (të të uriturit) dhe ngopja e stomakëve të uritura. Betohem në Atë që jeta e*

[1] Tefsiri "Usulul Kafij", vëll. 2, Hadithi 3, f. 200.

[2] Tefsiri "Usulul Kafij", vëll. 2, K. "It'amul Mu'mini", Hadithi 6, f. 201.

[3] Tefsiri "Usulul Kafij", vëll. 2, K. "It'amul Mu'min", Hadithi 18, f. 203.

Muhammedit është në duart e Tij, se nuk më ka besuar Mua ai njeri që fle i ngopur dhe vëllai i tij (ose komshiu i tij) mysliman është i uritur.".[1]

Pjesa e dytë e këtij hadithi flet për ushqyerjen e myslimanëve, kurse kuptimi i pjesës së parë është më i gjerë. Ai përfshin çdo të etur apo të uritur. Disa mendojnë se në këtë kuptim të gjerë përfshihen edhe kafshët.

Për këtë çështje ka shumë transmetime.

[1] "Biharul Enuar", vëll. 3, f. 369.

Ajetet 12 – 22

وَجَزَىٰهُم بِمَا صَبَرُواْ جَنَّةً وَحَرِيرًا ١٢ مُّتَّكِـِٔينَ فِيهَا عَلَى ٱلۡأَرَآئِكِۖ لَا يَرَوۡنَ فِيهَا شَمۡسًا وَلَا زَمۡهَرِيرًا ١٣ وَدَانِيَةً عَلَيۡهِمۡ ظِلَٰلُهَا وَذُلِّلَتۡ قُطُوفُهَا تَذۡلِيلًا ١٤ وَيُطَافُ عَلَيۡهِم بِـَٔانِيَةٖ مِّن فِضَّةٖ وَأَكۡوَابٖ كَانَتۡ قَوَارِيرَاْ ١٥ قَوَارِيرَاْ مِن فِضَّةٖ قَدَّرُوهَا تَقۡدِيرًا ١٦ وَيُسۡقَوۡنَ فِيهَا كَأۡسٗا كَانَ مِزَاجُهَا زَنجَبِيلًا ١٧ عَيۡنٗا فِيهَا تُسَمَّىٰ سَلۡسَبِيلٗا ١٨ ۞وَيَطُوفُ عَلَيۡهِمۡ وِلۡدَٰنٞ مُّخَلَّدُونَ إِذَا رَأَيۡتَهُمۡ حَسِبۡتَهُمۡ لُؤۡلُؤٗا مَّنثُورًا ١٩ وَإِذَا رَأَيۡتَ ثَمَّ رَأَيۡتَ نَعِيمٗا وَمُلۡكٗا كَبِيرًا ٢٠ عَٰلِيَهُمۡ ثِيَابُ سُندُسٍ خُضۡرٞ وَإِسۡتَبۡرَقٞۖ وَحُلُّوٓاْ أَسَاوِرَ مِن فِضَّةٖ وَسَقَىٰهُمۡ رَبُّهُمۡ شَرَابٗا طَهُورًا ٢١ إِنَّ هَٰذَا كَانَ لَكُمۡ جَزَآءٗ وَكَانَ سَعۡيُكُم مَّشۡكُورًا ٢٢

"Dhe, për durimin e tyre, Ai do t'i shpërblejë me Xhennet dhe petka të mëndafshta."

"Të mbështetur në divane, ata nuk do të kenë as vapë dhe as të ftohtë."

"Hija e pemëve të tij (Xhennetit) **është afër mbi kokat e tyre, ndërsa frutat e tyre do t'i kenë afër sa t'i arrijnë me dorë."**

"Aty do t'u shërbehet me enë të argjendta dhe kupa kristali."

"Kupa të tejdukshme argjendi, madhësinë e të cilave (do ta zgjedhin) **sipas dëshirës."**

"Aty do të pinë gota me pije të përzier me xhenxhefil."

"Prej një burimi të quajtur Selsebil."

"Atyre do t'u shërbejnë djem përherë të rinj, që, kur i shikon, të duken si margaritarë të shpërndarë."

"Ngado që të hedhësh sytë, do të shohësh lumni dhe një mbretëri të madhe."

"Ata do të jenë të veshur me petka të holla mëndafshi të gjelbër dhe me armaç mëndafshi të trashë, të stolisur me byzylykë të argjendtë. Zoti i tyre do t'u japë të pinë pije të pastër."

"Ky do të jetë me të vërtetë shpërblimi juaj; përpjekjet tuaja do të jenë të pranuara."

Komentimi

Shpërblimet madhështore në Parajsë

Pas një vështrimi të përgjithshëm në ajetet e kaluara, për shpëtimin e mirëbërësve dhe të devotshmëve nga dënimet e dhimbshme të Ditës së Kiametit, për realizimin e takimit me të dashurin dhe zhytjen në ngadhënjim dhe ngazëllim, këtu do të shpjegojmë, së paku, 15 begati dhe mirësi të Xhennetit.

Në fillim flitet rreth vendbanimit dhe veshjes së xhennetlinjve. Ajeti thotë: **"Dhe për durimin e tyre, Ai do t'i shpërblejë me Xhennet dhe petka të mëndafshta."**.

Përmes shumë qëndresash dhe flijimesh, ata synonin të përmbushnin premtimin: Të agjëronin tri ditë. Ata nuk e prishën agjërimin, edhe kur nuk hëngrën iftar për vete, sepse ushqimin e iftarit ua dhanë varfanjakut, jetimit dhe të zënit rob, të cilët u trokitën në derë. Për këtë, All'llahu i Madhëruar do t'i caktojë në kopshtet e posaçme të Xhennetit, si dhe do t'i veshë me rrobat më të bukura.

Jo vetëm në këtë ajet, por edhe në ajete të tjera kur'anore është shpalosur qartë që shpërblime të Kiametit u jepen durimtarëve dhe qëndrestarëve në rrugën e adhurimit, të nënshtrimit; durimtarëve përballë problemeve e fatkeqësive.

Në ajetin 24 të sures "Er Rrad" thuhet: **"Selam alejkum, me durimin tuaj gjetët shpëtimin. Sa përfundim i lavdishëm është ky vend!"**.

Po ashtu, në ajetin 111 të sures "El Mu'minun" thuhet: **"E Unë sot i shpërbleva ata pse ishin të durueshëm, ata janë fitimtarët."**.

Ajeti i dytë, në këtë seri ajetesh, thotë: **"Të mbështetur në divane, ata nuk do të kenë as vapë dhe as të ftohtë."**.

Përmendja e këtij pozicioni, mbështetja në divane, është tregues i rehatisë dhe i qetësisë së plotë të tyre. Pjesa e dytë e ajetit shënon temperaturën më të përshtatshme, e cila i shoqëron ata në Xhennet.

Nuk është se atje nuk ekziston dielli dhe hëna, por hijet e pemëve të Parajsës pengojnë depërtimin e rrezeve të diellit, të cilat shkaktojnë shqetësim.

Fjala *"eraik"* është shumësi i fjalës *"erike"*. Kjo fjalë tregon divanin që vendoset në dhomën e nuses. Edhe këtu është përdorur me kuptimin e divaneve të stolisur.

Alusij, komentuesi i njohur i Ehli Synetit, në veprën "Ruhul Meanij", duke komentuar një hadith nga Ibn Abasi rrëfen: "Banorët që ndodhen në Xhennet, papritur do të shohin një dritë si drita e diellit, e cila do të ndriçojë kopshtet e Xhennetit. Njerëzit e Xhennetit do t'i drejtohen Ridvanit, (engjëlli përgjegjës i Xhennetit) dhe do ta pyesin se ç'është ajo dritë, sepse All'llahu ka deklaruar: 'Në Xhennet nuk do të vërejmë as rrezet e diellit e as ftohjen.'.

Ai do t'u përgjigjet: 'Kjo nuk është drita e diellit dhe e hënës, por Aliu dhe Fatimja janë duke qeshur dhe Xhenneti është ndriçuar nga drita e dhëmbëve të tyre.'".[1]

Fjala *"zemherira"* rrjedh nga fjala *"zemher"* dhe është përdorur me kuptimin e të ftohtit të ashpër apo hidhërimin e tepërt, skuqjen e syrit nga zemërimi. Këtu është përdorur në kuptimin e parë.

Në një hadith thuhet: "Në Xhehennem ekziston një vend që nga acari i tepërt, organet e trupit do të shpartallohen.".[2]

Ajeti vazhdon me përshkrimin e begative: **"Hija e pemëve të tij** (Xhennetit) **është afër mbi kokat e tyre, ndërsa frutat e tyre do t'i kenë afër sa t'i arrijnë me dorë."**.

Nuk ka asnjë, nuk duhet asnjë përpjekje për arritur frutat.

E përsërisim edhe një herë tjetër faktin se parimet dominuese mbi jetën e njeriut në Atë Botë janë shumë të ndryshme me ato të kësaj bote. Ato që janë thënë në këta ajete rreth begative të Xhennetit, janë vetëm shoqërime të imagjinuara dhe përqasje me të përafërtat e tyre në këtë botë, që të krijohet një imazh i përafërt për Botën Tjetër dhe ndodhitë e saj, të cilat asnjë sy nuk i ka parë, asnjë vesh nuk i ka dëgjuar dhe asnjë mendje nuk i ka përfytyruar dot.

Ibn Abasi, në komentimin e disa prej ajeteve të kësaj sureje, ka thënë: "Ato që ka përmendë All'llahu në Kur'an, për begatitë e Xhennetit, nuk kanë të ngjashme në këtë botë, por All'llahu i ka

[1] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 29, f. 159.

[2] Tefsiri "Durrul Menthur", vëll. 6, f. 300.

përmendur me emra që janë të njohur për ne, p.sh: flet për një pije të pastër, që është e përzier me xhenxhefil, një lëndë aromatike, të cilën arabët e kishin shumë qejf.".[1]

Pas kësaj, ajetet sqarojnë një pjesë të mënyrës së pritjes së këtyre mysafirëve të Parajsës, mjetet e pritjes së tyre, si dhe pritësit: **"Aty do t'u shërbehet me enë të argjendta dhe kupa kristali, kupa të tejdukshme argjendi, madhësinë e të cilave** (do ta zgjedhin) **sipas dëshirës."**.

Në këto enë shërbehen lloje të ndryshme të ushqimeve të Parajsës, kurse në gotat prej kristali ka lloje të ndryshme pijesh të këndshme, që të sjellim gëzim, aq sa dëshirojnë dhe kanë qejf, ndërkohë që shërbëtorët e Xhennetit, pa ndërprerje, sillen rreth tyre dhe u shërbejnë.

Fjala *"anijetun"* është shumësi i fjalës *"inaun"* dhe përdoret në kuptimin e çdo lloj ene, kurse fjala *"ekuabun"* është shumësi i fjalës *"kuub"* dhe përdoret në kuptimin e enës së ujit që nuk ka vegë dhe ndonjëherë quhet *"kadeh"* - "gotë".

Fjala *"keuarijr"* është shumësi i fjalës *"karuretun"* dhe tregon enë prej kristali dhe xhami. Ajeti thotë se enët e kristalta të Parajsës janë bërë prej argjendi. Në botën tonë tokësore një enë e tillë nuk ekziston.

Sidoqoftë, nga ajeti kuptojmë se enët dhe gotat e Parajsës e kanë tejdukshmërinë si kristali dhe shkëlqimin dhe bukurinë e argjendit dhe pijet që futen në to janë plotësisht të dukshme.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 411.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet: "*Shikimi i njeriut depërton në argjendin e Xhennetit, njësoj siç depërton në shishen e kristaltë të kësaj bote.*".[1]

Ibn Abasi thotë: "Të gjitha begatitë në Xhennet kanë profilin e tyre dhe në këtë botë nuk kanë të ngjashëm.".[2]

Më pas, ajeti shton: **"Aty do të pinë gota me pije të përzier me xhenxhefil."**.

Shumë komentues të Kur'anit janë shprehur se arabët paganë kënaqeshin me verën e përzier me xhenxhefil, sepse xhenxhefili i jepte një shije të veçantë verës dhe Kur'ani flet për gota të plota me pije të spastruar, të përzier me xhenxhefil. Por është e dukshme se midis pijeve tokësore që sillen si shembuj, vetëm për të krijuar një imazh të përafërt dhe pijeve të Xhennetit, ka një ndryshim aq të madh, sa nuk përshkruhet dot. Thënë ndryshe, ndryshimi është sa toka me qiellin apo nga toka deri në Ahiret.

Duket se arabët paganë kanë pasur dy lloj verërash me dy karakteristika të ndryshme. Njëra ekzaltuese dhe energjidhënëse, kurse tjetra që shkaktonte plogështi dhe ishte qetësuese.

Të parën e përzienin me xhenxhefil, kurse të dytën me kafur, por megjithëse realet e asaj Bote të përtejme i tejkalojnë kuptimet e fjalëve të kësaj bote, nuk mund të procedohet ndryshe, përveç me analogji imagjinare të përafërta.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 410.

[2] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 29, f. 159.

Edhe pse për kuptimin e fjalës *'xhenxhefil'* përmendën interpretime të ndryshme, në përgjithësi e kanë shpjeguar si rrënjë me aromë të këndshme, që përdoret në erëzat e posaçme për ushqim dhe pije.

Më pas, ajeti shton: **"Prej një burimi të quajtur Selsebil."**.

Fjala *"selsebijl"* tregon një pije shumë të këndshme dhe të shijshme.

Shumë komentues janë të mendimit se rrjedh nga rrënja *"selaseh" - "rrjedhshmëri"*.

Ka komentues, që këtë fjalë e përdorin me kuptimin e lëvizjeve të njëpasnjëshme, të cilat krijojnë përshtypjen e rrjedhshmërisë së diçkaje. Prandaj, të dy kuptimet janë shumë të përafërta me njëra-tjetrën.

Disa komentues mendojnë se kjo është një fjalë e përbërë nga dy fjalët: *"sale"* dhe *"sebijl"*.

Në rastin e parë, kuptimi do të ishte "kërko një rrugë" dhe në rastin e dytë, "kërkoi një rrugë", kurse kuptimi i tërthortë i të dyjave është: "e këndshme".

Disa kanë thënë se në Fjalorin e Gjuhës Arabe nuk ka ekzistuar fjala *"selsebijl"* dhe ajo është nga risitë e Kur'anit Famëlartë. Kuptimi i parë është më i njohur dhe më i përshtatshëm se të gjithë.

Pas kësaj, ajeti flet për pritësit apo shërbëtorët e kësaj feste që organizohet në saje të mëshirës së All'llahut në Xhennetin e

lartësuar dhe thotë: **"Atyre do t'u shërbejnë djem përherë të rinj, që, kur i shikon, të duken si margaritarë të shpërndarë."**.

Ata djem janë të amshueshëm në Xhennet. Edhe freskia, bukuria dhe gjallëria rinore e tyre, është e amshueshme, ashtu si shërbimi që bëjnë. Për këtë dëshmon fjala *"mukhal'ledune"* nga njëra anë, dhe fjala *"jetufu alejhim"*, nga ana tjetër.

Shprehja: *"Lu'lu'en menthura"*, përdoret për të treguar jo vetëm bukurinë, çiltërsinë, shkëlqimin dhe magnetizmin e tyre, por edhe praninë e këndshme të tyre në këtë festë hyjnore. Meqenëse begatitë e Botës Tjetër janë të papërshkrueshme, në ajetin vijues, në mënyrë të përmbledhur, theksohet: **"Ngado që të hedhësh sytë, do të shohësh lumni dhe një mbretëri të madhe."**.

Për fjalët *"neijmun"* dhe *"mulken kebijran"* janë dhënë interpretime të ndryshme. Ndër to, në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të)*, lexojmë: *"Ajeti tregon se kjo është një pasuri e patundshme që asnjëherë nuk asgjësohet dhe nuk zhduket."*.[1]

Begatitë e Xhennetit janë aq të përhapura, sa nuk mund të përshkruhen e numërohen. Ose *"mulkun kebijran"*, është ai që ëngjujt në kohën kur do të hyjnë tek xhennetlinjtë marrin leje, përshëndesin me selam (paqe). Banorët e Xhennetit e arrijnë atë që dashurojnë; Banori më i ulët i Parajsës, kur e shikon pronën e tij, vëren se kufijtë e saj qëndrojnë njëmijë vjet rrugë larg.

Pronë e përhershme dhe e amshueshme, e shoqëruar me realizimin e të gjitha shpresave dhe dëshirave.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 411.

Fjala *"neijmun"* tregon begatitë e shumta, kurse togfjalëshi *"mulkun kebijran" - "pronë e madhe"*, shpreh madhështinë dhe gjerësinë e kopshteve të Xhennetit. Këtë fjalë përfshijnë të gjitha interpretimet e lartpërmendura.

Deri këtu u diskutua për disa prej begative të Xhennetit, si: vendstrehimet, fronet, hijet, frutat, pijet, enët dhe grupi i pritësve. Tani është radha e mjeteve dekorative të banorëve të Xhennetit. Ajeti thotë: **"Ata do të jenë të veshur me petka të holla mëndafshi të gjelbër dhe me armaç mëndafshi të trashë..."**.

Fjala *"sundusun"* tregon një copë mëndafshi të hollë, kurse fjala *"el istebraku"* një copë mëndafshi të trashë. Sipas disa gjuhëtarëve, ajo rrjedh nga fjala perse *"istebere"* apo *"stebere"*. Disa të tjerë mendojnë se kjo fjalë rrjedh nga fjala arabe *"bark"* dhe tregon ndriçimin, shkëlqimin.

Ajeti shton: **"...të stolisur me byzylykë të argjendtë. Zoti i tyre do t'u japë të pinë pije të pastër."**.

Argjend të tejdukshëm, që shkëlqen si kristali dhe më i bukur se rubini dhe perla.

Fjala *"esavijru"* është shumësi i fjalës *"esvera"* dhe *"esvera"* është shumësi i fjalës *"suvar"* ose *"sivar"*. Në thelb, është marrë nga fjala perse *"destvar"*, e cila tregon "byzylykun", por gjatë transferimit në gjuhën arabe ka pësuar ndryshimin fonetik dhe ka marrë formën "sevar".

Përzgjedhja e ngjyrës jeshile për rrobat e Xhennetit është se kjo ngjyrë sjell gjallëri, ngjashëm me gjethet e bukura të pemëve.

Sigurisht, ngjyra jeshile ka shumë tonalitete dhe secila ka një hijeshi të veçantë.

Në disa ajete kur'anore, si p.sh. ajetin 31 të sures "El Kehf" lexojmë: **"...aty stolisen me rrathë të artë dore dhe ata veshin rrobe të gjelbra..."**. Kjo nuk bie në kundërshti me atë që është thënë në ajetin e lartpërmendur, sepse ata herë stolisen me një byzylyk me një ngjyrë dhe herë me byzylykë me ngjyrë tjetër. (të argjendtë, të artë...)

Këtu lind pyetja: Si mundet, që rrathët dhe byzylykët që janë stoli për gratë, të përmendet për burrat e Xhennetit?

Por përgjigjja e saj është shumë e qartë. Në shumë vende, floriri dhe argjendi përdoren si stolisje edhe për burrat, edhe për gratë (edhe pse Islami e ka ndaluar stolisjen e burrit me flori), por duhet të kemi parasysh faktin që byzylykët për burra ndryshojnë nga ato të grave për nga lloji e forma. Nga ajeti 53 i sures "Zukhruf", nga vetë goja e Faraonit, thuhet: **"Përse nuk i janë vënë atij byzylykë ari, ose të kenë ardhur bashkë me të engjëjt shoqërues?"**. Kështu arrijmë të kuptojmë, që në hapësirën e Egjiptit, byzylyku i artë ishte shenjë madhështie dhe krenarie për burrat.

Përveç kësaj, ashtu siç e kemi diskutuar shumë herë, kur kemi shpjeguar begatitë e Xhennetit, fjalët e rëndomta të kësaj bote nuk arrijnë të bëjnë përshkrime të sakta për begatitë madhështore dhe të papërshkueshme të Xhennetit.

Në përfundim, ajeti përmend begatinë e fundit dhe më të rëndësishmen nga kjo seri e begative: **"Zoti i tyre do t'u japë të pinë pije të pastër."**.

Një nga begatitë ishte edhe pija e këndshme, me të cilën mbushen shishet e tejdukshme, nga burimi i rrjedhshëm. Banorët e Xhennetit ngopen me këtë pije. Por nëpërmjet tyre dhe asaj që është thënë në ajetin në fjalë, ka shumë ndryshim, sepse, nga njëra anë, atje u fol se kupëmbajtësit ishin "*uildane mukhal'ledune*", kurse këtu kupëmbajtësi është "All'llahu". Vërtet, çfarë shprehje e çuditshme kjo! Veçanërisht duke u mbështetur në fjalën "*rabbun*" - "*kujdestar*".

All'llahu, i Cili gjithnjë e ka edukuar njeriun dhe është Pronari e Edukatori i tij, e ka orientuar gjithnjë atë drejt fazave të përsosmërisë, derisa ka arritur në fazën e fundit. Tani i ka ardhur koha që ta çojë në nivelin kulmor, me dorën e fuqisë së Tij dhe ta ngopi dhe ta entuziazmojë me pijet e këndshme dhe të pastra.

Nga ana tjetër, fjala "*tahur*" është në kuptimin: "një gjë e pastër, që ka veti pastruese". Kjo pije e spastron trupin dhe shpirtin e njeriut nga çdo lloj papastërtie dhe ndyrësie dhe i dhuron atij aq shumë ndriçim dhe gëzim, sa nuk mund të përshkruhet me asnjë fjalë. Madje në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, është thënë: "*E pastron zemrën dhe shpirtin e tyre nga çdo gjë, përveç All'llahut.*".[1]

Kjo pije i gris perdet e neglizhencës, i heq mbulesat dhe njeriun e bën të meritojë praninë e përhershme në altarin e afërsisë së All'llahut. Magjepsja dhe ngazëllimi nga kjo pije e pastër është më e lartë se çdo begati tjetër dhe më e çmuar se çdo dhuratë.

Në qoftë se vera e papastër e kësaj bote e "asgjëson" mendjen e njeriut dhe e largon atë nga All'llahu, vera e pastër e Botës Tjetër, që do të jepet me dorën e "Pijedhënësit Krijues", e

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 410.

tjetërson njeriun nga çdo gjë, përveç All'llahut dhe e zhyt atë në bukurinë dhe hijeshinë e Tij.

Thënë shkurt, mirësia e fshehur në këtë ajet dhe në këtë begati është më e çmueshme dhe më e lartë se çdo gjë tjetër.

Nga hadithi, që është transmetuar nga Profeti i Islamit, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*, përftohet se burimi i verës së pastër është në hyrjen e Xhennetit: "*Atyre do t'u jepet një gllënjkë nga kjo verë e pastër për ta pirë dhe All'llahu i Madhëruar, me anë të saj, do t'ua pastrojë zemrat nga zilia (dhe nga çdo ves tjetër).*".[1]

Tepër interesant është fakti, se fjala "*tahur*", në Kur'anin Famëlartë, është përmendur vetëm në dy raste: një herë për shiun, (Sure "Furkan", ajeti 48) me anë të të cilit pastrohet dhe ringjallet çdo gjë në tokë dhe rasti tjetër, për pijen e veçantë të Xhennetit, që, gjithashtu, është pastruese dhe jetëdhënëse.

Në ajetin e fundit të diskutimit, thuhet: **"Ky do të jetë me të vërtetë shpërblimi juaj; përpjekjet tuaja do të jenë të pranuara."**.

Të mos mendojë kush se këto begati dhe shpërblime të mëdha jepen pa asnjë llogari. Të gjitha këto janë shpërblim i veprave dhe i përpjekjeve, i vetëformimit, i vetedukimit dhe i heqjes dorë nga mëkati.

Njoftimi i kësaj çështjeje ka një kënaqësi dhe ndjenjë ngazëllimi. Vetë All'llahu i Madhëruar, ose engjëjt e Tij, do t'u drejtohen të devotshmëve dhe vepërmirëve dhe, në shenjë mirënjohjeje dhe falënderimi ndaj tyre, do t'u thuhet: "Të gjitha

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, ajeti 60, f. 485.

këto janë shpërblimet e veprave tuaja, përpjekjet tuaja janë për t'u falënderuar. Sipas disa komentuesve të Kur'anit, kjo është njëra nga begatitë e shumta dhe një dhuratë e madhe, me të cilat All'llahu e falënderon njeriun.

Fjala *"kane"* tregon se këto begati janë përgatitur paraprakisht për ju që do të jeni mysafirët e pritshëm, sepse çdokush që i kushton rëndësi të madhe mysafirit të vet, i përgatit paraprakisht mjetet e pritjes së tij, në shenjë mirënjohjeje dhe respekti ndaj tij.

Ajetet 23 – 26

إِنَّا نَحۡنُ نَزَّلۡنَا عَلَيۡكَ ٱلۡقُرۡءَانَ تَنزِيلٗا ٢٣ فَٱصۡبِرۡ لِحُكۡمِ رَبِّكَ
وَلَا تُطِعۡ مِنۡهُمۡ ءَاثِمًا أَوۡ كَفُورٗا ٢٤ وَٱذۡكُرِ ٱسۡمَ رَبِّكَ بُكۡرَةٗ وَأَصِيلٗا ٢٥
وَمِنَ ٱلَّيۡلِ فَٱسۡجُدۡ لَهُۥ وَسَبِّحۡهُ لَيۡلٗا طَوِيلًا ٢٦

"Në të vërtetë, Ne ta kemi shpallur Kur'anin ty hap pas hapi."

"Prandaj ki durim për vendimin e Zotit tënd e mos dëgjo asnjë gjynahqar apo jobesimtar prej tyre!"

"Përmende Emrin e Zotit tënd në mëngjes dhe në mbrëmje."

"Në një pjesë të natës bëji sexhde Atij dhe, natën falju gjatë Atij."

Komentimi

Pesë urdhra të rëndësishme për sukses

Ajetet e mëparshme të kësaj sureje diskutuan për krijimin e njeriut, për eskatologjinë dhe ringjalljen e tij, kurse ajetet e reja flasin për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*, për urdhrat që i jepen për udhëzimin e njerëzve, si dhe për durimin dhe qëndresën në këtë udhë.

Në realitet, këto ajete tregojnë rrugën e arritjes dhe të përvetësimit të të gjitha këtyre begative të pashembullta, të cilat realizohen vetëm duke mësuar Kur'anin, duke pasuar Profetin e Islamit, Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe duke u frymëzuar prej urdhrave të tij.

Ajeti 23 thotë: **"Në të vërtetë, Ne ta kemi shpallur Kur'anin ty hap pas hapi."**. Disa komentues, fjalën *"tenzila"* e përdorin për të treguar "zbritjen graduale të Kur'anit".

Disa të tjerë, e kanë konsideruar si tregues për madhështinë e pozitës së këtij Libri qiellor dhe një mundësi mbi zbritjen e Kur'anit nga ana e All'llahut. Duke pasur parasysh dhe theksimet tjera të përmendura në ajet (me anë të mjeteve gramatike, si: pjesëza *"inne"*, përemri *"ne"* dhe fjalia emërore), kjo është një përgjigje ndaj atyre personave, që e akuzonin Profetin e Islamit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* si magjistar, orakull, shpifës ndaj All'llahut.

Më pas, ajeti i shpalos Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* pesë urdhra të rëndësishme. Urdhri i parë është thirrje për durim dhe qëndrueshmëri në rrugën e kumtimit dhe zbatimit të dispozitave të Zotit: **"Prandaj ki durim për vendimin e Zotit tënd."**.

Mos u tremb nga problemet, nga pengesat e mëdha gjatë rrugës, as nga numri i madh i armiqve dhe as nga kokëfortësia e tyre, por vazhdo rrugën tënde. Duhet të kemi parasysh, që urdhrin për qëndresë, në fjalën: **"prandaj ki durim"** e konsideron rrjedhojë të zbritjes së Kur'anit nga ana e All'llahut (për shkak të lidhëzës *"fe"* të pasojës). Kjo do të thotë se, meqenëse All'llahu është Mbështetësi yt, patjetër bëj qëndresë në këtë rrugë. Fjala *"rabbun"* - *"kujdestari"*, përcjell të njëjtin kuptim.

Në urdhrin apo rekomandimin e dytë drejtuar Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thuhet: **"Mos dëgjo asnjë gjynahqar apo jobesimtar prej tyre!".**

Urdhri i dytë përforcon urdhrin e parë, i cili thotë se armiqtë e Islamit përpiqeshin që përmes mënyrave të ndryshme ta detyrojnë Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të bëjë kompromis me falsitetit.

Transmetohet se Atabetu ibn Rabiatu dhe Velijd ibn Mugijretu i thoshin Profetit të nderuar të Islamit (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*, të hiqte dorë nga thirrja e tij. Për këtë ata do t'i jepnin shumë pasuri dhe do ta martonin me vajzat më të bukura arabe. Po ashtu, ata i bënë edhe propozime të tjera të ngjashme. Por Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si një udhëheqës i vërtetë, do të

tregonte qëndresë dhe durim përballë këtyre cytjeve djallëzore apo kërcënimeve. Përballë qëndresës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kundërshtarët e tij dështojnë plotësisht.

I Dërguari i Islamit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* asnjëherë nuk u dorëzua, por ajeti thekson rëndësinë që ka kjo çështje, për ta treguar Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* si shëmbëlltyrë për prijësit e tjerë të Udhës së All'llahut.

Fjala **"mëkatari"** ka një kuptim të përgjithshëm dhe përfshin paganin dhe jobesimtarin, prandaj përmendja e jobesimtarit është si përmendja e të pjesshmes pas të përgjithshmes dhe në funksion të përforcimit.

Durimi dhe qëndresa përballë këtyre vështirësive të mëdha nuk është gjë e lehtë dhe tejkalimi i kësaj rruge ka nevojë për parapërgatitje të posaçme. Për këtë arsye, në ajetin vijues, si urdhër i tretë, shtohet: **"Përmende Emrin e Zotit tënd në mëngjes dhe në mbrëmje."**.

Urdhri i katërt dhe i pestë deklarojnë se në saje të atij dhikri, të kësaj sexhdejeje dhe madhërimi, sigurohet fuqia e nevojshme dhe forca shpirtërore për të përballuar vështirësitë e kësaj Udhe.

Fjala *"bukran"* tregon fillimin e ditës, kurse fjala *"esijlan"* fundin e saj.

Disa dijetarë kanë thënë se kjo fjalë përdoret për të treguar fundin e ditës, ngaqë ajo vjen nga rrënja *"aslun"*, e cila tregon se fundi i ditës shënon fillimin e natës.

Janë disa raste që tregojnë se fjala *"asijl"* përdoret për të shënuar kohën midis drekës dhe darkës ("Mufredatu" Rragib), ashtu si dhe disa shprehje të tjera tregojnë se *"asl"* i thuhet edhe fillimit të natës, sepse atë e kanë interpretuar si *"el ashij'ji"*, ku fjala *"el ashij'j"* tregon fillimin e natës. Dy namazet e akshmait dhe të jacisë quhen "ishaejn". Madje ka disa thënie, sipas të cilave fjala *"el ashij'j"* përfshin periudhën kohore nga dreka deri te mëngjesi i ditës së nesërme.[1]

Por, duke pasur parasysh që fjalës *"asijl"* në këtë ajet i është vendosur përpara fjala *"bukran"* - *"mëngjesi"* dhe pas saj është folur rreth adhurimit të natës, bëhet e qartë se ajo tregon pjesën e fundit e ditës.

Sidoqoftë, këto dy ajete shprehin se, qoftë ditë, apo natë, All'llahu duhet të adhurohet dhe duhet të falënderohet pa ndërprerë.

Disa komentues e kanë interpretuar këtë shtrirje kohore si pesë vaktet e faljes, plus namazin e natës, ose veçanërisht namazi i sabahut, i ikindisë, i akshamit dhe i jacisë. Por kuptimi i dukshëm është ky: këto namaze janë pjesë e kujtimit dhe e madhërimit të vazhdueshëm të All'llahut, si dhe e sexhdes në praninë e Shenjtë të Tij.

[1] "Mufredatu" i Rragibit.

Shprehja *"lejlen tavijlan"* tregon se në një pjesë të madhe të natës duhet të madhërohet Zoti. Në një hadith të transmetuar nga Ali ibn Musa Err Rridha tregohet se, kur e pyetën se ç'do të thotë ky madhërim, ai ka dhënë këtë përgjigje: *"Bëhet fjalë për faljen e natës."*.[1]

Edhe pse ky komentim mund të mos jetë plotësisht i qartë, duhet të theksohet se falja e natës ka një ndikim të jashtëzakonshëm në përforcimin e shpirtit të besimit, të fisnikërimit të shpirtrave, si dhe të ruajtjes së gjallërisë së vullnetit të njeriut në Udhën e shërbimit ndaj All'llahut.

Hulumtim

Duhet t'u kushtojmë vëmendje pesë urdhrave që përmenden në ajetet e lartpërmendura, të cilat, ndonëse janë përmendur si program praktik për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, realisht janë model dhe mësim për të gjithë ata që fillojnë të ecin në rrugën e udhëheqjes shpirtërore dhe njerëzore të shoqërisë islame.

Pas bindjes së plotë e të palëkundur në qëllimin dhe misionin që kanë, ata duhet të tregojnë durim dhe vullnet të hekurt dhe të mos tremben nga vështirësitë e mëdha në këtë udhë, sepse

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 412.

udhëzimi i një komuniteti, sidomos kur ka përballë individë të pandërgjegjshëm, armiq të përbetuar dhe kryeneçë, kjo udhë gjithnjë do të jetë e shoqëruar me vështirësi tepër të mëdha.

Në qoftë se mungon vullneti dhe durimi i prijësve, asnjë mision nuk do t'ia arrijë qëllimit. Ata nuk duket ta shesin veten e as të lejojnë të kaplohen nga frika dhe kërcënimet, ndonëse djajtë përpiqen të devijojnë prijësit dhe udhëheqësit, me anë të dinakërive dhe mashtrimeve të shumta.

Për të përftuar forcën shpirtërore, vullnetin e kalitur, motivimin e palëkundur dhe vendimin monolit, duhet ta kujtojmë All'llahun çdo mëngjes dhe mbrëmje, ta vëmë ballin në altarin e Tij, veçanërisht, të frymëzohemi nga adhurimet gjatë natës. Në qoftë se këto çështje zbatohen, fitorja është e pashmangshme. Në qoftë se disa prej këtyre parimeve shkelen, do të ndodhë ndonjë fatkeqësi. Rregullimi i tyre sërish bëhet vetëm nën dritën e këtyre parimeve.

Programi i jetës së të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thirrja dhe misioni i tij, janë shembull për rrugëtarët e kësaj udhe.

Ajetet 27 – 31

إِنَّ هَٰٓؤُلَآءِ يُحِبُّونَ ٱلۡعَاجِلَةَ وَيَذَرُونَ وَرَآءَهُمۡ يَوۡمٗا ثَقِيلٗا ٢٧ نَّحۡنُ خَلَقۡنَٰهُمۡ وَشَدَدۡنَآ أَسۡرَهُمۡۖ وَإِذَا شِئۡنَا بَدَّلۡنَآ أَمۡثَٰلَهُمۡ تَبۡدِيلٗا ٢٨ إِنَّ هَٰذِهِۦ تَذۡكِرَةٞۖ فَمَن شَآءَ ٱتَّخَذَ إِلَىٰ رَبِّهِۦ سَبِيلٗا ٢٩ وَمَا تَشَآءُونَ إِلَّآ أَن يَشَآءَ ٱللَّهُۚ إِنَّ ٱللَّهَ كَانَ عَلِيمًا حَكِيمٗا ٣٠ يُدۡخِلُ مَن يَشَآءُ فِي رَحۡمَتِهِۦۚ وَٱلظَّٰلِمِينَ أَعَدَّ لَهُمۡ عَذَابًا أَلِيمَۢا ٣١

"Vërtet që jobesimtarët e duan jetën e këtushme dhe nuk e përfillin një Ditë të vështirë, që do t'u vijë."

"Ne i krijuam ata dhe ua forcuam strukturën, por, nëse duam, i ndërrojmë plotësisht me të tjerë si ata."

"Në të vërtetë, kjo është kështillë, prandaj, kush të dojë, le të ndjekë rrugën që e shpie te Zoti i tij."

"Por ju nuk mund të dëshironi, përveçse me vullnetin e All'llahut! Ai është vërtet i Gjithëdijshëm e i Urtë."

"Ai pranon në mëshirën e Vet kë të dojë, ndërsa për keqbërësit ka përgatitur një dënim të dhembshëm."

Komentimi

Ky është një paralajmërim, zgjedhja është e juaja!

Në ajetet e kaluara, Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i ishte dhënë paralajmërimi: "Mos bjer nën ndikimin e njerëzve mëkatarë dhe jobesimtarë!". Ata ishin njerëz që donin të shfrytëzojnë faktorë të tillë, si: mallin, pozitën, pasurinë dhe femrat e bukura, për të thyer vullnetin dhe vendosmërinë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Ajeti 27 thotë: **"Vërtet që jobesimtarët e duan jetën e këtushme dhe nuk e përfillin një Ditë të vështirë, që do t'u vijë."**.

Mendimet e tyre sillen vetëm rreth ushqimeve, rehatisë dhe epshit. Pika më e largët e shikimit të tyre janë kënaqësitë materiale. Këta kërkojnë të masin shpirtin e madh të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me të njëjtën njësi matëse që përdorin për vete, por harrojnë se kë kanë përballë.

Fjala *"ueráehum"*, duhet të përdoret me kuptimin *"përballë tyre"*. Disa komentues kanë pretenduar se fjala *"uera"* përdoret në dy kuptime: prapa dhe para.

Ajeti vijues i paralajmëron, që të mos mburren me fuqinë dhe forcën e tyre, sepse të gjitha vijnë prej All'llahut. Sa herë që do, Ai merr. Ajeti deklaron: **"Ne i krijuam ata dhe ua forcuam strukturën, por, nëse duam, i ndërrojmë plotësisht me të tjerë si ata."**.

Fala *"esrun"* tregon lidhjen e diçkaje me zinxhir, zënien rob, por fjala *"esrun"*, në rastin, konkret tregon lidhjet e shëndosha të njeriut me komunitetin, të cilat i sigurojnë mbështetjen dhe forcën e nevojshme për të kryer aktivitete të rëndësishme. Këto lidhje, Kur'ani i ka vlerësuar si lidhjet e gjymtyrëve të organit njerëzor me tërë muskujt, kockat, sistemin nervor, të cilat krijojnë një organizëm të shëndetshëm dhe të aftë për çdo veprimtari.

Ajeti në fjalë, bën të qartë se për jobesimtarët nuk është e nevojshme Qenia e Stërpastër e All'llahut. Ata duhet ta dinë se, nëse këmbëngulet që të futen në udhën e besimit, kjo bëhet vetëm nga mëshira dhe bekimi nga ana e All'llahut. Të njëjtin kuptim e kemi të shprehur edhe në ajetin 133 të sures "El En'am": **"Zoti yt nuk ka nevojë për asgjë, Ai është Mëshirues. Nëse do Ai, juve ju zhduk dhe sjell kë të dojë pas jush."**.

Më pas hedh një vështrim mbi tërësinë e diskutimeve dhe trajtesave në këtë sure, të cilat paraqesin një projekt universal lumturie dhe thotë: **"Në të vërtetë, kjo është kështillë, prandaj, kush të dojë, le të ndjekë Rrugën që e shpie te Zoti i tij."**.

Detyrim për ne është t'ju tregojmë rrugën, jo t'ju detyrojmë në zgjedhje. Jeni ju ata që duhet të dalloni të vërtetën nga falsiteti dhe të merrni vendim me vullnetin tuaj të lirë. E gjithë kjo është ripërsëritje dhe ritheksim mbi atë që u shpalos në fillimin e sures, ku u deklarua: **"Natyrisht, që Ne i treguam atij Rrugën e Drejtë, që ai të jetë ose mirënjohës, ose mosmirënjohës."**.

Por ka njerëz mendjeshkurtër, që i lënë këto çështje të rëndësishme në duart e njerëzve të tjerë. Për të mohuar këtë përfytyrim, ajeti thotë: **"Por ju nuk mund të dëshironi, përveçse**

me vullnetin e All'llahut! Ai është vërtet i Gjithëdijshëm e i Urtë.".

Ky është vërtetimi i parimit të njohur: "Çështja midis dy çështjeve", apo realiteti midis dy realiteteve. Nga njëra anë, ajeti thotë se All'llahu ua ka treguar rrugën dhe zgjedhja është te ju, kurse nga ana tjetër, zgjedhja juaj është në varësi prej dëshirës së providencës hyjnore, që do të thotë se ju nuk gëzoni pavarësi të plotë, por fuqia, forca dhe vullneti juaj i lirë, është sipas dëshirës së All'llahut dhe nga ana e Tij dhe çdo herë që Ai do, mund t'jua mohojë këtë forcë dhe liri.

Në këtë mënyrë, as kemi të bëjmë me indiferentizëm, as me lëshimin e plotë dhe as me fatalizëm dhe mohimin e zgjedhjes. Përkundrazi, është një realitet tepër i përpiktë dhe ekzakt midis këtyre të dyjave, apo thënë ndryshe, është një lloj lirie e varur prej providencës hyjnore. Që në çdo moment, që dëshiron mundet ta rimarë përsëri. Kështu edhe krijesat të kenë mundësinë të mbajnë përgjegjësinë e rrugës së përsosmërisë mbi supet e tyre. Po ashtu mos ta konsiderojnë apo imagjinojnë veten e tyre se nuk kan nevoj për Krijuesin.

Thënë shkurt, ky ajet vjen për të thënë se njerëzit të mos e konsiderojnë veten se nuk kanë nevojë për udhëzim, përkrahje, bekim dhe afirmim të Qenies së Shenjtë të All'llahut, por, krahas vendimmarrjeve në punët e tyre, t'ia dorëzojnë dhe ta lënë veten nën kujdesin e All'llahut.

Prej këtu bëhet e qartë se disa komentues, si Fakhru Rrazij, mbështeten te ky ajet. Kjo ndodh për shkak të paragjykimeve që kanë pasur në lidhje me këtë çështje. Ai thotë: "Ky ajet është prej ajeteve, ku dallgët e determinizmit dhe të fatalizmit sa ngrihen dhe

ulen.". Po, nëse ajetin e shkoqisim nga ajetet paraprake, mund të ketë vend për një përfytyrim të tillë, por, duke pasur parasysh faktin se në një ajet shpaloset ndikimi i përzgjedhjes dhe i vullnetit të lirë dhe në ajetin tjetër shpaloset ndikimi i dëshirës së All'llahut, më së miri vërtetohet parimi i quajtur: "Çështja midis dy çështjeve".

I çuditshëm është fakti se ithtarët e rrymës interministe janë mbështetur te ajeti që flet për lirinë absolute, ashtu si përkrahësit e fatalizmit mbështeteshin te ajeti që ndjell ndjenjën e determinizmit. Secila palë kërkon ta justifikojë veten, pra, të arsyetojë presupozimet e saj në të. Ndërkohë që të kuptuarit e drejtë të Fjalëve të All'llahut dhe çdo fjalë tjetër, kërkon që të gjitha thëniet t'i vëmë pranë njëra-tjetrës (të marrim parasysh edhe tërësinë e thënieve dhe ta gjykojmë çështjen të çliruar nga çdo lloj fanatizmi paraprak).

Në përfundim të ajetit thuhet: **"Ai është vërtet i Gjithëdijshëm e i Urtë."**. Ky ajet përcjell mesazhin se Dituria dhe Urtësia e All'llahut kërkon që robtë t'i lërë të lirë në Rrugën e përsosmërisë, sepse përsosmëria e detyruar nuk është zhvillim, se Dituria dhe Urtësia e All'llahut nuk lejon që të detyrojë disa njerëz të bëjnë vepra të mira dhe të tjerët të bëjnë vepra të liga dhe më pas, grupin e parë ta shpërblejë dhe të dytin ta ndëshkojë.

Në ajetin e mbylljes të kësaj çështjeje, tregohet fati i mirëbërësve dhe i keqbërësve. Ajeti thotë: **"Ai pranon në mëshirën e Vet kë të dojë, ndërsa për keqbërësit ka përgatitur një dënim të dhimbshëm."**.

Tërheq vëmendjen fakti se në fillim të ajetit thuhet: **"Ai pranon në mëshirën e Vet kë të dojë"**, por në fund të ajetit, dënimin e përqendron mbi shtypësin. Kjo tregon qartë se All'llahu ndëshkimin e jep për njerëzit që kanë bërë padrejtësi dhe mëkate, kurse në mëshirën e Tij përfshihen punëmirët. Kështu zbatohet Drejtësia Hyjnore dhe nuk mund të ketë ndonjë pritshmëri tjetër prej Urtësisë së All'llahut.

Me gjithë këto sqarime, sërish ka dijetarë, si Fakhru Rrazij, që pjesën e parë të ajetit e kanë marrë si argument për çështjen e fatalizmit *(el xhebru)*, pa e marrë në konsideratë vazhdimin e ajetit, i cili flet për vullnetin e lirë dhe lirinë e veprimet e shtypësve dhe të padrejtëve.[1]

O Zot, të lutem na përfshi në mëshirën Tënde, si dhe na shpëto prej dënimit të zjarrit të ashpër, që është në pritje të të padrejtëve.

O Krijuesi ynë! Ti e tregove Rrugën dhe ne që kemi ndërmend ta pasojmë këtë rrugë, të lutemi dhe të përgjërohemi për ndihmë!

O Zot! Nëse nuk jemi prej të devotshmëve, ne i duam ata, vetëm me bekimin Tënd mund t'u bashkëngjitemi!

Fundi i sures "El Insan"

[1] Për më shumë informacion, në lidhje me "Shpalljen", shih vëll. 19, f. 461-468, ajeti 37, sure "Ez Zumer".

Sure "El Murselat"

Zbritur në Mekë

50 ajete

Përmbajtja e sures "El Murselat"

Është e njohur se kjo sure ka zbritur në Mekë, por sipas disa dijetarëve, ajeti 48 i kësaj sureje ka zbritur në Medine. Ata nuk kanë përmendur ndonjë argument për këtë çështje. Në qoftë se fjalët *"ruku"* dhe *"namaz"*, të përmendura në këtë ajet, janë shkaku i këtij përfundimi, kjo nuk duket e saktë, sepse që herët myslimanët falnin namaz në Mekë dhe binin në ruku.

Sidoqoftë, çështjet kryesore që janë trajtuar në këtë sure, janë për Kiametin, për kërcënimin dhe paralajmërimin e përgënjeshtruesve dhe mohuesve.

Gjithashtu, veçori e kësaj sureje është se ajeti: **"Atë Ditë është mjerim i madh për ata që përgënjeshtruan."**, është përsëritur dhjetë herë dhe në secilën herë, pas një çështjeje të re.

Pasi përmend betime, na informon për Kiametin dhe ndodhitë e rënda dhe të vështira të Ringjalljes. Në vijim, e përmend po këtë ajet dhe thotë: **"Atë Ditë është mjerim i madh për ata që përgënjeshtruan."**.

Pas kësaj, trajton çështjen e historisë tragjike të popujve të kaluar mëkatarë.

Më pas përmend disa nga karakteristikat e krijimit të njeriut.

Në hapin e katërt, diskuton për një pjesë prej të mirave të All'llahut në tokë.

Në hapin e pestë, jep shpjegime për një pjesë prej dënimeve të përgënjeshtruesve.

Gjithashtu, në secilin hap sjell një çështje ndërgjegjësuese e tronditëse dhe e përsërit po këtë ajet: **"Atë Ditë është mjerim i madh për ata që përgënjeshtruan."**, madje në një pjesë të saj u referohet edhe begative të Xhennetit, që janë në pritje të të devotshmëve e të të drejtëve. Paralajmërimin e shoqëron me përgëzim dhe kërcënim.

Pavarësisht kësaj, kjo përsëritje të sjell në mendje përsëritjen e disa ajeteve të sures "Er Rrahman", me ndryshimin, se atje flitej rreth begative, kurse këtu përgjithësisht flitet për dënimet e përgënjeshtruesve.

Përzgjedhja e emrit "Murselat" për këtë sure është bërë për shkak të ajetit të parë të kësaj sureje.

Mirësitë e leximit të sures "El Murselat"

Në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: "*Ai që e lexon suren 'El Murselat', për të do të shkruhet: 'Ai nuk është prej politeistëve.'*".[1]

Në një hadith tjetër, të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të)*, lexojmë: "*Ai që e lexon këtë sure, All'llahu do ta njohë atë me Profetin Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), do ta ringjalli me të.*".[2]

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 414.

[2] Po aty.

Pa dyshim, ky shpërblim dhe kjo mirësi është për ata persona, që e lexojnë atë, meditojnë mbi të dhe e praktikojnë atë. Në një hadith tjetër, thuhet se disa nga shokët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu drejtuan atij: "O i Dërguari i All'llahut! Sa shpejt janë shfaqur shenjat e plakjes te ti?".

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u përgjigj; "*Mua më kanë plakur suret 'Hud', 'Vakiatu', 'Murselat' dhe 'En Nebe'.*".[1]

Duhet të kemi parasysh faktin se në suret e përmendura më lart, është pasqyruar gjendja e Kiametit, çështjet tronditëse dhe të frikshme të asaj gjykate të madhe. Këto kishin ndikuar në shpirtin e shenjtë të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Është e qartë se leximi i kësaj sureje pa meditim, përsiatje dhe pa praktikim, nuk mund të sjellë ndikime të tilla.

[1] "Khisal" i Saduk, vëll. 1, f. 199; "Babul Erbea", hadithi 10.

Ajetet 1 – 15

وَٱلۡمُرۡسَلَٰتِ عُرۡفٗا ١ فَٱلۡعَٰصِفَٰتِ عَصۡفٗا ٢ وَٱلنَّٰشِرَٰتِ نَشۡرٗا ٣ فَٱلۡفَٰرِقَٰتِ فَرۡقٗا ٤ فَٱلۡمُلۡقِيَٰتِ ذِكۡرًا ٥ عُذۡرًا أَوۡ نُذۡرًا ٦ إِنَّمَا تُوعَدُونَ لَوَٰقِعٞ ٧ فَإِذَا ٱلنُّجُومُ طُمِسَتۡ ٨ وَإِذَا ٱلسَّمَآءُ فُرِجَتۡ ٩ وَإِذَا ٱلۡجِبَالُ نُسِفَتۡ ١٠ وَإِذَا ٱلرُّسُلُ أُقِّتَتۡ ١١ لِأَيِّ يَوۡمٍ أُجِّلَتۡ ١٢ لِيَوۡمِ ٱلۡفَصۡلِ ١٣ وَمَآ أَدۡرَىٰكَ مَا يَوۡمُ ٱلۡفَصۡلِ ١٤ وَيۡلٞ يَوۡمَئِذٖ لِّلۡمُكَذِّبِينَ ١٥

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!

"Betohem në ato që dërgohen njëra pas tjetrës."

"Betohem në ato që shpejtojnë shtrëngatën."

"Betohem në ato që shpërndajnë shiun."

"Betohem në ato që ndajnë saktësisht."

"Betohem në ato që përcjellin këshilla."

"Si shfajësim apo paralajmërim."

"Në të vërtetë, ajo që ju është premtuar, do të bëhet."

"Kur yjet të shuhen."

"Dhe, kur qielli të çahet."

"Dhe, kur malet të thërrmohen si pluhur."

"Dhe, kur të Dërguarit të tubohen në kohën e caktuar."

"Në cilën ditë do të ndodhin të gjitha këto?"

"Në Ditën e Ndarjes vendimtare."

"Kush, vallë, do të ta shpjegojë se ç'është Dita e Ndarjes vendimtare?"

"Mjerë përgënjeshtruesit në atë Ditë!"

Komentimi

Premtimet e All'llahut janë të vërteta, mjerë përgënjeshtruesit!

Në pesë ajetet e para të kësaj sureje, janë përmendur pesë betime, për të cilët komentuesit kanë diskutuar shumë:

Në fillim thuhet: **"Betohem në ato që dërgohen njëra pas tjetrës. Betohem në ato që shpejtojnë shtrëngatën. Betohem në ato që shpërndajnë shiun. Betohem në ato që ndajnë saktësisht. Betohem në ato që përcjellin këshilla, si shfajësim apo paralajmërim!"**.

Tani le të shohim se cili është kuptimi i këtyre betimeve të paqarta dhe për cilat çështje të rëndësishme na informojnë.

Tri janë komentimet më të njohura:

1- Të gjitha këto betime flasin për "erëra dhe tufane", që kanë një rol ndikues në shumë prej çështjeve të rëndësishme të botës natyrore, prandaj kuptimi i ajetit do të ishte i tillë: "Betohem në erëra, që fryjnë njëra pas tjetrës.

Betohem në stuhitë e forta, që lëvizin me shpejtësi të lartë.

Betohem në ato, që i përhapin retë dhe lëshojnë pikat e shiut jetëdhënës mbi fushat e thara.

Betohem në ato, që i shpërndajnë retë pas rënies së shiut.

Betohem në këto erëra, që, me anë të këtij funksioni, i bëjnë njerëzit të mendojnë për All'llahun.".

Disa të tjerë, fjalinë: **"Betohem në ato që shpejtojnë shtrëngatën"**, e kanë konsideruar aludim për shtrëngatat e dënimit, kundrejt erërave jetëdhënëse të kësaj bote, të cilat, po ashtu, bëhen shkak i kujtimit dhe i ndërgjegjësimit.

2- Të gjitha këto betime u referohen "engjëjve të All'llahut", që do të thotë: "betohem në engjëjt, që, në mënyrë të njëpasnjëshme, u janë dërguar Profetëve, (apo engjëjt që janë dërguar me programe të qarta dhe të njohura).

Betohem në ata, që, si shtrëngatat, me shpejtësi maksimale shkojnë pas misionit të tyre.

Betohem në ata që u hapin dhe kumtojnë Profetëve ajetet e Librave qiellorë.

Betohem në ata që, me anë të kësaj vepre, ndajnë të vërtetën nga e pavërteta (falsiteti).

Betohem në ata që kujtimin e All'llahut dhe Urdhrat e Tij ua sjellin Profetëve.

3- Betimi i parë dhe i dytë i referohet çështjes së "erërave dhe shtrëngatave", betimi i tretë, i katërt dhe i pestë i referohet përhapjes (komunikimit) të ajeteve të All'llahut përmes "engjëjve" dhe më pas, ndarjen e të vërtetës nga e pavërteta. Në fund "mbjellja" e kujtimit dhe e urdhrave, (ligjeve) hyjnore te Profetët, me qëllim mbarimin e argumenteve dhe paralajmërimit.

Ajo që mund të shërbejë si dëshmi për komentimin e tretë, është:

Së pari, ndarja e betimeve në këto ajete në dy grupe është bërë me anë të lidhëzës *"uau"*, ndërkohë që në ajetet tjera, ndarjet janë bërë me anë të pjesëzës *"fa"*, që është argument i ndërlidhjes dhe bashkëngjitjes së tyre.

Së dyti, ashtu siç do ta vërejmë edhe në vazhdim, të gjitha këto betime flasin për çështjen që është përmendur në ajetin e shtatë, pra, për vërtetësinë dhe besueshmërinë e Ringjalljes. Ndërkohë, ne e dimë se në prag të Ringjalljes, në botë do të ndodhin ndryshime të mëdha. Erërat e forta dhe shtrëngata, tërmete dhe ngjarje tronditëse, nga një anë dhe nga ana tjetër, formimi i Gjykatës Hyjnore, ku engjëjt do të shpalosin librat e veprave të njerëzve, do të ndajnë besimtarët prej jobesimtarëve dhe do të komunikojnë vendimin e Zotit, sipas veprave të kryera.

Në qoftë se betimet e lartpërmendura, (që ishin pesë në numër), shpjegohen sipas këtij interpretimi, do të kishte përshtatje me ç'është betuar dhe në këtë këndvështrim, komentimi i fundit ka përparësi.

Fjala *"dhikrun"* në fjalinë: **"Betohem në ato që përcjellin këshilla",** ose tregon dijet dhe shkencat që u janë përcjellë Profetëve, ose janë ajetet që u janë zbritur atyre. Dimë se në ajetet kur'anore, për vetë Kur'anin, është përdorur fjala *"dhikr"*. Po këtë e lexojmë dhe në ajetin 6 të sures "El Hixhr": **"O Ti që t'u shpall përkujtimi,** (Kur'ani)**, me të vërtetë ti je i çmendur!"**.

Përdorimi i fjalës *"el mulkiat"* në numrin shumës është bërë, sepse engjëllin e Shpalljes, Xhebrailin, ndonjëherë e shoqëronte një grup i madh engjëjsh. Në ajetin 15 të sures "Abese", thuhet: **"Në duar të udhëtuesve"** (ajetet kur'anore iu zbritën Profetit të Islamit)", pra bëhet fjalë për shumë engjëj.

Tani duhet të shohim se cili është synimi i këtyre betimeve.

Në ajetin vijues qartësohet ky kuptim: **"Në të vërtetë, ajo që ju është premtuar, do të bëhet."**.

Ringjallja dhe sjellja në shesh, shpërblimi dhe dënimi, llogaria dhe gjykimi, që të gjitha janë të vërteta dhe nuk ka asnjë dyshim për to.

Disa të tjerë, gjithashtu, këtë e konsiderojnë si treguese për të gjitha premtimet e All'llahut, përfshirë premtimet që janë dhënë ndaj të mirëve dhe të këqijve në këtë botë, apo në Ahiret, por ajetet

në vijim na e bëjnë të qartë se me këtë synohet vetëm premtimi i Kiametit.[1]

Edhe pse në këtë ajet nuk ka asnjë arsyetim për Ringjalljen dhe është mjaftuar vetëm me pretendim, interesante është se në betimet pararendëse janë përmendur argumente për Ringjalljen, si p.sh, gjallërimi i tokave të vdekura me anë të zbritjes së shiut, që është shembull nga skena e Kiametit.

Po ashtu, zbritja e ligjeve hyjnore Profetëve dhe dërgimi i Profetëve, nuk do të kishte kuptim pa Ringjalljen. Kjo tregon se premtimi për Ringjalljen është i vërtetë dhe i patjetërsueshëm.

Kjo çështje, gjithashtu, është përmendur dhe në ajetin 23 të sures "Edh Dhariat": **"Pasha Zotin e qiellit e të tokës, risku juaj është i vërtetë, ashtu siç është e vërtetë se ju flisni."**.

Betimi në *"rabbun"*, tregon për Kujdestarinë dhe sundimin e All'llahut dhe drejtimin e Tij në botën krijuese, kërkon që robtë të mos i lejë pa risk dhe ushqim.

Më pas, ajeti përmend shenjat e asaj Dite të premtuar: **"Kur yjet të shuhen dhe, kur qielli të çahet dhe, kur malet të thërrmohen si pluhur."**.

Fjala *"tumiset"* rrjedh nga fjala *"tamsun"* dhe tregon heqjen e gjurmëve të një gjëje. Këtu ka mundësi të flasë për shuarjen e dritës së yjeve, apo shkatërrimin e tyre. Komentimi i parë është më i përshtatshëm, ashtu siç thuhet dhe në ajetin 2 të sures "Et Tekuir": **"Dhe kur yjet të jenë eklipsuar,** (shkapërderdhur)**."**.

[1] Referimi ndaj pjesëzës *"fa"*, gjithashtu, e përforcon këtë çështje.

Fjala *"nusifet"* rrjedh nga fjala *"nesfun"* dhe tregon hedhjen e farërave të ushqimit në sitë dhe tundjen e tyre, derisa lëvorja e tyre të ndahet nga kokrrat. Këtu është në kuptimin e tretjes, më pas hedhjes në erë të maleve.

Në thelb, nga ajete të shumta kur'anore përftohet se fundi i kësaj bote do të shoqërohet me një seri tragjedish shumë të frikshme dhe tronditëse, të cilat do ta shkatërrojnë gjithë rendin e saj dhe atë do ta zëvendësojë Bota e Ahiretit, me një rend të ri.

Këto tragjedi do të jenë aq të çuditshme dhe të frikshme, sa nuk mund të përshkruhen.

Vallë, a përshkruhen ndodhi që i lëvizin malet nga vendi dhe i përplasin aq fort, saqë shndërrohen në pluhur dhe i kthen ato në formën e leshit të rrahur dhe të shtypur?!

Komentuesit shprehen se madhështia e këtyre ngjarjeve është në atë shkallë, saqë tërmetet më të mëdha, të cilat njeriu i ka parë me sytë e tij, konsiderohen si fishekzjarrë me të cilat luajnë fëmijët dhe i shpërthejnë, në krahasim me bombën më të madhe atomike.

Sidoqoftë, këto shprehje kur'anore janë argument për ndryshimin e madh që ekziston mes rendit të Ahiretit dhe rendit të kësaj bote.

Në vazhdim, ajeti tregon një prej skenave të Ringjalljes: **"Kur të Dërguarit të tubohen në kohën e caktuar."**, për të dhënë dëshmi.

Në ajetin 6 të sures "El A'raf": **"Ne patjetër do të marrim në përgjegjësi ata, të cilëve u është dërguar** (Profet) **e do t'i marrim në pyetje edhe të Dërguarit."**.

Më pas ajeti shton: **"Në cilën ditë do të ndodhin të gjitha këto? Në Ditën e Ndarjes vendimtare!"**.

Dita e ndarjes së të vërtetës nga e pavërteta, e ndarjes së rreshtave të besimtarëve nga jobesimtarët, e vepërmirëve nga vepërkëqijtë dhe e Ditës së Gjykimit absolut të All'llahut ndaj të gjithëve.

Këto pyetje dhe përgjigje janë për të shprehur madhështinë e asaj Dite të madhe, e Ditës së ndarjeve!

Më pas, për të shprehur madhështinë e asaj Dite, ajeti shton: **"Kush, vallë, do të ta shpjegojë se ç'është Dita e Ndarjes vendimtare?"**.

Kur edhe Profeti, me gjithë atë dituri të gjerë, me atë shikim të mprehtë, me të cilin vëzhgonte të fshehtat, të mos jetë në dijeni për dimensionet e madhështisë së asaj Dite, është e qartë gjendja e njerëzve të tjerë. Ashtu siç e kemi diskutuar edhe shumë herë të tjera, perceptimi i të gjitha sekreteve të madhërishme të Kiametit për banorët e kësaj bote është i pamundur.

Në ajetin e fundit të diskutimit tonë, përgënjeshtrusit e asaj Dite të Madhe, kërcënohen ashpër. Atyre u thuhet: **"Mjerë përgënjeshtruesit në atë Ditë."**.

Fjalën *"uejlun"* disa e kanë interpretuar në kuptimin: *"shkatërrim"*, disa të tjerë në kuptimin: *"lloje dënimi"* dhe disa të tjerë, në kuptimin: *"luginë e mbushur me dënime dhe vuajtje në*

Xhehennem". Kjo fjalë zakonisht përdoret për ngjarjet e tmerrshme. Këtu tregon fatin e dhimbshëm të përgënjeshtruesve të asaj Dite.[1]

Fjala *"mukedhib'bijne"* tregon ata që e kanë përgënjeshtruar Kiametin. Dimë se ai që nuk beson në Kiamet, në Gjykatën e Drejtë Hyjnore, në llogarinë dhe dënimin e asaj Dite, shumë lehtë mund të përlyhet dhe të përfshihet në çdo lloj mëkati, në çdo dhunë dhe padrejtësi, kurse besimi i fortë ndaj asaj Dite, i jep njeriut ndjenjën e angazhimit, të përgjegjësisë dhe të devotshmërisë.

Hulumtim

Përmbajtja e këtyre betimeve

Në ajetet e lartpërmendura, së pari, është bërë betimi për erëra të forta dhe shtrëngata. Kjo tregon rolin e rëndësishëm që ato kanë në botën e krijuar. Ato i vënë në lëvizje retë, më pas ato i bashkon mbi tokat e thara dhe "të vdekura", dhe pas rënies së shiut, prapë ato shpërndahen.

Farat e bimëve i shpërndajnë nga një vend në tjetër dhe krijojnë pyje dhe kullota.

[1] Një përshkrim më të detajuar për kuptimin e fjalës *"uejl"* dhe ndryshimin e saj me fjalën *"uejs"* dhe *"uejh"* është dhënë në vëll. 22, f. 402, ajeti 60, sure "Edh Dhariat".

Shumë prej luleve dhe frutave i fekondojnë dhe ajrin e ngrohtë, apo të ftohtë e çojnë në vende të tjera të tokës dhe e moderojnë motin.

Ajrin e gjallë dhe plot oksigjen, nga fushat dhe shkretëtirat e dërgojnë në qytete, kurse ajrin e ndotur e marrin dhe e dërgojnë për pastrim në shkretëtirë.

Ujërat e deteve i bëjnë të stuhishme dhe të trazuara dhe i mbushin me oksigjen për organizmat (gjallesat e gjalla).

Erërat dhe flladet kanë funksione të mëdha dhe kryejnë shërbime jetike në këtë botë.

Pjesa tjetër e këtyre betimeve, të cilat flasin për zbritjen e Shpalljes nëpërmjet engjëjve në botën shpirtërore, gjithashtu, ka kuptim të ngjashëm me fryrjen e flladit në botën materiale. Fjalët e Shpalljes që janë jetëdhënëse si pikat e shiut, engjëjt i "mbjellin" në zemrën e Profetëve, siç mbillen lulet dhe frutat e njohurive hyjnore, siç mbillet devotshmëria në zemra. Në këtë kuptim është betimi i All'llahut të Madhëruar në kultivuesit e botës materiale dhe në kultivuesit të botës shpirtërore.

Interesant është fakti se të gjitha këto betime janë bërë për të përshkruar vërtetësinë e asaj Dite, ku të gjitha këto përpjekje do të japin frytet e tyre, pra, për Ditën e Kiametit, Ditën e Ndarjes.

Ajetet 16 – 28

أَلَمْ نُهْلِكِ ٱلْأَوَّلِينَ١٦ ثُمَّ نُتْبِعُهُمُ ٱلْآخِرِينَ١٧ كَذَٰلِكَ نَفْعَلُ بِٱلْمُجْرِمِينَ١٨ وَيْلٌ يَوْمَئِذٍ لِّلْمُكَذِّبِينَ١٩ أَلَمْ نَخْلُقكُّم مِّن مَّآءٍ مَّهِينٍ٢٠ فَجَعَلْنَٰهُ فِى قَرَارٍ مَّكِينٍ٢١ إِلَىٰ قَدَرٍ مَّعْلُومٍ٢٢ فَقَدَرْنَا فَنِعْمَ ٱلْقَٰدِرُونَ٢٣ وَيْلٌ يَوْمَئِذٍ لِّلْمُكَذِّبِينَ٢٤ أَلَمْ نَجْعَلِ ٱلْأَرْضَ كِفَاتًا٢٥ أَحْيَآءً وَأَمْوَٰتًا٢٦ وَجَعَلْنَا فِيهَا رَوَٰسِىَ شَٰمِخَٰتٍ وَأَسْقَيْنَٰكُم مَّآءً فُرَاتًا٢٧ وَيْلٌ يَوْمَئِذٍ لِّلْمُكَذِّبِينَ٢٨

“A nuk i kemi zhdukur të lashtët.”

“E pastaj do t’i bëjmë të tjerët t’i pasojnë?”

“Kështu do të veprojmë me të gjithë keqbërësit.”

“Mjerë përgënjeshtruesit në atë Ditë!”

“A nuk ju kemi krijuar nga një pikë lëngu të shpërfillur”

“të cilën e vumë në një vend të sigurt (mitër)**”**

“deri në një kohë të caktuar?!”

“Kështu e kemi rregulluar; sa Rregullues të shkëlqyer jemi Ne.”

“Mjerë përgënjeshtruesit në atë Ditë!”

"A nuk e kemi bërë Tokën vendqëndrim."

"Të të gjallëve dhe të të vdekurve?"

"A nuk kemi vënë në të male të larta e të patundshme? A nuk ju kemi dhënë të pini me bollëk ujë të ëmbël?"

"Mjerë përgënjeshtruesit në atë Ditë!"

Komentimi

Me gjithë këto manifestime të fuqisë, sërish dyshoni në Ringjallje?!

Në këto ajete, përmes mënyrave të ndryshme, jo vetëm paralajmërohen mohuesit e Ringjalljes, por, me anë të shprehjeve të ndryshme, i zgjon ata nga gjumi i thellë i neglizhencës.

Në fillim, i kap ata për dore dhe i çon prapa në histori dhe u tregon atyre tokat e prekura nga fatkeqësitë, që përfshinë popujt e kaluar jobesimtarë: **"A nuk i kemi zhdukur të lashtët?"**.

Gjurmët e tyre nuk shihen vetëm mbi faqet e historisë. Gjurmët e tyre janë të dukshme dhe në tokë. Popuj të tillë, si: populli i Adit, i Themudit, i Nuhut dhe i Lutit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ata!)*, si dhe populli i Faraonit, u shkatërruan nga stuhitë, pjesa tjetër nga rrufetë, nga tërmetet dhe kometat. Ata u ndëshkuan dhe u asgjësuan për veprat e tyre.

Më pas ajeti shton: **"Pastaj do t'i bëjmë të tjerët t'i pasojnë?"**.

Kjo është një traditë e vazhdueshme dhe nuk pranon diskriminim e përjashtim. A është e mundur, që një grup ta dënojë për një krim dhe po atë krim ta pëlqejë për të tjerët?!

Prandaj në ajetet në vijim thuhet: **"Kështu do të veprojmë me të gjithë keqbërësit."**.

Ky ajet tregon shkatërrimin e "popujve të lashtë" dhe më pas shkatërrimin e "popujve të tjerë, të fundit", sepse Dënimet Hyjnore as nuk kanë aspektin e hakmarrjes dhe as qërimin e hesapeve personale, por bazohen në parimin e meritës, të urtësisë dhe të filozofisë së krijimit.

Disa komentues kanë thënë se me fjalën *"evvelijne"* tregohen popujt që kanë jetuar shumë kohë më parë, si: populli i Nuhut, i Adit dhe i Themudit, kurse me "popujt e fundit" kuptohen popujt që kanë ardhur pas tyre, si: populli i Lutit dhe populli i Faraonit. Por përdorimi i foljes *"nutbiuhum"* në kohën e tashme, ndërkohë që folja *"elem nuhlik"* është në kohën e shkuar, bëhet e qartë që kuptimi i foljes *"evvelijne"* i përfshin të gjithë popujt e lashtë, të cilët u shkatërruan nga Dënimi Hyjnor, kurse me fjalën *"aherin"* tregohen jobesimtarët që kanë jetuar në kohën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*, ose ata që do të vijnë pas tij dhe do të përlyhen me mëkate, gjynahe, dhunë dhe korrupsion.

Në përfundim arrihet në këtë përfundim: **"Mjerë përgënjeshtruesit në atë Ditë!"**.

Fjala *"jeumeidhin"* tregon dënimet kryesore në Ditën e Ringjalljes. Përsëritja e këtij fakti bëhet për përforcimin e çështjes. Disa komentues kanë pretenduar se ky ajet lidhet me dënimet e kësaj bote, kurse ajeti i ngjashëm me të, i cili u përmend më parë, ka të bëjë me dënimin e Ahiretit. Ky argumentim është i papranueshëm.

Më pas, i çon ata në botën embrionale (të fetusit) dhe u tregon atyre madhështinë, fuqinë dhe shumëllojshmërinë e të mirave të All'llahut në këtë botë misterioze. Për të treguar fuqinë e All'llahut në çështjen e Ringjalljes, nga njëra anë, ta konsiderojnë veten borxhli ndaj këtyre begative të panumërta dhe të llojllojshme të All'llahut dhe, nga ana tjetër, karshi Tij të ulin kokën në shenjë përuljeje.

Kur'ani thotë: **"A nuk ju kemi krijuar nga një pikë lëngu të shpërfillur, të cilën e vumë në një vend të sigurt** (mitër)**?!"**.

Në mitër, në atë vend që është i siguruar nga çdo pikëpamje dhe ka të gjitha kushtet për kultivim, për jetesë, për zhvillim dhe për ruajtjen e fetusit njerëzor, aq përsosmërish, sa çudit çdo njeri.

Ajeti shton: **"deri në një kohë të caktuar"**.

Deri në atë kohë, për të cilën askush nuk është në dijeni, përveç All'llahut. Një kohë e mbushur me ndryshime, transformime dhe shumë zhvillime. Për një kohë, ku çdo ditë fetusi i njeriut vishet me një "rrobë" të re jete dhe e çon përpara në rrugën e përsosmërisë në atë vend të fshehtë.

Më pas ajeti thotë: **"Kështu e kemi rregulluar, sa Rregullues të shkëlqyer jemi Ne."**.

Ky është po ai argument ku është mbështetur shumë herë Kur'ani, për argumentimin e çështjes së Ringjalljes, si në ajetet e para të sures "Haxhxh", ku thotë se si mund të dyshoni në Ringjalljen e të vdekurve, ndërkohë që fuqinë e All'llahut e vëreni në këtë botë, në krijimin e njeriut prej një lëngu të pavlerë, çdo ditë e të cilit është Ringjallje?! Çfarë ndryshimi ka mes dheut dhe atij lëngu të pavlerë?

Në fund, sërish e përsërit fjalinë: **"Mjerë përgënjeshtruesit në atë Ditë!"**.

Mjerë ata që i shohin të gjitha këto shenja të fuqisë së All'llahut dhe sërish e mohojnë Atë!

Për këtë çështje, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"O krijesë e krijimit, që je ngjizur dhe je ruajtur në thellësitë e errëta të mitrave me shumë perde! Je krijuar nga substanca e dheut* (Kur'an, 23/12) *dhe je vendosur në vend të sigurt, gjer në urdhrin e pritur dhe afatin e caktuar.* (Kur'an, 71/21:22). *Mandej je transferuar prej vendbanimit tënd në vendbanimin që nuk e ke parë, as nuk i ke ditur mënyrat e shfrytëzimit të tij. Kush është Ai që të ka udhëzuar të thithësh nga gjoksi i nënës tënde dhe për të gjitha kërkesat dhe dëshirat e tua? Madje edhe shumë më shumë! Kush është ai që nuk është në gjendje të kuptojë cilësitë e atij me formë e gjymtyrë, që është edhe më pak i aftë të kuptojë cilësitë e Krijuesit, ose edhe më shumë se kjo, ta kuptojë me ndihmën e suazave të asaj që është krijuar?"*.[1]

Në pjesën tjetër të këtyre ajeteve, fillon shpjegimi i një pjese prej shenjave dhe gjurmëve të All'llahut, i mirësive dhe i të mirave të Tij në universin e madh. Këto janë argumente për fuqinë e

[1] "Nehxhul Belaga", Fjalimi 163.

mëshirën e gjerë të All'llahut, edhe provë për mundësinë e Ringjalljes, ndërkohë që në ajetet e kaluara u diskutua për shenjat e vazhdueshme të shfaqjes së dhuntisë së All'llahut në krijimin e vetë njeriut.

Ajeti thotë: **"A nuk e kemi bërë Tokën vendqëndrim të të gjallëve dhe të të vdekurve?"**.

Fjala *"kifaten"* dhe fjala *"kiftun"* tregojnë mbledhjen dhe ngjitjen (shtimin) e një gjëje me një gjë tjetër. Gjithashtu *"kifaten"* është quajtur edhe fluturimi i shpejtë i zogjve, sepse gjatë fluturimit të shpejtë, i mbledhin krahët, në mënyrë që të çajnë ajrin me shpejtësi më të madhe dhe të ecin përpara.

Ky shpjegim tregon se toka është një vendqëndrim për të gjithë njerëzit, i mbledh të gjithë të gjallët dhe vë në dispozicion të tyre çdo gjë që u nevojitet, mbledh edhe të vdekurit e tyre në zemrën e saj. Nëse toka nuk do të ishte e gatshme për varrosjen e të vdekurve, infeksionet dhe sëmundjet që rrjedhin prej tyre, do të ishin burim i fatkeqësisë për të gjithë të gjallët.

Ashtu si nëna që i mbledh rreth vetes fëmijës e saj, edhe toka mbledh rreth vetes të gjithë njerëzit, i ledhaton ata, i ushqen, i veshmbath, i strehon, si dhe ua siguron dhe ua plotëson të gjitha kërkesat dhe nevojat, madje edhe të vdekurit e tyre i fut brenda vetes, i "përtyp" ata dhe i zhduk pasojat e tyre të këqija.

Disa komentues të tjerë, fjalën *"kifaten"* e kanë komentuar në kuptimin: *"fluturim i shpejtë"* dhe ajetin e konsiderojnë si aludim për lëvizjen e tokës rreth diellit dhe lëvizje të tjera, të cilat, në kohën e zbritjes së Kur'anit, akoma nuk ishin zbuluar.

Por, duke pasur parasysh vazhdimin e ajetit: **"të të gjallëve dhe të të vdekurve"**, komentimi i parë duket më i përshtatshëm.

Duhet të kemi pasur parasysh edhe një hadith të transmetuar për Imam Aliun. Me pak fjalë, historia është: "Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* po kthehej nga Sefijni. Kur mbërriti afër Kufes, vuri re një varrezë. Sapo e pa, tha: *'Ky është vendstrehimi i të vdekurve'. Hodhi një vështrim mbi shtëpitë e Kufes dhe ndër të tjera, shtoi: 'Këto, gjithashtu, janë banesat e jetesës së tyre...'*. Më pas lexoi ajetet e lartpërmendura: **"A nuk e kemi bërë Tokën vendqëndrim të të gjallëve dhe të të vdekurve?"**.[1]

Ky koment i këtij ajeti sqaron se midis shtëpive të të gjallëve dhe të vdekurve nuk ekziston ndonjë largësi e madhe.

Më pas, ajeti përmend një prej begative më të mëdha të All'llahut në rruzullin tokësor: **"A nuk kemi vënë në të male të larta e të patundshme?"**.

Këto male të larta dhe të ndërthurura me njëra-tjetrën në rrënjë, nga një anë e kanë blinduar tokën dhe e mbrojnë atë nga presionet e brendshme dhe presionet që burojnë nga "baticat dhe zbaticat" e jashtme.

Nga ana tjetër, parandalojnë fërkimin e shtresës së ajrit me tokën.

Së treti, kontrollojnë shtrëngatat dhe erërat e forta. Në këtë mënyrë u dhuron banorëve të tokës qetësi dhe rehati. Në vazhdim

[1] Tefsiri "El Burhan", vëll. 4, f. 417, transmetuar nga tefsiri "Ali ibn Ibrahim".

të po këtij ajeti, Kur'ani përmend një begati tjetër të maleve: **"A nuk ju kemi dhënë të pini me bollëk ujë të ëmbël?"**.[1]

Ky ujë është i shijshëm dhe i burim i jetës edhe për ju, edhe për shtazët tuaja, për drithërat e kopshtet tuaja.

Të gjithë ujërat e ëmbla rrjedhin nga shiu, por malet luajnë një rol kryesor, sepse shumë prej burimeve dhe ujërave nëntokësore rrjedhin nga malet, prej të cilëve burojnë edhe lumenj të shumtë, të cilët krijojnë rezervat kryesore të ujit të pijshëm për njerëzit.

Majat e larta të maleve janë gjithnjë të ftohta dhe kështu me vite të tëra ruajnë brenda vetes rezervat e dëborës, në mënyrë që gradualisht, nën ndikimin e dritës së diellit, ajo të shkrihet dhe të ushqejë lumenjtë me ujë të pijshëm.

Në përfundim, sërish ajeti thotë: **"Mjerë përgënjeshtruesit në atë Ditë!"**.

Si është e mundur që shumë njerëz që i shohin me sytë e tyre të gjitha këto shenja dhe argumente të fuqisë së All'llahut, të gjitha këto begati të Tij dhe që janë të zhytur plotësisht në to, sërish e mohojnë Ringjalljen dhe Gjyqin e Kiametit, mohojnë Drejtësinë dhe Urtësisë e Tij?!

Ajetet 29 – 40

[1] Fjala *"revasiju"* është shumësi i fjalës *"rasijetun"* dhe është në kuptimin: "e qëndrueshme", kurse fjala *"shamikhatun"* është shumësi i fjalës *"shamikhun"* dhe është në kuptimin "lartësi". Në disa shprehje, si *"shemekhe bi enfihi"*, nënkupton mendjemadhësinë. ("Mufredate" Ragib.)

ٱنطَلِقُوٓاْ إِلَىٰ مَا كُنتُم بِهِۦ تُكَذِّبُونَ٢٩ ٱنطَلِقُوٓاْ إِلَىٰ ظِلّٖ ذِى ثَلَٰثِ شُعَبٖ٣٠ لَّا ظَلِيلٖ وَلَا يُغۡنِى مِنَ ٱللَّهَبِ٣١ إِنَّهَا تَرۡمِى بِشَرَرٖ كَٱلۡقَصۡرِ٣٢ كَأَنَّهُۥ جِمَٰلَتٞ صُفۡرٞ٣٣ وَيۡلٞ يَوۡمَئِذٖ لِّلۡمُكَذِّبِينَ٣٤ هَٰذَا يَوۡمُ لَا يَنطِقُونَ٣٥ وَلَا يُؤۡذَنُ لَهُمۡ فَيَعۡتَذِرُونَ٣٦ وَيۡلٞ يَوۡمَئِذٖ لِّلۡمُكَذِّبِينَ٣٧ هَٰذَا يَوۡمُ ٱلۡفَصۡلِۖ جَمَعۡنَٰكُمۡ وَٱلۡأَوَّلِينَ٣٨ فَإِن كَانَ لَكُمۡ كَيۡدٞ فَكِيدُونِ٣٩ وَيۡلٞ يَوۡمَئِذٖ لِّلۡمُكَذِّبِينَ٤٠

"(Do t'u thuhet)**: 'Nisuni drejt atij** (dënimi) **që e mohuat!'"**

"Shkoni drejt një hijeje me tri kolona (tymi të Xhehennemit)**."**

"E cila nuk bën hije (freskuese) **dhe as nga flaka nuk të shpëton!"**

"Ajo hedh shkëndija të mëdha sa një kala."

"Sikur të ishin deve të verdha!"

"Mjerë përgënjeshtruesit në atë Ditë!"

"Kjo është Një Ditë, kur ata nuk do të mund të flasin."

"Dhe nuk do t'u jepet leje për t'u shfajësuar."

"Mjerë përgënjeshtruesit në atë Ditë!"

"Kjo është Dita e Ndarjes vendimtare, në të cilën do të tuboheni ju dhe popujt e lashtë."

"Prandaj, nëse zotëroni ndonjë dinakëri, përdoreni kundër Meje!"

"Mjerë përgënjeshtruesit në atë Ditë!"

Komentimi

As kanë fuqinë për t'u mbrojtur e as rrugë për të shpëtuar

Në këto ajete përshkruhet fati përfundimtar i përgënjeshtruesve të Kiametit dhe i mohuesve të Gjyqit të Drejtë Hyjnor. Ky përshkrim e fut njeriun në një tmerr të thellë, si dhe ia bën të qarta dimensionet e tragjedisë.

Në fillim thuhet**: "**(Do t'u thuhet): **'Nisuni drejt atij** (dënimi) **që e mohuat.'"**.

Nisuni drejt atij dënimi (të Xhehennemit), që u tallet me të dhe e mohuat.

Nisuni në drejtim të torturave të llojllojshme, të cilat i kishit përgatitur më herët me anë të veprave tuaja.

Fjala *"intaliku"* rrjedh nga fjala *"el intiláku"* dhe tregon: *"lëvizje pa ndalim"*. Brenda këtij kuptimi është fshehur edhe një lloj lirie nga pengesat dhe prangat. Ky shpjegim tregon gjendjen e tyre

në Ditën e Kiametit. Atë Ditë, ata do të mbahen për një kohë të gjatë për të dhënë llogari. Më pas, do t'i lirojnë dhe do t'u thonë: "Nisuni drejt dënimit (Xhehennemit) pa ndaluar.".

Ky folës mund të jetë Vetë All'llahu i Madhëruar, që u drejtohet atyre në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose mund të jenë engjëjt e dënimit. Pavarësisht se kush është folësi, urdhri që jepet, ka një ton të përzier me qortim të thellë. Ky qortim, është një dënim i dhimbshëm dhe dërrmues.

Më pas, ajeti jep një shpjegim më të detajuar për këtë dënim dhe shton: **"Shkoni drejt një hijeje me tri kolona,** (tymi të Xhehennemit)**."**.

Këto tri kolona rrinë: njëra sipër kokave të tyre, tjetra, në anën e djathtë dhe kolona e tretë, në anën e majtë të tyre. Në këtë mënyrë, ata, nga çdo anë, janë të rrethuar nga ky tym vdekjeprurës, i cili do t'i përpijë brenda vetes.

Më pas shton: **"E cila nuk bën hije** (freskuese) **dhe as nga flaka nuk të shpëton!"**.

Disa komentues kanë supozuar se fjala *"dhil'lin"* - *"hije"* të krijon perceptimin se atje ekziston një hije që e ul ca flakën përvëluese të zjarrit, por ky ajet e kundërshton këtë supozim dhe thotë se kjo hije aspak nuk është hija që ju kishit imagjinuar, por është një hije që të përvëlon dhe të mbyt. Ajo është e formuar nga përqendrimi i tymit të zjarrit dhe i flakëve shkrumbuese.

Këtë fjali e dëshmojnë edhe ajetet e sures "El Uakia", të cilët për "Es'habul shimal" (njerëzit e së majtës), thonë: **"Janë në mes të zjarrit, në ujë të valuar dhe në errësirë të tymit, as të freskët e as**

të këndshëm, sepse ata përpara kësaj, kanë qenë të dhënë pas qejfeve.".[1]

Disa komentues të tjerë, kanë thënë se këto tri kolona përfaqësojnë tri përgënjeshtrimet e tyre për rrënjët e fesë, pra, për Monoteizmin, për Profetësinë dhe për Ringjalljen, sepse përgënjeshtrimi i Ringjalljes nuk është i ndarë nga përgënjeshtrimi i Profetësisë dhe i Monoteizmit.

Komentues të tjerë, kanë shprehur mendimin se këto tri kolona aludojnë për burimet e trellojshme të mëkatit, që janë: zemërimi, epshi dhe imagjinata, kurse tymi i errët është personifikimi i errësirave të pasioneve.

Ruaju nga errësira e zemërimit dhe e epshit,

që nga tymi i tyre do të errësohet syri i zemrës!

Kur vjen zemërimi, intelekti (mendja) del jashtë!

Nëse epshi dominon, shpirti çoroditet!

Më pas, duke bërë një përshkrim tjetër për këtë zjarr, ajeti shton: **"Ajo hedh shkëndija të mëdha sa një kala."**.[2]

Shkëndijat e zjarrit të Xhehennemit nuk janë si shkëndijat e zjarrit të kësaj bote, të cilat, ndonjëherë nuk janë as sa maja e gjilpërës.

Fjala *"kasrun"* këtu ka një kuptim shumë domethënës. Ndoshta mund të ishte më e përshtatshme të thuhej: "shkëndija si

[1] Sure "El Uakia", ajetet 42-44.

[2] Fjala *"shererin"* është shumësi i fjalës *"sheraretun"* dhe rrjedh nga fjala *"sherr"*. Kuptimi i saj është: *"grimca të vogla që ndahen nga zjarri dhe përhapen në ajër"*.

mali", por të mos harrojmë se në ajetet e mëparshme kemi thënë se malet janë burim i begative dhe depot e ujit të shijshëm, kurse kështjellat dhe pallatet e shtypësve dhe të të padrejtëve janë burim i flakëve përvëluese dhe i shkëndijave të zjarrit.[1]

Në ajetin vijues, në një përshkrim tjetër për shkëndijat e këtij zjarri përvëlues, thuhet: **"Sikur të ishin deve të verdha!"**.[2]

Fjala *"xhimaletun"* është shumësi i fjalës *"xhemelun"* dhe tregon devenë, kurse fjala *"sufrun"* është shumësi i fjalës *"esferun"* dhe tregon një gjë me ngjyrë të verdhë, ose një e verdhë që priret nga e zeza a nga një ngjyrë tjetër. Kuptimi i parë është më i përshtatshëm, sepse shkëndijat e zjarrit janë të verdha që anojnë drejt të kuqes.

Në ajetin pararendës, këto shkëndija ishin aq shumë, sa u krahasuan me një kështjellë të lartë, kurse në këtë ajet, për nga ngjyra, lëvizja e shpejtë dhe përhapja e tyre në çdo anë, janë krahasuar me deve me ngjyrë të verdhë, që lëvizin në çdo anë.

Aty ku ka shkëndi të tilla, aty do të ketë zjarr përvëlues. A mund të ketë torturë më të dhimbshme se djegia nga ky zjarr?!

---

[1] Disa komentues, si Fakhru Rrazij, për komentimin e fjalës *"kasr"*, kanë transmetuar nga Ibn Abasi se me këtë synohen drurët që i prisnin nëpër shkretëtirë dhe më pas i mblidhnin për dimër. Ky interpretim, gjithashtu, nuk ka mundësi të jetë, sepse drurët e vendosur njëri mbi tjetrin, nuk ka pse t'i krahasonin me një kala të lartë.

[2] Përemri *"ke en'nehu"* ka mundësi t'i rikthehet fjalës *"kasrun"* ose fjalës *"sherrerrin"*. Por, meqenëse fjala *"sherer"* është në shumës pa interpretim nuk është e mundur, vetëm nëse fjalën *"sherer"* e konsiderojmë si numër të përgjithshëm.

Sërish, në fund të këtyre ajeteve të këtij diskutimi, përsëritet i njëjti paralajmërim: **"Mjerë përgënjeshtruesit në atë Ditë!"**.

Më pas, ajeti fillon me trajtimin e pjesës tjetër të karakteristikave të asaj Dite të tmerrshme dhe thotë: **"Kjo është Një Ditë, kur ata nuk do të mund të flasin!"**.

Po, All'llahu i Madhëruar atë Ditë, mëkatarëve dhe kriminelëve do t'ua mbyllë gojën. Kjo është thënë edhe në suren "Ja Sin", në ajetin 65: **"Sot Ne ua mbyllim gojët e atyre, Neve na flasin duart e tyre, kurse këmbët e tyre dëshmojnë për atë që punuan."** Madje, në disa raste të tjera, në Kur'an thuhet se në Atë Ditë do të flasë dhe do të tregojë çdo gjë, edhe lëkura e tyre.

Ajeti përsëri shton: **"Nuk do t'u jepet leje për t'u shfajësuar."**.

As nuk mund të flasin dhe as nuk kanë leje të shfajësohen e të kërkojnë falje, sepse atë Ditë çdo gjë është e qartë, janë zbuluar të gjitha të vërtetat, nuk ka ngelur asnjë gjë pa u thënë. Të gjithë atyre që në këtë botë kanë abuzuar me lirinë e vet, kanë përgënjeshtruar të Dërguarit, i kanë përqeshur ata, kanë shtrembëruar të vërtetën, në atë Botë do t'u kyçet goja si ndëshkim për ç'kanë kryer. Kjo, në vetvete, është një torturë dhe dënim i dhimbshëm, sepse kur ata kanë aq shumë nevojë të flasin e të përpiqen të shfajësohen, u mbyllet goja.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet: *"All'llahu i Madhëruar është i Lartë, i Drejtë dhe i Madh. Ai nuk do ta pengonte robin e Tij të fliste e të shfajësohet, po të kishte alibi, por ata nuk kanë asnjë alibi për ta paraqitur."*.[1]

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 490.

Megjithatë, nga disa ajete kur'anore përftohet se në Kiamet, disa kriminelë do të flasin ndonjëherë, sepse, ashtu siç e kemi diskutuar edhe më parë, në Kiamet ka shumë vendndalime. Në disa prej tyre mbyllet goja dhe është radha e gjymtyrëve të trupit për të dhënë dëshmi, kurse në disa vendndalime të tjera, goja lëshohet dhe fillon të rrëfejë çështje të ndryshme. Kjo është shenjë e pikëllimit, e mjerimit, e keqardhjes dhe e konfuzionit të tyre.

Sërish në fund të kësaj pjese, ajeti thotë: **"Mjerë përgënjeshtruesit në atë Ditë!"**.

Një fjali tjetër tregon se çfarë i gjen kriminelët dhe përgënjeshtruesit në atë Ditë: **"Kjo është Dita e Ndarjes vendimtare, në të cilën do të tuboheni ju dhe popujt e lashtë..."**.

Sot, të gjithë njerëzit, pa përjashtim, që nga i pari deri te fundit, i kemi tubuar në këtë arenë dhe gjykatë të madhe për t'u kërkuar llogari.

Ajeti thotë: **"Prandaj, nëse zotëroni ndonjë dinakëri, përdoreni kundër Meje!"**.

Vallë, a mund të arratiseni nga territori i pushtetit Tim?

A mund të dominoni mbi fuqinë Time?

A jeni të aftë të paguani ndonjë shpërblim për t'u liruar?

A jeni të zotë t'i mashtroni përgjegjësit e llogaridhënies?

Çdo gjë që keni në dorë, kryejeni, por të jeni të bindur se nuk jeni në gjendje për të kryer asnjë veprim!

Në realitet kjo është të kërkosh një "çështjeje të pamundur", e cila tregon qartë paaftësinë dhe pafuqinë e palës tjetër, siç është ajo që është thënë për Kur'anin: "Nëse dyshoni mbi atë që ia kemi zbritur robit, sillni ndonjë sure të ngjashme me atë të Kur'anit!"

Fjala *"kejdun"*, siç është sqaruar edhe në veprën "Mufredat", tregon një lloj shkathtësie, e cila ndonjëherë është pozitive dhe ndonjëherë është e qortueshme, edhe pse në shumicën e rasteve është përdorur për rastet negative (siç është në ajetin në fjalë).

Atë Ditë, ata nuk janë në gjendje të kryejnë asnjë punë, sepse e dimë se në atë Ditë do të këputen lidhjet e tyre nga çdo lloj mjeti apo pajisjeje. Kjo është theksuar dhe në ajetin 166 të sures "El Bekare": **"...këputen lidhjet e tyre."**.

Duhet të kemi parasysh se, nga njëra anë, thotë se ajo Ditë është *"Jeumul Fasli"*, pra, Dita e Ndarjeve dhe, nga ana tjetër, ajo Ditë është *"Jeumul Xhem'i"*, që do të thotë është Dita e Tubimit. Secila nga këto deklarata realizohet në të njëjtën kohë, pra, në fillim të gjithë njerëzit do t'i tubojë në Gjykatën e Madhe, më pas do t'i ndajë ata në rreshta të ndryshëm, sipas bindjeve dhe veprave të tyre, madje edhe ata që shkojnë në Xhennet, do të jenë në rreshta të ndryshëm dhe kanë grada të ndryshme. Edhe në Xhehennem janë ndarë në rreshta dhe kanë pozita të ndryshme.

Ajo Ditë është Dita e Ndarjes së të vërtetës nga e pavërteta dhe e të drejtit nga i padrejti.

Sërish e përsërit fjalinë kërcënuese dhe thotë: **"Mjerë përgënjeshtruesit në atë Ditë!"**.

Ajetet 41 – 50

إِنَّ ٱلْمُتَّقِينَ فِى ظِلَٰلٍ وَعُيُونٍ ٤١ وَفَوَٰكِهَ مِمَّا يَشْتَهُونَ ٤٢ كُلُواْ وَٱشْرَبُواْ هَنِيٓـًٔا بِمَا كُنتُمْ تَعْمَلُونَ ٤٣ إِنَّا كَذَٰلِكَ نَجْزِى ٱلْمُحْسِنِينَ ٤٤ وَيْلٌ يَوْمَئِذٍ لِّلْمُكَذِّبِينَ ٤٥ كُلُواْ وَتَمَتَّعُواْ قَلِيلًا إِنَّكُم مُّجْرِمُونَ ٤٦ وَيْلٌ يَوْمَئِذٍ لِّلْمُكَذِّبِينَ ٤٧ وَإِذَا قِيلَ لَهُمُ ٱرْكَعُواْ لَا يَرْكَعُونَ ٤٨ وَيْلٌ يَوْمَئِذٍ لِّلْمُكَذِّبِينَ ٤٩ فَبِأَىِّ حَدِيثٍۭ بَعْدَهُۥ يُؤْمِنُونَ ٥٠

“Punëdrejtët do të jenë mes hijesh e burimesh.”

“Si dhe frutash nga ato që dëshirojnë.”

“(Do t’u thuhet) **‘Hani e pini e ju bëftë mirë,** (si shpërblim) **për atë që keni punuar.’”**

“Kështu i shpërblejmë Ne ata, që bëjnë vepra të mira.”

“Mjerë përgënjeshtruesit atë Ditë!”

“Hani dhe kënaquni për pak kohë! Ju jeni keqbërës!”

“Mjerë përgënjeshtruesit atë Ditë!”

“Kur atyre u thuhej: ‘Përkuluni (në namaz para All’llahut)**!’ - ata nuk përkuleshin.”**

“Mjerë përgënjeshtruesit në atë Ditë!”

"Në çfarë Shpallje tjetër do të besojnë ata, pas këtij (Kur'ani)**?!"**

Komentim

Në çfarë Shpallje tjetër do të besojnë ata?!

Dihet se metodoligjia kur'anore, është përzierja e paralajmërimit me përgëzimin, e kërcënimit me stimulimin, e pasqyrimit të fatit të besimtarëve, krahas fatit të kriminelëve, me qëllim që me anë të kontrastit, çështjet të kuptohen e perceptohen më mirë.

Mbështetur në këtë traditë, pas shpjegimit të dënimeve të llojllojshme për kriminelët në Kiamet, ka shpjeguar gjendjen e të devotshmëve dhe e të drejtëve: **"Punëdrejtët do të jenë mes hijesh e burimesh."**.

Kjo ndodh në kohën kur kriminelët do të jenë nën hijen e zjarrit flakërues dhe përvëlues.

Fjala *"dhilalun"* është shumësi i fjalës *"dhil'lun "* dhe tregon hijen, qoftë hijen e pemëve gjatë ditës, qoftë hijen që krijohet nga errësira e natës. Fjala *"el fej'u"* tregon hijen që krijohet vetëm nga një burim ndriçues, si hija e pemëve përball ndriçimit të diellit.

Ajeti shton: **"Si dhe frutash nga ato që dëshirojnë."**.

Është e qartë se përmendja e "frutave", e "hijeve" dhe e "burimeve" tregon për një pjese të të mirave të shumta të All'llahut për banorët e Xhennetit. Një pjese mund të përshkruhen me gjuhën e banorëve të kësaj bote por që nuk mund të përshkruhen dhe as mund të përfytyrohen nga mendjet e njerëzve të kësaj bote, sepse ato mirësi janë më të mira dhe më të larta.

Interesant është fakti se ata, në këtë vendbanim të pritjes hyjnore, priten në mënyrën më të mirë. Kjo tregohet edhe në ajtin në vijim: **"**(Do t'u thuhet)**: 'Hani e pini e ju bëftë mirë,** (si shpërblim) **për atë që keni punuar.'"**.

Kjo fjali, qoftë e drejtuar drejtpërsëdrejti nga All'llahu, qoftë e kumtuar përmes engjëjve, është e shoqëruar me dashuri dhe mirësi të qartë dhe tregon se ky është një ushqim për shpirtrat dhe zemrat e tyre.

Shprehja **"për atë që keni punuar"**, tregon se këto begati nuk ia japin asnjë njeriu pa llogari, si dhe nuk përfitohen me anë të imagjinatës, të pretendimeve dhe fantazive, por përftohen vetëm me anë të kryerjes së veprave të mira dhe të dobishme.

Fjala *"heni'en"* sipas Ragib Isfahaniut në veprën "Mufredat", nënkupton çdo gjë që nuk sjell vështirësi dhe nuk shkakton probleme, prandaj dhe uji, edhe ushqimi i shijshëm dhe i ëmbël është quajtur *"heni'un"*. Ndonjëherë është përdorur dhe për të treguar jetesën e rehatshme.

Kjo tregon se frutat, ushqimet dhe pijet e Xhennetit nuk ngjasojnë me ushqimet dhe pijet e kësaj bote, të cilat ndonjëherë ndikojnë keq në trup.

Mes komentuesve të Kur'anit, është çështje diskutimi, nëse urdhri për të ngrënë dhe për të pirë këtu tregon se këto begati lejohen të hahen e pihen, apo është një urdhër dhe detyrim i mirëfilltë.

Por duhet të kemi parasysh se urdhra të tillë, që përdoren gjatë mikpritjes, janë një lloj kërkese nga ana e folësit, ku respektohet mysafiri dhe një përpjekje për t'i krijuar mysafirit një mjedis të rehatshëm.

Në ajetin vijues, sërish theksohet se këto begati nuk jepen pa llogari dhe shton: **"Kështu i shpërblejmë Ne ata, që bëjnë vepra të mira."**.

Interesant është fakti se në ajetin e parë i ishte referuar "devotshmërisë", në ajetin pas tij, përqendrohet te "vepra", kurse në këtë ajet përqendrohet te "bamirësia dhe veprat e mira".

Me fjalën "*tekua*", nënkuptohet çdo lloj largimi nga mëkati, korrupsioni, politeizmi dhe mosbesimi. "Bamirësia" nënkupton çdo vepër të mirë dhe të dobishme, kurse "vepra" u referohet veprave të mira. Në këtë mënyrë bëhet e qartë se bollëku i begative hyjnore i përket vetëm këtij grupi, jo pretenduesve përgënjeshtrues të besimit, apo atyre që janë të përlyer me mëkate të llojllojshme, sado që në paraqitje duken prej grupit të besimtarëve.

Ajeti sërish thotë: **"Mjerë përgënjeshtruesit në atë Ditë!"**.

Mjerë ata që privohen nga aq shumë begati! Ky privim nuk është më pak torturues për ta, sesa zjarri përvëlues i Xhehennemit.

Duke pasur parasysh se një prej faktorëve të rëndësishëm të mohimit të Ringjalljes është dhënia pas kënaqësive kalimtare të

kësaj bote dhe pas prirjes ndaj lirive të pakushtëzuara për të përfituar në maksimum nga këto kënaqësi, në ajetin në vijim, me një ton kërcënues, u drejtohet kriminelëve dhe u thotë: **"Hani dhe kënaquni për pak kohë! Ju jeni keqbërës!"**.

Fjala *"kalilen"* tregon për jetën e shkurtër të njeriut në këtë botë, si dhe rëndësinë e paktë të të mirave të kësaj bote, në krahasim me të mirat e pafundme të Botës Tjetër.

Edhe pse disa komentues të Kur'anit pohojnë se kështu u janë drejtuar kriminelëve në Ahiret, por duke pasur parasysh që në Botën Tjetër për kriminelët nuk imagjinohet asnjë lloj përfitimi nga të mirat dhe begatitë e jetës, duhet të pranohet se kjo fjali është thirrje për ata në këtë botë.

Në realitet, të devotshmit në Ahiret i mirëpresin me respektin në të madh dhe u drejtohen me dashuri: **"Hani dhe kënaquni…"**, kurse adhuruesve të kësaj bote u drejtohen me fjalët: **"...për pak kohë! Ju jeni keqbërës!"**.

Të devotshmeve u drejtohet me fjalët: **"Ata, që bëjnë vepra të mira."**.

Kriminelëve u drejtohet: **"Ju jeni keqbërës!"**.

Sidoqoftë, kjo tregon se krimi dhe mëkati janë burim i dënimit hyjnor, i cili buron nga mosbesimi, apo rënia pre në kthetrat e epsheve.

Më pas, sërish e përmend kërcënimin: **"Mjerë përgënjeshtruesit në atë Ditë!"**.

Por ata u bënë arrogantë me magjepsjet, me pushtetin, me kënaqësitë dhe lakmitë e kësaj bote dhe në këtë mënyrë e merituan dënimin e All'llahut.

Në ajetin vijues, përmendet një faktor tjetër, i cili është shkak i devijimit, i fatkeqësisë dhe i përlyerjes së tyre: **"Kur atyre u thuhej: 'Përkuluni** (në namaz para All'llahut)**!' - ata nuk përkuleshin."**.

Shumë komentues të Kur'anit janë të mendimit se ky ajet ka zbritur për fisin Thekif, sepse, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u tha atyre: "*Falni namazin*", ata u përgjigjën: "Ne asnjëherë nuk do të përulemi para askujt. Kjo është një paturpësi për ne!".

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Ajo fe që nuk ka gjunjëzim dhe përulje, nuk ka vlerë.*".[1]

Ata jo vetëm që kishin refuzuar përkuljen dhe sexhden, përmes së cilave shfaqej shpirti arrogant i tyre, por ata as që i përuleshin All'llahut, as që u bindeshin urdhrave të Profetit, as që i njihnin dhe i pranonin të drejtat e njerëzve dhe as që tregonin modesti karshi njerëzve. Këta faktorë (mendjemadhësia dhe dhënia pas epsheve) janë shkaqet më të rëndësishme të krimit, të mëkatit, të politeizmit, të padrejtësisë dhe të shtypjes.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 10, f. 419. Po këtë domethënie e ka përmendur Alusij, në veprën "Ruhul Meanij", Kurtubij në tefsirin e tij , Zamakhsherij në "El Kesh'shaf" dhe në tefsirin "Ruhu Bejan", ajeti në fjalë.

Disa të tjerë janë të mendimit se në Kiamet atyre do t'u thuhet: "Përkuluni!".

Ky mendim nuk duket i përshtatshëm, po të kemi parasysh ajetet para dhe pas tij.

Në përfundim, për herë të fundit, në këtë sure, ajeti thotë: **"Mjerë përgënjeshtruesit në atë Ditë!".**

Kurse në ajetin e fundit të diskutimit tonë, që është dhe ajeti i fundit i sures "El Murselat", me një ton qortues, por edhe plot habi, thotë: **"Në çfarë Shpallje tjetër do të besojnë ata, pas këtij Kur'ani?!"**.

Ata nuk i besuan Kur'anit, i cili, po të zbriste mbi male, ato do të rrafshoheshin. Ata nuk u dorëzuan para një Libri qiellor dhe para një logjike racionale, por u treguan inatçorë e kryeneçë.

Hulumtim

Ashtu siç e diskutuam edhe në fillim të sures, fjalia: **"Mjerë përgënjeshtruesit në atë Ditë!"**, është përsëritur dhjetë herë në këtë sure. Kjo përsëritje është bërë për të theksuar një të vërtetë të rëndësishme dhe tronditëse. Edhe oratorët, kur duan të theksojnë një gjë, e përsërisin atë.

Por disa komentues janë të mendimit se secili prej këtyre dhjetë ajeteve parashtron një çështje të re, që ka të bëjë me

përgënjeshtrimin e çështjeve të përmendura më parë, prandaj nuk bëhet fjalë për përsëritje (nga pikëpamja e kuptimit).

Këtë sure po e mbyllim me një shprehje të marrë nga tefsiri "Ruhul Bejan": "Kjo sure i ka zbritur Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në një shpellë në afërsi të xhamisë Khejf, në tokën e Minas. Unë personalisht e kam vizituar këtë shpellë.".

O Zot! Të lutem, na bëj prej atyre që asnjëherë të mos i përgënjeshtrojmë ajetet e Tua!

O Zot! Të lutem, na ruaj ne nga arroganca, nga mendjemadhësia, nga dhënia pas epsheve, të cilat janë burimi kryesor i të gjitha të këqijave dhe krimeve!

O Zot! Të përgjërohem, Atë Ditë që të devotshmit do të gostiten me respektin më të madh në praninë Tënde, na bëj që të jemi në rreshtat e tyre!

Fundi i xhuzit njëzetenëntë.

Përmbajtja

Sure "El Mulk".....5
Përmbajtja e sures "El Mulk".....5
Mirësitë e leximit të sures "El Mulk".....7
Ajetet 1 – 5.....8
Komentimi.....9
Në univers nuk vërehet asnjë e metë apo mangësi.....9
Hulumtim.....18
Madhështia e krijimit të university.....18
Ajetet 6 – 11.....20
Komentimi.....21
Nëse do të ishim të dëgjueshëm dhe të vëmendshëm, nuk do të hynim në Xhehennem!.....21
Hulumtim.....25
Vlera e lartë e intelektit.....25
Ajetet 12 – 14.....28
Komentimi.....28
Krijuesi i botës është i Gjithëditur për të fshehtat e saj.....28
Ajetet 15 – 18.....33
Komentimi.....34
Asnjë mëkatar dhe fajtor nuk është i sigurt nga dënimi i All'llahut...34
Ajetet 19 – 21.....39
Komentimi.....40
Hidhini një vështrim shpendëve!.....40
Hulumtim.....44

Katër shkaqe për dështimin e njeriut.....44
Ajetet 22 – 27.....45
Komentimi.....46
Ata që ecin ballëlart në Rrugën e Drejtë.....46
Ajetet 28 – 30.....52
Komentimi.....52
Kush është ai që ju sjell ujë të rrjedhshëm?.....52
Hulumtim.....57
Sure "El Kalem".....59
Përmbajtja e sures "El Kalem".....60
Mirësitë e leximit të sures "El Kalem".....62
Ajetet 1 - 7 63
Komentimi.....64
Sa moral të lartë që ke!.....64
Hulumtime.....71
1- Rroli i penës në jetën e njeriut.....71
2- Një shembull nga morali i Profetit të Islamit.....75
Ajetet 8 – 16.....80
Komentimi.....81
Ata që i mbartin këto cilësi, mos i merrni si shembull.....81
Dy hulumtime.....88
1- Veset e liga.....88
2- Lëshimi dhe nënshtrimi.....90
Ajetet 17 – 25.....91
Komentimi.....92
Tregimi i pronarëve të kopshtit të gjelbëruar.....92
Ajetet 26 – 33.....96
Komentimi.....97
Përfundimi i dhimbshëm i pronarëve të kopshtit të gjelbër.....97
Hulumtim.....102
1- "Krijimi i monopolit", sprovë e madhe e pasanikëve.....102
2- Marrëdhënia mes mëkatit dhe ndërprerjes së begatisë.....104

Ajetet 34 – 41.....105
Komentimi.....106
Përgjigje e plotë.....106
Ajetet 42 – 45.....109
Komentimi.....110
Ata duan të bien në sexhde, por nuk munden.....110
Ajetet 46 – 50.....115
Komentimi.....116
Mos nxito në kërkimin e ndëshkimit.....116
Ajetet 51 – 52.....121
Komentimi.....121
Duan të të shkatërrojnë, por nuk munden!.....121
Hulumtim.....124
A është realitet syri i keq?.....124
SURE "EL HÂKKA".....127
Përmbajtja e sures "El Hâkka".....128
Mirësitë e leximit të sures "El Hâkka".....128
Ajetet 1 – 8.....129
Komentimi.....130
Dënimi i mundimshëm për popujt mohues.....130
Ajetet 9 – 12.....135
Komentimi.....135
Ku janë veshët që dëgjojnë?!.....135
Hulumtime.....138
Një tjetër virtyt nga virtytet e Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*....138
Përshtatje midis mëkatit dhe ndëshkimit.....140
Ajetet 13 – 17.....141
Komentimi.....142
Dita kur do të ndodhë ngjarja e madhe.....142
Ajetet 18 – 24.....147
Komentimi.....148
Hulumtime.....151

Një tjetër komentim për fjalën "arsh".....151
Pozita e Imam Aliut *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* dhe e shi'ave.....152
Përgjigjja e një pyetje.....152
Ajetet 25 – 29.....153
Komentimi.....153
Ah, sikur vdekja të më merrte!.....153
Hulumtimi.....156
Disa ngjarje mësimdhënëse.....156
Ajetet 30 – 37.....159
Komentimi.....160
Kapeni atë dhe lidheni me pranga!.....160
Hulumtim.....165
Fillimi i vendosjes se shenjave te shkronjat e Kur'anit.....165
Ajetet 38 – 43.....166
Komentimi.....167
Ky Kur'an, është Fjala e Zotit.....167
Ajetet 44 – 52.....172
Komentimi.....173
Nëse ai do të gënjente për Ne, nuk do t'i jepnim afat.....173
Hulumtim.....177
Surja "El Me'ârixh".....179
Përmbajtja e sures "El Me'arixh".....180
Mirësitë e leximit të sures "El Me'ârixh".....182
Ajetet 1 – 3.....183
Shkaku i zbritjes.....183
Komentimi.....186
Dënimi i shpejtë.....186
Hulumtim.....188
Vërejtje të pabaza të justifikuesve.....188
Ajetet 4 – 7.....193
Komentimi.....193
Një ditë që zgjat sa pesëdhjetë mijë vjet.....193

Ajetet 8 – 18.....197
Komentimi.....198
Dita kur asnjë mik nuk pyet për mikun.....198
Ajetet 19 – 28.....203
Komentimi.....204
Vetitë e njerëzve të merituesheëm.....204
Hulumtim.....205
A ekziston në natyrën e njeriut ligësia dhe e keqja?.....205
Ajetet 29 – 35.....212
Komentimi.....213
Pjesa tjetër e karakteristikave të banorëve të Xhennetit.....213
Ajetet 36 – 41.....218
Komentimi.....219
Me çfarë fytyre lakmon Xhennetin?.....219
Hulumtim.....223
Zoti i "lindjeve" dhe "perëndimeve".....223
Ajetet 42 – 44.....225
Komentimi.....225
Pothuajse po vrapojnë drejt idhujve të tyre.....225
Sure "Nuh".....229
Përmbajtja e sures "Nuh".....230
Mirësitë e leximit sures "Nuh".....232
Ajetet 1 – 4.....233
Komentimi.....234
Mesazhi i parë i Profetit Nuh (Paqja qoftë mbi të!).....234
Hulumtim.....237
Ndikimi i faktorëve shpirtërorë në shkurtimin, apo zgjatjen e jetës.....237
Ajetet 5 – 9.....238
Komentimi.....239
Shfrytëzimi i çdo mundësi për udhëzimin e tyre, por ...!!!.....239
Hulumtim.....243
1- Shembulli i thirrjes.....243

2- E përse largimi nga e vërteta?.....244
Ajetet 10 – 14.....246
Komentimi.....247
Shpërblimi i besimit në këtë botë.....247
Hulumtim.....249
Lidhja e devotshmërisë me mirëqenien.....249
Ajetet 15 – 20.....253
Komentimi.....254
All'llahu iu krijoi juve nga toka ashtu si bimët.....254
Ajetet 21 – 25.....259
Komentimi.....260
Mirësia e All'llahut është me ty.....260
Ajetet 26 – 28.....267
Komentimi.....268
Ky popull i shthurur dhe imoral duhet të zhduket.....268
Hulumtim.....272
Nuhu, Profeti i parë prej Profetëve të vendosmërisë së lartë *(ulil azmi)*...272
Sure "El Xhinn".....276
Përmbajtja e sures "El Xhinn".....277
Mirësitë e leximit të sures "El Xhinn".....278
Ajetet 1 – 6.....279
Shkaku i zbritjes.....280
Komentimi.....283
Ne kemi dëgjuar një Kur'an të mrekullueshëm!.....283
Ajetet 7 – 10.....290
Komentimi.....291
Më parë uleshim për të dëgjuar diçka, por.....291
Ajetet 11 – 15.....295
Komentimi.....296
Ne e dëgjuam udhëzimin dhe besuam në të.....296
Ajetet 16 – 19.....300
Komentimi.....301

Me këto begati të shumta, do t'ju vëmë në sprovë.....301
Hulumtim.....308
Shtrembërim në komentimin e ajetit "ue ennel mesaxhide lil'lah".....308
Ajetet 20 – 24.....311
Komentimi.....312
Çdo gjë është në dorën e All'llahut dhe jo në dorën time.....312
Hulumtim.....317
1- Sinqeriteti i udhëheqësve hyjnorë.....317
2- Nuk është e rëndësishme sasia por cilësia.....318
Ajetet 25 – 28.....320
Komentimi.....321
Vetëm All'llahu e di të padukshmen.....321
Hulumtim.....324
Hulumtim të zgjeruar rreth dijes së fshehtë.....324
Rrugë apo mënyra të tjera për të vërtetuar dijen e fshehtë të Imamëve....336
Hulumtim rreth krijimit të xhindit.....338
Sure "El Muzzemmil".....344
Përmbajtja e sures "El Muzzemmil".....345
Mirësitë e leximit të sures "El Muzzemmil".....348
Ajetet 1 - 5 349
Komentimi.....350
O ti i mbuluar! Çohu!.....350
Hulumtime.....354
1- Ngritja natën për të lexuar Kur'an dhe për t'u lutur.....354
2- Kuptimi i fjalës "et tertijlu".....356
3- Mirësitë e namazit të natës.....358
Ajetet 6 – 10.....360
Komentimi.....361
Ndikimi i adhurimit gjatë natës.....361
Ajetet 11 – 19.....369
Komentim.....370
Lërma mua llogarinë e këtyre mëkatarëve arrogantë!.....370

Hulumtim.....377
Katër llojet e etapave të dënimit të All'llahut.....377
Ajeti 20.....379
Komentimi.....380
Lexoni Kur'an sa të keni mundësi!.....380
Hulumtime.....388
1- Domosdoshmëria e përgatitjes ideologjike dhe kulturore.....388
2- Këndimi i Kur'anit, i shoqëruar me reflektim dhe meditim.....389
3- Përpjekja për të siguruar jetesën, e barasvlershme me xhihadin në Rrugën e All'llahut.....390
Sure "El Muddeththir".....392
Përmbajtja e sures "El Muddeththir".....393
Mirësitë e leximit të sures "El Muddeththir".....395
Ajetet 1 – 10.....396
Komentimi.....397
Ngrihu dhe tërhiqja vërejtjen botës!.....397
Ajetet 11 – 17.....409
Shkaku i zbritjes.....410
Komentimi.....414
Velijdi, një pasanik mendjemadh dhe mosmirënjohës.....414
Ajetet 18 – 25.....419
Komentimi.....420
Vdekja qoftë mbi të, çfarë kurthi të mallkuar kurdisi!.....420
Ajetet 26 – 30.....424
Komentimi.....424
Ky është fati i tij ogurzi.....424
Hulumtim.....429
Nëntëmbëdhjetë engjujt e dënimit.....429
Ajeti 31.....430
Komentimi.....431
Për çfarë është numri i përgjegjësve të zjarrit?.....431
Hulumtim.....435
Numri i ushtrisë së All'llahut.....435

Ajetet 32 – 37.....438
Komentimi.....438
Ajetet 38 – 48.....442
Komentimi.....442
Ju, pse jeni prej banorëve të Xhehennemit?.....443
Hulumtim.....450
Ndërmjetësuesit e Ditës së Gjykimit.....450
Ajetet 49 – 56.....454
Komentimi.....455
Ikin nga e vërteta si ikën zebra nga luani.....455
Sure "El Kijame".....461
Përmbajtja e sures "El Kijame".....462
Mirësitë e leximit të sures "El Kijame".....463
Ajetet 1 – 6.....464
Komentimi.....465
Betohet në Ditën e Kiametit dhe në shpirtin qortues.....465
Dy hulumtime.....473
1- Gjykata e ndërgjegjes apo Ringjallje e vogël?.....473
2- Emrat e Kiametit në Kur'anin e Madhërishëm.....476
Ajetet 7 – 15.....479
Komentimi.....480
Njeriu është gjykatësi më i mirë i vetes.....480
Ajetet 16 – 19.....487
Komentimi.....487
Mbledhja dhe ruajtja e Kur'anit është përgjegjësi e jona!.....487
Ajetet 20 – 25.....492
Komentimi.....492
Fytyra të qeshura dhe të zymta në skenën e Kiametit.....492
Ajetet 26 – 30.....499
Komentimi.....499
Hulumtim.....502
Çasti i dhimbshëm i vdekjes.....502

Ajetet 31 – 40.....506
Komentimi.....507
Njeriu është krijuar prej një pikë fare të pavlerë.....507
Dy hulumtime.....513
1- Transformimet e fetusit, apo ringjalljet e përsëritura.....513
2- Sistemi i gjinisë në botën njerëzore.....514
Sure "El Insan".....516
Përmbajtja e sures "El Insan".....517
Mirësitë e leximit të sures "El Insan".....518
A ka zbritur kjo sure në Medine?.....518
Ajetet 1 – 4.....522
Komentimi.....523
Njeriun e krijuam nga një farë e pavlerë.....523
Hulumtim.....530
Bota e çuditshme e fetusit.....530
Ajetet 5 – 11.....532
Shkaku i zbritjes.....533
Argument madhështor mbi virtytin e Ehli Bekjtit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.....533
Komentimi.....540
Shpërblimi madhështor i mirëbërësve të devotshëm.....540
Hulumtim.....549
Ushqyerja e të uriturve është nga mirësitë më të larta.....549
Ajetet 12 – 22.....552
Komentimi.....554
Shpërblimet madhështore në Parajsë.....554
Ajetet 23 – 26.....566
Komentimi.....567
Pesë urdhra të rëndësishme për sukses.....567
Hulumtim.....571
Ajetet 27 – 31.....573
Komentimi.....574
Ky është një paralajmërim, zgjedhja është e juaja!.....574

Sure "El Murselat".....579
Përmbajtja e sures "El Murselat".....580
Mirësitë e leximit të sures "El Murselat".....581
Ajetet 1 – 15.....583
Komentimi.....584
Premtimet e All'llahut janë të vërteta, mjerë përgënjeshtruesit!.....584
Hulumtim.....591
Përmbajtja e këtyre betimeve.....591
Ajetet 16 – 28.....593
Komentimi.....594
Me gjithë këto manifestime të fuqisë, sërish dyshoni në Ringjallje?!....594
Ajetet 29 – 40.....601
Komentimi.....602
As kanë fuqinë për t'u mbrojtur e as rrugë për të shpëtuar.....602
Ajetet 41 – 50.....609
Komentim.....610
Në çfarë Shpallje tjetër do të besojnë ata?!.....610
Hulumtim.....615

ألأمثل فى تفسير كتاب الله المنزل

مؤلف: العلامة الفقيه المفسر ناصر مكارم الشيرازى

الجزء التاسع و العشرون

تيرانا: 2020

نام کتاب: الامثل فی تفسیر کتاب الله المنزل (جزء بیست و نهم)

نویسنده: فقیه مفسّر حضرت آیة الله العظمی ناصر مکارم شیرازی (دام ظلّه)

ترجمه به زبان آلبانی: والبونا هروزُوا

زیر نظر: وُلْنَتْ مِرْیَا

ویرایش: یریدا کولا

مقابله: رایموندا فزا

تصحیح ادبی: ویولسا کارای

صفحه بندی و جلد: صبریه فزا

ناشر: جمعیت "نسیم"

چاپ: انتشارات "لیلو"

تیرانا: 2020